KONFERENCA KOMBËTARE E SHKENCAVE MJEKËSORE 10
10TH NATIONAL CONFERENCE OF MEDICAL SCIENCES

KKSHM

ABSTRACTS BOOK

2022

MAJ 2022 | MAY 2022

LIBRI I ABSTRAKTEVE| ABSTRACTS BOOKS

Konferenca Kombëtare e Shkencave Mjekësore 10 | 10th National Conference of Medical Sciences

12-14 Maj 2022 | 12 th- 14th May 2022

www.kkshm.weebly.com

Përgatiti për print: Xhoel NONAJ
Botimi i dhjetë, Tiranë 2022

© 2022 KKSHM



FJALA PËRSHËNDETËSE

GREETING SPEECH



Të dashur pedagogë e studentë të UMT,
Të nderuar miq, të ftuar e bashkëpunëtorë,

Kam kënaqësinë t'ju mirëpresim në Takimin e 10-të të Shkencave Mjekësore. Në vazhdën e një tradite tashmë 10-vjeçare, Universiteti i Mjekësisë, në bashkëpunim me aktorë të rëndësishëm të sistemit shëndetësor shqiptar dhe Këshillin Studentor, organizon këtë event shkencor, ku do të prezantohen punime nga të gjitha fushat e profilet që mbulon Universiteti ynë.

Përveç prezantimeve të pedagogëve dhe kërkuesve shkencorë, në këtë event do të referohen edhe punime të realizuara nga studentët nën drejtimin e pedagogëve të tyre. Unë besoj se kjo është rruga e duhur për të orientuar studentët tanë, përveç studimit, edhe drejt rrugës së bukur e të vështirë të humultimit shkencor. Universiteti ynë, i cili sivjet feston 70 vjetorin e tij, do të vazhdojë të udhëheqë studentët drejt rrugës së vyer akademike.

Është kënaqësi të përshëndes me këtë rast edhe mbi 50 lektorë të huaj që do të na nderojnë me pjesëmarjen e tyre! E di që një sipërmarrje e tillë paraqet sfida e vështirësi të shumta por jam po aq i ndërgjegjshëm që sfidat e mëdha mund të kapërcehen vetëm përmes përpjekjes së përbashkët të guximtarëve, të cilët besojnë tek vizioni i tyre, ata të cilët kanë zemër të qëndrojnë përballë çdo vështirësie dhe që kurrë s'do t'i brejë ndërgjegjia, pasi janë përpjekur me të gjithë fuqinë e ideve të tyre.

Duke falenderuar për përpjekjet e tyre Komitetin Shkencor dhe atë Organizativ, shpresoj që ky event shkencor të jetë në lartësinë e kohës, duke ngritur problematika shkencore e sociale, si dhe duke diskutuar mbi to me përgjegjësi dhe profesionalizëm.

Në emër të Universitetit të Mjekësisë, ftoj profesionistët e shëndetit të bëhen pjesë aktive e kësaj përpjekje të përbashkët.

Ju mirëpresim!

Prof. Dr. Arben Gjata
Rektor - Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

GREETING SPEECH

Dear pedagogues and students of the Medical University of Tirana
Dear friends, guests and collaborators,

I have the pleasure to welcome you to the Tenth Conference of Medical Sciences. In the wake of a 10-year tradition, the Medical University of Tirana in collaboration with important elements of our national healthcare system and the student council have organized this scientific event, in which the docents will publish their scientific research from different fields that our University covers.

Beside the lectures of pedagogues and scientific research, in this event students will lecture their scientific research done under the surveillance and with the help of their pedagogues. I believe this to be the right path to orientate our students not only through study and practice that our University offers, but also through the beautiful, but difficult path of scientific research. Our university, which this year celebrates its 70th anniversary, will continue to lead students towards the precious academic path.

It is a pleasure to salute through this event over fifty foreign lecturers that will honor us with their participation! I do know that such enterprise presents many challenges and much clutter, but i am also very aware that the important challenges can be succeeded only through the joint effort of the courageous, that believe in their vision, who have the strength to face any difficulty and who will never regret their decision as they have tried with all the power to give life to their ideas.

Thanking the Scientific and Organizational Committee for their effort, I hope that this scientific event will be up to date, raising scientific and social issues and discussing them responsibly and professionally.

Representing the Medical University of Tirana, I invite health professionals to become an active part of this joint effort.

You are welcomed!

Prof. Dr. Arben Gjata
Rector of the Medical University of Tirana



KOMITETI SHKENCOR & ORGANIZATIV

SCIENTIFIC & ORGANIZING COMMITTEE

PRESIDENT I KOMITETIT SHKENCOR/PRESIDENT OF SCIENTIFIC COMMITTEE

Prof. Dr Arben GJATA

KOMITETI SHKENCOR INTERNACIONAL/INTERNATIONAL SCIENTIFIC COMMITTEE

Prof. Dr. Rosa CHAVIANO MORAN
Prof. Dr. Sergio CAPUTI
Prof. Dr. Francesco INCHINGOLO
Prof. Dr. Florian BEUER
Prof. Dr. Valeria TONINI
Prof. Dr. Dirk PICKUTH
Prof. Dr. Roberto RAIMONDI
Prof. Dr. Cihan URAS
Prof. Dr. Nuran BESE
Prof. Dr. Yesim ERALP
Prof. Dr. Mohammad JAFFERANY
Prof. Dr. Gianluca GAMBARINI
Prof. Dr. Giampietro FARRONATO
Prof. Dr. Roberto PASQUARELLI
Prof. Dr. Vincenzo CAMPANELLA
Prof. Dr. Giulia DONADEL
Prof. Dr. Filadelfio CONIGLIONE
Prof. Dr. Burak DEMIRALP
Prof. Dr. Gianluca TARTAGLIA
Prof. Dr. Maher ALMASRI
Prof. Dr. Antonio ROMANO
Prof. Dr. Piero VENEZIA
Prof. Dr. Antonio FERRANTE
Prof. Dr. Luca TESTARELLI
Prof. Dr. Attilio CASTALDO
Prof. Dr. Giovanna ORSINI
Prof. Dr. Gaetano MARENZI
Prof. Dr. Filiberto MASTRANGELO
Prof. Dr. Marina DI DOMENICO
Prof. Dr Santosh KUMAR TADAKAMADLA
Prof. Dr Faeq AL QUADRI
Prof. Dr Stephen THADDEUS CONNELLY
Prof. Dr Massimo DEL FABBRO
Prof. Dr Patricia OYOLE
Prof. Dr Gianfranco FAVIA
Prof. Dr Aldo Bruno GIANNI'
Prof. Dr. Maria CONTALDO
Prof. Dr Rosario SERPICO
Prof. Dr Antonio SCARANO
Prof. As. Daniela DI VENERE
Prof. Dr. Lumnie KQIKU
PhD. Bruna SINJARI
PhD. Beatrice FEMMINELLA
PhD. Lorenzo ARCURI
PhD. Giovanni Tommaso ROCCA
PhD. Gianmaria D'ADDAZIO
PhD. Gianna DIPALMA
PhD. Felice LORUSSO
PhD. Marco FARRONATO
PhD. Ioana Roxana BORDEA
Dr. Giuseppina MALCANGI
Dr. Alessio ZANZA
Dr. Rodolfo REDA
Dr. Luisa LIMONGELLI
Dr. Antonio RUSSILLO
Dr. Ludovica NUCCI
Dr. Fabrizia D'APUZZO
Dr. Filippo CARDARELLI
Dr. Marco FARRONATO
Dr. Denisa HAZBALLA
Dr. Luigi ZAGARIA
Dr. Alessio DANILO INCHINGOLO
Dr. Angelo MICHELE INCHINGOLO
Dr. Biaggio RAPONE
Dr. Christian MONTI
Dr. Erica COSTANTINI
Dr. Imena REXHEPI
Dr. Manlio SANTILLI
Dr. Luigi ROMANO
Dr. Vincenzo TOSCO
Dr. Riccardo MONTERUBBIANESI
Dr. Giovanni DI NARDO

KOMITETI SHKENCOR/ SCIENTIFIC COMMITTEE

Prof. Dr. Arben GJATA
Prof. Dr. Xheladin DRAÇINI
Prof. Dr. Ledjan MALAJ
Prof. Dr. Adem ALUSHI
Prof. Dr. Agron DOGJANI
Prof. Dr. Agron YLLI
Prof. Dr. Ali REFATLLARI
Prof. Dr. Alma IDRIZI
Prof. Dr. Andi KORAQI
Prof. Dr. Anesti KONDILI
Prof. Dr. Anila GODO
Prof. Dr. Anyla BULO
Prof. Dr. Arben PILACA
Prof. Dr. Ariel COMO
Prof. Dr. Bajram HYSA
Prof. Dr. Diana BROVINA

Prof. Dr. Edmond PISTULI
Prof. Dr. Ermira VASILI
Prof. Dr. Jera KRUJA
Prof. Dr. Lindita XHEMNICA
Prof. Dr. Margarita RESULI
Prof. Dr. Mehdi ALIMEHMETI
Prof. Dr. Myftar BARBULLUSHI
Prof. Dr. Najada COMO
Prof. Dr. Pavli KONGO
Prof. Dr. Ramazan ISUFI
Prof. Dr. Rozarka BUDINA
Prof. Dr. Rudin DOMI
Prof. Dr. Ruzhdie QAFMOLLA
Prof. Dr. Suela KELLICI
Prof. Dr. Tritan KALO
Prof. Dr. Vilma PAPAJANI
Prof. Dr. Xhina MULO
Prof. As. Edit XHAJANKA
Prof. As. Ilirjana ZEKJA
Prof. As. Admir NAKE
Prof. As. Albana FICO
Prof. As. Besim BOCI
Prof. As. Besnik GAVAZI
Prof. As. Brunilda MYFTARI
Prof. As. Diamant SHTIZA
Prof. As. Ela HOTI
Prof. As. Entela HALOGI
Prof. As. Erda QORRI
Prof. As. Ergys RAMOSACO
Prof. As. Erjon TROJA
Prof. As. Gentian STRONI
Prof. As. Helidon NINA
Prof. As. Irena KOLA
Prof. As. Kenan FERATI
Prof. As. Klejda HARASANI
Prof. As. Merita BARDHOSHI
Prof. As. Mirela MIRAÇI
Prof. As. Monika FIDA
Prof. As. Tatjana CAJA
Prof. As. Teuta PUSTINA
Dr. Shk. Adela PEROLLA
Dr. Shk. Arberesha FERATI
Dr. Shk. Daniela TEFERICI
Dr. Shk. Dariel THERESKA
Dr. Shk. Ergeta KTONA
Dr. Shk. Iris HOXHA
Dr. Shk. Leart BERDICA
Dr. Shk. Linda MATUA
Dr. Shk. Prunela POLIÇI
Dr. Shk. Teona BUSHATI
Dr. Agon HOTI
Dr. Andia KUSTA
Dr. Anis THODHORJANI
Dr. Arianit JAKUPI
Dr. Aurel DEMIRAJ
Dr. Bisela ASLLANAJ
Dr. Blerina DUKA
Dr. Dardana MEHAJ
Dr. Defrim GOMA
Dr. Diana TOMA
Dr. Fatmir BRAHIMAJ
Dr. Gentjan ASLLANAJ
Dr. Kleva SHPATI
Dr. Nikoll DEDA
Dr. Nilena ERIKSEN
Dr. Pleurat SEJDIU
Dr. Xhejni BORSHI

KOMITETI ORGANIZATIV/ ORGANIZING COMMITTEE

Dr. Shk. Alba KOSHOVARI
Dr. Shk. Alert XHAJA
Dr. Shk. Algen ISUFI
Dr. Shk. Alketa QAFMOLLA
Dr. Shk. Almira ISUFI
Dr. Shk. Altina XHAFERRI
Dr. Shk. Andis QENDRO
Dr. Shk. Brunilda GASHI
Dr. Shk. Enida PETRO
Dr. Shk. Esat BARDHOSHI
Dr. Shk. Fatmir LELA
Dr. Shk. Ilma ROBO
Dr. Shk. Klejda TANI
Dr. Shk. Klodiana POSHI
Dr. Shk. Koco GJILO
Dr. Shk. Manola KELMENDI
Dr. Shk. Rosela XHEMNICA
Dr. Shk. Silvana BARA
Dr. Shk. Stela PANTEQI
Dr. Dervish KËRÇUKU
Dr. Emirvina KOLICI
Dr. Endrit PAPARISTO
Dr. Eriselda MALUSHI
Dr. Naile BREGU
Dr. Neada HYSENAJ
Dr. Renato ISUFI
Msc. Adelajda HOXHA
Msc. Adriana ZHAMA
Msc. Fribianka HOXHA
Enea CUNI
Xhoel NONAJ

KKSHM

ABSTRACTS BOOK

2022

PËRMBAJTJA

TABLE OF CONTENTS

PËRMBAJTJA
TABLE OF CONTENTS

ABSTRACTS OF MEDICAL SCIENCES/ 75

ABSTRAKTET E SHKENCAVE MJEKËSORE 75

EVOLUTION OF SURGICAL MANAGEMENT FOR BREAST CANCER IN THE MODERN ERA 75

Prof. Dr. Cihan Uras 75

EVOLUCIONI I MENAXHIMIT KIRURGJIKAL PËR KANCERIN E GJIRIT NË EPOKËN MODERNE. 75

Prof. Dr. Cihan Uras 75

ARTIFICIAL INTELLIGENCE AND DIGITAL LEADERSHIP – THE FUTURE HAS ALREADY BEGUN 76

Prof. Dirk Pickuth MD, PhD, MDs[1] 76

INTELIGJENCA ARTIFICIALE DHE UDHËHEQJA DIXHITALE- E ARDHMJA TASHMË KA FILLUAR. 77

Professor Dirk Pickuth MD, PhD, MDs (honoris causa). 77

PSYCHODERMATOLOGY: AN UNDER-RECOGNIZED FRONTIER IN DERMATOLOGY AND PSYCHOSOMATIC MEDICINE 78

Mohammad Jafferany, MD, FAPA, MCPS[1] 78

PSIKODERMATOLOGJIA: NJË KUFI I NJOHUR NË DERMATOLOGJI DHE MJEKËSI PSIKOSOMATIKE. 78

Mohammad Jafferany, MD, FAPA, MCPS[1] 78

RADIOTHERAPY AFTER PRIMARY SYSTEMIC TREATMENT 79

Prof. Dr. Nuran Bese 79

RADIOTERAPIA PAS TRAJTIMIT SISTEMIK PARËSOR 79

Prof. Dr. Nuran Bese 79

INVESTIMENTS IN KNOWLEDGE AND ITS INFLUENCES ON GDP 80

Roberto Raimondi 80

INVESTIMET NË NJOHURI DHE NDIKIMET E SAJ NË GDP 81

Roberto Raimondi 81

GIANT RETROPERITONEAL SARCOMAS: A SURGERY CHALLENGE BETWEEN GUIDELINES AND IMPROVISATION 81

Valeria Tonini 81

SARKOMAT GJIGANTE RETROPERITONEALE: NJE SFIDE KIRURGJIKALE MIDIS UDHEZIMEVE DHE IMPROVIZIMIT. 82

Valeria Tonini 82

ADVANCES IN THE SYSTEMIC TREATMENT OF BREAST CANCER: NAVIGATING MANAGEMENT THROUGH A MAZE OF OPTIONS 83

Prof. Dr. Yesim Eralp 83

PËRPARIMET NË TRAJTIMIN SISTEMATIK TË KANCERIT TË GJIRIT: DREJTIMI I MENAXHIMIT PËRMES NJË LABIRINTI OPSIONESH 83

Prof. Dr. Yesim Eralp 83

KUJDESI INFERMIEROR NË PACIENTËT ME SËMUNDJE MALINJE TË GJAKUT. 83

Dr.Adela Perolla, Migerta Lahi. 83

RUXOLITINIB DHE COVID – 19 84

Adela Perolla, Elsuarta Calliku, Tatjana Caja 84

QASJA NDAJ HEPATITIT B: VLERËSIMI YNË I STATUSIT TË IMUNIZIMIT DHE NEVOJA PËR RIVAKSINIM 85

Dr. Adilta Bejko, Dr. Elira Tashi, Dr. Ervin Bejko, Dr. Estefania Tulo 85

4 SHËNJUES TË RINJ BIOLOGJIKË. INTELIGJENCA (IQ). VEÇORITË (ID) E TYRE. EPËRSI. KUFIZIME. 86

Sibora Hasanaj, Xhesika Agaj, Erida Xhafi, Elisa Daci, Prof.Asoc.Dr. Admir Nake 86

VDEKJA NGA MENINGJITI STREPTOKOKSIK DHE MENINGOKOKSIK 86

Admir Sinamati[1], Geri Mehmeti[1], Fatos Sinani[1], Arben Lloja[2]86

METASTAZAT PULMONARE NË KUSHTET E PANDEMISË COVID-19. 87

Adrian Hoti 87

ATLS® COURSE ALBANIA, NJË MUNDËSI E SHKËLQYER PËR EDUKIMIN E PROFESIONISTËVE SHËNDETËSORË NË MENAXHIMIN E TRAUMËS... 87

Prof. Asc. Dr. Agron Dogjani MD, PhD, FACS, FISS, FICS [1], Prof. Dr. Kastriot Haxhirexha MD, PhD [2] 87

DIAGNOZA DHE TRAJTIMI I TROMBIT NË VENTRIKULIN E MAJTË PAS INFARKTIT TË MIOKARDIT 88

Albana Doko Banushi[1,2], Endri Hasimi [2], Vilma Paparisto[2] 88

ACIDI URIK DHE VESHKA 89

Albana Gjyzari, Olta Qyrku, Ilirjan Gjyzari 89

TIROIDITI HASHIMOTO SI NJË PATOLOGJI AUTOIMUNE QË RRIT RISKUN PËR KARCINOMË TË TIROIDES DHE NJË VËSHTRIM EPIDEMIOLOGJIK NË VENDIN TONË. 90

Dr. Albina Ndoja 90

QASJE NDAJ ALERGJISË MOLEKULARE, DIAGNOSTIKA E ALERGJIVE TË FËMIJËRISË 90

Albjola Maloku, Adilta Bejko 90

PËRDORIMI I BARNAVE ANALGJEZIKE NË STUDENTËT E FSHMT **91**
Migerta Lahi, Alert Xhaja Dr.Sh.M. 91

ORF (ECTHYMA CONTAGIOSUM) E TRANSMETUAR NGA NJË LOPË TE NJË NJERI: RAPORTIM RASTI (DIAGNOSTIKIM I GABUAR I NJË SËMUNDJE TË RRALLË) **92**
A.Xhaja. E. Shkodrani, M.Vargu 92

NJË RAST I RRALLË I MYCOSIS FUNGOIDES QË IMITON PSORIASIS VULGARIS **92**
A.Xhaja, S.Dedej 92

ANOREKSIA DHE BULIMIA , PATOLOGJI TË DASHURISË **93**
Alketa Çoku 93

COVID – 19 DHE MANIFESTIMET OKULARE **93**
Dr. Shk. Alketa Tandili, Prof. ASC. Arjeta Grezda, Meriana Kuka 93

TERAPIA ME QELIZA CAR-T, NJË ERË E RE NË TRAJTIMIN E KANCERIT. **94**
Cili.A, Perolla.A, Calliku.E, Pulluqi.P, Caja.T, Ivanaj.A. 94

NJË DEFEKT I MURIT TË BARKUT ME FISTULA TË ZORRËVE PAS RIPARIMIT TË HERNISË PRERËSE DUKE PËRDORUR RRJETË POLIPROPILENI **95**
Alma Llukacaj, Bilbil Rakipi, Nertila Kodra, Myzafer Kaci, Aldi Shani, Majlinda Naco, Prof. Arvin Dibra, Prof. Etmont Celiku95

SCREENING I TË POSALINDURIT DHE RËNDËSIA E TIJ PËR NDJEKJEN E FËMIJËS. **96**
Alma Nurçe[1], Vjollca Hajro[2], Esmeralda Thoma[1].Emirvina Koliçi[1], Enkeleida Kamberi[3], Rozeta Shahinaj[4], Irena Kola[1], Klodi Poshi[5] 96

MENAXHIMI I TË PORSALINDURIT TË NËNËS TË KONFIRMUAR OSE TË DYSHUAR PËR COVID-19. **97**

Alma Nurçe[1], Vjollca Hajro[2], Enkeleida Kamberi[3], Rozeta Shahinaj[4], Emirvina Koliçi[1], Esmeralda Thoma[1] 97

EFEKTSHMËRIA E KOMUNIKIMIT ALTERNATIV AUMENTATIV SI TERAPI NDIHMUESE NË REHABILITIMIN LOGOPEDIK 98

Msc. Antigoni Bullari[1], Ba. Ketrin Agaraj[2] 98

ROLI I TEKNIKUT RADIOLOG NW SCREENING MAMOGRAFIK 98

Miselda Kalashi[1], Ermira Muhadri[1], Ira Kadiu[1], Rina Berisha[2], Ilira Hoxha[1] , Altina Xhaferri[3] 98

GABIMET DHE PËRGJEGJËSIA PROFESIONALE E TEKNIKUT RADIOLOG 99

Irena LIKA[1], Den KONGJONI[1], Eldi FYSHKU[1], Selena KOLONJARI[2], Xhoana RUCI[1], Elvira PERVIZI[1] , Dr. Altina XHAFERI[3] 99

IMAZHERIA E TRUPAVE TË HUAJ 100

Altina Xhaferi[1], Enida Xhaferi[2], Ilir Lumi[3] 100

DIAGNOZA MIDIS KARCINOMËS KUTANE TË QELIZAVE BAZALE (BBC) DHE ASAJ TË QELIZAVE SQUAMOZE (SCC), KUSHT I RËNDËSISHËM PËR ORIENTIMIN TERAPEUTIK 101

A.Cenko[1], E. Shkodrani[2], A.Xhaja[3] 101

KINETIKA E ANTITRUPAVE IGG DHE IGM SPECIFIKE NDAJ SARS COV 2 NË SËMUNDJEN COVID 19. 102

Andi Koraqi, Denada Lacej, Rea Karafili, Fatjon Cuko 102

REHABILITIMI FIZIOTERAPEUTIK N COVID-19 102

Andromeda Lalaj Keci, Joana Xhema 102

DIAGNOZA E MENAXHIMI I DISA SITUATAVE EMERGJENTE NE ONKO – HEMATOLOGJINE PEDIATRIKE. 103

Prof.Dr.Anila Godo, Prof.Dr.Eleni Nastas, Dr.Shk.Mirela Xhafa, Prof.As.Dr.Donjeta Bali, Dr. Mirzana Kapllani, Prof.As.Dr.Manika Kreka, Dr.Shk.Daniela Nikaj 103

JO ÇDO DEPRESION MADHOR ËSHTË DEPRESION UNIPOLAR 104

Dr. Shk. Anila Hashorva[1] 104

VARIACIONET ANATOMIKE TË RRUGËVE BILIARE INTRA DHE EKSTRAHEPATIKE DHE RËNDËSIA E TYRE NË PRAKTIKËN KLINIKE. 104

Anila Kristo[1], Joneda Barjamaj[2] 104

ANATOMIA E SËMUNDJES SË REFLUKSIT, SHFAQJET EZOFAGEALE DHE EKSTRAEZOFAGEALE DHE REKOMANDIMET AKTUALE TË MJEKIMIT 105

Anila Kristo[1], Jonila Çela[2], Artan Kristo[3], Nikollaq Leka[1] 105

RËNDËSIA E USHTRIMEVE TË FRYMËMARRJES DHE ATO OROFACIALE NË TRAJTIMET LOGOPEDIKE. 106

Anita Ferati 106

ASPEKTE TEORIKE MJEKOLIGJORE MBI KQYRJEN E KUFOMËS NË VENDIN E NGJARJES. 106

Prof.Asc.Arben Lloja, Dr.Ilir Decolli, Dr. Fatos Sinani, Dr.Donjet Lloja 106

SFIDAT QË DUHEJ TË PERBALLONIN TË MOSHUARËT GJATË PANDEMISË COVID 19. 107

Prof Arben Pilaca 107

DEMENCA POSTPARTUM 107

Prof.Ariana Pojani[1] ,Albanian University. 107

MALFORMACIONET ARTERIO-VENOZE CEREBRALE: OPSIONET E TRAJTIMIT. 108

Artur Xhumari 108

NJË RAST ME LEZION DIELAFOY DHE NJË PËRDITËSIM I TRAJTIMIT AKTUAL. 108
Arvit Llazani, Marsela Sina 108

PARAMETRAT INFLAMATORË GJATË NDJEKJES SË PACIENTIT ME COVID-19. 109
Asead Abdyli, Gentian Huti, Driola Hoxha, Altin Papa 109

RISITË NË PRAKTIKAT E MENAXHIMIT SPITALOR DHE AMBULATOR TË PATOLOGJIVE KARDIOVASKULARE GJATË PANDEMISË SË COVID-19 110
Dr. Aurel Demiraj[1], Arbër Shehu[2] 110

KOMPLIKACIONET KARDIOVASKULARE TË COVID-19 111
Dr. Aurel Demiraj[1], Flavio Sula[2] 111

MENAXHIMI I EMERGJENCAVE KARDIAKE GJATË PANDEMISË SË COVID-19 112
Dr. Aurel Demiraj[1], Silvi Zhobe[2] 112

TEKNIKAT DHE RISITË NË KARDIOLOGJINË INVAZIVE 2020 – 2022, COVID-19 DHE JO VETËM 113
Dr. Aurel Demiraj[1] 113

SFIDAT E SIGURISË USHQIMORE DHE TË DHËNAT LABORATORIKE NË LIDHJE ME NGARKESËN MIKROBIKE TË PRODUKTEVE USHQIMORE. 114
Dr. A Xhixha[1], Dr. A Xhixha[2], E.Uzuni[1], J.Hasa[1] 114

PËRCEPTIMET E STUDENTËVE TË INERMIERISË PËR NDËRLIDHJEN E MËSIMIT NË LABORATORE DHE PRAKTIKES KLINIKE INSTITUCIONALE. 114
Agnesa Kadrijaj, Lirigzon Goçaj, Viola Haxhija, Argjiro Alija MSc, Bekim Sejdiu PhD cand 114

ERIBULIN MESILAT ME DOZË TË ULËT FRENON PËRHAPJEN E QELIZAVE DHE INDUKTON APOPTOZËN NË QELIZAT E GLIOBLASTOMËS NJERËZORE 115

Ayşenur Aykan, 1 MSC; Belisa Kaleci, 2* PhD; Gamze Tanriverdi, 2 PhD; Meral Koyuturk, 2 MD, PhD; Zeliha Yazici, 3 PhD. 115

RINOPLASTIKA ME PIEZO TRENDBASHKËKOHOR I KIRURGJISË ESTETIKE TË HUNDËS 116

Prof.Asoc.Besim Boçi, Arjola Brahimi 116

TË DHËNA EPIDEMIOLOGJIKE TË INTERVENTEVE KIRURGJIKALE PLASTIKE NË REGJIONIN E KOKË-QAFËS NË KLINIKËN E DJEGIE PLASTIKËS NË QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE "NENE TEREZA". 116

Besnik Faskaj 116

KOMPLIKACIONET JO RESPIRATORE TË COVID -19 117

Besnik Filaj, Asead Abdyli, Gentian Huti, Driola Hoxha 117

EFEKTET E PANDEMISË COVID-19 NË TRAJTIMIN DHE MENAXHIMIN E PACIENTËVE ME PATOLOGJI TUMORALE NË NJESINË E KIMIOTERAPISË 118

Dr. Bledi Kreka 118

MASTOCITOZA 119

Blerta Lame[1], Laerta Pupo[2] 119

PLACENTA INCRETA PARAQITET SI URGJENCË OBSTETRIKE. RAPORTI I RASTIT. 119

Daniela Nakuci[1], Erisa Kola[2], Leart Berdica[3], Ina Kola[4], Mehdi Alimehmeti[5] 119

MIOKARDITI INFEKTIV, KARDIOMIOPATIA INFLAMATORE DHE COVID 19 120

Tobias Taga[1], Dr. Shk.Daniela Teferiçi[2] 120

KARDIOMIOPATIA POSTPARTUM DHE DISA VLERËSIME MBI USHQYERJEN ME GJI 121

Daniela Teferiçi[1] 121

APLIKIMI I CELL BLOCK NË VERSAMENTET PLEURALE MALINJE **122**
Daniela Xhemalaj[I], Fatmir Caushi[I], Ilir Skenduli[I], Fadil Gradica[I], Lutfi Lisha[I], Elona Xhardo[I], Leart Berdica[2]. 122

PANKREATITI AKUT **122**
Dariel Thereska[1],Savio Dosti[2] 122

KIRURGJIA DHE PANDEMIA GLOBALE SARS – COVID 19 **123**
Dr. Med. Dariel Thereska, Ass. Prof Enton Bollano, Kosta Gjyli, Aleksandro Mako, Prof. Arben Gjata 123

DIAGNOZA LABORATORIKE E COVID 19. SITUATA AKTUALE NË PERGJIGJË TË KONTROLLIT TË PANDEMISË DHE PRESPEKTIVA E SË ARDHMES. **124**
Denada Lacej, Andi Koraqi, Rea Karafili, Fatjon Cuko 124

STUDIMI KLINIK MBI EFIKASITETIN JO-INFERIOR MIDIS TABLETAVE ME 600 MG DIOSMINË TË PAMIKRONIZUAR DHE TABLETAVE MPFF 1000 MG NË SËMUNDJEN VENOZE KRONIKE. **124**
Denis Kosovrasti 124

SHKAQET E INSUFIÇIENCËS RENALE KRONIKE NË FËMIJËT SHQIPTARË. **125**
[1]Diamant Shtiza, [2]Erida Zabuni, [2]Brisilda Derstila, [3]Enkelejda Shkurti 125

INFEKSIONI URINAR, REFLUKS VEZIKO-URETERAL DHE ROLI I SHINTIGRAFISË RENALE STATIKE NË MOSHËN PEDIATRIKE **126**
Diamant Shtiza[1], Brisilda Derstila[2], Erida Zabuni[2], Enkelejda Shkurti[3], Albert Lama[4] 126

HEMATURIA NË MOSHËN PEDIATRIKE: PËRVOJA E SHËRBIMIT TË NEFROPEDIATRISË. **127**
Diamant Shtiza[1], Jorgjia Bucaj[2], Lorena Sila[2] 127

RED MAN FACE" PREJ LUPUS DISCOID, TINEA FACEI, MYCOSIS FUNGOIDE. 127
Dorina Demaj[2], Prof. As. Monika Fida[1] 127

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE E SËMUNDJEVE MALINJE NË SHQIPËRI ,2015-2019 128
Dorina Toçi[1], Alban Ylli[1,2], Eugena Tomini[1]. 128

AKTUALITET MBI KANCERIN E DIFERENCUAR TË TIROIDES, SFIDAT DIAGNOSTIKE DHE TRAJTIMI. 129
Martiola Kola, Dorina Ylli, Edlira Elezaj, Ira Xhemollari, Pranvera Spahija, Albana Dulovic, Agron Ylli, Xheladin Dracini. 129

AKSIDENTET CEREBROVASKULARE ISHEMIKE PAS COVID-19. 129
Driola Hoxha, Gentian Huti, Asead Abdyli 129

NJË VËSHTRIM EPIDEMIOLOGJIKO – KLINIK I BRUCELOZËS GJATË VITEVE 2017-2021. 130
D. Rami, P. Pipero, A. Harxhi, Sh. Kurti, E. Ramosaço 130

FREKUENCA E SËMUNDJEVE TE FËMIJËT SHKOLLORË DHE RINIA TË TRAJTUAR NË ORGANIZATAT SHËNDETËSORE TË MJEKËSISË SË PËRGJITHSHME 131
Edita ETEMI[1], Sani BAJRAMI[1,2], Sherif SHAQIRI[3] 131

ASPEKTET EPIDEMIOLOGJIKE NË PACIENTË ME LEUCEMI AKUTE LIMFOBLASTIKE NË MOSHAT PEDIATRIKE 132
Izabela Piroli, Xhesika Meta, Elvira Hoxha, DrianaAlushaj, Prof. Dr. Edmond Pistulli 132

CORONAVIRUSI DHE FËMIJA 133
Klea Vejseli, Renato Pjetri, Xhesika Meta, Prof Edmond Pistulli[1] 133

MOSHA PEDIATRIKE DHE "RREZIKU" SINDROM METABOLIK 134

Prof Dr Edmond Pistulli, Prof. Asc. Gentian Stroni, Prof Asc Admir Nake 134

KUJDESI INFERMIEROR NË PACIENTËT ME COVID-19. 135
Edmond Puca[1], Fiorela Mehmetas[2], Sara Allko[3], Klajdi Fida[3], Bonita Shehu[3] 135

KONTROBUTI SHKENCOR GJATË PERIUDHËS SË PANDEMISË NE LIDHJE ME INFEKSIONIN SARS-COV2 135
Edmond Puca[1], Entela Puca[2] 135

NJË RISHIKIM I EKSPERIENCËS NË LIDHJE ME INFEKSIONIN SARS-COV2, PANDEMINË DHE LEKSIONET QË NXORRËM PREJ SAJ. 136
Edmond Puca[1], Entela Puca[2], Elda Qyra[1], Monika Dede[1], Rozeta Kamberi[1], Najada Çomo[1] 136

ROLI I FIZIOTERAPISË TE PERSONAT ME FIBROMIALGJI-RISHIKIM I LITERATURËS 137
Egzon Zejnullahu**,** Jonida Sahiti**,** Rozafa Berisha 137

IMPLIKIMET E COVID-19 NË QËNDRËN KLINIKE UNIVERSITARE NË KOSOVË – DEPARTAMENTI I PEDIATRISË 137
Egzona Berisha [1] 137

PSIKODERMATOLOGJIA NË SHQIPËRI 138
Jorgaqi E[1], Fida M[2], Savo I[3], Cela R[4], Doci Xh[5], Jefferany M[6]. 138

ETHJA, ETHJA PA VATËR DHE PASOJAT E SAJ TE FËMIJËT 139
Elda Skenderi[1], Admir Sulovari[2], Irena Dautaj[1], Alberta Shkembi[1], Artemisa Shehu[1], Alma Babo[1] 139

KUJDESI VENTILATOR NË PACIENTË ME COVID-19. 140
Elida Agaci, Gentian Huti, Asead Abdyli, Driola Hoxha. 140

PREEKLAMPSIA. ETIOLOGJIA DHE TRAJTIMI. 141

Eliona Demaliaj[1], Andja Manja, Pavlina Mikli, Dajna Balla, Klejda Tomani. 141

SINDROMI I BANDAVE AMNIOTIKE: RISHIKIM I LITERATURËS 141
Elmas Shaqiri 141

MYCOSIS FUNGOIDES RËNDËSIA E ANATOMOPATHOLOGJISË NË DIAGNOZËN DIFERENCIALE 142
Elmijola Janushaj[1] , Daniela Nakuci[2], Mehdi Alimehmeti[3] 142

NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI KARAKTERISTIKAT KLINIKE TE CRREGULLIMIT OBSESIVO-KOMPULSIV TE FËIJËT SHQIPËTARË 143
Elona Dashi[1], Valmira Skendi[2], Valbona Alikaj[3] 143

EDUKIMI SHËNDETËSOR I NËNAVE TË REJA NË PARANDALIMIN E PËRKEQËSIMIT TË DISPLAZISË TË KOFSHËS (DDH) 144
Doc. Elona Hasalla[1], Prof.As.Dr Ilia Mazniku[2],Ph.D. Ilda Taka[2], Msc. Elona Dybeli[2], Msc. Blerta Hasalla[2],Dr. Sulejman Baha, Msc. Irena Xhaferri 144

MBIJETESA E PËRGJITHSHME E LEUKEMISË KRONIKE LIMFOCITARE RELAPS / REFRAKTORE NË PACIENTËT TË TRAJTUAR ME IBRUTINIB NË VIJËN E TRETË NË SHQIPËRI (2018-2022) 145
Elsuarta Calliku MD Hematologe QSUT 145
Adela Perolla MD. PhD Hematologe QSUT 145
Tatjana Caja MD. Prof Hematologe.QSUT 145

NJË RAST ME PËRFUNDIM LETAL NGA SHOKU TOKSIK GJATË NJË INFEKSIONIME BACILLUS CEREUS TEK NJË FËMIJË IMUNOKOMPETENT 146
Elton Serani[1], Fatos Sinani[1], Bledar Xhemali[1] 146

ECLAMPSIA DHE PREECLAMPSIA 146

Msc. Adriana Zhama, Sanie Ago, Xhesiara Koxhaj, Ermelinda Xhari 146
Dr. Emirvina Koliçi 146

OVARI POLICISTIK, NDRYSHIMET METABOLIKE DHE HORMONALE NË TË. 147
Msc.Fribianka Hoxha, Sindi Deliallisi, Taulant Mehmeti, Dr.Emirvina Koliçi. 147

VITAMINA D_3, RËNDËSIA E SAJ NË PATOLOGJI TË NDRYSHME. 148
Msc.Manjola Kuka, Dr.Emirvina Koliçi 148

NDIKIMI I ANTITRUPAVE ANTI – CCD NË DIAGNOZËN E ALERGJIVE 149
E.Koliçi, K.Poshi, A. Çerekja, A.Zyli, A.Nurçe 149

DAPAGLIFLOZIN DHE NDIKIMI NË INTERPRETIMIN E GLUKOZURISË NË PACIENTËT DIABETIKË 149
E.Koliçi, K.Poshi, A. Çerekja, A.Zyli, A.Nurçe 149

SELENIUMI DHE SËMUNDJET AUTOIMMUNE TË TIROIDES 150
E.Koliçi, A.Zyli, A.Cerekja, K.Poshi, E.Thoma, A.Nurçe 150

NDIHMA DHE ROLI I FIZIOTERAPISË NË REHABILITIMIN E PACIENTËVE ME COVID-19. 151
Endrit Toska 151

DIABETI DHE PARANDALIMI I TIJ 151
Lorena Mani, Resila Gjegji, Lujsida Shemuni, Erilda Latifi, Zeliha Rexha, Enida Xhaferi 151

AUTOIMUNITETI DHE SËMUNDJET REUMATIZMALE 152
Dr. Enida Xhaferi[1], Dr. Fatbardha Lamaj[2], Florjan Risilia[3], Dr. Esmeralda Thoma Hoxha[1], Dr. Altina Xhaferi[1] 152

MANIFESTIMET EKSTRA MUSKULOSKELETIKE TEK PACIENTËT ME SPONDILIT ANKILOZANT 153

Dr. Enida Xhaferi[1], Dr. Altina Xhaferi[1], Asc.Prof. Dorina Ruci[2], Dr. Fatbardha Lamaj[3] 153

VLERËSIMI I BASHKËVEPRIMIT POZITIV TË POLIMIKSINËS B DHE NEOMICINËS NËPËRMJET PËRCAKTIMIT TË MIC/MBC DHE INDEKSIT FIC/FBC" (CHECKERBOARD METHOD). 154

Enkeleda Prifti 154

PREZANTIM RASTI I BRONKIOLITIT NË MOSHËN PEDIATRIKE 155

Artemona Sulaj, Yzeiri[1], Enkelejda Shkurti[2], Diamant Shtiza[2] 155

PREKJA PULMONARE DHE NDIKIMI I SAJ NË PROGNOZËN E PACIENTËVE MË COVID -19 155

E. Kolovani, R. Osmënaj, E. Ramosaço, N. Kryemadhi, Sh. Kurti, N. Çomo 155

EUROMELANOMA DHE FUSHATAT E SAJ MBI NDËRGJEGJËSIMIN NDAJ KANCERIT TË LËKURËS. 156

As. Prof. Entela Shkodrani 156

INKONTINENCA URINARE 157

Eralda Dervishi, Albana Gjyzari 157

SKEPTICIZMI I PRINDËRVE MBI VAKSINËN MMR DHE MOSVAKSINIMI I FËMIJËVE 157

Erestinë Uka, Abetare Goga, Altea Shahollari, Ana Allkaj, Elvis Hyka, Kaltrina Gashi, Kejsi Balla, Kleotilda Kamaj, Mettisa Guleksi, Stelina Stanga, Urtina Baftiu, Valeria Prifti 157

TË DHËNA EPIDEMIOLOGJIKE, KLINIKE E LABORATORIKE NË PACIENTË TË HOSPITALIZUAR ME INFEKSION NGA SARS-COV 2 158

E. Ramosaço, E. Kolovani, N. Kryemadhi, Sh. Kurti, N. Çomo 158

NJË STUDIM MBI SHPËRNDARJEN STATISTIKORE PËR MELANOMËN DHE NEVUSET DISPLAZIK NË SHQIPËRI 159
Erion Sukaj[1], Albina Ndoja[2], Teona Bushati[1,2], Leart Berdica[1,2] 159

BASHKEKZISTENCA E INDIT EKTOPIK TË TIROIDES DHE GJËNDRAVE TIROIDE NORMALE. 159
Erisa Kola[1], Daniela Nakuci[2], Ina Kola[3], Mehdi Alimehmeti[4] 159

MIKSOMA KARDIAKE: EKSPERIENCA E SHËRBIMIT TË KARDIOKIRURGJISË ''QSUT'' ME 49 RASTE 160
Ermal Likaj, Selman Dumani, Devis Pellumbi, Laureta Dibra, Saimir Kuci, Alfred Ibrahimi, Ali Refatllari 160

MIOKARDITË NË PACIENTËT ME SARS-COV2 161
Ermir Tafaj[1] 161

SËMUNDJET E RRALLA ME MANIFESTIME KUTANE 162
Prof. Ermira Vasili[1], Prof. Anila Babameto[2], Prof. Ass. Monika Fida[1] 162

IMPAKTI POTENCIAL PSIKO-EMOCIONAL I COVID-19 TEK STUDENTËT E VITIT TË PARË, FSHMT. NDËRHYRJE TERAPEUTIKE TË MUNDSHME 162
Ervin Marku[1], Xhesika Miska[2] 162

TUMORI KRUKENBERG I VEZORËVE - RAPORTI I RASTIT NË FEMRA 52 VJEÇ. 163
Ervisi Rapaj[1], Leart Berdica[2], Robert Meta[3], Aleks Sulejmani[4] 163

PNEUMOMEDIASTINUM NË MOSHAT E REJA TEK PACIENTËT ME COVID-19 164
Esi Duka , Najada Çomo[1], Arjan Harxhi[1], Esmeralda Meta [1].164

ROLI I INFERMIERIT NË MENAXHIMIN E PACIENTIT TË PARAQITUR URGJENTISHT ME DIAGNOZËN E KOMËS OPIOIDE. 165
Dr Esmeralda Thoma[1]. Valentina Kasemi 165

SA LARG MUND TË SHKONI NGA ABUZIMI ME STEROIDE? RAPORTIM RASTI 165
PhD. Esmeralda Thoma[1], PhD. Lordian Nunci[2], MD. Amarildo Hidri[2], MD. Sonila Bitri[3], MD. Emirvina Kolici[4] 165

PËRDORIMI I STEROIDEVE ANABOLIKE – ANDROGJENIKE. RISHIKIM LITERATURE. 166
PhD. Esmeralda Thoma[1], Prof. Enkelejda Shkurti[2], MD. Sonila Bitri[3], MD. Emirvina Kolici[2], Alma Pula[2] 166

KUJDESI I PERSONELIT INFERMIEROR NE PACIENTET ME COVID-19. 167
Eugen Ismolli[1] 167

NJOHJA E SINDROMËS NEUROLEPTIKE MALINJE-DIAGNOZA DHE MENAXHIMI NË SHËRBIMET E URGJENCËS 168
Fatime Elezi 168

PAMJAFTUESHMËRIA AKUTE E VESHKAVE 168
Dr.Fatlume Arifaj 168

DREJTUESIT E AUTOMJETEVE PËRGJEGJËSIA PENALE CIVILE DHE ADMINISTRATIVE , ROLI I DROGAVE DHE ALKOOLEVE NË GJËNDJEN E TYRE FIZIKE DHE PSIKIKE 169
Prof.As.Arben Lloja, Dr. IIir .Decolli, Dr.Shk.Elmas Shaqiri, Dr. Fatos Sinani, Dr.Donjet Lloja 169

ÇRREGULLIMET GASTROINTESTINALE NË POPULLATËN E MOSHUAR 170
Floreta Kurti[1] 170

I FOLURI NË PACIENTËT ME SËMUNDJE NEURODEGJENERATIVE TEK MOSHAT 40-50 VJEC. 170
Ba.Florinte Korchagin 170

KRAHASIMI I PROTOKOLIT EFIKAS PËR CRRËNJOSJEN E INFEKSIONIT HELIOBAKTER PYLORI NË KOSOVË 171
H. Aliaga[1,2],G Bojaj[1,2,3], H.Ibishi[2,3] 171

ROLI I TOCILIZUMABIT NE TRAJTIMIN E COVID-19 172
Gentian Huti, Asead Abdyli, Driola Hoxha, Rudin Domi 172

FIBRILACIONI ATRIAL NË PACIENTËT KARDIAK PAS KORIGJIMIT TË VALVULËS MITRALE 173
Dr. Gentian Stroni[1], Elda Sulaj 173

ÇRREGULLIMET HEMODINAMIKE POSTOPERATORE DHE KUJDESI INFERMIEROR 173
Mbaresa Çela[1], Eralda Lila[2], Joana Nilo[2], Andi Sula[2], Dr. Gentian Stroni[3] 173

TRAJTIMI AMBULATOR I COVID-19 NË SHQIPËRI 174
PhD. MD. Gentian STRONI[1] 174

ÇRREGULLIMI I PERSONALITETIT BORDERLINE 175
Gentjan Asllanaj[1] 175

GRAVES DISEASE, SHKAKU MË I SHPESHTË I HIPERTIROIDIZMIT: DIAGNOZA DHE MËNYRAT E TRAJTIMIT 176
Dr. Gentjan Lita 176

GJENDJET FEBRILE TE FËMIJËT 177
Dr. Gentjan Lita 177

LINJË UDHËZUESIT E SURVIVING SEPSIS CAMPAIGN 2021 NË KOHËN E COVID -19 177
Gentjana Zotaj, Gentian Huti, Asead Abdyli, Driola Hoxha 177

SINDROMA KAWASAKI 178
Greta Haxhi 178

AKI NJË GJËNDJE ALARMANTE NË PACIENTËT ME COVID-19. 179
Grisilda Gjana 179

KUJDESI INFERMIEROR TE TË SËMURËT NË UROLOGJI. 179
Dr. Haxhire Gani, Mariglena Rrapaj, Franceska Beqiri, Xhesika Muça, Eden Naço. 179

INFEKSIONI COVID-19 SËMUNDJET ONKOLOGJIKE 180

EVOLUCIONI NË TRAJTIMIN KIRURGJIKAL TË KANCERIT TË GJIRIT 180

Prof. Asoc. Helidon Nina 180

ADENOKARCINOMA INTRAMUKOZE E STOMAKUT - EGC (KANCERI I HERSHËM I STOMAKUT) DHE RËNDËSIA E ENDOSKOPISË (EGDS) NË DIAGNOSTIKIMIN E HERSHËM. 181

Hysni Dede 181

SEKSIO CESAREA KUNDREJT LINDJES SPONTANE 182

Ilda Ndreko Obstetre – Gjinekologe, Qendra shëndetësore Nr.1, Fier, Shqipëri 182

RËNDËSIA E TRAJTIMIT TË DËMTIMEVE TË HAPURA NË REPARTET E URGJENCËS 183

Msc. Ilda Taka, Doc. Elona Hasalla, Prof. Dr. Ilia Mazniku, Msc. Albana Sula, Msc. Saimira Qerana, Msc. Blerta Hasalla 183

TRAJTIMI I HERNIES DISKALE LUMBARE ME OZON EPIDURAL/CAUDAL NË SHQIPËRI 183

Dr. Ilir Agastra 183

KONCEPTE ETIKO-JURIDIKE PËR KEQUSHTRIMIN DHE GABIMIN MJEKËSOR 184

Ilir Decolli, Prof.As.Dr.Arben Lloja, Dr.Shk.Admir Sinamati, Dr.Donjet Lloja 184

FRAKTURË E MBËSHTJELLËSES SË PATELËS NË NJË DJALË 11 VJEÇ. RAPORT RASTI 185

Ilir Hasmuca MD, Zamir Demiraj MD, PhD 185

RADIOLOGJIA INTERVENTISTE 185

Dr.Sh.M.Ilirian Laci, Sabina Kembora 185

TRU-CUT BIOPSIA NË DIAGNOZËN E LEZIONEVE TË GJIRIT 186

Dr.Sh.M. Ilirian Laci[1] ,Dr.Alketa Spahiu[2] ,Prof.Asc. Helidon Nina[1] ,Dr.Sh.M. Leart Berdica[1]. 186

BIOPSIA TRU-CUT SI METODA FILLESTARE E DIAGNOSTIKIMIT NË TUMORET E KOCKAVE 186

Dr.Sh.M. Ilirian Laci[1], Dr.Alketa Spahiu[2], Dr.Sh.M.Artan Bodeci[1], Dr.Ledian Fezollari[3], Prof.Dr.Kenan Bayrakçi[4] 186

REZULTATET E TRU CUT BIOPSISË SË DREJTUAR NËN CT NË LEZIONET PULMONARE 187

Dr.Sh.M. Ilirian Laci[1], Dr.Alketa Spahiu[2], Dr.Sh.M.Artan Bodeci[1], Dr.Evisa Kozma[1], Dr.Benard Shehu[1], Dr.Sh.M. Klerida Shehu 187

COVID 19 DHE DISLIPIDEMIA 188

Ilirjan Gjyzari, Eralda Dervishi, Albana Gjyzari 188

SFIDAT E FIZIOTERAPISË NË PACIENTËT POST AVC. 188

Ilirjana Zekja[1]; Baftie Vata[2] 188

RAST I VECANTË I METASTAZËS SË KOLONIT NGA KARCINOMA SEROZE E GRADËS SË ULËT TË OVARIT 189

Dr.Sc.Gentiana Cekodhima, Dr.Altin Cekodhima, Dr.Manjola Tahiraj, Dr.Ina Lulo 189

MANIFESTIMET KUTANE TË RADIOTERAPISË NË PACIENTËT ONKOLOGJIKE 190

Ina Sotiri[1], Prof.Ass. Monika Fida[2], Dr. Orges Spahiu[3], Indi Xhemaili[3] 190

TRAJTIMI I DHIMBJES LUMBARE ME SHOCK WAVE 191

Irena Kola[1], Adelajda Hoxha, Asilda Baculi, Danjel Isaku, Redis Halla 191

TERAPIA ME SHOCK WAVE NË TRAJTIMIN E SUPIT TË NGRIRË. 192

Denis Mata, Esmeralda Novruzaj , Rea Sherifi, Prof.As.Irena Kola. 192

KORRELACIONI I VITAMINËS D ME OSTEOPOROZËN 192

Prof.Asoc. Irena Kola, Kristina Gjoka, Anxhela Gjini 192

MENAXHIMI I RADIKULOPATISË CERVIKALE ME ANË TË USHTRIMEVE TË STABILIZIMIT. 193
Prof.Asoc. Irena Kola, Msc. Flogerta Doku 193

MENAXHIMI I PACIENTËVE COVID-19 ME ANË TË TEKNIKAVE TË REHABILITIMIT. 194
Prof.Asoc. Irena Kola, Msc. Klea Cipuri 194

IMPAKTI I COVID-19 NË PATOLOGJITË KRONIKE TË TRAKTIT GASTROINTESTINAL 194
Dr. Shk. Irgen Tafaj 194

INTERPRETIMI I REZULTATEVE LABORATORIKE TË AUTOANTITRUPAVE ANA 195
Joana Hankollari 195

ROLI I ANALIZAVE GJENETIKE NË LEUKEMITË AKUTE LIMFOBLASTIKE 196
Jora Kociaj, Alma Cili, Adela Perolla, Arben Ivanaj 196

REZULTATI NË PACIENTËT ME KERATOKONUS , EKSTAZI KORNEALE DHE KORNEA TË HOLLA 196
Klajda Bardhi [1] 196

LIDHJA E TROMBOZËS ASIMPTONMTIKE E VENAVE TË THELLA TEK PACIENTËT ME COVID-19 , ME NIVELET E RRITURA TË D-DIMERIT. 197
Klara Hysenaj, Rezarta Stena, Gjergji Doka 197

"MIRROR THERAPY" TE PACIENTËT PAS AKSIDENTIT CERBROVASKULAR 198
Megi Kuka[1], Migena Hoxha [1], Klejda Tani[2] 198

RËNDËSIA E FIZIOTERAPISË RESPIRATORE DHE TERAPISË USHTRIMORE TE PACIENTËT ME SËMUNDJE PULMONARE OBSTRUKTIVE 198
Klejda Tani[1], Vjollca Shpata[1], Fregen Dhamaj[1] 198

KUJDESI INFERMIEROR NE DIABETIN GESTACIONAL 199
Phd Klodiana Poshi[1,2] Edjona Miraka [2] 199

HIPOTIROZA DHE GRAVIDANCA 200
PH.D Klodiana Poshi [1,2] Minushe Cela[2] 200

SËMUNDJET ALERGJIKE DHE ROLI I KORTIKOSTEROIDËVE NË TRAJTIMIN E TYRE 200
Laerta Pupo[1] , Monika Fida[2] , Blerta Lame[3] 200

METASTAZAT E TUMOREVE BENINJE 201
Dr. Sci. Leart Berdica, Agim Deda, Eva Luniku, Haki Guri, Indri Bibaja, Justi Gjoni, Melina Alimadhi, Meri Vasha, Xhensila Lilaj 201

NDRYSHIMET PATOLOGJIKE ORGANORE NË PACIENTËT E PREKUR ME COVID-19 202
Bjorn Eski[1], Blerina Vidhishta[1], Sadet Zala[1], Fabjola Kamberi[1], Anxhela Laze[1], Kevin Zykaj[1], Dr. Sci. Leart Berdica[2] 202

MATASTAZAT JATROGJENIKE 202
Fiorela Mulellari, Kejda Ymeri, Luena Seferasi, Sara Selgjekaj, Sibora Lohja, Uarda Kraja 202

TUMOROGJENEZA VIRALE 203
Geri Gega, Kendi Haskaj, Meri Suta, Patris Gjoka, Sindi Cahani 203

PLAZMOCITOMA EKSTRAMEDULARE E GJUHËS. 204
Leart Berdica[1,2], Teona Bushati[1,2], Alfred Aga[2], Emirjona Vajushi[2], Erion Sukaj[2], Albina Ndoja[1] 204

MENAXHIMI INFERMIEROR NË INFEKSIONET NOSOKOMIALE 205
Ledi Necaj[1], Elsa Hallidri 205

PËRCAKTORËT PSIKOLOGJIK TANI KONSIDEROHEN FAKTORË TË RËNDËSISHËM NË PACIENTËT E SËMUNDJEVE TË ZEMRËS 205
Ledi Neçaj[1], Rozana Dore[2], Ervin Marku[1], Zamir Damani[1] 205

OSTOTOMIA E FIBULËS PROKSIMALE SI NJË TRAJTIM ALTERNATIV NDAJ OSTEOARTTRITIT MEDIAL TE GJURIT **206**
L.Fezollari, A.Gega, G.Biba, prof V.Ruci, F.Vellku, R.Nela, A.Kristo, MD E.Selmani 206

PROTEZA TOTALE REVERSE E SUPIT, NJË CASE REPORT NË SHQIPËRI **207**
L.Fezollari, T.Alia, A.Gega, G.Biba 207

ROLI I HISTEROSKOPISË NË DIAGNOSTIKIMIN DHE TRAJTIMIN E PATOLOGJISË SË MITRËS. **208**
Ledja Toro 208

NJOHURITË E STUDENTËVE TË ALBANIAN UNIVERSITY MBI PARANDALIMIN E COVID-19 **208**
Dr. Liljana Loci[1], Migena Neli[2] 208

TRAJTIMI FIZIOTERAPEUTIK I TORTICOLLIS **209**
Dr. LinditaVata 209

KONSIDERATA EPIDEMIOLOGJIKE E DIAGNOSTIKE TË ANEMISË FERRO-DEFICITARE NË FËMIJËT. **210**
Dr.Lorena Sila, Prof.Dr.Anila Godo, Prof.Dr.Eleni Nastas, Dr.Shk.Mirela Xhafa, Prof.As.Dr. Donjeta Bali, Dr.Mirzana Kapllani, Prof.As.Dr.Manika Kreka. 210

PERCEPTIMET E STUDENTEVE FEMRA TË ALBANIAN UNIVERSITY RRETH KANCERIT TË QAFËS SË MITRËS **211**
Dr. Lumturi Merkuri, Borana Salollari 211

SHËNDETI MENDOR, PANDEMIA COVID-19 DHE NDIKIMI TE STAFI MJEKËSOR **212**
Dr Majlinda Murati 212

EPIDEMIOLOGJIA DHE PËRDITËSIMET E SISTEMIT JETË-SHPËTUES SIPAS GUIDELINES TË ERC REANIMACIONIT 2021. **212**
Prof. Asc. Dr. Majlinda NAÇO Md, PhD [1'2]. 212

ROLI I INFERMIERES SË BLLOKUT OPERATOR NË NEUROENDOSKOPI 213
Msc Manjola Pjetri[1], Klea Kazazi[2], Eralda Ymeraj[2], Xhulja Sulaj[2], Arilda Dedaj[2] 213

RËNDËSIA E ANA DHE FLUORESHENCA CITOPLAZMIKE NË SËMUNDJET AUTOIMUNE HEPATIKE 214
Margarita Kurti Prifti 214

GRAVES'DISEASE, GRAVES'ORBITOPATI DHE COVID-19. 215
Marjeta Kermaj[1], Ina Mihaj[1], Ardita Muja[1], Sindi Bushati[1], Agron Ylli[1]. 215

SINDROMI I SUPLEMENTIT TE KALCIUMIT 216
Marjeta Kermaj[1], Edlira Bucpepa[1], Albana Dulevic[1], Agron Ylli[1]. 216

LIMFOMA GASTRIKE ME QELIZA B JO HODGKIN 217
Dr.Marsela Shani[1], Dr Griselda Pelo[2], Dr.Jerina Todhe[3] 217

PREVALENCA E RREGULLIMIT TË FUNKSIONIT KONJITIV, ÇRREGULLIMIT TË GJUMIT DHE SINDROMIT TË KËMBËS SË SHQETËSUAR NË PACIENTË ME STAD TË PËRPARUAR TË SRK DHE TERAPI RENALE ZËVËNDËSUESE DHE VLERËSIMI I FAKTORIT TË RRISKUT 218
Merita Rroji[1], Larisa Shehaj[1] 218

HIPERTENSIONI SI FAKTOR I RËNDËSISHEM RRISKU NË SËMUNDJEN RENALE KRONIKE. 219
Dr Merita Rroji PhD 219

KRIOLIPOLIZA SI METODË PËR REDUKTIMIN E DHJAMIT DHE KONTURIMIT TE TRUPIT 219

EFEKTET ANËSORE TË SAJ 219
Dr. Migena Gega PhD 219

PSORIASIS VULGARIS DHE RISKU KARDIOVASKULAR 220

M.Vargu[1], E.Vasili[1], P.Vargu[2], S.Dedej[1] 220

KANCERI DHE TRAUMA PSIKOLOGJIKE QË PËRJETON INDIVIDI DHE FAMILJARËT 220

Mimoza Dosti 220

NDËRVEPRIMI I SINJALIZIMIT TË HIPOKSISË NË MOSFUNKSIONIMIN DHE INFLAMACIONIN MITOKONDRIAL NË SËMUNDJET KARDIOVASKULARE DHE KANCERIN:NGA MEKANIZMAT MOLEKULARË NË QASJET TERAPEUTIKE 221

Mimoza Tamizi 221

SHËNDETI OKULAR TEK FËMIJËT, ROLI INFERMIEROR 222

Mirela Tushe[1] 222

ANEMIA FANCONI. PREZANTIM RASTI 223

Mirzana Kapllanaj[1], Eleni Dervishi[2], Mirjana Lama[4], Nevila Kapllanaj[5], Donjeta Bali[1], Mirela Xhafa[1], Anila Babameto-Laku[3], Anila Godo[1]. 223

SINDROMA PASH – NJË SËMUNDJE E RRALLË DHE NJË MUNDËSI E RE TRAJTIMI 224

Monika Fida[1],Arbnore Tafica[1], Elda Semanjaku[1], Arjana Aliaj[2] 224

FYTYRË E KUQE PËR SHKAK TË AKNEVE DHE REAKSIONEVE AKNEIFORME 225

Prof.As. Monika Fida, Klea Kalemi 225

NDJEKJA E PACIENTIT ME MELANOME – CFARË DUHET TË DIJË NJË DERMATOLOG DHE MJEK FAMILJE. 225

Monika Fida1, Ermira Vasili1, Edlira Lashi2 225

KUJDESI INFERMIEROR TE PACIENTËT ME KANCER GJIRI (RAPORT CASE) 226

MSc.Muhamet Kadrija, MSc.Erald Cocka, Msc.Argjiro Alija, MSc.Sabrije Kelmendi Bardhaj 226

RISITË BASHKËKOHORE NË KANCERIN E STOMAKUT. 227
Prof.As.Myzafer Kaci, Albjona Demushi 227

DEPRESIONI NË KOSOVË GJATË PANDEMISË COVID-19 SIPAS GJASHTË STUDIMEVE NË PERIUDHA TË NDRYSHME KOHORE. 228
Prof. Asoc. Dr. Naim Fanaj[1] 228
Dr. Sci. Sevim Mustafa[1] 228

SËMUNDJET RENALE DHE MIELOMA MULTIPLE. 228
Olta Qurku[1], Prof.Dr.Alma Idrizi[2] 228

MENAXHIMI I PACIENTËVE ME KANCER GJATË PANDEMISË COVID-19: PËRVOJA E QENDRËS SË VETME PUBLIKE E NJËSISË SË RADIOTERAPISË (RT) NË SHQIPËRI 230
O. Spahiu[1], B. Shima[1], E. Kozma[1], E. Hafizi[1], E. Karaulli[1], F. Kraja[1], B. Jahaj[1], U. Bitri[1], G. Hysa[1], A. Qehajaj[1], R. Buci[1], U. Gjoka[1], R. Jorgo[1], J. Saveta[1] 230

FAKTORËT QË NDIKOJNË NË VONESËN E TË FOLURIT. 230
MSc. MA Orla Kaimi, Elma Prifti, Kis Mahmutaj, Kaltrina Gashi, Kejsi Balla 230

VËSHTIRËSITË E LOGOPEDIT NË PACIENTË ME ÇRREGULLIME TË SJELLJES 231
MSc.MA Orla Kaimi [1] , Eneida Buzi [2] 231

NDIKIMI I GJUHËS RECEPTIVE NË ZHVILLIMIN E GJUHËS VERBALE. 231
MSc.MA.Orla Kaimi 231

TRAJTIMI I SUPIT TË NGRIRË ME LASERNEEDLEACUPUNCTURE 232
Dr.RABIT SADIKU[1] 232

HIDRADENOMA PAPILLIFERUM ME FOKUSE TË KARCINOMËS SKUAMOZE: RAST KLINIK NË SUOGJ 'KOCO GLIOZHENI'. 233

Rezart Ajazi.MD.PHD, Kizjona Perdja.MD 233

ERITRODERMIA PËR SHKAK TË DERMATITIT SEBORRHEIK , PSORIASIS , DERMATITIT . 233

Ritjona Mala[1], Valbona Zenelaj[2], Prof.As. Monika Fida[3] 233

HIPOTENSIONI ARTERIAL PAS INDUKSIONIT TË ANESTEZISË SË PËRGJITHSHME. 234

Bleris Bushati 234

ROLI I PROKALCITONINËS NË TERAPINË ME ANTIBIOTIKE NE ICU DHE REPARTET E EMERGJENCËS 235

Rudin Domi, Gent Huti, Asead Abdyli, Driola Hoxha 235

DERMATITI EKSFOLIATIV SEVER NË NJË FËMIJË 3 MUAJSH ME COVID-19 235

Ermira Vasili[1], Monika Fida[1], Sabina Dedej[1], Dea Klironomi[2] 235

DIAGNOSTIKIMI DHE MENAXHIMI I KRIPTORKIDIZMIT. 236

Dr.Sh.M. Sander KOLA[1], Dr.Erinda FRROKU[2], Dr.Gezim Shehu[3] 236

PËRPARËSIA E CT NË EKZAMINIMIN RADIOLOGJIK TË COVID-19. (RIVIEW) 237

Dr.Sh.M. Sandër KOLA[1], Irena KOLA[2], Erinda Frroku[3] 237

SHPESHTËSIA E HASJES SË ASTMËS BRONKIALE PARA DHE PAS PANDEMISË NË LEZHË 237

Shkelqime Poga – Tobli [1], Erjona Frroku [2] 237

EFEKTIVITETI I ANTIBIOTIKËVE PARA, GJATË DHE PAS PERIUDHËS SË PANDEMISË NË SHKODËR 238

Shkëlqime Poga – Tobli [1], 238

NIVELI I DEPRESIONIT TEK MOSHA E TRETË DHE NDËRLIDHJA E TIJ ME KUALITETIN CILËSOR TË JETËS 239

Shqipe Vitija 239

KONCEPTI I HARMONIZIMIT DHE ROLI I EQA NË MJEKËSINË LABORATORIKE. 240
Sidorela Dervishi 240

ETIOLOGJIA, DIAGNOZA, PARAQITJET KLINIKE DHE TRAJTIMI I URTIKARIES 240
Dr.Sc. Sonila Borici[1] 240

HIPERKOAGULIMI NË COVID-19 241
Sotiraq Lako, Hematolog, Spitali Amerikan, Tiranë, Shqipëri. 241

CRVO (OKLUZIONI I VENËS CENTRALE TË RETINËS) DHE TRAJTIMI I SAJ ME ANTI -VEGF 241
Stela Ceca [1] 241

MENAXHIMI PERIOPERATOR I PACIENTËVE AMBULATOR NË TERAPI ME ANTIKOAGULANTË NË PACIENTË COVID-19. 242
PhD. Suela Mumajesi[1], MD. Grisilda Demiri [2], Prof. Dr. Nestor Thereska[3], Prof. Dr. Myftar Barbullushi[1] 242

SËMUNDJA ISHEMIKE E ZEMRËS NË QENDRËN SHËNDETËSORE GJERGJAN DHE SHIRGJAN NË RRETHIN E ELBASANIT NË VITIN 2020 242
Dr. Svetllana Bitincka, Marsida Lleshi 242

BENEFITET E MJEKIMIT HERËT NË TË SËMURËT ME MIELOFIBROZË 243
Tatjana Caja, Adela Perrolla, Elsuarta Calliku 243

TERATOMA APO TUMORI "MREKULLI" 243
Dr.Sci.Teona Bushati Berdica, Ardenis Kapllani, Elma Fejzullahi, Endina Kelmendi, Erta Hyka, Kelt Kalaj, Kristia Dorre, Laura Qamili, Melisa Zejnuni, Ornela Rustemi, Pamela Ferataj, Regi Çota, Sara Memsuri, Viola Canoku, Zahide Lleshi 243

STUDIMI I MUTACIONEVE ALK, EGFR DHE PD-L1 NË KARCINOMAT PULMONARE NËPËRMJET IMUNOHISTOKIMISË. 244
Teona Bushati [1,2], Leart Berdica [1,2], Jeta Memçaj [1] 244

GINGIVITI DHE SHTATËZANIA 245
Dshm Dr Ob/Gyn T.Bare, E.Paparisto, N.Bare 245

RËNDËSIA E VAKSINËS ANTICOVID 19 TEK MOSHAT E REJA 246
Tone Sokoli-Imeraj, Mimoza Sinjari, Blegina Arapi, Aurora Xhixha, Majlinda Çuedari, Mejreme Ndreu, Gazmend Doda. 246

ETHET E KAFSHIMIT TË MIUT, NJË SËMUNDJE E LËNË PAS DORE NË SHQIPËRI. 247
Tritan Kalo 247

PROBLEMET E SHËNDETIT MENDOR GJATË PANDEMISË COVID-19 NË IRAN, INDI, SHQIPËRI DHE NIGERI 248
Valbona Alikaj, Elona Dashi[1], Valmira Skëndi[1] 248

PANORAMA SIMPTOMATOLOGJIKE E KLINIKE E PACIENTËVE ME COVID-19 NË PERIUDHËN POST AKUTE SI DHE NE LONG-COVID. 248
Valbona Gashi[1] 248

TRAJTIMI ME INFLIXIMAB NË PACIENTËT ME ARTRIT REUMATOID 249
V.Salko, A.Zoto, E.Rapushi, T.Backa, A.Ndoja 249

PSIKOTERAPIA NË SHQIPËRI: 250

LUKS APO DOMOSDOSHMËRI?! SFIDA DHE BARRIERA KULTURORE! 250
Valmira Skendi[1], Valbona Alikaj[2], Elona Dashi[3] 250

IDENTIFIKIMI I TEKNIKAVE TË PËRBALLIMIT TË SITUATËS TEK PRINDËRIT E FËMIJËVE ME AUTIZËM 251

Dr. VenetikeMerkaj[1], Dr. Brizida Refatllari[1], Dr.Ergeta Nika Ktona [1] M.a. Fjorda Dragoti[2] 251

EFEKTI I KËSHILLIMIT NË GRUP KUNDREJT STRESIT TEK NËNAT Ë FËMIJËVE ME AUTIZËM 252

Dr. VenetikeMerkaj[1], Dr. Brizida Refatllari[1], Dr.Ergeta Nika Ktona[1], M.a. Fjorda Dragoti[2] 252

ENIGMA KOMPLEKSE E QASJES TERAPEUTIKE Të DISLIPIDEMISë Në SëMUNDJEN RENALE KRONIKE (SRK) 253

Vilma Cadri 253

"SARKOMA KAPOSI FAMILJARE, GJATË COVID-19" RASTI I PARË NË SHQIPËRI 254

D.SH.M Violeta Dajci[1], Dr.Briseida Ziu[1] , Dr. Ada Dajci[2], D.SH.M. Ardiana Sinani[3] 254

"PREHABILITIMI", NJË PËRQASJE MULTIMODALE QË KONTRIBUON NË PËRMIRËSIMIN E ECURISË POSTOPERATORE TË PACIENTËVE KIRURGJIKALË ADULTË 255

Vjollca Shpata[1], Xhensila Prendushi[3], Alma Nurçe[3], Nertila Kodra[2], Klejda Tani[1] 255

SI TË ARRIHET NJË PAMJE RINORE NË ZONËN PERIORBITALE? 256

Vladimir Filaj[1], Ina Kola[2], Erisa Kola[3] 256

KANCERI MEDULAR I TIROIDES. DIAGNOZA/ TRAJTIMI/ NDJEKJA. 256

Justina Sinani[1], Xheladin Draçini[2], Dorina Ylli[2], Adela Haxhiraj[2], Agron Ylli[2]. 256

QËLLIMI DHE APLIKIMI I AFEREZËS TERAPEUTIKE: EKSPERIENCA E QENDRËS KOMBËTARE TË TRASFUZIONIT TË GJAKUT. 257

Xh.Beqoviq, D.Kroni, A.Dukaj 257

NDIKIMI AFATGJATË I INFEKSIONIT COVID-19 NË SHËNDET **258**
Autorët: Xhensila Prendushi[1], Vjollca Shpata[2], Najada Gjylameti[3], Alketa Domi[3]. 258

FIZIOLOGJIA E MPLAKJES TE APARATIT LOKOMOTOR DHE FRAKTURAT OSTEOPORIKE. **259**
Dr.Zamir Demiraj, Dr.Ilir Hasmuca, Dr.Enea Grazhdani. 259

SUICIDET DHE TENTATIVA SUICIDALE NË AMBIENTET E PARABURGIMIT TË PERONAVE ME VARTËSI NGA DROGA , ILUSTRIM I NJË RASTI TIPIK SUICIDAL **259**
Dr. Shk. Zija Ismaili (ekspert mjek ligjor) Dr. Shk. Bledar Xhemali (ekspert mjek ligjore) Dr. Ilir Decolli (eksperte mjek ligjore) 259

261

ABSTRAKTET E DENTISTRISË/ **262**

ABSTRACTS OF DENTISTRY **262**

INTERNATIONAL EDUCATED DMD PROGRAM OPPORTUNITIES **262**
Rosa Chaviano Moran 262

MUNDËSITË NDËRKOMBËTARE PËR PROGRAMIN E EDUKIMIT TË STOMATOLOGJISË **262**
Rosa Chaviano Moran 262

NAVIGATION IN IMPLANT DENTISTRY **263**
Florian Beuer 263

NAVIGIMI NË IMPLANTOLOGJINË DENTARE. **264**
Florian Beuer 264

INNOVATIONS IN ENDODONTICS **264**
Gianluca Gambarini, Alessio Zanza 264

INOVACIONET NË ENDODONCI **265**

Gianluca Gambarini, Alessio Zanza 265

THE POWERS OF DIGITAL INSTRUMENTS APPLIED TO CLINICAL SOLUTIONS 265
Prof. Giampietro Farronato[1] 265

FUQITË E INSTRUMENTEVE DIXHITALE TË APLIKUARA NË ZGJIDHJET KLINIKE 266
Prof. Giampietro Farronato[1] 266

RISK OF RADIOACTIVE CONTAMINATION IN THE DENTAL OFFICE BY THE PATIENT WHO HAS RECENTLY UNDERGONE NUCLEAR MEDICAL IMAGING. 266
Roberto Pasquarelli 266

RREZIKU I KONTAMINIMIT RADIOAKTIV NË KLINIKAT DENTARE NGA PACIENTË TË CILËT SË FUNDMI I JANË NËNSHTRUAR IMAZHERISË MJEKËSORE NUKLEARE. 267
Roberto Pasquarelli 267

DIRECT AND INDIRECT VENEERS 267
Vincenzo Campanella 267

FASETAT DIREKTE DHE INDIREKTE 268
Vincenzo Campanella 268

TREATMENT WITH HUMAN PLACENTAL LACTOGEN (HPL-A) IMPROVES GLUCOSE HOMEOSTASIS ONE YEAR AFTER PANCREATIC ISLETS TRANSPLANTATION IN MICE ANTERIOR EYE CHAMBER 268
Giulia Donadel 268

TRAJTIMI ME LAKTOGJEN TË PLACENTËS HUMANE (HPL-A) PËRMIRËSON HOMEOSTAZËN GLUKOZALE NJË VIT PAS TRANSPLANTIMIT TË ISHUJVE PANKREATIK NË DHOMËN E PËRPARME TË SYRIT TË MINJVE. 269
Giulia Donadel 269

MEDICAL EMERGENCIES IN DENTISTRY: ARE WE READY? 270

ROLE OF UNIVERSITY EDUCATION AND CONTINUING EDUCATION 270

F. Coniglione[1,2], E. Cule[1], E. Pashaj[1], B. Rrapi[1], Sh. Mulla[1], A. Kerci[1], F. Vinjolli[1], F. Rulli[1] 270

"EMERGJENCAT MJEKËSORE NË DENTISTRI: A JEMI GATI? 270

ROLI I ARSIMIT UNIVERSITAR DHE EDUKIMI I VAZHDUESHËM." 270

F.Coniglione[1,2] E.Cule[1], E.Pasha[1], B.Rrap[1], Sh.Mulla[1], A.Kerci[1], F. Vinnjolli[1], F.Rulli[1]. 270

FUNDAMENTALS OF IMPLANT SURGERY AT THE ESTHETIC ZONE 271

Burak Demiralp 271

BAZAT E KIRURGJISË IMPLANTARE NË ZONËN ESTETIKE. 272

Burak Demiralp 272

THE INFLUENCE OF PARAFUNCTIONAL HABITS ON MASTICATORY AND NECK MUSCLES 272

Prof. Gianluca Martino Tartaglia[1] 272

NDIKIMI I ZAKONEVE PARAFUNKSIONALE NË MUSKUJT PËRTYPËS DHE TË QAFËS. 272

Prof. Gianluca Martino Tartaglia 272

ENTREPRENEURSHIP IN DENTISTRY, A SKILL YOU CAN LEARN 273

Maher Almasri[1] 273

SIPËRMARRJA NË DENTISTRI, NJË AFTËSI QË MUND TË MËSONI. 273

Maher Almasri 273

MINIMALLY INVASIVE APPROACH FOR ORAL LESIONS: ADVANCES IN PHOTODYNAMIC THERAPY **274**
Prof. Antonio Romano[1] 274

QASJET MINIMALISHT INVAZIVE PËR LEZIONET ORALE: ZHVILLIMET NË TERAPINË FOTODINAMIKE. **274**
Prof. Antonio Romano[1] 274

DIGITAL CROSS-MOUNTING: A NEW OPPORTUNITY IN PROSTHETIC DENTISTRY **275**
Piero Venezia 275

MONTIMI DIXHITAL: NJË MUNDËSI E RE NË PROTETIKËN DENTARE **275**
Piero Venezia 275

ENDODONTICS VS IMPLANTOLOGY: A RATIONAL CHOICE **276**
Luca Testarelli, Rodolfo Reda 276

ENDODONCIA KUNDREJT IMPLANTOLOGJISË: NJË ZGJEDHJE RACIONALE **276**
Luca Testarelli, Rodolfo Reda 276

PREVENTION IN ORTHODONTICS: VERTICAL AND SAGITTAL CONTROL **277**
Prof. Attilio Castaldo[1] 277

PARANDALIMI NË ORTODONCI: KONTROLLI VERTIKAL DHE SAGITAL **277**
Prof. Attilio Castaldo[1] 277

EFFECT OF IMPLANT SURFACE ROUGHNESS AND MACRO- AND MICRO-STRUCTURAL COMPOSITION ON WEAR AND METAL PARTICLES RELEASED **278**
Prof. Gaetano Marenzi 278

EFEKTI I ASHPËRSISE SË SIPËRFAQES SË IMPLANTIT DHE PËRBËRJA MAKRO DHE MIKRO-STRUKTURORE E GRIMCAVE METALIKE TË LËSHUARA. 278
Prof. Gaetano Marenzi 278

DENTAL IMPLANT BEHAVIOR IN REGENERATES ALVEOLAR SOCKET MAXILLARY SITES WITH AN INNOVATIVE TOOTH DERIVED AUTOLOGOUS BIOMATERIAL: AN IN VIVO 1 YEAR FOLLOW-UP STUDY 279
Prof. Filiberto Mastrangelo[1] 279

PËRGJIGJIA E IMPLANTIT DENTAR NË RIGJENERIMIN E ALVEOLAVE MAKSILARE ME NJË BIOMATERIAL INOVATIV AUTOLOG QË DERIVON NGA DHËMBI: NJË STUDIM IN VIVO 1-VJEÇAR. 279
Prof. Filiberto Mastrangelo[1] 279

TITANIUM FUNCTIONALIZED WITH POLYLYSINE HOMOPOLYMERS: IN VITRO ENHANCEMENT OF CELLS GROWTH 280
Prof. ssa Marina Di Domenico[1] 280

TITANI I VESHUR ME HOMOPOLIMERË POLILIZINE: ZHVILLIMI I RRITJES QELIZORE IN VITRO. 280
Prof. Marina Di Domenico 280

CLINICAL EFFICACY OF A NEW CETYLPYRIDINIUM CHLORIDE-HYALURONIC ACID-BASED MOUTHRINSE FOR LONG-TERM ORAL DISEASES PROTECTION 281
Prof. Santosh Kumar Tadakamadla 281

EFIKASITETI KLINIK I SHPËLARËSIT TË RI TË GOJËS ME BAZË KLORUR CETILPIRIDINIUM- ACID HIALURONIK PËR MBROJTJEN AFATGJATË NGA SËMUNDJET ORALE. 281
Prof. Santosh Kumar Tadakamadla 281

IMPACT OF DENTAL CARIES ON ACADEMIC PERFORMANCE OF SCHOOLCHILDREN 282

Prof. Faeq Al Quadri 282

NDIKIMI I KARIESIT DENTAR NË PERFORMANCËN AKADEMIKE TË NXËNËSVE. 282
Prof. Faeq Al Quadri 282

SALIVARY SURVEILLANCE FOR NEURODEGENERATIVE DISEASES 283
Stephen Thaddeus Connelly 283

STUDIMI I SALIVËS PËR SËMUNDJET NEURODEGJENERATIVE 284
Stephen Thaddeus Connelly 284

UPDATES ON THE EFFICACY OF AUTOLOGOUS PLATELET CONCENTRATES FOR HEALING PROMOTION IN ORAL SURGERY 284
Massimo Del Fabbro[1] 284

PËRDITËSIMI MBI EFIKASITETIN E KONCENTRATEVE AUTOLOGE TË TROMBOCITEVE PËR PROMOVIMIN E SHËRIMIT NË KIRURGJINË ORALE 285
Massimo Del Fabbro[1] 285

PREVENTION AND MANAGEMENT OF VASCULAR OCCLUSIONS OF INJECTABLE AESTHETIC PROCEDURES 285
Prof. Patricia Oyole, DDS, OMS, MBA 285

PARANDALIMI DHE MENAXHIMI I OKLUZIONEVE VASKULARE TË PROCEDURAVE ESTETIKE TË INJEKTUESHME. 285
Prof. ssa Patricia Oyole 285

NEW TECHNOLOGIES IN ODONTOSTOMATOLOGY AND ORAL PATHOLOGY 286
Prof. Gianfranco Favia[1], Dott.ssa Luisa Limongelli[1] 286

TEKNOLOGJITË E REJA NË ODONTO-STOMATOLOGJI DHE PATOLOGJI ORALE. 286

Prof. Gianfranco Favia[1], Dott.ssa Luisa Limongelli[1] 286

ARTHROSCOPIC PROCEDURE FOR HABITUAL DISLOCATION OF THE TEMPOROMANDIBULAR JOINT 286
Prof. Aldo Bruno Giannì, Dott. Antonio Russillo 286

PROCEDURA ARTROSKOPIKE PËR DISLOKIMIN HABITUAL TË ARTIKULACIONIT TEMPOROMANDIBULAR. 287
Prof. Aldo Bruno Gianni, Dott. Antonio Russillo 287

ORAL MICROBIOTA, PERIODONTITIS AND OSTEOPOROSIS: BIDIRECTIONAL INTERRELATIONSHIPS AND CLINICAL IMPLICATIONS 287
Prof. Maria Contaldo[1], Prof. Rosario Serpico[2] 287

MIKROBIOTA ORALE, PERIODONTITI DHE OSTEOPOROZA: MARRËDHËNIET E NDËRSJELLA TË DYFISHTA DHE IMPLIKIMET KLINIKE. 288
Prof. Maria Contaldo[1], Prof. Rosario Serpico[2] 288

ADVANCES AND INSIGHTS IN ADJUVANT SUPPLEMENTS-ASSISTED APPROACHES FOR BONE HEALING 288
Prof. Felice Lorusso[1], Prof. Antonio Scarano[1] 288

PËRPARIMET DHE ZHVILLIMET MBI SUPLEMENTET NDIHMËSE PËR SHËRIMIN KOCKOR. 289
Prof. Felice Lorusso[1], Prof. Antonio Scarano[1] 289

DENTAL ERUPTION ANOMALIES IN INTERCEPTIVE ORTHODONTICS 289
Prof. Ssa Daniela Di Venere[1] 289

ANOMALITË E ERUPSIONIT DENTAR NË ORTODONCINË INTERCEPTIVE 289
Prof. Asoc. Daniela Di Venere[1] 289

KRITERET E SUKSESIT TË TRAJTIMEVE TË KANALIT TË RRËNJËVE. 290
Lumnije Kqiku 290

THE EVOLUTION OF REGENERATIVE PERIODONTAL SURGERY **290**
Beatrice Femminella 290

EVOLUCIONI I KIRURGJISË PERIODONTALE RIGJENERATIVE **290**
Beatrice Femminella 290

INTRAORAL SCANNER AND BASIC CONCEPTS OF ITS USE IN DENTAL PROSTHETICS **291**
Lorenzo Arcuri 291

SKANERI INTRAORAL DHE KONCEPTET BAZË TË PËRDORIMIT TË TIJ NË PROTETIKËN STOMATOLOGJIKE. **291**
Lorenzo Arcuri 291

PERIIMPLANTITET DHE TRETMANI I TYRE NË STOMATOLOGJINË MODERNE **292**
Doc. Dr.Arbëresha Bexheti Ferati, Doc. Dr. Kenan Ferati, Ass.Dr. Jeta Bexheti 292

ÇRREGULLIMET E NYJES TEMPOMANDIBULARE SI PASOJË E PUNIMEVE PROTETIKE JOADEKUATE **292**
Teuta Pustina 292

REVERSE ENGINEERING ANALYSIS OF DIMENSIONAL CHANGE IN POST-EXTRACTION ALVEOLAR RIDGE **293**
Gianmaria d'Addazio[1,2], Manlio Santilli[1,2], Imena Rexhepi[1,2], Sergio Caputi[1,2], Bruna Sinjari[1,2] 293

ANALIZA INXHINIERIKE E NDRYSHIMIT DIMENSIONAL NË KRESHTËN REZIDUALE PAS EKSTRAKSIONIT. **293**
Gianmaria d'Addazio, Manlio Santilli, Imena Rexhepi, Sergio Caputi, Bruna Sinjari 293

DIGITAL DENTISTRY AND NEW TECHNOLOGIES **294**
Prof. Marco Farronato 294

DENTISTRIA DIXHITALE DHE TEKNOLOGJITË E REJA 294
Prof. Marco Farronato 294

LASER ASSISTED TREATMENT FOR DENTINAL HYPERSENSITIVITY 295
Prof. Ioana Roxana Bordea 295

TRAJTIM I ASISTUAR ME LAZER NË HIPERSENSITIVITETIN DENTINAR. 295
Prof. Ioana Roxana Bordea 295

ORTHODONTIC INTRUSION OF UPPER INCISORS IN A PERIODONTOPATHIC PATIENT: A CASE REPORT 295
Dott. Ssa. Giuseppina Malcangi 295

INTRUZIONI ORTODONTIK I INCIZIVËVE TË SIPËRM NË NJË PACIENT PERIODONTOPATIK: RAPORTIM RASTI 296
Dr. Giuseppina Malcangi 296

OCCLUSAL SPLINTS AND ORTHODONTIC TREATMENT IN GROWING PATIENTS WITH TEMPOROMANDIBULAR DISORDERS 296
Dott. Ssa Ludovica Nucci[1], Dott. Ssa Fabrizia D'apuzzo 296

SPLINTET OKLUZALE DHE TRAJTIMI ORTODONTIK NË PACIENTËT NË RRITJE ME ÇRREGULLIME TEMPORO-MANDIBULARE. 297
Dr. Ludovica Nucci1, Dr. Fabrizia D'apuzzo 297

THE EFFECT OF ELASTODONTIC THERAPY IN CHILDREN WITH ANTERIOR OPEN BITE AND TONGUE DYSFUNCTION 298
Dott. Filippo Cardarelli[1] 298

EFEKTI I TERAPISË ELASTODONTIKE TEK FËMIJËT ME KAFSHIM TË HAPUR ANTERIOR DHE MOSFUNKSIONIM TË GJUHËS. 298
Dott. Filippo Cardarelli[1] 298

INFLUENCE OF MAXILLARY SINUS VASCULARIZATION ON SCHNEIDERIAN MEMBRANE PERFORATIONS DURING SINUS ELEVATION SURGERY Error! Bookmark not defined.
Dott. ssa Denisa Hazballa 298

NDIKIMI I VASKULARIZIMIT TË SINUSIT MAKSILAR NË PERFORACIONET E MEMBRANËS SCHNEIDER GJATË OPERACIONIT PËR NGRITJEN E SINUSIT. 298
Dr. Denisa Hazballa 299

GNATHOLOGY AND POSTURE: CLINICAL CASE 299
Dr. Zagaria Luigi 299

GNATOLOGJIA DHE POSTURA: RAST KLINIK 300
Dr. Luigi Zagaria 300

DIGITAL DENTISTRY FOR DIAGNOSIS AND TREATMENT OF MAXILLARY MALIGNANCY: A CASE REPORT 300
Dott. Giuseppe Barile, Dott. Alessio Inchingolo 300

DENTISTRIA DIXHITALE PËR DIAGNOSTIKIMIN DHE TRAJTIMIN E MALINJITETIT NË MAKSILË. 301
Dr. Giuseppe Barile, Dr.Alessio Inchingolo 301

THE IMPACT OF PERIODONTAL INFLAMMATION ON ENDOTHELIAL FUNCTION ASSESSED BY CIRCULATING LEVELS OF ASYMMETRIC DIMETHYLARGININE (ADMA)301
Dott. Biaggio Rapone[1] 301

NDIKIMI I INFLAMACIONIT PERIODONTAL NË FUNKSIONIN E ENDOTELIT, I VLERËSUAR NGA NIVELET QARKULLUESE TË DIMETIL-ARGININËS ASIMETRIKE (ADMA) 302
Dr. Biaggio Rapone[1] 302

POST-EXTRACTION AND IMMEDIATE LOADING IMPLANTATION IN MODERN PERIO-IMPLANTOLOGY 303
Dr. Christian Monti 303

NGARKIMI I MENJËHERSHËM POST EKSTRAKTIV I IMPLANTEVE NË PERIO-IMPLANTOLOGJINË MODERNE 303
Dr. Christian Monti 303

UPREGULATION OF DIFFERENT MIRNAS IN PERIODONTOPATHIC PATIENTS AND THEIR RELATIONSHIP WITH IL-6 AND TNFA 303
Erica Costantini 303

PËRGJIGJIA E RRITUR E MIKRO-ARN-VE TË NDRYSHME NË PACIENTËT PERIODONTOPATIKË DHE LIDHJA E TYRE ME IL-6 DHE TNFA. 304
Erica Costantini 304

THE EFFICACY OF CURCUMIN LIPOSOME-BASED GEL AS AN ADJUNCT TO NON-SURGICAL PERIODONTAL TREATMENT: A RANDOMIZED CONTROLLED CLINICAL TRIAL 305
Imena Rexhepi[1], Beatrice Femminella[1], Ida Uccello[1], Michele Paolantonio[1] 305

EFIKASITETI I LIPOZOM KURKUMINËS NË TRAJTË XHELI SI NJË ALTERNATIVË NDIHMËSE NDAJ TRAJTIMIT PERIODONTAL JOKIRURGJIKAL: STUDIM KLINIK 305
Imena Rexhepi[1], Beatrice Femminella[1], Ida Uccello[1], Michele Paolantonio[1] 305

ORAL SQUAMOUS CELL CARCINOMA(OSCC), FROM EPIDEMIOLOGY TO MULTIDISCIPLINARY APPROACH: A VIDEO CASE REPORT 306
Manlio Santilli[1,2], Gianmaria d'Addazio[1,2], Imena Rexhepi[1,2], Arnaldo Filippini[3], Bruna Sinjari[1,2] 306

KARCINOMA E QELIZAVE SKUAMOZE ORALE (OSCC), NGA EPIDEMIOLOGJIA Nè QASJEN MULTIDISIPLINARE. 307

Manlio Santilli[1,2], Gianmaria d'Addazio[1,2], Imena Rexhepi[1,2], Arnaldo Filippini[3], Bruna Sinjari[1,2] 307

NON-SURGICAL GINGIVAL PHENOTYPE MODIFICATION IN RECESSION ASSOCIATED WITH A NON-CARIOUS CERVICAL LESION USING THE ROOT PLASTIC TECHNIQUE (RPT). A PROSPECTIVE CASE SERIES. 307

Luigi Romano 307

MODIFIKIMI JO-KIRURGJIKAL I FENOTIPIT GINGIVAR Nè RECESIONE Tè SHOQèRUAR ME LEZIONE CERVIKALE JO-KARIOZE DUKE PèRDORUR TEKNIKèN E PLASTIKèS RADIKULARE (RPT). 308

Luigi Romano 308

ESSENTIAL LINES: A NEW TECHNIQUE TO SIMPLIFY POSTERIOR COMPOSITE RESTORATIONS. 308

Vincenzo Tosco, Riccardo Monterubbianesi, Giuseppe Chiodera, Giovanna Orsini and Angelo Putignano 308

LINJAT THELBËSORE: NJË TEKNIKË E RE PËR TË THJESHTUAR RESTAURIMET POSTERIORE TË KOMPOZITIT 309

Vincenzo Tosco, Riccardo Monterubbianesi, Giuseppe Chiodera, Giovanna Orsini and Angelo Putignano 309

RESEARCH ON NEW MATERIALS IS THE FOUNDATION OF THEIR CLINICAL APPLICATION 309

Riccardo Monterubbianesi*, Vincenzo Tosco, Angelo Putignano, Giovanna Orsini 309

KËRKIMI SHKENCOR MBI MATERIALET E REJA ËSHTË BAZA E APLIKIMIT TË TYRE KLINIK 310

Riccardo Monterubbianesi, Vincenzo Tosco, Angelo Putignano, Giovanna Orsini 310

EVALUATION OF TECAR TECHNOLOGY DURING ORTHODONTIC TREATMENT: A CASE REPORT 311

Anna Maria Ciocia 311

VLERËSIMI I TEKNOLOGJISË TEKR GJATË TRAJTIMIT ORTODONTIK. 311
Anna Maria Ciocia 311

ENDO-PERIO LESIONS, A CASE REPORT 312
Anna Netti 312

LEZIONET ENDO-PERIODONTALE. 312
Anna Netti 312

ELASTODONTIC THERAPY OF HYPERDIVERGENT CLASS II PATIENTS USING AMCOP® DEVICES 313
Dott. Ssa. Assunta Patano, Dr. Sabino Ceci 313

TERAPIA ELASTODONTIKE E PACIENTËVE TË KLASËS II HIPERDIVERGJENTE DUKE PËRDORUR PAJISJEN AMCOP 313
Dr. Assunta Patano, Dr Sabino Ceci 313

PROSTHETIC ASPECTS IN ORAL IMPLANTOLOGY. 313
Bruno G. Scalise 313

ASPEKTET PROTETIKE NË IMPLANTOLOGJINË ORALE. 314
Bruno G. Scalise 314

THE IMPACT OF BREASTFEEDING AND NON-NUTRITIVE SUCKING HABITS ON INFANT HEALTH 314
Chiara Di Pede, Giulia Palmieri 314

NDIKIMI I USHQYERJES ME GJI DHE VESEVE THITHËSE JOUSHQYESE NË SHËNDETIN E FOSHNJAVE 314
Chiara Di Pede, Giulia Palmieri 314

MANAGEMENT OF INFRA-OCCLUDED PRIMARY MOLARS 315
Dott. Ssa. Claudia Laudadio 315

MENAXHIMI I MOLARËVE PRIMARË TË INFRA-OKLUDUAR. 315
Dr. Claudia Laudadio 315

ORTHODONTIC PURPOSES OF CORTICOTOMY 315
Daniela Azzollini 315

QËLLIMET ORTODONTIKE TË KORTIKOTOMISË. 316
Daniela Azzollini 316

DIGITAL DENTISTRY – NEW MILESTONE IN DENTAL PROFESSION 316
Danimir Jevremovic 316

DENTISTRIA DIXHITALE-ARRITJE INOVATIVE NË FUSHËN DENTARE. 316
Danimir Jevremovic 316

ORTHODONTIC TREATMENT IN A PERIODONTAL PATIENT: CASE REPORT 317
Elisabetta De Ruvo 317

TRAJTIMI ORTODONTIK I PACIENTËVE PERIODONTALË. 317
Elisabetta De Ruvo 317

THE INTRAMASCELLAR AND EXTRAMASCELLAR IMPLANTOLOGY USED IN FULL ARCH REHABILITATIONS 318
Dr. Enrico Andreoli 318

IMPLANTOLOGJIA INTRASINUSALE DHE EKSTRASINUSALE E PËRDORUR NË REHABILITIMET TOTALE 318
Dr. Enrico Andreoli 318

FORSUS FATIGUE RESISTANT DEVICE: A TYPE OF NON-COMPLIANCE DEVICE IN THE TREATMENT OF CLASS II 319
Fabio Piras 319

PAJISJA REZISTENTE NDAJ LODHJES "FORSUS": NJË PAJISJE E CILA NUK KËRKON BASHKËPUNIMIN E PACIENTIT ME QËLLIM TRAJTIMIN E KLASËS II **319**
Fabio Piras 319

ORTHODONTIC ALIGNERS & PERIODONTAL IMPLICATION: WHY ARE CLEAR ALIGNERS ON MOST PERIODONTALLY INVOLVED CASES SUPERIOR TO FIXED APPLIANCES? **320**
Fotis Exarchou 320

"ALIGNERS" & IMPLIKIMET PERIODONTALE: PSE JANË "CLEAR ALIGNERS" SUPERIORË NË SHUMICËN E RASTEVE ME IMPLIKIME PERIODONTALE KRAHASUAR ME APARATET FIKSE ORTODONTIKE? **321**
Fotis Exarchou 321

DIGITAL PLANNING IN ALIGNER ORTHODONTICS: SCIENCE OR FICTION? LUCK OR STRATEGY? **321**
Fotis Exarchou 321

PLANIFIKIMI DIXHITAL NË "ALIGNERS": SHKENCË APO IMAGJINATË? FAT APO STRATEGJI? **322**
Fotis Exarchou 322

III CLASS TREATMENT WITH LOWER TEETH DISTALIZATION **323**
Dr. Giovanni Coloccia 323

TRAJTIMI I KLASËS III ME DISTALIZIM TË DHËMBËVE TË POSHTËM. **323**
Dr. Giovanni Coloccia 323

EXTRACTIVE VS NON-EXTRACTIVE ORTHODONTIC TREATMENTS: DIAGNOSTIC ELEMENTS **323**
Giulia Latini 323

KRAHASIMI I TRAJTIMIT ORTODONTIK ME DHE PA EKSTRAKSIONE: ELEMENTET DIAGNOSTIKE **324**

Giulia Latini 324

IMPACTED CANINES: AETIOLOGY, DIAGNOSIS AND ORTHODONTIC MANAGEMENT 324
Grazia Garofoli 324

KANINËT E IMPAKTUAR: ETIOLOGJIA, DIAGNOZA DHE MENAXHIMI ORTODONTIK. 325
Grazia Garofoli 325

DENTAL ANOMALIES IN NON-SYNDROMIC PATIENTS WITH CLEFT LIP AND PALATE 325
Dott. Ssa. Grazia Marinelli 325

ANOMALITË DENTARE NË PACIENTËT JO SINDROMIKË ME ÇARJE TË BUZËS DHE QIELLZËS. 325
Dr. Grazia Marinelli 325

MARPE: AN EASY WAY TO PERFORM IT. A CASE REPORT 326
Irene Ferrara 326

EKSPANSIONI I SHPEJTË PALATINAL PËRMES MINIVIDAVE (MARPE): NJË MËNYRË E LEHTË PËR TA REALIZUAR. 326
Irene Ferrara 326

IS THERE A FUTURE FOR DENTAL CERAMICS? 327
Jan Schünemann MDT 327

A KA TË ARDHME PËR QERAMIKËN DENTARE? 327
MDT Jan Schünemann 327

THE IMPORTANCE OF A REASONED DIAGNOSIS FOR A CORRECT TREATMENT PLANNING IN ORTHODONTICS 328
Mariagrazia Garibaldi 328

RËNDËSIA E NJË DIAGNOZE TË ARSYETUAR PËR NJË PLANIFIKIM KORREKT TË TRAJTIMIT NË ORTODONCI. 328
Mariagrazia Garibaldi 328

THE ART OF SAFE ROOT CANAL SHAPING **328**
Prof. Mehmet Baybora Kayahan 328

ARTI I FORMËSIMIT TË SIGURT TË KANALEVE RADIKULARE. **329**
Prof. Mehmet Baybora Kayahan 329

EVALUATION WITH CBCT OF VERTICAL BONE AUGMENTATION IN THE MAXILLARY SINUS LIFT TECHNIQUE WITH LATERAL APPROACH: A CASE REPORT **329**
Merigrazia Campanelli, Pasquale Avantario 329

VLERËSIMI ME SKANER CBCT I NGRITJES VERTIKALE KOCKORE NË TEKNIKËN E NGRITJES LATERALE TË SINUSIT MAKSILAR. **330**
Merigrazia Campanelli, Pasquale Avantario 330

CORRELATION BETWEEN THE THIRD FINGER MIDDLE PHALANX MATURATION METHOD AND THE CERVICAL VERTEBRAL MATURATION METHOD IN ORTHODONTIC DIAGNOSIS **331**
Nicole De Leonardis 331

LIDHJA MIDIS MATURIMIT TË FALANGËS SË MESME TË GISHTIT TË TRETË DHE MATURIMIT TË VERTEBRËS CERVIKALE NË DIAGNOZËN ORTODONTIKE. **331**
Nicole De Leonardis 331

TRUE BONE REGENERATION – WHAT THE BODY NEEDS. TRANSLATING BIOLOGY INTO SUCCESSFUL IMPLANT DENTISTRY. **331**
Prof. Dr. Peter JM Fairbairn 331

RIGJENERIMI I VËRTETË I KOCKOR – ÇFARË I NEVOJITET TRUPIT. BIOLOGJIA NË DENTISTRINË IMPLANTARE TË SUKSESSHME. **332**
Peter JM Fairbirn 332

SYSTEMATICS OF IRRIGATION IN ENDODONTICS **333**
Silvio Buongiorno 333

SISTEMI I IRRIGIMIT NË ENDODONCI **334**
Silvio Buongiorno 334

FORENSIC DAMAGE ASSESSMENT OF TEMPOROMANDIBULAR JOINT: A REVIEW **334**
Stefania Costa 334

VLERËSIMI MJEKO-LIGJOR I DËMTIMIT TË ARTIKULACIONIT TEMPOROMANDIBULAR. **335**
Stefania Costa 335

OBJECTIVE ASSESSMENT OF PATIENT COMPLIANCE WITH REMOVABLE ORTHODONTIC APPLIANCES **336**
Dott. Ssa. Valentina Montenegro 336

VLERËSIMI OBJEKTIV I PAJTUESHMËRISË SË PACIENTIT ME APARATE ORTODONTIKE TË LËVIZSHME. **336**
Dr. Valentina Montenegro 336

ATYPICAL SWALLOWING: DIAGNOSIS AND THERAPY IN THE GROWING PATIENT **336**
Viapiano Fabio 336

GËLLTITJA ATIPIKE: DIAGNOZA DHE TRAJTIMI TEK PACIENTËT NË RRITJE **337**
Viapiano Fabio 337

SURGICAL-ORTHODONTIC THERAPY OF A RIGHT LOWER CANINE INCLUDED: CASE REPORT **338**
Vincenzo Carpentiere 338

TRAJTIMI KIRURGJIKALO-ORTODONTIK I KANINIT MANDIBULAR TË DJATHTË TË IMPAKTUAR. **338**
Vincenzo Carpentiere 338

ASSOCIATION BETWEEN INTRAOSSEOUS MALPOSITIONED CANINE AND MESIALISATION OF THE FIRST PREMOLAR **339**
Vito Settanni 339

LIDHJA MIDIS KANINIT TË KEQPOZICIONUAR INTRAKOCKOR DHE MEZIALIZIMIT TË PREMOLARIT TË PARË. **340**
Vito Settanni 340

AVULSIONI I DHËMBIT DHE REIMPLANTIMI I INCIZIVIT CENTRAL MAKSILAR **340**
As.Prof.Dr. Abdyl Izairi 340

FLUORI NË MILENIUMIN E TRETË. **341**
Adelajda Ruci, Prof. As Edit Xhajanka 341

NDIKIMI I PANDEMISË NË SHËNDETIN E PËRGJITHSHËM DHE ORAL **342**
Dr. Afërdita Salihu Fazliu PhD cand[1], Dr Gazmend Fazliu 342

SI DUHET TË MENAXHOHEN TË RRITURIT ME KANCER NGA MJEKËT STOMATOLOGE NËSE KANË NEVOJË PËR TRAJTIM DENTAR **343**
Aida Sadiku 343

MENAXHIMI I LEZIONEVE TË NJOLLAVE TË BARDHAVE **343**
Alba KAMBERI[1] , Olja TANELLARI[1] 343

OSSEODENSIFIKIMI, NJË TEKNIKË ALTERNATIVE E OSTEOTOMISË TRADICIONALE **344**
Dr. Albi Skilja[1], Prof. Asc. Dr. Erda Qorri[2], Dr. Gerila Tafaj[3] 344

NJË ANALIZË MBI IMPLANTIMIN IMEDIAT ME NGARKESË IMEDIATE **345**
Dr.Aldo Vangjeli (Phd)1, Dr.Enkelejda Elbasani2, Dr. Erion Gjiknuri3 345

KANCERI I BUZËS DHE ROLI I MJEKUT STOMATOLOG NË ZBULIMIN E HERSHËM TË TIJ. 346
Dr Shk Algen Isufi[1*], Dr Shk Irina Isufi [2], Prof Dr Ramazan Isufi 346

TRAJTIMI KIRURGJIK ORAL I PACIENTËVE ME SËMUNDJE SISTEMIKE. 346
Amet Demiri[1], Seha Demiri –Mustafai [2,3], Armed Demiri[2] 346

TRAJTIMI I MALOKLUZIONIT TË KLASËS SË III 347
MSc. Andia Kusta[1] 347

ZGJEDHJA E DHËMBËVE ANTERIORË NË PROTEZËN TOTALE 348
Anisa Hallaçi[1], Bianka Bermuça[1], Alketa Qafmolla[2]. 348

TERAPIA ANTIBIOTIKE NË INFEKSIONET ODONTOGJENE 348
Armend Demiri[1], Seha Mustafai[1,2], Amet Demiri[3] 348

KOMPLIKACIONET LOKALE TË IMPLANTEVE DENTARE DHE MENAXHIMI I TYRE 349
Benarda Beqaraj 349

RIKONSTRUKSIONI I BUZËS SË POSHTME 350
Bisela Asllanaj[1] 350

EFIKASITETI KLINIK I PASTËS SË DHËMBËVE ME PËRMBAJTJE LAKTAT ALUMINI DHE KLORHEKSIDINE LIDHUR ME FORMIMIN E PLLAKËS DENTARE DHE GINGIVITIT 350
Dr. Bisela Asllanaj, Prof. Dr. Nicole B. Arweller, Prof. Dr. E. Hellwig 350

KRAHASIMI I DY METODAVE TË POLIMERIZIMIT TË PLASTMASËS NË PROTEZAT E LËVIZSHME, METODA TRADICIONALE VS METODA E POLIMERIZIMIT ME PRESION 351
MSc. Dervish Kërçuku 351

ANESTEZIA LOKALE. TIPET DHE SOLUCIONET QË PËRDOREN NË KLINIKAT TONA. 352
Dorian Kostandini[1], Sara Zeneli[2] 352

PROTOKOLLI OPTIMAL PËR REALIZIMIN E RESTAURIMEVE POSTERIORE DIREKTE. 352
Dorina Mele 352

PËRCAKTIMI I PARAMETRAVE TË DHËMBËVE SIPAS TEORISË SË AUTORËVE FRUSH DHE FISHER GJINI PERSONALITET MOSHË 353
Prof. Asoc. Edit Xhajanka, Dr. Endrit Paparisto, Tedi Vercani 353

NDIKIMI I VITAMINËS D NË ZHVILLIMIN E DHËMBËVE 353
Dr.Shk.Mj.Eglantina Bejko, Dr.Edlira Mulo 353

MATERIALET E MASËS TË PËRDORURA NË PUNIMET PROTETIKE FIKSE DHE TË LËVIZSHME 354
Elisa Cesaj[1], Prof. Asc. Edit Xhajanka [2] 354

KONSIDERATA DIAGNOSTIKE NË PLANIFIKIMIN E TRAJTIMIT TË KAFSHIMIT TË THELLË. 355
Elona Kongo[1], Giovanni Manes Gravina[1]. 355

TRAJTIMI I KOMBINUAR I ANOMALISË SË KLASËS II/1 ME KAFSHIM TË THELLË TRAUMATIK TE DY PACIENTË ADOLESHENTË 355
Dr. Emire Çitaku, Dr. Ekrem Çitaku, Dr. Burak Shabani, Dr. Minire Çitaku, Dr. Teuta Pustina, Dr. Shkurte Çitaku 355

PROTEZA TOTALE E ARDHSHME DHE PËRGATITJA NËPËRMJET PLLAKAVE BAZALE 356
Dr. Endrit Paparisto, Dr. Alketa Qafmolla, Neada Hysenaj, Tedi Vercani 356

ETAPAT KRYESORE NË KRIJIMIN E DIAGNOZËS PERIODONTALE. 357

Eni Jani[1], Endrit Paparisto[1], Anis Thodhorjani[1], Dhimitër Jani[1], Eneida Prifti[1] 357

TRAJTIMI I FRAKTURËS SË KOMPLIKUAR NË DHËMBËT ME APEKS TË PAFORMUAR (RAST KLINIK). 357

Dr. Shk. Enida Petro[1], Albina Kulla[1,2], Megi Terziu[1], Oliverta Hoxha[1], Laureta Vaja[1] 357

PULPEKTOMIA VITALE NË DHËMBËT FRONTALË NË FËMIJË 358

Dr. Shk. Enida Petro[1], Loreta Gjoni[1], Miki Geci [1], Teufik Mula [1], Çlirim Mata[1] 358

AVANTAZHET E PËRDORIMIT TË GLASSIONOMER CEMENTEVE ME REZINË TË MODIFIKUAR NË DENTISTRINË PEDIATRIKE 359

Dr. Shk. Enida Petro[1], Sagita Doda[1], Kristi Licaj[1], Klejda Seiti[1], Erni Prifti[1] 359

VLERËSIMI I BRUKSIZMIT NË MOSHAT E REJA 359

Dr. Shk. Enida Petro[1], Salushe Çela[1], Aurora Bylykbashi[1] 359

SHKAQET E EKSTRAKSIONEVE NË KLINIKAT DENTARE DHE NDËRLIKIMET KRYESORE GJATË DHE PAS NDËRHYRJES360

Prof.Ass.Dr. Erda Qorri, Gloria Demnika 360

QASJE MULTIDISIPLINARE NË TRAJTIMIN E DHËMBËVE TË IMPAKTUAR. 360

Erda Qorri[1], Claudio Taglia[1], Giovani Manes Gravina[1], Isida Marko[1], Erion Ostreni[2], Merilda Tarja[1], Rezart Qorri[3], Nertsa Cunoti[4] 360

SINUSITI MAKSILAR ODONTOGJEN. 361

Eriola Lleshi[1], Dr.Shk.Msc.Nineta Fino[2] 361

ESTETIKA NË ZGJEDHJEN E DHËMBËVE FRONTALE NË PROTEZAT E LËVIZSHME 362

Dr. Eris Kotorri[1], Prof. Asc. Edit Xhajanka[1], Dr. Ejonis Ibrahimi[1] 362

ETIOLOGJIA, DIAGNOZA DHE TRAJTIMI I KANINEVE DHE PREMOLARËVE TË IMPAKTUAR 362
Dr. Eriselda Simoni[1], As Prof. Merita Bardhoshi[2], Dr. Anis Thodhorjani[1], Dr. Denis Kadaifciu[1], Dr. Renato Isufi[1] 362

EKSTRAKSIONI I DHËMBËVE NË PERSONA DIABETIKË DHE HIPERTENSIVË 363
Erisilda Biçaku[1], Dr. Nineta Saraçi[2] 363

OPTIMIZIMI I ESTETIKËS DHE PARASHIKUESHMËRISË SË IMPLANTEVE POSTEKSTRAKTIVE. 364
Erta Xhanari 364

ARSYET E PËRDORIMIT DHE MOSPËRDORIMIT TË SHËRBIMEVE DENTARE TEK ADOLESHENTËT 364
EVA HABAZAJ(Dhima), Matilda Shena, Xhanina Gavazi, Anis Thodhorjani 364

TRAJTIMI I RASTEVE ME ATROFI EKSTREME NËPËRMJET RIBAZIMEVE ME MATERIALE ELASTIKE 365
Fabjola Gjini[1], Prof. Asc. Edit Xhajanka[2] 365

RUAJTJA E DHËMBËVE DHE IMPLANTEVE, QËLLIMI FINAL 366
Gurien Demiraqi, Eriola Noçka, Ervin Sulaj, Edlira Baruti 366

NEURALGJIA TRIGEMINALE, VECORITË E DIAGNOZËS DHE TË REJAT NË TRAJTIM 367
Ilirjana Xhediku[(1)], Dr. Nineta Saraçi[(2)] 367

EFEKTET E KLORHEKSIDINËS TEK SHTRESA HIBRIDE 367
Dr.Shk.Med. Ilma Robo, Edona Hasanaj[1] 367

SUTURAT PERIODONTALE, DISA TË DHËNA MBI KARAKTERISTIKAT SPECIFIKE SIPAS RASTEVE KLINIKE 368
Dr.Shk.Med. Ilma Robo, Glorja Demika[1] 368

FRIKA E FËMIJËVE NDAJ DENTISTËVE, METODA INNOVATIVE PËR AFRIMIN E FËMIJËVE DREJT KABINETEVE DENTARE **368**
Dr.Shk.Med. Ilma Robo, Kristina Myftaraj[1] 368

LLOJET E SUTURIMIT PERIODONTAL, AVANTAZHET DHE DISAVANTAZHET NË APLIKIM **369**
Dr.Shk.Med. Ilma Robo, Migerta Çafaj[1] 369

VENEERS APO LUMINEERS **370**
Ilvia Tabaku Alimehmeti, Klea Mazelli, Pamela Tushe, Igli Kllomollari 370

RIVASKULARIZIMI : PROTOKOLLET E REJA DHE KONSIDERATA KLINIKE (RISHIKIM LITERATURE). **370**
Ilvia Tabaku Alimehmeti, Zajbeita Alimehmeti, Daniela Kume, Ama Mino 370

KOMPLIKACIONET E COVID-19 NË REGJIONIN MAKSILO-FACIAL **371**
Dr. Jakup Vrioni, Dr.Deniada Zhupa, Dr.Kleida Selhanej, Dr.Grei Malo 371

KAPACITETI PUFERIK I PËSHTYMËS DHE IHO SI FAKTOR RREZIKU I KARIESIT **371**
Jetmire Alimani Jakupi 371

ARRITJA E VENDOSJES SË FONETIKËS OPTIMALE NË PACIENTË ME PROTEZA TOTALE **372**
Jonida Roçi[1], Prof. Asc. Edit Xhajanka[2] 372

PADHËMBËSIA E PJESSHME E VARGJEVE DHËMBORE PERMANENTE DHE FREKUENCA E SAJ **373**
Kaltrina BEQIRI[1], Sherif SHAQIRI[1,2] , Amet DEMIRI[2,3], Seha MUSTAFAI[4] 373

NDËRHYRJET KIRURGJIKALE TË INDEVE TË BUTA, NË FUNKSION TË PROTEZIMIT **373**
Kevin Ndreu[1], Prof. Ass. Merita Bardhoshi[2] 373

PREPARIMI VERTIKAL ME MBROJTJE BIOLOGJIKE I DHËMBËVE, BOPT, PËRKUNDREJT METODAVE BAZË TË PREPARIMIT. 374
Laureta Peposhi, Spec.Msc Egida Haldeda 374

REHABILITIMI I MAKSILËS ATROFIKE ME ANËN E IMPLANTEVE ZIGOMATIKË 374
Prof. Asc. Dr. Luan Mavriqi, Dr. Denis Argjiri. 374

SILANTET NË PROFILAKSINË E KARIESIT 375
Dr. Shk Manola Kelmendi, Jorisa Malaj 375

TRAJTIMI I PATOLOGJISË PULPARE NË DENTICIONIN E PËRKOHSHËM. 375
Dr.Shk Manola KELMENDI, Ornela HYSENAJ 375

TRAUMAT DENTARE 376
MSc. Marinela Malçi, MSc. Bujar Ferati 376

STUDIM RETROSPEKTIV NË MENAXHIMIN E TRAUMAVE DENTARE NË SPITALIN E TRAUMËS PËRGJATË VITEVE 2011-2020 377
Megi Taraj 377

MANAXHIMI KIRURGJIKAL I DHËMBËVE TË PJEKURISË 378
Merita Bardhoshi, Manuela Ismailaj 378

MANAXHIMI I PROCESEVE INFLAMATORE TË REGIONIT OMF 378
Merita Bardhoshi, Merisa Hate 378

LEZIONET ORALE TEK PACIENTËT HIV POZITIV 379
MSc. Naile Bregu 379

INCIDENCA E LEZIONEVE ORALE NË PACIENTËT E TRAJTUAR ME PROTEZA TOTALE TË LËVIZSHME. 380
Neada Hysenaj, Endrit Paparisto 380

STOMATITI PROTETIK: RISHIKIM LITERATURE. 380

Dr. Neada Hysenaj[1], Prof. Asoc. Edit Xhajanka[2], Endrit Paparisto 380

MENAXHIMI SPITALOR I INFEKSIONEVE ODONTOGJEN. 381

Dr. Nela Mataj; Dr.Shk Andis Qendro 381

TRAJTIMI I KAFSHIMIT TË HAPUR NË PACIENTËT ME DINTICION MIKS 381

Prunela Poliçi, Ilsa Nini 381

KIRURGJIA PLASTIKE PARODONTALE – LLOJET E GRAFTEVE DHE TEKNIKAT PËR MBULIMIN E RECESIONEVE GINGIVARE 382

Gavazi R., Kërçi A., Lulaj Xh. 382

PARIMET BIOMEKANIKE DHE PLANI I TRAJTIMIT TË IMPLANTEVE DENTARE 383

Dr. Renato Isufi[1], Dr. Aurora Isufi[2], Dr. Eriselda Simoni[1], Dr. Denis Kadaifciu[1], Dr. Anis Theodhorjan 383

DISFUNKSIONET ORALE 383

Rosela Xhemnica, Ana Golloshi 383

KANINI I IMPAKTUAR. 384

Rosela Xhemnica, Rael Hidi, Klaudia Legisi 384

NDIKIMI I TORUSIT PALATINAL NË THYERJEN E PROTEZËS TOTALE. 385

Prof. Dr. Ruzhdie Qafmolla, Marjola Shehi, Endrit Paparisto 385

NDËRLIDHJA NDËRMJET ÇRREGULLIMEVE MENDORE DHE BRUKSIZMIT 385

Prof.Dr.Rruzhdie Qafmolla, Mesuara Pasho, Alketa Qafmolla 385

PERICORONITIS: NJË STUDIM KLINIK DHE EPIDEMIOLOGJIK TË PACIENTËVE TË TRAJTUAR NË REPARTIN E KIRURGJISË ORALE TETOVË **386**
Seha Demiri Mustafai[1,2], Armed Demiri[1];Amet Demiri[3] 386

FREKUENCA E SANIMIT PROTETIK TË VARGJEVE DHËMBORE PERMANENTE **386**
Sherif Shaqiri[1,2], Kaltrina Beqiri[1] 386

VLERËSIMI I HIGJENËS ORALE NË PACIENTË ME SËMUNDJE SISTEMIKE. **387**
Skerda Bego, Prof.As Edit Xhajanka 387

RIGJENERIMI KOCKOR **388**
Dr. Uran Halimi1 PhD cand., Dr. Shqipe Krasniqi2 388

ÇRREGULLIMET DISFUNKSIONALE TË ATM-SË DHE LËVIZJET ATIPIKE. **389**
MSc. Xhejna Matlija, Prof. Dr. Ruzhdie Qafmolla. 389

FORMA E HARKUT ALVEOLO-DENTAR MAKSILAR E RËNDËSIA PROTETIKE E TIJ. **390**
Xhoana Buzi, Prof. As. Edit Xhajanka 390

MBINDJESHMËRIA E DENTINËS **390**
Xhovana Myrtollari[1], Prof. Asc. Edit Xhajanka[2] 390

LEZIONET ORALE NË SINDROMËN DOWN **391**
Xhovana Saliasi[1], Prof. Asc. Edit Xhajanka[2] 391

DIXHITALIZIMI NË IMPLANTOLOGJINË MODERNE **391**
Msc Ylli Menga, Prof Giovani Manes Gravina, Phd Dorian Kostandini, Phd Loreta Pojani , Dr Erjona Baci, Dr Brixhilda Neli. 391

ABSTRACTS OF PHARMACY/ **394**

ABSTRAKTET E FARMACISË **394**

SFIDAT E ARKITEKTURËS SË PRAKTIKËS SË FARMACISË NË TRAJTIMIN E PANDEMISË COVID-19 – SHKËMBIMI I PËRVOJËS NGA PRAKTIKA FARMACEUTIKE NË KOSOVË **394**

Arianit Jakupi[1,2], Arta Basha Jakupi[3] 394

FALSIFIKIMI I MEDIKAMENTEVE DHE SHITJA ONLINE E TYRE SI NJË NDËR SFIDAT GJATË PERIUDHËS SË PANDEMISË SË COVID-19 **395**

Artenca Shkeza Kraja 395

STUDIM MBI PËRDORIMIN, PËRGATITJEN DHE VLERËSIMIN E PRODUKTEVE KOZMETIKE HALLALL NË BOTË DHE NË VENDIN TONË **395**

Anxhela Kasapi[1], Brunilda Myftari[1] 395

ROLI I TEKNOLOGJISE FARMACEUTIKE NE ZHVILLIMIN E TERAPIVE PER TRAJTIMIN E SËMUNDJES SË ALZHEIMERIT **396**

Brunilda Myftari[1], Dea Cenomeri[1], Jola Habasllari[1] 396

PËRSIATJE MBI FORMULIMIN DHE PËRGATITJEN E DISA SAPUNEVE PËR LËKURË TË THATË **397**

Denis Meni[1], Brunilda Myftari[1] 397

ROLI I VAJIT TË BIMËS CANABIS SATIVA L. NË PRODUKTET DERMOKOZMETIKE **398**

Brunilda Myftari[1], Naola Egro[1], Megi Zeneli[1] 398

VITILIGO, SHFAQJA E TIJ DHE ROLI FARMACISTIT NË KËTË SËMUNDJE **399**

Brunilda Myftari[1], Ledjana Resulaj[1] 399

PËRDORIMI I SUPLEMENTEVE NË SHTATËZANI **399**

Dajana Roshi, Antigona Shahinaj[1], Rexhina Leka[2] 399

SHURUPI I AMITRIPTILINËS, NJË SHEMBULL I GALENIKËS KLINIKE NË SHËRBIM TË PROBLEMATIKËS SË FORMË-DOZAVE 400
Delina Xhafaj[1], Sara Hamolli[2] 400

GADISHMËRIA DHE ROLI I FARMACISTIT NË URGJENCA DHE FATKEQËSI KOMBËTARE 401
Delina Xhafaj[1], Vivian Haliti[2], Blerina Agushi[3], Eldisa Qoku[2], Dea Zaimi[2] 401

PËRDORIMI I SUPLEMENTEVE TË MELATONINËS NË ÇRREGULLIMET E GJUMIT 401
Dorina Dervishi[1], Emi Panariti[2], Anjeza Rustemi[2], Sara Zavalani[1] 401

PËRCAKTIMI I PAPASTËRTIVE NË BARNA, NJË HAP I RËNDËSISHËM PËR TË GARANTUAR CILËSINË 402
Lorena Karaj, Prof. Asoc. Ela Hoti 402

COVID-19: CILI ËSHTË ROLI I RESVERATROL? 403
Elisa Domi[1], Malvina Hoxha[1], Bruno Zappacosta[1] 403

ANTIVIRALËT, DIZENJIMI DHE ZHVILLIMI I TYRE DERI NË PERIUDHËN COVID-19 404
Entela Haloci, Megi Selgjekaj, Megi Ndrecka 404

APLIKIMET AKTUALE DHE RISITË NË INFORMATIZIMIN E SISTEMIT FARMACEUTIK DHE MJEKËSOR SHQIPËTAR 405
Qerime Ruçi[1], Valbona Xhafa[1], Delina Troja[2], Ranela Ceci[3], Erjon Troja[1] 405

VETË-MJEKIMI NË MIGRENË 406
Dr. Eva Troja 406

PËRGATITJET GALENIKE: NJË SFIDË E FARMACISTIT SPITALOR PËR TË PLOTËSUAR NEVOJAT E PACIENTËVE PEDIATRIK 406
M.Sc.Fabiola Noga[1,3], Prof.Asoc. Ela Hoti[1], M.Sc. Enida Balla[2], M.Sc. Evis Lushaj[3] 406

ROLI I FARMACISTIT NË MENAXHIMIN E ASTMËS 407
Mr. Ph. Granit Çeku 407

SIMPTOMAT E STRESIT, ANKTHIT DHE DEPRESIONIT NË PACIENTËT ME AKNE VULGARIS 408
MSc. Helena Hazizaj[1], Alma Hazizaj[2] 408

NDIKIMI I PANDEMISË SARS COVID-19 NË SHËRBIMIN FARMACEUTIK NË SHQIPËRI 409
Irsida Mehmeti[1], Silvi Bozo[2], Eftiola Pojani[3] 409

KËNDVËSHTRIMI I FARMACISTËVE NË SHQIPËRI NDAJ "PËRSHKRIMI FARMACEUTIK" 410
MSc. Josiana Selami[1], MSc. Sindi Huti[2], Prof. Dr. Suela Këlliçi[3] 410

FARMAKOVIGJILENCA NDIKIMI I SAJ NË SHËNDETIN E NJERIUT. VAKSINAT KUNDËR COVID-19 411
MSc. Jovisa Marku, MSc. Dajana Roshi 411

PROVAT KLINIKE NË TUMORET E RRALLA GJINEKOLOGJIKE 411
Prof. Asoc. Klejda Harasani[1], Amelja Lala[2], Silvia Semanjaku[2] 411

MONITORIMI TERAPEUTIK I BARNAVE NË PACIENTËT E SHTRUAR NË SPITAL 412
Prof. Asoc. Klejda Harasani[1], Lediona Dautaj[2] 412

PERCEPTIMI I FARMACISTËVE DHE PACIENTËVE PËR REDUKTIMIN APO ELEMINIMIN E NJË BARI OSE NJË GRUPI BARNASH (DEPRESCRIBING) NË PËRSHKRIME PËR DIAGNOZA TË NDRYSHME 413
Msc. Ledi Shehi[1], Dr. Shk. Klejda Harasani[1,2] 413

STUDIM PËR IDENTIFIKIMIN E PËRGATESAVE PEDIATRIKE QË MUNGOJNË NË RECEPTURË DHE MUND TË PËRGATITEN NGA FARMACISTI 414
Prof. Dr. Ledjan Malaj, MSc. Ani Tusha, MSc. Alkida Rraja 414

NDIKIMI I DEGRADIMIT TË SHIKIMIT NË ADERENCËN TERAPEUTIKE NË MOSHËN E TRETË 415
Prof. Dr. Ledjan Malaj[1], MSc. Sindi Huti[2], MSc. Josiana Selami[3] 415

MENAXHIMI I LABORATORIT GALENIK NË FUNKSION TË RRITJES SË PERFORMANCËS SË FARMACISË 415
Prof. Ledjan Malaj[1,2], Zehadin Gashi[3], MSc. Yllka Omuri[1], Drilon Gashi[4] 415

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI VALIDIMIN E PROCESEVE TË PRODHIMIT NË INDUSTRINË FARMACEUTIKE 416
Eni Bushi, Ledjan Malaj 416

ANALIZË MBI MUNDËSINË E VËNIES NË ZBATIM TË SISTEMIT "LEAN" NË SISTEMIN SHËNDETËSOR NË SHQIPËRI 417
Eni Bushi, Ledjan Malaj 417

SITUATA AKTUALE DHE SFIDAT E EDUKIMIT NË FARMACI 418
MS. Orion Dido, Prof. Ledjan Malaj 418

NDIKIMI I TOKSICITETIT TË METALEVE TË RËNDA DHE PESTICIDEVE NË ÇRREGULLIMET MENDORE 418
Linda Matua[1], Alesia Vasku[2], Nadia korreshi[2], Marina Kuca[2] 418

TOKSICITETI I INHIBITORËVE SELEKTIVË TË RIKAPJES SË SEROTONINËS GJATË TRAJTIMIT TË DEPRESIONIT E ANKTHIT TË SHKAKTUAR NGA PANDEMIA COVID-19 419
Linda Matua[1], Livia Nuhaj[2], Eva Leka[2] 419

KRITERET SHQIPTARE DHE EUROPIANE PËR HAPJEN E NJË FARMACIE 420
Irina Argjiri, Prof. Asoc. Mirela Miraçi 420

LEGJISLACIONI PËR SHËNDETIN MENDOR : KRAHASIMI MIDIS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR DHE LEGJISLACIONIT TË VENDEVE TË TJERA. 421
Lorena Karaj, Prof. Asoc. Mirela Miraci. 421

TERAPIA GJENIKE DHE RREGULLIMI LEGJISLATIV 422
Olivera Hila, Prof.Asoc. Mirela Miraçi 422

RECEPTORËT TOLL (TLR), SHËNJESTËR E MUNDSHME TERAPEUTIKE PËR SHUMË BARNA TË RINJ 423
M.Sc. Sabihe Cenaj, Prof.Asoc. Ela Hoti 423

SFIDAT E LIDHURA ME TERAPINË ME ANTIKOAGULANTË, TRAJTIMI FARMACEUTIK NË KËTO RASTE 424
MSc. Beti Faber[1], MSc Adela Canaj[1], Prof. Dr. Suela Këlliçi[2] 424

POLIFENOLET ME ORIGJINË BIMORE ME AKTIVITET TË MUNDSHËM ANTIVIRAL NDAJ SARS-COV-2 425
Tea Mastori, Fjoralba Shehu, Mario Shyti, Klea Spahiu, Prof. Dr. Vilma Papajani (Toska) 425

RËNDËSIA E UDHËZIMEVE PËR PËRDORIMIN E DREJTË TË BARNAVE DHE FAKTORËT QË NDIKOJNË NË MOSDHËNIEN E KËTYRE UDHËZIMEVE 426
Zehadin Gashi[1] , Ledjan Malaj[2], Drilon Gashi[3] 426

POSTER ABSTRACTS/ 428

ABSTRAKTET ME POSTERA 428

MENARKA NË MESIN E VAJZAVE ADOLESHENTE TË SHKOLLËS 9 –VJEÇARE FENIX 428
Alma Imami[1], Mark Lelcaj[2], Xhevahire Hajdari[3], Miranda Çela[1], Denisa Bego[1], Alketa Dervishi[1] 428

HERPES ZOSTER VIRUS NË PACIENTËT HEMATOLOGJIK 428
Ana Plaku, Adela Perolla, Elsuarta Calliku, Alma Cili, Tatjana Caja, Polikron Pulluqi, Arben Ivanaj 428

EFEKTIVITETI I USHTRIMEVE TË BALANCËS NË RRITJEN E PERFORMANCËS SPORTIVE DHE AFTËSIVE MOTORIKE TE SPORTISTËT ME DËMTIME TË GJYMTYRËVE INFERIORE 429

Ana Sulaj 429

SITUATA E DISA ÇRREGULLIMEVE DIARREIKE DHE SËMUNDJEVE TË TJERA INFEKTIVE ME BAZË USHQIMORE, NË RRETHIN E TIRANËS 2015-2016 430

Dr. A. Xhixha[1], T. Xhixha[3], Dr. A. Xhixha[2] 430

ASTAKSANTINA: NJË PËRBËRËS NATYROR ME VEPRIMTARI BIOLOGJIKE DHE PËRFITIME SHËNDETËSORE 431

Dorina Dervishi[1], Emi Panariti[2], Sara Zavalani[1], Xheni Nokaj[3] 431

MENAXHIMI I ANOMALISË SË KLASËS II/1 ME KAFSHIM TË HAPUR 432

Dr. Ekrem Çitaku, Dr. Emire Çitaku, Dr. Burak Shabani, Dr. Minire Çitaku, Dr. Shkurte Çitaku. 432

TRAJTIMI I DIASTEMËS MEDIANE - QASJA MULTIDISIPLINARE 433

Dr. Ekrem Çitaku, Dr. Emire Çitaku, Dr. Burak Shabani, Dr. Minire Çitaku, Dr. Shkurte Çitaku. 433

ARSYET SE PSE VJEN KARIESI I FËMIJËRISË SË HERSHME 434

Dr. Elona Zahaj 434

TRAJTIMI INTERDISIPLINAR I ANOMALISË SË KLASËS II/1 ME DIASTEMA 434

Dr. Emire Çitaku, Dr. Ekrem Çitaku, Dr. Burak Shabani, Dr. Minire Çitaku, Dr. Shkurte Çitaku 434

TRAJTIMI I DENDËSISË BIMAKSILLARE TE PACIENTI ADOLESHENT 435

Dr. Emire Çitaku, Dr. Ekrem Çitaku, Dr. Burak Shabani, Dr. Minire Çitaku, Dr. Shkurte Çitaku 435

ROLI I ANALIZËS KROMOZOMIKE KONVENCIONALE NË DIAGNOSTIKIMIN E ANEMISË FANKONI 436

[1]Flogerta Alia, [2]Dorina Roko, [2]Anila Babameto – Laku 436

RITRAJTIMI I NJE DËSHTIMI ENDODONTIK (RAPORTIM RASTI) 437

Florjan Zoto[1], Odeta Zoto[2] 437

STRATEGJIA KOMBËTARE NDAJ COVID-19 DHE ROLI I FONDIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR 437

Dr. Shk. Florjana Rustemi[1] 437

TURKISH TRIFOLIUM PRATENSE L. INDUCED APOPTOSIS AND AUTOPHAGY IN C6 GLIOBLASTOMA CELLS, BUT WAS NOT EFFECTIVE ON CANCER STEM CELLS 438

Gamze Tanrıverdi[1], Aynur Abdulova[1], Hatice Çölgeçen[2], Havva Atar[2], Belisa Kaleci[1], Tuğba Ekiz-Yılmaz[3] 438

TURK TRIFOLIUM PRATENSE L. INDUKTOI APOPTOZËN DHE AUTOFAGINË NË QELIZAT GLIOBLASTOMA C6, POR NUK ISHTE EFEKTIVE NË QELIZAT BURIMORE TË KANCERIT. 439

Gamze Tanrıverdi[1], Aynur Abdulova[1], Hatice Çölgeçen[2], Havva Atar[2], Belisa Kaleci[2], Tuğba Ekiz-Yılmaz[3] 439

DEPISTIMI I FIBROZËS KISTIKE. 440

Ilda Ndreko[1], Ariola Kosta Zeqirllari[2] 440

EKUILIBRI MIDIS VETËKUJDESIT DHE MËNYRËS SË JETESËS GJATË PERIUDHËS SË PANDEMISË 441

Msc. Jada Caja[1], Msc. Tedi Mana[1], Prof. Tatjana Caja[2] 441

PROCEDURAT E KONTROLLIT TË CILËSISË NË KAMERAT GAMA ME DY KOKA DHE NDËRTIMI I NJË FAQEJE INTERAKTIVE ANALITIKE NË INTERNET 442

Jurgen Shano 442

INFEKSIONET E TRAKTIT URINAR NË MOSHAT ADULTE 442

Venemin Gega 442

ABSTRAKTET E SHKENCAVE MJEKËSORE

ABSTRACTS OF MEDICAL SCIENCES

ABSTRACTS OF MEDICAL SCIENCES/ ABSTRAKTET E SHKENCAVE MJEKËSORE

EVOLUTION OF SURGICAL MANAGEMENT FOR BREAST CANCER IN THE MODERN ERA

Prof. Dr. Cihan Uras

Abstract

The management of breast cancer has evolved into a multidisciplinary evidence-based surgical speciality, with emphasis on conservative surgery. A number of landmark trials have established lumpectomy followed by radiation as the standard of care for many patients. The aim of this study is to construct a narrative review of recent developments in the surgical management of breast cancer and how such developments have impacted surgical practice. A comprehensive literature search of Pubmed was conducted. The latest search was performed on October 31st, 2020. Search terms “breast cancer” were used in combinations with specific key words and Boolean operators relating to surgical management. The reference lists of retrieved articles were comprehensively screened for additional eligible publications. Articles were selected and reviewed based on relevance. We selected publications in the past 10 years but did not exclude commonly referenced and highly regarded previous publications. Review articles and book chapters were also cited to provide reference on details not discussed in the academic literature. This article reviews the current evidence in surgical management of early-stage breast cancer, discusses recent trends in surgical practice for therapeutic and prophylactic procedures and provides commentary on implications and factors associated with these trends.

EVOLUCIONI I MENAXHIMIT KIRURGJIKAL PËR KANCERIN E GJIRIT NË EPOKËN MODERNE.

Prof. Dr. Cihan Uras

Abstrakt

Menaxhimi i kancerit të gjirit ka evoluar në një specialitet kirurgjikal shumëdisiplinor të bazuar në prova, me rëndësi në kirurgjinë konservative. Një numër provash historike kanë vendosur lumpektominë e ndjekur nga rrezatimi si standard i kujdesit për shumë pacientë. Qëllimi i këtij studimi është të ndërtojë një përmbledhje narrative të zhvillimeve të fundit në menaxhimin kirurgjik të kancerit të gjirit dhe se si zhvillime të tilla kanë ndikuar në praktikën kirurgjikale. U krye një kërkim gjithëpërfshirës i literaturës në Pubmed. Kërkimi i fundit u krye në 31 tetor 2020. Termat e kërkimit "kanceri i gjirit" u përdorën në kombinime me fjalë kyçe specifike dhe operatorë Boolean në lidhje me menaxhimin kirurgjikal. Listat e referencës së artikujve të marrë u kontrolluan në mënyrë gjithëpërfshirëse për botime shtesë të pranueshme. Artikujt u zgjodhën dhe u rishikuan në bazë të rëndësisë. Ne zgjodhëm botime në 10 vitet e fundit, por nuk përjashtuam botimet e mëparshme të përmendura zakonisht dhe shumë të vlerësuara. Artikujt rishikues dhe kapitujt e librave u cituan gjithashtu për të ofruar

referencë mbi detajet që nuk diskutohen në literaturën akademike. Ky artikull shqyrton provat aktuale në menaxhimin kirurgjikal të kancerit të gjirit në fazën e hershme, diskuton tendencat e fundit në praktikën kirurgjikale për procedurat terapeutike dhe profilaktike dhe jep komente mbi implikimet dhe faktorët që lidhen me këto tendenca.

Fjalë kyç: menaxhim kirurgjikal, kanceri i gjirit.

ARTIFICIAL INTELLIGENCE AND DIGITAL LEADERSHIP – THE FUTURE HAS ALREADY BEGUN

Prof. Dirk Pickuth MD, PhD, MDs[1]
[1]*Head of the Department of Diagnostic and Interventional Radiology Director of the Digital Innovation and Strategy Hub Formerly Medical Director*

Abstract
Artificial intelligence is the most positive development in medical imaging. AI facilitates the detection and augments the characterisation of lesions. AI optimises decision making. AI transforms radiology from a subjective skill into an objective science. AI reduces the scan time. AI mitigates the shortage of clinical radiologists. AI frees up time and resources, automates mundane repetitive tasks and time consuming tasks, and boosts radiological accuracy and radiological productivity. AI determines clinical priorities. Key developments such as work-list management, triage of cases by acuity and no-show prediction improve service quality.
AI in medical imaging transforms decision making, with the effects of more accurate diagnoses, better tailored treatment, faster drug development and more empowered patients. Precision medicine and personal healthcare will be expanded with AI powered decision support solutions. With AI, medicine moves from volume-based to value-based.
AI has a global perspective and progressive research is being undertaken across all continents. Start-ups do pioneering work and aid the international healthcare industry with cutting edge technology.
Now it is high time for healthcare organisations to leverage digital leadership at all levels.
Digital leaders have particular expertise and experience in translating digital products into clinical use, thus meeting the needs of both patients and professionals. They have comprehensive skills in digital leadership and change management, along with the proven ability to deliver on competing priorities with multiple stakeholders, especially at the intersection of technology strategy and business operations. Digital change management is fresh in thinking and uncompromising about quality. Mental agility is essential to digital leaders because they are continually dealing with ongoing complexity and the need to make decisions in an uncertain context.
In the next few years, digital technology's influence will become even more pervasive. We will need a new generation of digital leaders who use the digital world to everyone's advantage. These leaders will deliver change so that patients, staff and organisations benefit from the many improvements digital technology has to offer. This includes above all knowledge management, data analytics, decision support and artificial intelligence.

INTELIGJENCA ARTIFICIALE DHE UDHËHEQJA DIXHITALE- E ARDHMJA TASHMË KA FILLUAR.

Professor Dirk Pickuth MD, PhD, MDs (honoris causa).
Head of the Department of Diagnostic and Interventional Radiology Director of the Digital Innovation and Strategy Hub
Formerly Medical Director
CaritasKlinikum Saarbrücken
Academic Teaching Hospital of Saarland University

Abstrakt

Inteligjenca artificiale (IA) është zhvillimi më pozitiv në imazhet mjekësore. IA lehtëson zbulimin dhe rrit karakterizimin e lezioneve. IA optimizon vendimmarrjen. IA e transformon radiologjinë nga një aftësi subjektive në një shkencë objektive. IA zvogëlon kohën e skanimit. IA zbut mungesën e radiologëve klinikë. Inteligjenca artificiale çliron kohë dhe burime, automatizon detyrat e zakonshme të përsëritura dhe detyrat që konsumojnë kohë, dhe rrit saktësinë radiologjike dhe produktivitetin radiologjik. IA përcakton prioritetet klinike. Zhvillimet kryesore si menaxhimi i listës së punës, klasifikimi i rasteve sipas mprehtësisë dhe parashikimi i mos-shfaqjes përmirësojnë cilësinë e shërbimit. Inteligjenca artificiale në imazhet mjekësore transformon vendimmarrjen, me efektet e diagnozave më të sakta, trajtimit më të përshtatshëm, zhvillimit më të shpejtë të barnave dhe pacientëve më të fuqizuar. Mjekësia precize dhe kujdesi shëndetësor personal do të zgjerohen me zgjidhjet e mbështetjes së vendimeve të mbështetura nga IA. Me inteligjencën artificiale, mjekësia kalon nga vëllimi në bazë të vlerës. IA ka një perspektivë globale dhe kërkime progresive po ndërmerren në të gjitha kontinentet. Ndërmarrjet fillestare bëjnë punë pioniere dhe ndihmojnë industrinë ndërkombëtare të kujdesit shëndetësor me teknologjinë më të avancuar. Udhëheqësit dixhitalë kanë ekspertizë dhe përvojë të veçantë në përkthimin e produkteve dixhitale në përdorim klinik, duke përmbushur kështu nevojat e pacientëve dhe profesionistëve. Ata kanë aftësi gjithëpërfshirëse në udhëheqjen dixhitale dhe menaxhimin e ndryshimeve, së bashku me aftësinë e dëshmuar për të ofruar prioritete konkurruese me aktorë të shumtë, veçanërisht në kryqëzimin e strategjisë së teknologjisë dhe operacioneve të biznesit. Menaxhimi i ndryshimeve dixhitale është i freskët në të menduar dhe pa kompromis për cilësinë. Shkathtësia mendore është thelbësore për udhëheqësit dixhitalë sepse ata vazhdimisht po merren me kompleksitetin e vazhdueshëm dhe nevojën për të marrë vendime në një kontekst të pasigurt. Në vitet e ardhshme, ndikimi i teknologjisë dixhitale do të bëhet edhe më i përhapur. Ne do të kemi nevojë për një gjeneratë të re liderësh dixhitalë që përdorin botën dixhitale në avantazhin e të gjithëve. Këta liderë do të sjellin ndryshime në mënyrë që pacientët, stafi dhe organizatat të përfitojnë nga përmirësimet e shumta që ofron teknologjia dixhitale. Kjo përfshin mbi të gjitha menaxhimin e njohurive, analitikën e të dhënave, mbështetjen e vendimeve dhe inteligjencën artificiale.

Fjalë kyç: Inteligjenca artificiale, mjekësi, udhëheqja dixhitale, etj.

PSYCHODERMATOLOGY: AN UNDER-RECOGNIZED FRONTIER IN DERMATOLOGY AND PSYCHOSOMATIC MEDICINE

Mohammad Jafferany, MD, FAPA, MCPS[1]
[1]Clinical Professor, Central Michigan University College of Medicine and CMU Medical Education Partners, Saginaw, Michigan, USA

Abstract

Psychodermatology is a growing field in psychosomatic medicine that examines the complex associations between the psyche and skin to better manage this diverse and under-recognized patient population. Categorical organization of psychodermatologic conditions falls under five general areas: psychophysiologic disorders, primary and secondary psychiatric disorders, cutaneous sensory syndromes, and psychotropic drugs in dermatology. A lack in awareness and knowledge exists of this grey area of medicine leading to misdiagnosis and under-diagnosis. Additionally, from a patient perspective, the ineffective and essentially non-existent traditional methods of care lead to increasing burden from their chronic conditions'. Inability to receive concrete information and individualized, holistic treatment options for their conditions can lead to "doctor shopping," socioeconomic burden, and can foster a distrust of the medical professional causing decreased compliance. Patients with psychocutaneous disease may present to multiple professionals to seek care. The multidimensional nature of the conditions can lead to specialists being fearful of how to properly manage patients. This lecture provides vital information for a multidisciplinary audience to spark collaboration, increased awareness, and ultimately, improved patientcare.

PSIKODERMATOLOGJIA: NJË KUFI I NJOHUR NË DERMATOLOGJI DHE MJEKËSI PSIKOSOMATIKE.

Mohammad Jafferany, MD, FAPA, MCPS[1]
[1]Clinical Professor, Central Michigan University College of Medicine and CMU Medical Education Partners, Saginaw, Michigan, USA

Abstrakt

Psikodermatologjia është një fushë në rritje në mjekësinë psikosomatike që shqyrton lidhjet komplekse midis psikikës dhe lëkurës për të menaxhuar më mirë këtë popullatë të larmishme dhe të nën-njohur të pacientëve. Organizimi kategorik i gjendjeve psikodermatologjike ndahet në pesë fusha të përgjithshme: çrregullimet psikofiziologjike, çrregullimet psikiatrike parësore dhe dytësore, sindromat shqisore të lëkurës dhe barnat psikotrope në dermatologji. Ekziston një mungesë e vetëdijes dhe njohurive për këtë zonë gri të mjekësisë që çon në diagnozë të gabuar dhe nën diagnozë. Për më tepër, nga këndvështrimi i pacientit, metodat tradicionale joefektive dhe në thelb inekzistente të kujdesit çojnë në rritjen e barrës nga kushtet e tyre kronike. Paaftësia për të marrë informacion konkret dhe opsione të individualizuara dhe tërësore të trajtimit për kushtet e tyre mund të çojë në "doctor shopping", barrë socio-ekonomike dhe mund të nxisë një mosbesim ndaj profesionistit mjekësor duke

shkaktuar ulje të pajtueshmërisë. Pacientët me sëmundje psikokutane mund të paraqiten te profesionistë të shumtë për të kërkuar kujdes. Natyra shumëdimensionale e kushteve mund të bëjë që specialistët të kenë frikë se si të menaxhojnë siç duhet pacientët. Ky referim ofron informacion jetik për një audiencë multidisiplinare për të nxitur bashkëpunimin, rritjen e ndërgjegjësimit dhe në fund të fundit, përmirësimin e kujdesit ndaj pacientit.

Fjalë kyç: psikodermatologjia, psikikë, lëkurë, etj.

RADIOTHERAPY AFTER PRIMARY SYSTEMIC TREATMENT

Prof. Dr. Nuran Bese

Abstract

In early stage breast cancer, radiotherapy is an integral part of breast-conserving treatment. Standard treatment includes irradiation of the entire breast for several weeks, followed by a boost to the tumor bed in women age 50 years or younger or those with close surgical margins. Mastectomy is an appropriate treatment for many patients. Postmastectomy irradiation with proper techniques substantially decreases local recurrences and improves survival in patients with positive axillary lymph nodes. Many patients present with locally advanced or inoperable breast cancer. Their initial treatment is by systemic therapy; after responding to systemic therapy, most will require a modified radical mastectomy followed by radiotherapy. For those patients in whom mastectomy is still not possible after initial systemic therapy, breast and regional irradiation is given, followed whenever possible by mastectomy. For patients with distant metastases, irradiation may provide relief of symptoms such as pain, bleeding, ulceration, and lymphedema. A single fraction of irradiation can effectively relieve pain from bone metastases. Radiotherapy is also effective in the palliation of symptoms secondary to metastases in the brain, lungs, and other sites. Radiotherapy is important in the treatment of women with breast cancer of all stages. In developing countries, it is required for almost all women with the disease and should therefore be available.

RADIOTERAPIA PAS TRAJTIMIT SISTEMIK PARËSOR

Prof. Dr. Nuran Bese

Abstrakt

Në fazën e hershme të kancerit të gjirit, radioterapia është një pjesë integrale e trajtimit për ruajtjen e gjirit. Trajtimi standard përfshin rrezatim të të gjithë gjirit për disa javë, i ndjekur nga një nxitje në shtratin e tumorit te gratë e moshës 50 vjeç ose më të reja ose ato me kufij të ngushtë kirurgjik. Mastektomia është një trajtim i përshtatshëm për shumë pacientë. Rrezatimi pas mastektomisë me teknikat e duhura ul ndjeshëm përsëritjet lokale dhe përmirëson mbijetesën në pacientët me nyjet limfatike axillare pozitive. Shumë pacientë paraqiten me kancer të gjirit lokalisht të avancuar ose të paoperueshëm. Trajtimi fillestar i tyre është me terapi sistemike; pas përgjigjes ndaj terapisë sistemike, shumica do të kërkojnë një mastektomi radikale të modifikuar të ndjekur nga radioterapi. Për ata pacientë në të cilët mastektomia nuk është ende e mundur pas terapisë fillestare sistemike, jepet rrezatim i gjirit dhe rajonal, i ndjekur kur është e mundur nga mastektomia. Për pacientët me metastaza të

largëta, rrezatimi mund të sigurojë lehtësim të simptomave të tilla si dhimbje, gjakderdhje, ulçera dhe limfedema. Një pjesë e vetme e rrezatimit mund të lehtësojë në mënyrë efektive dhimbjen nga metastazat e kockave. Radioterapia është gjithashtu efektive në zbutjen e simptomave dytësore të metastazave në tru, mushkëri dhe zona të tjera. Radioterapia është e rëndësishme në trajtimin e grave me kancer gjiri të të gjitha fazave. Në vendet në zhvillim, ajo është e nevojshme për pothuajse të gjitha gratë me këtë sëmundje dhe për këtë arsye duhet të jetë e disponueshme.

Fjalë kyç: kanceri i gjirit, trajtim sistemik parësor.

INVESTIMENTS IN KNOWLEDGE AND ITS INFLUENCES ON GDP

Roberto Raimondi

Abstract

The concept of economy has undergone substantial changes since knowledge became central to the productive fabric, thus giving rise to an irreversible process of innovation through the development of new ideas and solutions which only highly specialized personnel are able to produce. Industry and factories, machines and the human workforce, as well as material capital in general are no longer the driving force of economic growth or a useful positive indicator of an economy; rather, it is now the intangible assets of knowledge that are not only the driving force of productivity, but also allow for the differentiation between companies, between geographical areas and between states to be identified and explained.

This is so true that today we no longer speak of the economy in a traditional sense but rather of knowledge-based economy, an expression that highlights the transformation of industrial capitalism which was built on the concept of machine capital/manual labour into cognitive capitalism based on the concept of knowledge/mental labour capital in which, therefore, the primary productive resource is represented by cognitive skills. The productive capacity of knowledge lies in its intrinsic adaptability and its ability to multiply the use of value obtained from the initial knowledge.

Today, the crucial sector of the economy is the so-called advanced tertiary sector which consists of finance, research, IT services, business consulting services, media and entertainment in general. These activities have taken the place of agriculture, industry, trade and transport and this transformation of production processes characterized by a competitiveness based on time has brought with it a radical transformation in skills and competences making it necessary to have highly qualified and skilled personnel in all production segments.

Key words: investiments, influence, GDP.

INVESTIMET NË NJOHURI DHE NDIKIMET E SAJ NË GDP

Roberto Raimondi

Abstrakt

Koncepti i ekonomisë ka pësuar ndryshime thelbësore që kur dija u bë qendrore në strukturën prodhuese, duke krijuar kështu një proces të pakthyeshëm inovacioni nëpërmjet zhvillimit të ideve dhe zgjidhjeve të reja që vetëm personeli shumë i specializuar është në gjendje të prodhojë. Industria dhe fabrikat, makineritë dhe fuqia punëtore, si dhe kapitali material në përgjithësi nuk janë më forca shtytëse e rritjes ekonomike ose një tregues pozitiv i dobishëm i një ekonomie; përkundrazi, tani janë asetet e paprekshme të njohurive që janë jo vetëm forca lëvizëse e produktivitetit, por gjithashtu lejojnë që të identifikohet dhe shpjegohet diferencimi midis kompanive, midis zonave gjeografike dhe midis shteteve.
Kjo është aq e vërtetë sa që sot nuk flasim më për ekonominë në kuptimin tradicional, por për ekonominë e bazuar në njohuri, një shprehje që nxjerr në pah transformimin e kapitalizmit industrial i cili u ndërtua mbi konceptin e kapitalit makiner/punës manuale në kapitalizmin kognitiv. mbi konceptin e njohurive/kapitalit të punës mendore në të cilin, pra, burimi kryesor prodhues përfaqësohet nga aftësitë njohëse. Kapaciteti prodhues i njohurive qëndron në përshtatshmërinë e saj të brendshme dhe aftësinë e saj për të shumëfishuar përdorimin e vlerës së marrë nga njohuritë fillestare. (Grazzini 2011)
Sot, sektori vendimtar i ekonomisë është i ashtuquajturi sektor i avancuar terciar i cili përbëhet nga financa, kërkimi, shërbimet e TI-së, shërbimet e këshillimit të biznesit, media dhe argëtimi në përgjithësi. Këto aktivitete kanë zënë vendin e bujqësisë, industrisë, tregtisë dhe transportit dhe ky transformim i proceseve të prodhimit të karakterizuar nga një konkurrencë e bazuar në kohë, ka sjellë me vete një transformim rrënjësor të aftësive dhe kompetencave duke bërë të nevojshme të ketë personel të kualifikuar dhe të kualifikuar në të gjitha segmentet e prodhimit.

Fjalët kyç: investime, ndikim, GDP.

GIANT RETROPERITONEAL SARCOMAS: A SURGERY CHALLENGE BETWEEN GUIDELINES AND IMPROVISATION

Valeria Tonini

Abstract

Retroperitoneal sarcomas (RPS) are usually associated with a high rate of recurrences. In the absence of effective systemic therapies, surgery represents the mainstay of curative-intent treatment for RPS and complex multivisceral resections are frequently required. Many studies demonstrated that the prognosis of patients is better when surgeons perform an aggressive surgical approach with en bloc resection of the tumour and contiguous organs. Contiguous organs have to be resected en-bloc with the RPS, even if they are not clearly infiltrated by the tumour. This is the only way to achieve an oncological radicality able to counteract the high risk of local recurrences. Because the best chance of cure is at the time of primary surgery, this rare malignancy has to be managed by an experienced surgical team in a specialized referral center. However, according to the latest international guidelines, the aggressiveness of the operation must be graded on the basis of histological type and tumour grading, assessed on CT-guided biopsy. Given the high number of histological types and the

frequent coexistence of portions with different grading within the same tumour, it is easy to understand how difficult it is to make a correct pre-operative diagnosis, which is often different from the final histological examination of the surgical specimen. Hence the urgent need to identify systems that allow a correct pre-operative diagnosis to enable the surgeon to correctly plan the surgical strategy.

The author reviews the latest studies in the literature on RPS and comments on the most recent guidelines related to this pathology. And finally, she presents the results of her own surgical case series related to giant RPS.

SARKOMAT GJIGANTE RETROPERITONEALE: NJE SFIDE KIRURGJIKALE MIDIS UDHEZIMEVE DHE IMPROVIZIMIT.

Valeria Tonini

Abstrakt

Sarkomat retroperitoneale (RPS) zakonisht shoqërohen me një shkallë të lartë të përsëritjes. Në mungesë të terapive sistemike efektive, kirurgjia përfaqëson bazën e trajtimit me qëllim kurativ për RPS dhe shpesh kërkohen rezeksione komplekse multiviscerale. Shumë studime treguan se prognoza e pacientëve është më e mirë kur kirurgët kryejnë një qasje kirurgjikale agresive me rezeksion en-block të tumorit dhe organeve ngjitur. Organet ngjitur duhet të resektohen en-block me RPS, edhe nëse ato nuk janë infiltruar qartë nga tumori. Kjo është mënyra e vetme për të arritur një radikalitet onkologjik të aftë për të luftuar rrezikun e lartë të përsëritjeve lokale. Për shkak se shansi më i mirë i shërimit është në kohën e operacionit parësor, kjo sëmundje e rrallë malinje duhet të menaxhohet nga një ekip kirurgjik me përvojë në një qendër të specializuar referimi. Megjithatë, sipas udhëzimeve të fundit ndërkombëtare, agresiviteti i operacionit duhet të vlerësohet në bazë të llojit histologjik dhe klasifikimit të tumorit, të vlerësuar në biopsinë e drejtuar me CT. Duke pasur parasysh numrin e lartë të llojeve histologjike dhe bashkëjetesën e shpeshtë të porcioneve me gradime të ndryshme brenda të njëjtit tumor, është e lehtë të kuptohet se sa e vështirë është të bëhet një diagnozë e saktë para operacionit, e cila shpesh është e ndryshme nga ekzaminimi përfundimtar histologjik i mostrës kirurgjikale. Prandaj lind nevoja urgjente për të identifikuar sistemet që lejojnë një diagnozë të saktë para operacionit për t'i mundësuar kirurgut të planifikojë saktë strategjinë kirurgjikale.

Autori shqyrton studimet më të fundit në literaturën mbi RPS dhe komenton udhëzimet më të fundit në lidhje me këtë patologji. Dhe së fundi, ajo paraqet rezultatet e serisë së saj të rasteve kirurgjikale që lidhen me RPS gjigante.

Fjalë kyç: sarkoma, RPS, kirurgji.

ADVANCES IN THE SYSTEMIC TREATMENT OF BREAST CANCER: NAVIGATING MANAGEMENT THROUGH A MAZE OF OPTIONS

Prof. Dr. Yesim Eralp

Abstract

Over the past few decades, the systemic therapy of breast cancer (early and advanced) has changed considerably. For the past 40–50 years, and since the discovery and further therapeutic use of tamoxifen, a selective estrogen receptor modulator, breast cancer treatment has become the model for the development and success of tailored medical treatment. Much still needs to be done in improving outcomes for all patients with breast cancer, and especially for those who have advanced breast cancer, a challenging area for medical oncologists. Ongoing international clinical trials are currently evaluating new therapeutic approaches and identifying specific biological subsets that could determine a patient's ability to respond to particular chemotherapeutic drugs.

PËRPARIMET NË TRAJTIMIN SISTEMATIK TË KANCERIT TË GJIRIT: DREJTIMI I MENAXHIMIT PËRMES NJË LABIRINTI OPSIONESH

Prof. Dr. Yesim Eralp

Abstrakt

Gjatë dekadave të fundit, terapia sistematike e kancerit të gjirit (e hershme dhe e avancuar) ka ndryshuar ndjeshëm. Për 40-50 vitet e fundit, dhe që nga zbulimi dhe përdorimi i mëtejshëm terapeutik i tamoxifenit, një modulator selektiv i receptorit të estrogjenit, trajtimi i kancerit të gjirit është bërë modeli për zhvillimin dhe suksesin e trajtimit mjekësor të përshtatur. Duhet bërë ende shumë për të përmirësuar rezultatet për të gjithë pacientët me kancer gjiri, dhe veçanërisht për ata që kanë kancer të gjirit të avancuar, një fushë sfiduese për onkologët mjekësorë. Provat klinike ndërkombëtare në vazhdim po vlerësojnë qasje të reja terapeutike dhe po identifikojnë nëngrupe specifike biologjike që mund të përcaktojnë aftësinë e pacientit për t'iu përgjigjur barnave të veçanta kimioterapeutike.

Fjalë kyç: terapia e kancerit të gjirit, tamoxifeni.

KUJDESI INFERMIEROR NË PACIENTËT ME SËMUNDJE MALINJE TË GJAKUT.

Dr.Adela Perolla, Migerta Lahi.
Qendra Spitalore Universitare"Nënë Tereza", Tiranë
Studente master shkencorë infermieri, FSHMT

Abstrakti

Sëmundjet malinje janë shkaku I dytë madhor I vdekjeve në Shqipëri, dhe shihet që ka një rritje të vitet e fundit..Shumë prej tyre kapen ose zbulohen në faza të vona ku mundësia për ndërhyrje dhe kujdes nuk I favorizon shumë profesionistët e shëndetësisë, e në veçanti Infermierët të cilët kanë një rol shumë të rëndësishëm jo vetëm në trajtim, por edhe në parandalim parësor dhe edukim , parë këto si dy hallkat krysore më të rëndësishme për zbulimin e hershëm të sëmundjeve malinje, si dhe rëndësia e Higjenës dhe korrektesa e orareve të terapive tek këta pacientë.
Qëllimi:Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë rolin e infermierëve në një patologji të vështirë dhe të rëndë psikologjikisht për pacientin si Sëmundjet Malinje të gjakut.
Materiale dhe metoda: Ky punim u ngrit duke ndjekur metodën kërkim-arkivor , duke studiuar protokollet e ndjekjeve të këtyre pacientëve në Francë,Britaninë e Madhe dhe në Itali dhe të dhëna të gjeneruara nga kartelat e pacientëve të pavionit të hematologjisë pranë QSUNT.

Fjalë kyç: sëmundje malinje të gjakut, trajtim, kujdes infermieror, parandalim, edukim.

RUXOLITINIB DHE COVID – 19

Adela Perolla, Elsuarta Calliku, Tatjana Caja

Abstrakt

Pandemia nga SARS-COV2 vazhdon ende që prej dhjetorit 2019 duke mbartur në historikun e zhvillimit të saj shumë raste të infektuar, të mbijetuar e mjaft raste të humbura. Si cdo sëmundje tjetër infektive ajo nuk kurseu dhe nuk kursen të sëmuret me sëmundje malinje hematologjike që bëjnë pjesë në grupin e personave me risk shumë të lartë për të zhvilluar forma severe dhe me risk shumë të lartë për të humbur jetën nga COVID - 19.

Qëllimi: Arsyeja e këtij referimi ka të bëjë pikërisht me prezantimin e Ruxolitinibit, një preparatë që përdoret për të trajtuar pacientët me Mielofibrozë – sëmundje malinje që bën pjesë në grupin e Sindromave Mieloproliferative BCR/ABL negative (policitemia Vera , TRombocitemia Esenciale).

Metodika: Është kërkuar mbi rolin e Ruxolitinibit në COVID-19 në PUBMED dhe HINARI dhe janë nxjerrë në këtë referim konkluzione të marra nga studimi i literaturës dhe nga metaanaliza e publikuar on line në periudhën e pandemisë. Por studimet janë në zhvillim e sipër.

Rezultatet: Pacientët e diagnostikuar me Neoplazi Mieloproliferative (Mielofibroze Primare, Policitemia Vera, Trombocitemi Esenciale) është parë se kanë risk të lartë për të zhvilluar evente trombotike, dhe kjo korelon direkt me mutacionet e *JAK2* V617F dhe me frekuencën e varianteve alelike (sidomos ne Policitemine Vera).
Mutacionet e JAK2 V617F prezantojnë një fenotip pro-trombotik si pasojë e ndryshimeve në ekspresionin e P-selektinës dhe të β1/β2 integrinave endoteliale duke rritur në këtë mënyrë adezionin e leukociteve në endotelin vazal dhe në këtë mënyrë rrisin riskun e trombozës së lidhur me Neoplazitë Mieloproliferative.
Gjetjet kliniko-laboratorike ne Covid19 (D-dimer i lartë, trombocitopeni e lehtë, Koha e protrombines jo sinjifikative, fibrinogeni i rritur, tromboza venoze, tromboza arterial,

eventet kardiovaskulare në mosha te reja, bllokim nga trombet i kateterëve dhe rrugëve centrale dhe mikrotrombozat periferike) të shkaktuara nga:
a. Tromboinflamacioni:
b. Endotelopatia
U rekrutuan 180 pacientë nga 38 qendra hematologjike europiane. Sponsor i këtij studimi ishte Foundation for Research (FROM) në spitalin Papa Giovanni XXIII në Bergamo, Italy, (aprovimi nga Italian National Ethical Committee (Spallanzani Hospital, in Rome); Qendrat e tjera e morën aprovimin nga komitetet përkatëse respektive vendase.

Konkluzioni: Stuhia e citokinave e cila është një ndër shkaqet e mortalitetit nga COVID – 19, favorizohet dhe pason ndërprerjen e menjëhershme të ruxolitinibit sjell atë që quhet **"**ruxolitinib discontinuation syndrome", i cili nga ana tjetër mund të sjellë komplikimin fatal të vdekjes nga insuficienca multiorganore. Prandaj rekomandohet që këta pacientë që marrin Ruxolitinib të mos e ndërpresin mjekimin nëse infektohen nga SARS- COV 2**.**

Fjalë kyç: ruxolitinib, covid.

QASJA NDAJ HEPATITIT B: VLERËSIMI YNË I STATUSIT TË IMUNIZIMIT DHE NEVOJA PËR RIVAKSINIM

Dr. Adilta Bejko, Dr. Elira Tashi, Dr. Ervin Bejko, Dr. Estefania Tulo

Abstrakt

Sfondi dhe qëllimi: Ne synuam të përcaktonim nivelin e imunizimit të pacientëve nga qershori 2017 deri në qershor 2019, duke matur antitrupat e tyre anti Hbs tek 1448 pacientë (të cilët janë testuar herë pas here dhe kishin marrë doza vaksinimi), për të kuptuar nevojën për rivaksinim dhe nëse ai duhet të shtrihet në grupmoshat e tjera ose nëse duhet shtuar si një test i dobishëm pas dozave të vaksinimit.

Metodat: I ndamë pacientët në dy grupmosha. Grupi A: 346 pacientë të moshës 0-25 vjeç, grupi B: 1102 pacientë të moshës >25 vjeç. Pacientët u testuan për antitrupat e tyre anti Hbs, duke përdorur metodën_ECLIA dhe instrumentin COBAS e411 dhe COBAS e601 (ROCHE ANALYZER).

Rezultatet: Ne gjetëm 161 rezultate pozitive të testit, 147 rezultate negative të testit dhe 38 rezultate të zonës gri në grupin A; 412 rezultate pozitive të testit, 620 rezultate negative të testit, 70 rezultate të zonës gri në B. Duke shtuar rezultatet e zonës gri në rezultatin negativ të testit, zbuluam se 185 pacientë në grupin A dhe 690 pacientë në grupin B kishin nevojë për rivaksinim. Sipas studimit tonë dhe duke iu referuar pacientëve të rastësishëm, interesi ynë është të dimë se si këto rezultate mund të interpretohen dhe krahasohen me të gjithë popullsinë që ka marrë vaksinën.

Konkluzione: Sipas studimit tonë ka një përqindje të lartë të imunizimit negativ në pacientët që kanë marrë dozat e vaksinimit siç duhet. Ne besojmë se testimi për nivelin e imunizimit është një mjet i besueshëm që mund të përdoret për të përcaktuar kontigjentin që nuk ka zhvilluar imunitet dhe ka nevojë për rivaksinim.

Fjalët kyç: hepatiti B, vaksinim, imunizim.

4 SHËNJUES TË RINJ BIOLOGJIKË. INTELIGJENCA (IQ). VEÇORITË (ID) E TYRE. EPËRSI. KUFIZIME.

Sibora Hasanaj, Xhesika Agaj, Erida Xhafi, Elisa Daci, Prof.Asoc.Dr. Admir Nake

Abstrakt

Hyrje: Enzimat e sekrecionit apo të metabolizmit, mbeten tregues laboratorikëtë rëndësishëm orientues-diagnostikë, monitorues prognostikë dhe të vlerësimit të rriskut për mortalitet, në sëmundje inflamatore akute apo kronike, citolitike, beninje dhe malinje, në situata të urgjencës, mjekësi spitalore dhe ambulatore, pse jo me statusin biomarkers, edhe si reagentë, ose pjesë e strategjive terapeutike(fenilaalaninë hidroksiliaza), apo përplotësues të GAP-it hulumtues mjekësor.

Qëllimi i studimit: Nevoja për përmirësimin e protokolleve, futjen e enzimave të reja. 4 shembuj tipikë. IQ dhe ID e këtyre ekzaminimeve.

Metariali dhe Metoda: Literatura e 20 viteve të fundit.

Rezultate dhe Përfundime: Liziloksidaza (Lox), Adenozindeaminaza (ADA), Peptidilargininëdeiminazat (PAD), Enzima e konversionit tëangiotenzinës (ACE), janë shembull spektakolar i nevojës së përmirësimit të vazhdueshëm dhe rolit të enzimave në algoritmat mjekësore

Fjalë kyç: IQ e ekzaminimit, adenozinëdeaminaza, peptidilargininë deiminazat, biomarkers.

VDEKJA NGA MENINGJITI STREPTOKOKSIK DHE MENINGOKOKSIK

Admir Sinamati[1], Geri Mehmeti[1], Fatos Sinani[1], Arben Lloja[2]
[1]*Instituti i Mjekësisë Ligjore Tiranë*
[2]*Departamenti i Anatomisë Patologjike dhe Mjekësisë Ligjore FM, UMT*

Abstrakt

Në këtë punim do të raportojmë një rast fatal të meningjitit streptokoksik dhe meningokoksik në një fëmijë 3-vjeçar, që vetëm tre ditë para vdekjes ishte plotësisht i shëndetshëm.
Fillimisht u dërgua nga prindërit në spitalin e qytetit "B" pasi kishte temperaturë të lartë.
Duke qenë në sezon gripi, nga mjeku i urgjencës u trajtua si një rast rutine dhe pas këshillimit të rastit u dërgua në banesë. Disa orë me vonë e ema e fëmijës pa disa njolla të kuqe në lëkurën e anësive dhe u rikthye menjëherë në spital. Mjekët e Spitalit "B" e nisin për në Spitalin Universitar, por pavarësisht trajtimit intensiv fëmija bëri eksitus brenda 48 oresh. Nga mjekët kliniciste menjëherë pas hospitalizimit i ishin marrë, mostrat e lëngut cerebrospinal, të gjakut komplet, tamponit së hundës dhe faringut për ekzaminiime mikrobiologjike, të cilat dhanë informacionin për shkaktarët e infeksionit. Një bashkëinfeksion i njëkohshëm i të dy patogjenëve është raportuar rrallë në literaturën mjekësore.
Pamundësia e përcaktimit të një diagnoze klinike të saktë, nga ana e familjarëve u denoncua si rast për hetim mjekoligjor që lind nga përgjegjësia e mundshme profesionale për mjekun e shërbimit të urgjencës, i cili nuk kishte arritur të diagnostikonte në kohë fëmijën. Për këtë

arsye kufoma e fëmijës iu nënshtrua autopsisë mjekoligjore brenda 24 orëve pas vdekjes. Pas ekzaminimit të jashtëm dhe të brendshëm. Nga ekzaminimimi i mostrave mikrobiologjike marrë për së gjalli dhe mostrave histologjike marre pas vdekjes u konkludua se shkaku i vdekjes ishte gjendja toksikopiemike multiorganore në terren të meningitit streptokoksik dhe meningitit meningokoksik.
Të gjitha mostrat e testuara për së gjalli duhet të testoheshin edhe postmortum, por për shkak të mungesës së një laboratori të gjenetikës forence për të provuar rezultatin pozitive të ADN-së së Neisseria meningitidis dhe ADN-së Streptococcus pneumoniae; ekzaminimet mikrobiologjike dhe shenjat klinike antemortum u morën të mirqëna për të përcaktuar diagnozen mjekoligjore.

Fjalë kyçe: meningjit, Streptococcus pneumoniae, Neisseria meningitidis, Sindroma Waterhouse Friderichsen.

METASTAZAT PULMONARE NË KUSHTET E PANDEMISË COVID-19.

Adrian Hoti

Abstrakt

Sfida të ndryshme në lidhje me diagnostikimin dhe ndjekjen e metastazave pulmonare u shfaqën gjatë pandemisë 2-vjeçare të Covid-19.
Arsyet pas kësaj janë (a) karakteristikat e ngjashme radiologjike që hasen në disa lloje metastazash, p.sh. metastazat mucinoze dhe pneumonia simptomatike dhe asimptomatike në fazën e hershme të Covid-19, (b) përfshirja e enëve të vogla të gjakut dhe sistemit limfatik, si dhe (c) një shpërndarje e paracaktuar subpleurale në të dyja sëmundjet dhe (d) shtrembërim intersticial në fibrotik faza. Mungesa e tomografisë së emetimit të pozitronit kufizon aftësinë tonë për të dalluar nyjet fibrotike dhe sëmundjet metastatike. Për më tepër, shënuesit e tumorit nuk janë të dobishëm në të gjitha llojet e kancerit dhe për më tepër, zbulimi i metastazave pulmonare nuk mund të pasohet gjithmonë nga një rritje e konsiderueshme e shënuesve të tumorit. Studimi ynë përfshin 100 pacientë të diagnostikuar me metastaza pulmonare nga tumore të ndryshme parësore gjatë vitit të kaluar, disa prej të cilëve shfaqin komplikime si pasojë e mbivendosjes së pneumonisë Covid-19. Për këtë studim u vlerësuan skanimet CT dhe shënuesit përkatës të tumorit.

Fjalë kyç: metastazë, pulmon, Covid-19.

ATLS® COURSE ALBANIA, NJË MUNDËSI E SHKËLQYER PËR EDUKIMIN E PROFESIONISTËVE SHËNDETËSORË NË MENAXHIMIN E TRAUMËS...

Prof. Asc. Dr. Agron Dogjani MD, PhD, FACS, FISS, FICS [1], Prof. Dr. Kastriot Haxhirexha MD, PhD [2]

[1.] Profesor i Kirurgjisë, Departamenti i Kirurgjisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, SHQIPËRI.

[2.] Profesor i Kirurgjisë, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Kirurg i Përgjithshëm në Spitalin Klinik të Tetovës, RN e MAQEDONISË.

Abstrakt

Prej më shumë se 30 vitesh, pas ndryshimeve që ndodhën në Shqipëri në vitin 1992, marrim informacione nga pacientët e traumës në media për ofrimin e shërbimeve të traumës. Të dhënat e policisë janë të denja për një raport të bilanci lufte. Trauma, vlerësohet të jetë shkaku i vdekjeve në 13.7% / 100,000 njerëz. Çdo dy ditë vdesin tre qytetarë shqiptarë nga aksidentet automobilistike…
Ndryshime tashmë kanë ndodhur, por lind pyetja, kush kujdeset për traumën dhe menaxhimin e saj?
Ofrimi i shërbimit të traumës tani po evoluon përgjatë linjave të një modeli qendror dhe të folur me një përqendrim ekspertize dhe specializimi në qendër të rrethuar nga njësi më të vogla që drejtohen nga qendra. Studimet tregoi një rritje prej 19% në shanset e mbijetesës që nga implementimi i teknikave menazhuese ne baze te ketyre trajnimeve. Eshte e verifikuar qe 1600 viktima të tjera të mundshme traumës (sot jetojne) për shkak të zhvillimeve në administrimin e pacientëve me traumë në Angli gjatë gjashtë viteve të fundit.
Në këtë sistem apo mënyrë organizimi që është sot QKUM apo organizimi i transportit të të traumatizuarve nga vendi i ngjarjes në Spitalin Universitar të Traumës... nga personeli mjekësor. Si është edukativ statusi i personit në kryeqytet dhe rajone të tjera me te largeta?
Kurset e studentëve ATLS® në vendin tonë janë zbatuar fare pak dhe individualisht… ASTES, sipas rregullave të paracaktuar, ka fituar të drejtën e organizimit të ATLS® në Shqipëri, dhe tani jemi shumë afër organizimit të kursit inaugurues ATLS® në Shqipëri (09-13 Maj 2022), me pjesëmarrje dhe mbështetje morale, por nga ana dhe financiare jemi shumë larg. ATLS®Course… ok, por tani si ATLS® Albania Course ...

Fjalë kyçe: Trauma, Menaxhimi, ATLS®, Shqipëri, ASTES.

DIAGNOZA DHE TRAJTIMI I TROMBIT NË VENTRIKULIN E MAJTË PAS INFARKTIT TË MIOKARDIT

Albana Doko Banushi[1,2], Endri Hasimi [2], Vilma Paparisto[2]
Universiteti i Mjekësisë Tiranë[1], Departamenti Kardiologji, QSUT [2]

Abstakt

Pavarësisht se mortaliteti nga infakti akut i miokardit (IAM) është ulur si rezultat i trajtimit të tij me PCI primare, ende komplikacionet post infarkti janë shkak i mortalitetit dhe morbiditetit në një numër të konsiderueshëm pacientësh. Një nga komplikacionet më invalidizuese janë ngjarjet tromboembolike, si pasojë e fomimit të trombit në VM pas infarktit të miokardit (IM).
Risku i formimit të trombit në ventrikulin e majtë (VM) është i lartë gjatë tre muajve të parë që ndjekin IAM. Akinezi dhe diskinezia regjionale e VM që rezultojnë në stazën e gjakut, iskemia që çon në dëmtimin subendokardial me ndryshime inflamatore, si dhe gjendja e hiperkoagulimit janë faktorët kryesore të formimit të trombit në VM. Të dhënat para erës së trajtimit me trombolitikë, kanë sugjeruar që trombi në VM në kuadrin e IAM ishte i pranishëm në 7-46% te pacientëve. Në ditët e sotme incidenca është më e ulët për shkak të terapisë më agresive antikoagulante dhe revaskularizimit të hershëm, që rezulton në zona më të vogla infarkti dhe remodelim më të mire të VM pas IM. Të dhëna epidemiologjike sugjerojnë që incidenca e trombit në VM e vlerësuar nga modalitetet optimale imazherike është rreth 15% në pacientët me STEMI dhe deri 25% në pacientët me IM anterior. Koha e vlerësimit të trombit në VM është vendimtare, pasi vlerësimi shumë i hershëm pas IM do të humbë formimin e trombit.

Ekokardiografia standarde transtorakale (TTE) është modaliteti i zgjedhur për zbulimin e trombit në VM dhe duhet të kryhet brenda 24 orëve nga shtrimi në pacientët me rrezik të lartë për tromb apikal (ata me IM anterior të gjerë ose që perfuzionohen vonë). Modalitete të tjera në rastet kur TTE është jokonkluduese janë TTE me kontast ose MRI kardiake bazuar në burimet e spitalit. Rekomadimet e ESC 2017 (STEMI guidelines) janë për fillimin e terapisë me antikoagulantë oralë menjëherë sapo diagnostikohet trombi në VM deri në 6 muaj, nën kontrolle të përsëritura ekokardiografike, dhe duke vleresuar riskun hemoragjik për shkak të nevojes së terapisë së dyfishtë antiagregante shoqëruese në pacientë të cilët janë trajtuar me PCI në STEMI. Për shkak të mungesës së të dhënave të studimeve të randomizuara klinike, si dhe variabilitetit të madh të shfaqjes dhe komplikacioneve të trombit në VM pas IAM, rekomandohen qasje të individualizuara të çdo rasti.

Fjalë kyç: tromb , infarkt miokardi, ekokardiografia.

ACIDI URIK DHE VESHKA

Albana Gjyzari, Olta Qyrku, Ilirjan Gjyzari
Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti i Mjekësise Tiranë
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë
Qendra Shendetësore Nr 7, Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Acidi urik në serum (AUS) është produkti përfundimtar i zbërthimit të purinës nga ksantinë oksidoreduktaza dhe ekskretohet kryesisht nga veshkat. Nivelet e AUS rriten në pacientët me sëmundje renale kronike (SRK) për shkak të humbjes progresive të funksionit të veshkave. Disa studime në popullatën e përgjithshme, kanë treguar se një nivel i rritur i AUS është një faktor risku për semundje kardiovaskulare (SKV) dhe mortalitetin. Në pacientët me dializë peritoneale (DP), studimet kanë treguar lidhje pozitive, negative ose në formë U-je midis AUS dhe mortalitetit.

Metoda: Ky studim kohort prospektiv perfshiu 81 pacientë që trajtohen me hemodializë (HD) kronike në qendrën spitalore universitare Nënë Tereza, gjatë periudhës Mars- Prill 2016. Të dhënat u morën nga kartelat klinike. Këta pacient u ndoqën për një periudhë 4 vjecare. Qëllimi ishte të vlerësohej vdekshmëria nga të gjitha shkaqet dhe lidhja e saj me AUS.

Rezultatet: U përfshinë gjithsej 81 (67% meshkuj) pacientë me HD. Mosha mesatare ishte 53±12 vjeç (22-77); Koha mesatare e dializës 6,2±3,9 vjet; Indeksi mesatar i masës trupore (BMI) 24,5±3,9 kg/m2; Pesha interdialitike mesatare 3,03±0,8 kg; Niveli mesatar i albuminës në serum 3,9±0,3 g/dl; Niveli mesatar i fosforit në serum 5.4±1.4 mg/dl; Niveli mesatar i AUS 8.5 ± 1.9 mg/dL. Gjate periudhës 4 vjecare të ndjekjes mortaliteti ishte 29 (35.8%). Nëpërmjet regresionit logjistik binar u gjet një lidhje statistikisht sinjifikante midis hiperuricemis (≥10.1 mg/dL) dhe mortalitetit: HR, 1.3; 95% CI: 1.01–2.09: p=0.001).

Konkluzione: Një bashkëpunim më i ngushtë midis pacientit dhe stafit mjekësore nevoitet për mbajtjen e vlerave të acidit urik në normë. Ky bashkëpunim duhet të përfshijë jo vetëm trajtimin dialitik por edhe edukimin e pacientit në lidhje me dietën dhe mjekimin konservativ.

Fjalë kyç *:Acidi urik, sëmundje renale kronike, mortalitet*

TIROIDITI HASHIMOTO SI NJË PATOLOGJI AUTOIMUNE QË RRIT RISKUN PËR KARCINOMË TË TIROIDES DHE NJË VËSHTRIM EPIDEMIOLOGJIK NË VENDIN TONË.

Dr. Albina Ndoja
Mjeke Specializante, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Mjeksisë, Departamenti i Anatomisë Patologjike dhe Mjeksisë Ligjore.

Abstrakt

Prezantimi: Tiroiditi Hashimoto është sëmundja autoimune më e shpeshtë e tiroides. Kjo gjendje është përshkruar për here të parë në vitin 1912 nga Hakaru Hashimoto, një kirurg dhe anatomopatolog Japonez. Kjo patologji karakterizohet nga nje infiltrim difuz limfocitar, fibrozë dhe atrofi e parenkimës. Gjithashtu shoqërohet me disfunksion të tiroides dhe në disa raste me zhvillimin e strumës.

Metoda: Rezultatet janë marrë nga biopsitë e tiroides të realizuara nga viti 2017-2022 në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza dhe Spitalin Amerikan.

Diskutimi: HT është nje diagnozë histologjike me kritere strikte. Është shkaku më i zakonshëm i hipotiroidizmit në vendet e zhvilluara. Më shpesh preken femrat. Raporti femërmeshkuj është 10:1. Kjo sëmundje njihet edhe si tiroiditi kronik autoimun dhe tiroiditi limfocitar kronik. Diagnoza është shpesh sfiduese dhe mund të marrë kohë deri në avancimin e sëmundjes. Gjetjet më të zakonshme laboratorike tregojnë një rritje të hormonit stimulues të tiroides (TSH) dhe nivele të ulëta të tiroksinës së lirë (fT4), shoqëruar me rritje të antitrupave antitiroide peroksidazë (TPO). Dailey et al. ishin të parët që propozuan një lidhje midis HT dhe PTC në 1955, duke lidhur inflamacionin kronik me ndryshimet neoplazike. Megjithatë faktit nëse ekziston një lidhje ndërmjet HT dhe karcinomës së tiroides është një debat i vazhdueshëm. Disa studime kanë gjetur një risk të rritur të karcinomës papilare të tiroides në pacientët me HT, ndërkohë disa studime të tjera nuk shikojnë një risk të shtuar. Në një studim të botuar në Oncotarget, 2017, Vol. 8, (No. 37), pp: 62414-62424 të quajtur: A meta-analysis of Hashimoto's thyroiditis and papillary thyroid carcinoma risk u konstatua se ekziston një korrelacion ndërmjet Tiroiditit Hashimoto dhe Karcinomës së Tiroides. Në këtë sdudim u përfshinë 18 studime të tiroidektomive, 6 studime të aspirimit me gjilpërë të imët (FNA) dhe 3 FNA selektive ose studimet e tiroidektomisë.Të tre llojet e studimeve mbështetën korrelacionin ndërmjet HT dhe PTC.

Përfundime: Tiroiditi Hashimoto është një patologji autoimune e shpeshtë e tiroides e cila rrit riskun për zhvillimin e karcinomës së tiroides.

Fjalë kyç: tiroiditi hashimoto, biopsi, autoimune.

QASJE NDAJ ALERGJISË MOLEKULARE, DIAGNOSTIKA E ALERGJIVE TË FËMIJËRISË

Albjola Maloku, Adilta Bejko

Abstrakt

Sfondi dhe qëllimi: Ne synuam të përcaktonim nivelin e sensibilizimit ndaj antigjeneve të kikirikut, vezëve dhe qumështit të pacientëve të rastësishëm nga qershori 2017 deri në shkurt 2020, duke matur antigjenet e tyre molekulare në shirita të veshur me 52 pacientë (të cilët u testuan herë pas here), për të kuptuar nevoja dhe ndihma e diagnozës molekulare, veçanërisht për t'iu përgjigjur pyetjeve klinike të mëposhtme: (1) sensibilizimi kundrejt alergjisë klinike ndaj vezës, (2) alergjia ndaj vezëve të papërpunuara ose pjesërisht të ziera, (3) alergjia ndaj të gjitha formave të vezëve (të papërpunuara dhe i gatuar). (4) Shumica e subjekteve alergjikë ndaj qumështit të lopës janë të polisensibilizuar ndaj disa proteinave të kazeinës dhe hirrës. (5) Alergjenët e kikirikut mund të shkaktojnë reaksione të rënda alergjike ushqimore Ndjeshmëri të IgE ndaj proteinave të qëndrueshme të ruajtjes së farës (Ara h 2, më pak në Ara 1, 3 dhe 6) ,që zhvillohen kryesisht në foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme, shoqërohen me alergji të reaksioneve të rënda alergjike.

Metodat: Pacientët u testuan për sIgE të tyre molekulare, duke përdorur përpunimin plotësisht të automatizuar të imunoblloteve nga EuroblotOne nga identifikimi i mostrës deri në rezultatin përfundimtar.

Rezultatet: Ne gjetëm 16 rezultate pozitive të testit, 7 teste pozitive vetëm për proteinat e vezëve (n Gal d1, n Gal d2, n Gal d3, n Gal d4) 3 rezultate pozitive për proteinat e vezës dhe qumështit (n Bos d8, n Gal d2, n Gal d3) dhe (n Bos d4/d5/d6/d8 plus n Gal d2/d3/d4),3 test pozitiv vetëm për qumështin (n Bos d4/d8,n Bos d4) 1 pacient pozitiv ndaj qumështit dhe kikirikut (n Bos d6 plus r Ara h1/h2/h3),1 rezultate pozitive vetëm për kikirikët(r Ara h2) dhe 2 pacientë për polenin e thuprës (r Bet v1).

Përfundim: Profili i pediatrisë Dpa Dx është një test shumë i dobishëm sepse jep:
1- Profili i detajuar sensibilizimi për çdo pacient.
2- Vlerësimi i rrezikut të reaksioneve të rënda.
3- Vlerësimi i mundësisë së induksionit të tolerancës.
4- Dëshmi për kufizimin e kërkuar dietik.
5- Diferencimi i polenit të lidhur nga alergjitë e vërteta të kikirikut.

Fjalët kyç: alergji, diagnostika, pediatri.

PËRDORIMI I BARNAVE ANALGJEZIKE NË STUDENTËT E FSHMT

Migerta Lahi, Alert Xhaja Dr.Sh.M.

Abstrakt

Qëllimi: Të përcaktojë prevalencën dhe grupin e analgjezikëve të vetë përdorur nga studentët e FSHMT.

Materiali dhe Metoda: Ky është një studim i kryqëzuar ku morën pjesë 135 studentë të FSHMT. Gjatë periudhës shkurt-prill 2022 studentët plotësuan një formular konfidencial me të dhënat e tyre socio-dermografike. Nga formulari gjithashtu u morën të dhëna për vetë përdorimin dhe llojin e barnave të përdorura gjatë gjashtë muajve të fundit. Të dhënat analitike dhe descriptive u analizuan me SPSS.

Rezultatet: Gjatë 6 muajve të fundit më shumë se 50% e pjesëmarrësve në studim kanë përdorur analgjezike pa përshkrim mjekësor. Bari më i përdorur ishte paracetamoli.

Konkluzioni: Në studim u vunë re nivele shqetësuese të vetë përdorimit të analgjezikëve në studentët e FSHMT. Përdorimi i analgjezikëve pa përshkrim mjekësor duhet përmirësuar nëpërmjet strategjive të edukimit.

Fjalë kyç: analgjezikë, paracetamoli.

ORF (ECTHYMA CONTAGIOSUM) E TRANSMETUAR NGA NJË LOPË TE NJË NJERI: RAPORTIM RASTI (DIAGNOSTIKIM I GABUAR I NJË SËMUNDJE TË RRALLË)

A.Xhaja. E. Shkodrani, M.Vargu

Abstrakt

Sfondi: Orf ose sic quhet ndryshe ecthyma contagiosum është një zoonoze që shkaktohet nga një parapox virus, i cili është endemic në delet dhe dhitë, por është e rrallë në lopet. Orf zakonisht transmetohet te njerezit kur kanë kontakt me kafshët e infektuara. Diagnoza e sëmundjes përcaktohet nga të dhënat klinike si dhe nga historia personale e pacientit që ka kontaktuar me kafshët e infektuara.

Raportim rasti: Ne paraqesim rastin e një pacienteje 32 vjecare e cila u paraqit në konsultat e dermatologjisë pranë QSUT me diagnozen e dërgimit suspekt keratoacanthoma, granuloma pyogene. Mjeku referues rekomandonte ekzaminimin me dermatoskopi dhe ekscizimin kirurgjikal si dhe konfirmimin e diagnozes me biopsi. Në momentin e paraqitjes në klinike pacientja paraqiste një formacion të ngritur mbi sipërfaqen e lëkurës në gishtin tregues. Formacioni karakterizohej nga një rreth erythematoz i kufizuar mirë dhe elemente krustoze e hiperkeratotike. Pacientja gjithashtu ankohej për praninë e linfonodulave të dhimbshme në krahun e të njëjtës gjymtyre. Diagnoza e Orf u vu bazuar në dyshimet klinike. Pacientja u mjekua me acid fucidik krem lokalisht dhe u observua derisa lezioni u shërua spontanisht duke lënë një depigmentim postinflamator.

Konkluzione: Të gjithë mjekët duhet ta konsiderojnë si diagnozë diferenciale në pacientët që kanë kontakt me lopet. Gjithashtu Orf është një sëmundje që vetëshërohet, por diagnostikimi i hershëm është shumë i rëndësishëm për të parandaluar komplikacionet, stresin psikologjik dhe ndërhyrjen e panevojshme kirurgjikale.

Fjalë kyç: orf, kafshë të infektuara.

NJË RAST I RRALLË I MYCOSIS FUNGOIDES QË IMITON PSORIASIS VULGARIS

A.Xhaja, S.Dedej

Abstrakt

Mycosis fungoide është një limfomë e rrallë cutane me një polmorfizem klinik dhe patologjik. Diagnostikimi në stadet e hershme mund të jetë i vështirë për shkak të ngjashmërisë klinike me semundjet e tjera beninje të lëkurës. Ne paraqesim një rast të pazakontë të mycosis fungoides në një paciente 60 vjecare që klinikisht paraqiste pllaka psoriatike të lokalizuara në pëllëmbet e duarve, në bryla, gjunj dhe në scalp. Biopsia e parë sugjeronte psoriasis vulgaris, por përkeqësimi klinik me erytheme dhe edemë e deskuamim në të gjithë trupin na detyroi të përsërisnim biopsinë. Biopsia e dytë kutane dhe punksion biopsia e kryer në linfonoduj pas 6 muajsh sugjeroi mykosis fungoides. Histologjikisht paraqitej si infiltrat dermal difuz me praninë e lartë të limfociteve atipike me imunofenotipe CD3+,CD4+, CD8+, CD20- dhe epidermotropizën. Bazuar në të dhënat laboratorike dhe imazherike pacientja u stadifikua si mycosis fungoides (stadi IIB,T0,N2,M0).

Fjalë kyç: mycosis fungoide, polimorfizëm, biopsi.

ANOREKSIA DHE BULIMIA , PATOLOGJI TË DASHURISË

Alketa Çoku
Pedagoge e jashtme në Fakultetit të Shkencave Mjekësore

Abstrakt

Kur flasim për çrregullimet e të ushqyerit shpesh mendohet se duhet kuruar dieta ose sjellja ndaj ushqimit. Problematikat e anorekisë dhe bulimisë janë komplekse dhe nuk zgjidhen me dietën në tavolinë. Në këtë prezantim do jap një këndvështrim psikologjik dhe të specializuar psikoanalitik, të këtyre çrregullimeve. Rritjen e numrit të këtyre patologjive, në shoqërinë bashkëkohore, mund ta ndaj në dy pika kryesore. E para është mitizimi modern i imazhit të trupit, ku anoreksia është shprehja më radicale e këtij çrregullimi. E dyta është konsumimi pa limit i objekteve, në këtë rast bulimia bëhet shprehja e pakontrollueshme i këtij konsumi. Duke marr në shqyrtim këto dinamika për interpretimin e çrregullimit, ajo që çalon, ajo që është në keqfunksionim është lidhja, relacioni midis personave të implikuar. Nga historitë klinike të pacientëve me këto çrregullime, gjejmë një plagë akoma të pambyllur që është pjesë e historisë së personit. Kjo "plagë" ka të bëj me rolin e subjektit dhe qendrimin e tij ndaj Tjetrit më të afërt që ka. Diçka në këtë relacion nuk shkon mirë dhe kjo shënjë vazhdon kufizon jetën e subjektit, edhe pse ky i fundit në mënyrë të pavetdishme mund ta mohoj ekzistencën. Nëse në një anë nuk mund të akuzojmë Tjetrin për zgjedhjet e subjektit, në anën tjetër nuk mund të mohojmë që eksperiencat e para të dashurisë fëmija i ka me caregiver (personi më i afërt që përkujdeset), që pothuajse gjithmonë janë prindërit ose ndonjë tjetër person që ka këtë detyrë ndaj fëmijës.Prandaj, kura e çrregullimeve të të ushqyerit, kalon nëpërmjet Tjetrit, pra nëpërmjet terapisë së fjalës, talking cure siç e ka quajtur Freud. Në këtë proçes është e nevojshme bashkëpunimi me disa figura profesionale (psikiatër, dietolog, endokrinolog, mjek familje, etj) dhe përfshirja e gjithë familjes (personat që ndodhen afër pazienti), për t'i ndihmuar të gjejnë rrugën më pak të dëmshme për personin dhe të afërmit.

Fjalë kyç: anoreksia , bulimia , histori klinike

COVID – 19 DHE MANIFESTIMET OKULARE

Dr. Shk. Alketa Tandili, Prof. ASC. Arjeta Grezda, Meriana Kuka
Klinika Okulistikës, QSUT

Abstrakt

Hyrja: Paraqitja e pacientëve me manifestime të dyshuara okulare të sëmundjes së koronavirusit 2019 (COVID-19) kanë nxitur hetime për shenjat, simptomat dhe transmetimin okular. Në rastet e paraqitura në Klinikën e Okulistikës në QSUT, si dhe duke ju referuar literaturës dhe eksperiencës së kolegëve në vendet e huaja, na bëjnë të shqyrtojmë vlerësimin dhe menaxhimin e manifestimeve okulare të COVID-19, si dhe të nxjerrim në pah rolin e ekipeve profesionale në menaxhimin e pacientëve me këtë gjendje.

Materiale dhe metoda: Jemi munduar të përmbledhim epidemiologjinë e manifestimeve okulare të Covid – 19, si dhe të përshkruajmë paraqitjet tipike të pacientëve me manifestime okulare të Covid – 19. Po ashtu kemi përshkruar konsideratat e menaxhimit për pacientët me manifestime okulare të Covid – 19, duke përfshirë këshillimin kryesor të pacientëve për parandalimin e transmetimit të sëmundjes, si dhe rëndësinë e bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet ekipeve ndërprofesional për të përmirësuar rezultatet për pacientët e prekur nga Covid – 19.

Rezultate: Pandemia e shkaktuar nga sindroma e rëndë akute e frymëmarrjes koronavirus 2 (SARS-CoV-2) ka pasur implikime shëndetësore të përmasave të paprecedentë. Infeksioni mund të variojë nga asimptomatike, të lehta deri në shqetësime të frymëmarrjes kërcënuese për jetën. Mund të prekë pothuajse çdo organ të trupit. Si manifestimet okulare permenden: konjuktiviti folikular, keratokonjuktiviti, konjuktiviti hemoragjik dhe pseudomembranoz, episklerite, dëmtime të uveas dhe retinës, dëmtime neuro oftalmike, e deri në manifestimet e mucormycosis e cila u paraqit kërcënuese për jetën.

Konkluzione: Oftalmologët në mbarë botën kanë raportuar manifestime të ndryshme të infektimit të syve me coronavirusin. Ky punim do të ndihmojë jo vetëm oftalmologët të njohin manifestimet e mundshme dhe fazën e sëmundjes virale kur ato zakonisht shfaqen. Covid – 19 nxorri në pah edhe njëherë rëndësinë e vlerësimit dhe menaxhimit të gjithë manifestimeve si dhe manifestimeve okulare, si dhe rolin e ekipeve profesionale në menaxhimin e pacientëve me këtë gjendje.

Fjalët kyç: covid – 19, okulistika, manifestime.

TERAPIA ME QELIZA CAR-T, NJË ERË E RE NË TRAJTIMIN E KANCERIT.

Cili.A, Perolla.A, Calliku.E, Pulluqi.P, Caja.T, Ivanaj.A.

Abstrakt

Kanceri është një nga shkaqet kryesore të vdekjeve në mbarë botën. Me kalimin e viteve, janë zhvilluar një sërë qasjesh konvencionale citotoksike për sëmundjet malinje. Megjithatë, për shkak të efektivitetit të tyre të kufizuar në përputhje me heterogjenitetin e qelizave kancerogjene, ekziston një kërkim i vazhdueshëm për qasje terapeutike me rezultate me te mira , siç është imunoterapia që përdor dhe rrit kapacitetin normal të sistemit imunitar të pacientit.

Qëllimi: Terapia me qeliza CAR-T është një lloj trajtimi në të cilin qelizat T të pacientit ndryshohen në laborator, kështu që ato do të sulmojnë qelizat kancerogene. Qelizat T merren nga gjaku i pacientit. Pastaj geni për një receptor të veçantë që lidhet me një proteinë të caktuar në qelizat e kancerit të pacientit shtohet në laborator. Receptori special quhet receptor

i antigjenit kimerik (CAR). Një numër i madh i qelizave CAR-T rriten në laborator dhe i jepen pacientit me infuzion. Terapia me qeliza CAR-T është duke u studiuar në trajtimin e disa llojeve të kancerit.

Rezultate: Në mesin e pacientëve me Leukemi akute limfoblastike mbijetesa e përgjithshme mesatare ishte 20.1 muaj dhe u shoqërua me një incidencë dukshëm më të ulët të sindromës së çlirimit të citokinave dhe ngjarjeve neurotoksike pas infuzionit të qelizave CAR-T sesa u vërejt te pacientët me një infuzion më të lartë. Qelizat CAR-T mund të jenë efektive në trajtimin e limfomës me qeliza të mëdha B të relapsuara ose refraktare dhe të limfomës folikulare. U vunë re ritme të larta të remisionit afatgjatë, me rikuperim të qelizave B dhe imunoglobulinave në disa pacientë. Encefalopatia kalimtare u zhvillua në afërsisht një në tre pacientë dhe sindroma e rëndë e çlirimit të citokinës u zhvillua në një në pesë pacientë. Pacientët me limfomë refraktare të qelizave B të mëdha që morën terapi me qeliza CAR-T me axi-cel kishin nivele të larta të përgjigjes së qëndrueshme, me një profil sigurie që përfshinte mielosupresionin, sindromën e çlirimit të citokinës dhe ngjarje neurologjike.

Fjalë kyç: CAR-T, terapi, kancer.

NJË DEFEKT I MURIT TË BARKUT ME FISTULA TË ZORRËVE PAS RIPARIMIT TË HERNISË PRERËSE DUKE PËRDORUR RRJETË POLIPROPILENI

Alma Llukacaj, Bilbil Rakipi, Nertila Kodra, Myzafer Kaci, Aldi Shani, Majlinda Naco, Prof. Arvin Dibra, Prof. Etmont Celiku

Abstrakt

Në këtë punim, ne tregojmë një rast të rrallë të defektit të madh të murit abdominal dhe fistulave enterokutane pas riparimit pa tension duke përdorur proteza për hernie incizionale. Pacientja, një grua 50-vjeçare, kishte një histori të hernies seksio cezariane dhe kërthizës të komplikuar nga një hernie e madhe incizionale që ishte mbyllur kryesisht, por përsëritej. Tre vjet më vonë, hernia u riparua duke përdorur një rrjetë polipropileni. Ecuria e saj u ndërlikua nga një infeksion kronik i plagës postoperative me zhvillim eventual të fistulave enterokutane. Pacienti u trajtua me sukses me ekstirpim të protezës, rezeksion të zorrës së fistulizuar dhe vendosjen e një rrjete biologjike për të mbyllur defektin e madh të murit të barkut.

Fistulat enterokutane janë një ndërlikim i njohur i riparimeve të hernies inciziale duke përdorur proteza. Të dhëna klinike shtesë kërkohen për të konfirmuar sigurinë dhe efikasitetin e kësaj procedure pasi ajo po përdoret më gjerësisht.

Ekstirpimi i protezës duhet të kryhet pa vonesë për të parandaluar komplikime serioze. Rikonstruksioni me një protezë biologjike ishte i dobishëm për defektin e madh të murit të barkut.

Fjalët kyç: hernie prerëse abdominale, defekt i murit të barkut, fistula e zorrëve të vogla.

SCREENING I TË POSALINDURIT DHE RËNDËSIA E TIJ PËR NDJEKJEN E FËMIJËS.

Alma Nurçe[1], Vjollca Hajro[2], Esmeralda Thoma[1].Emirvina Koliçi[1], Enkeleida Kamberi[3], Rozeta Shahinaj[4], Irena Kola[1], Klodi Poshi[5]
[1]Departamentin e Diagnostikës Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikave në Kirurgji dhe Infermieristikave në Obsetrik Gjinekologji. FSHMT Tiranë
[2]Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit, Universiteti i Sporteve të Tiranës
[3]SUOGJ "Koço Gliozheni" Tirana
[4]SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë"Tirana
[5]Departamentit të Lëndëve Paraklinike, FSHMT Tiranë

Abstrakt

Sfondi: Përparimet në teknologjinë e ekzaminimit të të porsalindurit, së bashku me përparimet e fundit në diagnostikimin dhe trajtimin e kushteve serioze të lindura, ofrojnë mundësi të shumta për të ndikuar pozitivisht në jetën e fëmijëve. Çelësi është të zbulohet sa më shpejt që të jetë e mundur nëse fëmija ka shënues për një sëmundje të mundshme gjenetike ose metabolike që mund të trajtohet herët, në mënyrë që të mos shfaqen komplikime afatgjata.

Qëllimi: Për të përcaktuar kontrollet efektive të të porsalindurve për diagnozë e hershëm të sëmundjeve.

Materialet dhe metodat: U rishikua literatura në 10 vitet e fundit në Cochrane dhe PubMed, rekomandimet e AAP, ACMG, ACOG, CDC. Baza e të dhënave u kontrollua duke përdorur titullin e temës dhe fjalët kyçe. Grupi i studimin, ishte i porsalindurit deri 28 ditë. U përzgjodh vetëm literaturë në gjuhën angleze.

Rezultatet: Programet e testimeve përfshijnë: të gjithë të porsalindurit, të porsalindurit me rrezik të shtuar për çrregullimeve specifike, për kërkime, analizat e lëngut amniotik të nënës shtatzënë. Ekzaminimi i të porsalindurve për çrregullime përfshin: Hiperplazinë kongjenitale të veshkave, hipotiroidizmin kongjenital, fibrozën cistike, galaktoseminë, homocistinurinë, sëmundja e urinës së shurupit të panjës, Acil-CoA dehidrogjenaza me zinxhir të mesëm, oksidimi i acideve të tjera yndyrore, acidi organik, fenilketonuria, çrregullimi i rëndë i imunitetit të kombinuar, Sëmundja e drepanocitoza, tirosinemia, çrregullimet e ciklit të uresë. Koha më e përshtatshme e ekzaminimit është 1 -14 ditë pas lindjes. Kartat e njollave të gjakut ruhen deri në 2 vjet dhe mund të përdoren për të siguruar teste laboratorike, për të zhvilluar teste të reja.

Konkluzione: Rekomandimet për depistimin e të porsalindurve përfshijnë: defekte kongjenitale të zemrës, çrregullime gjenetike dhe metabolike, dëmtim të dëgjimit, hiperbilirubinemi.
Probleme serioze, të tilla si paaftësi intelektuale/zhvillimore, sëmundje ose vdekja, mund të parandalohen nëse i gjejmë çrregullimet menjëherë.

Fjalë kyç: neonat, ekzaminik, sëmundjet, metabolike

MENAXHIMI I TË PORSALINDURIT TË NËNËS TË KONFIRMUAR OSE TË DYSHUAR PËR COVID-19.

Alma Nurçe[1], Vjollca Hajro[2], Enkeleida Kamberi[3], Rozeta Shahinaj[4], Emirvina Koliçi[1], Esmeralda Thoma[1]

[1]Departamentin e Diagnostikës Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikave në Kirurgji dhe Infermieristikave në Obsetrik Gjinekologji. FSHMT Tiranë
[2]Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit, Universiteti i Sporteve të Tiranës
[3]SUOGJ "Koço Gliozheni" Tiranë
[4]SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë"Tirana

Abstrakt

Sfondi: I porsalinduri paraqitet më shpesh si asimptomatik ose me sëmundje të lehtë, veçanërisht respiratore. Diagnoza e COVID-19 tek neonati përfshin ekzaminimin fizik, testimin laboratorik dhe radiologjik. Vlerësimi laboratorik përfshin SARS-CoV-2 RT-PCR dhe teste si CBC dhe CRP.

Qëllimi: Praktikat e kujdesit të neonatin gjatë pandemisë COVID-19.

Materialet dhe metodat: U rishikua literatura në 2 vitet e fundit në PubMed, rishikimet dhe rekomandimet nga OBSH, AAP, ACOG, CDC. Baza e të dhënave u kontrollua duke përdorur titullin e temës dhe fjalët kyçe. U përcaktua grupi i përshtatshëm për studimin, ku u përfshinë të porsalindurit deri 28 ditë. U përzgjodhën vetëm materialet në gjuhën angleze.

Rezultatet: Transmetimi vertikal i SARS-CoV-2 nuk ndodh. Për identifikimi i virusit rekomandon marrjen e një tamponi nazofaringeal (ose kampion i lavazhit bronkoalveolare). Radiologjia e kraharorit është e ndryshueshme, jospecifike, unilaterale ose bilaterale, zona lobare ose subsegmentare të konsolidimit të mushkërive, pneumotoraks dhe ndonjëherë normale. CT nuk jep informacion shtesë diagnostikues. Lidhja vonë e kordonit tek i porsalinduri i nënës me COVID-19 rrit rrezikun e transmetimit sekondar. SARS-CoV-2 nuk është zbuluar në qumështin e gjirit të nënave me COVID-19.

Konkluzione: Personeli mjekësor të vesh PPE të plotë gjatë procesit të lindjes të nënave me COVID-19 të konfirmuar ose të dyshuar, dhe nënat të mbajnë maska kirurgjikale. Lidhje e hershme e kordonit umbilikal. Tampon i fytit dhe nazofaringut tek i porsalindurit bëhet 24 - 48 orë pas lindjes. Imazheria kryhet vetëm nëse ka klinikë. Qumështi i gjirit i shtrydhur jepet, nga një kujdestar i shëndetshëm.

Fjalë kyç: i porsalindur, COVID -19, tampon, kordon, qumësht.

EFEKTSHMËRIA E KOMUNIKIMIT ALTERNATIV AUMENTATIV SI TERAPI NDIHMUESE NË REHABILITIMIN LOGOPEDIK

Msc. Antigoni Bullari[1], Ba. Ketrin Agaraj[2]
[1]*Logopediste, Msc. Shkencat Rehabilituese në Profesionet Mjekësore, Shqipëri*
[2]*Studente, Logopedi Viti II-të Bachelor, Shqipëri*

Abstrakt

Qëllimi: Ofrimi i shërbimit të rehabilitimit logopedik nëpërmjet komunikimit alternativ aumentativ.

Metodologjia: Terapia e të folurit konsiston në parandalimin, edukimin dhe trajtimin e çrregullimeve të lidhura me gjuhën verbale dhe joverbale, komunikimin tek fëmijët dhe të rriturit, çrregullime të sjelljes, çrregullime konjitive dhe çrregullime të gëlltitjes. Komunikimi alternativ aumentatic (AAC) zakonisht zbatohet sisteme mbështetëse të komunikimit të krijuara për individët që kanë vështirësi të shprehen përmes fjalës. Sistemet përfaqësuese të komunikimit AAC janë bordet e shenjave grafike dhe pajisjet elektronike të zërit. Ky lloj komunikimi është i dobishëm në çrregullime të spektrit të autizmit, sëmundjen e Parkinsonit, paraliza cerebrale, vonesë gjuhësore, dyspraxia e zhvillimit, afazitë dhe shumë çrregullime të tjera të cilat lidhen me komunikimin dhe ndërveprimin njerëzor. Kemi paraqitur disa case series për të treguar llojet e komunikimit alternativ aumentativ si dhe efektshmerinë si metodë ndihmëse në terapinë logopedike, në pacientë të të gjitha moshave.

Konkluzione: Nëpermjet komunikimit alternativ aumentativ si mjet ndihmës, rritet efektshmëria e terapisë logopedike në pacientë të të gjitha moshave.

Fjalët kyç: AAC, komunikimi alternativ aumentativ, aksidente vasculo-cerebrale, ictus, logopedi, rehabilitim logopedik, vonesë gjuhësore, bilingualizëm, afazi.

ROLI I TEKNIKUT RADIOLOG NW SCREENING MAMOGRAFIK

Miselda Kalashi[1], Ermira Muhadri[1], Ira Kadiu[1], Rina Berisha[2], Ilira Hoxha[1] , Altina Xhaferri[3]
[1]*Studentë të degës Teknik Imazherie, FSHMT, UMT*
[2] *Teknike Imazherie FSHM, KOSOVE*
[3]*Pedagoge FSHMT, UMT*

Abstrakt

Hyrje: Mamografia është radiografia e gjirit e cila realizohet kryesisht pas moshës 40 vjeç. Mamografia e screening është ajo mamografi e cila realizohet për të diagnostikuar kancerin e gjirit në ato gra të cilat nuk kanë simptoma apo klinikë të sëmundjes së gjirit. Tekniku radiolog është i përfshirë në procesin e pritjes së pacientes, përgatitjes së saj për ekzaminim si dhe realizimin e mamografisë.

Metodologjia: Tekniku radiolog është personel shëndetësor që ka marrë formimin profesional dhe është specializuar për realizmin e mamografisë, Në këtë prezantim do të fokusohemi mbi rolin që luan tekniku radiolog gjatë gjithë procesit të mamografisë që në momentin e paraqitjes së pacientes në kabinet deri ne momentin e largimit prej tij.

Rezultatet: Tekniku radiolog është personeli i parë dhe në të shumtën e rasteve i vetmi që përfshihet në pritjen e pacientes, sqarimin dhe përgatitjen e saj për realizimin e mamografisë me qëllim final perftimin e një imazhi të qartë diagnostikues. Procesi i mamografisë per një pjesë të grave mund të rezultojë i dhimbshëm dhe anksioz, por komunikimi i kujdesshëm me pacienten shërben për evitimin e problemeve të ndryshme gjatë pozicionimit dhe procedurës në përgjithësi Po ashtu roli i tij është i rëndësishëm në njohjen e aparaturës së mamografisë, evidentimin e problemeve teknike dhe gjetjen e mundësive për shmangien e tyre.

Konkluzioni: Per një teknik radiolog është shumë e rëndësishme të ketë aftesi të larta komunikuese. Eshtë e rëndësishme që pacienti të ndihet konfort gjatë realizimit të mamografisë. Megjithëse tekniku radiolog nuk ka ka kompetencën për të interpretuar imazhin ai duhet të jetë i aftë të vlerësojë rezultatin e imazhit të perftuar me qëllim përsërtijen e tij nëse është e nevojshme. Tekniku radiolog duhet të jetë familjar me aparaturën me të cilën punon dhe me detajet teknike të proçedurës radiologjike që përdor.

Fjalë kyç*:* teknik radiolog, mamografi, screening, aparature, gjiri

GABIMET DHE PËRGJEGJËSIA PROFESIONALE E TEKNIKUT RADIOLOG

Irena LIKA[1], Den KONGJONI[1], Eldi FYSHKU[1], Selena KOLONJARI[2], Xhoana RUCI[1], Elvira PERVIZI[1] , Dr. Altina XHAFERI[3]
[1]*Studentë të degës Teknik Imazherie, FSHMT, UMT*
[2]*Studentë Teknik Imazherie, UET*
[3]*Pedagoge FSHMT, UMT*
Corresponding author: Irena LIKA irena.lika2000@gmail.com

Abstrakt

Hyrje: Gabimet në radiologji janë të shpeshta në mjekësi. Për fat të mirë shumica e gabimeve nuk çojnë në dëme të rëndësishme shëndetësore. Shkaqet më të shpeshta të rezultateve të paparashikuara që vijnë nga gabimet në mjekësi janë njohuritë e mangëta, mungesa e eksperiencës, lodhja, pakujdesia.

Metodologjia: Në këtë prezantim do të bëhet një reflektim mbi shkaqet e gabimeve radiologjike që mund të ndodhin nga ana e personelit teknik gjatë punës së përditshme në kabinetin e Radiologjisë. Teknikët radiologë gjatë aktivitetit të tyre në departament janë të përfshirë në një sërë ekzaminime, situate dhe të papritura të cilat duhet të tejkalohen me mjeshtëri. Roli i teknikut radiolog është të përftojë një ekzaminim sa më të mirë me qëllim diagnostikimin sa më të saktë me sa më pak ose aspak gabime.

Rezultatet: Gjatë punës së teknikut radiolog janë identifikuar disa gabime kryesore në radiologji që janë gabimet në projeksion ose në teknikën e përdorur, gabimet në ekspozim apo në proçesim të imazhit, gabimet në mirëmbajtjen e filmave apo kasetave radiologjike si

dhe gabimet dixhitale. Përsos kësaj gabime të tjera që mund të reduktojnë performancën e punës së një tekniku radiolog janë edhe problemet e bashkëpunimit në grup, të komunikimit, problemet teknike të pajisjeve radiologjike, politikat e departamentit etj.

Konkluzion: Tekniku radiolog ka një rol të rëndësishmë dhe të padiskutueshëm në gjithë procesin e realizimit të një ekzaminimi radiologjik. Ai mund të përfshihet në hallka të ndryshme i vetëm ose në bashkëpunim si me kolegët e tij ashtu edhe me mjekun radiolog. Performanca e teknikut radiolog rritet shumë kur ai bëhet koshient për rolin e tij, për faktorët që ndikojnë në punën e tij si dhe shmangia dhe eliminimi i të gjithë faktorëve që mund të ndikojnë në realizimin e një ekzaminimi radiologjik deficitar.

Fjalëkyçe: Teknik radiolog, gabim, përgjegjësi, ekzaminim.

IMAZHERIA E TRUPAVE TË HUAJ

Altina Xhaferi[1], Enida Xhaferi[2], Ilir Lumi[3]
[1, 2] Universiteti i Mjekësisë, FSHMT
[3] Spitali Universitar i Traumës

Abstrakt

Hyrje: Trupat e huaja mund të futen ne organizëm me mekanizma te ndryshëm, p.sh përtypjen, aspirimi, mund te futen dhe me qëllim. Ato përbëjnë një nga elementët e trajtimit në departamentin e urgjencës. Për të siguruar diagnostikim e saktë të trupave të huaja (corpus alien) dhe të komplikimeve që lidhen me të, shërbimi i urgjencës duhet të ketë njohuri për modalitetin e duhur imazherik që duhet përdorur, teknikën specifike që do shërbejë edhe për diagnozë por edhe në vlerësimin folloë –up të trupave të huaj.

Metodologjia: Nëpërmjet këtij punimi do diskutohen epidemiologjia, paraqitja klinike dhe strategjitë e përshtatshme radiologjike për cdo mekanizëm hyrjeje të trupit të huaj duke përfshirë ekografinë, radiografinë, fluoroskopinë ose Rezonancën magnetike. Karakteristikat kyc të imazhit janë madhësia, forma, densiteti, lokalizimi anatomik dhe pasojat klinike të trupave të huaja gjë e cila mund te ndikojë në menaxhimin e rastit duke cuar ndonjëherë dhe deri në ndërhyrje kirurgjikale.

Rezultatet: Radiografia është teknika që përdoret më gjerë për diagnostikimin e trupave të huaja. Kur trupat e huaja vlerësohen nëpërmjet radiografisë është e rëndësishme të merret në konsideratë radiopaciteti dhe diferencimin radiografik i një trupi të huaj.
Ekografia është në përgjithësi një metodë shumë e mirë për vlerësimin e trupave të huaj të dimensioneve të vogla apo radioluecente të lokalizuara në sipërfaqe të trupit të njeriut, apo në identifikimin e trupave të huaja të futur në aparatin urogenital. Sidoqoftë rezultatet e saj mund të jenë subjektive. Fluoroskopia përdor imazhin real-time për mbledhjen e inforrmacionit rreth funksionit dinamik të organit apo sistemit të interesit. Pas radiografisë, CT Skaner është hapi tjetër i vlerësimit të trupave të huaj apo komplikacioneve që lidhen me të për shkak të aftësisë së modalitetit për të dhënë informacione të detajuara volumetrike dhe spaciale të strukturës anatomike dhe patologjisë.

Konkluzione: Në diagnozën e trupave të huaj dhe në trajtimin e duhur të komplikacioneve që lidhen me të është shumë e rëndësishme paraqitja klinike e pacientit, menaxhimi radiologjik i duhur sipas rrugës së hyrjes së tyre. Një element kritik në vendimarrjen e

shërbimit të urgjencës është njohja e shenja klinike, madhesisë, formës dhe lokalizimit anatomik të trupave të huaja.

Fjalë kyç: trupa të huaj, radiologji, ekografi, skaner, urgjencë

DIAGNOZA MIDIS KARCINOMËS KUTANE TË QELIZAVE BAZALE (BBC) DHE ASAJ TË QELIZAVE SQUAMOZE (SCC), KUSHT I RËNDËSISHËM PËR ORIENTIMIN TERAPEUTIK

A.Cenko[1], E. Shkodrani[2], A.Xhaja[3]
[1.] *Spitali italo-shqiptar Salus, Departamenti i Dermatologjisë dhe Venereologjisë*
[2.] *Qëndra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Departamenti i Dermatologjisë dhe Venerologjisë*
[3.] *Qëndra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Departamenti i Dermatologjisë dhe Venerologjisë*

Abstrakt: Karcinoma e qelizave bazale (BCC) dhe ajo e qelizave skuamoze (SCC), përbëjnë format më të shpeshta të tumoreve jo melanocitike të lëkurës. Emërtimi i tyre përkon me nivelin qelizor të origjinës, përkatësisht nga shtresa bazale për BCC dhe shtresa skuamoze për SCC. Këto malinjite hasen në cdo popullatë, rracë apo tip lëkure. Riskun për të zhvilluar kancer të lëkurës e kanë personat që i perkasin tipit I, II dhe II Fiztpatrick të lëkurës, personat me histori familjare për tumore, histori të mëparshme të kancerit të lëkurës, defekte gjenetike, djegie të herpashershme të lëkurës, rrezatimet e jonizuara, rrezatimi ultraviolet. Lokalizimi anatomik i tyre, i shpeshtë, përfshin zonat me ekspozim të shprehur ndaj rrezatimit diellor, si në regionin e kokës, atë torakal, shpinë, dhe në gjymtyrët e sipërme të poshtme.
Diagnoza diferenciale e këtyre formave të shpeshta tumorale, orienton mjekun dermatolog për zgjedhjen e alternativës terapeutike, jo vetëm nëpërmjet interpretimit të imazhit makroskopik, por kryesisht nëpërmjet të dhënave dermatoskopike. Karcinoma e qelizave bazale paraqitet si një formacion nodular i vogël, me tendencë rritjeje vertikale dhe horizontale, që gjatë evolimit të tij mund të pësojë një depresion qendror, ose ulceracion. Shpesh ajo mund paraqitet edhe si një njollë eryitematoze, me disa krusta të vogla në sipërfaqje, ose me pamje morfeaforme. Futja në zbatim e dermatoskopisë ka përmirësuar ndjeshëm saktesinë diagnostike, edhe për tumoret me përmasa të vogla. Karakteristikat dermatoskopike të vaskularizimit (enët e gjakut të arborizuara, apo vazat telagiektazike), të elementëve të pigmentuar (globujt dhe shportat me pigment blu-gri, strukturat si gjethe panje dhe ato si rrotë qerre), strukturat kristaline arrijnë të diferencojnë nëntipin, shkallën e invazionit dhe severitetit të BCC. Forma tjetër e kancerit të lëkurës jomelanocitik, SCC, paraqitet klinikisht si një element papulonodular eritematoz, me nje mase qendrore keratine, ose si nje ulceracion i crregullt. Kriteret dermatoskopike evidentojnë strukturat rrethore të hapjeve folikulare të mbuluara me keratin dhe vazat e gjakut haipin-si lak i rrethuar me një aureole të bardhë elementët vaskulare, lineare-serpentine, pikëzore dhe glomerulare. Format e keqdiferencuara identifikohen në dermatoskopi nga prania e eritemës, vaskularitet dens dhe rrjedhje hemorragjike, përkundrejt formave të diferencuara mirë ku mbizoterojnë strukturat e bardha dhe keratina.
Diagnoza e dermatologut orienton zgjedhjen terapeutike, bazuar në lokalizimin, nëntipin e tumorit, formën primare apo rekurentë të tij.

Fjalë kyç: karcinoma e qelizave bazale, karcinoma e qelizave skuamoze, dermatoskopi, vaza gjaku.

KINETIKA E ANTITRUPAVE IGG DHE IGM SPECIFIKE NDAJ SARS COV 2 NË SËMUNDJEN COVID 19.

Andi Koraqi, Denada Lacej, Rea Karafili, Fatjon Cuko
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.
Fakulteti Mjekësisë.
Departamenti i laboratorëve.
Shërbimi i Mikrobiologjisë.

Abstrakt

Sëmundja e COVID-19 e shkaktuar nga infeksioni me virusin SARS-CoV-2 paraqet sfida të rënda për shëndetin publik. Testimi i antitrupave në serum kohët e fundit po bëhet një nga metodat më të rëndësishme për diagnostikimin e pacientëve me COVID-19. Ne analizuam përgjigjen imunitare dhe titrin e antitrupave IgM dhe IgG kundër antigeneve të SARS-CoV-2 (nukleokapsidit (N) dhe proteinës spike (S)) pas shfaqjes së simptomave. Nivelet e IgM dhe IgG specifike për proteinat N dhe S u zbuluan me metodologjinë ELPHA. Një seri mostrash gjaku u mblodhën përgjatë gjithë së sëmundjes nga i njëjti pacient. Zbulimi i IgM dhe IgG specifike N dhe S mund të identifikojë deri në 75% të pacientëve të infektuar me SARS-CoV-2 në javën e parë. S-IgG ishte dukshëm më i lartë në pacientët jo-ICU sesa në pacientët me ICU në javën e tretë. IgM dhe IgG specifike N dhe S u rritën gradualisht pas shfaqjes së simptomave dhe mund të përdoren për zbulimin e infeksionit SARS-CoV-2. Analiza e dinamikës së S-IgG mund të ndihmojë në parashikimin e prognozës.

Fjalë kyç: antitrupa, sars CoV 2.

REHABILITIMI FIZIOTERAPEUTIK N COVID-19

Andromeda Lalaj Keci, Joana Xhema

Abstrakt

Qëllimi. Evidentimi i rëndësisë së rehabilitimit fizioterapeutik në pacientët me Covid-19 përgjatëndjekjes spitalore dhe post covid në kushte spitalore/shtëpi. Vendosja e fokusit në rehabilitimin pulmonar përmes ushtrimeve respiratore, lëvizjeve aktive dhe pasive duke monitoruar shenjat vitale të pacientit.

Metodologjia. Për të realizuar këtë rishikim literature, gjatë kërkimit janë përdorur fjalët kyçeCovid-19 dhe ushtrime respiratore. Si rezultat i kërkimit janë evidentuar 69 rezultate, janë përzgjedhur 21 nga të cilat vetëm 12 prej tyre kanë përkuar në përgjigje të qëllimit tonë.
Studimet e përfshira specifikisht janë 5 rishikime literature, 6 artikuj dhe një letër editimi. Studimet janë marrë në burime zyrtare si Pubmed Central dhe revista prestigjoze si Respiratory Physiology & Neurobiology, Complementary therapies in clinical practice, Advances in Respiratory Medicine etj. Në këtë rishikim janë përfshirë të gjitha studimet të cilat konsideroninushtrimet respiratore në pacientët covid dhe post covid e janë përjashtuar ato studime të cilat përfshinin pacientë me sëmundje shoqëruese metabolike apo Alzheimer. Gjithashtu janë përjashtuar studime të cilat fokusoheshin vetëm në efektet si ankthi dhe depresioni tek këta pacientë.

Rezultate. Ushtrimet respiratore në pacientët post covid ndikojnë në përmirësimin e kapacitetit funksional të mushkërive, reduktim të dispnesë dhe përmirësim të masës muskulare. Ushtrimet respiratore të realizuara në kushte shtëpie nga pacientët për 4 javë, ndikojnë në lëvizjet e diafragmës, presionin dhe rrjedhën maximale inspiratore.Po ashtu ushtrimet Liuzijue dhe Qigongndikojnë në përmirësimin e kapacitetit funksional të pacientit, funksionin kognitiv dhe përmirësimin e kualitetit të jetës.

Konkluzioni. Rehabilitimi pulmonar përmes ushtrimeve respiratore ndikon në reduktim të dispnesë, reduktim të lodhjes përmirësim të kualitetit të jetës jo vetëm në aspektin fizik, por edhepsikologjik të pacientit. Protokollet ushtrimore Luizijue dhe Qigong në shtëpi ndikojnë ndjeshëmnë rehabilitimin respirator të pacientit duke i bërë ato tepër premtuese në të ardhmen, veçanërishtnë rast risku për lockdown-e të tjera.

Fjalë kyçe: Covid-19, ushtrime respiratore, fizioterapi, frymëmarrja diafragmatike, Liuzijue

DIAGNOZA E MENAXHIMI I DISA SITUATAVE EMERGJENTE NE ONKO – HEMATOLOGJINE PEDIATRIKE.

Prof.Dr.Anila Godo, Prof.Dr.Eleni Nastas, Dr.Shk.Mirela Xhafa, Prof.As.Dr.Donjeta Bali, Dr. Mirzana Kapllani, Prof.As.Dr.Manika Kreka, Dr.Shk.Daniela Nikaj

Q. S. U. "Nene Teresa", Tiranë. Departamenti i Pediatrisë. Shërbimi i Onko–Hematologjisë.

Abstrakt

Me urgjencat hematologjike dhe onkologjike pediatrike përballen në përgjithësi specialistët përkatës në shërbimin terciar e dytësor, por ndodh të përballet dhe pediatri apo mjeku i familjes në shërbimin parësor. Këto emergjenca mund të grupohen në 3 kategori kryesore: ndërlikimet e çrregullimeve hematologjike, ato që lidhen me shfaqjen e re të kancerit dhe fillimin e terapisë, dhe ato të lidhura me trajtimin. Numri i përgjithshëm i këtyre pacientëve mbetet i ulët; megjithatë, vdekshmëria e lidhur me këto situata mbetet e lartë, e përbën një sfidë aktuale, pavarësisht përparimeve të rëndësishme në menaxhim. Të kuptosh thelbin e të menaxhosh drejt këto situata emergjente do të thotë të rrisësh përqindjen e mbijetesës si dhe të një jete cilësore për këtë kontigjent fëmijësh. Në këtë punim ne kemi përzgjedhur referimet më të mira, më të fundit e fort të rekomandueshme mbi emergjencat në onko-hematologjinë pediatrike, të shoqëruara dhe me eksperiencat e jetuara në strukturat e shërbimit tonë. Qëllimi ynë ka qenë të tërheqim vëmendjen mbi shkaqet e mundshme të këtyre emergjencave, mbi diagnozën e saktë të komplikimeve konkrete potenciale të tyre e sidomos mbi qëndrimin fillestar e menaxhimin në vazhdim të tyre. Situatat janë më të shumta, por ne kemi zgjedhur për të trajtuar: Aneminë e rëndë, hemorragjitë jetë kërcënuese, krizën hemolitike hiperakute, sindromin e lizës tumorale, neutropeninë febrile, shoqëruar ose jo me sepsis e shok septik. Problemet akute ndahen në dy grupe, ato që kërkojnë vlerësim, diagnozë dhe terapi të menjëhershme dhe ato që kërkojnë vëmendje. Në këtë studim, ne synuam të analizonim në mënyrë prospektive diagnozën urgjente dhe karakteristikat klinike të pacientëve të urgjencës onkologjike të pranuara, si dhe të vlerësonim konsideratat e qasjes ndaj rasteve, trajtimin e tyre, rezultatet e pacientit dhe faktorët prognostikë. Ofruesit e urgjencës që mund të identifikojnë dhe menaxhojnë urgjencat onkologjike mund të kontribuojnë ndjeshëm në një prognozë të përmirësuar.

Fjalë kyç: situata emergjente në onko–hematologjinë pediatrike.

JO ÇDO DEPRESION MADHOR ËSHTË DEPRESION UNIPOLAR

Dr. Shk. Anila Hashorva[1]
[1]*Psikiatër, Departamenti i Neuroshkencës, QSUT*

Abstrakt

Hyrja: Çrregullimi depresiv madhor diagnostikohet si unipolar, në mungesë të simptomave hipomaniakale. Hipomania vonon të diagnostikohet sepse: pacienti përgjithesisht nuk i tregon simptomat, ose doktori duke trajtuar simptomat e thella të depresionit nuk iu kushton vëmendje dhe nuk insiston për simptomat e hipomanisë, gjithashtu alkooli dhe droga e fshehin hipomaninë. Kjo bën që një pjesë e depresionit bipolar të diagnostikotet dhe trajtohet gabimisht si depresion unipolar. Kjo ka kosto të madhe në trajtim dhe ndikon në prognozë.

Qëllimi: Ky studim ka për qëllim të analizojë depresionin madhor sipas këndvështrimit të ri spektrit bipolar dhe të zbulojë hershëm simptomat hipomaniakale, dhe t'i japë përgjigje pyetjes: Ç'pjesë e Depresionit Madhor është në fakt Depresion i Bipolaritetit?

Metoda: Në studimu përfshinë 190 paciantë midis moshës 19- 56 vjec, tëdiagnostikuar me Depresion Madhor (episod i parë ose rekurent). Për të gjetur simptomat e fshehura të hipomanisë u përdor testi HCL-32 dhe MDQ. Të dhenat demografike për gjetjet e hipomanisë u llogaritën sipas programit statistikor EPIINFO
Rezultatet: HCL-32 dhe MDQ tregoi se 21% (1/5) e pacientëve me MDD kanë simptoma të spektrit bipolar. Ka lidhje statistikisht të rëndësishme midis hipomanisë se gjetja dhe numri i episodeve depresive, kohëzgjatja, fillimi i depresionit para moshës 25 vjeç.

Përfundim: Një pjesë e madhe e Depresionit Madhor diagnostikohet gabimisht si Depresin Unipolar por është në fakt Depresioni i Bipolaritetit dhe duhet trajtuar si i tillë.

Fjalët kyç: depression, diagnostifikim, hipomania.

VARIACIONET ANATOMIKE TË RRUGËVE BILIARE INTRA DHE EKSTRAHEPATIKE DHE RËNDËSIA E TYRE NË PRAKTIKËN KLINIKE.

Anila Kristo[1], Joneda Barjamaj[2]
[1]*Departamenti i Morfologjisë, Seksioni i Anatomisë. FM, UMT*
[2]*Studente Viti II, Mjekësi e Përgjithshme, FM, UMT*

Abstrakt

Anatomia normale e rrugëve biliare intra dhe ekstrahepatike shfaqet në rreth 60% të popullsisë. Drenimi intrahepatik biliar konsiston në duktuset hepatike të djathtë dhe të majtë që drenojnë lobet respektive të heparit. Duktusi hepatik i djathtë formohet nga bashkimi i

duktusit sektorial të djathtë posterior i cili drenon segmentet VI, VII dhe duktusit sektorial të djathtë anterior që drenon segmentet V, VIII ndërkohë që duktuse tributare segmentare II-IV formojnë duktusin hepatik të majtë. Bashkimi i segmenteve ekstrahepatike të duktuseve hepatike të djathtë dhe të majtë formon duktusin hepatik komun. Duktusi cistik zakonisht drenon në aspektin lateral të duktusit hepatik komun poshtë origjinës së tij duke formuar duktusin biliar komun. Ndër variacionet më të shpeshta të rrugëve intrahepatike jane: trifurkimi (bashkimi i duktusit hepatik të majtë, sektorial të djathtë posterior dhe sektorial të djathtë anterior), derdhja e duktusit sektorial të djathtë posterior në duktusin hepatik të majtë ose derdhja e e tij apo e duktusit sektorial të djathtë anterior në duktusin hepatik komun. Drenimi i segmenteve hepatike direkt në rrugët biliare ekstrahepatike mund të realizohet nga duktuse akcesore të cilat dalin zakonisht nga lobi i djathtë i heparit dhe mund të derdhen në duktusin hepatik komun, duktusin cistik, duktusin biliar komun ose direkt në fshikzën e tëmthit. Duktusi cistik paraqet si variante më të shpeshta inserimin medial në anën e majtë të duktusit hepatik komun, inserim i ulët në 1/3 distale të duktusit hepatik komun si dhe zbritja paralele rreth 2 cm ose më shumë me duktusin hepatik komun. Njohja e variacione anatomike të rrugëve biliare është e rëndësishme në kirurgjinë e heparit, kolecistës dhe rrugëve biliare. Ekzaminimet imazherike si CT dhe MR kolangiografia lejojnë përcaktimin e qartë të këtyre variacioneve dhe janë të nevojshme të përdoren për të identifikuar para operacionit ato variante anatomike që kërkojnë vëmendje të veçantë nga pikëpamja kirurgjikale duke parandaluar në këtë mënyrë komplikacione që lidhen me dëmtimin e rrugëve biliare.

Fjalë kyç: rrugë biliare, duktus, CT, MR kolangiografi.

ANATOMIA E SËMUNDJES SË REFLUKSIT, SHFAQJET EZOFAGEALE DHE EKSTRAEZOFAGEALE DHE REKOMANDIMET AKTUALE TË MJEKIMIT

Anila Kristo[1], Jonila Çela[2], Artan Kristo[3], Nikollaq Leka[1]
[1]Departamenti i Morfologjisë, Seksioni i Anatomisë, FM, UMT
[2]Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Elbasan
[3]Shërbimi i Kardiologjisë, QSU "Nënë Tereza"

Sëmundja e refluksit gastroezofageal (GERD) ndodh kur kalimi i përmbajtjes gastrike në drejtim të ezofagut është i shtuar dhe jep dëmtime të mukozës ezofageale duke shkaktuar ezofagit dhe predispozon zhvillimin e ezofagut Barret. Simptomat tipike të GERD-it janë djegia retrosternale dhe regurgitimi kurse dhimbja retrosternale e ngjashme me dhimbjen kardiake mund të jetë shoqëruese e tyre ose edhe e vetmja simptomë. Refluksi mund të përparojë në laringofaring dhe më pas, në rajone të tjera të kokës dhe qafës si në laring, gojë, nazofaring, hundë, sinuse paranazale dhe veshin e mesëm. Si rrjedhojë mund të zhvillohen një sërë simptomash ekstraezofageale të lidhura me GERD-in si kolla kronike, ngjirja e zërit, laringiti, globus, astma, erozionet dentare, halitoza, rinosinuziti kronik dhe otitis media. "Barrierat" kryesore anatomike/fiziologjike që shërbejnë si mbrojtës për të parandaluar invazionin kranial të refluksit gastrik jane: sfinkteri gastroezofageal i cili përfaqëson një mekanizem kompleks me elementë të muskujve të lemuar të sfinkterit të poshtëm ezofageal si dhe muskujve të vijëzuar krural të diafragmës që së bashku realizojne ruajtjen e presionit ne bashkimin gastroezoafageal, sfinkteri i sipërm i ezofagut i cili përfaqëson një zonë me presion të lartë në bashkimin faringoezofageal e që parandalon refluksin drejt laringut, vetë funksioni motorik i ezofagut si dhe rezistenca mukozale e faringut dhe laringut. Guri themelor i trajtimit në GERD janë medikamentet frenues të pompës protonike (PPI) dhe modifikimi i stilit të jetes. Krahas realizimit të diagnozës diferenciale, përgjigja klinike ndaj

terapisë PPI është propozuar si një metodë kyçe për diagnozën dhe trajtimin e GERD-it ekstraezofageal. Në rastet refraktare te GERD-it përvec optimizimit të terapisë PPI, rekomandohen edhe ndërhyrje endoskopike dhe kirurgjikale.

RËNDËSIA E USHTRIMEVE TË FRYMËMARRJES DHE ATO OROFACIALE NË TRAJTIMET LOGOPEDIKE.

Anita Ferati
Logopede

Abstrakt

Hyrje: Ky studim është realizuar për të vërtetuar rëndësinë e ushtrimeve të frymëmarrjes dhe ushtrimeve orofaciale në patologjitë të cilat kërkojnë trajtimin Logopedik.

Objektivat: Studimi do tregojë rëndësinë e këtyre ushtrimeve.
Si mund ti përdorim të njëjtat ushtrime në patologji të ndryshme Logopedike?
Përse këto ushtrime duhet të zbatohen në fillim të trajtimit?
Cilat janë hapat që një Logoped duhet të ndjekë për këto ushtrime?
Si dhe paraqitja e rezultateve.

Metodologjia: Në këtë studim do paraqiten 4 raste klinike me diagnoza të ndryshme.
Paraqitet plani rehabilitues hap pas hapi dhe rezultati përfundimtar.

Rezultatet: Ushtrimet e frymëmarrjes dhe ushtrimet orofaciale duhet të jenë objektivat e para në trajtimet Logopedike.

Konkluzioni: Përdorimi i këtyre ushtrimeve është pothuajse në të gjitha diagnozat Logopedike.
Si një profesioniste mund ti quaj edhe si "Çelësi i një trajtimi të sukseshëm".
Kjo pasi mushkëritë janë "gjeneratori" i aparatit të të folurit dhee muskulatura orofaciale është thelbësori për artikulimin e tingujve.

Fjalët kyç: Logopedi, ushtrimet e frymëmarrjes, ushtrimet orofaciale, trajtimi Logopedik.

ASPEKTE TEORIKE MJEKOLIGJORE MBI KQYRJEN E KUFOMËS NË VENDIN E NGJARJES.

Prof.Asc.Arben Lloja, Dr.Ilir Decolli, Dr. Fatos Sinani, Dr.Donjet Lloja

Abstrakt

Ky punim synon teë japë një kontribut modest për një nga problematikat kryesore në lidhje me"Aspektin mjekoligjor të kqyrjes së kufomës në vendin e ngjarjes" dhe si e tillë, problematika është komplekse dhe do të kërkonte një trajtim jo vetëm mjekoligjor, por edhe kriminalistik, e deri dhe kriminologjik. Për vetë rëndësinë dhe dinamizmin e situatave konkrete që paraqet një vdekje nga shkaqe kriminale apo në rrethana të dyshimta, është i domosdoshëm një hetim i shpejtë, i organizuar dhe me nivel të lartë shkencor. Për këtë arsye prania e mjekut ligjor në vendin e ngjarjes përbën një element të pazëvendësueshëm dhe të

domosdoshëm për sa i përket ndihmës dhe informacioneve që mund të jap falë profesionalizimit dhe aftësive të tij mjeko ligjore në kqyrjen e vendit të ngjarjes dhe vecanërisht të kufomës në lidhje me ate vendngjarje.
Hetimi mjekoligjor i vdekjes nënkupton kqyrjen e parë të kufomës në vendin e ngjarjes. Ekspertimi mjekoligjor, së bashku me atë kriminalistik, si veprimtari tekniko-shkencore shërbejnë si një konsulencë profesionale në ndihmë të organeve të drejtësisë, për të zbardhur përmes laboratoreve shkencore rrethanat e dhunshme të një ngjarje me pasojë vdekjen.

Fjalë kyç: Kufoma , mjekoligjore , laboratori shkencor.

SFIDAT QË DUHEJ TË PERBALLONIN TË MOSHUARËT GJATË PANDEMISË COVID 19.

Prof Arben Pilaca
Departamenti i lëndëve klinike. FSHMT, UMT.

Abstrakt

Qëllimi: Refleksione mbi pandeminë e shkaktuar Covid 19 impakti në të moshuarët në vendin tonë. U bënë afërsisht 24 muaj që i gjithë globi u godit nga një pandemi e shkaktuar nga një virus i quajtur Sars Cov 2 e cila ndikoj në mënyrë të dukshme dhe të rëndësishme, në ndalimin e veprimtarisë rutinë dhe duke e ndryshuar cdo ditë jetën njerëzore. Covid 19, u përhap në mënyrë jo të zakonshme në gjithë globin, shkaktoj sfida të mëdha të sferës shëndetësore, ekonomike, sociale, politike mbi gjithë popullsinë e tij.
Në bazë të dhënave të botura periodikisht gjatë pandemisë, sidomos në muajt e parë të tij, grup mosha që përballoj problemet më të mëdha negative ishte dhe vazhdon të jetë ajo e moshave mbi 65 vjec. Incidenca dhe prevalenca e kësaj pandemie tregon për shifra më të larta të infektimit, hospitalizimit dhe humbjeve të jetës ne te moshuaret. Masat parandaluese të pandemisë, sic ishte distancimi social, kufizimet e aktiviteteve rutinë në sistemin shëndetësor, kufizimet e lëvizjeve (lock down), keqinformacioni, mungesa e protokolleve të qarta trajtuese, dhe problemet me vaksinimin,etj, ishin sfida qe ju paraqiten kësaj grup moshe më shumë se të tjerët.
Edhe në vendin tonë, pavaresisht specifikave demografike, sociale, kulturore dhe ekonomike të ndryshme nga shume vende të tjera, të moshuarët ishin pjesa që pësoj me shumë se të tjerët efektet negative të pandemisë. Pandemia Covid 19 është në një fazë remisioni por akoma është midis nesh. Megjithatë eksperienca e deri tanishme (ka të dhëna të mjaftueshme) na obligon që të bëhet një analizë shumë planëshe dhe të reflektohet mbi zgjedhjet e bëra deri tani, ndërhyrjet e duhura në të ardhmen me qëllim që i gjithë sistemi reagues ndaj pandemive të ardhshme të jetë më efikas dhe me një kosto më të lehtë sidomos atyre shëndetësore në personat me rrisk me të lartë sic janë grup moshat mbi 65 vjec.

Fjalët kyçe: Covid 19, sfida, virus, pandemi.

DEMENCA POSTPARTUM

Prof.Ariana Pojani[1] ,Albanian University.

Abstrakt

Hyrja: Demenca postpartum(DP) përkufizohet si crregullim I trurit I cili prek kujtesën afatshkurtër, aftësitë gjuhësore,aftësitë motorike.

Qëllimi:Qëllimi i projektit është që të vlersojë si menaxhohet dhe metodat që përdoren për zvogëlimin e DP në një paciente shtatzënë ose pas lindjes në Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjikë "**Koco Gliozheni**".

Rezultatet: Demenca postpartum mund të shfaqet te nënat në pritje të një fëmije ose menjëherë pas lindjes. Kujdesi kryesor në pushim me gjumë, në trajtimin e kujtesës dhe dietë. Panvarësisht komplikacioneve, mund që femra të kthehet në normalitet.

Fjalë kyçe:demenca postpartum(DP), kujtesa, hormone, gjumë

MALFORMACIONET ARTERIO-VENOZE CEREBRALE: OPSIONET E TRAJTIMIT.

Artur Xhumari

Abstrakt

Hyrje: Malformacionet arterio-venoze (MAV) janë sëmundje të lindura të cilat hasen në organe të ndryshme të trupit, përfshirë edhe trurin. Klinikisht mund të jenë të heshtura, por mund të japin hemorragji, efekt kompresiv apo epilepsi. Trajtimet përfshijnë abstensionin, kirurgjinë, embolizimin, radiokirurgjinë, apo kombinimin e tyre.

Metodat: Rishikuam dosjet imazherike, klinike, operatore për gjatë viteve 2018-2021 të një kirurgu të vetëm (AXh) për MAV dhe nxorrëm të dhëna demografike, shfaqjet klinike, mënyrat e trajtimit si dhe rezultatet deri në vizitën e fundit klinike.

Rezultatet: Gjetëm dhjetë të sëmurë me MAV. Shenjat klinike ishin hemorragji në 6 raste, epilepsi në 2 raste dhe në 2 raste gjetje icindentale. Trajtimi përfshiu në një rast mbajtjen në ndjekje, 2 u operuan, 5 u trajtuan me radiokirurgji, 1 u embolizua, trajtua me radiokirurgji dhe u operua. Rezultatet në 3 raste pa ndryshime, përmirësim në 3 raste, keqësim nga radionekrozë në 2 dhe nga hemorragji e re në 2 raste prej te cilëve njëri operohet me përmirësim dhe një mbahet në ndjekje.

Perfundimet: Trajtimi i MAV kërkon një bashkëpunim të ngushtë të një ekipi multidisiplinar. Opsionet e trajtimit janë multimodale dhe në eksperiencën tonë me rezultate të mira por me nevojë për ndjekje afatgjatë.

Fjalë kyç: MAV, hemorragji, epilepsi.

NJË RAST ME LEZION DIELAFOY DHE NJË PËRDITËSIM I TRAJTIMIT AKTUAL.

Arvit Llazani, Marsela Sina
First Clinic, Reparti i Kirurgjisë, Njësia Gastrointestinale dhe Hepatologjike, QSUT "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Hyrje: Lezioni i Dieulafoy është një gjendje relativisht e rrallë, por potencialisht kërcënuese për jetën. Ajo përbën 1-2% të gjakderdhjeve akute gastrointestinale (GI), por ndoshta është e nën-njohur dhe jo e rrallë. Natyra e tij serioze e bën të nevojshme përfshirjen e tij në diagnozën diferenciale të gjakderdhjes gastrointestinale të errët. Qëllimi i këtij studimi ishte studimi i rastit dhe rishikimi i tendencave aktuale në diagnostikimin dhe menaxhimin e lezionit të Dieulafoy.

Rezultatet: Mashkull 25 vjeç i paraqitur në urgjencë me hemorragji gastrointestinale të manifestuar me melenë. Ai u shtrua në spital dhe iu bë ekzaminimi i endoskopisë së sipërme, u diagnostikua me lezion Dielafoy. Trajtohet me injeksion të epinefrinës. Ai pati një shërim të mirë për 8 ditë, në ditën e 9 pati hemorragji G-I të manifestuar me shok, shkoi në ICU, u reanimua dhe u krye një EGD tjetër që tregon gjakderdhje aktive afërsisht 3 cm larg klipit në lezionin Dielafoy. Ka shkuar në sallën e operacionit dhe është bërë gastrotomia dhe qepja e lezionit. Ai u shërua pa probleme dhe u lirua.

Diskutimet: Nuk ka konsensus për trajtimin e lezioneve të Dieulafoy. Endoskopia terapeutike mund të kontrollojë gjakderdhjen në 90% të pacientëve ndërsa angiografia po pranohet si një alternativë e vlefshme për endoskopinë për lezionet e paarritshme. Aktualisht, ndërhyrja kirurgjikale mbahet për dështimin e ndërhyrjeve terapeutike endoskopike ose angiografike dhe duhet të udhëhiqet nga lokalizimi para operacionit.

Përfundime: Gjakderdhja nga lezionet e Dieulafoy mund të menaxhohet me sukses me metoda endoskopike, të cilat duhet të konsiderohen si zgjedhja e parë. Përparimet në endoskopi kanë rritur zbulimin e lezioneve të Dieulafoy dhe kanë ulur vdekshmërinë nga 80% në 8.6%. Kirurgjia është trajtimi kur procedurat endoskopike nuk arrijnë të ndalojnë gjakderdhjen. Ka raporte të fundit inkurajuese për përdorimin e suksesshëm të kirurgjisë laparoskopike në menaxhimin e lezioneve simptomatike të Dieulafoy.

Fjalë kyç: lezionet Dieulafoy, hemoragji, epinefrinë.

PARAMETRAT INFLAMATORË GJATË NDJEKJES SË PACIENTIT ME COVID-19.

Asead Abdyli, Gentian Huti, Driola Hoxha, Altin Papa
Departmenti i Anestezise dhe Terapise Intensive, Spitali Amerikan 3, Tirana, Albania

Abstrakt

Hyrje: Covid-19 është pandemi që preokupon të gjithë botën në këto momente. Kjo pandemi është duke ushtruar një presion të madh mbi repartet e terapisë intensive për shkak të numrit të madh të pacientëve që kanë nevojë për kujdes në këto reparte të terapisë intesive apo semiintensive. Kjo pandemi virale prek të gjitha organet dhe shkakton një përgjigje inflamatore me efekte multiorganore. Mbi bazën e ndryshimeve inflamatore, prokoaguluese, hipoksisë së zgjatur dhe të gjeneralizuar, reflektohen edhe ndryshimet në organe të ndryshme dhe në tendencën për komplikacione septike. Ky infeksion pavaresisht fokusit që ka në mushkëri, prek ndjeshëm dhe shpesh edhe disa organe të tjera si psh veshkat, trurin, mëlçinë, koagulimin, muskujt etj. Pra është një sëmundje multiorganore dhe ndjekja me analizat biokimike është shumë e rëndësishme.

Materiali dhe Metoda: Shumë parametra dhe markues biokimik janë propozuar për ndjekjen e Covid-19 dhe që maten rregullisht. Në skemën normale të ndjekjes propozohen të maten rregullisht Ddimer, Ferritinemi, Fibrinogjen, Gjak komplet, LDH, Indeksi Neutrofile/Limfocite, dhe Proteina C-Reaktive. Në faza të avancuara maten edhe IL6, IL1 për të gjykuar mbi "Stuhinë e citokinave"

Diskutimi: Departamenti i Anestezi-Reanimacionit te Spitali Amerikan 3 ka ndjekur mbi 200 pacientë të hospitalizuar me Ddimer, Gjak komplet, Fibrinogjen, Ferritinemi, LHD, CRP dhe Prokalcitonine. Janë bërë edhe matje serike të IL6 në 8 raste. Sic dihet Interlukina 6 është gjetur si një faktor kryesor në stuhinë e citokinave në Covid-19 dhe mendohet se korrelon me rëndesën e sëmundjes. Në pacientët me sëmundje shoqëruese kardiake apo metabolike, rendimi i parametrave proinflamator korrelon me gravitetin e sëmundjes. Nga ana tjetër nivelet e larta të CRP, PCT, dhe Ferritinemisë janë besnike të një prognoze të rezervuar. Sot në literaturë po merr vlerë si element parashikues për ecurinë jo të favorshme të sëmundjes edhe indeksi Neutrofile/Limfocite sepse siç e dimë prania e limfocitopenisë është element i rëndësishëm karakterizues i Covid-19.

Konkluzion: Matja e markuesve biokimikë proinflamatore është e rëndësishme në ndjekjen e pacientëve me Covid-19. Nga ana tjetër është e qartë edhe nga praktika jonë klinike se këto parametra më shumë sesa parashikues të formave të rënda, na ndihmojnë mbi të gjitha për të vendosur terapinë sipas stadit ku ndodhet pacienti për të optimizuar trajtimin dhe ecurinë e tij.

Fjalë kyç: Covid-19, inflamacion, markuesit inflamator.

RISITË NË PRAKTIKAT E MENAXHIMIT SPITALOR DHE AMBULATOR TË PATOLOGJIVE KARDIOVASKULARE GJATË PANDEMISË SË COVID-19

Dr. Aurel Demiraj[1], Arbër Shehu[2]
[1]Shërbimi I-rë i Kardiologjisë, QSU "Nënë Tereza", Tiranë
[2]Student Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Covid-19, e përkufizuar si pandemi prej Shtatorit 2020, ndryshoi thelbësisht strategjitë dhe prioritetet në praktikat e menaxhimit spitalor dhe ambulator të patologjive kardiovaskulare. Adaptimi "ad hoc" i strukturave të shëndetit solli ndryshime në protokollet dhe qasjen klasike ndaj pacientit. Duke balancuar riskun e shtuar të fatalitetеve brenda sistemit të ofrimit të kujdesit shëndetësor dhe domosdoshmërinë për të ofruar shërbim ndaj pacientëve, u implementuan teknika dhe protokolle të reja. Edhe pas përmirësimit të situates epidemiologjike, disa nga këto protokolle vijojnë të aplikohen në praktikën e përditshme spitalore.

Materiali dhe metodat: Reduktimi i aksesit tek strukturat spitalore dhe para-spitalore ishte pasoja e pare direkte e pandemisë. Kjo solli ndryshimin e protokolleve bazike të menaxhimit të pacientëve me patologji kardio-vaskulare. Dikur e pakonceptueshme, tele-medicina fitoi terren ndaj ekzaminimit klinik klasik dhe ndërveprimit direkt mjek-pacient. Reduktimi i ekzaminimeve laboratorike dhe konteksti i pandemisë ndryshoi qasjen ndaj vlerave "cut-off" për domosdoshmërinë e trajtimit të patologjive kardio-vaskulare. Reduktimi i numrit të shtretërve spitalorë dhe veçanërisht shtretërve të reanimacionit solli ndryshimin e raportit

mes procedurave spitalore dhe atyre ambulatore. Prioritetet për mbrojtjen e stafit mjeksor ulën numrin dhe ndryshuan indikacionet për një shumllojshmëri ekzaminimesh ambulatore rutinë. Triazhimi i ri i emergjencave kardio-vaskulare modifikoi profilin e shtrimeve spitalore, si edhe indikacionet specifike të trajtimit. Një shumllojshmëri procedurash, dikur të jo kosto-efikase apo të rezervuara për situate jo të trajtueshme me teknikat konvencionale, u promovuan dhe në disa raste zëvendësuan procedurat klasike. Pavarësisht përmirësimit të situatës së pandemisë, një trend i tillë vijon edhe sot, duke i dhënë prioritet minimizimit të kontaktit staf mjeksor – pacient. Një trend i tillë do të vijojë, probabilisht, edhe për shumë kohë me potencialin real për t'u shndëruar nga "përjashtim" në "normë".

Rezultati dhe konkluzionet: Qasja bashkëkohore terapeutike ndaj pacientëve me patologji kardio-vaskulare, normat dhe strategjitë e trajtimit, si edhe teknikat e reja të aplikuara gjatë pandemisë janë risi në kardiologjinë Shqiptare. Dilemma e të ardhmes do të jetë validimi i efikasitetit të një qasjeje të tillë përkundrejt asaj klasike; në rast se provohet që kjo qasje nuk është inferiore në rezultate immediate dhe përfitim afatgjatë, atëherë Covid-19 do të shënonte një pike kthese në filozofinë e trajtimit të këtij grupi pacientësh. Dhe në fatkeqësi ka shpresë.

Fjalët kyç: menaxhimi spitalor, menaxhimi ambulator, patologji kardiovaskulare, covid-19.

KOMPLIKACIONET KARDIOVASKULARE TË COVID-19

Dr. Aurel Demiraj[1], Flavio Sula[2]
[1]Shërbimi I i Kardiologjisë, QSU "Nënë Tereza", Tiranë
[2]Student Universisteti i Mjekësisë, Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Pacientët e infektuar me Covid-19 janë statistikisht më të prirur të shfaqin shenja dhe simptoma klinike specifike të patologjive kardiovaskulare. Kjo tablo klinike mund të shfaqet para, gjatë periudhës së infektimit por edhe pas negativizimit të testit RT-PCR dhe "shërimit" të pacientëve. Komplikacionet kardio-vaskulare të lidhura me Covid-19 përkeqësojnë prognozën e këtij grupi pacientësh. Këto komplikacione kanë specifikat e tyre dhe ende mbeten shumë të panjohura për trajtimin optimal. Parandalimi dhe trajtimi optimal i tyre është kompleks dhe kërkon një qasje multi-disiplinare.

Materiali dhe metodat: Stresi global dhe pamundësia për një akses të kënaqshëm në sistemin shëndetësor (për arsye logjistike apo mos-funksionim normal të sistemit) shpjegojnë pjesërisht rritjen e inçidencës të patologjive kardiovaskulare në popullatë. Por, për arsye të njohura apo të supozuara, të lidhura me fiziopatologjinë e Covid-19, vihet re shtimi apo shfaqja e disa patologjive kardiovaskulare specifike. Stormi i citokinave shton probabilitetin e (dhe supozohet të jetë faktori kryesor i) shokut kardiogjen apo sistemik. Inflamacioni mund të shpjegojë prekjen e miokardit, me pasojë shtimin e frekuencës së miokarditeve dhe çrregullimeve inherente të ritmit, shpeshherë fatale. Çrregullimet e koagulimit që vërehen tek pacientët me Covid-19 mund të shpjegojnë aksidentet tromboembolike, qofshin ato në qarkullimin koronar (të manifestuara si sëmundje iskemike e zemrës), atë pulmonar (tromboembolia pulmonare) apo sistemik (aksidentet vaskularë cerebralë dhe periferikë). Dhe jo më pak e rëndësishme, ecuria afatgjatë e pacientëve të konsideruar "të shëruar" nga Covid-19 mund të komplikohet nga evente kardiovaskulare të supozuara të reja.

Rezultati dhe konkluzionet: Ecuria e pacientëve me Covid-19 ka shumë të panjohura; komplikacionet kardiovaskulare të shkaktuara nga (ose të supozuara të tilla) kjo patologji

janë ende pak të studiuara. Qasja empirike ndaj këtyre situatave është ende standarti i aplikuar aktualisht, por protokolle më strikte do të duhet të aplikohen për trajtimin e situatave dhe komplikacioneve specifike kardiovaskulare të Covid-19.

Fjalët kyç: komplikacion, kardiovaskulare, covid-19.

MENAXHIMI I EMERGJENCAVE KARDIAKE GJATË PANDEMISË SË COVID-19

Dr. Aurel Demiraj[1], Silvi Zhobe[2]
[1]Shërbimi I-rë i Kardiologjisë, QSU "Nënë Tereza", Tiranë.
[2]Student Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Strategjia e menaxhimit të emergjencave dhe urgjencave kardiovaskulare ka ndryshuar gjatë pandemisë së Covid-19. Entet dhe organizmat rregullatorë përkatës janë adaptuar me situatën duke prezantuar protokolle të reja, si për pacientët me patologji kardiovaskulare në situatën aktuale, ashtu edhe për këtë grup patologjish tek pacientët e dyshuar, diagnostikuar me Covid-19. Ndryshimet në protokollet përkatëse prekin qasjen ndaj situatave klinike, organizimin e stafit dhe strukturave dhe principet e deontologjisë dhe etikës mjeksore.

Materiali dhe metodat: Të dhënat aktuale të mbledhura nga shoqatat specifike (ESC, ACC, AHA), revistat shkencore dhe praktikat klinike, modifikojnë qasjen ndaj patologjive kardiovaskulare në kontekstin e pandemisë. Duke qenë se protokollet e mëparshme mbështeten në nocionin e shpejtësisë në aksesin spitalor, agresivitetin në trajtim (procedura invasive dhe qasje multidisiplinare ndaj pacientëve me patologji akute kardiovaskulare) dhe në konsultimin e rastit në kohë reale mes specialiteteve por edhe me pacientin, familiarët, këto protokolle nuk janë më lehtësisht të aplikueshme në situatën aktuale. Domosdoshmëria e triazhimit të pacientëve me patologji kardiovaskulare, balanca midis mbrojtjes së stafit dhe shëndetit të pacientit si edhe diskutimi etik dhe llogjik për mënyrën, kohën, mjetet dhe nivelin e agresivitetit në trajtimin e patologjive kardiovaskulare tek pacientët e dyshuar, konfirmuar me Covid-19 janë trendi i ri në protokollet e trajtimit. Adaptimi dhe shndërimi i strukturave të specializuara në trajtimin e patologjive kardiovaskulare në struktura të balancuara mes riskut dhe përfitimit në shëndet dhe jetë humane është zgjidhja më e pranueshme, edhe pse jo lehtë e realizueshme, në kushtet e pandemisë.

Rezultati dhe konkluzionet: Domosdoshmëria për ndërhyrje të shpejta, komplekse dhe multidisiplinare kontrastohet nga mbingarkesa e sistemit shëndetësor (dhe veçanërisht shërbimeve të urgjencave), pakësimi i resurseve në aparatura, shtretër dhe personel, si edhe risku i kontaminimit të stafit dhe pacientëve. Shumë proçedura rutinë janë pezulluar ose shtyrë në kohë. Principet e triazhimit tek pacientët me patologji kardiovaskulare gjithashtu janë modifikuar në funksion situatës aktuale, disponibilitetit të aseteve humane dhe teknike e laboratorike. Mënyra e qasjes dhe limiti i agresivitetit në trajtimin e sëmundjeve kardiovaskulare tek pacientët e konfirmuar me Covid-19 ngelet i paqartë dhe përbën një dilemë etiko-profesionale për personelin mjekësor.

Fjalët kyç: emergjencat kardiake, pandemic, covid-19.

TEKNIKAT DHE RISITË NË KARDIOLOGJINË INVAZIVE 2020 – 2022, COVID-19 DHE JO VETËM

Dr. Aurel Demiraj[1]
[1]*Shërbimi I-rë i Kardiologjisë, QSU "Nënë Tereza", Tiranë.*

Abstrakt

Hyrje: Strategjia e menaxhimit të patologjive kardiovaskulare ka ndryshuar gjatë pandemisë së Covid -19. Ndryshimet në protokollet përkatëse prekin qasjen ndaj situatave klinike, organizimin e stafit dhe strukturave dhe teknikat e përdorura. Prioriteti në trajtimin e patologjive kardio-vaskulare ka ndryshuar në favor të minimizimit të kontaktit personel mjeksor – pacient. Kardiologjia invazive gjithashtu është përshtatur me trendin e ri.

Materiali dhe metodat: Në mbështetje të protokolleve të reja të menaxhimit të patologjive kardio-vaskulare, kardiologjia invazive si nën-specialitet u adaptua në indikacionet dhe teknikat e përdorura. Qëllimi kryesor gjatë gjithë periudhës së pandemisë ishte minimizimi i përhapjes së Covid-19 dhe mbrojtja e stafit si prioritet absolut. Shkurtimi i kohës së kontaktit staf – pacient dhe i kohës totale të qëndrimit të pacientit në strukturat spitalore modifikoi teknikat e përdorura nga kardiologët invazivë.
Aksesi klasik (nga Arteria femorale) zgjat kohën e kontaktit pacient – staf dhe qëndrimin e pacientit në strukturën spitalore. Aksesi nga Arteria radiale eliminon pjesërisht këtë handikap; gjithsesi kjo kërkon trajnimin specific të operatorëve, materialin specifik (me koston përkatëse) dhe nuk është e aplikueshme në çdo situatë. Trajtimi i të gjitha lezioneve në vazat koronare në një seancë është alternativë ndaj procedurave të kryera në disa etapa. Avantazhi është tek minimizimi i kohë-qëndrimit spitalor, por jo pa problematika specifike për pacientin. Shkurtimi i kohëqëndrimit spitalor pas një procedure invazive është një mënyrë efikase për të mbrojtur stafin dhe pacientin. Por a ka dhe cilat janë pasojat tek ecuria e pacientëve dhe a është kjo statistikisht sinjifikative? Përdorimi i alternativave të tjera jo-invazive për diagnostikimin e stenozave të arterieve koronare mund të pakësojë kontaktin staf – pacient. Cilat janë situatat kur indikohen këto ekzaminime? Trajtimi invaziv i lezioneve të arterieve karotide, renale dhe periferike rivalizon trajtimin kirurgjikal dhe është më i kushtueshëm. Por benefiti në reduktimin e kohëqëndrimit spitalor dhe pakësimi i kontaktit staf – pacient ka gjithashtu avantazhet e veta. Trajtimi perkutan i valvulopative gjithashtu është alternative llogjike ndaj kirurgjisë klasike. Pavarësisht kostos dhe kompleksitetit logjistik, ky grup teknikash gjen zbatim në kontekstin e pandemisë. E njëjta filozofi vlen edhe për trajtimin e defekteve të lindura etj.

Rezultati dhe konkluzionet: Ulja e kohëqëndrimit spitalor dhe shkurtimi i kohës së kontaktit direkt staf – pacient janë prioritetet e imponuara nga pandemia e Covid-19. Me këtë filozofi, kardiologjia invazive zgjodhi të adaptohej me realitetin e krijuar nga kjo situatë. Studime të mëtejshme do të verifikojnë rezultatet afatgjata të kësaj qasjeje të krahasuar me atë klasike.

Fjalët kyç: kardiologjia invazive, risitë, covid-19.

SFIDAT E SIGURISË USHQIMORE DHE TË DHËNAT LABORATORIKE NË LIDHJE ME NGARKESËN MIKROBIKE TË PRODUKTEVE USHQIMORE.

Dr. A Xhixha[1], Dr. A Xhixha[2], E.Uzuni[1], J.Hasa[1]
[1]Departamenti i Shëndetit Publik Tiranë.
[2]Inspektorati Sanitar Shtetëror Tiranë.

Abstrakt

Siguria e ushqimit përkufizohet si gjendja e të qenit të sigurt dhe të garantuar që ushqimi i konsumuar nga konsumatori nuk do të shkaktojë asnjë lloj dëmtimi kur ai përgatitet ose konsumohet. Qasja në ushqim që është mjaftueshëm ushqyes dhe i sigurt për mirëqenien e dikujt është një e drejtë themelore dhe primare individuale." Ndër kërcënimet më të mëdha në lidhje me sigurinë ushqimore është padyshim izolimi i mikroorganizmave patogjenë si salmonela, kampylobakteret, EHEC, streptokoku faekal, brucella, Staphylococcus aureus, clostridium boutulinum, pseudomonas etj. Në laboratorin mikrobiologjik pranë Departamentit të Shëndetit Publik Tiranë283 u analizuan mostrat e ushqimit, me një normë pozitive prej 146 mostrash. Janë analizuar 69 mostra akullore ku 12 rezultuan pozitive. Sa i përket pijeve, nga 26 mostra asnjë nuk rezultoi pozitiv. Sa i përket ujit, nga mostrat e vitit 2004 105 rezultuan pozitive. Për sa i përket mishit dhe produkteve të tij, 2 nga 367 mostra rezultuan pozitive. 0 nga 59 mostrat e bukës dhe miellit rezultuan pozitive, 5 nga 38 mostra të qumështit dhe produkteve të qumështit rezultuan pozitive, 5 nga 67 mostra të ëmbëlsirave rezultuan pozitive. 17 nga 209 mostra të një sërë produktesh të tjera rezultuan pozitive. Ngarkesa bakteriale e mostrave të analizuara u përcaktua me metodën e hollimit dhe kultivimit në terrene bazë për çdo mikroorganizëm të dyshuar në mostrat e klinikës dhe produkteve ushqimore. Terrenet e përdorura për analizën e mostrave të klinikës dhe produkteve ushqimore bazuar në mikroorganizmat e dyshuar janë renditur si më poshtë: laktozë biliare, gjak agar (STA), endo (EHEC), ECE (për E.COLI dhe C.T) TTC (STF), Chapek ,PYA (për ngarkimin e mykut), Muller Hinton (bac.mezentericus) DC, Selenit, Agar XLD (salmonella,shigella,).

Fjalë kyç: siguria ushqimore, ngarkesa mikrobike.

PËRCEPTIMET E STUDENTËVE TË INERMIERISË PËR NDËRLIDHJEN E MËSIMIT NË LABORATORE DHE PRAKTIKES KLINIKE INSTITUCIONALE.

Agnesa Kadrijaj, Lirigzon Goçaj, Viola Haxhija, Argjiro Alija MSc, Bekim Sejdiu PhD cand

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi ishte të identifikonte nëse ekziston një lidhje midis asaj që studentët e infermierisë mësojnë në ushtrimet e simuluara të laboratorit klinik në objektet e fakultetit dhe asaj që ata përjetojnë gjatë praktikimit të tyre ne institucione shendetësore klinike. Laboratorët klinikë zakonisht përdoren për të ndihmuar studentët të zhvillojnë aftësi klinike infermierore përmes simulimit të përvojave, shkathësive klinike, kompetencave klinike e të tjera. Qëllimi është që të përcaktohet nëse ushtrimet laboratorike klinike ju kanë ndihmuar studentëve të integrojnë teorinë dhe praktikën e infermierisë në mjedisin klinik shëndetësor.

Pjesëmarrësit ishin studentët të infermierisë nga universitetet publike dhe private të arsimit universitar. Metodë studimit ishte pyetësori për praktika klinike i realizuar nga 114 studentë të infermierisë. Pyetjet kishin të bënin me përceptimin e studentëve për atë që u mësuan asistentet në ushtrime laboratorike dhe për atë që përjetuan gjatë praktikes në mjedise klinike. Rezultatet vërtetuar nevojën për të zhvilluar tutje ligjerata shtesë, ushtrime laboratorike, dhe demostrim i tyre në maneken duke e theksuan si të nevojshëm dhe për zhvillimin e aftësive profesionale të tyre, rritjen e kompetencave dhe zotësinë për te marrë vetëbesimin ne përballje me pacient dhe mjedisin praktik institucional shëndetësor.

Përfundim: Nderlidhja midis asaj që mësohet në laboratore dhe asaj që është përjetuar ne mjedisin institucional është e domosdoshme për të siguruar praktikë të sigurt tek studentët e infermierisë

Fjalë kyç: laboratorë klinik, praktika klinika, teoria dhe praktika, mentorët klinik, studentët infermier.

ERIBULIN MESILAT ME DOZË TË ULËT FRENON PËRHAPJEN E QELIZAVE DHE INDUKTON APOPTOZËN NË QELIZAT E GLIOBLASTOMËS NJERËZORE

Ayşenur Aykan, 1 MSC; Belisa Kaleci, 2* PhD; Gamze Tanriverdi, 2 PhD; Meral Koyuturk, 2 MD, PhD; Zeliha Yazici, 3 PhD.

Abstrakt

Qëllimi: Glioblastoma multiforme (GBM) është forma më e zakonshme dhe malinje e tumorit të trurit me një zhvillim të shpejtë dhe invaziv dhe me vdekshmëri të lartë. Shumica e trajtimeve standarde si rezeksioni kirurgjik, rrezatimi dhe kimioterapia janë të kufizuara nga efikasiteti i ulët terapeutik që konsiston në një prognozë të dobët. Prandaj nevojitet zhvillimi i agjentëve të rinj terapeutikë. Ne synuam të hetojmë karakteristikat antikancerogjene të eribulinës mensilate si një agjent terapeutik i mundshëm për trajtimin e glioblastomës multiforme dhe më pas të sqarojmë mekanizmat themelorë të veprimit të saj.

Metodat: U kryen eksperimente me dozë in vitro për të përcaktuar dozën efektive të eribulinës. Përhapja e qelizave u vlerësua nga Bromodeoxyuridine (BrdU) dhe Cell Counting Kit-8 (CCK-8), përkatësisht, u aplikuan për të vlerësuar efektet antiproliferative dhe citotoksike. Ngjyrosja e aneksinës V u krye për të përcaktuar efektet apoptotike të eribulinës në qelizat T98. Gjithashtu ndryshimet morfologjike u vlerësuan me mikroskop drite dhe rrugët Smad2/3 (p-Smad2/3) u analizuan me imunocitokimi.

Rezultatet: Grupi me dozë më të ulët (5 nM) të eribulinës kishte efekt të mirë antiproliferues dhe efekti apoptotik u rrit në krahasim me grupin e kontrollit në një mënyrë të varur nga koha. Gjithashtu shprehjet Smad2/3 dhe p-Smad2/3 u rritën ndjeshëm në një mënyrë të varur nga koha. Eribulina induktoi formimin e qelizave multinukleare dhe piknotike.

Përfundime: Eribulina shfaq aktivitete in vitro antiproliferative dhe apoptotike kundër qelizave të glioblastomës njerëzore duke ndërhyrë në rrugët Smad.

Fjalë kyç: Eribulin mesilat, glioblastoma multiforme, apoptozë, proliferim qelizor.

RINOPLASTIKA ME PIEZO TRENDBASHKËKOHOR I KIRURGJISË ESTETIKE TË HUNDËS

Prof.Asoc.Besim Boçi, Arjola Brahimi

Abstrakt

Hyrje: Megjithëse rinoplastika është një nga ndërhyrjet estetike më të shpeshta në kirurgjinë e fytyrës, rezultatet e saj në shumë raste lënë shumë për të dëshiruar. Këto rezultate varen jo vetëm nga eksperienca e kirurgut por edhe nga teknikat e përdorura. Vitet e fundit teknika me piezo ka përmirësuar në mënyrë drastike rezultatet e rinoplastikës dhe ka pakësuar ndërkohë ndërlikimet e kësaj ndërhyrje.

Materiali dhe metoda: Janë marrë në studim rreth 300 raste ku është kryer rinoplastika me piezo për vititn 2021. Pacientët në të cilët është kryer kjo ndërhyrje janë të moshave nga 18-45 vjeç, nga të cilët 233 kanë qënë femra dhe 67 kanë qenë meshkuj. Në të gjithë pacientët janë realizuar fotot para dhe pas ndërhyrjes për të parë rezultatin estetik të hundës. Në të gjithë pacientët mobilizimi i hundës është kryer me piezo për të arritur një rezultat shumë të mirë dhe për të shmangur ndërlikimet.

Rezultatet: Në të gjithë rastet ku u aplikua teknika me piezo rezultatet ishin shumë të mira. Konkretisht në 266 raste rezultatet post operatore krahasuar me ato preoperatore ishin shumë të mira. Në 15 raste rezultatet ishin relativisht të mira, kjo lidhur me frakturen jo të duhur të hundës në murin lateral të saj. Në 19 raste rezultatet ishin të mira por pacientët kishin edemë në njerën anë të hundës për shumë muaj. Pothuaj në të gjitha rastet ndërlikimet ishin të papërfillshme, përveç ndonjë rasti ku hemoragjia zgjaste më shumë. Rezultatet e teknikës me piezo janë impresionuese dhe ankesat nga pacientet janë minimale.

Konkluzione: Teknika me piezo sot është teknika kryesore që përdoret në kirurgjinë estetike të hundës duke arritur rezultate shumë të mira pas operacionit. Me këtë teknike nëse kryhet një pyetësor të pacientet lidhur me rezultatin e arritur pothuaj në 90% të tyre shkalla e kënaqësisë është maksimale.

Fjalë kyç: rinoplastika, teknikë me piezo.

TË DHËNA EPIDEMIOLOGJIKE TË INTERVENTEVE KIRURGJIKALE PLASTIKE NË REGJIONIN E KOKË-QAFËS NË KLINIKËN E DJEGIE PLASTIKËS NË QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE “NENE TEREZA”.

Besnik Faskaj
Universiteti i Mjekësisë, Fakulteti Shkencave Mjekësore Teknike

Abstrakt

Regjioni i kokë-qafës është regjioni më kritik në trupin e njeriut ku vendosen të gjitha shqisat dhe ku rezultatet e ndërhyrjeve kirurgjikale performojnë pamjen e jashtme vizive të personit me të cilën ai prezantohet dhe kryen aktivitetet e tij të përditshme në shoqërine civile. Nga ana tjetër është një regjion ku kryhen një game e gjerë interventesh plastike me qëllim restaurimin e regioneve të prekura duke patur si objeksion rekonstruksionin e cdo shtrese

anatomike deri në mbylljen përfundimtare të lëkurës me transplant ose me lembo. Në cdo qendër djegieje në botë pacientët që mund të trajtohen aty, ndahen në tre prioritete. Prioriteti i parë përfshin trajtimin e pacientëve të djegur, dëmtimi termik i të cilëve përcaktohet sipas protokolleve nga American Burn Association si dhe nga kriteret e cdo vendi. Pacientët e prioritetit të parë janë pacientë me: Djegie të rënda, Dëmtimet elektrike, Djegie respiratore, djegie në fëmijë, në të moshuar, në pacientë me sëmundje shoqëruese dhe Toxic Epidermal necrolysis. Pacientët e përfshirë në prioritetin e dytë janë pacientë të cilët kanë trauma multiple ose penetruese, dëmtime maksilo-faciale si dhe rekonstruksion pas traumës i regjioneve kritike.

Qëllimi: Studimi i të gjitha rasteve me patologji të lokalizuara në regjionin e kokë-qafës që kërkojnë trajtim kirurgjikal plastik gjatë periudhës 2010-2019 në Shërbimin e Djegie-Plastikës, Qendra Spitalore Universitare "Nene Tereza", Tiranë.

Rezultatet: Aktiviteti kirurgjikal i Shërbimit të Djegie-Plastikës ka konsistuar në kryerjen e 12633 interventeve në total me një mesatare 1263.3±313.1 intervente në vit. Interventet e kryera në regjionin e kokë –qafës (n=5561) përbëhen nga: interventet për djegien dhe traumën, për pasojat e djegieve, për patologjitë e lindura, tumoret beninje, tumoret malinje dhe interventet estetike. Përsa i përket grup-moshës një numër i konsiderueshëm 205 raste (%) ishin fëmijë deri 10 vjec, më pas rastet ndjekin një shpërndarje normale ku më shumë janë rastet e grup-moshës 40-69 vjec Raporti M:F ishte 1.88:1, pra një predominancë e seksit mashkull. Gjatë periudhës në studim janë kryer tre lloj interventesh estetike: Otoplastika, Rhinoplastika dhe Blefaroplastika për diagnozat respective :Prominaureus, Gibus nazi dhe Ptosis Palpebralis. Interventet konsistojne ne Rhinoplastikat me 172 raste (62%), më pas Otoplastikat me 86 raste (31%) dhe në fund renditen Blefaroplastikat me 19 raste ose 7% e totalit. Nuk janë kryer intervente të tjera estetike.

Përfundime: Trajtimi kirurgjikal është pjesa kryesore e trajtimit kompleks të pacientëve me patologji në regjionin e kokë-qafës, por ajo duhet të kombinohet me trajtimet e tjera për të arritur përmirësimin e cilësisë së jetës të këtyre pacientëve.

Fjalë kyç: Kokë qafa,Djegie, Trauma.

KOMPLIKACIONET JO RESPIRATORE TË COVID -19

Besnik Filaj, Asead Abdyli, Gentian Huti, Driola Hoxha
Departamenti i Anestezisë dhe Terapisë Intensive, Spitali Amerikan 3

Abstrakt

Hyrje: Covid-19 paraqet sfida të jashtezakonshme në ditët tona teksa pandemia mban ngërthyer botën. Në fillim u pa përfshirje e rëndësishme respiratore deri në insuficensë respiratore por me kalimin e kohës shfaqja e komplikacioneve të mevoshme jashtë mushkërive u bë evidente dhe shumë ndikim në prognozën e pacientëve.

Materiali dhe Metoda: Covid-19 është një sfidë për mjekët dhe personelin mjekësor. Si pasojë e hipoksisë së zgjatur shumë organe preken dhe dëmtohen më tepër sidomos nëse kanë dëmtime paraprake. Në këto kushte është shumë e rëndësishme që mjeku anestezist-intensivist të mbajë parasysh mundësinë e dëmtimit multiorganor.

Diskutimi: Komplikacionet mund të jenë pulmonare dhe jo pulmonare. Tek jo pulmonarët futen komplikacionet neurologjike, të cilat e kanë një incidencë rreth 6-36% dhe kryesisht në

formën e aksidenteve cerebrovaskulare ishemike, mioziteve dhe poliradikuloneuritë. Gjithsesi mund të hasen edhe komplikacione hemorragjike të shtratit vaskular cerebral. Komplikacionet kardiake përfaqësohen nga miokarditet me ulje funksioni dhe sindroma akute koronare të cilat kanë një incidencë rreth 20% me nundësi deri në 30% për insuficensë kardiake. Koagulapatite prezantohen në format trombotike në masë të madhe por sigurisht mund të hasen edhe forma të koagulimit të diseminuar intravascular dhe fenomene hemorragjike jetë kërcënuese si psh hemorragji intraalveolare. Incidenca e komplikacioneve hematologjike është raportuar në nivelet 11%. Ne 11-19% të pacientëve hasim insuficensë renale dhe për këtë arsye pacientët mund të jenë kandidatë terapi zëvëndësuese renale. Prizma Flex përdoret sidomos në pacientët me acidozë metabolike dhe crregullime elektrolitike të rënda që nuk trajtohen farmakologjikisht. Sepsis raportohet 3-6% të rasteve të rënda dhe disfuksioni organor është shumë i shprehur.

Konkluzion: Covid-19 është një sindrom në fakt sepse prek të gjitha organet. Në këto kushte mjeku nuk duhet të përqëndrohet vetem tek hipoksia dhe ana pulmonare por duhet të mbrojë edhe organet e tjera nga efektet hipoksike, sdm në rastet e sëmundjeve paraprake të organeve target.

Fjalë kyç: Sepsis, Covid-19, Insuficensa renale

EFEKTET E PANDEMISË COVID-19 NË TRAJTIMIN DHE MENAXHIMIN E PACIENTËVE ME PATOLOGJI TUMORALE NË NJESINË E KIMIOTERAPISË

Dr. Bledi Kreka
Shërbimi i Onkologjisë QSUT

Abstrakt

Pandemia Covid 19 pati një efekt të madh në të gjitha aspektet e funksionimit normal të shoqërisë. Shërbimit shëndetësor iu desh të përballonte një situatë të jashtëzakonshme
Ndikimi ishte i dukshëm edhe në trajtimin e kancerit duke e bërë të nevojshme ndryshimet në mënyrën tradicionale të vendim -marrjes.
Shfaqja e këtij faktori të ri me ndikim të madh në vdekshmëri pati ndikim në raportin kosto /përfitim të trajtimit antitumoral .
Kjo emergjence , në fillimet e saj ,i la mjekët dhe pacientët në kushtet e mungesës së evidencave të nevojshme ku bazohet praktika e përditshme e punës
Të dhënat e para nga Kina treguan një vdekshmëri më të lartë për pacientët me patologji malinje (case fatality rate 5.6 % vs 2,3 % për pacientet e tjerë)
Epidemia covid pati një efekt negativ në të gjithë aktivitetin normal të shërbimit tonë duke prekur të gjitha aspektet e trajtimin antitumoral,si në nivelin individual ashtu dhe sistemik
Mungesat e personelit të nevojshëm : nga virusi sars -cov 2 u prekën rreth 80 % e personelit duke shkaktuar mungesa dhe rritje të ngarkesës ditore të punës
Shqetësimi për të realizuar trajtimet sipas protokolleve të njohura duke ju përmbajtur rregullave që u lëshuan nga administrata dhe qeveria për mbajtjen nën kontroll të epidemisë
Shërbimi yne ka specifika të vecanta si për numrin e madh të trajtimeve ashtu edhe për mënyrën e organizimit të konsultave multidisiplinare që përbëjnë një kusht të domosdoshëm në trajtimin modern të kancerit .Numri i trajtimeve me kimioterapi që realizohen gjatë një viti në njësinë e kimioterapisë është mbi 17000 pa llogaritur numrin e konsultave ,të vizitave te kontrollit etj

Qe ne fillim te pandemise u be mjaft e nevojshme vleresimi i mundesise se reduktimit te fluksit te pacienteve qe normalisht duhet te levizin brenda hapesirave te sherbimit .

Fjalë kyç : Pandemia Covid 19 , emergjenca , kimioterapi.

MASTOCITOZA

Blerta Lame[1], Laerta Pupo[2]
[1] Alergologe-Imunologe Klinike, Klinikë Private, Tiranë
[2]Alergologe-Imunologe Klinike, Klinikë Private, Tiranë

Abstrakt

Mastocitoza përfshin një grup heterogjen sëmundjesh që karakterizohen nga rritje jo normale e numrit të mastociteve dhe grumbullimi i tyre në një ose më shumë sisteme (lëkure, trakti gastro-intestinal, hepar, lien, kocka etj)
Mund të shfaqet që në lindje ose në cfaredolloj moshe dhe nuk ka preferencë specifike për gjininë.Prek të gjitha rracat, me një përqindje pak më të lartë për kaukazet.
Janë raportuar forma familjare të mastocitozës (50-100 familje në të gjithë botën) dhe njëkohësisht është përshkruar dhe predispozimi genetik (polymorphism).
Dallojmë 2 kategori kryesore: mastocitoza kutane dhe mastocitoza sistemike, por ka dhe një kategori të vecantë si Sindromi I aktivizimit mastocitar që përmbledh ato forma qe nuk përmbushin kriteret tipike të dy formave të mësipërme.

Karakteristikat klinike: Simptomatologjia klinike është e lidhur ngushtë me sistemet dhe organet e prekura, dhe variojnë nga simptomat konstitucionale (lodhje, rënie në peshë, djerësitje, temperaturë), në simptomat të lidhura me mediatorët e cliruar, simptomat muskulo-skeletike (palcën e kockave, muskujt dhe ligamentet) etj.

Kriteret diagnostike: Sipas OBSH diagnoza e mastocitozës vendoset duke u mbeshtetur në kriteret madhore (infiltrate të mastociteve të dendura, multifokale në biopsinë e palcës së kockës, dhe /ose në organe të tjera), dhe ato minore (rritje e triptazes bazale, prezenca e mutacioneve të genit KITD816V etj)

Trajtimi: Bazohet në dy shtylla kryesore, atë të shmangies së faktorëve shpërthyes dhe atë simptomatike.

Fjalë kyç : Mastocitoza ,simptomatologjia klinike, mediatore.

PLACENTA INCRETA PARAQITET SI URGJENCË OBSTETRIKE. RAPORTI I RASTIT.

Daniela Nakuci[1], Erisa Kola[2], Leart Berdica[3], Ina Kola[4], Mehdi Alimehmeti[5]
[1]Departamenti i Patologjisë, Vlorë, Shqipëri.
[2]Departamenti i Patologjisë, Gjirokastër, Shqipëri.
[3]Universiteti i Mjekësisë, Universiteti i Tiranës, Shqipëri.
[4]Departamenti i Djegieve dhe Kirurgjisë Plastike, Tiranë, Shqipëri.
[5]Universiteti i Mjekësisë, Universiteti i Tiranës, Shqipëri.

Abstrakt

Hyrje: Placenta Increta është një gjendje e rëndë e shtatzënisë që ndodh kur placenta rritet thellë në muret e mitrës duke zënë muskujt e saj. Janë të njohura tre variante të implantimit jonormal të placentës: Acrreta, Increta dhe Percreta të cilat janë një nga shkaqet kryesore të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë amtare. Nëse gjendja diagnostikohet herët në shtatzëni, atëherë është e nevojshme një lindje me operacion, e ndjekur nga një histerektomi. Incidenca e këtyre gjendjeve është rritur ndjeshëm nga 2-90 për 10.000 në 30 vitet e fundit, fenomen që i atribuohet rritjes së shkallës globale të seksionit cezarian. Diagnoza e kësaj gjendje bëhet nëpërmjet ekzaminimit histopatologjik kur i gjithë trajtimi tjetër konservativ ka dështuar dhe pas një ekzaminimi të mirë imazheral ku një rol të rëndësishëm luan MRI. Placenta previa increta i referohet një gjendjeje kur gjatë ekzaminimit mikroskopik vihet re mungesa e deciduas dhe prania e vileve korionike brenda miometrit.

Objektivi: Në studimin aktual, ne raportojmë një rast të placentës increta që paraqet urgjencë obstetrike. -Një grua 30-vjeçare u paraqit në urgjencën obstetrike me gjakderdhje vaginale në javën e 34-35 të shtatzënisë me një ndjekje të rregullt antenatale.

Rezultatet: Në fazën intraoperative mendohet të ketë ndodhur një implantim jonormal i placentës dhe pas lindjes është marrë një vendim urgjent për histerektominë. Mitra është sjellë në laboratorin patologjik për ekzaminim të mëtejshëm histopatologjik. Ekzaminimi mikroskopik i kampionit tregoi një lezion që infiltroi endometriumin duke u shtrirë në më shumë se gjysmën e miometriumit në prani të membranës placentare. Miometriumi ishte holluar. Fibrina dhe trofoblasti ekstravilloz ishin të pranishëm midis vileve dhe fibrave miometriale.

Përfundime: Placenta increta por edhe gjendje të tjera të këtij spektri janë kërcënuese për jetën si për nënën ashtu edhe për foshnjën. Kontrollet e rregullta gjatë shtatzënisë janë jashtëzakonisht të rëndësishme veçanërisht për nënat me rrezik të lartë me palcenta previa dhe lindje cezariane të mëparshme. Histerektomia mbetet një procedurë e zakonshme. Ky rast nxjerr në pah nevojën për kërkime të mëtejshme në zbulimin e hershëm dhe ndjekjen e kujdesshme të këtyre gjendjeve për të parandaluar hemorragji masive dhe komplikime serioze.

Fjalë kyç: Spektri i placentës previa, cezariani, histerektomia, hemorragjia obstetrike, placenta increta.

MIOKARDITI INFEKTIV, KARDIOMIOPATIA INFLAMATORE DHE COVID 19

Tobias Taga[1], Dr. Shk.Daniela Teferiçi[2]
[1]Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
[2]Departamenti i Kardiologjisë-Kardiokirurgjisë, QSU "Nënë Tereza", Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Miokarditi është një sëmundje inflamatore e miokardit. Kardiomiopatia inflamatore është shoqërimi i miokarditit me disfunksionin kardiak. Paraqitja klinike e miokarditit është e larmishme e cila varion nga forma të lehta, asimptomatike, pa evidencë të disfunksionit sistolik e deri në kardiomiopati të dilatuara të prezantuar në formën e insuficencës së rëndë kardiake. Përmirësimi spontan vërehet në 50% të rasteve me miokardit të provuar me biopsi ndërsa regresi drejt kardiopatisë së dilatuar ndodh deri në 21% të rasteve. Pavarësisht

dyshimit klinik asnjë ekzaminim nuk është specifik për format e lehta të miokarditit. Në pandeminë e COVID-19 u vu re që deri në 30% e pacientëve të hospitalizuar kishin evidencë të prekjes në komplikacionet kardiake tek pacientët me COVID -19 miokarditi renditet i treti pas sindromit koronar akut dhe takiaritmive atriale.

Prezantimi i rastit : Një 44 vjeçar hospitalizohet në kushtet e historisë 3 javore me dispne progresive dhe dhimbje gjoksi. Pa faktore risku. Paraqitet në spital me hipotension, sat O2 85%, me rale deri në fushat e mesme. Në EKG bllok dege të majtë. Në radiografi kraharori vërehen shenjat e edemës pulmonare. Të dhënat laboratorike asgjë me rëndësi. Eko hipokinezi difuze. Mendohet për një infarkt akut të miokardi të komplikuar me edemë pulmonare dhe shok kardiogjen. Në kushtet e mësipërme vendoset që pacienti të kryejë koronarografinë. Koronarografia nuk tregon stenoza të rëndesishme. Bazuar dhënat e reja u mendua për miokardit akut fulminant. Një histori më e detajuar tregoi që ai në ditët përpara paraqitjes në spital ankohej për simptoma gripale si temperaturë, kollë, mialgji, lodhje, faringalgji. Filloi terapia standarte e insuficiencës kardiake si dhe u vendos ICD. Pas 3 javësh ai del nga spitali për tu ndjekur më tej si insuficiencë kardiake.

Konkluzioni: Shumica e formave kanë prezantime të lehta, jo specifike fatmirësisht format me prenzantim me insuficencë kardiake dhe shok kardiogjen janë të rralla por me prognozë të varfër. Diagnoza në shumicën e rasteve vendoset bazuar në klinikë, anamnezë, EKG, enzimat kardiake si dhe resonancë kardiake megjithatë standarti i artë mbetet biopsia endomiokardiale e cila kryhet rrallë.

Fjalët kyç: miokardit, kardiomiopati, covid-19.

KARDIOMIOPATIA POSTPARTUM DHE DISA VLERËSIME MBI USHQYERJEN ME GJI

Daniela Teferiçi[1]
[1]Departamenti Kardiologji – Kardiokirurgji, QSUT

Abstrakt

Kardiomiopatia Postpartum (KMPP) është një diagnozë përjashtuese, ku pacientja paraqitet me insuficiencë kardiake si pasojë e disfunksionit sistolik të VM rreth fundit të barrës ose në muajt pasues pas lindjes, pa shkak tjetër të njohur për insuficiencën kardiake. KMPP është relativisht e rrallë, dhe prek midis 1 në 5000 dhe 1 në 10000 lindje, mendohet të ketë prevalencë më të rritur në gra mbi 30 vjeç, racë të zezë, histori për pre-eklampsi apo hipertension të induktuar nga shtatëzania dhe tek gratë me shtatëzani multiple. Simptomat mund të jenë të padallueshme nga ato të shtatëzanisë normale, me gra që paraqiten me dispne, orthopne dhe ulje të kapacitetit ushtrimor. Ekzaminimi fizik, RO grafia toraxit dhe ekokardiografia janë zakonisht konsistente me diagnozën e insuficiencës kardiake dhe nivelet e peptidit natriuretik (BNP) e troponins, janë zakonisht të rritura. Ecuria klinike varion në mënyrë të konsiderueshme, me disa pacientë që avancojnë drejt endstage të insuficiencës kardiake brenda pak ditësh nga fillimi i simptomave. Në mënyrë të ngjashme rekuperimi i funksionit të VM është variabël dhe mund të ndodhë edhe spontanisht. Manaxhimi i insuficiencës kardiake stabël apo akute në KMPP duhet të fokusohet në kontrollin e kongjestionit, përgjigjeve neurohormonale dhe uljen e riskut për komplikacione tromboembolike apo aritmi. Ndërkohë që rrugët e trajtimit të insuficiencës kardiake janë tashmë të vendosura, duhet të merren parasysh implikimet tek foshnjat nënat e të cilëve kanë vendosur ti ushqejnë me gji pavarësisht se janë nën farmakoterapi për insuficiencën kardiake. Pothuajse të gjithë medikamentet do të kalojnë në qumështin e gjirit në një farë mase,

megjithëse niveli kalimit zakonisht është i ulët. Shumë faktorë ndikojnë në përqëndrimin e medikamentit në qumësht: që mund të jenë të lidhura me medikamentin (doza, biodisponibiliteti, tretshmëria në lipide, lidhja me proteinat, pesha molekulare, ½ jeta, metabolitet aktive dhe mekanizmi i eliminimit), të lidhura me nënën (doza maternale, farmakogjenetika si dhe funksioni renal dhe hepatik). Gjithashtu, efektet anësore të një medikamenti duhet të merren në konsideratë pasi mund të shfaqen edhe në foshnjën e ekspozuar ndaj tyre.

Fjalët kyç: kardiomiopatia, ushqyerja me gji, postpartum.

APLIKIMI I CELL BLOCK NË VERSAMENTET PLEURALE MALINJE

Daniela Xhemalaj[1], Fatmir Caushi[1], Ilir Skenduli[1], Fadil Gradica[1], Lutfi Lisha[1], Elona Xhardo[1], Leart Berdica[2].
[1]*Spitali Universitar 'Shefqet Ndroqi",Tiranë*
[2]*Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i anatomisë patologjike, Tiranë.*

Abstrakt

Tek pacientët me versamente pleurale, studimi citologjik, luan një rol të rëndësishëm, krahas analizave kliniko-biokime dhe mikrobiologjike, vecanerisht në rastet e suspektuara për malinjitet. Udhërrëfyesit nga ACCP (American College of Chest Physicians) dhe BTS (British Thoracic Society) rekomandojnë ekzaminimin citologjik nga dy kampione të likideve pleurale(1). Afërsisht 1.5 milion pacientë me efuzione pleurale diagnostikon cdo vit në SHBA(2). Sensitiviteti i ekzaminimit citologjik varion nga 40-87%(3,4,5), për dedektimin e efuzioneve pleurale malinje. Rritja e saktësisë diagnostike në versamentet pleurale malinje, rritet edhe me aplikimin e teknikës cell-block.

Qëllimi i studimit tonë është të evidentojë rëndësinë e aplikimit të cell block, te pacientët me versamente pleurale malinje, duke rritur kosto-efektivitetin diagnostik, duke minimizuar procedurat invasive bioptike. Është një studim retrospektiv, për pacientët me versamente pleurale malinje të hospitalizuar në spitalin Universitar" Shefqet Ndroqi". Krahas strishove konvecionale me H-E,Giemsa, u realizua dhe cell-block, duke e shndërruar likidin në një material bioptik, në bllok parafine, duke gjykuar për prezencën e qelizave tumorale dhe përcaktuar histogjenezën nëpërmjet konfirmimit me ngjyrimet imunohistokimike. Në 90% të rasteve lezionet ishin me natyrë karcinomatoze (Adenocarcinoma pulmonare, carcinoma ductale invasive gl. mame). Pjesa tjetër rezultuan me origjinë nga melanoma ose sarcoma.

Fjalë kyç: versament pleural malinj, cell block.

PANKREATITI AKUT

Dariel Thereska[1],Savio Dosti[2]

Abstrakt

Hyrje:Sëmundjet inflamatore të pankreasit mund të klasifikohen kohën si më tej ,pankreatiti akut ,pankreatiti akut recidivues ,pankreatiti kro-nik recidivues, dhe pankreatiti kronik.
Pankreatiti akut është një proces inflamator akut i pankreasit i cili duhet të suspektohet tek pacientët me dhimbje të forta akute të abdomenit superior por që kërkon evidencë radiologjike dhe biokimike për vendosjen e diagnozës.

Pankreatiti akut shkaktohet nga një numër i madh faktorësh etiologjike. Por mekanizmat që ndërhyjnë në lindjen e inflamacionit të pankreasit ende nuk njihen plotësisht. Në një grup të veçantë futen pankreatitet akute me natyrë alkoolike, pasi shumica dërrmuese e personave që përdorin alkool nuk sëmuren nga pankreatiti. Lista e faktorëve të vërtetuar si shkaktarë të pankreatitit akut po rritet vazhdimisht.
Tashmë mendohet se shkaktarët më të shpeshtë janë infeksionet virale dhe medikamentet.

Metoda: Ky studim përshkruan ,etiologjinë dhe patogjenezën e sëmundjes ,shkaqet e pankreatitit akut ,shenjat klinike ,faktorët rendues që ndikojnë në prognozën e pankreatitit akut ,diagnoza, ecuria e sëmundjes dhe nderlikimet ,mjekimi.

Përfundimi: Rekomandohet diagnostikimi i hershëm me qëllim trajtimin në kohë dhe parandalimin e komplikacioneve. Identifikimi dhe ulja e ekspozimit ndaj faktorëve të riskut

Fjalë kyç : Pankreatiti akut , infeksione virale , proces inflamator.

KIRURGJIA DHE PANDEMIA GLOBALE SARS – COVID 19

Dr. Med. Dariel Thereska, Ass. Prof Enton Bollano, Kosta Gjyli, Aleksandro Mako, Prof. Arben Gjata

Abstrakt

Ky prezantim ka për qëllim të paraqesi një pjesë të zbulimeve dhe rezultateve të rëndësishme të korrura nga një rrjet multifunksional kirurgësh të quajtur Globalsurg. Globalsurg Collaborative është themeluar për të përfaqësuar kirurgë nga e gjithë bota. Ato kryejnë studime ndërkombëtare për rezulatet kirurgjikale duke bashkëpunuar me rrjete lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Rrjeti aktual Globalsurg përfshin mbi 5000 mjek klinik në mbi 100 shtete. Të gjithë të dhënat janë mbledhur gjatë një jave, falë një projekti ndërkombëtar të quajtur CovidSurg Week. Projekti i mbipërmendur përbëhet nga një kohorte multifokale që ka për qëllim:
-Të përcaktojë tempizmin optimal për kryerjen e një operacion kirurgjikal pas një infeksioni nga SARS-CoV-2.
-Të përcaktojë indikatorët kirurgjikal global, si vdekshmëria postoperatore.
Pjesëmarrja në këtë projekt kaq të gjerë dhe të rëndësishëm ishte një nder shumë i madh për ne. Disa nga zbulimet më të rëndësishme janë tashmë pjesë e linjave drejtuese kirurgjikale në të gjithë botën dhe ne do ti listojmë artikujt së bashku me revistat ku janë botuar. Qëllimi i këtij studimi ka qenë përcaktimi i kohëzgjatjes së vonesës së planifikuar për operacionin kirurgjikal të pacientëve pas një infeksioni nga SARS-Cov2. Duke marrë në konsideratë se rreziku i pacientëve kirurgjikal për tromboemboli venose është më i konsiderueshëm se përgjithsësisht, ky studim pati qëllim të qartësonte nëse rreziku për një pacient, pas një infeksioni me SARS-Cov2, do të ishte më i lartë. Një vaksinim preoperator për SARS-Cov2 lehtëson një përzgjedhje më të sigurtë të pacientëve. Numri i vaksinave është i limituar, prandaj ky studim ka për qëllim të qartësojë dhënien e përparësisë bazuar në një model. Ky studim pati për qëllim përcaktimin e impaktit të izolimit pre-operator në komplikimet pulmonare postoperatore, pas një përzgjedhje të pacientëve gjatë pandemisë globale SARS-Cov2.

Fjalët kyç: kirurgji, pandemia, covid-19.

DIAGNOZA LABORATORIKE E COVID 19. SITUATA AKTUALE NË PERGJIGJË TË KONTROLLIT TË PANDEMISË DHE PRESPEKTIVA E SË ARDHMES.

Denada Lacej, Andi Koraqi, Rea Karafili, Fatjon Cuko
Universiteti i Mjekësisë, Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Mikrobiologjisë Tiranë – Shqipëri

Përhapja me shpejtësi në përmasa pandemie e koronavirusit të 2 të sindromës së rëndë akute respiratore (SARS-CoV-2) dhe sëmundjes se lidhur me të (COVID-19) ka rritur kërkesat e sistemet e kujdesit shëndetësor për kontrollin dhe menaxhimin e saj. Një nga çështjet me kritike që duhet adresuar është përmirësimi i diagnozës laboratorike dhe shqyrtimi i një pjese të madhe të popullsisë për të ndaluar përhapjen e virusit.

Aktualisht, diagnoza laboratorike e infeksionit SARS-CoV-2 dhe sëmundjes Covid 19, të lidhur me te bazohet në kerkimin dhe dedektimin e ARN-së virale me metoda te rt-PCR në materialin klinik te marre ne rrugët e sipërme dhe të poshtme të respiratore.

Testet serologjike qe sherbejne për të zbuluar antitrupat anti - SARS-CoV-2 mund të ndihmojnë mjekët dhe punonjësit e kujdesit shëndetësor të mbështesin diagnostikimin dhe te bejne ndjekjen e hecurise se COVID-19.

Permbledhja e pergjitheshme paraqet njohuritë aktuale të testeve direkte qe perdoren për të dedektuar ARN virale dhe ato serologjike të kryera per te zbuluar pranine dhe vleresimin e titrit te antitrupave anti-SARS-CoV-2 me qellim vlerësimin dhe analizimin e avantazheve dhe disavantazheve te ketyre testeve specifike.

STUDIMI KLINIK MBI EFIKASITETIN JO-INFERIOR MIDIS TABLETAVE ME 600 MG DIOSMINË TË PAMIKRONIZUAR DHE TABLETAVE MPFF 1000 MG NË SËMUNDJEN VENOZE KRONIKE.

Denis Kosovrasti

Abstrakt

Qëllimi: Të demonstrohet efikasiteti klinik jo-inferior dhe të vlerësohet pranueshmeria e tabletave orale me diosminë 600 mg të pamikronizuar vs tabletave orale me 900 mg diosminë e mikronizuar + 100 mg hesperidinë në simptomat venoze në pacientë që vuajnë nga Sëmundja Venoze Kronike.

Metoda: Studim njëfish i fshehtë, rastësor, në grupe paralele, multicentrik (në 6 universitete).

Kohëzgjatja: 6 muaj.

Pjesëmarrës: 120 pacientë.

Skema : 4 vizita flebologjike (M0, M2, M4, M6), Telefonata (M1, M3, M5).
Simptomat klinike që u vlerësuan: Rëndesa në këmbë, dhimbja në këmbë, lodhja në këmbë, enjtja/ tensioni në këmbë.
Vlerësimi me një shkallë vizuale analoge globale 100 mm (VAS).
U krahasua: Pranueshmëria orale me shkallë VAS 100 mm, pëlqyeshmeria totale e pacientit (e keqe, e pranueshme, e mirë, shumë e mirë), pëlqyeshmëria totale e mjekut (e keqe, e pranueshme, e mirë, shumë e mirë).

Rezultatet: Tabletat me diosminë 600 mg janë po aq efikase sa tabletat me MPFF 1000 mg në lehtësimin e simptomave venoze.
Tabletat me diosminë 600 mg janë dukshem më të lehta për t'u gëlltitur krahasuar me tabletat me MPFF 1000 mg.
Pëlqyeshmëria e përgjithshme e pacientëve favorizon tabletat me diosminë 600 mg.
Siguria e përgjithshme ishte e mirë për të dy barnat.

Fjalë kyç: diosminë, sëmundje venoze kronike.

SHKAQET E INSUFIÇIENCËS RENALE KRONIKE NË FËMIJËT SHQIPTARË.

[1]Diamant Shtiza, [2]Erida Zabuni, [2]Brisilda Derstila, [3]Enkelejda Shkurti
[1]Departamenti i Pediatrisë, Shërbimi i Nefrologjisë, QSUT "Nënë Tereza".
[2]Studente e Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë.
[3]Lektore e Statistikës, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt

Hyrje: Insufiçienca renale kronike (IRK) është një problem me shtrirje botërore, shkaqet e të cilës në fëmijë dallojnë nga ato të të rriturve.

Materiali dhe metoda: Qëllimi i këtij studimi është identifikimi i shkaqeve madhore që çojnë në insufiçiencën renale kronike në moshën pediatrike. Për përcaktimin e këtyre shkaqeve, paraqitjen klinike, ecurinë, dhe rezultatet e IRK në fëmijë ne realizuam një studim prospektiv nga Janari 2011 deri në Mars 2014 në repartin e nefrologjisë dhe dializës në Qendrën Universitare "Nënë Tereza" në Tiranë.

Rezultatet: Tridhjetë pacientë me shkallë të ndryshme të dëmtimit renal u përfshinë në studim. Prej tyre, 10 fëmijë (33,3%) patën nefropati obstruktive si shkak të IRK, 17 fëmijë (56,7%) patën nefropati jo-obstruktive, ndërsa shkaku mbeti i panjohur në 3 pacientë (10%). Vezika neurogjene dhe valvula e uretrës posteriore ishin shkaku më i zakonshëm i nefropatise obstruktive, që u konstatuan në 4 pacientë në secilën nga patologjitë (13,3%), nefrolitiaza dhe obstruksioni pielo-ureteral u konstatua me nga 1 rast secila (3,3%). Nefropatia nga refluksi ishte shkaku më i zakonshëm i nefropatisë që u konstatua në 12 pacientë (40%). Glomerulonefriti u konstatua në 3 raste (10%); hypodisplasia renale dhe nefrokalcinoza u konstatua nga një rast secila (3,3%).

Përfundime: Nefropatia nga refluksi është shkaku më i rëndësishëm i insufiçiencës renale kronike në fëmijët shqipëtarë. Shkaqet urologjike mbeten një problem i zakonshëm i sëmundjes kronike renale.
Fjalë kyç: insufiçienca renale kronike, refluksi veziko-ureteral.

INFEKSIONI URINAR, REFLUKS VEZIKO-URETERAL DHE ROLI I SHINTIGRAFISË RENALE STATIKE NË MOSHËN PEDIATRIKE

Diamant Shtiza[1], Brisilda Derstila[2], Erida Zabuni[2], Enkelejda Shkurti[3], Albert Lama[4]

[1]Departamenti i Pediatrisë, Shërbimi i Nefrologjisë, QSUT "Nënë Tereza"
[2]Studente e Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë
[3]Lektore e Statistikës, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Tiranë, Shqipëri
[4]Departamenti i Pediatrisë, Shërbimi i Urgjencës, QSUT "Nënë Tereza"

Abstrakt

Hyrje: Shintigrafia renale statike me 99mTc-DMSA aktualisht konsiderohet metoda e referimit për diagnozën e dëmtimit renal parenkimal fokal si pasojë e pielonefritit.

Qëllimi: Vlerësimi i lidhjeve që ekzistojnë midis shkallës së refluksit veziko - ureteral (RVU) të diagnostikuar përmes cistografisë miksionale dhe alterimeve në shintigrafinë renale statike me DMSA.

Materiali dhe metoda: Gjatë periudhës 3 vjecare (2012-2015), janë diagnostikuar me anë të cistografisë miksionale standarte 153 femijë me RVU të moshës nga 1 muaj – 15 vjeç, nga të cilët 60 meshkuj e 93 femra me një raport F:M = 1,55:1. Shintigrafia e cila u krye 2-3 orë pas injektimit të lëndës së kontrastit 99mTc-DMSA, vlerësoi në mënyrë cilësore dhe sasiore nëpërmjet pozicioneve anteriore, posteriore dhe oblike posteriore, majtas e djathtas, gjëndjen funksionale të veshkave (në përqindje respektive) në bazë të fiksimit të gjurmuesit i cili u shpreh normal në rastet kur gjurmuesi ishte i fiksuar uniformisht, si dhe u konsiderua si cikatrice apo scar zona me fiksim të dobët të gjurmuesit e cila u shfaq si zonë e vetme hipofiksuese apo multiple.

Rezultatet: U kostatuan 33 RVU dekstra, 31 RVU sinistra dhe 89 RVU bilaterale për një total prej 242 njësi refluente. Përsa i takon grupmoshave 49 fëmijë i përkisnin moshës 0-1 vjeç, 63 fëmijë moshës 1-4 vjeç dhe 41 fëmijë moshës mbi 4 vjeç. Sipas shkallës së RVU u gjetën 45 njësi refluente të shkallës parë, 104 të shkallës dytë, 54 të shkallës tretë, 30 të shkallës katërt, 9 të shkallës së pestë. 50% ishin banorë të Tiranës, 50% banorë të rretheve të ndryshme. Nga 153 fëmijët me RVU vetëm 72 prej tyre kanë kryer një shintigrafi renale me DMSA. 45 (62,5%) u gjetën me scar, prej tyre 34 (47,2%) me scar multiple, 11 (15,2%) me një scar, 27 shintigrafi (37,5%) pa scar. Shkalla e parë e RVU: 5 shintigrafi pa scar, shkalla 2 e 3 u gjetën 23 me scar dhe 20 pa scar, shkalla e katërt 15 me scar e 2 pa scar, shkalla e pestë 7 shintigrafi të gjitha me scar multiple.

Konkluzion: Vetëm shkalla e parë e RVU nuk paraqet scar, ndërkohë që shkalla e pestë paraqet gjithmonë scar multiple. Shkallët 2, 3, 4 paraqesin scar fokal e multiple në më shumë se 50% të rasteve. Si rrjedhim rekomandojmë që të kryhet shintigrafia renale statike me DMSA në të gjithë fëmijët me RVU të shkallës 2-5, si dhe në ata që kalojnë pielonefrit akut gjatë vitit të parë të jetës.

Fjalët kyç: infeksioni urinar, refluks, shintigrafia.

HEMATURIA NË MOSHËN PEDIATRIKE: PËRVOJA E SHËRBIMIT TË NEFROPEDIATRISË.

Diamant Shtiza[1], Jorgjia Bucaj[2], Lorena Sila[2]
[1]Departamenti i Pediatrise, Sherbimi i Nefrologjise, QSUT "Nene Tereza"
[2]Specializante e Pediatrise, Departamenti i Pediatrise, QSUT "Nene Tereza"

Abstrakt

Hematuria, e cila mund të jetë makroskopike ose mikroskopike, është një simptomë e zakonshme tek fëmijët. Ndryshe nga të rriturit, hematuria tek fëmijët pothuajseasnjëherë nuk shoqëron një patologji malinje. Diagnoza diferenciale është e gjerë, ku infeksioni, glomerulonefriti dhe hiperkalciuria janë shkaqet më të zakonshme. Është e rëndësishme të bëhet diagnoza diferenciale midis patologjive të traktit të sipërm urinar dhe patologjive të traktit të poshtëm urinar.

Qëllimi: Synimi i këtij prezantimi është të ofrojë një pasqyrë aktuale lidhur me hematurinë në shërbimin e Nefropediatrisë, duke përfshirë shkaqet më të zakonshme, diagnozën dhe trajtimin sipas etiologjisë.

Fjalë kyç: hematuri, moshë pediatrike, nefropediatri.

RED MAN FACE" PREJ LUPUS DISCOID, TINEA FACEI, MYCOSIS FUNGOIDE.

Dorina Demaj[2], Prof. As. Monika Fida[1]
[1] Departamenti i Dermatologjisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë i Tiranës, Shqipëri
[2] Njësia e Dermatologjisë, Spitali Hygea, Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt

Hyrje: Eritrodermia e lokalizuar në fytyrë është një manifestim i lëkurës për shkak të sëmundjeve të ndryshme të lëkurës si tinea facei, lupus discoid, mycosis fungoide, psoriasis, dermatiti seborrheik, dermatiti alergjik i kontaktit.

Qëllimi i prezantimit: Të tregojë disa raste klinike të diagnostikuara dhe trajtuara në Departamentin e Dermatologjisë UHCT "Nënë Tereza" me Eritrodermi të fytyrës të diagnostikuar si më poshtë: Lupus Discoid, Dermatit Seborrheic, Psoriasis Vulgaris, Mycosis Fungoide, Tinea facei. Për të theksuar veçoritë klinike, diagnozën e ndryshme dhe protokollin e trajtimeve të këtyre rasteve.

Rezultatet: "Red Man Face" është një term që mund të përfshijë sëmundje të ndryshme të lëkurës por të gjitha manifestohen me njolla skuamoze eritematoze, edemë, papula në fytyrë. Diagnozat e sakta vendosen në bazë të karakteristikave klinike, biopsisë dhe analizave laboratorike. Trajtimi bazohet në protokolle të përditësuara për çdo sëmundje.

Përfundim: Një grup patologjish manifestohen si "Burri me fytyrë të kuqe" dhe këto sëmundje duhet të diagnostikohen drejt. Për diagnozën e saktë janë të nevojshme karakteristika të ndryshme klinike, teste laboratorike dhe biopsi të lëkurës. Trajtimi bazohet në regjimet personale dhe protokollet e përditësuara të trajtimit.

Fjalët kyç: Fytyrë e kuqe, Lupus Discoid, Tinea facei, Dermatiti Seborrheik, Psoriasis, Mycosis Fungoide.

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE E SËMUNDJEVE MALINJE NË SHQIPËRI ,2015-2019

Dorina Toçi[1], Alban Ylli[1,2], Eugena Tomini[1].
[1]*Insituti i Shëndetit Publik, Tirana, Shqipëri*
[1]*Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tirana, Shqipëri*

Abstrakt

Kanceri është shkaku i dytë kryesor i vdekjeve pas sëmundjeve kardiovaskulare në nivel global. Në vitin 2020 llogariten rreth 10 milion vdekje, ose një në gjashtë vdekje nga kanceri në botë. Çdo vit, 3.5 milion njerëz në Bashkimin Evropian diagnostikohen me kancer dhe 1.3 milion vdesin prej tij. Sëmundshmëria është matur nëpërmjet nivelit të incidencës dhe nivelit të shtrimeve spitalore. Të dhëna mbi rastet e reja të diagnostikuara çdo vit bazohen në regjistrin kombëtar të kancerit. Vdekshmëria nga kanceret raportohet nga INSTAT. Pandemia nga Covid-19 gjatë 2020, ashtu si në të gjithë botën, ka shkaktuar një ulje të përdorimit të shërbimeve shëndetësore dhe të nivelit të rasteve të reja të diagnostikuara me kancer. Për këtë arsye analiza epidemiologjike e situatës së kancereve në vendin tonë i referohet periudhës 2015-2019. Kanceret më të shpeshtë të diagnostikuar në Shqiperi janë kanceri i mushkërive (29.7/100000 për vitin 2019), kanceri i gjirit (50.3/100000 gra viti 2019) dhe kanceret e lëkurës (34.8/100000 viti 2019). Kanceret e mësipërme përbëjnë 40% të të gjitha kancereve të raportuara nga sistemi shëndetësor. Në tre vitet e fundit incidenca e kancereve te meshkujt është në mënyrë të qëndrueshme më e larte se te femrat. Incidenca e kancereve është më e lartë në rajonet e Gjirokastrës, Fierit, Beratit dhe Tiranës. Shtrimet spitalore nga kanceret kanë ardhur në rritje të vazhdueshme si për meshkujt edhe për femrat. Nga viti 2015 në 2019 shtrimet u rritën me mbi 70%. Kanceret ngelen shkaku i dytë më i rëndësishëm i vdekjeve në vendin tonë (16% të të gjithë vdekjeve). Niveli i vdekshmërisë së parakohshme nga kanceri (grupmosha 30-69 vjeç) është ulur nga viti 2012 në 2019 (respektivisht 137.9 dhe 121.8 për 100000 banorë). Niveli i standartizuar i vdekshmërisë për moshën është ulur nga 89.4 për 100000 në vitin 2015, në 77.9 për 100000 në vitin 2019. Regjistri i kancerit ofron një informacion të detajuar mbi situatën e sëmundjeve malinje në vendin tonë i cili shërben për marrjen e vendimeve të drejta në politikat shëndetësore në drejtim të kontrollit dhe parandalimit të kancerit.

Fjalë kyç : vdekshmëria , shtrimet spitalore.

AKTUALITET MBI KANCERIN E DIFERENCUAR TË TIROIDES. SFIDAT DIAGNOSTIKE DHE TRAJTIMI.

Martiola Kola, Dorina Ylli, Edlira Elezaj, Ira Xhemollari, Pranvera Spahija, Albana Dulovic, Agron Ylli, Xheladin Dracini.
Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza".

Abstrakt

Hyrje: Kanceri i tiroides është ndër patologjitë malinje më të shpeshta endokrine. Në dekadat e fundit është vënë re një trend global ne rritjen e incidences së këtij lloj kanceri. Është ende në diskutim nëse kjo është një rritje reale apo është rritje si pasojë e aksesit më të mirë në instrumete diagnostike si ekografia. Ndonese është më i shpeshtë tek femrat kur haset tek meshkujt ka nje prognozë më pak te mire. Aktualisht, nga shpeshtësia renditet si kanceri i pestë me i shpeshtë tek grate dhe ndër më të shpeshtit tek femrat nën 25 vjec. Rreth 90% i gjithë kancereve të tiroides janë variant papilar, 4% variant folikular, 1.5% Hurthle cell, 1.5% medular dhe 1% anaplastik.

Materiale dhe Metoda: Në studim do te paraqiten të dhëna nga pacientet e diagnostikuar me karcinomë të tiroides pranë Qendres Spitalore Universitare "Nënë Tereza" (QSUNT). Do të ofrohet një panoramike mbi moshën, gjininë, klasifikimin e kancerit të tiroides dhe stratifikimi sipas riskut. Do te analizohet lloji i kirurgjisë së aplikuar, terapia me iod radioaktive, radioterapinë dhe terapitë më të reja me inhibitorët e tirozin kinazës. Gjithashtu do të paraqiten të dhëna për ndjekjen dhe ecurinë në vite të pacienteve duke u bazuar në recidive strukturore dhe prezencë biokimike e markuesve tumoral specifik.

Rezultatet: Në 50 pacientë të diagnostikuar me kancer të tiroides pranë QSUNT, 44 ishin femra dhe 6 meshkuj. Mosha mesatare e femrave ishte 47,3 vjec dhe mosha mesatare e meshkujve ishte 39,6 vjec. Karcinoma papilare e tiroides ishte varianti më i shpeshtë 70% (35/50), i ndjekur nga karcinomë varianti folikular 28% (14/50) dhe 2% (1/50) variant Hurthle cell. Në analizën histopatologjike 10% e pacienteve kishte invazion limfatik, 12 % invazion vaskular dhe 1 pacient kishte metastaza në momentin e diagnostikimit. Tiroidektomia totale u aplikua tek të gjithë pacientet, ashtu si dhe iodi radioaktiv (I131). Mesatarja e tireoglobulines para terapisë me I131 ishte 28.9 µg/L dhe pas I131 u ul ne 1.1 µg/L. Në follow up, vetëm dy pacient kanë ende përstistence të sëmundjes.

Konkluzionet: Kanceri i tiroides është nje ndër kancerat më të shpeshtë me patologjitë endokrine. Në Shqipëri ashtu si dhe në botë ka një prevalencë më të lartë tek femrat, por në të dy gjinitë, ruan një prognozë të mirë.

Fjalë kyç: kancer, tiroide, patologji malinje.

AKSIDENTET CEREBROVASKULARE ISHEMIKE PAS COVID-19.

Driola Hoxha, Gentian Huti, Asead Abdyli
*Departamenti i Anestezis*ë *dhe Terapis*ë *Intensive, Spitali Amerikan 3, Tirana, Albania*

Abstrakt

Hyrje: Trajtimi i pacientëve me probleme cerebrovaskulare është kompleks dhe kërkon bashkëpunim multispecialistik. Kujdesi për këto pacientë në terapi intensive është vazhdim i kujdesit në salle dhe konsiston në monitorizimin e ngushtë neurologjik, kujdesin për hemodinamikën, përdorimin ose jo të antikoagulantëve, dhe kujdesin e përgjithshëm si për çdo pacient të terapisë intensive.

Materiali dhe Metoda: Monitorizimi i sferës neurologjike shërben për të parë se si shkojnë ndryshimet neurologjike egzistuese dhe nëse ka apo jo defiçite të reja. Mjeku në terapi intensive duhet të ketë njohuri mbi teknikën anestetike, procedurën neurologjike të kryer, deficitet paraprake dhe sigurisht edhe prognozën e pacientit. Vlerësimi neurologjik bëhet çdo 2-4 orë dhe në rast përkeqësimi apo shfaqje të re defiçit njoftohet ekipi i neurologji-neuroradiologji si edhe mund të kërkohen egzaminime imazherike shtesë. Kujdesi për hemodinamikën është shumë i rëndësishëm.

Diskutimi: Në rastet e pathologjive ishemike/trombectomive/stendeve në karotide, është e preferueshme të mbahen presione arteriale 140-180 mmHg. Në rastet e embolizimeve ose me rrezik të lartë ndaj hemorragjisë tentohen presione të ulta arteriale në rangun e 100-110 mmHg. Vlen të theksohet se vlerat e përshkruara të presioneve vendosen edhe duke u bazuar mbi pacientin/procedurë/sëmundjet shoqëruese dhe në bashkëpunim të plotë midis specialistëve që janë të përfshirë. Trajtimi i lezioneve ishemike apo trombectomive si edhe vendosja e stendeve kërkon edhe përdorimin e antiagregantëve dhe/ose antikogulantëve. Kujdes i vecantë duhet treguar nëse është bërë paraprakisht tromboliza. Në kujdesin e përgjithshëm merr rëndësi parandalimi i ulcerave të stresit, aktivizimi sa më i shpejtë i pacientit, nutricioni, evitimin e dekubituseve, si edhe kujdesi për evitimin e komplikacioneve respiratore.
Konkluzioni: Së fundi duhet theksuar që puna në terapi intensive për këta të sëmurë përfshin një sërë specialitetesh, bashkëpunimi i ngushtë i të cilëve mund të përmirësojë ecurinë e pacientit.

Fjalë kyç: Covid-19, ishemi cerebrale, hemorragji cerebrale.

NJË VËSHTRIM EPIDEMIOLOGJIKO – KLINIK I BRUCELOZËS GJATË VITEVE 2017-2021.

D. Rami, P. Pipero, A. Harxhi, Sh. Kurti, E. Ramosaço

Abstrakt

Hyrje: Bruceloza është një nga sëmundjet më të shpeshta zoonotike e përhapur në botë. Në Shqipëri, si në të gjitha vendet e Mesdheut, bruzeloza është një sëmundje endemike. Në vendin tonë ajo haset me një incidencë 25 raste/vit për 100 000 banorë. Bruceloza prek më shpesh personat që kanë kontakte të afërta më kafshët, si fermerët, veterinerët, apo edhe kasapët. Hetimet epidemiologjike të ISHP kanë treguar se 70% e infeksioneve janë fituar nga kontakti i drejtpërdrejtë me kafshët e infektuara. Bruceloza mbetet një problematikë shëndetësore humane sidomos në në rrethet kufitare si Korça, Gjirokastra, Vlora dhe Kukësi. Efekti i programit mbarëkombëtar të vaksinimit në Shqipëri, që nga viti 2012, si dhe parashikimi i incidencës më të ulët në kafshë, kanë ndikuar në incidencën e brucelozës humane. Megjithatë, sipas OBSH-së, një përafrim i numrit të vërtetë të rasteve në vendet e Mesdheut, mund të merret duke shumëzuar të paktën me tre numrin e rasteve të raportuara.

Materiali dhe metodat: Në studim janë përfshirë 67 pacientë adultë të diagnostikuar me Brucelozë në rrethin e Gjirokastrës, gjatë viteve 2017-2021. Janë mbledhur dhënat sociodemografike dhe të dhënat klinike të këtyre pacientëve.

Rezultatet: Nga të dhënat e mbledhura rezultoi se numri më i madh i rasteve me brucelozë u diagnostikuan në vitin 2017 (31%). Grupmosha më e prekur ishte 35-50 vjec (28%), me predominim të meshkujve (71.6%). Fermerët (39.3%) dhe shtëpiaket (18.6%) përfaqësonin grup- popullatat më të prekura. Shenjat dhe simptomat më të shpeshta ishin ethe (59.4%), djersitje (55.2%), dhe artralgjia (50.0%).

Konkluzionet: Bruzeloza, pavarësisht masave të ndërmarra për të ulur incidencën e saj, përsëri përfaqëson një zoonozë të rëndësishme në aspektin epidemiologjik dhe shëndetësor, sidomos për zonat e jugut të Shqipërisë. Rritja e shkallës së diagnostikimit të hershëm dhe mjekimi i plotë i pacientëve me brucelozë akute, është një hap i rëndësishëm në uljen e shfaqjeve të komplikacioneve kronike të rënda të saj.

Fjalë kyç: bruceloza, zoonozë.

FREKUENCA E SËMUNDJEVE TE FËMIJËT SHKOLLORË DHE RINIA TË TRAJTUAR NË ORGANIZATAT SHËNDETËSORE TË MJEKËSISË SË PËRGJITHSHME

Edita ETEMI[1], Sani BAJRAMI[1,2], Sherif SHAQIRI[3]
[1]Organizata Shëndetësore "Dr. Sani", Tetovë
[2]Programi Studimor Mjekësi, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës
[3]Programi Studimor Stomatologji, Fakulteti I Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës

Abstrakt

Qëllimi: Qëllimi i studimit tonë është që, përmes të dhënave retrospektive të përfituara nga ekzaminimet klinike të fëmijëve shkollorë dhe rinisë të përcaktohet frekuenca e sëmundjeve sipas: gjinisë**,** llojit të sëmundjes dhe grup moshave.

Materiali dhe metodat: Për këtë qëllim janë shfrytëzuar të dhënat retrospektive për periudhën kohore 01.10.2021 – 31.12.2021 për pacientët e ekzaminuar në organizatën shëndetësore "Dr. Sani" në Tetovë ku nga totali i të ekzaminuarve(217), 91 prej tyre ishin pacientë të gjinisë mashkullore ndërsa 126 ishin paciente të gjinisë femërore. Të dhënat e fituara janë futur në kartela të pacientit duke përdorur formën e modifikuar të vlerësimit të shëndetit oral sipas OBSH-së, të përshtatur dhe modifikuar me natyrën e studimit tonë**.** Analiza e rezultateve është bërë me anë të metodës statistikore deskriptive, shpërndarja e të dhënave është treguar me anë të përqindjeve, ndërsa krahasimi u bë me anë të T-testit.

Rezultatet: Rezultatet e grafikut 1 na tregojnë se 68.67% e pacientëve të trajtuar i takojnë nxënësve shkollorë dhe rinisë, ndërsa 31.33% i takojnë grupit të pacientëve madhorë. Rezultatet e grafikut 2 flasin për prani më të madhe të sëmundjeve te gjinia femërore me 53.02% të rasteve kundrejt gjinisë mashkullore me 46.97% të rasteve. Nga numri i përgjithshëm i patologjive që kanë prekur pacientët tonë, sipas rezultateve të tabelës 1, dominojnë faringiti dhe tonziliti akut me 28.48% të rasteve. Sa u përket grup-moshave rezultatet e tabelës 2 tregojnë për dominim të grup-moshës 7-9 vjet me 51.0% të rasteve.

Përfundim: 1. Nxënësit shkollorë dhe rinia nuk janë imunë ndaj larmishmërisë së sëmundjeve dhe pa përjashtim preken nga ato. 2. Përqindja më e lartë e pacientëve të gjinisë femërore që afektohen nga këto sëmundje i atribuohet imunitetit më të dobët. 3. Vlerësimi në kohë, i saktë dhe gjithëpërfshirës i sëmundjeve tek fëmijët dhe adoleshentët ofron informacion që është thelbësor për vendimmarrjen e politikave shëndetësore. 4. Dallimi në përqindje te rezultatet e autorëve të ndryshëm sa i përket sëmundjeve te nxënësit e shkollës dhe rinia mund të shpjegohet me standardet e ndryshme që ekzistojnë në vendet e ndryshme prej nga vijnë autorët dhe studimet.

Fjalët kyç: frekuenca, nxënësit shkollorë, OBSH.

ASPEKTET EPIDEMIOLOGJIKE NË PACIENTË ME LEUCEMI AKUTE LIMFOBLASTIKE NË MOSHAT PEDIATRIKE

Izabela Piroli, Xhesika Meta, Elvira Hoxha, DrianaAlushaj, Prof. Dr. Edmond Pistulli

Abstrakt

Hyrje :Lucemitë e fëmijërisë janë sëmundje heterogjene me shkallët e ndryshme incidentesh në mbarë botën.Leucemia pediatrike perfaqeson një grup hetereogjen sëmundjesh të karakterizuara nga mutacione germinale dhe somatike që manifestohen në kontekstin e crregullimeve në makinerinë epigjenetike dhe rregullimin gjenetik . LAL karaketerizohet nga ndyshime gjenetike që bllokojnë diferencimin ,nxisin përhapjen pararendese limfoide dhe janë të rëndësishme për shtresimin e rrezikut . Për disa dekada ,ka qenë e qartë se shumica e raste vete LAL fillojnë në uterus . Kështu LAL mbetet një sëmundje sfiduese për t'u trajtuar në popullatat e adoleshentëve dhe të rriturve .Opsionet terapeutike për LAL vecanërisht në kushtet e relapsit dhe refraktarit janë zgjeruar ndjeshëm kohët e fundit , duke prekur 3800 fëmijë në vite në SHBA dhe kjo vjen me koston e toksiciteteve: mjekësore dhe financiare. Për më tepër 80% e pacientëve me LAL në remission të plotë dhe me dëshmitë sëmundjes minimale të mbetur arrin një përgjigje të plotë pas trajtimit me blinatumomab. Shkalla e mbijetesës është inferior dhe prognoza afatgjatë për të rriturit është e dobët .Prognoza për pacientët me LAL të sapodiagnostikuar është përmiresuar në përdorimin e regjimeve me intensive të kimioterapisë ,frenuesit e tirozinekinazës , agjentët e synuar dhe transplantin e qelizave hematopoetike alogjene .
Qëllimi :Të japim një pasqyrë të sëmundjes së Leucemisë Akute Limfoblastike (LAL) tek fëmijët e grupmoshave të ndryshme pediatrike .

Metodat : Kemi marrë në studim të gjithë kartelat e pacientëve me Leucemi Akute Limfoblastike(LAL), në Spitalin e Pediatrisë , QSUT , Tiranë , nga viti 2010-2022 të ndarë në bazë të vendlindjes , gjinisë , grupmoshave dhe simptomave .

Rezultatet :Në bazë të rasteve të marra në studim nga 196 kartela pacienti me LAL nxjerrim këto rezultate : - Në bazë të vendlindjes predomindon me 87% zonat urbane ;
- Në bazë të grup moshës predominon mosha 1-4 vjec me 43.8% ;
- Në bazë të gjinisë predominon seksi mashkull me 62% ;
- Në bazë të grupit të gjakut ku janë marrë në studim 161 kartela pacienti nga 196 predominon grupi A^+ Rh (+) pozitiv me 36%
- Simptomat kryesore rezultuan :limfonodulat , lodhje , dhimbje trupore, zbehje, anoreksi, të vjella, temperaturë me disa episode gjate ditës.

Përfundimi :Grupmosha më e prekur është 1-4vjec , seksi mashkull , grupi gjakut A^+ Rh(+)

Fjalë kyç: LAL – LeucemiAkuteLimfoblastike - Moshapediatrike

CORONAVIRUSI DHE FËMIJA

Klea Vejseli, Renato Pjetri, Xhesika Meta, Prof Edmond Pistulli[1]

Abstrakt

Hyrje : Koronaviruset janë viruse ARN që ndahen në katër gjini. Dihet se alfacoronaviruset dhe betacoronaviruset infektojnë njerëzit. Në fund të vitit 2019, infeksioni me një betacoronavirus të ri, i quajtur më pas SARS-CoV-2, u raportua te njerëzit që ishin ekspozuar në një treg në Ëuhan, Kinë, ku shiteshin kafshë të gjalla. Që atëherë, ka pasur përhapje të shpejtë të virusit, duke çuar në një pandemi globale të Covid-19. SARS-CoV-2 përhapet kryesisht nga personi në person përmes grimcave të frymëmarrjes të madhësive të ndryshme, të cilat lëshohen kur një person i infektuar kollitet, teshtin ose flet. Simptomat mund të përfshijnë ethe, kollë, dhimbje të fytit,dobësi, mialgji etj.Testimi diagnostik për të identifikuar personat e infektuar aktualisht me SARS-CoV-2 zakonisht përfshin zbulimin e acidit nukleik SARS-CoV-2 me anë të analizës PCR. Trajtimi i Covid-19 varet nga stadi dhe ashpërsia e sëmundjes.

Qëllimi i studimit :Të pasqyrojmë efektet e covid-19 në moshën pediatrike.

Materiali dhe metoda : Kemi mbledhur të dhënat e literaturës bashkëkohore 2019-2022 në lidhje me veprimin e Coronavirusit, Covid-19 ,në moshën pediatrike. Ndikimi i covid-19 mbi organizmin e fëmijës, dëmtimet kryesore në sisteme dhe organe të ndryshme, efektet e vaksinave etj.

Rezultate dhe diskutime: Fëmijët nën 18 vjeç në Urgjencën Pediatrike në Itali që kishin Covid-19 përbënin vetëm 1% të numrit total të pacientëve; 11% e këtyre fëmijëve u shtruan në spital dhe asnjë nuk vdiq. 21% e pacientëve ishin asimptomatikë, 58% kishin sëmundje të lehtë, 19% kishin sëmundje të moderuar, 1% kishin sëmundje të rëndë dhe 1% ishin në gjendje kritike. (Niccolò Parri, MD,et al) Midis 713 pacientëve të shtruar në spital për COVID-19, 24.7% ishin të moshës <1 vit, 17.1% ishin të moshës 1-4 vjeç, 20.1% ishin të moshës 5-11 vjeç dhe 38,1% ishin të moshës 12-17 vjeç. (Ëanga, Valentine etc). Në një studim rreth efekteve të Covid 19 tek fëmijët me sëmundje neurologjike dhe/ose neuromuskulare, fëmijët u ndanë në dy grupe: ata me (grupi I) dhe pa çrregullime neurologjike dhe/ose neuromuskulare. (grupi II). Diferenca midis grupit I dhe grupit II ishte domethënëse për sa i përket konvulsioneve (47,3%; 1,7%), dispnesë (36,8%, 6,2%) dhe numrit të ditëve me temperaturë (2,6±1,9; 1,58±1,42) .Përfshirja e pulmoneve nga COVID-19 u zbulua të ishte më e rëndë në grupin I. (Okur, Dicle Sener). Përfshirja e veshkave në mesin e pacientëve pediatrikë me COVID-19 varion midis 10% dhe 80%.(Martin, Sandra M etc). Përafërsisht 42,504 fëmijë të moshës 5-11 vjeç u regjistruan në v-safe pas vaksinimit me vaksinën Pfizer-BioNTech COVID-19; pas dozës 2, u raportuan gjithsej 17,180 (57,5%) reaksione lokale dhe 12,223 sistemike (40,9%) (përfshirë dhimbjen në vendin e injektimit, lodhje ose dhimbje koke). (Hause, Anne M etc)
Përfundimet :Nga studimi i bërë rezultoi se Coronavirusi,Covid-19, ka prekur më pak dhe më lehtë moshën pediatrike se të rriturit.

Fjalë kyç: Covid-19,mosha pediatrike,aparati pulmonar,vaksina.

MOSHA PEDIATRIKE DHE "RREZIKU" SINDROM METABOLIK

Prof Dr Edmond Pistulli, Prof. Asc. Gentian Stroni, Prof Asc Admir Nake

Abstrakt

Çfarë është sindromi metabolik? Sindromi metabolik është kombinimi i tërësisë së faktorëve fiziologjik, biokimik, klinik dhe metabolik që ndikojnë në mënyrë direkte në rritjen e riskut për zhvillim të aterosklerozës, diabetit mellitus tipi 2 dhe sëmundje të tjera me mortalitet të lartë. Në moshat pediatrike, përkufizimi është i ngjashëm me adultët por ka disa veçori që bëjnë dallimin. Në moshat pediatrike disa nga faktorët e riskut që ndikojnë në zhvillimin e sindromit metabolik janë raporti bel-ije i cili tek femrat është >0.85 dhe tek meshkujt është >0.9 dhe me BMI >30 kg/m^2, trigliceridet me vlera ≥150 mg/dL dhe me HDL-kolesterol < 40 mg/dL. Gjithashtu përfshihet presioni i gjakut me vlerat ≥140/90 mmHg, dhe mikroalbuminuria me prani të albuminës në urinë me vlera >20 μg/min.

Materiali dhe metoda: Janë analizuar studime të viteve të fundit në lidhjen me sindromin metabolik në moshën pediaktrike. Studime që kanë evidentuar rëndësin e këtij sindromi edhe në këtë fazë moshore ku deri para disa viteve njihej si patologji e moshës adulte. Në studim janë përfshirë të dhëna nga autorë të ndryshëm në lidhje me këtë sindrom në moshën pediatrike.

Diskutimi dhe rezultatet: Nga të dhënat e studimeve të autorëve të ndryshëm ka rezultuar se faktorët e riskut që takohen në moshën adulte janë të pranishme dhe mund të konstatohen dhe në moshat e hershme pediatrike, duke filluar edhe që nga mosha 12 muajsh. Sigurisht që mosha pediatrike ka disa veçori në lidhje me përllogaritjet në sindromin metabolik të raportit bel-ije dhe të BMI në përgjithësi. Është konstatuar se çrregullimet lipidike fillojnë që në moshat e hershme pediatrike. Popullata më të rrezikuara janë pacientët diabetik, persona që kanë prindërit , një vëlla/motër me diabet, femrat (krahasuar me meshkujt) dhe femra me histori të sindromit policistik ovarial. Sipas studimeve të viteve 2013-2015 nga Mary Ann Liebert, Inc. prevalenca mesatare e sindromit metabolik në botë është 3.3%. Studimi tregoi që tek fëmijët mbipeshë, prevalenca e shfaqjes së sindromit metabolik është 11.9%, tek fëmijët obezë prevalenca është 29.2% dhe tek fëmijët me peshë normale, prevalenca është 0-1%. Faktorë të tillë të riskut si dislipidemia, hipertensioni, intoleranca ndaj glukozës, diabeti mellitus, steatoza hepatike joalkoolike, sindromi policistik ovarial, jeta sedentare, obeziteti, përdorimi i medikamenteve antiinflamatorë dhe antihistaminik, takohen në moshën pediatrike me disa specifika.
Marrja e anamnezës dhe ekzaminimet fizike përbëjnë hapin e parë në shqyrtimin e sëmundjeve co-morbide, prandaj klinicistët duhet ti kushtojnë rëndësi simptomave shoqëruese si apnea në gjumë dhe sëmundjet hepatike.

Përfundimet: Nga të dhënat e shumë punimeve ka rezultuar se sindromi metabolik në moshën pediatrike është prezent dhe një rrezik real për të ardhmen e fëmijës me pasoja në moshën pediatrike dhe në moshën adulte që ndikon edhe në jetëgjatësinë e individit.

Fjalët kyç: mosha pediatrike, sindromi metabolik, ateroskleroza, diabet mellitus tipi 2, jeta sedentare, dislipidemia.

KUJDESI INFERMIEROR NË PACIENTËT ME COVID-19.

Edmond Puca[1], Fiorela Mehmetas[2], Sara Allko[3], Klajdi Fida[3], Bonita Shehu[3]
[1]*Shërbimi i Sëmundjeve Infektive, QSU, Tiranë*
[2]*Fakulteti i Shkencave Mjeksore Teknike, Tiranë*
[3]*Fakulteti i Infermierisë së Përgjithshme, Universiteti Aldent*

Abstrakt

Infeksioni nga virusi SARS-Cov2 ishte një problem madhor për të gjithë sistemin shëndetësor. Të gjithë hallkat e tij ishin pjesë e një zinxhiri të pandërprerë, por personeli infermieror ishte ai që mbajti barrën më të madhe në menaxhimin dhe mirëfunksionimin e tij.
Qëllimi i këtij punimi është të japim një panoramë të shkurtër dhe shkëmbimin e eksperiencave në menaxhimin e pacientëve të infektuar me Sars-Cov2. Mënyra e pritjes së pacientit, vlerësimi primar, monitorimi i parametrave vitale dhe ndjekja në pavion.

Materialet dhe metodat: Për pregatitjen e këtij punimi u bazuam në të dhënat e mbledhura në shërbimet e spitaleve të klasifikuar si "covid" dhe nga shërbimet e urgjencës. Gjithashtu u bazuam në të dhënat e literaturës në lidhje me menaxhimin e pacientëve të prekur me infeksionin Sars-Cov2.

Rezultate dhe konkluzione: Menaxhimi i pacientëve me infeksion Sars-Cov2 është një proces kompleks dhe mjaft i komplikuar. Procesi i veshjes, zhveshjes, pritja e pacientit, matja e parametrave vitale, marrja e ekzaminimeve, plotësimi i formularëve, kryerja e ekzaminimeve, numri i madh i rasteve, mungesa e eksperiencave ishin procedura jo të lehta për tu realizuar në një hapësire kohore tejet të limituar. Pacientët mund të paraqiten në forma të ndryshme klinike: formë e lehtë e ngjashme me gripin; formë e mesme pa probleme të insuficiencës respiratore; formë e mesme e rëndë ku pacienti ka nevojë për suport respirator dhe format e rënda. Ndërkohë mund të kemi pacientë të moshave të ndryshme dhe ajo cka është më e rëndësishme me patologji bashkëshoqëruese shpesh mjaft komplekse. Sidoqoftë me gjithë këto problematika personeli infermieror në bashkëpunim me personelin tjetër shëndetësor arritën të menaxhojnë me sukses këtë epidemi të përmasave katastrofike.

Fjalë kyc: infermier, Sars-Cov2, pandemic, covid.

KONTROBUTI SHKENCOR GJATË PERIUDHËS SË PANDEMISË NE LIDHJE ME INFEKSIONIN SARS-COV2

Edmond Puca[1], Entela Puca[2]
Shërbimi i Sëmundjeve Infektive, QSU, Tiranë
Spitali Amerikan, No2, Tiranë

Abstrakt

Hyrje :Infeksioni Sars-Cov2 ishte një dramë e madhe për sistemin shëndetësor botëror. Njohuritë dhe informacionet rreth këtij virusi ishin tejet të limituara. Me shpërthimin e infeksionit në Wuhan dhe përhapjen e tij në pandemi mbarë botërore, publikimet shkencore morën një hov të madh të paimagjnueshëm në krahasim me ndonjë sëmundje tjetër.

Qëllimi: Të bëjmë një revieë të publikimeve shkencore të autorëve shqiptarë në lidhje me infeksionin Sars-Cov2 dhe pandeminë aktuale.
Materiali dhe metodat: Aktualisht janë bërë kërkime në revistat zyrtare të Fakultetit të Mjekësisë (New Bulletin of Medical Sciences); revistën zyrtare të Universitetit të Mjekësisë (Albanian Journal of Medical Health and Science) dhe revistën zyrtare të Institutit të Shëndetit Publik (Buletini). Gjithashtu u bënë kërkime në Pubmed me fjalët kyce: Sars-Cov2 infection, Covid-19, pandemic, Albania. Kërkimi përfshin periudhën Janar 2020 deri më 28 shkurt 2021. është bërë vlerësimi i autorëve të parë në artikuj dhe bashkeautorëve.

Rezultatet: Në revistën Albanian Journal of Medical Health and Science rezultojnë vetëm dy artikuj. Në revistat ndërkombëtare të indeksuara në Pubmed rezultuan 53 artikuj, në të cilët autorë shqiptarë ishin pjesmarrës të artikujve. Vetëm në 26% (14 artikuj), autori i parë është cilësuar si punonjës në Shqipëri. Në 74% të rasteve të tjera
janë pjesmarrës në studim ose pjesë si bashkëautore.

Konkluzione: U vunë re publikime të limituara në lidhje me situatën e pandemisë si në revistat ndërkombëtare ashtu edhe në ato shqiptare.

Fjalë kyç : kontribut shkencor, Sars-Cov2 infection, Covid-19, pandemic, Albania.

NJË RISHIKIM I EKSPERIENCËS NË LIDHJE ME INFEKSIONIN SARS-COV2, PANDEMINË DHE LEKSIONET QË NXORRËM PREJ SAJ.

Edmond Puca[1], Entela Puca[2], Elda Qyra[1], Monika Dede[1], Rozeta Kamberi[1], Najada Çomo[1]
[1]Shërbimi i Sëmundjeve Infektive, QSU, Tiranë.
[1]Shërbimi i Endokrinologjisë, Spitali Amerikan, Tiranë.

Abstrakt

Hyrje :Pas shpërthimit të rasteve të para të infeksionit Sar-Cov2 në Wuhan, Kinë në fund të vitit 2019, me 8 Mars 2020 është paraqitur dhe konfirmuar me pas edhe rasti i parë në Shqipëri. Më pas numri i pacientëve të infektuar erdhi në rritje duke pësuar edhe luhatje deri në muajin Mars 2022, ku mesa duket jemi në pjesën e fundit të pandemisë.

Qëllimi : është të bëjmë një panorame të ecurisë së pandemisë që nga fillimi i saj e deri në momentet e tanishme. Mënyra si filloi infeksioni, përhapja mbarë botërore, shpallja e pandemisë, mënyra e menaxhimit të saj dhe mësimet që nxorrëm. Si na gjeti dhe si e perballuam pandeminë në vendin tonë?
Në mbështetje të këtij punimi jemi bazuar në të dhënat e literatures dhe eksperiencën tonë jo të vogël gjatë periudhës së pandemisë. Gjithashtu jemi munduar të bëjmë edhe një analizë të vendimeve dhe situatave gjatë periudhës së pandemisë, duke i analizuar ato dhe duke nxjerrë konkluzionet përkatëse.

Konkluzione : ne arritëm të kuptojmë së sëmundjet infektive nuk qenkan të lehta për tu izoluar dhe mjekët kliniciste nuk duhet ti shkëpusin nga vëmendja e tyre. Përdorimi i maskave dhe karantinimi është një metodë mjaft e mirë për zvogëlimin e transmetueshmërisë, uljen e rasteve të infektuara dhe njëkohësisht vdekshmërinë. Mënyra e trajtimit të pacientit kaloi ne disa etapa. Ndërgjegjësimi i popullatës për vaksinimet është një

sfidë për të ardhmen. U gjetën metoda të reja bashkëpunimi sic ishte telemedicinë apo mësimdhënja në disa platforma. Shëndeti mendor dhe trajtimi post covid ose covid i zgjatur. Mënyra e bashkëpunimit si e vetmja mundësi për të pranuar realitetin dhe për të ecur përpara.sistemi shëndetësor duhet ti analizoje me qetësi pandeminë që kaluam dhe të kemi protokolle të standartizuara dhe eficiente në të ardhmen. Megjithë përparimet e mëdha të shkencës, sëmundjet infektive ngelën një sfidë për sistemin shëndetësor.

Fjalë kyç: Sars-Cov2, pandemi, mësim.

ROLI I FIZIOTERAPISË TE PERSONAT ME FIBROMIALGJI-RISHIKIM I LITERATURËS

Egzon Zejnullahu, Jonida Sahiti, Rozafa Berisha

Abstrakt

Hyrje:Sindroma e fibromialgjisë është një sëmundje e karakterizuar nga dhimbja kronike, shtangimi, butësia e muskujve, tendinave dhe nyjeve, pa inflamacion të shprehur. Është një gjendje që shkakton dhimbje në të gjithë trupin, probleme me gjumin, lodhje dhe shpesh shqetësim emocional dhe mendor. SFM konsiderohet si një problem sistemik që përfshin çrregullime biokimike, neuroendokrine dhe fiziologjike.

Qëllimi i punimit: Qëllimi i këtij punimi është që përmes një përmbledhje sistematike të bëjmë hulumtimin rreth rolit dhe efikasitetit të terapisë fizikale te personat me fibromialgji.
Materiali dhe metodat: Ky punim është i tipit "rishikim i literaturës". Materialet e përdorura në punimin e kësaj teme janë marrë nga GoogleScholar, PubMed dhe PEDro. Numri i studimeve të përfshira është 16. Studimet janë përzgjedhur në bazë të kritereve duke përdorur fjalët kyçe të kombinuara: Terapia fizikale, Fibromialgjia, Fizioterapia, Modalitetet, Terapia me ushtrime, COVID-19, ku gjetjet e tyre janë përmbledhur në pjesën e rezultateve.
Rezultatet:16 punime shkencore janë rishikuar ku është vërtetuar se terapia fizikale është treguar efikase në parandalimin e dhembjes, përkeqësimit të sëmundjes, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe simptomatologjisë së fibromialgjisë, duke rezultuar në zgjidhjen më të mirë jofarmakologjike për pacientët me fibromialgji.
Konkluzioni:Në bazë të punimeve dhe literaturëssë rishqyrtuar në këtë punim, mund të konkludojmë dhe të ofrojmë prova për rolin e terapisë fizikale te personat me fibromialgji.
Fjalët kyçe: Terapia fizikale, Fibromialgjia, Fizioterapia, Modalitetet, Terapia me ushtrime, COVID-19

IMPLIKIMET E COVID-19 NË QËNDRËN KLINIKE UNIVERSITARE NË KOSOVË – DEPARTAMENTI I PEDIATRISË

Egzona Berisha [1]

Abstrakt

Hyrja:Në fund të dhjetorit te vititi 2019, rastet e para të pneumonisë me origjinë të panjohur u identifikuan në Ëuhan, kryeqyteti i provincës Hubei në Kinën qendrore. Perderisa shumica e të dhënave janë në dispozicion për pacientët e rritur te infektuar me COVID-19, egzistojn te dhëna te pakta qe analizojnë pacientët pediatrikë të infektuar me SARS-CoV-2. Qëllimi i

studimit ishte të përshkruante karakteristikat epidemiologjike dhe klinike të sëmundjes koronavirus (COVID-19) te pacientët në Qendrën Klinike Pediatrike të Kosovës.

Materiali dhe metodat: Ky hulumtim është retrospektiv dhe përfshin të dhëna për periudhën nga 8 korriku 2020 deri më 6 janar 2021. Në këtë studim ne kemi marrë të dhëna nga dokumente të ndryshme dhe të dhëna të pacientëve, duke siguruar informacion në lidhje me gjininë, moshën, numrin e rasteve, diagnozën më të shpeshtë, pacientët kritikë , etj

Rezultatet: Nga 69 pacientë pediatrikë të shtruar në klinikë gjatë shtatë muajve, 50 pacientë rezultuan pozitivë me COVID-19. Mostra e studimit përfaqësonte një numër të barabartë të meshkujve dhe femrave (50/50), ndërsa mosha mesatare e pacientëve ishte 6 vjet. Bazuar në grupmoshat pediatrike, mostra e studimit përfshin 16 pacientë të grupmoshave 1 muaj -2 vjeç, 20 pacientë të grupmoshës 2-6 vjeç; 4 pacientë të grupmoshës 6-12 vjeç dhe 10 pacientë të grupmoshës 12-18 vjeç.

Përfundimet:Të dhënat sugjerojnë që rastet pediatrike të COVID-19 tek adoleshentët kanë simptoma më të rënda sesa në grupmoshat e tjera; megjithatë, në përgjithësi fëmijët priren të përballojnë shumë më lehtë virusin sesa të rriturit.

Fjalë kyç:COVID-19, sindromi inflamator multisistemik tek fëmijët, pacientët pediatrikë.

PSIKODERMATOLOGJIA NË SHQIPËRI

Jorgaqi E[1], Fida M[2], Savo I[3], Cela R[4], Doci Xh[5], Jefferany M[6].
[1]*Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Shërbimi Dermatologjik, Tiranë, Shqipëri*
[2]*Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Departamenti i Dermatologjisë, Tiranë, Shqipëri.*
[3]*Spitali Amerikan i Tiranës, Reparti i Dermatologjisë, Tiranë, Shqipëri*
[4]*Njësia Ambulatore Dermatologjike, Kujdesi Shëndetësor Parësor, Tiranë, Shqipëri*
[5]*Qendra Spitalore Universitare, Departamenti i Dermatologjisë, Durrës, Shqipëri*
[6]*Universiteti i Miçiganit, SHBA*

Abstrakt

Sfondi: Rastet klinike të pacientëve me sëmundje psikokutane nuk janë aq të rralla sa konsiderohen në praktikat spitalore në mbarë botën dhe në Shqipëri. Koncepti i psikodermatologjisë ende nuk është njohur si një nocion dhe si kategori diagnostike e mirënjohur tek dermatologët shqiptarë. Lezionet psikodermatologjike zakonisht janë keqinterpretuar dhe nëndiagnostikuar.

Qëllimi: Të vlerësohet ndërgjegjësimi dhe njohuritë rreth Psikodermatologjisë tek dermatologët shqiptarë.

Metodat: Disa dermatologë shqiptarë u ftuan online për t'iu përgjigjur pyetësorit të anketës dhe të tjerëve iu dorëzuan pyetësorin në konferencën rajonale. Në studim morën pjesë 41 dermatologë, të cilët u pyetën për variablat demografike dhe më shumë në detaje, u morën të dhëna për modelet e referimit, shkallën e rehatisë në menaxhimin e çrregullimeve psikokutane, interesin për vazhdimin e aktiviteteve edukative mjekësore për të matur qasjen e njohurive të tyre mbi Psikodermatologjinë.

Rezultatet: Në total janë regjistruar 41 mjekë dermatologë, 11 meshkuj (26.83%) dhe 30 femra (73.17%), shumica prej të cilëve mjekë universitarë. Çrregullimet psikodermatologjike

janë vërejtur shpesh (34.1%) në praktikën e tyre, ndërsa niveli i tyre i rehatisë së trajtimit vlerësohet si neutral në 20 dermatologë (48.7%). Diagnoza dermatologjike më e zakonshme e referuar nga dermatologët te psikiatri ishte psoriasis (35.5), trichotillomania (18.5%) dhe prurigo (16%). Nuk është për t'u habitur që shumica e të anketuarve në anketë (79%) nuk kanë ndjekur kurrë ndonjë trajnim formal ose edukim të vazhdueshëm mjekësor në Psikodermatologji dhe interesi i tyre për të ndjekur CME ishte gjithashtu i rëndësishëm (75.6%).

Konkluzioni: Nga studimi ynë rezultoi se dermatologët kanë boshllëqe dhe vështirësi të konsiderueshme në njohuritë në diagnostikimin dhe trajtimin e çrregullimeve psikokutane. Këto të dhëna hapin rrugën drejt konsiderimit të tij si një problem serioz në praktikën e Dermatologjisë që lidhet drejtpërdrejt me mungesën e përfshirjes didaktike në literaturën e tyre mjekësore dhe trajnimin adekuat.

Fjalë kyç: psikodermatologjia, Shqipëri , studim.

ETHJA, ETHJA PA VATËR DHE PASOJAT E SAJ TE FËMIJËT

Elda Skenderi[1], Admir Sulovari[2], Irena Dautaj[1], Alberta Shkembi[1], Artemisa Shehu[1], Alma Babo[1]
[1]Qëndra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, Shqipëri
[2]Spitali Amerikan Prishtinë, Kosovë

Abstrakt

Hyrja: Ethja është një nga shenjat më të hershme të sëmundjes te njerëzit dhe një nga arsyet më të zakonshme të konsultave mjekësore në mbarë botën. Megjithëse rritja e temperaturës trupore është një komponent i padiskutueshëm i përgjigjes ethore, ajo nuk është sinonim i ethes. Perveç një rritje të temperaturë trupore ethja shoqërohet nga ndryshime në metabolizmin, fiziologjinë e shumë organeve dhe sistemeve, ndryshime në përgjigjet imune dhe ndryshime të sjelljes. Ethja shpesh ndodh si përgjigje ndaj infeksionit, inflamacionit dhe traumës. Krahasuar me fëmijët me të rritur dhe adultët, fëmijët më të vegjël dhe foshnjat bëjnë ethe me temperatura më të larta dhe më të zgjatura, rritje më të shpejtë të temperaturës dhe luhatje të madhe të saj. Një ethe që shoqëron një sëmundje infektive është fitimprurëse por në rastet e etheve jo-infektive efektet e saj janë të dëmshme. Kur prodhimi i nxehtësisë e tejkalon eleminimin e saj, një kombinim i efekteve në nivel qelizor, organor dhe sistemik shkakton dëme afat-shkurtra dhe afat-gjata, të cilat në qoftë se nuk ndërpriten e çojnë organizmin deri në vdekje.

Qëllimi dhe metoda: Të evidentojmë rolin e ethes dhe pasojat e saj në sëmundjet pediatrike. Në studim u morën fëmijët e hospitalizuar në Shërbimin e Pediatrisë së Përgjithshme në QSUNT gjatë periudhës Janar 2019 - Dhjetor 2019.

Rezultatet: Ethja dhe ethja pa vatër janë diagnoza të zakonshme në hospitalizimet në pediatri. 24% e hospitalizimeve në Shërbimin e Pediatrisë së Përgjithshme në Qëndrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" gjatë një studimi një vjeçar Janar 2019 - Dhjetor 2019, rezultuan me diagnozën "Ethe pa vatër". 40% e tyre ishin femra dhe 60% meshkuj. Grupmosha 1-5 vjeç përbënte pjesën më të madhe të hospitalizimeve me 48% të rasteve, e ndjekur nga foshnjat 0-1 vjeç me 35% të rasteve dhe me pak të prekur rezultuan femijet > 5 vjeç me 17% të rasteve.

Konkluzioni: Ethja njihet si një përgjigje e hershme kompensative mbrojtëse që çon në aktivizimin e sistemit imunitar, frenim të replikimit viral dhe bakterial dhe përmirësim të mbijetesës së individit. Ethja dhe ethja pa vatër janë të zakonshme të fëmijët. Fëmijët deri ne moshen 5 vjeçare vuajnë më së shumti prej tyre. Ethja si mekanizëm kompensator nuk është pa pasoja, veçanërisht kur shoqërohet me temperatura të larta dhe sëmundje bashkë – shoqëruese. Ethja do vazhdojë të jetë shenjë e rëndësishme e sëmundjeve të vjetra e të reja, qofshin infeksioze ose jo-infeksioze. Të kuptojmë mirë përgjigjen ethore është e rëndësishme për vendosjen e diagnozës, mjekimin dhe ndjekjen e shumë sëmundjeve te fëmijët dhe jo vetëm.
Fjalët kyç: ethe, përgjigje ethore, infeksion, përgjigje imune, ethe pa vatër.

KUJDESI VENTILATOR NË PACIENTË ME COVID-19.

Elida Agaci, Gentian Huti, Asead Abdyli, Driola Hoxha.
Shërbimi i Terapisë Intensive, Spitali Amerikan 3, Tiranë.

Abstrakt

Hyrje: Covid-19 është pandemi e kohës tonë me shumë ndikim në shëndetin e pacientëve dhe shërbimet shëndetsore. Duke qenë se ka fokus primar mushkëritë dhe jep insuficencë respiratore deri në detres respirator të adultit, atëherë kujdesi përkarshi oksigjenimit dhe ventilimit të pacientit është roli primar i mjekut në repartet e Terapisë Intensive. Suporti në luftën ndaj hipoksisë përfshin O2 terapinë konvencionale, pozicionin pronë, metodat jo invazive të ventilimit mekanik, dhe intubimi endotrakeal dhe ventilimi mekanik në format e rënda.

Materiali dhe Metoda: Suporti me O2 nazal ose me maskë realizohet në fomat e lehta klinike me saturime mbi 88-92% dhe me shunt nën 50%. Nëse situata progreson ath provohen metodat jo invazive si High Flow Nazal Kanjula (HFNC) me flukse deri 100 litra dhe me FiO2 deri 100%. Metodë tjeter jo invazive janë edhe CPAP dhe BiPAP. Nëse këto dështojnë atëherë alternativë mbetet intubimi endotrakeal dhe vemtimi mekanik.

Diskutimi: Ecuria klinike e Covid-19 është paparashikueshme. Ndër mjetet që të rritet oksigjenimi i pacientit janë oksigjenoterapia, metodat e ventilimit joinvaziv, dhe intubimi dhe ventilimi mekanik. Oksigjenoterapia realizon administrimin me oksigjen me nazal dhe me maskë. Në Spitalin Amerikan 3, jemi bazuar në përdorimin e high flow nasal oxygenation (HFNC) dhe prone position. Kjo mënyre realizon oksigjenim më të mirë për pacientin dhe minimizon rrezikun e shpërndarjes në personel. Në rreth 390 raste që nga tetori 2020 kemi përdorur vetëm në 10 raste CPAP, dhe tek të tjerët HFNC. Pacientët e intubuar janë 31, nga të cilët 11 kanë bërë exitus dhe 20 janë extubuar dhe shkëputur nga ventilimi mekanik. Në pacientët e intubuar kemi ventiluar si ARDS mbi bazën e Berlin Definition, pra duke përdorur mioreleksantet, prone position, dhe duke ndjekur strategjitë e proteksionit pulmonar.

Konkluzioni: Mjekët që punojnë në terapi intensive duhet të jenë të pregatitur për të gjitha mënyrat e ventilimit mekanik invaziv dhe jo invaziv. Rëndësi të dorës së parë kanë përcaktimet në kohë dhe pa vonesa të indikacioneve për cdo mënyrë ventilim dhe marrja e saktë në kohën e duhur të vendimit për përshkallëzimin e suportit ventilator.

Fjalë kyç: COVID-2019, pacient, terapia intensive

PREEKLAMPSIA. ETIOLOGJIA DHE TRAJTIMI.

Eliona Demaliaj[1], Andja Manja, Pavlina Mikli, Dajna Balla, Klejda Tomani.
1. Spitali universitar Obstetriko-Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë", Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt

Hyrje: Preeklampsia është një sëmundje hipertensive, specifike e shtatzënisë me përfshirje të shumë sistemeve që prek 3-5% të shtatzënive. Është shkaku kryesor i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë amtare, lindjeve të parakohshme, vdekjeve perinatale dhe hipotrofisë fetale.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë faktorët e rrezikut, tablonë klinike, trajtimin medikamentoz dhe zgjidhjen e shtatzënisë me preeklampsi në spitalin tonë terciar në Shqipëri.

Materiali dhe metoda: Ky është një studim retrospektiv me të dhëna nga pacientët e shtruar në Spitalin Universitar "Mbretëresha Geraldinë" në periudhën midis janarit 2019 dhe dhjetorit 2020. Ne analizuam të dhënat e marra nga të dhënat mjekësore të këtyre pacienteve duke përfshirë karakteristikat e pacientit, historinë mjekësore, obstetrikale, historinë aktuale të shtatzënisë, tablonë klinike, trajtimin e dhënë në spital dhe zgjidhjen e shtatzënisë.

Rezultatet: Faktorët kryesorë të rrezikut që u identifikuan ishin nulliparitet, obeziteti, shtatzënia e shumfishtë, historia familjare për preeklampsi/eklampsi, hipertensioni paraekzistues ose sëmundjet e veshkave, preeklampsia/eklampsia në shtatzënitë paraprake, diabeti melit, mosha e avancuar e nënës dhe intervali kohor ndërmjet 2 shtatzënive mbi 10 vite.

Trajtimi: Terapia me sulfat magnezi u është dhënë të gjithë pacienteve para lindjes, 24-48 orë pas lindjes, por jo gjatë lindjes. (MgSO4 25%+NaCl 0.9% 250 CC). Klinikisht: pacientes i matet tensioni arterial (TA) çdo 2/4h, maten RZF+ pyetet pacientja për lëvizjet fetale, shihen edemat, pyetet pacientja për ankesat subjektive (çrregullime në shikim, cefale, dhimbje gjoksi/epigastër). Shumica e shtatzënive janë zgjidhur me sectio Caesarea. Rikuperimi i pacientëve kërkon 3-5 ditë ose më shumë në rastet e rënda.

Konkluzion: Diagnostikimi i hershëm, monitorimi korrekt dhe trajtimi në kohë mund të parandalojë komplikacionet dhe të zvogëlojë sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë.

Fjalë kyç: preeklampsia (PE), hipertensioni (HTA), etiologjia, trajtimi, lindja.

SINDROMI I BANDAVE AMNIOTIKE: RISHIKIM I LITERATURËS

Elmas Shaqiri

Abstrakt

Sipas studimeve epidemiologjike në lidhje me incidencën e këtij sindromi të 17 viteve të fundit ku ka rezultuar mesatarisht një fëmijë i prekur në 11.200 lindje gjallë, pra është një situatë e rrallë e cila ka pasoja të ndryshme mbi fetusin të cilat konsistojnë nga dëmtime minore, estetike deri në humbjen e ekstremiteteve distale ose defekte serioze të trupit, kokës, fytyrës etj. Sindromi i bandave amniotike është një manifestim i dëmtimeve të ndryshme të

fetusit dhe asnjë rast i ABS nuk i ngjan rastit tjetër duke e bërë atë plurimorfe e cila manifestohet me një shumëllojshmëri situatash duke patur secila specifikën dhe partikularitetin e saj. Ekziston mundësia që në faza të ndryshme të evidentohet banda amniotike, kur konstatohen në ekzaminimin ekografik dhe mund të ndiqet në dinamikë. Në ekzaminimin ekografik mund të evidentohet pakësim i likidit amniotik dhe mungesa e organit. Natyrshëm ka vështirësi diagnostike kjo nga fakti që shumica e rasteve diagnostikohen në lindje. Diagnostikimi prenatal i defekteve të gjymtyrëve me ekzaminim ekografik obstetrikal ka për qëllim parandalimin e anomalive duke vlerësuar faktorët që ndikojnë në detektimin duke përfshirë edhe prezencën e anomalive shoqëruese, rritjen e performancës në detektimin e këtyre anomalive dhe për të diferencuar nëse anomalitë e ekstremiteteve me patologji shoqëruese kishin shkallë më të lartë detektuese. Ekziston mundësia që në faza të ndryshme të shtatzanisë të evidentohet banda amniotike, kur konstatohen në ekzaminimin ekografik dhe mund të ndiqet në dinamikë. Në ekzaminimin ekografik mund të evidentohet edhe mungesa e organit. Natyrshëm ka vështirësi diagnostike kjo nga fakti që shumica e rasteve diagnostikohen në lindje. Formimi morfollogjik i fetusit përfundon në javën e 12-të (muaji i tretë i shtatzanësisë). Më vonë fetusi rritet në përmasa me zhvillim normal. Diagnoza mund të vërtetohet me anë të ekzaminimit histologjik i cili ka repertin e mëposhtëm: Kordoni umbilikal paraqitet i rregullt me kompleksin e tij vaskular pa lezione domethënëse. Placenta në nivelin e lezioneve makroskopike të bardha paraqet ind osteoid dhe ind kondroid të paorganizuar dhe me vendosje vatrore multicentrike. Vërehet fibrinë në spaciumet interviloze. Trajtimi fetal i ABS (amniotic bands sindrom) në uterus/mitër me qëllim shpëtimin e gjymtyrëve: trajtimi i sindromës së bandave amnitoce realizohet nëpërmjet teknikës së fetoskopisë me lazer me qëllim lirimin e bandave amniotike ofron mundësinë të ndalojë amputimin (këputjen) e gjymtyrëve. Një kamera e vogël futet në abdomenin (barkun) e nënës, në lëngun amniotic me qëllim të verifikojë dhe më pas të presë bandat me lazer. Zakonisht procedura e mësipërme kryhet nëpërmjet anestezisë lokale. Një fetoskopi e hershme mund të ndalojë amputimin e gjymtyrëve duke lejuar zhvillimin e hershëm të tyre. Trajtimi i ABS (amniotic band sindrom) nëpërmjet fetoskopisë realizohet në shumë spitale të specializuar për trajtimin e sëmundjeve të ndryshme fetale (Fetal care hospitalis).

Fjalë kyç: sindromi i bandave amniotike, mungesa e organit.

MYCOSIS FUNGOIDES RËNDËSIA E ANATOMOPATHOLOGJISË NË DIAGNOZËN DIFERENCIALE

Elmijola Janushaj[1] , Daniela Nakuci[2], Mehdi Alimehmeti[3]
Dermatologe - Venerologe, Poliklinika Doctors Hospital, Tiranë
Anatomopathologe, Departamenti i Anatomise Patologjike, Spitali Rajonal Vlore
Anatomopathologe, Departamenti i Anatomise Patologjike,

Abstrakt

Hyrje
Mukoza fungoide (MF) është një nga Limfomat kutane më të zakonshme. Paraqitja klasike e patologjise karakterizohet me stadin e njollave eritematoze, pllakave dhe tumoreve, dekursi klinik i te cilave eshte i zgjatur nder vite. Mukoza fungoide ngjan me shumë patologji të lëkurës, sidomos gjatë stadit të saj të hershëm klinik duke krijuar sfida diagnostike,vecanërisht në vendin tone. Diagnoza diferenciale e ketyre patologjive kerkon ekzaminime bioptike, imunohistokimi dhe element molekularë diagnostike specifike.

Materiale dhe metoda : Ky artikull është nje studim retrospektiv dhe i përditësuar te artikujve të botuar në Pubmed për Limfomën Kutane (LK) me fokus MF dhe klasifikimit ËHO-EORTC per Limfomat Kutane. Të gjitha këto të dhëna të MF u shqyrtuan dhe u analizuan.

Rezultatet: Klasifikimi i LK me qeliza T sipas klasifikimit ËHO-EORTC te rishikuar ne 2018 i ndan ne dy grupe madhore : Limfomat kutane me qeliza T me sjellje klinike indolente si MF dhe variantet e tij dhe grupi i Limfomave kutane me qeliza T me sjellje klinike agresive si Sezary sindrom. Fillimi jo karakteristik i klinikes se MF e ben te veshtire dianostikimin ne fazat e hershme, por dekursi klinik nder vite behet me i qarte klinikisht por jo elemente specifike te MF. Në këtë studim rezultoi rëndësia e ekzaminimit bioptik për diagnostikimin e MF dhe ekzaminimeve të tjera si imunohistokimia. Pasqyrimi i nje tablo me diagnozen diferenciale të kësaj patologjie që imiton shumë patologji inflamatore si ekzema, psoriasis, lichen, lupus, pseudolymphoma, parapsoriasis dhe toxidermia, eshte me rendesi për të paralajmëruar klinicistët për spektrin e gjerë të kësaj sëmundjeje të vështirë. Është per tu permendur nevoja e percaktimit te elementeve me specifike nga pikepamja histopathologjike dhe imunohistokimike. Shpesh vihet re veshtiresi sidomos ne fazat e hershme te MF per shkak te mbivendosjes se elementeve klinikopatologjike me elemente te dermatozave inflamatore.

Konkluzion: Klasifikimi i Limfomave Kutane është multidisiplinar dhe kërkon korrelacion midis elementëve diagnostik klinik, histopatologjik, imunohistokimik dhe elementëve molekulare. Është e rendësishme të dyshohet për MF kur një proces eritematoz ka ecuri të gjatë në kohe, përgjigjet keq ndaj mjekimeve për patologji të tjera inflamatore kutane. Më e rëndësishmja eshte korelacion kliniko-histopathologjik per vendosjen e diagnozes dhe percaktimi i prezences se qelizave atipike ne epiderme.

Fjalët kyç: Mukoza Fungoide, diagnoza diferenciale, Limfoma Kutane Primare, sëmundje inflamatore te lëkurës.

NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI KARAKTERISTIKAT KLINIKE TE CRREGULLIMIT OBSESIVO-KOMPULSIV TE FËIJËT SHQIPËTARË

Elona Dashi[1], Valmira Skendi[2], Valbona Alikaj[3]
[1]Mjeke psikiatre për fëmijë dhe adoleshentë, MD
[2] Psikologe klinike, PhD. Shërbimi i Psikiatrisë së Fëmijëve/Adoleshentëve. QSU "Nënë Tereza" Tiranë.
[3] Mjeke psikiatre për fëmijë/adoleshentë., Proff.asc., Pedagoge e brendshme, Fakulteti i Mjekësisë

Abstrakt

Hyrje: Çrregullimi obsesiv-kompulsiv (ÇOK) përkufizohet si një çrregullim neuropsikiatrik kronik me prani të obsesioneve dhe kompulsioneve, të cilat mund të jenë kohë-konsumuese ose shkaktojnë stres apo dëmtim klinikisht të dukshëm (APA, 2013). Studimet e fundit tregojnë se çrregullimi obsesiv-kompulsiv te fëmijët dhe adoleshentët është më i shpeshtë sesa mendohej dikur, me një prevalencë mes 0.25%-4% (Krebs and Heyman, 2015) dhe sipas DSM-5, 25% e rasteve fillojnë para moshës 14 vjeçare (APA, 2013).

Qëllimi : Qëllimi i studimit tonë është përshkrimi i simptomave klinike të fillimit te çrregullimit obsesiv-kompulsiv në fëmijëri dhe krahasimi i tyre në bazë të karakteristikave socio-demografike.

Metoda: Studim deskriptiv/përshkrues, i tipit cross-sectional/ndërseksional. Periudha kohore e studimit është 12 mujore dhe i kryer në klinikën e Psikiatrisë së Fëmijëve dhe Adoleshentëve [PFA], Qëndra Spitalore Universitare "Nënë Tereza". U përdor versioni për fëmijë i pyetësorit Yale Broën (Scahill L et al., 1997). Analiza statistikore u krye nëpërmjet paketës statistikore për shkencat sociale (SPSS).

Përfundime: U vlerësuan 55 pjesmarrës të diagnostikuar me ÇOK, nga ku 56.4% ishin femra. Në praktikën tonë klinike fëmijët dhe adoleshentët me ÇOK kërkonin ndihmë profesionale me vonesë dhe në forma të rënda të çrregullimit me dëmtim të theksuar të funksionimit ku 18.2% e tyre referuan paaftësi nga ÇOK.

Fjalë kyç: Çrregullimi obsesiv-kompulsiv ,studim deskriptiv.

EDUKIMI SHËNDETËSOR I NËNAVE TË REJA NË PARANDALIMIN E PËRKEQËSIMIT TË DISPLAZISË TË KOFSHËS (DDH)

Doc. Elona Hasalla[1], Prof.As.Dr Ilia Mazniku[2],Ph.D. Ilda Taka[2], Msc. Elona Dybeli[2], Msc. Blerta Hasalla[2],Dr. Sulejman Baha, Msc. Irena Xhaferri
Universiteti "A. Xhuvani" Elbasan, Fakulteti i Shkencave Mjekësore-Teknike, Departamenti i Lëndëve Paraklinike, Departamenti i Specialiteteve Mjekësore Teknike, Departamenti i Lëndëve Klinike, Universiteti i Firences, Itali

Abstrakt

Prezantimi:Edhe pse është arritur progres i madh në fushën e dislokimit kongjenital të mjekimit të kofshës (DDH), kjo anomali trashëgimore mbetet një sfidë e madhe për nënat e reja dhe personelin shëndetësor për sa i përket diagnostikimit dhe trajtimit të hershëm.

Qëllimi:Qëllimi i këtij studimi është diagnostikimi dhe trajtimi i hershëm i DDH dhe pasojave të tij dobësuese që zgjasin gjatë gjithë jetës.
1.Diagnoza dhe trajtimi i hershëm i DDH.
2. Edukimi i nënave të reja dhe kryerja e një kontrolli të fëmijëve nëpërmjet analizave diagnostikuese në maternitet, dhomave të konsultimit dhe departamenteve ortopedike.
3. Trajtimi i hershëm i fëmijëve me DDH përmes jastëkëve rrëmbyes si një metodë efikase dhe rezultuese në trajtimin e kësaj anomalie të lindur.
4. Prezantimi i rezultateve të trajtimit dhe përvojës sonë modeste në këtë fushë.

Materiale dhe metoda:Në këtë studim kemi shqyrtuar të dhënat shëndetësore të 68 fëmijëve me DDH nga shtatori 2014 deri në janar 2016. Nga këta fëmijë, 38 ose 56% ishin dypalësh, ndërsa 30 fëmijë ose 44% ishin të njëanshëm. Në total janë trajtuar 106 artikulacione me DDH. Raporti djem/vajza në studimin tonë është 1:2.

Rezultatet:Të gjithë fëmijët në studimin tonë u trajtuan me jastëk rrëmbyes plastik të disponueshëm në treg në tre dimensione të ndryshme 1,2,3.
-41 fëmijë ose 60.3% u shëruan plotësisht.

-18 fëmijë ose 26.4% janë ende nën trajtim.
- Në 9 fëmijë ose 13.2% trajtimi dështoi. Këta fëmijë iu nënshtruan trajtimit të mëtejshëm.

Konkluzione: 1.Diagnoza dhe trajtimi i hershëm është çelësi i suksesit në trajtimin e DDH.
2. Pozicioni në abduksion me jastëk ose splinta rrëmbyese krijon kushte ideale për pozicionimin e kokës së femurit në acetabulum, që është edhe qëllimi i trajtimit.
3. Rritja e kapaciteteve të stafit infermieror në diagnostikimin dhe trajtimin e anomalisë.
4.Të edukojmë nënat e reja që të mos i lidhin fëmijët e tyre pasi kjo ndikon shumë në DDH.

Fjalët kyç: DDH, mjekim, diagnozë, fëmijë, anomali, test Ortolani

MBIJETESA E PËRGJITHSHME E LEUKEMISË KRONIKE LIMFOCITARE RELAPS / REFRAKTORE NË PACIENTËT TË TRAJTUAR ME IBRUTINIB NË VIJËN E TRETË NË SHQIPËRI (2018-2022)

Elsuarta Calliku MD Hematologe QSUT
Adela Perolla MD. PhD Hematologe QSUT
Tatjana Caja MD. Prof Hematologe.QSUT

Abstrakt

Synimet: Studimi ynë synon të evaluoje Mbijetesën e Përgjithshme (OS) të të gjithë pacientëve me Leuçemi Limfocitare Kronike Refraktore/relapse të trajtuar me Ibrutinib në linjën e tretë të terapisë nga viti 2018 deri në janar 2022 dhe të vlerësojë korrelacionin e kësaj mbijetese me nëngrupet e moshës dhe gjininë.

Metoda: Ne studiuam të gjithë pacientët e diagnostikuar në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" në Tiranë, Shqipëri me R/R CLL të cilët filluan trajtimin me ibrutinib, të kombinuar ose jo me imunoterapi nga korriku 2018 deri në janar 2022 nga mosha >18 vjeç dhe. lart. Të dhënat i kemi mbledhur nga regjistrat dhe databaza e Klinikës së Hematologjisë. Të dhënat u analizuan me variantin 25 të SPSS.

Rezultatet: Nga korriku 2018 deri në janar 2022 ne kemi trajtuar me Ibrutinib të linjës së tretë 46 pacientë të diagnostikuar me R/R CLL, 32 (69.6%) ishin meshkuj dhe 14 (30.4%) ishin femra me një raport M/F rreth 2:1. Me një moshë mesatare 63 ± 7,4 (varg 43 – 80) vjeç. Mbijetesa e përgjithshme mesatare e vlerësuar rezultoi prej 28 ± 4,9 (95% CI 18-37) muaj. Mbijetesa e përgjithshme e vlerësuar sipas nëngrupeve të moshës ishte më e lartë në nëngrupin 50-59 vjeç duke rezultuar në 38 ± 7,7 (95% CI 16-39) muaj. Dallimet e mbijetesës së përgjithshme të pacientëve me R/R CLL të trajtuar me ibrutinib në linjën e tretë në varësi të gjinisë ishin jo të rëndësishme.

Konkluzionet Studimi yne tregoi se gjinia nuk ka influence ne mbijetesen e pergjithshme se pacienteve me R/R CLL te trajtuar me ibrutinib in linjen e trete.

Fjalë kyç: leukemia , ibrutinib, mbijetesa.

NJË RAST ME PËRFUNDIM LETAL NGA SHOKU TOKSIK GJATË NJË INFEKSIONIME BACILLUS CEREUS TEK NJË FËMIJË IMUNOKOMPETENT

Elton Serani[1], Fatos Sinani[1], Bledar Xhemali[1]
[1]IML Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Bacillus cereus mund të shkaktojë infeksione virulente kryesisht me simptomatologji gastrointestinale, dhe mund të prekë moshat pediatrike në forma të rënda. Sindroma diarreike mbizotëron në aspektin klinik, dhe lidhet me praninë e mjaft toksinave që çlirohen prej këtij mikroorganizmi.

Përshkrim rasti: Një fëmijë i seksit mashkull, katër vjeçar, paraqitet në një spital rrethi me dhimbje abdominale, të vjella dhe diarre. Pas shtrimit dhe brenda disa orëve pacienti shfaq hipotension të rëndë dhe shok kardiocirkulator, që shkaktoi vdekjen e menjëhershme pavarësisht trajtimit agresiv të aplikuar. Pas ngjarjes, u krye autopsia dhe një analizë e plotë toksikologjike. Shkak i vdekjes u konsiderua komplikacioni i shokut të rëndë toksik në terren të një gastro-enteriti fulminant. U vunë re ndryshime inflamatore dhe nekrozë në mukozat e stomakut dhe zorrës së hollë, ashtu si edhe endokardit akut me vatra miokardiale nekrotike. U evidentua prekje edhe e viscerave të tjera, me hemorragji difuze pulmonare dhe cerebrale, dhe lezione të tjera multiple hemoragjike.

Konkluzioni: Infeksionet e shkaktuara nga bacillus cereus prezantohen me dy forma kryesore klinike, që të dyja me periudhë shumë të shkurtër inkubacioni dhe që ndryshojnë nga njëra-tjetra kryesisht prej simptomës predominuese, e cila eventualisht mund të jetë të vjellat ose diarrea. Në rastin tonë ne vumë re një kuadër klinik fulminant ku mbizotëruan të vjellat që shkaktuan hipovolemi të rëndë, hemorragji viscerale dhe transudate të shumta, shok toksik kardiocirkulator dhe vdekje. Për sa kohë që ky infeksion është i rrallë, lind nevoja e një njohje më të mirë nga ana e mjekëve kurues të kuadrit klinik specifik të kësaj sëmundjeje.

Fjalët kyç: shok toksik, vdekje, rast klinik.

ECLAMPSIA DHE PREECLAMPSIA

Msc. Adriana Zhama, Sanie Ago, Xhesiara Koxhaj, Ermelinda Xhari
Dr. Emirvina Koliçi

Abstrakt

Qëllimi: Çrregullimet HTA në shtatëzani janë shkaktari kryesor i vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë në shtatëzani. Aftësia për të parashikuar këto ndërlikime duke përdorur teste të thjeshta mund të ndihmojë në menaxhimin dhe përmirësimin e rezultateve.
Ky studim ka për qëllim të vlerësojë komplikacionet që sjell hipertensioni tek gratë shtatëzëna dhe diagnozën laboratorike për pre-eklampsinë në bashkëpunim me shenjat klinike dhe analizat e tjera.

Metodologjia: Një studim retrospektiv (Tetor – Dhjetor 2016) u përdor për të vlerësuar 52 pacientë të grupmoshes nga 17-45 vjeç, të diagnostikuara me hipertension arterial. Për

këto paciente u vlerësuan mosha e nënës, nr i shtatzanive, vlerat e HTA, prania e patologjive të tjera si diabeti Mellitus, vlerat e transaminazave, proteinurisë, trombociteve. Të dhënat u morën në statistikën e maternitetit "Koço Glozheni".

Rezultate: Në varësi të të dhënave u vu re se kemi një rritje të rasteve me HTA në grupmoshën 35-45 vjeç në krahasim me grupmoshat e tjera. U vu re një rritje e rasteve me eklamsi në nënat me patologji bashkëshoqëruese të shtatzanisë. Rastet e aborteve është në rritje në rastet në grupmoshat e 35-45 vjeç të shoqëruara me patologji të tjera. Nuk u vu re një lidhje sinjikavive mes vlerave të HTA me ndryshimet biokimike. Nga parametrat biokimike vetëm vlera të larta të proteinurisë janë më të besuara si bashkëshoqëruese e eklamsisë.

Konkluzione: Çrregullimet hipertensionale në shtatzëni janë shkaku kryesor i vdekshmërisë amtare në mbarë botën. Incidenca e hipertensionit në shtatzëni vazhdon të rritet. Aktualisht, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë se cili pacient do të zhvillojë këtë patologji**.** Jo gjithmonë një HTA I rëndë shoqërohet me ndryshime të rëndësishme biokimike. Rastet me eklamsi rriten me rritjen e moshës së shtazanisë.

Fjalët kyç: pre-eklampsi, HTA, proteinuri, acid urik**.**

OVARI POLICISTIK, NDRYSHIMET METABOLIKE DHE HORMONALE NË TË.

Msc.Fribianka Hoxha, Sindi Deliallisi, Taulant Mehmeti, Dr.Emirvina Koliçi.

Abstrakt

Hyrje: Sindromi i ovarit policistik është ndër patologjitë më të shpeshta endokrine në femrat fertile. PCOS është çrregullim endokrin që karakterizohet nga çrregullime të sistemit riprodhues dhe atij metabolik që përfshijnë hiperandrogjenizmin, disfunksionin ovarial dhe nga ndryshime morfologjike në ovare (prania e kisteve) si dhe simptoma te tjera klinike e biokimike si hirsutizmi, hiperinsulinemia (insulinorezistence), hiperprolaktinemia, etj.

Metoda: Ne kemi ekzaminuar 100 raste të diagnostikuara si PCOS, bazuar në kriteret e Roterdamit. Në të gjitha rastet, ne kemi matur nivelet e serumit të hormonit luteinizing (LH), hormon stimulues të folikulit (FSH), totalit të testosteronit (TT) dhe DHT dhe ekzaminet biokimike si glicemia, lipidograma dhe insulinemia.

Rezultatet: Manifestimet biokimike në pacientët me ovar policistik treguan se lipideve mes pacientëve me PCOS dhe grupit të kontrollit nuk u vu re një lidhje sinjikative. Manifestimet hormonale në pacientët me ovar policistik në rastin e insulinës ($p<0.001$), HOMA-IR ($P<0.001$). Në rastin e androgjenëve u vu re një lidhje sinjifikative në rastin e raportit TT/DHT ($P < 0.01$), Free Testosteronit ($P< 0.05$) si dhe raportit LH/FSH ($p<0.001$).

Përfundimi: Sindromi i ovarit policistik është ndër patologjitë më të shpeshta endokrine në femrat fertile. PCOS është çrregullim endokrin që karakterizohet nga çrregullime të sistemit riprodhues dhe atij metabolik që përfshijnë hiperandrogjenizmin, disfunksioni ovarial dhe nga ndryshime morfologjike në ovare (prania e cisteve) si dhe simptoma të tjera klinike e biokimike si hirsutizmi, hiperinsulinemia (insulinorezistence), hiperprolaktinemia, etj. Është vlerësuar se kjo patologji prek 4-12 % të femrave në moshën fertile.

Fjalë kyç: PCOS, FSH, LH, lipidogramë.

VITAMINA D_3, RËNDËSIA E SAJ NË PATOLOGJI TË NDRYSHME.

Msc.Manjola Kuka, Dr.Emirvina Koliçi

Abstrakt

Hyrje: Vitamina D është një prohormon, i njohur për rolin e saj të rëndësishëm në rregullimin e nivelit të kalciumit dhe fosforit dhe mineralizimit kokcor. Veprimi metabolik u realizua përmes formës së tij hormonale 1α,25 dihidroksivitamin D3 [1,25(OH)2D3], pasi lidhet me një receptor nuklear (VDR), i cili rregullon transkriptimin e një numri gjenesh target në varësi nga qelizat target të vitaminës D. Përveç rolit qëndror të vendosur mirë në hemostazën e kalciumit, ky hormon pluripotent ka veprime shtesë biologjike në sistemin imun të lindur dhe të fituar, në sekretimin e insulinës nga qelizat beta të pankreasit, në rregullimin e tensionit arterial, në zhvillimin e fetusit dhe të trurit.

Metodat: U studiuan 55 paciente gra të moshës 35-55 vjec, të cilave ju mat vitamina D. Gjaku u mor në mëngjes esëll, në tuba me xhel, serum, i cili pasi u centrifugua për 15 minuta me 3600 rrotullime/min, u vendos në aparatin hormonal Elexys 2010. Metoda e cila u përdor për të realizuar matjen e vitaminës D është ECLIA (eletro kemiluminishenca). Analizatori mund të masë mostra në serum dhe në plazëm. Rezultatet nxirren në formë sasiore, pacientëve ju mat njëkohësisht dhe niveli i kalciumit dhe fosforit në gjak. Metoda e matjes së këtyre mineraleve është metoda end-point, e cila në këtë rast u realizua në autoanalizatorin A-15.

Rezultatet: U studiuan 55 paciente gra të moshës 35-55 vjeç, të cilave ju mat vitamina D. Ky grup pacientësh u nda në 4 nëngrupe sipas moshës 35-40 vjeç, 40-45 vjeç, 45-50 vjeç, 50-55 vjeç, >55 vjeç. Me moshën, vlera e vitamines D ulet, kjo tregon që kjo moshë është më e prirur për të zhvilluar fenomenin e osteoporozës. U vu re një rënie e rëndesishme e nivelit të vitaminës D me rritjen e moshës. Gjithashtu niveli i kalciumit ulet me rritjen e moshës, si dhe një korelacion mes nivelit të ulët të vitaminës D dhe rritjes oesatore te Parahormonit. Gjithashtu u vu një lidhje sinifikative mes osteoporozës dhe nivelit të ulët të Vitaminës D.

Konkluzion: Mineralizimi kockor varet kryesisht nga përqëndrimi i kalciumit. Kalcium aktiv i thithur nga zorra varet nga formimi i 1,25(OH)2D dhe receptorëve të paprekur të vitaminës D. Si përfundim, niveli normal i Vitaminës D mund të shmangë problemin e osteoporozës, por nuk korigjon keqpërthithjen e kalciumit. Megjithëse korigjon keqpërthithjen e kalciumit, mbetet për t'u parë nëse sasitë më të larta të vitaminës D mund të normalizojnë keqpërthithjen e kalciumit me rritjen në moshë.

Fjalë kyç: Vitamina D, kalcium, fosfor.

NDIKIMI I ANTITRUPAVE ANTI – CCD NË DIAGNOZËN E ALERGJIVE

E.Koliçi, K.Poshi, A. Çerekja, A.Zyli, A.Nurçe
Universiteti i Mjekësisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike

Abstrakt

Hyrje: Tek personat me alergji sistemi imunitar formon antitrupa IgE gjatë kontaktit të parë me një alergjen (substancë e huaj) nga mjedisi ose ushqim. Në çdo kontakt të mëtejshëm, bashkëveprimi midis antitrupave dhe alergjenit mund të shkaktojë reaksione të ndryshme imunitare. Për pacientin është e rëndësishme të dihet shkaku i alergjisë së tij. Në diagnostikimin e alergjisë mund të kemi reaksione të kryqëzuara me CCD (glikoproteinat) të cilat mund të pengojnë identifikimin e substancës që shkakton alergji. Nëse sistemi imunitar ka formuar antitrupa IgE pas kontaktit me një alergjen, ato mund të drejtohen kundër vetë pjesës së proteinës së alergenit ose kundër strukturës CCD (antitrupat anti-CCD IgE). Antitrupat anti-CCD IgE ndodhin deri në 25% të pacientëve me alergji, por në përgjithësi nuk kanë ndonjë rëndësi klinike në krahasim me antitrupat IgE kundër zonave specifike proteinike.

Metoda: Është një studim teorik pasi u morën në studim artikuj nga revista si PubMed, Medline, Science Direct.

Rezultati: Në diagnostikimin e alergjive bazuar në ekstraktet e alergjenit, antitrupat anti-CCD IgE përfaqësojnë një problem, pasi me një rezultat pozitiv të testit nuk është e mundur të bëhet dallimi midis reaksioneve për shkak të antitrupave specifikë IgE kundër proteinës, antitrupave anti-CCD IgE reaktive të kryqëzuara ose të dyjave. Për të parandaluar një fals pozitivitet të mundshëm të rezultateve të testit për shkak të anti-CCD IgE, antitrupat ndër-reaktivë në mostrën e pacientit mund të eliminohen paraprakisht duke përdorur Anti-CCD Absorbent. Përthithësi lidh antitrupat anti-CCD IgE në serum dhe i bën ato të pakapshme.

Konkluzioni: IgE-anti CCD mund të krijojë një diagnozë të gabuar të alergjive ndaj ushqimeve, lateksit e cila mund të çojë në terapi të panevojshme. Eliminimi i efektit të IgE-anti CCD-ve me anë të frenimit çon në një reduktim të ndjeshëm të rezultateve false-pozitive pa ulur ndjeshmërinë ndaj sensibilizimeve përkatëse. Aplikimi i bllokuesit CCD mund të jetë i vlefshëm në cdo test ku përdoren ekstrakte ose përbërës natyralë alergjenë.

Fjalët kyç: CCD, glikoproteine, allergen, IgE.

DAPAGLIFLOZIN DHE NDIKIMI NË INTERPRETIMIN E GLUKOZURISË NË PACIENTËT DIABETIKË

E.Koliçi, K.Poshi, A. Çerekja, A.Zyli, A.Nurçe
Universiteti i Mjekësisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike

Hyrje: Dapagliflozin është një preparat që përdoret në diabet mellitus tip 2 për të ulur nivelet e glicemisë në gjak, vetëm ose i kombinuar me medikamente të tjera. Dapagliflozin është në një hipoglicemiant që frenon transportuesin natriumi-glukozë 2 (SGLT2). SGLT2 vepron kryesisht në veshka duke përthithur glukozën. Frenimi i saj çon në rritjen e ekskretimit renal duke ulur nivelin e glicemisë në gjak. Meqënëse veprimi i saj nuk kërkon praninë e insulinës.

Dapagliflozin nuk jep hipoglicemi. Dapagliflozin nuk përdoret për trajtimin e diabetit të tipit 1 ose ketoacidozën diabetike.

Metoda: Është një vëzhgim teorik pasi u vlërësuan të dhëna nga revista si PubMed, Medline, NCBI.

Rezultati: Tek njeriu pragu renal për glukozën është 180 mg/dl, prandaj një glukozuri në përgjithësi të orienton për një nivel të lartë glicemie në gjakun periferik e shoqëruar me rritje të HbA1c. Në rastin e mjekimit me Dapagliflozin, glukozuria nuk na orienton për nivelin e glukozës në gjak. Gjithashtu efektet anësore të preparatit, si urinim dhe etje e shtuar, shenja klinike dhe të diabetit mellitus, mund të fshehin klinikën e vërtetë të pacientit.

Konkluzioni: Përdorimi i Dapagliflozin, nxjerr edhe njëherë në dukje rëndësinë e fazës preanalitike, informacionin për mjekimin e pacientëve, njohjes së mekanizmave të veprimit të medikamenteve të ndryshme si dhe rëndësinë e bashkëveprimit klinikë-laborator për një rezultat laboratorik sa më të saktë si dhe një interpretim sa më të qartë të testeve laboratorike.

Fjalët kyç: dapagliflozin, glukozuria, diabet mellitus.

SELENIUMI DHE SËMUNDJET AUTOIMMUNE TË TIROIDES

E.Koliçi, A.Zyli, A.Cerekja, K.Poshi, E.Thoma, A.Nurçe
Universiteti i mjekësise, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Tiranë

Abstrakt

Hyrja: Seleniumi është një mikroelement me ndikim të rëndësishëm si antiinflamator ashtu dhe antioksidant në organizëm. Tiroidja është organi me nivelin më të lartë të seleniumit në organizëm. Në tiroide ai ndikon në metabolizmin e hormoneve të tiroides si dhe ka efekt antioksidues. Shpeshherë në sëmundjet autoimmune të tiroides është vënë re një mungesë e tij e cila mund të vijë si pasojë e këtyre sëmundjeve ose kjo mungesë mund të ndikojë në etiologjinë e tyre. Duke parë rolin e seleniumit në krijimin e inflamacionit në sëmundjet autoimune qëllimi është të vlerësojmë ndikimin e tij në to.

Metoda: Është një studim teorik pasi u morën në studim artikuj nga revista si PubMed, Medline, Science Direct dhe Google Scholar.

Rezultatet: Bazuar në shumicën e studimeve u vu re një ulje e nivelit të seleniumit në pacientët me sëmundjet autoimmune të tiroides. Për më tepër, shumica e artikujve treguan një përmirësim në simptomat klinike të këtyre sëmundjeve pas trajtimit të pacientëve me doza të ndryshme të L-selenomethionine.

Konkluzione: Studimet tregojnë se seleniumi ndikon në ecurinë e sëmundjeve autoimmune të tiroides duke luajtur një rol mbrojtës në to. Seleniumi ka mekanizma veprimit anti-inflamator duke ndikuar si modulator i përgjigjes inflamatore në sëmundjen infektive dhe autoimmune. Në tiroiditin autoimun përdorimi seleniumit ka kontribuar në uljen e antitrupave antiperoksidazë si dhe përmiresimin e strukturës së tiroides. Në patologjinë Graves përdorimi i selenium ndikon në nivelin e orbitopatisë duke ndaluar përparimin e saj si dhe përmirësim në rastet e orbitopatisëe së lehtë ose moderuar.

Fjalët kyç: selenium, sëmundjet autoimmune, sëmundjet vaskulare të kolagjenit.

NDIHMA DHE ROLI I FIZIOTERAPISË NË REHABILITIMIN E PACIENTËVE ME COVID-19.

Endrit Toska
Shërbimi i Fizioterapisë, Spiali Amerikan 3, Tiranë, Albania

Hyrje: Fizioterapistit kur i kërkohet nga mjeku primar të merret me pacientin, fillimisht duhet të dijë parametrat vital, ka apo jo deficit neurologjik, ka apo jo fraktura ,rigiditet articular, atrofi muskulare dhe nëse cohet apo jo nga shtrati. Në ICU kemi pacient që janë me problematika të ndryshme, komplekse dhe të mbivendosura dhe nuk mund të ndjekin fizioterapistët në bërjen e të gjitha ushtrimeve dhe një pjesë e bënë pacienti dhe një pjesë fizioterapisti. Pacientët në këtë pavion, pjesën më të madhe të kohës qëndrojn në shtrat dhe si pasojë na lind ne detyra që pacientëve mos ti ngrijë asnjë artikulacion në trupin e tij duke u trajtuar konkretisht në spitalet tona me tre séance fizioterapie.

Materiali dhe Metoda: Duke mobilizuar cdo artikulacion të trupit. Duke qenë se kemi pacient të cilët janë të detyruar të qëndrojn gjatë në shtrate për shkak të sëmundjeveve, edhe atrofia muskulore në shumë raste është prezente dhe ne punojmë me pacientin në ushtrime izometrike në mënyrë most e humbasim mase muskulore për sa kohë pacienti qëndron në shtrate.

Diskutimi: Në ICU shtrohen shumë pacient me probleme pulmonare dhe fizioterapistit i lind detyra të merret me këta pacient. Në varësi të gjendjes së pacientit dhe llojit të sëmundjes fizioterapistit i lind detyrë të merret me rritjen e kapacitetit pulmonar, ushtrime për mekanikën respiratore, stimulimi i kollës, përdorimi 3 Flow si dhe riedukimi i frymëmarrjes. Pasi bëhet prezantimi me rastin dhe historiku i sëmundjes së pacientit si dhe njohja me parametrat vital të tij dhe gjendjen fizike, muskulore, skeletike, fizioterapisti ndërton një strategji në mënyrë që pacienti të riaftësojë sa më shpejt në mënyrë që të bëhet autonomi sa më shpejt të jetë e mundur. Në spitalin Amerikan 3, janë trajtuar 157 pacientë me rezultate shumë të mira.

Konkluzioni: Roli i fizioterapisë është mjaft i rëndësishëm dhe ndihmë në trajtimin e pacientit që vuan nga Covid-19 sidomos në fazën e rehabilitimit.

Fjalët kyç: Covid-19, fizioterapi, terapi intensive

DIABETI DHE PARANDALIMI I TIJ

Lorena Mani, Resila Gjegji, Lujsida Shemuni, Erilda Latifi, Zeliha Rexha, Enida Xhaferi

Abstrakti

Hyrja: Diabeti njihet prej kohësh si një sëmundje që lidhet me rritjen e nivelit të glukozës në gjak. Edhe pse, në mbarë botën janë prekur me miliona njerëz nga diabeti, jo të gjithë janë të informuar mirë për natyrën e sëmundjes. Diabeti lidhet me praninë e përqëndrimit të tepërt, te glukozës në gjak dhe urinë, për shkak të prodhimit joadekuat të insulinës ose rezistencës ndaj saj.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të japë një kuadro të përmbledhur të kësaj sëmundjeje dhe se çfarë masash parandaluese duhet të kemi prioritet për të parandaluar diabetin apo për të patur një diagnostikim të hershëm, në mënyrë që terapia e dhënë nga specialistët të jetë më efikase.

Metodologjia: Zbulimi i hershëm i prediabetit dhe diabetit, si dhe ndërhyrjet në stilin e jetës, duke përfshirë dietën dhe stërvitjen, janë objektivat kryesore në parandalimin dhe menaxhimin e diabetit. Për individët që nuk arrijnë kontrollin e glicemisë me modifikimin e stilit të jetesës, ka klasa më të reja të mjekimeve që ndihmojnë. Diabetikët mund të bëjnë një jetë normale, me kusht që të marrin ilaçe të përshkruara, Modifikimi i stilit të jetesës (d.m.th. humbja modeste e peshës dhe rritja e aktivitetit fizik) është qasja më e qëndrueshme dhe efektive për parandalimin e diabetit. Medikamentet, duke përfshirë metforminën, akarbozën dhe tiazolidinedionet, janë terapi efektive për parandalimin ose vonimin e diabetit. Ndërhyrjet janë efektive në mosha dhe grupe të ndryshme etnike. Diabeti i pakontrolluar çon në disa nga ndërlikimet, si retinopati, nefropati, neuropati, ketoacidoze diuretike etj. Kështu që disa nga ndryshimet që duhet të bëjmë në stilin e jetës do luajnë një rol të madh për të parandaluar diabetin.

Konkluzionet: Zbatimi i këtyre gjetjeve në iniciativat e shëndetit publik ka qenë i ngadalshëm, të paktën pjesërisht për shkak të implikimeve të tyre financiare te të sëmurët diabetik. Përdorimi i këtyre metodave që në prezantimin me simptomat e para të sëmundjes së diabetit janë shumë efikase nëse pacientët i respektojnë si duhet këto këshilla.

Fjalët kyç: tipet, simptomat, komplikimet, dieta, ushtrimet, prandalimi.

AUTOIMUNITETI DHE SËMUNDJET REUMATIZMALE

Dr. Enida Xhaferi[1], Dr. Fatbardha Lamaj[2], Florjan Risilia[3], Dr. Esmeralda Thoma Hoxha[1], Dr. Altina Xhaferi[1]
[1]University of Medicine/Faculty of Medical Technical Sciences, Tirana, Albania
[1]Intermedica Laboratory, Tirana, Albania
[3]AKBPM, Tirana, Albania

Abstrakt

Sëmundjet autoimune (AD) përfshijnë një grup të gjërë, heterogjen patologjish, të cilat karakterizohen nga reagimi i komponentëve të sistemit imun, ndaj vetvetes. Spektri i çrregullimeve autoimune është i larmishëm, dhe çdo strukturë apo organ i trupit mund të sulmohet nga elementët e aktivizuar imunitarë, përfshi këtu: muskujt, enët e gjakut, zemrën, trurin, pulmonet e gjëndrën tiroide.
Shumica e këtyre patologjive përkeqësohen gradualisht, çka çon në krijimin e dëmtimeve të konsiderueshme indore, shumë kohë përpara, diagnostikimit të tyre përfundimtar klinik. Dëmtimet pasuese strukturore, mund të jenë të pakthyeshme. Ato reduktojnë ndjeshëm cilësinë e jetesës së pacientëve dhe ndikojnë negativisht në funksionimin e tyre familjar e shoqëror. Për këtë arsye diagnostikimi i shpejtë dhe fillimi i menjëhershëm i trajtimit mjekësor duhet të konsiderohen priorite profesionale, për të gjithë personalin mjekësor të impenjuar në menaxhimin e kësaj kategorie të sëmurësh.
Materiali studimor në vijim ka për qëllim të prezantojë shkurtimisht, disa prej mekanizmave kryesore patogjenetike dhe manifestimet më të rëndësishme klinike, të dy prej sëmundjeve prototip reumatizmale – Artritit Reumatoid dhe Lupusit Eritematoz Sistemik.

Lupusi Eritematoz Sistemik është një patologji komplekse, autoimune, multisistemike e karakterizuar nga prania e autoantikorpeve të drejtuara kundër acideve nukleik dhe proteinave të tyre. Shkatërrimi i tolerancës imune individuale, mendohet të jetë rezultat i ndërmveprimit kompleks ndërmjet komponentëve gjenetikë, faktorëve mjedisor dhe elementëve rastësor. Çrregullimi është shumë heterogjen dhe karakterizohet nga një larmi e madhe shenjash klinike. Pacientët shfaqin gjërësisht manifestime muskuloskeletike, mukokutaneale, renale, neurologjike, hematologjike e gastro-intestinale.
Artriti rheumatoid është një sëmundje e ndërmjetësuar imunologjikisht, në të cilën vihet re prania e citokinave inflamatore, autoantikorpeve, inflamacionit synovial, shkatërrimit artikular dhe invaliditetit të gradëve të ndryshme. Tipikisht, patologjia karakterizohet nga prania e poliartritit simetrik, në artikulacionet e vogla të duarve dhe këmbëve. Megjithatë, çdo artikulacion që ka membranë synoviale mund të dëmtohet. Krijim i panusit, shkatërimi i strukturave të kyçeve, si rrezultat i errozioneve kockore dhe të kartilagos, përfundon në krijimin e deformimeve tipike dhe invalidizimit rëndues.

Fjalët kyç: autoimuniteti, reumatizma

MANIFESTIMET EKSTRA MUSKULOSKELETIKE TEK PACIENTËT ME SPONDILIT ANKILOZANT

Dr. Enida Xhaferi[1], Dr. Altina Xhaferi[1], Asc.Prof. Dorina Ruci[2], Dr. Fatbardha Lamaj[3]
[1]*University of Medicine/Faculty of Medical Technical Sciences, Tirana, Albania*
[2]*University Hospital Center "Mother Theresa", Rheumatology Clinic, Tirana, Albania*
[3]*Intermedica Laboratory, Tirana, Albania*

Abstrakt

Spondiliti Ankilozant përbën një patologji kronike, inflamatore, përbërëse të grupit të Spondiloartropative (SpA), në të cilin përfshihen një gamë e gjërë çrregullimesh të ndërlidhura por klinikisht specifike, të përqëndruara kryesisht në artikulacionet e shtyllës kurrizore, ato sakroiliake, të qafës, disa artikulacione të mëdha dhe në organe të brendshme të tipit zorrë apo sy.
Ky grup, i cili përmbledh patologji të tilla si artriti psoriatik, artriti reaktiv, artriti bashkëshoqërues i sëmundjes inflamatore të zorrës, një nëngrup të artritit juvenil kronik dhe spondilitin ankilozant, klasifikohet në kategoritë e mëposhtme: Spondiloartrit aksial (SpA aksial) – i karakterizuar nga mbizotërimi i dhimbjes inflamatore në rajonin sakroiliak/shtyllën kurrizore ose në të dy nivelet njëkohësisht; SpA periferik ku predominojnë artritet periferike, entesiti e daktiliti dhe grupin e krijuar nga mbivendosja ndërmjet këtyre dy kategorive.
SpA aksial përmbledh format e herëshme inflamatore të çrregullimit të njohura si SpA jo radiografik dhe dëmtimet e mëtejshme, gjatë së cilave vërehen ndryshime strukturale në radiografitë konvensionale të artikulacioneve sakroiliake. Kjo fazë radiografike e sëmundjes njihet si Spondiliti Ankilozant klasik. Spondiliti ankilozant (SA) karakterizohet nga prania e inflamacionit në rajonin e shtyllës kurrizore, artikulacioneve periferike dhe organeve të brendshme. Diagnostikimi i saktë i patologjisë dhe menaxhimi i duhur terapeutik përbëjnë objektiva sfiduese për personelin trajtues mjekësor. Ky studim ka për qëllim të paraqesë shkurtimisht disa nga manifestimet kryesore ekstra muskuloskeletike të raportuara tek pacientët me Spondilit Ankilozant.
Prekja okulare vërehet shpesh tek të sëmurët, dhe uveiti anterior akut ose iridocikliti përbëjnë manifestimin më të shpeshtë ekstrartikular. Uveiti akut anterior shfaqet si një sindromë

unilaterale, me fillim të menjëhershëm, i cili mund të ketë gjithashtu natyrë përsëritëse. Pacientët raportojnë praninë e dhimbjes bezdisëse në sy ose ballë të shoqëruar me dëmtim të shikimit, fotofobi, dhe lotim të shtuar (epifora). Shfaqja e turbullimit të shikimit që është dhe shenja më e zakonshme, shkaktohet nga turbullimi i aqueos-it.

Fjalët kyç: spondilit ankilozant, manisfestime ekstra muskuloskeletike, spondiloartropati.

VLERËSIMI I BASHKËVEPRIMIT POZITIV TË POLIMIKSINËS B DHE NEOMICINËS NËPËRMJET PËRCAKTIMIT TË MIC/MBC DHE INDEKSIT FIC/FBC" (CHECKERBOARD METHOD).

Enkeleda Prifti

Abstrakt

Objektivi: Qëllimi i këtij studimi in-vitro është të përcaktojë se si ndërveprojnë Polimiksina B dhe Neomicina të kombinuara (Laboratoire innotech international) për të rritur aktivitetin ndaj disa baktereve shkaktarë të vaginitit/vaginozës infektive.

Metoda: Shtamet e testuara shkaktarë të vaginitit aerobik: Staphylococcus aureus (gram +), escherichia colii (gram -), strepctococcus agalactiae (gram +). Shtamet e testuara shkaktarë të vaginozës bakteriale (baktere anaerobe): Gardnerella vaginalis (gram+). Metoda e përcaktimit të përqëndrimit minimal inhibitor/ përqëndrimi baktericid minimal (MIC/MBC) në mikropjata u zgjodh për të përcaktuar efikasitetin e secilës substancë. Metoda e 'shahut' u përdor për të përcaktuar indeksin e përqëndrimin inhibitor fraksional (FIC) dhe përqëndrimin baktericid fraksional (FBC).
Nëse indeksi FIC/FBC është: ≤ 0.75: dy substancat aktive kanë aktivitet sinergjik, afër 1:dy substancat aktive kanë efekt aditiv, ≥ 2: dy substancat aktive kanë efekt antagonist.

Rezultatet: Përcaktimi i MIC/MBC për molekulat aktive të testuara veçmas tregoi: Aktivitet antibakterial të Polimiksinës B dhe Neomicinës kundër E.Coli karakterizuar nga efekt baktericid. Aktivitet antibakterial të Polimiksinës B dhe Neomicinës kundër S.Aureus dhe E.Coli, gjithashtu baktericid. Për sa i përket ndërveprimeve të Polimksinës B dhe Neomicinës, u tregua se: Nuk ka antagonizëm midis dy principeve active. Ka sinergji kundër S.aglactiae në inhibimin e rritjes dhe efekt baktericid pavarësisht kohës së kontaktit (2 deri në 24 orë). Ka sinergji në inhibimin e rritjes dhe efekt baktericid kundër S. aureus, me një rritje të indeksit të FBC sipas kohës së kontaktit (indeksi FBC afër 1 për 24 orë kohë kontakti). Bashkëveprim aditiv kundër E.coli dhe G. vaginalis

Konkluzioni: Ky studim in-vitro konfirmoi se Polimiksina B dhe Neomicina, në formulime të kombinuara, kanë spektër veprimi komplementar që sjell homogjenitet më të mirë të veprimit të tyre dhe mund të veprojnë në sinergji për të zgjeruar spektrat respektive të veprimit.

Fjalë kyç: polimiksina B, neomicina.

PREZANTIM RASTI I BRONKIOLITIT NË MOSHËN PEDIATRIKE

Artemona Sulaj, Yzeiri[1], Enkelejda Shkurti[2], Diamant Shtiza[2]
[1]*Spitali Rajonal Fier*
[2]*Universiteti i Mjekësisë Tiranë*

Abstrakt

Bronchiolitis obliterans është një (BO) sëmundje jo e shpeshtë e pulmonare obstruktive që ndjek një prekje të traktit të poshtëm respirator. Bronchiolitis i cili ndjek një sëmundje infektive të rëndë pulmonare është forma më e zakonshme e raportuar tek fëmijët. Ajo përfshin një proces nekrotizues kronik dhe fibrotik së fundmi i cili prek rrugët e vogla ajrore duke cuar në një dëmtim progresiv që rezulton me një sëmundje obstruktive pulmonare. Simptomat përfshijnë dispnenë , kollën kronike, prodhimin e sputumit dhe fishkëllimën. Megjithëse histopatologjia mbetet standarti i artë i diagnozës, skaneri është një ndihmë ,e madhe për diagnozën. Roli etiologjik i ventilimit nuk është studiuar mirë.

Paraqitje rasti: Ne raportuam një rast të një fëmije 8 muajsh mashkull në spitalin rajonal të Fierit në Maj 2021 që ushqehet me gji dhe sapo ka nisur ushqimet e ngurta. Ka qenë i pasemurur më parë. Referohet për temperaturë 2 ditë 39, kolle, fishkëllima.Nuk frekuenton cerdhen. Motra e tij 8 vjec , paraqitet me temperaturë. Prindërit infermiere janë të dy të vaksinuar për Covid 19.Nga ekzaminimet raportohet: Fr 50/ min, Sat O2 93% në ajrin e dhomës me tërheqje interkostale, nuk ka pirë mirë prej disa orësh, aktiv, diureza e ruajtur. Zemra shfaqet me tone ritmike Në pulmone vihen re rale sibilante e krepitante në të dy fushat pulmonare ,ekspirim i zgjatur. Diagnostikohet si bronchiolitis. Trajtimi perfshiu: Prednisolon 2 mg/kg i ndare në dy marrje, ventoline me aerosol cdo 6 ore, kortizonike me aerosol, lavazh i hundëve, vit D_3, probiotike. Pas komplikacionit shtohet në terapi: Oksigjenoterapi .Ampicilline (pas rendimit te shenjave klinike.

Konkluzion: Përfundimisht rasti u prezantua si bronchilitis me IRA. Trajtimi i duhur, ekzaminimet dhe ndjekja në vazhdimësi janë të nevojshme për shërimin e plotë të pacientit.

Fjalë kyç: Bronchiolitis,femije,Fier

PREKJA PULMONARE DHE NDIKIMI I SAJ NË PROGNOZËN E PACIENTËVE MË COVID -19

E. Kolovani, R. Osmënaj, E. Ramosaço, N. Kryemadhi, Sh. Kurti, N. Çomo

Abstrakt

Hyrja: Infeksioni nga koronavirus SARS-CoV-2, mund të shoqërohet me prekje të traktit respirator të poshtëm. Në këta pacientë inflamacioni pulmonar është manifestimi kryesor patologjik i COVID-19. Manifestimet e tomografisw sw kompjuterizuar (CT) tw toraksit ndryshojnë dhe përfshijnë, opacitete të tipit "ground-glass", konsolidime ose opacitete "ground-glass"të përzier me konsolidime. Shkalla e prekjes pulmonare është e lidhur ngushtë me gravitetin e insuficencës respiratore akute që shfaqin këta pacientë. Shumica e lezioneve janë të vendosura në zonën subpleurale periferike, kryesisht në lobet e pasme ose të poshtme.

Lezionet mund të shtrihen nga periferia në qendër, me rëndimin e situatës së prekjes pulmonare. Qëllimi i punimit është të shoh ndikimit që ka shkalla e prekjes pulmonare e këtyre pacientëve në momentin e hospitalizimit, në prognozën e sëmundjes.

Materiali: Në studim u përfshin 133 pacientë të shtruar në Spitalin COVID 1, QSUT "Nënë Tereza". Pacientët ishin të rritur të moshës ≥ 18, të konfirmuar laboratorisht me infeksion SARS-CoV-2, gjatë periudhës shtator-tetor 2020.

Rezultatet: Gjetjet në CT e toraksit në momentin e hospitalizimit të pacientëve ishin: në 22% të pacientëve u evidentua 0-25% prekje parenkimale e mushkërive, në 41% të pacientëve u pa 26% -75% prekja parenkimale e mushkërive dhe në 37% u pa më shumë se 75% prekje parenkimale pulmonare (e rëndë) p = 0.02. Gjatë qëndrimit në spital, 42.9% e pacientëve shfaqën IRA të tipit I, 6% e pacientëve zhvilluan fibrozë pulmonare, 3.8% patën tromboemboli pulmonare dhe 1.9 % e pacientëve u komplikuan me pneumotoraks. Shkalla e vdekshmërisë ishte 22.6%. Pacientët me prekje parenkimale pulmonre prej më shumë se 75% në CT e toraksit patën një shkallë vdekshmërie prej 57.14%. Pacientët me 26-75% të prekjes pulmonare patën vdekshmërie prej 3,77%, ndërsa pacientët me prekje më të ulët se 25% patën vdekshmërinë prej 0%.

Konkluzione: Pacientët e hospitalizuar me infeksion nga SARS-Cov2 me prekje bilaterale të parenkimës pulmonare ose me prekje të shumëfishtë lobesh në CT e toraksit në momentin e shtrimit në spital, patën një risk më të madh për përparimin dhe zhvillimin e IRA të rëndë. Studimi aktual tregon se përfshirja dhe ndryshimet e parenkimës së mushkërive > 75% në CT e toraksit është një faktor risku i pavarur që ndikon në shkallën e vdekshmërisë.

Fjalët kyçe: SARS-Cov2, tomografi e kompjuterizuar, prekje pulmonare, vdekshmëri.

EUROMELANOMA DHE FUSHATAT E SAJ MBI NDËRGJEGJËSIMIN NDAJ KANCERIT TË LËKURËS.

As. Prof. Entela Shkodrani

Abstrakt

Euromelanoma është një organizatë Paneuroiane e cila ka për qëllim të promovojë dhe shpërndajë informacion mbi parandalimin e Melanomes dhe Kancerit Jo melanocitik të lëkurës, diagnozës së hershme dhe trajtimit të tyre. Kjo shoqatë u themelua nga një rrjet dermatologësh Europiane në vitin 1999 të cilët ende sot zemërgjerësisht i dedikojnë kohën e tyre kësaj kauze. Aktivitetet e Euromelanomës janë fokusuar që të arrijnë të kenë vëmendjen e tre aktorëve kryesorë: publikut të gjerë, komunitetit shkencor dhe politikbërësve Europiane dhe Kombëtare. Për publikun e gjerë Euromelanoma ka vënë në dispozicion websit-in e saj i cili është vizituar prej më shumë se 10 milion vetë dhe një fushatë ndërgjegjësimi publiku vjetore, në të cilën promovohen njohuritë e përgjithshme mbi Kancerin e lëkurës, parandalimin, zbulimin e hershëm dhe trajtimin e tij. Këto aktivitete arrijnë kulmin e tyre në një screening publik gjatë një ditë të vetme të quajtur "Euromelanoma Screening Day". Rreth 450.000 vetë kanë përfituar ekzaminim falas të lëkurës gjatë kësaj dite. Në këtë organizatë mjekësore janë të përfshirë 45 vende Europiane dhe jo vetëm dhe me Shqipëria u bë pjesë e saj në vitin 2019, me një program të unifikuar sensibilizimi ndaj populatës me qëllimin e vetëm: parandalimin e melanomës dhe kancerit Jo Melanocitik të lëkurës.

Fjalë kyç: kanceri i lëkurës, jo melancitik, parandalim i melanomës.

INKONTINENCA URINARE

Eralda Dervishi, Albana Gjyzari
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë
Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti i Mjekësise Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Inkontinenca urinare është një siptom që lidhet më së shumti me moshën e tretë. Prevalenca e saj rritet me kalimin e moshës. Femrat janë më të prekura nga inkontinenca urinare për shkak të ndërtimit anatomik që ato kanë. Në femrat e moshës 20-39 vjec prevalenca shkon në 7%, 40-59 vjec 17%, dhe mbi 80 vjec 32%. Ndërsa prevalenca te burrat është sa 1/3 e grave dhe ajo barazohet në dekadën e 9 të jetës. Impakti i parë i inkontinencës lidhet me cilesinë e jetës dhe vetëvlerësimin. Tek moshat e reja dhe moshat e mesme inkontinenca urinare shkaktohet nga ifeksionet apo anomalit e ndryshme të traktit të poshtëm urinar. Tek të moshuarit inkontinenca urinare prezantohet si sindrom geriartrik i varur nga faktorët e rriskut si: mosha, ndryshimet fiziologjike, crregullimet fuksionale, morbiditetet (si frakturat).
Analiza e urinës rekomandohet për të gjithë pacientët me hematuria. Poliuria dhe bakteruria prezantohet si semundje asiptomatike. Të moshuarit kanë prevalenc më të madhe pë urinë reziduale të lidhur kryesisht me hiperaktivitetin e muskulit detrusor. Testi për urinë reziduale duhet bërë kryesisht tek pacientët me diabet melitus, retension urinar, infeksione rekurente urinare, medikamente që lidhen kontraktilitetin e muskulit detrusor.

Konkluzione: Vlersimi i inkontinencës urinare në të moshuarit duhet të jetë multifuksional duke përfshirë komorbiditetin, fuksionin, medikamentet. Korigjimi i faktorëve shkaktar të inkontinencës urinare është shumë i rëndësishëm në uljen e morbiditetit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

Fjalë kyç *:* inkontinenca urinare, sindrom geriartrik.

SKEPTICIZMI I PRINDËRVE MBI VAKSINËN MMR DHE MOSVAKSINIMI I FËMIJËVE

Erestinë Uka, Abetare Goga, Altea Shahollari, Ana Allkaj, Elvis Hyka, Kaltrina Gashi, Kejsi Balla, Kleotilda Kamaj, Mettisa Guleksi, Stelina Stanga, Urtina Baftiu, Valeria Prifti
Studente master shkencor, Universiteti i shkencave Mjeksore Teknike.

Abstrakti

Autizmi apo spektri i autizmit, i referohet një çrregullimi neurozhvillimor të karakterizuar nga ngecje dhe deficite në ndërveprimin social, komunikimin verbal dhe jo-verbal, sjellje të përsëritura dhe interesa të limituar. Vlerësohet se 1 në 44 fëmijë, diagnostifikohen me autizëm dhe shkaktari i tij akoma nuk është evidentuar përkundër debateve dhe kërkimeve të shumta. Vëmendje të veçantë dhe bujë të madhe kanë polemnikat mbi rrezikun potencial të vaksinës MMR dhe rolin e saj në autizëm. Nisur nga prevalence dhe ashpërsia e spektrit të autizmit, ky studim synonte të vlerësonte skpeticizmin e prindërve për të vaksinuar

fëmijët e tyre me MMR dhe opinionet që ata kanë mbi këtë debat. Në studim morën pjesë 65 prindër. Ndërsa, rezultatet konfirmojnë ekzistencën e këtij fenomeni edhe në Shqipëri, ku prindërit ngurrojnë të vaksinojnë fëmijët e tyre, 35% duke e shtyer vaksinimin kurse 13% duke e mos vaksinuar fare. Ky studim ka implikime kryesisht ne rrafshin praktik, duke sugjeruar kampanja dhe fushata informuese për prindërit e rinjë mbi autizmin, sigurin dhe efektet e vaksinës MMR.

Fjalët kyçe: Spektri i autizmit, Prindërit, Vaksinimi, MMR

TË DHËNA EPIDEMIOLOGJIKE, KLINIKE E LABORATORIKE NË PACIENTË TË HOSPITALIZUAR ME INFEKSION NGA SARS-COV 2

E. Ramosaço, E. Kolovani, N. Kryemadhi, Sh. Kurti, N. Çomo

Abstrakt

Hyrje: Infeksioni nga Coronavirus 2019 (COVID-19) përkufizohet si sëmundja e shkaktuar nga një koronavirus i ri i quajtur sindromi respirator akut i rëndë nga koronavirusi 2 (SARS-CoV-2), i cili u identifikua për herë të parë në qyteti Wuhan, Kinë. Fillimisht nga OBSH ai u raportua në 31 dhjetor 2019. Shumica e personave të infektuar shfaqin sëmundje me simptomatologji të lehtë deri në mesatare, të cilët shërohen pa kërkuar trajtim të veçantë. Megjithatë, një pjesë e personave të prekur shfaqin sëmundjë të rëndë respiratore dhe që kërkojnë kujdes të veçantë mjekësor. Personat e moshuar dhe ata me sëmundje bashkëshoqëruese, si sëmundjet kardiovaskulare, diabeti apo sëmundjet kronike të frymëmarrjes, kanë më shumë gjasa të zhvillojnë sëmundje serioze, deri në insufiçencë respiratore akute. Qëllimi është të analizojmë të dhënat epidemiologjike, klinike dhe laboratorike në pacientë të hospitalizuar me infeksion nga SARS-CoV2.

Materiali: Në studim u përfshin 165 pacientë të shtruar në Spitalin COVID 1, QSUT "Nënë Tereza". Pacientët ishin të rritur të moshës ≥ 18, të konfirmuar laboratorisht me infeksion SARS-CoV-2, gjatë periudhës tetor-nëntor 2021.

Rezultatet: Në studim u përfshin 165 pacientë, me moshë mesatare 60,46 ± 13,53 vjeç. 68.1% e pacientëve ishin meshkuj. Koha mesatare nga fillimi i simptomave deri në pranimin në spital ishte 8,8 ± 3,71 ditë. Nëntëdhjetë e tre pacientë kishin të paktën një sëmundje bashkëshoqëruese. Hipertensioni arterial u pa si patologjia më e shpeshtë (46.1% e pacientëve), e ndjekur nga diabeti mellitus (19.8% e pacientëve). Simptomat më të zakonshme përfshijnë: kollë, ethe, dispne dhe mialgji. Ekzaminimet laboratorike të kryera në momentin e hospitalizimit treguan se gjetjet jo normale më të shpeshta ishin: rritje të vlerave të proteinës C-reaktive në 52,1% e pacientëve, vlerë të rritur të LDH në 73.5% të pacientëve dhe limfocitopeni në 62.4% të pacientëve. Rritja e titrit të D-Dimer-it u pa në 28.1% të pacientëve.

Konkluzione: Pacientët e hospitalizuar me infeksion nga SARS-Cov2 ishin me moshë mesatare rreth 60 vjeç, me predominim të meshkujve. Hipertensioni ishte sëmundja bashkëshoqëruese më e shpeshtë. PCR dhe LDH e rritur dhe limfopenia ishin gjetjet më të shpeshta të evidentuara në këta paciëntë në momentin e hospitalizimit.

Fjalët kyçe: SARS-Cov2, hospitalizim, ekzaminim laboratorik, sëmundje bashkëshoqëruese.

NJË STUDIM MBI SHPËRNDARJEN STATISTIKORE PËR MELANOMËN DHE NEVUSET DISPLAZIK NË SHQIPËRI

Erion Sukaj[1], Albina Ndoja[2], Teona Bushati[1,2], Leart Berdica[1,2]
[1]*Spitali Amerikan*
[2]*Fakulteti i Mjekesise UMT*

Abstrakt

Hyrje: Melanoma dhe nevuset displazik janë neoplazi të lëkurës, diagnoza dhe trajtimi i hershëm i të cilave kërkon një ekspertizë të saktë dhe është i një rëndësie kritike për shëndetin e pacientit. Shqipëria duke qenë një vend mesdhetar dhe ku për shkak të pozitës gjeografike, shumicën e kohës njerëzit janë të ekspozuar ndaj rrezeve të diellit, rritet edhe mundësia për të zhvilluar lezione melanocitare të lëkurës si beninje ashtu edhe malinje.

Metoda: Në studimin tonë janë përfshirë gjithsej 177 raste në total nga të cilët 122 nevuse, 47 melanoma dhe 8 metastaza. Rastet janë marrë nga arkivi i Departamentit të Patologjisë së Spitalit Amerikan, Tiranë për vitet 2018-2019. Mostrat indore të tumoreve të fiksuar në formalinë dhe të ruajtur në blloqe parafine janë studiuar me ngjyrimin Hematoksilinë-Eozinë. Të dhënat u analizuan me anë të programit kompiuterik SPSS 20.0 IBM për të vlerësuar domethënien statistikore të tyre.

Rezultatet: Frekuenca nevuseve pëson rritje të ndjeshme në dekadën e 3-të dhe të 4-t dhe ulet në dekadën e 6-të ndërsa frekuenca e melanomave fillon të rritet në dekadën e 5-të, kulmon në dekadën e 7-të dhe ulet në dekadën e 9-të. Rastet e nevuseve janë 75% femra dhe 25% meshkuj, ndërsa për melanomat 49% janë femra dhe 51% janë meshkuj ku duket se shpërndarja është pothuajse e njëjtë. Në rastet e nevuseve ato që dominojnë janë: 42% me lokalizim në kokë, 26% me lokalizim në trung dhe 22% të paspecifikuara, anësitë e sipërme dhe të poshtme kanë shpërndarje të njëjtë me 5%. Ndërsa për rastet e melanomave ato që dominojnë janë: 18% me lokalizim në kokë dhe 29% me lokalizim në trung, anesitë e sipërme dhe të poshtme kanë shpërdarje pothuajse të njëjtë me 7%, 14% janë metastaza dhe 25% të paspecifikuara.

Konkluzioni: Rezultatet tona për melanomën përputhen me literaturën në shpërndarjen moshë-gjini si dhe në shpërndarjen e lokalizimit për të dy gjinitë në total, por jo në shpërndarjen lokalizim-gjini. Po ashtu ka përputhje për shpërndarjen moshë-gjini, por jo në shpërndarjen moshë-lokalizim. Përsa i përket nevuseve ka përputhje me literaturën në shpërndarjen sipas moshës për të dy gjinitë, por nuk përputhen për shpërndarjen ndërmjet gjinive.

Fjalët kyç: melanoma, nevuset displazike, studim.

BASHKEKZISTENCA E INDIT EKTOPIK TË TIROIDES DHE GJËNDRAVE TIROIDE NORMALE.

Erisa Kola[1], Daniela Nakuci[2], Ina Kola[3], Mehdi Alimehmeti[4]
[1]*Departamenti i Patologjisë, Gjirokastër, Shqipëri.*
[2]*Departamenti i Patologjisë, Vlorë, Shqipëri.*
[3]*Departamenti i Djegieve dhe Kirurgjisë Plastike, Tiranë, Shqipëri.*
[4]*Universiteti i Mjekësisë, Universiteti i Tiranës, Shqipëri.*

Abstrakt

Hyrje: Indi ektopik i tiroides është një anomali e rrallë zhvillimore që vjen nga një devijim në migrimin normal të gjëndrës tiroide, nga dyshemeja e pjesës së përparme primitive në pozicionin e saj përfundimtar. Zakonisht është asimptomatike, shpesh duke u diagnostikuar si një gjetje e rastësishme. I nënshtrohet transformimit malinj dhe shoqërohet klasikisht nga një transformim i ngjashëm i gjëndrës tiroide amtare. Ngjashëm me atë të gjëndrës tiroide amtare, malinjiteti më i zakonshëm i gjetur është karcinoma papilare e tiroides. Rastet e pazakonta në të cilat karcinoma ektopike e tiroides paraqitet me ind normal vendas, mbështesin një hipotezë alternative që indi ektopik i tiroides mund të zhvillojë tumore malinje në mënyrë të pavarur nga gjëndra tiroide vendase.

Objektivi: Ne paraqesim dy raste të rralla për të rritur rëndësinë e përfshirjes në diagnozën diferenciale të indit ektopik të tiroides, edhe kur ka dëshmi të gjëndrës tiroide të vendosur normalisht. 1. Një grua 30-vjeçare e diagnostikuar më parë me tiroiditin Hashimoto, duke u paraqitur me një masë të palpueshme në qafën anësore të dyshimtë për malinje. 2. Pacient mashkull 42 vjeç, me dispne, dhimbje gjoksi dhe lodhje. Testet laboratorike treguan nivele të ulëta serike të hormonit stimulues të tiroides (TSH) dhe një tomografi e kompjuterizuar torakale zbuloi një masë heterogjene në mediastinumin anterior.

Rezultatet: 1. Pas disa ekzaminimeve dhe heqjes kirurgjikale të masës, vlerësimi histopatologjik i seksioneve të vazhdueshme të tiroides, demonstroi sëmundje metastatike nga karcinoma papilare e tiroides. Tiroidektomia totale dhe biopsia zbuluan indin beninj të tiroides pa asnjë vatër mikrokarcinome. U bë një hipotezë e indit ektopik të tiroides dhe transformimit të tij malinj.
2. Pacienti iu nënshtrua një rezeksioni të plotë kirurgjik. Ekzaminimi histopatologjik postoperativ i masës tregoi praninë e indit ektopik beninj të tiroides në mediastinumin anterior pa asnjë provë malinje, së bashku me gjëndrat e vendosura normalisht.

Konkluzione: Këto raste nënvizojnë rëndësinë e marrjes parasysh të ETT kur merret parasysh diagnoza diferenciale e masës mediastinale. Qëllimi ynë është të evidentojmë dhe ndërgjegjësojmë mjekët për mundësinë e zhvillimit të karcinomës parësore të indit ektopik të tiroides, pa një tumor aktiv të gjëndrës tiroide. Testet diagnostike para operacionit mund të japin detaje anatomike të masës, megjithatë analiza histologjike është guri i themelit të konfirmimit diagnostik.

Fjalë kyç: Indi ektopik i tiroides, ETT, karcinoma papilare e tiroides.

MIKSOMA KARDIAKE: EKSPERIENCA E SHËRBIMIT TË KARDIOKIRURGJISË "QSUT" ME 49 RASTE

Ermal Likaj, Selman Dumani, Devis Pellumbi, Laureta Dibra, Saimir Kuci, Alfred Ibrahimi, Ali Refatllari

Abstrakti

Objektivat: Në këtë studim, u rishikua përvoja jonë me një numër të konsiderueshëm miksomash kardiake të operuara në periudhën Janar 2004 deri në Mars 2022.

Popullata e pacientëve dhe metodat: U operuan rishtazi 49 pacientë për miksomën kardiake. U vu re një dominancë e gjinisë femërore me 34 raste (69.4%) dhe 15 raste (30.6%) ishin meshkuj. Mosha mesatare ishte 56±12.33 vjeç. Gjatë kësaj periudhe u realizuan ekzaminime të detajuara të hershme dhe afatgjata klinike dhe ekokardiografike.

Rezultatet: Shumica e miksomave origjinonin nga atriumi i majtë në 47 (96%) pacientë dhe pjesa e mbetur nga atriumi i djathtë në 2 (4%) pacientë. Në ekokardiografi, miksomat prodhonin prolaps në ventrikulin e majtë në 42.4% të pacientëve dhe stenozë mitrale në 30,3 % të pacientëve. Shenjat kardiake si dispnea (57,57 %) dhe sinkopi (27,27 %) u shfaqën në shumicën e pacientëve dhe çuan në vendosjen e diagnozës. Eventet embolike preoperatore u hasën në 12,12 % të rasteve. Koronarografia u realizua në 27 pacientë dhe dy prej tyre kishin stenoza të izoluara te arterieve koronare. Përqasja rutinë ishte nëpërmjet sternotomisë mediane dhe bypass-it kardiopulmonar me kanjulim bikaval. Përqasjet kirurgjikale ishin incizioni atrial bilateral ose incizioni transeptal. Septumi atrial në vendin e inserimit u rezekua në 38 (77,55 %) të pacientëve dhe u mbyll me patch perikardi në 14 (28,57%) pacientë. Koha mesatare e klampazhit ishte 39.35±14.7 min. Tre pacientë iu nënshtruan procedurave konkomitante: CABG (2 pacientë) dhe zëvendësim të valvulës mitrale (1 pacient).
Mortaliteti i hershëm ishte 2.0% (një pacient 80 vjeç exitus nga hemoragjia masive gastrointestinale). Komplikacionet e hershme përfshinin fibrilacion atrial (3 pacientë), efuzionin perikardial (2 pacientë), rihapje për hemoragji (2 pacientë) dhe aksident cerebrovaskular (1 pacient). Pas interventit, 85,23% e pacientëve nuk patën simptoma kardiake. Follow-up afatgjatë ishte 63,48±43,55 muaj dhe prognoza ishte e shkëlqyer. Asnjë pacient nuk është rioperuar deri më sot për miksomë rekurrente.

Konkluzionet: Miksomat zakonisht u zbuluan dhe u operuan ne pacientë simptomatikë. Dyshimi i fortë është i rëndësishëm për diagnozën e hershme. Ekokardiografia ishte ekzaminimi imazherik kyç për diagnozën. Trajtimi i menjëhershëm kirurgjikal u indikua për shkak të rrezikut të lartë të embolizimit ose vdekjes së papritur.

Fjalët kyç: miksoma kardiake, kardiokirurgji, QSUT.

MIOKARDITË NË PACIENTËT ME SARS-COV2

Ermir Tafaj[1]

Abstrakt

SARS-CoV-2 mori një vëmendje të gjerë në fundin e vitit 2019, kur pas shpërthimit në zonën e Ëuhan-it në Kinë, u vu re se virusi ishte përgjegjës për shfaqjen formave të tënda të sindromës së detresit respirator. Me kalimin e kohës u vërtetua se përvec prekjes pulmonare, kishim prekje edhe të sistemeve dhe organeve të tjera sic janë komplikacionet kardiake të tilla si: miokarditi, aritmitë jetëkërcënuese, sindromi koronar akut, insuficiensa kardiake dhe shoku kardiogjen. Është akoma e paqartë mënyra dhe mekanizmi i shfaqjes së miokarditit tek këta pacientë, megjithatë studime me numra disi të limituara, tregojnë një korrelacion midis SARS-CoV-2 dhe shfaqjes së miokarditit. Të dhënat e pakëta nuk e qartësojnë shumë tablonë rreth prevalencës dhe prognozës, si dhe faktin nëse miokarditi është komplikacion indirekt i sëmundjes apo një manifestim direkt nga ana e virusit. Diagnostikimi bazohet në klinikën e pacientit, elektrokardiogramën, testet laboratorike, ekokardiografi, rezonanca magnetike dhe biopsia endomiokardiale, janë hapat e nevojshëm për vënien e diagnozës.

Fjalë kyç : miokardia , ekokardiografi , rezonanca magnetike.

SËMUNDJET E RRALLA ME MANIFESTIME KUTANE

Prof. Ermira Vasili[1], Prof. Anila Babameto[2], Prof. Ass. Monika Fida[1]
[1]Departmenti i Semundjeve Infektive dhe Dermatologji, Fakulteti i Mjekesise, Universiteti Mjekesor i Tiranes, Shqiperi.
[2]Shërbimi i Gjenetikës, Qendra Universitare Spitalore "Nënë Teresa", Universiteti Mjekësor i Tiranës, Shqipëri.

Abstrakt

Hyrje: Sëmundjet e rralla janë sëmundje që prekin më pak se 5 individe në 10,000 persona. Referuar kompleksitetit, shkallës së rëndesës dhe kohëzgjatjes këto sëmundje mund të cojnë në ndryshime degjenerative, paaftësi dhe cënim të dukshëm të kualitetit të jetës. Në rast të diagnostikimit të hershëm shumë nga këto sëmundje mund të trajtohen, të mbahen stabël dhe të përmirësohet ndjeshëm cilësia e jetës së pacientit dhe të familjarëve.

Qëllimi i prezantimit: Të njihemi me karakteristikat epidemiologjike dhe klinike të sëmundjeve të rrallë në vendin tonë. Këto të dhëna do të kenë vlerë për të kontribuar në literaturë dhe do të shërbejnë si bazë për studime të mëtejshme. Nëpërmjet këtij prezantimi ne do të përpiqemi për të sensibilizuar mjekët e familjes, mjekët pediatër dhe dermatolog për sëmundjet e rralla dhe manifestimet kutane të tyre.

Materiali dhe Metoda: Studim retrospektiv i pacientëve të diagnostikuar dhe të hospitalizuar në Shërbimin e Dermatologjisë, QSUT " Nënë Teresa" në periudhën 2014 - 2022 . Të dhënat e pacientëve u morën nga kartelat klinike të tyre dhe u përpunuan në sistemin statistikor SPSS. Pacientët u përzgjodhën referuar listës së sëmundjeve të ralla NORD (National Organization for Rare Disorders).

Rezultate: Rreth 120 pacientë u diagnostikuan me sëmundje të rralla në harkun kohor 2014-2022. Rreth 48% ishin meshkuj dhe 52% femra. 36 sëmundje të rralla me prekje në lëkurë për arsye didaktike u klasifikuan si me poshtë : I- Grupi i patologjive neuro-kutane. II- Grupi i patologjive kongenitale. III- Grupi i sëmundjeve të rralla me etiopatogeneze të ndryshme.

Konkluzione: Sëmundjet e rralla janë sëmundje që kërkojnë vëmendje të vecantë nga mjeku i familjes, mjeku pediatër dhe dermatolog në mënyrë që të diagnostikohen sa më herët, të realizohet trajtimi i mundshëm, dhe të mbahen nën kontroll në mënyrë që të përmirësojme kualitetin e jetës se këtyre pacientëve dhe të familjeve të tyre.

Fjalë Kyç: Sëmundje të rralla, manifestime kutane, neurofibromatosis, sëmundja Darier, Pyoderma Gangrenosum, Ichtiosis Vulgaris, Sapho Sindrom, PASH sindrome.

IMPAKTI POTENCIAL PSIKO-EMOCIONAL I COVID-19 TEK STUDENTËT E VITIT TË PARË, FSHMT. NDËRHYRJE TERAPEUTIKE TË MUNDSHME

Ervin Marku[1], Xhesika Miska[2]
[1]FSHMT, Universiteti Mjekësor Tiranë
[2]Spitali francez, Okulistikë, QSUNT

Abstrakt

Hyrje: Pandemia e COVID-19 goditi mbarë botën në mënyrë agresive për dy vite rresht, duke ndikuar në jetën tone të përditshme. Një nga shtresat që u prek si direkt ashtu edhe indirekt ishin studentët universitarë edhe në vendin tonë të cilët praktikuan mësimdhënien online në kushtet emergjente të pandemisë.

Qëllimi: Studimi jonë është i tipit transversial anketues për të vlerësuar perceptimin e impaktit psiko-emocional të Covid-19 tek një kampion studentësh të vitit të parë, dega infermieri, si dhe të propozojmë ndërhyrje e mundshme terapeutike në mbështetje të shëndetit mendor të tyre.

Metodologjia: Sondazh nëpërmjet anketimit duke përdorur katër pyetje të vetë-punuara mbi përceptimin e impaktit psiko-emocional të pandemisë Covid-19 për 292 studentë. Sondazhi u realizua me anë të programit google forms, duke ruajtur anonimitetin.

Rezultate: Vlerësuam se 38.4% e studentëve të anketuar perceptojnë se arsyeja kryesore e ndryshimeve psiko-emocionale vjen si pasojë e mungesës së shpresës për të ardhmen pavarsisht pandemisë, e ndjekur nga nje shifër prej 26% të tyre që fajësojnë COVID-19 dhe implikimet e tij si shkakun e stresit të tyre të shtuar. Ndërkohë që 19,9% listojnë shqetësime të tjera personale dhe një përqindje prej 15.8% vendos problemet familjare dhe arsyet sociale si faktorë të ankthit që ndjejnë. Pyetjes nëse mendonin se pandemia do ketë impakt afatgjatë në shëndetin mendor, i janë pergjigjur pozitivisht 77,4% e tyre. Ndërkohë që 94,2% e studentëve mendojne se duhet të implementohen struktura të këshillimit psikologjik pranë fakulteteve dhe 92% e tyre besojnë se këto struktura do kenë efekt pozitiv në përmirësimin dhe menaxhimin e stresit psioko-emocional në terma afatgjatë.

Përfundime: Nga rezultatet e marra përceptohet se pandemia ka ndikuar ndjeshëm në shëndetin mendor të studentëve, pasojat e së cilës mund të kenë efekt afatgjatë sipas studimeve të fundit. Disa nga ndërhyrjet e mundshme terapeutike në nivel makro bazuar tek literatura këtë fushë janë:

- Implementimi i strukturave të këshillimit psikologjik në Universitetin Mjekësor të Tiranës.
- Hartimi i strategjive të nxitjes dhe suportit të aktiviteteve sportive dhe rekreacionale.

Qëllimi i këtyre ndërhyrjeve potenciale është parandalimi dhe menaxhimi i stresit psiko-emocional tek studentët universitarë. Në këtë mënyrë, brezat e ardhshëm të personelit të shëndetit parësor, sikurse do jenë infermierët, të kenë aftësi sa më të mira për të superuar ngarkesat psikologjike të profesionit, por jo vetëm.

Fjalët kyç: covid-19, sondazh, studentët e infiermierisë, impakti psiko-emocional, ndërhyrjet potenciale.

TUMORI KRUKENBERG I VEZORËVE - RAPORTI I RASTIT NË FEMRA 52 VJEÇ.

Ervisi Rapaj[1], Leart Berdica[2], Robert Meta[3], Aleks Sulejmani[4]

[1] MD.Reparti i Patologjise Spitali Rajonal Fier.

[2] Dr. Sci. Departamenti i Patologjisë, Spitali Amerikan, Spitali Nënë Tereza.

[3]MD. Departamenti i Kirurgjisë, Spitali Rajonal Fier, Spitali Amerikan.

[4]*MD. Departamenti i Gastrologjisë, Spitali Rajonal Fier, Spitali Amerikan.*

Abstrakt

Një tumor krukenberg është një lloj i rrallë dhe specifik i tumorit që rritet në vezore. Megjithatë, një tumor krukenberg nuk është rreptësisht një kancer ovarian. Këto tumore shkaktohen nga një kancer tjetër, zakonisht kanceri i stomakut, i cili është përhapur (metastazuar) në vezore. Emri vjen nga mjeku gjerman Friedrich Krukenberg i cili zbuloi këtë tumor ovarian në 1896 pa e ditur origjinën e tij të vërtetë.
Këtu po paraqes një rast të rrallë të një gruaje 52 vjeçare e cila është paraqitur me masa bilaterale ovariane. Kirurgët i bënë histerektominë me salpingooforektomi dypaléshe. Pas ekzaminimit histopatologjik sugjeruam diagnozën e tumorit Krukenberg.

Fjalë kyç: Tumori Krukenberg, Vezore, Stomaku, Friedrich Krukenberg

PNEUMOMEDIASTINUM NË MOSHAT E REJA TEK PACIENTËT ME COVID-19

Esi Duka , Najada Çomo[1], Arjan Harxhi[1], Esmeralda Meta [1].
[1]*Shërbimi i Sëmundjeve Infektive, QSUT "Nënë Tereza", Tiranë.*

Abstrakt

Qëllimi. Përshkrimi i një rasti me Pneumomediastinum, në pacient 23 vjeç të infektuar me COVID-19 në kushtet e insufiçiencës respiratore për shkak të pneumonisë intersticiale.

Prezantimi i rastit. Pacienti, 23 vjeç paraqitet në klinikën e Sëmundjeve Infektive me vështirësi në frymëmarje, kollë të thatë, dhimbje gjoksi, dhimbje muskujsh, dhimbje kyçesh, humbje të shijes, dhimbje fyti, dobësi të theksuar trupore, diarre. Ai referonte se këto ankesa i kishin filluar përpara 11 ditësh. Pacienti i pavaksinuar ndaj COVID-19.Në momentin e shtrimit në spital në ekzaminim objektiv evidentohet emphyzeme subkutane cervikale dhe një respiracion i ashpër në të dy fushat pumonare me Sat O2 94 me 10 L oksigjen.Në gjakun periferik u konstatua: Leukocite 10.1 K/µL, Eritrocite 5.57 10^6/µL, Lymphocite 9.6 %, Neutrofile 88.8 %. Ne bilancin biokimik u konstatua: Glukoze 129 mg/dL, LDH 956 U/L, CK 723 U/L, AST 55 U/L, urea 49.8 mg/dL, Na + 134 mmol/L, Cl 96 mmol/L. Protein C-reaction (PCR) rezultoi 17.91 mg/dL (norma eshte <0.5 mg/dL). Fibrinogjen 738 mg/dL, D-Dimer 0.52 µg/mL, APTT 27.2 sec, PT 90 %, INR 1.07. Ferritin 1404.53 ng/mL. Ne astrupograme u konstatua: PO_2 45.3 mm Hg, PCO_2 36.2 mm Hg, PH 7.459, $cHCO_3$ 25.1 mmol/L, BE 1.6 mmol/L, S O_2 83,7 %. Tamponi RT-PCR nga ISHP rezultoi pozitiv për Covid-19. Ne CT thoraxi u evidentua: Pneumomediastinit i madh.Emphyzeme subcutane.Pneumoni intersticiale COVID 2.U realizua ndjekja në dinamike edhe nga kirurgu thorakal ku u realizua edhe drenimi në zonën cervikale (te emphizemes subkutane). Pacienti u trajtua me antibiotikoterapi (Tazobactam 4.5 g, ivx3, Levofloxacine 0.5 g/100 cc, ivx1), Dexamethazon 4 mg, 3x2 amp iv; Dalteparine 5000 UI/0.2 cc, 2x1 s.c; Omeprazol 40 mg, ivx1; vitaminoterapi, O_2-terapi sipas Sat O_2 (15 liter O_2 me maskë faciale), likide, elektrolite sipas astrupogramës dhe antipiretik. Iu aplikua që ditën e parë të hospitalizimit Tocilizumab 400 mg/20 mL, 2 fl (fl i dytë pas 12 orësh pas dozës së parë).

Konkluzionet. 1.Pneumomediastinum eshte nje ndërlikim i rrallë i pneumonisë nga COVID-19 në të cilën etiopathogjeneza konsiston në prekjen severe pulmonare që mund të ndikohet ose jo nga përdorimi i ventilimit mekanik invaziv. 2.Vaksinimi ndaj Covid-19 do të

parandalonte shfaqjen e komplikacineve jetë kërcënuese në pacientët dhe minimizimin e shtrimeve ne spital.

Fjalë Kyç : covid-19 , trajtimi , pneumomediastinum

ROLI I INFERMIERIT NË MENAXHIMIN E PACIENTIT TË PARAQITUR URGJENTISHT ME DIAGNOZËN E KOMËS OPIOIDE.

Dr Esmeralda Thoma[1]. Valentina Kasemi
[1]Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Abstrakt

Hyrje: Koma opioidale shkaktohet nga mbidoza e opioideve (heroina). Trajtimi i tij zakonisht bëhet me antagonistin opioid, naloksonin. Heroina mund të shkaktojë nauze dhe të vjella, një numër i konsiderueshëm vdekjesh që i atribuohen mbidozimit të shkaktuar nga aspirimi i të vjellave nga një person pa ndjenja. Kryesisht doza mesatare vdekjeprurëse (për një individ naiv mesatarisht 75 kg opiate) është midis 75 dhe 600 mg. Varësia nga heroina shpesh trajtohet me medikamente që përfshijnë buprenorfinën, metadonin ose naltreksonin.

Qëllimi: Nëpërmjet këtij studimi synojmë të vlerësojmë mënyrat e duhura të ndërhyrjes infermierore në trajtimin e pacientit të paraqitur në urgjencë me diagnozën e komës opioidale.

Metoda: Ky studim shkencor bazohet në marrjen e informacionit selektiv nga një kërkim i literaturës nga faqet zyrtare si Medline, Google Scholar, National Library of Medecine, PubMed dhe përvoja klinike e mjekëve. Në këtë studim u analizuan mjekimet dhe ndërhyrja e personelit mjekësor të urgjencës në koma opioid.
Përfundim: Një mbidozë e heroinës mund të trajtohet me nalokson. Heroina shkakton nauze, të vjella, humbje të vetëdijes, depresion në frymëmarrje, funksion të dëmtuar mendor. Mbidozimi çon në vdekje të shpejtë, kërkon ndërhyrje urgjente.

Fjalët kyç: koma opioid, nalokson, heroinë, vdekshmëri e lartë.

SA LARG MUND TË SHKONI NGA ABUZIMI ME STEROIDE? RAPORTIM RASTI

PhD. Esmeralda Thoma[1], PhD. Lordian Nunci[2], MD. Amarildo Hidri[2], MD. Sonila Bitri[3], MD. Emirvina Kolici[4]
[1]Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" / Shërbimi Klinik i Toksikologjisë; Universiteti i Mjekësisë / FSHMT
[2]Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" / Shërbimi Intensiv
[3]Spitali Amerikan 2
[4]Universiteti i Mjekësisë / FSHMT

Abstrakt

Përdorimi i steroideve anabolike androgjenike (AAS) tek të rinjtë e përfshirë në aktivitetet e fitnesit është rritur vitet e fundit në Shqipëri. Shumica e tyre nuk janë të informuar mirë për pasojat shëndetësore që lidhen me përdorimin e pakontrolluar të këtyre AAS. Ne raportojmë

këtu një rast të një burri 37 vjeç të paraqitur në urgjencë me agjitacion pschykomotor i cili shoqërohej me përdorimin e AAS. Pacienti është gjetur pa ndjenja në një lokal dhe është transportuar me ambulancë në urgjencë. Me të mbërritur, pacienti ishte ende pa ndjenja, kishte agjitacion psikomotor dhe gjak nga goja. Frekuenca e zemrës ishte 97/minutë, presioni arterial 170/97 mmHg, saturimi i O2 70%, niveli i glukozës në gjak ishte 82 mg/dl. Pacienti ka qenë përdorues intravenoz i drogës, por muajt e fundit ka qenë në trajtim zëvendësues me metadon. Menjëherë pas mbërritjes u bënë të gjitha analizat e gjakut. Gazi arterial i gjakut rezultoi në acidozë të rëndë me pH 7.03 dhe nivele të ngritura të disa enzimave; enzima më e ngritur ishte CK (39600UI/l). Pas marrjes së historisë së tij mjekësore nga familja e tij dhe një ekzaminimi të kujdesshëm, pacienti u diagnostikua "Rhambdomiolizë për shkak të abuzimit me AAS". Duke parë gjendjen klinike të pacientit, ai u transferua në repartin e kujdesit intensiv për ekzaminime dhe trajtim të mëtejshëm. Pas disa ditësh ai doli nga spitali në gjendje të mirë shëndetësore.

Përfundim: Duhet t'i kushtojmë më shumë vëmendje përdorimit të steroideve anabolike te pacientët me jetë aktive fitnesi dhe kur është e mundur duhet të informojmë pacientët për pasojat shëndetësore që lidhen me përdorimin e pakontrolluar të steroideve anabolike.

Fjalët kyç: përdorim anabolik, steroid, përdorues intravenoz të drogës.

PËRDORIMI I STEROIDEVE ANABOLIKE – ANDROGJENIKE. RISHIKIM LITERATURE.

PhD. Esmeralda Thoma[1], Prof. Enkelejda Shkurti[2], MD. Sonila Bitri[3], MD. Emirvina Kolici[2], Alma Pula[2]

[1]Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" / Shërbimi Klinik i Toksikologjisë, Universiteti i Mjekësisë / FSHMT
[2]Universiteti i Mjekësisë / FSHMT
[3]Spitali Amerikan 2

Abstrakt

Steroidet anabolike androgjenike (AAS) janë një grup kompleks molekulash që përfshijnë si androgjenët steroidë ashtu edhe komponime sintetike, që rrjedhin nga testosteroni. AAS përdoren zakonisht për të mbështetur terapinë farmakologjike në rastet e hipogonadizmit parësor ose dytësor, djegieve të mëdha dhe kaheksisë neoplazike. Konsumimi i tyre i zgjatur dhe mbifiziologjik mund të provokojë disa efekte negative në organe dhe sisteme të ndryshme. Gjatë 30 viteve të fundit, ka pasur një interes në rritje të mediave, politikave dhe akademikëve për këtë formë të përdorimit të drogës, në veçanti klasifikimi i barnave që përdoren për të rritur madhësinë dhe forcën e muskulaturës. Më të dukshmet brenda kësaj kategorie janë steroidet anabolike androgjenike (AAS) dhe barnat e lidhura me to. Tregu i steroideve anabolike-androgjenike (AAS) po rritet gjithnjë e më shumë. Numri i njerëzve që i përdorin ato është në rritje edhe në Shqipëri. Dëshmitë janë rritur shumë vitet e fundit për të mbështetur të kuptuarit e kësaj forme të përdorimit të substancave dhe dëmtimeve shëndetësore që lidhen me të. Ky është një përmbledhje e literaturës në lidhje me përfitimet shëndetësore dhe pasojat që vijnë nga përdorimi i tyre. Rritja njerëzore e përdorimit të këtyre substancave ndryshon nga format e tjera të përdorimit të drogës për shkak të motivimit ose qëllimit të përdorimit të tyre. Në mënyrë tipike, ato nuk konsumohen as për trajtimin e një sëmundjeje ose dëmtimi dhe as për kënaqësi të menjëhershme nëpërmjet vetive të tyre psikoaktive. Në vend të kësaj, funksioni i tyre është një përpjekje për të ndryshuar pamjen e një individi ose për të përmirësuar një aftësi, aftësi ose aktivitet. AAS përdoren në mjedisin

klinik për të kundërshtuar disa efekte anësore në trajtimin e disa sëmundjeve, të tilla si osteoporoza, anemia aplastike dhe hipogonadizmi ndër të tjera, dhe gjendjet e lidhura me kaheksinë si djegiet, HIV, dështimi renale dhe hepatike dhe kanceri. Përdorimi i tepërt i këtyre substancave shoqërohet shumë me ngjarje kardiovaskulare, si infarkti akut i miokardit, goditjet në tru, hepatotoksiciteti, toksiciteti i sistemit renal, çrregullimet mendore etj.

Fjalët kyç: steroid anabolik-androgjen, abuzim, shëndeti.

KUJDESI I PERSONELIT INFERMIEROR NE PACIENTET ME COVID-19.

Eugen Ismolli[1]
[1]*Kryeinfermier në Repartin e Terapisë Intensive, Spitali Amerikan 3*

Abstrakt

Hyrje: Covid-19 paraqet një sërë problemesh të rëndësishme për implikimin e shumë organeve edhe pse me fokus mushkëritë. Për këtë arsye një pjesë e pacientëve shtrohen në terapi intensive, në të cilën roli infermieror është mjaft i rëndësishëm dhe thelbësor.

Materiali dhe Metoda: Si çdo pacient tjetër në terapi intensive, trajtimi infermieror mbështetet në të njëjtat parime duke shtuar në këtë rast edhe protokollet e mbrojtes së personelit si edhe parandalimin e përhapjes mes tyre.

Diskutimi: Siç dihet virusi përhapet nëpërmjet spërklave respiratore gjatë kollitjes dhe/ose asistencës respiratore tek këta pacientë. Repartet e urgjencës dhe të terapisë intensive janë mjaft të rrezikuara. Prezantimet klinike janë mjaft të ndryshme dhe perfshijnë që nga simptomat respiratore (kollë, rrufë, vështirësi në frymëmarrje), dhimbje fyti, mialgji, simptoma gastrointestinale (diarre, nausea, të vjella, dhimbje barku). Përgjegjësia kryesore infermierore është të mbrojnë vetveten dhe të minimizojnë trasnmetimin. Për këtë arsye shërbejnë trajnimi dhe përvetësimi i protokolleve të përdorimit të PPE, si edhe organizimi në Terapi intensive të ambienteve të vecanta ku do trajtohen këto pacientë. Përdorimi jo adekuat i PPE, cilësia jo e përshtashme e tyre, apo edhe tendencat për risterilizim, janë faktorë për te rritur transmetimin dhe ankthin ndërmjet personelit infermieror. Numri i personeli në dhomat ku trajtohen pacientët me Covid-19, duhet të jetë i kufizuar dhe i justifikuar. Nga ana tjetër ka rëndësi komunikimi midis stafit që pret pacientin dhe stafin e që bie në spital, me qëllim marrjen e masave paraprake mjekësore dhe të sigurisë. Kur pacienti paraqitet në terapi intensive, aty infermieria e monitoron dhe krijon një përshtypje të përgjithsme mbi shenjat vitale të pacientit dhe situatën klinike. Pas monitorimit dhe oksigjenoterapisë në varësi të gravitetit të situatës, realizohet marrja e analizave që përshijnë gjak komplet, ddimer, ferritinemi, fibrinogjen, crp, prokalcitoninë, si edhe egzaminimet e tjera që kërkon mjeku.

Konkluzioni: Trajtimi i këtyre pacientëve përvec asistencës respiratore përfshin edhe kujdesin për organet vitale, nutricionin, parandalimin e dekubituseve, fizioterapinë, dhe kujdes për suportin psikologjik sipas rastit.

Fjalët kyç: Covid-19, ARDS, Kujdes infermieror

NJOHJA E SINDROMËS NEUROLEPTIKE MALINJE- DIAGNOZA DHE MENAXHIMI NË SHËRBIMET E URGJENCËS

Fatime Elezi
Universiteti Mjekësisë Tiranë, Fakulteti Mjekësisë. Departamenti Neuroshkencës. Shërbimi Psikiatrisë, QSUT "Nënë Tereza".

Abstrakt

Hyrje: Sindroma neuroleptike malinje (NMS) është një situatë mjekësore, relativisht e rrallë, efekt anësor i paparashikueshëm, potencialisht kërcënuese për jetën e shkaktuar nga përdorimi i antipsikotikëve. Ky sindrom manifestohet me ndryshime të statusit mendor, temperaturë, rigiditet dhe disfunksion të sistemit nervor autonom. Shkalla e mortalitetit së fundmi është më e ulët 0.02-3%.

Objektivi: njohja e incidencës, shkaqeve, faktorëve të riskut, patogenezës dhe e klinikës ndihmon mjekun në identifikimin, diagnostikimin dhe ndërhyrjen e shpejtë për trajtim adekuat.

Metoda: rishikim i literaturës më të fundit, artikuj të marrë në PubMed, MEDLINE (2010-2022) një rishikim thelbësor mbi raportimet të një seri rastesh me NMS dhe të tjera informacione klinike dhe teorike të vlefshme për punën e një klinicisti.

Rezultatet: Neuroleptikët mund të shkaktojnë sindromën malinje, përfshirë edhe gjeneratën e re. Rritja e standarteve të kujdesit dhe njohja e plotë e NMS është përmirësuar sidomos në dekadat e fundit. Trajtimi specifik dhe simptomatik, si likidet intravenoze, antipiretikët dhe korigjimet e nevojshme për dehidratimin, disbalanca elektrolitike, monitorim i funksionit renal, kardiorespirator janë të indikueshme dhe të nevojshme.

Konkluzione: NMS është e rrallë por një çrregullim potencialisht fatal, ka variabilitet në mënyrën e fillimit dhe pacientët me këtë sindrom shpesh paraqiten në urgjenca të përgjithshme. Menaxhimi i pacientëve me NMS bazohet në ashpërsinë e tablosë klinike dhe të sigurisë diagnostike. Përdorimi i Dantrolenit dhe Amantadinës konsiderohen si trajtim i rëndësishëm në përmirësimin e rezultateve të mjekimit. Ndjekja e kujdeshme e pacientëve, ndërhyrja dhe trajtimi në kohë garaton ulje të vdekshmërisë.

Fjalë kyç: sindroma neuroleptike malinje, etiopatogjeneza, paraqitja klinike, trajtimi.

PAMJAFTUESHMËRIA AKUTE E VESHKAVE

Dr.Fatlume Arifaj

Abstrakt

Pamjaftueshmëria akute e veshkave karakterizohet nga një rritje reversibile e përqendrimit të kreatininës dhe produkteve të azotit si rezultat i paaftësisë së veshkave për të mbajtur në mënyrë adekuate të balancuar homeostazën e lëngjeve dhe elektrolitëve.

Qëllimi i punimit: është që të hulumtoj rreth literatures më të re në lidhje me PAV si dhe përcaktimi i shkaktarëve më të shpesht të të tri formave të kësaj sëmundje, determinimi i

formës mbizotëruese,përcaktimi i moshës dhe i gjinisë të paicentëve, në Kliniken e Pediatrisë, pranë QKUK-së.

Metodat e hulumtimit: metoda e përdorur për këtë hulumtim është metoda retrospektive. Të dhënat janë grumbulluar në Kliniken e Pediatrisë, pranë Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, dhe përfshijnë 5 vite 2011-2016.

Rezultatet: Nga 59 pacientë me PAV, 28 kanë qenë femra kurse 31 meshkuj. Me llogaritjen në përqindje kuptojmë që 47% të pacientëve janë femra kurse 53% janë meshkuj. Më së shumti nga PAV preken moshat e reja e sidomos fëmijët nga 1 deri në 5 vjeç.

Përfundimet: PAV është më e shprehur në rradhët e gjinisë mashkullore, dhe atë me 53% në krahasim me 47% të rasteve të gjinisë femërore. Prej të tri formave të PAV vërehet që më e shpesht është forma Pre-renale. Më së shumti nga PAV preken moshat e reja e sidomos fëmijët nga 1 deri në 5 vjeç.

Fjalë kyç: Pamjaftueshmëria akute e veshkave, kreatinina, elektrolitë.

DREJTUESIT E AUTOMJETEVE PËRGJEGJËSIA PENALE CIVILE DHE ADMINISTRATIVE , ROLI I DROGAVE DHE ALKOOLEVE NË GJËNDJEN E TYRE FIZIKE DHE PSIKIKE

Prof.As.Arben Lloja, Dr. Ilir .Decolli, Dr.Shk.Elmas Shaqiri, Dr. Fatos Sinani, Dr.Donjet Lloja

Abstrakt

Në këtë punim jemi nisur nga një realitet konkret, nga prania në jetën e përditshme të pjesës dërrmuese të shoqërive të kohës sonë, të rasteve të aksidenteve të shkaktuara me/nga mjetet lëvizëse motorike.
Të tilla aksidente, të cilat mund të jenë shpesh edhe vdekjeprurëse, mund të thuhet se përbëjnë edhe një nga problemet më shqetësuese të shoqërive të kohës sonë, kryesisht atyre të industrializuara, duke krijuar kësisoj një paradoks dhe ironi: krahas një mjeti që synon të rrisë mirëqenien, mjetet lëvizëse motorike janë kthyer edhe në burim jo i vogël vdekjesh dhe, në raste "fatlume", traumash në sfrerën dhe jetën fizike, psikike dhe shëndetësore të të aksidentuarve. Një realitet i tillë kaq shqetësues vihet në pah edhe nga të dhënat statistikore të ofruara nga raporti i *Ëorld Health Organization, Dhjetor 2018* (Organizata Botërore e Shëndetit). Sipas raportit në fjalë, numri i aksidenteve me/nga mjetet lëvizëse është rreth 1.35 milion raste ne vit , prej të cilave 70% kanë sjellë vdekjen e të dëmtuarit, ndërkohë që 36% kanë lënë tek i dëmtuari pasoja fizike dhe psikologjike, apo patologji neurologjike si epilepsia, paraplegjia, tetraplegjia etj, në rastet kur aksidenti ka sjellë dëmtime të pjesës së kokës dhe të trurit, ku nga të dhënat e të njëjtit raport rezulton se mosha më e prekur është mosha më aktive e shoqërisë, deri ne 29 vjeç.
Një përllogaritje aritmetike e këtyre të dhënave na vendos përballë një të vërtete alarmuese: çdo 15 sekonda, në botë ndodh një aksident me/nga mjetet lëvizëse; çdo 12 minuta regjistrohet një rast vdekjeje e shkaktuar nga të tilla aksidente.

Fjalë kyç: aksidentet nga mjetet lëvizese, alkoole, drogëra.

ÇRREGULLIMET GASTROINTESTINALE NË POPULLATËN E MOSHUAR

Floreta Kurti[1]
[1]*Shërbimi i Gastrohepatologjisë, QSU'Nënë Tereza" Tiranë*
[1]*Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, UMT, Tiranë*

Abstrakt

Hyrje
Veçoria kryesore e plakjes është humbja progresive e integritetit fiziologjik, e cila, nga ana tjetër çon në dëmtim të funksionit dhe rritje të vulnerabilitetit e vdekjes.
Popullsia e moshuar aktualisht përkufizohet si individë të moshës 65 vjeç e lart; e megjithatë rritja e jetëgjatësisë mund t'a rrisë këtë kufi në vitet në vijim. Përqindja e popullsisë së moshuar ndryshon sipas vendit. Në Shqipëri, popullsia mbi 65 vjeç u rrit nga 5% në 11% gjatë periudhës 1989-2011. Procesi i moshimit pritet të vazhdojë rritjen edhe në të ardhmen; pritet të shkojë në 29% në vitin 2060. Popullsia globale e parashikuar mbi moshën 80 vjeç pritet të jetë 17% deri në vitin 2050. Plakja ndikon në të gjitha funksionet e sistemit gastrointestinal (GI): lëvizshmërinë, sekretimin e enzimave dhe hormoneve, tretjen dhe përthithjen. Sistemi GI gjithashtu luan një rol thelbësor në përthithjen dhe metabolizmin e medikamenteve dhe zakonisht ndikohet nga efektet anësore. Nuk ka asnjë sëmundje gastrointestinale që është specifike dhe e kufizuar në moshën mbi 65 vjeç, por disa sëmundje janë më të përhapura në këtë grupmoshë dhe mund të kërkojnë trajtim të ndryshëm. Prandaj, qëllimi i këtij prezantimi është të nxjerrë në pah sëmundjet më të zakonshme që prekin të moshuarit duke theksuar detajet e paraqitjes klinike dhe menaxhimit të tyre. Fiziopatologjia e traktit GI e lidhur me moshën dhe implikimet klinike tek të moshuarit janë fokusi kryesor. Menaxhimi i sëmundjeve gastrointestinale tek të moshuarit, duke përfshirë algoritmin diagnostik, si dhe ndërhyrjen terapeutike, ndërlikohet më tej nga prania e disa sëmundjeve shoqëruese, përdorimi i shumë medikamenteve dhe një jetëgjatësi e kufizuar. Të moshuarit zakonisht kanë paraqitje atipike të një sëmundjeje me simptoma më të lehta, prandaj mjekët që nuk janë familjarë me këto veçori mund të mos i diagnostikojnë në kohën e duhur. Efektet anësore të disa medikamneteve që ata përdorin, kontribuojnë më tej në kompleksitetin e pamjes klinike dhe mund të orientojnë mjekët në drejtimin e gabuar.

Përfundime: Pacientët tanë të moshuar përfaqësojnë një popullatë specifike me nevoja unike në lidhje me qasjet diagnostike dhe terapeutike. Thellimi i mëtejshëm i njohurive tona është i nevojshëm në mënyrë që ne të jemi në gjendje të ofrojmë kujdes më të mirë të bazuar në prova dhe me kosto efektive, në mënyrë që të maksimalizojmë cilësinë e jetës së kësaj popullate pacientësh.

Fjalë kyç: popullatë e moshuar, çrregullime gastrointestinale, fiziopatologjia e traktit tretës.

I FOLURI NË PACIENTËT ME SËMUNDJE NEURODEGJENERATIVE TEK MOSHAT 40-50 VJEC.

Ba.Florinte Korchagin

Abstrakt

Ky studim u realizua nëpermjet një pyetësori drejtuar profesionistëve multidisiplinare në trajtimin e këtyre sëmundjeve .

Qëllimi i punimit: është që të evidentojmë si është cilësia e të folurit në këto mosha , dhe si trajtohen ato ,pra cilat janë teknikat dhe ndërhyrjet terapeutike dhe ecuria në preiudha 6mujore-2vjece trajtimi.

Objektivat : Të bëjmë të njohur shenjat e para klinike që paraqesin këto paciente ose ndyshe "red flags''.Evidentojme rolin jo vetëm të mjekut por edhe profesionistëve të tjerë shëndetësore ,në këtë rast Logopedi. Rezultatet referojnë se për shkak të pamundësive financiare shumica e pacientëve mjaftohen vetëm me mjekimin me barna dhe se Logopedia është një term I ri për këtë grup-moshë . Sugjeroj që profesionistë të tjerë të ndërgjegjësojnë shoqerinë dhe trajnime të vazhdueshme për sa I përket terapisë të së folurit jo vetëm në vonesa gjuhësore apo crregullime të spektrit por edhe në pacientë të tjerë .

Fjalë kyç: Logoped , Ekip Multidisiplinar , Sëmundje neurodegjenerative, I foluri.

KRAHASIMI I PROTOKOLIT EFIKAS PËR CRRËNJOSJEN E INFEKSIONIT HELIOBAKTER PYLORI NË KOSOVË

H. Aliaga[1,2],G Bojaj[1,2,3], H.Ibishi[2,3]
[1]*Kolegji Heimerer,Prishtinë,Kosovë*
[2]*Qendra e Mjekësisë Familjare, Klinë, Kosovë*
[3]*Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri*

Abstrakt

Infeksioni me Heliobakter pylori është ende i shpeshtë në komunitet dhe të gjithë subjekteve të infektuar duhet të ju ofrohet një terapi çrrënjosjeje. Në ditët e sotme, mjekët duhet të përballen me sfidën e e rezistencës ndaj antibiotikëve në trajtimin e individëve që janë të infektuar me Heliobakter pylori.

Qëllimi: Ky rishikim ofron një përmbledhje të udhëzimeve aktuale ndërkombëtare dhe raporton provat e fundit të përmbledhjeve sistematike dhe provat klinike ne trajtimin e infeksionit Heliobakter pylori dhe kjo duhet të ndihmojë mjekët që të trajtojnë më mirë pacjentët e tyre.

Metodologjia: Qëllimi i këtij studimi është që të vlerësoj incidentin e infeksionit nga Heliobakter pylori dhe lidhjen e tij me titrin e IGg, gastritin kronik, aneminë dhe kancerin e stomakut. Në studim morën pjesë 241pacientë me moshën mesatare 47 vjec((±16.1), mosha mesatare 45 vjec dhe renditja 17-77. 61% janë meshkuj dhe 39% janë femra. Incidenca e Heliobakterit pylori në këtë studim është 65.%[95%CI 59.2 – 71.6]. Dendësia e gastritit është 94.6%, inflamacioni 66.8%, anemia 73% dhe tendenca për ndryshime mukozale drejt shfaqjes së kancerit 38.2%.
Korrelacioni significant është gjetur në mes prezencës së Heliobakter pylori dhe gastritit, dyshimet mukozale me tendencë të adenokarcenomës, anemisë dhe inflamacionit

Rezultatet: Rregullat e përgjithshme për të zgjedhur menaxhimin e infeksionit Heliobakterit pylori përfshijnë: duhet pasur parasysh ekspozimin e mëhershëm të pacjentëve ndaj antibiotikëve, përdorimin e dozës së madhe të inhibitorëve, dhe shmangien e përseritjës së të njëjtit regjim, nëse ka tashmë dështime.
Terapia e katërfishtë e bizmutit dhe terapia shoqëruese janë trajtimet më të mira empirike të

linjës së pare në zonat me rezistencë të lartë ndaj klaritromicinës dhe në individ me përdorim të mëparshëm të makrolideve; përndryshe , terapia e trefishtë 14-ditore me klaritromicinë - që përmbanë terapi të trefishtë është një regjim i vlefshëm.Terapia sekuenciale nuk është më një trajtim i sugjeruar nga udhëzuesit ndërkombëtare.

Konkluzionet: Udhëzimet aktuale ndërkombëtare janë të qëndrueshme në përcaktimin e strategjive të trajtimit për infeksionin Heliobakter pylori. Tani nevojitet përdorimi i regjistrave kombëtare për të monitoruar efikasitetin dhe tolerushmërinë e regjimeve të ndryshme në botën reale të praktikës klinike.

Fjalët kyç:Heliobakter pylori, strategjitë e trajtimit, përdoruesit e kujdesit parësor shëndetësor, cilësia e kujdesit.

ROLI I TOCILIZUMABIT NE TRAJTIMIN E COVID-19

Gentian Huti, Asead Abdyli, Driola Hoxha, Rudin Domi
Shef i Departamentit te Anestezi-Reanimacion, Spitali Amerikan 3

Abstrakt

Hyrje: Covid-19 ka shkaktuar një pandemi të vazhdueshme e sëmundjes, dhe ka prekur të gjithë botën, duke ushtruar një presion të madh mbi repartet e terapisë intensive për shkak të numrit të madh të pacientëve që kanë nevojë për kujdes në këto reparte të terapisë intesive apo semiintensive. Kjo pandemi virale ka efekte të rëndësishme multiorganore dhe prek pothuaj cdo organ. Mbi bazën e ndryshimeve inflamatore, prokoaguluese, hipoksisë së zgjatur dhe të gjeneralizuar, reflektohen edhe ndryshimet në organe të ndryshme dhe në tendencën për komplikacione septike. Ky infeksion pavarësisht fokusit që ka në mushkëri, prek ndjeshëm dhe shpesh edhe disa organe të tjera si psh veshkat, trurin, mëlçinë, koagulimin, muskujt etj. Pra është një sëmundje multiorganore. Flitet për tocilizumabin, remdesivirin, CPAP apo intubim, dhe të dhënat janë të paqarta.

Metoda: Disa pika të nxehta janë të rëndësishme të diskutohen. Sot flitet për përdorimin e tocilizumabit apo jo, përdorimin e remdesivirit apo jo, përdorimin e CPAP apo jo. Të dhënat në literaturë janë me kundërshti, dhe parandaj po paraqesim të dhëna në lidhje me rekomandimet e literaturës për këto pika. Kemi parë me vëmendje literature duke paraqitur analizën që kjo literature i bën problemeve kryesore dhe rekomandimet që jep.

Diskutimi: Siç dihet Interlukina 6 është gjetur si një faktor kryesor në stuhinë e citokinave në Covid-19 dhe mendohet se korrelon me rëndesën e sëmundjes. Literatura është në kundërshti për përdorimin sepse artikuj të ndryshëm kanë marrë në studime të ndryshme qëllime të ndryshme. Tocilizumabi që frenon interleukinen 6, mendohet se nuk jep superioritet në trajtimin e pacientëve me Covid-19, madje mund të rrisi mortalitetin nga avancimi i komplikacioneve septike. Tocilizumabi përdoret 8 mg/kg me dy doza të ndara 8-24 orë nga njëra tjetra. Remdesiviri është një preparat antiretroviral, që ka kuptim të përdoret në ditët kur replikimi viral arrin kulmin që raportohet të jetë nga dita e 7-10 të sëmundjes. Remdesiviri përdoret me dozën 200 mg ditën e parë dhe pastaj 4 ditët e tjera nga 100 mg. Kujdes i vecantë duhet treguar në funksionin renal dhe hepatik.

Konkluzioni: Përcaktimi i protokolleve kombëtare, thellimi në literaturë, realizimi i një tavoline të rrumbullakët, janë masa kryesore në përpunimin e një protokolli unik dhe të pranuar nga të gjithë.

Fjalët kyc: Covid-19, tocilizumab, remdesivir.

FIBRILACIONI ATRIAL NË PACIENTËT KARDIAK PAS KORIGJIMIT TË VALVULËS MITRALE

Dr. Gentian Stroni[1], Elda Sulaj

Abstrakt

Hyrje: Ky punim është realizuar për të ditur më tepër për fushën e kardiologjise, konkretisht për fibrilacionin atrial pasi është kryer korigjimi kirurgjikal i valvulës mitrale. Fibrilacioni atrial është i pranishëm në 30-40% të pacientëve që paraqiten për kirurgji të valvulës mitrale.Shoqërohet me rritje të kohëzgjatjes së qendrimit në ICU si dhe me kostot e kujdesit post-operativ të pacientëve pas operacioneve kardiake.Në studim janë shqyrtuar në mënyrë koncize faktorë të konsiderueshëm para dhe mbas operacionit që mund të rrisin rrezikun e FA dhe trajtimet e mundshme.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është që në pacientët që i nënshtrohen operacionit të valvulës mitrale të vlerësohet incidenca e FA menjëherë dhe disa ditë më vonë pas operacionit të valvulës mitrale, të vlerësohen faktorët e FA post operativ , të hetohen pasojat e FA të hershëm post operativ për sa i përket përsëritjes së FA dhe të vlerësohet ndikimi i FA pas ndërhyrjes kirurgjikale.

Materiali: Në studim janë përfshirë pacientë të shtruar në repartin e kardiologjisë në spitalin e zemrës Dr.Roland Xhaxho.Realizimi i këtij punimi u krye me anë te regjistrimit të pacienteve te hospitalizur në këtë pavion.

Rezultatet: Në bazë të rezultateve të studimit arrijmë në përfundim se FA është i zakonshëm pas operacionit te korigjimit kirurgjikal te valules mitrale, shoqerohet me nje shkalle te larte morbiditeti dhe nje kujdes te zgjatur postoperatore ne moshat mbi 70 vjec me semundje te tjera bashkeshoqeruese.

Rekomandimet: Pacientët që zhvillojnë FA pas kirurgjise se valvules mitrale zgjidhet një strategji e menaxhimit të ritmit.Përdorimi profilaktik i bllokuesve beta-adrenenergjike redukton incidencën e FA pas operacionit dhe duhet përdorur në të gjithë pacientët. Të gjithë pacientët me FA që vazhdon më shumë se 24-48 orë duhet të marrin antikoagulantë, perjashto rastet me kunderindikacione,te kontrollojne ne menyre te vazhduar ritmin e zemres te kujdesen per stilin e jeteses dhe zbatimin e terapise medikamentoze te pershkruar nga mjeku.

Fjalët kyç: FA, kardiokirurgji, valvula mitrale, beta-bllokues.

ÇRREGULLIMET HEMODINAMIKE POSTOPERATORE DHE KUJDESI INFERMIEROR

Mbaresa Çela[1], Eralda Lila[2], Joana Nilo[2], Andi Sula[2], Dr. Gentian Stroni[3]
[1]Studente FSHMT/UMT Tiranë
[2]Infermier spitali VILLA MARIA Tiranë
[3]Doktor Shkencash FSHMT/UMT , QSUT Tiranë

Abstrakt

Hyrja: Çrregullimet hemodinamike janë ndër fenomenet më të shpeshta që hasen në fazën post operative në pacientët që i nënshtrohen ndërhyrjeve kirurgjikale jo kardiake të llojeve të ndryshme. Ndër çrregullimet hemodinamike më të shpeshta janë: a.Hypotensioni, b.Hypertensioni. Arsyeja e çrregullimeve hemodinamike në fazën e hershme postoperative është multifaktoriale,me predominim të disa faktorëve apo kombinimi i disa faktorëve.Njohja e hershme e ketyre faktorëve që çojnë në çrregullime të rëndësishme hemodinamike në fazën e hershme postoperative, parashikimi i çrregullimeve hemodinamike.

Qëllimi: Incidenca e çrregullimeve hemodinamike në kirurgjinë jokardiake në raste që i nënshtrohen kirurgjive të planifikuara,lidhja e këtyre çregullimeve hemodinamike me faktorët e ndryshëm.

Subjekti dhe Metodologjia: Ky është një studim analitik retrospektive me të dhëna të mbledhura nga rastet e marra në studim në mënyr prospektive,i cili është zhvilluar pranë spitalit Europian Villa Maria , Tiranë , Shqipëri pergjatë periudhës kohore Janar - Mars 2022 dhe përfshin të gjithë pacientët që u janë nënshtruar ndërhyrjeve kirurgjikale të gradëve të ndryshme në këtë periudhë pranë këtij spitali në fushat të tilla si ortopedi -traumatologji; orl – kirurgji estetike; neurokirurgj; kirurgji e përgjithshme .Faktorët që u supozuan të kenë ndikim në çrregullimet e hershme hemodinamike u grupuan në tre kategori:-faktorë të lidhur me karakteristikat e pacientit dhe komorbidetetin;-faktorë të lidhur me teknikën anestetike të përdorur;-faktorë të lidhur me kirurgjinë, të dhënat u grumbulluan për analizë retrospektive.Pacientët u kategorizuan në:-pacientë hypotensive;-pacientë hypertensive;-pacientë normotensivë. Matje frekuente në fazën e hershme postoperative u regjistruan.

Rezultatet : Hipotension u verejt në 12% të rasteve që ju nështruan kirurgjisë jo kardiake. 36 paciente(12%) kishin vlera të MAP<60 mmHg apo TA sistolik <90 mmHg. Hipertensioni u vërejtë në 2.6 % të rasteve,8 pacientë (2.6%) patën vlera të TA mbi 140 mmHg.U verejtë një lidhje e rëndësishme midis sëmudjes HTA -gradë IV e kirurgjise dhe hipotesionit në fazat e hershme postoperative (OR i rregulluar, 3.26; 95% CI, 1.57 to 6.48, $P = 0.001$).U vërejt një lidhje e rëndësishme midis pacientëve me sëmundje shoqëruese HTA dhe rritjes së TA ne fazën e hershme postoperatore (OR i rregulluar, 6.64; 95% CI, 1.57 to 4.22, $P = 0.001$)

Konkluzione: Çrregullimet hemodinamike janë një fenomen frekuent në fazën e hershme post operatore. Karakteristikat e pacienteve ku futen mosha e madhe dhe prania e komorbiteteve kardiovaskulare si dhe faktorët kirurgjikalë

Fjalët kyç: paciente, çrregullimet hemodinamike, interventi kirurgjikal, faza pre/intra /postoperatore, anestezi, hemorragji, hypotension/ hypertension, kujdesi infermieror.

TRAJTIMI AMBULATOR I COVID-19 NË SHQIPËRI

PhD. MD. Gentian STRONI[1]
[1]*Infektiolog, Universiteti Mjekësor i Tiranës*

Abstrakt

Rasti i parë i diagnostikuar në Shqipëri ishte një paciente femër e moshur e cila humbi jetën dhe që u infektua nga i biri i cili vinte nga zona e Lombardisë Itali në fund të muajit Mars të

2020. Periudhat më të vështira gjatë kësaj pandemie ishin në vjeshtë 2020 në muajt tetor-nentor, dhe shkurt-mars 2021. Në këto momente Shqipëria po kalon një fazë tjetër të lartë të infektimeve. Menaxhimi i Pandemisë në Shqipëri në fazat me ritme të larta të infektimeve ishte disi specifik dhe ndryshe nga vendet e tjera pasi një pjesë e mirë e pacientëve të stadeve të avancuara të Covid-19 u trajtuan në kushte ambulatore, duke eksperimentuar protokolle individuale, shpesh herë të orientuara nga eksperiencat e suksesshme të vendeve të ndryshme. Terapia u orientua me baza llogjike për të ulur sado pak aktivitetin viral dhe për këtë që në ditët e para të pathologjisë u përdorën kombinimet Azithromycin+Hydroxicloroquin, ose Favipiravir, vitaminoterapi.
Me kalimin e fazës së Viremisë bazuar në repertin laboratorik, dhe veçanërisht imazherik, (ct-pulmoni), fillonte Remdesivir, Deksamethazon, dhe kjo terapi do të zgjaste për 5 ditë duke qënë nën kontrollin e vazhdueshëm të saturimeve të oksigjenit. Nëse pacienti do kishte rënie të saturimeve, pacienti vendosej nën regjime të oxigjenoterapisë me litrazh të ndryshëm. Gjatë kësaj periudhe fillonte edhe antibiotikoterapia e cila do varej nga vlerat e PCR. Një vlerë e lartë e saj do bënte që pacienti të merrte terapi endovenoze, ku në pjesën më të madhe të rasteve baza ishte një antibiotic nga grupi i quinoloneve si levofloxacin ose moxifloxacin dhe e shoqëruar me cafalosporina të gjeneratës së tretë në rastet e PCR shumë të lartë. Rezultatet e këtij protokolli kanë qënë përgjithësisht të suksesshme por shumë të vështira për pacientët dhe familjet e tyre duke qënë se do i duhej të përballonin financiarisht koston e tyre në mënyrë vetiake.
Në fazën e fundit nëse pacienti vazhdon me simptoma dhe veçanërisht me temperaturë u përdor Tocilizumab.

Fjalët kyç: covid-19, barna, infeksion.

ÇRREGULLIMI I PERSONALITETIT BORDERLINE

Gentjan Asllanaj[1]
[1]Mjek psikiatër

Abstrakt

Studimet e fundit kanë ndihmuar në përmirësimin e njohurive rreth çrregullimit të personalitetit borderline dhe mënyrën sesi ai trajtohet. Ky çrregullim lidhet me vështirësinë e rregullimit të emocioneve. Kjo nënkupton se personat që vuajnë nga ky çrregullim përjetojnë emocione shumë të forta që zgjasin për një periudhë të gjatë kohore dhe bëhet e vështirë për ta të stabilizohen pasi ka ndodhur një ngjarje nxitëse.

Çrregullimi i personalitetit borderline karakterizohet nga dëmtime të rënda funksionale, dëmtim të vetes, rrisk të lartë për suicid, efekt negativ në rrjedhën e çrregullimeve depresive, përdorim të zgjeruar trajtimi dhe kosto të lartë për shoqërinë. Shkaqet nuk janë plotësisht të qarta por lidhen me faktorët gjenetikë dhe me ndodhitë negative të jetës (abuzim fizik, emocional dhe seksual).

Personat me çrregullimin borderline që nuk trajtohen kanë një rrisk më të shtuar për abuzim me drogërat dhe alkoolin, për të zhvilluar depresion, për të demtuar veten apo për vetëvrasje. Të dhënat për efektivitetin e farmakoterapisë ndryshojnë dhe provat nuk janë ende të forta. Format specifike të psikoterapisë duket se janë të dobishme për disa nga problemet e raportuara shpesh te pacientët me çrregullim të personalitetit kufitar. Aktualisht, nuk ka asnjë

provë që sugjeron se një formë specifike e psikoterapisë është më efektive se një tjetër. Nevojiten kërkime të mëtejshme mbi diagnozën, neurobiologjinë dhe trajtimin e çrregullimit të personalitetit kufitar.

GRAVES DISEASE, SHKAKU MË I SHPESHTË I HIPERTIROIDIZMIT: DIAGNOZA DHE MËNYRAT E TRAJTIMIT

Dr. Gentjan Lita

Abstrakt

Hyrje: Palpitacionet, takikardia apo hipersensitiviteti ndaj temperaturës, janë vetëm disa nga simptomat dhe shenjat që karakterizojnë hipertiroidizmin, ku shkaku më i shpeshtë i tij është Graves Disease (GD) apo Morbus Graves.

Vetëm në shërbimin e urgjencës paraqiten çdo ditë raste me tablo klinike të një hipertiroidizmi, por jo gjithmonë zbulohet shkaku, duke bërë kështu që pacientët të mos diagnostohen si duhet, e për pasojë nuk marrin trajtimin e duhur.

Qëllimi i këtij prezantimi është të njihemi me tepër me patofiziologjinë e GD, faktorët e riskut, kuadrin klinik, diagnostikimin dhe mënyrat e trajtimit.

E përshkruar për herë të parë nga Rober J. Graves, mjek irlandez, në vitin 1835, GD është një patologji autoimune, që prek kryesisht gjëndrën tiroide dhe karakterizohet nga *hipertiroidizmi*, *ekzoftalmia* (20-40%) dhe *dermatopatitë* (*miksedema pretibiale*, 1-5%).

Patofiziologjia e GD lidhet me prodhimin e auto-antitrupave TSI (Thyroid Stimulating Immunoglobulins) me receptorët e TSH në tiroide, duke stimuluar prodhimin e pakontrolluar të hormoneve të tiroides (T3, T4), për pasojë në shfaqjen e hipertiroidizmit. Zbulimi i auto-antitrupave TSI ka një sensitivitet dhe specificitet rreth 95% për GD. Ndërkohë, GD mund të shoqërohet edhe me oftalmopati (*ekzoftalmi*), që karakterizohet me protrusion të globusit okular, diplopi apo edeme periorbitale. Patogjeneza e *ekzoftalmisë* lidhet me inflamacionin lokal dhe proliferimin e shtuar të indit adipoz retro-orbikular, e nxitur nga citokinat proinflmatore dhe auto-antitrupat qarkulluese TSI.

Antitiroidienët e sintezës janë linja e parë e trajtimit, ku më shpesh përdoret Propylthiouracil (PTU) në doza 300-450 mg/d apo Carbimazole (CBZ) në doza 40-60mg/d. Në rast të një relapsi aplikohet trajtimi me jod radioaktiv (RAI), por që kundërindikohet në gratë shtatëzëna. Kirugjia mbetet zgjidhja përfundimtare, e cila përfshin tiroidektominë subtotale apo totale, dhe pasohet me terapinë hormonale orale me Levothyroxine. Diagnostikimi i duhuar dhe trajtimi në kohë i GD është shumë i rëndësishëm për të evituar komplikacione e mundshme, nga hipertiroidizmi, ekzoftalmia graves apo dermatopatitë.

Fjalë kyç: morbus graves, hipertiroidizmi, ekzoftalmia, sëmundje autoimune, trajtimi.

GJENDJET FEBRILE TE FËMIJËT

Dr. Gentjan Lita

Abstrakt

Hyrje: Pireksia apo temperatura e lartë është një prej shenjave më të shpeshta te fëmijët, ku 25-40% e rasteve në urgjencat pediatrike paraqiten me gjendje febrile.

Shkaqet më të zakonshme të temperaturës në moshat pediatrike janë infeksionet virale, kreysisht respiratore, gastro-intestinale, të cilat kërkojnë vetëm trajtim simptomatik, por mund të vijë edhe nga shkaqe bakteriale, që indikon terapi me antibiotikë.

Megjithëse temperatura është shenjë dhe jo patologji në vetëvete, ekziston një frikë tek prindërit, për ta ulur menjëherë temperaturën në mënyrë agresive sapo kalon 37.5°C, që njihet si Fever Fobia.

Faktorët pirogjenë që rrisin temperaturën e trupit mund të jenë ekzogjenë (endotoksinat bakteriale) ose endogjenë (prodhimi i citokinave proinflamatore, IL-1, IL-6, TNF-a etj.) Këto faktorë pyrogjenë qarkullojnë në zonë preoptike në Hipothalamusin anterior (Qendra e Termorregullimit), duke sjellë prodhimit e Prostaglandinave E2 dhe rritjen e temperaturës.

Gjendjet febrile mund të jenë: (a) me kohëzgjatje të shkurtër, ku prania e shenjave të tjera orienton drejt një diagnoze; (b) Pa prani fokusi inflamator: Rreth 20% e gjendjeve febrile te fëmijët, pa shenja/simptoma apo (c) Temperatura Idiopatike (FUO), ku nuk arrihet të zbulohet origjina edhe pas 3 javësh në ndjekje jashtëspitalore apo pas 7 ditëve në hospitalizim.

Anamneza e hollësishme, ekzaminimi i kujdesshëm objektiv dhe një teste laboratorike ndihmojnë në diagnostikimin e duhur të shkakut të pireksisë.

Fjalë kyç: gjendje febrile, pediatri, pireksia, hipertemia malinje, gjendja febrile idiopatike (FUO).

LINJË UDHËZUESIT E SURVIVING SEPSIS CAMPAIGN 2021 NË KOHËN E COVID -19

Gentjana Zotaj, Gentian Huti, Asead Abdyli, Driola Hoxha
Departmenti i Anastezisë Spitali Amerikan 3, Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Si dihet sepsis përfaqëson një sindrom dhe nozologji mjaft të rëndësishme në repartet e Terapisë Intensive ose sic njihet në vëndin tonë Reanimacion. Ky sindrom është jetë kërcënues dhe ndodh si pasojë e crregullimit të sistemeve mbrojtëse të organizmit ndaj një stimuli infeksioz të rëndësishëm në organizëm. Sepsis dhe shoku septik ndikojnë drejtë për

së drejti në rritjen e mortalitetit dhe morbiditetit të pacientëve të shtruar në repartet e terapisë intensive. Identifikimi i shpejtë i sepsisit dhe fillim sa më shpejtë i terapisë korrekte na mundëson përmirësimin e prognozës së kësaj kategorie pacientësh.

Materiali and Metoda: Linjë udhëzuesit e vitit 2021 janë përcaktuar nga një grup i madh ekspërtësh, dhe me diferenca me 2016. Krahasimi i dy linjëudhëzuesve na bën të kutpojmë diferencat dhe të evidentojmë konkluzionet e reja të këtyre linjëudhezuesve. Psh shumë pikëzime janë përcaktuar për sepsisin si kriteret SIRS, Sequential Organ Failure Score (qSOFA) ose kriteret Sequential Organ Failure Assessment (SOFA), pikëzimi National Early Ëarning Score (NEWS), ose pikëzimi Modified Early Warning Score (MEWS). Linjëudhëzuesit e 2021 rekomandojnë që asnjë pikëzim i marrë vetëm nuk shërben si prediktiv.

Diskutimi: Rekomandimet kryesore të linjëudhëzuesve 2021 janë: nuk rekomandohet me vetëm matja e PCT për fillimin e antibiotikëve por duhet vlerësuar edhe gjendja klinike e pacientit, laktatet janë të rëndësishme për të na udhëhequr për mbushjen e shtratit vaskular por mbi të gjitha jo vlera absolute por diferencat midis matjeve, MAP të mbahet mbi 65 mmHg, mbushja kapilare është element shumë i rëndësishëm në ndjekjen klinike të pacientit, të përdoret më shumë kristaloidet e balancuara sesa fiziologjiku i zakonshëm, përdorimi i albuminës është më i efektshëm sesa starchet, noradrenalina mbetet linjë e parë si vazopresor por në rast mos realizimi të MAP të kërkuar rekomandohet shtimi i vazopresines dhe jo rritja e dozës së noradrenalines, përdorimi i HFNC në vënd të NIMV, prone position ne ARDS nga Covid-19 për të paktën mbi 12 orë, ventilimi me volume të vogla 6-8 ml/kg, presion plato nën 30, PEEP rreth 10.

Konkluzion: Cdo spital duhet të ketë protokollin e vet bazuar në linjëudhëzuesit. Identifikimi i shpejtë na jep mundësinë e përmirësimit të prognozës.

Fjalë kyç: sepsis, antibiotics, septic shock.

SINDROMA KAWASAKI

Greta Haxhi

Abstrakt

Sëmundja Kawasaki është një vaskulit akut i vetë-kufizuar që karakterizohet nga ethe, konjuktivit joeksudativ dypalësh, ekzantema, mukoziti, ndryshime në ekstremitete, skuqje dhe limpadenopati cervikale. Nga janari 2017 – dhjetor 2018, vetëm 5 fëmijë plotësonin kriteret diagnostikuese të sëmundjes.

Qëllimi: Kemi kryer një studim retrospektiv për të përcaktuar të dhënat epidemiologjike, paraqitjet klinike, rezultatet klinike, ndjekjen dhe komplikimet kardiake të fëmijëve që kanë pasur sëmundjen Kawasaki gjatë periudhës.

Materiali dhe metoda: Diagnoza e Sëmundjes Kawasaki është vendosur në bazë të kritereve të CDC dhe udhëzimeve AHA 2017. Fëmijët janë ndjekur gjatë kësaj periudhe.

Rezultatet dhe diskutimet: 3 djem dhe 2 vajza të moshës 4 muaj deri në 7 vjeç kishin vuajtur nga Sëmundja Kawasaki gjatë kësaj periudhe. Sëmundja ishte më e shpeshtë në periudhën e vjeshtës. Të gjitha rastet përfaqësonin ethe të vazhdueshme për më shumë se 10 ditë, limfadenopati cervikale, mocositis si cheilitis, ndryshime në ekstremitet (edemë,

deskuamime periunguale). Artriti u konstatua në 2 raste, pyuira sterile në 1 rast dhe diarre në një rast. Gjetjet laboratorike treguan leukocitozë me zhvendosje majtas, trombocitozë, CRP të ngritur dhe ERS. Diagnoza e KD u vendos gjatë javës së dytë të temperaturës. Të gjithë fëmijët janë trajtuar me IVIG dhe aspirinë, vetëm një rast është trajtuar me pentaglobinë. Vetëm njëri prej tyre zhvilloi komplikacione kardiake (dilatim difuz i koronares së majtë dhe të djathtë).

Konkluzione: Incidenca e ulët e Sëmundjes Kawasaki në vendin tonë është e ngjashme me referencat nga vendet e tjera evropiane. Terapia ishte e suksesshme dhe efikase për një rezultat pa komplikime.

Fjalët kyç: Sëmundja Kawasaki, fecer, limfadenopati cervikale, trombocitozë, IVIG.

AKI NJË GJËNDJE ALARMANTE NË PACIENTËT ME COVID-19.

Grisilda Gjana
Nefrologe, Spitali Universitar i Traumës, Tiranë.

Abstrakt

Hyrje: COVID – 19 konsiderohet kryesisht sëmundje respiratore, por duke qenë se SARS-CoV-2 përdor receptorin e enzimës konvertuese të angiotenzinës 2 (ACE2) për të hyrë në qelizat humane, veshka është gjithashtu një objektiv i infeksionit viral. Dëmtimi akut i veshkave (AKI) është gjendja më alarmante në pacientët me COVID-19. Incidenca e AKI-së në pacientët me COVID-19 varion nga 0.5% në 35% dhe shoqërohet me prognozë më të keqe. Një numër në rritje i punimeve sugjerojnë një lidhje të fortë midis zhvillimit të AKI - së dhe vdekshmërisë më të lartë në pacientët me COVID-19. Raportet histopatologjike treguan se shumica e pacientëve me COVID-19 me AKI paraqitën dëmtim tubular akut, ndonjëherë me nekrozë dhe glomerulopati kolapsuese. Hapat më të rëndësishëm që duhet të ndërmerren në parandalimin e AKI janë si më poshtë: minimizimi i rrezikut të hipovolemisë dhe monitorimi i niveleve të kreatininës në serum në fazat e hershme të infeksionit me COVID-19, veçanërisht në lidhje me pacientët me rrezik të lartë ; ata në një moshë më të madhe, me Diabet Mellitus, HTA dhe sëmundje kardiovaskulare. Qëllimi ynë është të ngremë serenat e alarmit në diagnostikimin e hershëm të AKI tek pacientët me COVID-19 për të minimizuar pasojat e kësaj sëmundjeje që ka mbërthyer globin.

Fjalë kyç: AKI, COVID-19, ACE 2.

KUJDESI INFERMIEROR TE TË SËMURËT NË UROLOGJI.

Dr. Haxhire Gani, Mariglena Rrapaj, Franceska Beqiri, Xhesika Muça, Eden Naço.

Abstrakt

Parathënie - Kujdesi infermieror konsiston në një sërë rolesh si matja e shenjave jetike, balanca e lëngjeve, menaxhimi psikosocial, etj.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë cilat janë ndërhyrjet infermierore më të rëndësishme që realizohen në të sëmuret urologjike.

Materiali dhe Metoda – Në këtë studim analitik janë perfshirë 100 pacientë të trajtuar në Kliniken e Urologjisë, Qendra Spitalore Universitare Nënë Teresa, QSUT. Periudha kohore e ketij punimi është Dhjetor 2021 – February 2022. Është bërë analizimi i çdo ndërhyrje të realizuar nga stafi infermieror.

Rezultatet - Ndër të gjitha ndërhyrjet e listuara në Figure.1, stafi infermieror kontrolloi më shpesh sasinë dhe cilësinë e urines dhe i kushtoi më shumë rëndësi ruajtjes se balancës së lëngjeve. Puna e infermierit ne kujdesin ndaj pacientit te shtruar ne urologji ka konsistuar ne: menaxhimin e terapise, higjenën personale, balancën e ujit(meqënëse një numër i madh i pacientëve janë me lavazh, matja e diurezës bëhet më e vështire dhe bëhet diferenca e sasisë të lëngjeve të mara me urinen e prodhuar), marrja e analizave, lëvizja e pacientit, trasferimi për ekzaminime. Në tabelën më poshtë vihet re që kujdesi më i madh është realizuar ndaj vlerësimit të urinës me një përqindje prej 39.2% (sasia, prezenca e hematurisë, prania e koagulave) ndjekur nga kujdesi me kateterin 19.6%. Numri mesatar i ndërhyrjeve infermierore për një pacient gjatë një turni është mesatarisht 5. Krahasimi i të dhënave gjendet në grafik.

Ndërhyrja	**Frekuenca në Nr.**	**Frekuenca në %**
Vlerësimi I urinës	20	39.2%
Matja e shenjave jetike	2	3.9%
Marrja e analizave	<1	1.9%
Kujdesi për kateterin	10	19.6%
Transporti per ekzaminime	<1	1.9%
Mbeshtetje psikosociale	5	9.8%
Raportimi I ndryshimeve	5	9.8%
Administrimi I medikamenteve	2	3.9%
Sigurimi i rrugës venoze	<1	1.9%
Tranferimi dhe lëvizja	3	5.9%
Kujdesi personal	1	1.9%

Përfundimi - Roli më i rëndësishëm i stafit infermieror në kujdesin ndaj pacientëve urologjikë është vleresimi i urinës së pacientëve.

Fjalë kyç: roli infermieror, urologji.

INFEKSIONI COVID-19 SËMUNDJET ONKOLOGJIKE EVOLUCIONI NË TRAJTIMIN KIRURGJIKAL TË KANCERIT TË GJIRIT

Prof. Asoc. Helidon Nina
Drejtor MjeKësor, Poli i Administrimit Integruar, Spitali Onkologjik, QSUNT
Përgjegjës Njesia Kirurgji & Terapi Intensive, Spitali Onkologjik, QSUNT

Abstrakt

Pacientët onkologjik si gjithë popullata globale u gjendën të pa pergatitur përballe kësaj problematike të madhe me shumë të panjohura. Spitali Onkologjik iu përgjigj me përgjegjshmëri urdhërit të Ministrisë së Shëndetësisë për ofrimin e shërbimit ndaj pacientëve

onkologjik pa kufizime. Në të treja Njësite përbërëse të tij (Kirurgji, Kimioterapi dhe Radioterapi) u morën masat në bazë të rregullave në fuqi që të ofrohej shërbimi për cdo pacient, duke respektuar distancimin, mbrojtjen me maska, doreza, disinfektues, matje temperature në hyrje të spitalit, plotësim formularësh për prezencë shenjash të infeksionit, kontaktet me persona të infektuar, riorganizime të stafeve, etj. Aplikimi i rekomandimeve të "Society of Surgical Oncology", për pacientët e diagnostikuar në atë periudhë me diagnoze onkologjike dhe që prezantonin stade dhe tipe të ndryshme të patologjisë onkologjike. U vazhdua kimioterapia dhe radioterapia për të gjithë pacientët që kishin trajtimet e planifikuara. U organizua që trajtimi me kimioterapi të zhvillohej në Spitalet Rajonale që e ofrojnë këtë shërbim si: Durrës, Shkodr, Vlorë, Fier, Korce, etj, nën një koordinim të onkologeve aty me onkologët e Spitalit Onkologjik. Radioterapia u realizua për gjithë pacientët e planifikuar, duke respektuar me rigorozitet distancimin. Vizitat e para për pacientët e diagnostikuar ose dyshuar për patologji onkologjike, u realizuan në të gjitha punktet e Spitalit Onkologjik: kirurgji, kimiterapi dhe radioterapi. Vizitat e kontrollit për pacientët e trajtuar, u reduktuan në maksimum duke ju dhënë prioritet kontakteve të pacientëve me onkologët e rretheve dhe mjekët e familjeve në mungesë të tyre, për të evituar grumbullimet dhe spostimet e panevojshme. Kuptohet në raste të një problematike që duhej trajtuar dërgoheshin në Spitalin Onkologjik Shfrytëzimi i platformave online (ËhatsApp & Viber) për konsultimet direkt të pacientëve me mjekët e tyre kurues, për të shmangur lëvizjet e panevojshme.Në trajtimin kirurgjikal të kancerit të gjirit në Njësinë e Kirurgjisë Onkologjike në kohë është realizuar një evolucion në metodikat e perdorura, duke kaluar nga një kirurgji radikale standarte në trajtimin konservativ dhe deridiku në atë rikonstruktiv me përdorimin e protezave dhe meshave biologjike.

Fjalë kyç*:* covid, kancer, onkologji

ADENOKARCINOMA INTRAMUKOZE E STOMAKUT - EGC (KANCERI I HERSHËM I STOMAKUT) DHE RËNDËSIA E ENDOSKOPISË (EGDS) NË DIAGNOSTIKIMIN E HERSHËM.

Hysni Dede

Abstrakt

Kanceri i stomakut (GC) përbën 10% të të gjitha vdekjeve të lidhura me kancerin. Me rritjen e përdorimit të trajtimit endoskopik në EGC, historia natyrore e EGC duhet të merret parasysh në mënyrë që të vlerësohet efikasiteti i rezeksionit endoskopik dhe të përmirësohet vendimmarrja për trajtimin; kjo është veçanërisht e rëndësishme për pacientët e moshuar. Sidoqoftë, gastrektomia me limfadenektomi është trajtimi standard i artë [11]. Prezantojmë një rast me EGC (Kanceri i hershëm i stomakut - Adenokarcinoma intramukoze gastrike) i trajtuar me trajtim standard ari pavarësisht moshës së tij (pacient i moshuar).

Raporti i rastit: Një burrë 83-vjeçar (Q.SH) në datë 21 korrik 2021 është referuar në Departamentin e Gastro-Hepatologjisë të Spitalit Ndërkombëtar German në Tiranë për shqetësime të tretjes si: Dhimbje epigastrike, ndjesi ngopjeje të shpejtë dhe shqetësim abdominal pas ngrënies, humbje e lehtë në peshë (rreth 4 kg në 3 muajt e fundit) me një histori disavjeçare të këtyre ankesave, pa histori personale dhe familjare të patologjive të traktit tretës, pa sëmundje të tjera shoqëruese. . Duhanpirës prej vitesh (10-15 cigare/ditë) dhe moskonsumues i alkoolit dhe substancave të tjera të varësisë. Gjendja e përgjithshme është e mirë dhe refuzon të kryejë Fibrogastroskopinë dhe ekzaminimet e tjera të

rekomanduara duke vazhduar trajtimin me PPI të dhënë disa javë më parë nga mjeku i familjes. Rishfaqja sërish pas 2 muajsh më 29 shtator 2021 ku kryen procedurën e Fibrogastroskopisë gjatë së cilës përveç gastritit të theksuar dhe hernies hiatale të theksuar, prania e një zone mbi nivelin e mukozës, me diametër rreth 3-4 cm me një të ashpër. sipërfaqja vihet re në antrum. , pamje multilobulare, jashtëzakonisht e brishtë dhe pak e përgjakshme nga e cila është marrë biopsia.

Rezultate: Rezultati i biopsisë është: Adenokarcinoma gastrike intramukoze (mukoza gastrike me gjëndra me arkitekturë "prapa-mbrapa" me epitel me displazi të shkallës së theksuar që pushton lamina propria). Të gjitha ekzaminimet e tjera laboratorike të gjakut rezultuan brenda normës ndërsa ekzaminimet e tjera imazherike (ekografia e barkut, radiografia e kraharorit, CT-toraks-abdomen) nuk zbuluan metastaza. Pas gastrektomisë subtotale dhe një pjese të omentumit, nga ekzaminimi histopatologjik u zbulua kuadri histopatologjik i gastritit kronik difuz të rëndë, me metaplazi të theksuar intestinale dhe displazi mukozale multifokale të moderuar deri në të rëndë dhe prania e Helicobacter pylori. Nuk u identifikuan asnjë nyje limfatike dhe omentumi ishte i pastër.

Konkluzioni: Ecuria e gjendjes klinike të pacientit pas ndërhyrjes dhe në vazhdim ishte shumë e mirë dhe pa praninë e simptomave dhe ankesave të mëparshme të pacientit. Diagnoza e hershme endoskopike me biopsi jo vetëm që minimizon rrezikun e pushtimit të mëtejshëm të kancerit të hershëm të stomakut me kalimin e kohës, por gjithashtu rrit mbijetesën e pacientit përmes trajtimit adekuat të përshtatur me profilin individual të pacientit (mosha, sëmundjet shoqëruese, etj.)

Fjalë kyç: adenocarcinoma gastrike intramukoze, endoskopi.

SEKSIO CESAREA KUNDREJT LINDJES SPONTANE

Ilda Ndreko
Obstetre – Gjinekologe, Qendra shëndetësore Nr.1, Fier, Shqipëri

Abstrakt

Qëllimi : Qëllimi i këtij studimi është të përcaktoj prevalencën e lindjes spontane kundrejt lindjes cesareane (operacion).

Metoda : Kohëzgjatja e këtij studimi ishte 48 muaj, nga Janar 2017 deri në Dhjetor 2020. Janë marrë në studim të gjitha gratë shtatzanë, primipare dhe multipare në qendrën shëndetësore. Janë ndjekur që nga fillimi i shtatzanisë deri në fund të saj. Rezultatet e marra janë: lindje spontane dhe lindje me seksio cesarea.

Rezultatet: Studimi përfshin 1500 lindje nga të cilat 787 janë me seksio cesarea dhe 713 janë lindje spontane. 787 janë lindje me seksio cesarea nga të cilat: 389 janë seksio cesarea për herë të parë, 296 janë lindje me section cesarea pas një ose më shumë lindje me seksio cesarea dhe 102 janë lindje me seksio cesarea pas një ose më shumë lindjeve spontane. Janë 713 lindje spontane nga të cilat: 2 janë spontane pas një lindje me seksio cesarea dhe 711 janë lindje spontane vaginale.

Konkluzioni : Në këtë studim vihet re një përqindje e lartë e lindjeve me seksio cesarea. Kemi 52.47 % seksio cesarea kundrejt 47.53% lindje spontane.

Fjalët kyç : seksio cesarea, prevalence, lindje spontane.

RËNDËSIA E TRAJTIMIT TË DËMTIMEVE TË HAPURA NË REPARTET E URGJENCËS

Msc. Ilda Taka, Doc. Elona Hasalla, Prof. Dr. Ilia Mazniku, Msc. Albana Sula, Msc. Saimira Qerana, Msc. Blerta Hasalla
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike Elbasan Departamenti i Specialiteteve Mjekësore Teknike; Departamenti i Lëndëve Paraklinike Departamenti i Infermieristikës; SHQ Tirane

Abstrakt

Hyrje: Frakturat e hapura janë dëmtime të komplikuara që ndërpresin vazhdimësinë e kockës dhe fragmentet e tyre komunikojnë me mjedisin e jashtëm nëpërmjet plagëve të hapura në lëkurë. Pacientët e prekur nga këto dëmtime janë të prirur për infeksione, osteomelit, proçesin e gjatë të shërimit ose deri në humbjen e jetës. Këto lloj dëmtimesh janë shtuar shumë si pasojë e urbanizmit, shtimit të mjeteve të qarkullimit rrugor si dhe nga pakujdesia e shoferëve dhe këmbësorëve.

Qëllimi: Qëllimi i studimit tonë është vlerësimi i shpjetë dhe trajtimi adekuat nga ana e personelit mjekësor të këtyre dëmtimeve si edhe tërheqja e vëmëndjes së opinionit publik mbi rëndësinë e parandalimit të këtyre traumave dhe zbatimit të rregullave të qarkullimit rrugor.

Metodologjia: Studimi jonë është retrospektiv dhe i përket periudhës kohore shkurt 2018 deri në shkurt 2019. Si material në këtë studim kanë shërbyer kartelat e 180 pacientëve të diagnostikuar me traumë të hapur lokomotore. Nga këta të dëmtuar kemi 120 meshkuj(67 %) dhe 60 femra (33 %). Të gjithë të dëmtuarit janë me dëmtime të hapura me shkallë të ndryshme klasifikimi sipas Gustillios; pre tyre 70 pacientë (39 %) janë të shkallës së tretë, 66 pacientë (37 %) të shkallës së dytë dhe 43 prej tyre(24 %) janë të shkallës së parë.

Fjalët kyç: frakturë e hapur, traumë lokomotore, osteosintezë, komplikacione.

TRAJTIMI I HERNIES DISKALE LUMBARE ME OZON EPIDURAL/CAUDAL NË SHQIPËRI

Dr. Ilir Agastra

Abstrakt

Hyrja: dhimbja e mesit eshte nje problem i zakonshem qe prek rreth 40-80% te njerezve gjate jetes. Ajo ka nje ndikim te madh shendetesor, shoqeror dhe ekonomik.

Rezultatet e kirurgjise tradicionale ne hernien diskale shoqerohen shpesh me komplikacione dhe syndrome te deshtimit te operacionit (FBSS). Nder vite jane zhvilluar shume teknika perkutane minimalisht invazive. Ozonoterapia eshte njera prej tyre dhe ka treguar rezultate premtuese. Une kam aplikuar ozonin epidural/caudal ne pacientet me hernie diskale lumbare.

Metoda: me shume se 100 paciente me diagnose kliniko-radiologjike te hernies diskale lumbare jane trajtuar me ozon epidural/caudal (15-20 ml ozon 15-20 mcg/mL). Rezultati i trajtimit eshte vleresuar me shkallen analoge vizuale (VAS). Ne 10 raste eshte konfirmuar me MRI te bere 6-8 muaj pas trajtimit.

Rezultatet: intensiteti i dhimbjes u reduktua ndjeshem pas trajtimit (VAS 8-10 para trajtimit u be 3-4 pas nje muaji, 1-2 pas gjashte muajsh. Edhe MRI tregoi nje rezolucion te shprehur te hernies diskale. Nuk u verejten komplikacione minore apo madhore ne keto raste.

Konkluzione: mund te konkludohet qe ozoni epidural eshte shume efektiv ne trajtimin e dhimbjes nga hernia diskale lumbare.

Fjalë kyç: hernie diskale , komplikacione , dhimbje.

KONCEPTE ETIKO-JURIDIKE PËR KEQUSHTRIMIN DHE GABIMIN MJEKËSOR

Ilir Decolli, Prof.As.Dr.Arben Lloja, Dr.Shk.Admir Sinamati, Dr.Donjet Lloja

Abstrakt:

Kequshtrimi mjekësor përfshin shkelje të natyrës etike, deontologjike dhe ligjore të mjekut apo personelit shëndetësor në trajtimin e të sëmurëve. Mjekësia është shërbim profesional në dobi të të sëmurëve dhe të nevojave shëndetësore të njeriut. Është e rëndësishme të theksojmë se ekziston një etikë profesionale mjekësore, që i detyron mjekët t'i shërbejnë me ndërgjegje dhe angazhim profesional cdo të sëmuri, pa dallim race, feje, kombësie, shtrese sociale, ideologjike dhe politike. Mjeku nuk është vetëm mbrojtës i individit(pacientit) kundër sëmundjes, por edhe mbrojtës i shëndetit publik(lufta parandaluese kundër sëmundjeve dhe përhapjes së epidemive, edukimi shëndetësor etj). Parimi i cdo mjeku duhet të jetë respekti për jetën e njeriut, duke i shërbyer atij në raste sëmundjesh apo fatkeqësish. Në dritën e këtij parimi dhe sipas thënies së vjetër latine:"para se gjithash, mos dëmto" mjeku dhe personeli tjetër shëndetësor duhet të tregohen tepër të kujdesshëm, që të mos shkaktojnë dëmtime tek i sëmuri si pasojë e pakujdesisë. I sëmuri i beson mjekut shëndetin dhe jetën. Për të përligjur këtë besim, mjeku ka për detyrë të ushtrojë një praktikë të mirë mjekësore, duke ruajtur standartet profesionale dhe një kujdes shëndetësor të shkallës së lartë, në përputhje me kërkesat etiko-ligjore të një njeriu të arsyeshëm dhe te matur.

Fjalë kyç: Gabimi mjekësor , sëmundje , fatkeqësi.

FRAKTURË E MBËSHTJELLËSES SË PATELËS NË NJË DJALË 11 VJEÇ. RAPORT RASTI

Ilir Hasmuca MD, Zamir Demiraj MD, PhD
Departamenti i Ortopedisë dhe Traumatologjisë, Spitali Universitar i Traumës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Incidenca e frakturave të patelës tek fëmijët është 6,5 % e të gjitha frakturave të patelës, megjithatë, tek fëmijët e papjekur skeletalisht, thyerjet e mëngës së patelës janë lloji më i zakonshëm i frakturave të patelës, por i vështirë për t'u diagnostikuar dhe shpesh i humbur.
Një djalë 11-vjeçar u shtrua në urgjencën e spitalit tonë pasi kishte ndjerë dhimbje të forta në gjurin e djathtë gjatë vozitjes së biçikletës pasi u rrëzua nga ajo. Shenjat e tij klinike ishin: Dhimbje, ënjtje në gju, pamundësi për të mbajtur peshë dhe pamundësi për të zgjatur plotësisht gjurin. Radiografia tregoi vetëm një patellë të lartë. Thyerja e mëngës së patellës u diagnostikua klinikisht në bazë të shenjave të një patelle me kalërim të lartë dhe një boshllëk në mekanizmin ekstensor në polin e poshtëm të patelës. Të nesërmen pas lëndimit, ne kryem operacion reduktimi të hapur dhe fiksim të brendshëm me shirit të tensionit.
Si përfundim, megjithëse frakturat e mëngës së patelës tek fëmijët janë të rralla, duhet ta konsiderojmë atë si një nga diagnozat e mundshme diferenciale, në rastet e dëmtimeve akute të gjurit. Trajtimi kirurgjik në frakturën e mëngës së zhvendosur të patellës është mënyra më e mirë për të arritur një rikuperim të plotë sa më shpejt të jetë e mundur dhe fillimin e shpejtë të jetës normale.

Fjalët kyç: frakturë e patelës, diagnozë e humbur, reduktim i hapur, frakturë e pazakontë.

RADIOLOGJIA INTERVENTISTE

Dr.Sh.M.Ilirian Laci, Sabina Kembora

Abstrakt

Hyrje: Radiologjia tashmë është një fushë edhe më e gjerë shkak i pacientëve të cilët kërkojnë githmonë trajtime dhe metoda kurimi miniinvazive të cilat përvec se i ndihmojnë në trajtimin e tyre i sigurojnë edhe një cilësi jetese më të mirë përgjatë këtyre trajtimeve. Si për mjekun dhe pacientin është e rëndësishme shpejtësia e marrjes së informacionit mbi sëmundjen dhe trajtimin sa më shpejtë të saj, kompetenca këto të radiologjisë.

Materiali dhe Metodat: Ky punim shkencor bazën materiale e ka marrë nga studime të ndryshme nga mjekë të ndryshëm dhe metoda me të cilën punohet është ajo e krahasimit të patologjisë/simptomave para dhe pas nderhyrjes.

Rezultate: Rezultatet në fushën e radiologjisë interventiste janë pjesë e mjekësisë bashkëkohore dhe mund të konsiderohet dhe e ardhmja e mjekësisë. Shumë prej pacientëve të cilët i nënshtrohet ndërhyrjeve të ndryshme interventiste kanë rezultate të dukshme dhe prognoza më të mira shëndetësore. Radiologjia Interventiste kontribuon në trajtimin e pacienteve kryesisht me tumore hepatike si edhe pankreatike e përpos tyre ndihmon në trajtimin e këmbëve diabetike, lehtësimin e dhimbjeve të ndryshme, trajtimin e problemeve vaskulare etj.

Përfundime: Metodat interventiste të ndërhyrjeve janë kryesisht kompetencë e mjekëve radiologe por janë përkrahur edhe nga mjeke të specializimeve të tjera për të kontribuar në fushën e tyre. Aplikimi i këtyre metodave kërkon trajnim të specializuar dhe aftësi shumë të mira të mjekut.

Fjalë kyç: radiologji interventiste, tumore, këmbë diabetike, dhimbje, probleme vaskulare.

TRU-CUT BIOPSIA NË DIAGNOZËN E LEZIONEVE TË GJIRIT

Dr.Sh.M. Ilirian Laci[1] ,Dr.Alketa Spahiu[2] ,Prof.Asc. Helidon Nina[1] ,Dr.Sh.M. Leart Berdica[1].
[1]Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza,Tiranë.
[2]Poliklinika e Specialiteteve Nr.3,Tiranë.

Abstrakt

Objektivi: Të vlerësohet rëndësia e biopsisë Tru-Cut (TCB) në diagnozën e lezioneve të gjirit.

Metodat: Një seksion kryq vëzhgues jo-ndërhyrës u krye rishikimi i të gjitha raporteve të TCB-së për një masë ose lezion vërejtur në pacientët e shtruar ndërmjet janarit 2019 dhe dhjetorit 2021.Procedura është realizuar nën guide ekografike nën rregullat e asepsisë dhe anestezisë lokale.

Rezultatet: Nga rezultatet histopatologjia tregoi mbi 90% janë lezione malinje,në dy rast vlerësimi ishte suboptimal për arsye sepse lezioni ishte i vogël nën 9 mm dhe pacienteti ju nenshtruan kirurgjisë,ndërsa pjesa tjetër rezultuan lezione beninje të cilat ndiqen me ekzaminime radiologjike në vazhdimësi.Në asnjë pacientë nuk është përsëritur tru cut biopsia.I vetmi komplikacion ka qënë dhimbja dhe gjendja e ankthit në 2 pacientë,e cila është qetësuar me AINS dhe anksiolitike.

Përfundim: Biopsia Trucut është një alternativë e saktë për vleresimin e lezioneve te gjirit.

Fjalë kyçe: Lezionet e gjirit; Biopsi Tru-Cut.

BIOPSIA TRU-CUT SI METODA FILLESTARE E DIAGNOSTIKIMIT NË TUMORET E KOCKAVE

Dr.Sh.M. Ilirian Laci[1], Dr.Alketa Spahiu[2], Dr.Sh.M.Artan Bodeci[1], Dr.Ledian Fezollari[3], Prof.Dr.Kenan Bayrakçi[4]
[1]Qendra Spitalore Universitare Në në Tereza,Tirane.
[2]Poliklinika e Specialiteteve Nr.3,Tiranë .
[3] Spitali Universitar i Traumë s,Tiranë .
[4] Spitali Villa Maria,Tiranë .

Abstrakt

Sfondi: Biopsia Tru-cut në tumoret e dyshuar të kockave mund të kryhet edhe në qendra te radiologjise intervencionuese. Biopsia Tru-cut ka është vërtetuar si metode e sigurt me saktësi mbi 90%. Ne pergjithesi biopsia e kockes eshte realizuar nga mjeke ortoped ne sallen e kirurgjise duke marre nje fragment kocke ne zonen e dyshuar te tumorit dhe me pas eshte

bere vleresim histopatologjik nga mjeku anatomopatolog. Në ditë t e sotme gjithnjë e më shumë ë shtë rritur numri i pacientë ve që vijnë në kabinetet e radiologjisë intervencionuese për r të kryer procedure të biopsisë së kockë s në n drejtim radiologjik.

Materialet dhe metodat: Një studim u krye përmes një baze të dhënash të mbledhur duke përdorur një protokoll uniform. Të gjitha pacientët që kishin një lezion kockor.Pacientë t e marrë në studim janë pacientë të referuar nga mjekë t ortopede,kirurge,onkologe apo të diagnostikuar rastë sisht gjatë ekzaminimeve radiologjike.Të pacientë t realizuam biopsisë Tru-Cut duke respektuar parimet e asepsise dhe anestezise lokale. Modaliteti më i perdorur për r realizimin e biopsive kockore ë shtë CT (skaner) por janë të shumta rastet kur kemi aplikuar edhe ekografinë vecanë risht në tumore kockore me infitrim të indeve të buta,fluoroskopisë por kemi për rdorur dhe metoda të kombinuara.

Rezultatet: Në mbi 90 % të pacientë ve kemi patur një diagnozë të sigurt.Në për rgjithë si procedurat kanë që në të sukseshme dhe pa komplikacione madhore.Komplikacionet më të rë ndë sishme për rmë ndim dhimbja e fortë në një paciente e cila u qetë sua pas aplikimit e AINS si dhe një paciente e cila shfaqi nje reaksion të lehtë nga anestetiku i aplikuar lokalisht (lidokaina).

Konkluzione: Biopsia Tru-cut mund të rekomandohet si një metodë fillestare e diagnostikimit të tumoreve kockore.

Fjalët kyç: Diagnostika fillestare, tumore kockore, Tru cut biopsi.

REZULTATET E TRU CUT BIOPSISË SË DREJTUAR NËN CT NË LEZIONET PULMONARE

Dr.Sh.M. Ilirian Laci[1], Dr.Alketa Spahiu[2], Dr.Sh.M.Artan Bodeci[1], Dr.Evisa Kozma[1], Dr.Benard Shehu[1], Dr.Sh.M. Klerida Shehu

[1] Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza,Tiranë.

[2] Poliklinika e Specialiteteve Nr.3,Tiranë.

Abstrakt

Hyrje: Biopsia transtorakale (TTB) është një metodë efektive e përdorur për diagnostikimin e lezioneve pulmonare. Eshte më pak invazive në krahasim me procedurat kirurgjikale. Ndërkohë shkalla diagnostike e biopsisë tru-cut është më e lartë se ajo e biopsisë aspiruese me gjilpërë (FNAB) veçanërisht për lezionet beninje. Në këtë studim, ne prezantuam rezultatet e procedurës së biopsisë transtorakale (TTB) dhe frekuencën e tyre Komplikimet e TTB me faktorë rreziku të lidhur.

Materiali dhe metoda: U morën në studim pacientë të paraqitur për TCB transtorakale në periudhën janar 2019 dhjetor 2021.Në të gjitha rastet u përdor CT guidë për realizimin e procedurës.Pacientët ishin të ndërgjegjësuar dhe informuar për llojin e procedures dhe pasi kishin rënë dakort firmosin konsentin.Procedura është realizuar duke zbatuar rregullat e asepsisë dhe anestezisë lokale.Kemi patur disa raste të komplikacioneve dhe në të gjitha rastet komplikacioni ka qënë pneumotoraksi.

Rezultatet: Në shumicën e pacientëve biopsia ka vërtetuar një patologji malinje.Kemi patur vetem dy pacientë me patologji beninje dhe asnjë pacient pa diagnozë perfundimtare. Një paciente ka paraqitur dhimbje të forta e cila u qetësua me AINS.Ndërsa komplikacioni i

vetëm ka qënë pneumotoraksi u zhvillua në 10 pacientë dhe vetëm në një rast ishte masiv dhe u vendos dren torakal. Në raste të tjera pneumotoraksi ishte minimal dhe u aspirua apo u monitorua.Faktor i rëndësishëm për pneumotoraks është pulmoni emfizematoz.Sigurisht tru cut biopsia krahasuar me FNA rrit lehtësisht mundësinë për pneumotoraks.Nga ana tjetër për lezione malinje sensitiviteti dhe specificiteti i diagnozës me TCB dhe FNA nuk ndryshon shumë,gjë të cilën nuk mund ta themi për lezionet beninje.

Konkluzione: Komplikimet e TCB janë të ngjashme FNAB,por rëndësia e TCB është më e madhe kryesisht në lezionet beninje.

Fjalët kyçe: Lezion pulmonar, biopsi transtorakale, trucut, pneumotoraks.

COVID 19 DHE DISLIPIDEMIA

Ilirjan Gjyzari, Eralda Dervishi, Albana Gjyzari
Qendra Shendetësore Nr 7, Tiranë
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë
Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti i Mjekësise Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Shumica e pacientëve të infektuar me COVID-19 zhvillojnë sëmundje të lehtë ose të pakomplikuar. Kujdesi parësor ka luajtur një rol të rëndësishëm në diagnostikimin dhe manaxhimin e COVID-19 duke ulur kërkesën për shërbime spitalore. Sëmundja e Coronavirus 2019 (COVID-19) manifestohet me një spektër të gjerë simptomash dhe çrregullimesh patologjike. Çlirimi i citokineve pro-inflamatore shkakton një reaksion inflamator sistemik, ku profili metabolik gjithashtu dëmtohet. Ky studim pati si qëllim vlerësimin e ndryshimeve patologjike të low-density lipoprotein cholesterol (LDL-C), high-density lipoprotein (HDL), triglicerideve (TG) dhe niveleve të kolesterolit total në pacientët post COVID-19.

Metoda: Në këtë studim transversal u vlerësua profili lipidik i pacientëve post COVID-19, të cilët realizuan check up tek mjeku I familjes gjatë periudhës Nëntor-Dhjetor 2021. Si grup kontrolli u zgjodhën pacientë që nuk e kishin kaluar COVID-19 dhe përputheshin sa i takon moshës dhe gjinisë, gjatë së njëjtës periudhë.

Rezultatet: Në studim u perfshinë 25 pacientë post covid-19, 76% meshkuj, me moshë mesatare 62±14 vjeç. Grupi i kontrollit përbëhej nga 20 individ, të cilët nuk ishin infektuar me COVID-19, 70% meshkuj, me moshë mesatare 65±13 vjeç. Nivelet e LDL-C, HDL, TG dhe kolesterolit total ishin dukshëm më të ulëta në pacientët me COVID-19 krahasuar me grupin e kontrollit (përkatësisht P <0,001, 0,05, 0,043, < 0,001).

Konkluzione: Hipolipidemia, në mënyrë sinjifikante është më frekuente në pacientët post COVID-19. Indikatorët e inflamacionit duhet të monitorhen ngushtësisht në këta pacientë.

Fjalë kyç*: COVID-19, dislipidemi, inflamacion*

SFIDAT E FIZIOTERAPISË NË PACIENTËT POST AVC.

Ilirjana Zekja[1]; Baftie Vata[2]
[1]*Pedagoge FSHMT – UMT*
[2]*Studente FSHMT - UMT*

Abstrakt

Aksidenti cerebro vaskular (AVC) përcaktohet si çrregullim i vaskularizimit të indit cerebral, me pasojë defiçitet neurologjike me instalim te menjëhershëm e lokalizim në varësi të zonës së privuar /varfëruar nga vaskularizimi. Pacientët e diagnostikuar me AVC (ishemik/hemorragjik), manifestojnë defiçite neurologjike fokale të lokalizimeve e graviteteve të ndryshme. Në varësi të lokalizimit dhe gravitetit të defiçiteve neurologjike, pacientëve ju alterohen aktivitetet e jetës së përditëshme dhe u prishet cilësia e jetës së tyre dhe familjarëve që i asistojnë. Trajtimi medikamentoz ka në fokus rivendosjen e vaskularizimit kur është e mundur, si edhe trajtimin/ korrigjimin e vazhdueshëm të faktorëve të riskut. Përveç këtyre, e rëndësishme për pacientin dhe familjarët, është korrigjimi apo minimizimi i deficiteve neurologjike për të lehtësuar jetën e pacientit në kushtet e reja të krijuara. Fizioterapia/rehabilitimi fizik në AVC ndihmon në përmirësimin e cilësisë së jetës duke u fokusuar ne veçanti në kapacitetin/aftësitë fizike. Paaftësitë që mund tëshkaktohen nga AVC mund të jenë: defiçitet motore (me paraliza apo vështirësi në realizimin e lëvizjeve si: ecje, ruajtja e ekuilibrit apo edhe gëlltitja), defiçite sensitive (vështirësi/ pamundësi të sensibilitetit taktil, termik, algjezik apo të pozicionit), defiçite dhe çrregullime të të folurit, defiçite të memories apo alterime të të menduarit,çrregullime emocionale. Ekipi multidisiplinar i reabilitimit përbëhet nga : neurologu, fizioterapisti, infermieri logopedi, terapisti okupacional, psikologu, punonjësi social. Programet e reabilitimit të pacientëve post AVC hartohen nga ekipi i sipërcituar në mënyrë individuale në përputhje me nevojat e çdo pacienti me fokus: trajtimin e sëmundjes bazë dhe parandalimin e komplikacioneve; trajtimin e paaftësive fizike dhe përmirësimin e funksionit; sigurimin e mjeteve adaptuese dhe përshtatëse të mjedisit; orientimin dhe instruktimin e familjarëve. Reabilitimi post AVC ndihmon pacientin: të rekuperojë defiçitet e shkaktuara prej AVC-së, të rifitojë aftësitë e humbura, të zhvillojë mënyra të reja të funksionimit në përputhje me gjendjen e tij.

Fjalë kyç: AVC, fizioterapi, rehabilitim fizik.

RAST I VECANTË I METASTAZËS SË KOLONIT NGA KARCINOMA SEROZE E GRADËS SË ULËT TË OVARIT

Dr.Sc.Gentiana Cekodhima, Dr.Altin Cekodhima, Dr.Manjola Tahiraj, Dr.Ina Lulo

Abstrakt

Metastazat e zorrës nga një patologji primare malinje janë një etintet jo i zakonshëm në praktikën mjekësore. EUS-FNA është një proçedurë e rëndësishme për diagnotikimin e lezioneve pelvike. EUS-FNA është një guidë e mirëfilltë për klinicistët jo vetëm për diagnostikimin dhe trajtimin por ndikon në tërësinë ë trajtimit të pacientit. (1) Biopsia dhe ngjyrimet imunohistokimike jane esenciale për diferencimin e një patologjie primare kolorektale nga në metastazë e kolonit. Ne prezatojm rastin e një pacienteje femër, 42 vjeç, e cila referon se vuan prej vitesh nga konsipacioni dhe dhimbja perianale. Referon për sekrecione vaginale jot të pastra prej 3-4 muajsh. Në ekzaminimin gjinekologjik vihen re sekrecione me ngjyrë të errët. Pap Test është strisho me infiltrate inflamatore pa prani të qelizave atipike. Pacientja kryen një Rezonancë Magnetike ku evidentohet një lezion heterogjen , në hapësirën extraperitoneale , rekto-vaginale, me dyshimin për nje GIST ose tumor me origjine nga trakti gjinekologjik. Pacientes I merret material nën EUS FNA duke

përdorur një gjilpërë 19-gauge. Pacietja u diagnostikua me metastazë të kolonit nga kancer i ovarit i padiagnostikuar më parë.

Rast klinik: Pacientja jonë është një grua 42-vjeçare, e cila ankohej se vuante prej vitesh nga konstipacioni dhe dhimbjet perianale. Ajo raportoi sekrecione të papastra vaginale prej 3-4 muaj. Ekzaminimi gjinekologjik zbulon sekrecione të papastra. Citologjia vaginale: Infiltrate inflamatore pa qeliza atipike. Ndjekja e pacientit tregoi se niveli i CA125 në serum ishte ngritur në 120 U/mL (normale <35 U/mL). Ndërkohë, MRI demonstroi një formacion heterogjen me përmasa 7 cm në hapësirën rekto-vaginale, ekstraperitoneale, i dyshuar midis GIST dhe një tumori me origjinë nga septumi rekto-vaginal, ekstraperitoneal. Pacientja nuk ka histori të sëmundjes onkologjike. Gjithsesi, nuk mund të përjashtojmë mundësinë e metastazës rektale. Prandaj, pacientja iu nënshtrua një proçedure EUS FNA. Shkopi linear endosonografik u kalua nga anusi në nivelin 15 cm në regjionin e rektumit. Në rektum, në nivelin 3-4 cm nga linea dentata, u evidentua një formacion heterogjen solido-kistik me përmasa 68 mm. Formacioni është i kapsuluar me konture të rregullta dhe formë të rrumbullakët dhe mbështetej në murin i përparmë të rektumit.

Diskutimi: Karcinoma e ovareve është shkaku 5-të i vdekjes nga kanceri tek femrat në mbarë botën dhe metastazat mund të ndodhin në katër mënyra të ndryshme: diseminim peritoneal, invazioni direkt, metastaza në rrugë limfatike dhe metastaza në rrugë hematogjene (4) (5).
Kanceri kolorektal është malinjiteti i tretë më i shpeshtë në mbarë botën, por metastazat si patologji të kolonit janë të rralla. Si përfundim, metastazat sekondare të kolonit janë atipike. Diferencimi midis karcinomës primare të zorrës së trashë dhe metastazës dytësore mund të jetë gjithmonë sfidues për mjekët.

Fjalët kyçe: metastazë e kolonit, kancer i ovarit, ngjkyrimet imunohistokimike, EUS-FNA (aspirim me gjilpërë të imët)**.**

MANIFESTIMET KUTANE TË RADIOTERAPISË NË PACIENTËT ONKOLOGJIKE

Ina Sotiri[1], Prof.Ass. Monika Fida[2], Dr. Orges Spahiu[3], Indi Xhemaili[3]
[1]Mjek i Përgjithshëm, QSUT.
[2]Shërbimi i Dermatologjisë dhe i Venerologjisë. Departamenti i Sëmundjeve Infektive, QSUT.
[3]Njësia e Radioterapise Onkologjike, Shërbimi Onkologjik, QSUT.

Abstrakt

Hyrje: Radioterapia e përdorur në trajtimin e patologjive të ndryshme, në shumë raste pasohet me efekte të padëshiruara në lëkurë. Këto manifestime në lëkurë mund të jenë të lehta ose të rënda në varësi të shumë faktorëve. Ky studim synon pikërisht evidentimin e manifestimeve kutane të ndryshme që ndodhin gjatë ose pas periudhës së radioterapisë.

Qëllimi: Ky studim ka si qëllim të demonstrojë manifestimet kutane në pacientët nën trajtim me radioterapi për patologji të ndryshme, njohja e të cilave do të shërbejë për parandalimin dhe trajtimin e tyre.
Materiale dhe metoda: Studim prospektiv i kryer në Njesinë e Radioterapisë Onkologjike, Sherbimi Onkologjik në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë. Burimi i të dhënave janë 60 pacientë nën trajtim me Radioterapi në periudhën Mars- Maj 2021. Shumica

e pacientëve morën rrezatim në rangun e dozës totale prej 40-50 Gray (81.6 %). Ekzaminimi klinik përfshin ekzaminimin e përgjithshëm fizik dhe ekzaminimin kutan. Të dhënat e marra janë analizuar statistikisht.

Rezultate: Në këtë studim u vërejtën manifestime anësore kutane të ndryshme. Në studimin tonë morën pjesë pacientë të të dy sekseve me një predominim të seksit femër (63.3 %) në krahasim me seksin mashkull (36.6 %) në raportin 1.7:1. Grup-mosha më e prekur ishte midis 61-70 vjec (38.3 %). Mosha mesatare e të gjithë pacientëve llogaritet të jetë 61.58. Manifestimi kutan më i shpeshtë ishte eritema (71.4 %), i pasuar nga hiperpigmentimi (64.2 %), pruriti (38 %) dhe xerosis (38 %). Manifestime të tjera kutane ishin deskuamimi i lagësht (19 %), telangiektazia (11.9 %), alopecia (16 %), pllaka atrofike (7.1 %), likenifikim i lekures (2.3 %) dhe deskuamim i thatë (2.3 %). Indikacioni më i shpeshtë për radioterapi ishte kanceri i gjirit (31.6 %).

Konkluzione: Karakteristikat klinike të radiodermatitit dhe manifestimeve të tjera anësore janë më të rënda në pacientë me moshën më të madhe. Doza totale rrezatuese që shkaktoi më shumë radiodermatitit ishte midis 40-50 Gray. Karakteristikat klinike të radiodermatitit janë më të rënda në pacientët që morën dozë totale rrezatuese më të lartë.

Fjalë kyç: pacientët onkologjikë, radiodermatit.

TRAJTIMI I DHIMBJES LUMBARE ME SHOCK WAVE

Irena Kola[1], Adelajda Hoxha, Asilda Baculi, Danjel Isaku, Redis Halla
[1]*Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*

Abstrakt

Hyrja: Lumbalgjia është dhimbja muskuloskeletike më e zakonshme. Shfaqet në pjesën më të madhe të rasteve tek të rriturit, por mund të vihet re edhe tek fëmijët dhe adoleshentët. Baza anatomike e dhimbjeve të mesit është me origjinë vertebrale (e bashkëlindur apo e fituar) dhe jashtëvertebrale (muskulare, meningeale, viscerale). Format më të shpeshta të dhimbjeve të mesit mbeten ato me origjinë diskale dhe ato me origjinë nga artroza vertebrale. Terapia me shock wave dhe ajo ushtrimore janë opsione të rëndësishme terapeutike në trajtimin e lumbalgjive.

Qëllimi: Me anë të këtij studimi kemi si qëllim të tregojmë efektshmërinë e terapisë me shock wave të kombinuar me terapinë ushtrimore te pacientët me dhimbje kronike mesi në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe reduktimin e simptomave.

Metodika: Ky studim shkencor bazohet në marrjen e informacioneve nga një kërkim selektiv i literaturës nga faqe zyrtare si PubMed, Medline, Google Scholar, National Library of Medicine dhe në përvojën klinike të fizioterapistëve. Gjatë studimit u vlerësua siguria dhe efektshmëria e përdorimit të shock wave, trajtimit medikamentoz me analgjezikë, terapisë ushtrimore të individualizuar te pacientët me lumbalgji.

Konkluzioni: Rehabilitimi me shock wave i kombinuar me terapi ushtrimore dhe medikamentoze, lehtëson ndjeshëm simptomat duke favorizuar rritjen e amplitudes së lëvizjeve në regionin lumbar. Fizioterapia e aplikuar me terapi fizike ndihmon në përmirësimin e performancës fizike dhe cilësinë e jetës te këta pacientë.

Fjalët kyç: shock wave, ushtrime, rehabilitim, lumbalgji.

TERAPIA ME SHOCK WAVE NË TRAJTIMIN E SUPIT TË NGRIRË.

Denis Mata, Esmeralda Novruzaj , Rea Sherifi, Prof.As.Irena Kola.
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Abstrakt

Hyrja: Kapsuliti adeziv është një patologji e artikulacionit gleno-humeral, duke shkaktuar dhimbje dhe imobilitiet të artikulacionit. Shkaku në shumicën e rasteve është i panjohur. Trajtimi konservativ është i mire, por ende i paqartë, por terapia ESWT, është një terapi ndihmëse dhe e efektshme për trajtim.

Objektivat: Të analizojmë efektshmerinë e terapisë me Shock-Wave (ESWT) në trajtimin e dhimbjes dhe ROM-it në supin e ngrirë.

Metoda: Jemi bazuar në 9 studime, të cituara nga revista mjekësore (PubMed, Medline,WebMD, MedScope). Pacientët të diagnostikuar me kapsulit adeziv, në të gjitha studimet e marra në referencë, janë ndarë në dy grupe, në mënyrë të rastësishme. Në studimet [1] [3], njëri grup u trajtua me ESWT, tjetri me AINS orale. Në studimet [2] [8], njëri grup u trajtua me ESWT, dhe tjetri me trajtim placebo. Në studimin [9], njëri grup u trajtua me ESWT, tjetri me ultrasound dhe terapi ushtrimore. Në studimet [6] [7] njëri grup u trajtua me ESWT, tjetri me terapi fizike conservative.

Rezultatet: Për studimet e marra në konsideratë u vu re se : pacientët e trajtuar me ESWT kanë një përmirësim më të hershëm dhe më të dukshëm të dhimbjes dhe funksionalitetit, ROM-it articular, krahasuar me efektin nga trajtimet e tjera si: (placebo, AINS, trajtim konservativ, ultrasound), të aplikuara te pacientët.

Konkluzione: Në bazë të studimeve të mësipërme, arrihet në përfundim se, terapia ESWT është më efikase në trajtimin e dhimbjes dhe funksionalitetit, ROM-it artikular, krahasimisht me trajtime të tjera të aplikuara te grupet e pacientëve të diagnostikuar me kapsulit adeziv.

Fjalë kyç: Sup i ngrirë, fizioterapi, placebo, ESWT.

KORRELACIONI I VITAMINËS D ME OSTEOPOROZËN

Prof.Asoc. Irena Kola, Kristina Gjoka, Anxhela Gjini
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Abstrakt

Hyrje: Osteoporoza është një sëmundje e metabolizmit kockor, e cila karakterizohet nga reduktimi në mënyrë të heshtur dhe progresive të densitetit kockor dhe pasohet nga një risk për fraktura që mund të rezultojnë fatale për pacientin. Shkaqet që çojnë në këtë sëmundje janë endogjene dhe ekzogjene ,por kryesisht lidhet me uljen e nivelit të vitaminës D.

Qëllimi: Studimi ynë është rishikimi dhe paraqitja e një tabloje sa më të plotë lidhur me osteoporozën dhe efektin e vitaminës D për osteoporozën.

Materiali dhe metoda e studimit: Është një rishikim literature, të studimeve të publikuara në PubMed, Medline,WebMD , mbi korrelacionin e vitaminës D me osteoporozën, një indikator me përdorim të gjerë në diagnostikën dhe studimin e thellë të kësaj sëmundjeje. Studimet e marra në referencë nxjerrin në pah se, rëndësi të vecantë ka diagnostikimi i osteoporozës nëpërmjet densitometrisë me rreze X me energji të dyfishtë(DEXA), e cila përbën praktikën më të mirë të matjes së densitetit kockor. Sipas statistikave të Fondacionit Ndërkombëtar të Osteoporozës për vendet e BE,Zvicër,MB numri i vlerësuar i individëve të moshës mbi 50 vjeç me osteoporozë në vitin 2019 janë 32 milionë, ku 25.5 milionë janë femra dhe 6.5 milionë meshkuj, duke dalë në përfundimin se femrat janë më të prekurat nga osteoporoza. Krahas diagnostikimit të osteoporozës , në këto studime rëndësi i është kushtuar dhe nivelit të vitaminës D dhe korrelacionit me osteoporozën. Tek studimet e Michael Holick në Vitamin D deficiency. *N Engl J Med.* mungesë e vitaminës D përcaktohet përqendrimi i 25(OH)D më i vogël se 10 ng/mL dhe pamjaftueshmëria 20-30 ng/ml. Së fundmi trajtimet dhe rekomandimet për osteoporozën në këndvështrimin e mungesës së vitaminës D kanë përparuar nga dieta, suplementet, trajtimet me bifosfonate si dhe ai i zëvendësimit hormonal.

Konkluzion: 25-OH-Vitaminë D është thelbësore për statusin e vitaminës D. Për të shmangur mundësitë e zhvillimit të osteoporozës, duhet treguar kujdes me dietën , stilin e jetesës, si dhe me diagnostikimin me anë të DEXA sa më herët, kryesisht grupin e pacientëve të riskuar.

Fjalë kyç: Vitamina D, osteoporoza, pacienti, dieta, mungesa e vitaminës D.

MENAXHIMI I RADIKULOPATISË CERVIKALE ME ANË TË USHTRIMEVE TË STABILIZIMIT.

Prof.Asoc. Irena Kola, Msc. Flogerta Doku

Abstrakt

Hyrje:Radikulopatia cervikale është një proçes patologjik që karakterizohet nga komprimimi i nervit nga hernia diskale ose osteofitet. Kjo prekje zakonisht jep dhimbje ose mpirje të qafës dhe krahut, deficite sensore ose disfunksion motorrik të qafës dhe gjymtyrëve të sipërme. Norma vjetore e incidencës 0,3%, piku i saj arrin në moshën 50 -54 vjeç.

Qëllimi:Të vlerësojë efikasitetin e ushtrimeve të stabilizimit në menxhimin e radikulopatisë cervikale.

Metodologjia: Punimi shqyrtoi literaturën aktuale për radikulopatinë cervikale dhe efikasitetin e ushtrimeve të stabilizimit në reduktimin e simptomave. Kërkimi i literaturës u krye për artikujt e botuar në gjuhën angleze. Të dhënat e grumbulluara janë dytësore. Për identifikimin e studimeve përkatëse u përdorën site publikimesh zyrtare si: Google Scholar, Biblioteka Cochrane, MEDLINE, PubMed, PEDro etj. Janë përshirë artikuj të 10 viteve të fundit dhe janë përjashtuar artikuj në lidhje me patologji të tjera të regjionit cervikal. Të dhënat nga artikujt e ndryshëm janë përpunuar duke treguar metodën më të pranueshme dhe të suksesshme te pacientët.

Rezultatet: Një total prej 25 artikujve u zgjodhën nga strategjia sistematike e kërkimeve. Pasi u hoqën 4 kopje, 21 artikujt e mbetur u shqyrtuan nëpërmjet titullit dhe përmbjatjes së

abstraktit dhe 16 studime u vlerësuan si potencialisht të pranueshme. Pas analizës së plotë të tekstit 2 artikuj u përjashtuan për shkak të mungesës së përdorimit të ushtrimeve të stabilizimit dhe mungesës së rasteve. Si përfundim 14 artikuj plotësuan kriteret e përfshirjes. Bazuar në artikujt e përzgjedhur u pa që ushtrimet e stabilizimit përmirësojnë ndjeshëm funksionalitetin e pacientëve me readikulopati cervikale.

Konkluzioni: Ky punim sugjeron se përdorimi i ushtrimeve të stabilizimit në radikulopatinë cervikale është efektiv. Këto ushtrime ndikojnë në uljen e dhimbjes dhe përmirësimin e cilësisë së jetës dhe qëndrimit në pacientët me radikulopati cervikale.

Fjalë kyç: radikulopati cervikale, ushtrime stabilizimi, dhimbje, paaftësi, dhimbje qafe.

MENAXHIMI I PACIENTËVE COVID-19 ME ANË TË TEKNIKAVE TË REHABILITIMIT.

Prof.Asoc. Irena Kola, Msc. Klea Cipuri

Abstrakt

Qëllimi: Qëllimi i këtij rishikimi literature është vlerësimi i efektivitetit të disa teknikave të rehabilitimit në përmirësimin e simptomave dhe cilësisë së jetës tek personat e diagnostikuar me COVID-19.

Metodat: Për realizimin e këtij rishikimi literature u përdorën si burim informacioni databaza elektronike të besueshme si Medline®,PubMed®,GoogleScholar.Pas përzgjedhjes së detajuar sipas kritereve të pranimit dhe përjashtimit,u përfshinë 27 artikuj në total,të organizuar në 4 hipoteza në lidhje me fizioterapinë respiratore, rehabilitimin pulmonar gjithëpërfshirës, trajnimin e muksujve të frymëmarrjes (teknika IMT) dhe ushtrimeve terapeutike.

Rezultatet: Ndër artikujt e përzgjedhur 9 studime trajtonin rehabilitimin pulmonar gjithë përfshirës, 8 studime trajtonin fizioterapinë respiratore, 5 studime trajtonin trajnimin e muskujve inspirator (IMT) dhe 5 trajtonin ushtrimet terapeutike. Nga studimet e shqyrtuara u vu re se efektet kryesore të rehabilitimit ne menaxhimin e pacientëve me COVID-19 janë përmirësimi i dispnesë, lodhjes, statusit mendor(ankthi dhe depresioni), rritja e forcës muskulare, cilësisë së jetës si dhe përshpejton kohën e rikuperimit.

Konkluzioni: Të gjithë teknikat e rehabilitimit të shqyrtuara në këtë punim kanë rezultuar të realizueshme, të sigurta dhe efektive. Nga rishikimi i literaturës është e qartë se teknikat e rehabilitimit ndihmojnë në përmirësimin e simptomave dhe menaxhimin e COVID-19.

Fjalët kyç: COVID-19, përmirësimi i simptomave, fizioterapia respiratore, trajnimi i muskujve inspirator , ushtrimet terapeutike.

IMPAKTI I COVID-19 NË PATOLOGJITË KRONIKE TË TRAKTIT GASTROINTESTINAL

Dr. Shk. Irgen Tafaj
Shërbimi gastroenterologji-hepatologji
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë

Abstrakt

COVID-19 u konsiderua fillimisht si një sëmundje respiratore, por virusi SARS-CoV 2 mund të ketë konsekuenca të rëndësishme sistemike përmes prekjes së organeve të ndryshme, përfshirë këtu edhe traktin gastrointestinal. Në këtë prezantim janë sjellë të dhëna të rëndësishme për mjekun klinicist që përballet me këta të sëmurë, ku perfshihen: mekanizmat e dëmtimit indor nga virusi SARS-CoV-2; pasojat e imunosupresionit në të sëmurët me sëmundje inflamatore kronike intestinale; sëmundja kronike e mëlcisë dhe risku i shtuar i dekompensimit në të sëmurët me cirroze hepatike; impakti i COVID-19 në urgjencat gastrointestinale, në endoskopinë gastrointestinale, në diagnozë dhe në trajtim. Në këto kushte është e nevojshme të njihen mirë toksiciteti dhe efektet terapeutike të barnave të përdorura gjerësisht nga gastrohepatologet si dhe lidhja e tyre me COVID-19.

Në konkluzion: cdo pjesë e sistemit digjestiv mund të preket nga virusi SARS-CoV-2 dhe të sëmuret me sëmundje pre-ekzistuese gastrointestinale janë me risk më të lartë për efekte anësore. Disa nga barnat e propozuara për trajtimin e SARS-CoV-2 mund të shkaktojnë ose përkeqësojnë disa nga simptomat gastrointestinale të lidhura me COVID 19, si dhe mund të shkaktojnë dëmtime serioze hepatike.

Fjalë kyç: trakti gastrointestinal, covid**.**

INTERPRETIMI I REZULTATEVE LABORATORIKE TË AUTOANTITRUPAVE ANA

Joana Hankollari
Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University, Tiranë

Abstrakt

Antitrupat antinukleare (ANA) janë një grup autoantitrupash, që kanë target substancat që gjenden në bërthamën e një qelize. Këto autoantitrupa prodhohen nga sistemi imunitar, kur ai nuk arrin të dallojë "veten dhe joveten". Testi ANA është një nga analizat më të rëndësishme të gjakut që përdoret për të diagnostikuar një çrregullim autoimun në Reumatologji. Të kesh një rezultat pozitiv nuk do të thotë që një pacient ka një sëmundje. Ky prezantim synon të interpretojë rezultatet e ndryshme të testit ANA, për të sqaruar indikacionet për këtë test, shkaqet e rezultateve fals pozitive, shkaqet e rezultateve fals negative, situatat kur është e nevojshme të hetohet më shumë me analizat e tjera laboratorike. Rezultatet pozitive mund të përfshijnë modele të ndryshme si modeli centromer, modeli citoplazmatik, modeli bërthamor, modeli nukleolar, modeli homogjen ose modeli me pika, gjë që na ndihmon të bëjmë një diagnozë diferenciale të çrregullimeve autoimune në Reumatologji.

Fjalët kyçe: antitrupat antinukleare, rezultat fals pozitiv, rezultat fals negativ, çrregullime autoimmune.

ROLI I ANALIZAVE GJENETIKE NË LEUKEMITË AKUTE LIMFOBLASTIKE

Jora Kociaj, Alma Cili, Adela Perolla, Arben Ivanaj

Abstrakt

Hyrja: Leukemia akute limfoblastike (LAL) është një sëmundje malinje e palcës kockore, në të cilën pekusoret e hershëm limfoid, prolifeojnë dhe zëvendesojnë qelizat nomale hematopoetike të palcës. Leukemia akute limfoblastike është sëmundja malinje më e shpeshtë te fëmijët dhe pavarësisht përqindjes të lartë të shërimit te fëmijët (rreth 90%), mbetet një shkak I rëndësishëm mobiditeti dhe motaliteti në fëmijë dhe adultë. Shoqata Amerikane e Kancerit parashikon që në vitin 2022 do të jenë afërsisht 6,660 raste të reja me LLA (3,740 në meshkuj dhe 2,920 në femra) dhe rreth 1560 vdekje (880 në meshkuj dhe 680 në femra). Qelizat malinje të LAL janë pekursoret limfoide që kanë ndaluar në një fazë të hershme të zhvillimit. Ky ndalim shaktohet nga një shprehje jo nomale e gjeneve, shpesh si rezultat I një translokacioni kromozomal ose anomalie të numrit të komozomeve.

Përshkrimi: Leukemia akute limfoblastike (ALL) ndahet në ALL me qeliza prekusore të linjës B (BCP) (BCP-ALL) ose, më rrallë, me qeliza prekusore të linjës T (T-ALL). Dihet pak për faktoret e riskut të ALL te të rriturit, në shumicën e rasteve janë të paidentifikueshëm, por mutacionet gjenetike janë prezente, dhe përgjegjëse për agresivitetin, ecurinë, relapsin e sëmundjes. LAL pediatrike ka një etiologji multifaktoriale me mutacione gjenetike që ndodhin në dy faza, edhe ekspozimi ndaj infeksioneve luan rol të rëndësishëm.

Konkluzioni: Identifikimi i saktë dhe gjithëpërfshirës i gamës së plotë të ndryshimeve gjenetike në LAL është i rëndësishëm për diagnostikimin, prognozën, zbatimin e terapisë së synuar dhe monitorimin e ecurisë dhe përgjigjies së trajtimit. Për këtë arsye është e rëndësishme të kryhen teste gjnetike në pacientë me LAL që në hapat e fillimit të diagnostikimit të tyre, si dhe në relaps, veçanërisht për nëntipet e LAL me rrezik të lartë.

Fjalët kyç: gjenetika, leukemia akute.

REZULTATI NË PACIENTËT ME KERATOKONUS , EKSTAZI KORNEALE DHE KORNEA TË HOLLA

Klajda Bardhi [1]

Abstrakt

Qëllimi: Të ndalojë keratokonusin ose progresin e hollimit të kornesë, të reduktojë astigmatizmin e parregullt dhe
përmirësojnë BCVA. Studimi 6-vjeçar dhe ndjekja e pacientëve të parë zakonisht çdo 2-3 pacientë çdo muaj, pothuajse 120
pacientët në 6 vjet.

Metodat: PRK duke përdorur Ëave light eximer EX 500 nm dhe CXL UV 300 nm. Këtyre procedurave, ne shtuam një
trajtim i kombinuar duke iu referuar Oculink ose topografisë së drejtuar për të përmirësuar parregullsitë e kornesë - gjithashtu duke përdorur

Vibex Rapid i cili është me një shpejtësi dyfishi të difuzionit se riboflavina standarde.
Zgjedhja e kandidatëve: Jo të gjithë pacientët me keratokonus mund të kenë sukses në PRK+CXL të udhëhequr nga topografia.
+oculink/topografi e drejtuar+Vibex rapid – më të mundshmet janë Kc1, Kc1-Kc2, kc2 me k1-K2 jo shumë të larta.

Konkluzioni: PRK+CXL e drejtuar nga topografia është metoda më adekuate për ndalimin dhe përmirësimin e shikimit në
pacienti me keratokonus, dhe në astigmatizëm të parregullt, ose topografi të kornesë së hollë të drejtuar është një metodë më e sigurt për të mos
duke pasur komplikime në kohë, qëllimi i trajtimit është të rrafshojë pjesën më të pjerrët të kornesë dhe të thellojë
zona më e sheshtë e kornesë.

Fjalë kyç: Keratokonus; astigmatizëm i parregullt; Topografia e hollë e kornesë; Keratektomia fototerapeutike; Korneale
kolagjenit

LIDHJA E TROMBOZËS ASIMPTONMTIKE E VENAVE TË THELLA TEK PACIENTËT ME COVID-19 , ME NIVELET E RRITURA TË D-DIMERIT.

Klara Hysenaj, Rezarta Stena, Gjergji Doka
Klara Hysenaj , Msc, Asistent lektor, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti "A.Xhuvani", Elbasan
Rezarta Stena Msc.Asistent lektor, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti "A.Xhuvani", Elbasan
Gjergji Doka, Msc, Asistent lektor, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti "A.Xhuvani", Elbasan

Abstrakt

Hyrje: Tromboza e venave të thella nënkupton mpiksje të gjakut ose tromb në një venë të thellë. Më të zakonshme ato janë në këmbë, por mund të zhvillohen në krah ose dhe në pjesë të tjera të trupit. Një pjesë e mpiksjes, e quajtur embolia mund të shkëputet dhe të hyjë në mushkëri duke shkaktuar embolin pulmonare (PE), e cila mund të jetë fatale. Gjatë pandemisë u vu re se pacientët me pneumoni nga COVID-19 të shtruar në njësinë e kujdesit intensiv (ICU), kishin një risk shumë të lartë për tromboembolizëm venoz (VTE).

Qëllimi: Gjatë studimit u synua që të vlerësohej ndikimi i nivele të rritura të D-dimerit tek pacientët me trombozë asimptomatike të venave të thella (DVT).

Metodologjia: Në këtë studim prospektiv, janë ekzaminuar shumë pacientë të shtruar në njësitë e kujdesit jo intensiv me diagnozën e pneumonisë nga COVID-19 dhe D-dimer > 1000 ng/ml. Këta pacientë u ekzaminuan gjithashtu për DVT asimptomatikë me eko doppler për nje tablo më të plotë.

Rezultatet: Në studim u përfshin 146 pacientë, ku nga këta shumica ishin meshkuj (55 % meshkuj). Përveç tre pacientëve, të gjithë të tjerët u trajtuan me doza standarde të tromboprofilaksisë. Ditët mesatare të shtrimit në spital deri në ekzaminimin me eko doppler ishin 9. Pas diagnostikimit me eko Doppler për trombozë asimptomatike të venave të thella,

u vu re që nga 22 pacientë (13.5%), vetëm një ishte me trombozë asimptomatike të venave të thella proksimale, kurse gjashtë pacientë të tjerë ishin me trombozë asimptomatike të venave të thella distale bilaterale. Tek këta pacientë u vun re dhe nivele të larta të D-dimerit të cilat varionin nga 2350 ng/ml deri në 5247 ng/ml në varësi të gjëndjes së pacientëve. Shpesh herë nivelet e D-dimerit me vlere >1680 ng/ml shoqëroheshin me DVT asimptomatike.

Konkluzionet: Nga studimi i këtyre pacientëve arritëm në përfundimin që nivelet e rritura të D-dimerit, janë të dhëna shumë të rëndësishme dhe të nevojshme laboratorike së bashku me eko doppler për diagnostikimin e trombozave asimptomatike të venave të thella tek pacientët me COVID-19.

Fjalë kyç: COVID-19, Tromboembolizëm venoz, Trombozë e venave të thella, Eko Doppler, D-dimer

"MIRROR THERAPY" TE PACIENTËT PAS AKSIDENTIT CEREBROVASKULAR

Megi Kuka[1], Migena Hoxha [1], Klejda Tani[2]
[1] Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, UMT
[2] Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit, UST

Abstrakt

Hyrje: Qëllimi i këtij studimi është njohja me terapinë me pasqyrë, të njohur ndryshe "mirror therapy", të shpjegojë mekanizmin që fshihet pas përdorimit të saj dhe të tregojë nëse është efektive në rehabilitimin e pacientëve pas një aksidenti cerebrovaskular.

Metodat: Janë gjetur artikuj shkencorë përmes një pune kërkimore sistematike në website mjekësore si PubMed, Google Scholar, Medline dhe ato janë përzgjedhur për shqyrtim në bazë të rezultateve të pasqyruara.

Rezultatet: "Mirror therapy" rezultoi të ketë efektshmëri në përmirësime motorike dhe ndijore edhe pse shkalla e përmirësimeve në dëmtimet ndijore, neglizhencës së anës së prekur dhe dhimbjes është e limituar.

Konkluzionet: "Mirror therapy" vërtetohet të jetë një qasje efektive dhe lehtësisht e realizueshme për të rehabilituar pacientët pas një aksidenti cerebrovaskular në fazat akute, subakute dhe kronike të sëmundjes, edhe pse efektet e saj afatgjata dhe ndikimi në aktivitetet e jetës së përditshme duhen analizuar më tej.

Fjalët kyç: mirror therapy, hemiplegji, aksident cerebrovaskular, rehabilitim, motor-sensor, dhimbje.

RËNDËSIA E FIZIOTERAPISË RESPIRATORE DHE TERAPISË USHTRIMORE TE PACIENTËT ME SËMUNDJE PULMONARE OBSTRUKTIVE

Klejda Tani[1], Vjollca Shpata[1], Fregen Dhamaj[1]
1- Fakulteti i Shkencave te Rehabilitimit, Universiteti i Sporteve të Tiranës

Abstrakt

Hyrje: Fizioterapia respiratore dhe ushtrimore janë opsione të rëndësishme terapeutike në sëmundjen pulmonare obstruktive kronike (SPOK), fibrozën cistike, astmën dhe sëmundjet e tjera obstruktive pulmonare. Në vitin 2020 SPOK ishte shkaku i tretë më i zakonshëm i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë në mbarë botën. Sëmundjet obstruktive përkeqësojnë ndjeshëm cilësinë e jetës së pacientëve dhe paraqet një sfidë të madhe ekonomike për sistemin e kujdesit shëndetësor.

Qëllimi: Me anë të këtij studimi kemi si qëllim të tregojmë efektshmërinë e fizioterapisë respiratore dhe ushtrimore te pacientët me sëmundje obstruktive në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe simptomave të këtyre pacientëve.

Metodika: Ky rishikim bazohet në publikimet përkatëse të marra nga një kërkim selektiv i literaturës nga faqe zyrtare si PubMed, Medline, Google Scholar dhe në përvojën klinike të autorëve. Gjatë rishikimit të literaturës vlerësuam sigurinë dhe efektshmërinë në rezultatet fiziologjike dhe klinike të drenazhit autogjen, ciklin aktiv të teknikave të pastrimit të rrugëve të frymëmarrjes dhe rehabilitimin ushtrimor në pacientët obstruktiv.

Konkluzioni: Rehabilitimi respirator dhe ushtrimor, për pacientët me sëmundje obstruktive, mbështetet nga evidencat me nivelin më të lartë statistikor. Fizioterapia respiratore ndimon në përmirësimin performancës fizike, vështirësinë e frymëkëmbimit dhe cilësinë e jetës te këta pancient.

Fjalët kyç: fizioterapia respiratore, ushtrime, rehabilitim, sëmundje obstruktive kronike

KUJDESI INFERMIEROR NE DIABETIN GESTACIONAL

Phd Klodiana Poshi[1,2] Edjona Miraka [2]
[1]*Departamenti Endocrilogjise QSUT*
[2]*FSHMT*

Abstrakt

Diabeti melitus eshte nje crregullim endokrin i metabolizmit te karbohidrateve qe vjen si pasoje e deficitit te prodhimit te insulines nga qelizat e ishujve te langerhansit ,ne pankreas.Gjate periudhes se barres placenta prodhon laktogjen human placentar qe eshte nje antagonist I fuqishem i insulines. Sasia e prodhimit eshte ne perpjesetim te drejte me madhesine e placentes.Rriskojne individet .Mbipesha e larte me indeksin e mases trupore mbi 30 kg/m² ,diabeti ne familje (prindrit/motrat/vellezerit),diabet gestacional ne shtatzanite e meparshme shtatzani me moshe mbi 30 vjec,lindjet e deshtuara ne fazen e vonshme te shtatzanise,lindje e meparshme me peshe mbi 4000 gram (keta persona qe jane me te rrezikuar ndaj kesaj semundjeje duhet te testohen qe ne kontrollin e pare te shtatzanise.)Gjithsesi mund te ndodhe qe nje pjese e grave te jene te prekura nga diabeti gestacional dhe mos te kene pasur asnje faktor rrisku te mesiperm. KUJDESIT INFERMIEROR:

Zhvillohet nje bashkebisedim me pacienten ku gjate kohes se hospitalizimit anetaret e stafitgrumbullojme nje histori te plote mbi dieten dhe shendetin,kryejne nje vleresim te pergjithshem te sisteme te organizmit dhe percaktojne planet e trajtimit te bazuara ne njohurite dhe nevojat e pacientes.Kontrolli adekuat i gruas gravide me diabet eshte problemi

primar ne planifikimin e nderhyrjes infermierore per te parandaluar ose pakesuar shpeshtesine e mortalitetit dhe morbilitetit perinatal. komponentet kryesore te kujdesit direkt infermieror dhe edukimi i pacientes lidhen me –ushqyerjen -dhenien e insulines -monitorimin e glukozes ne urine/gjak -ushtrimet gjimnastikore.

Fjalë kyçe:. Diabeti mellitus .Gravidanca Kujdesi Infermieror

HIPOTIROZA DHE GRAVIDANCA

PH.D Klodiana Poshi [1,2] Minushe Cela[2]
[2]Departamenti i Endokrinologjisë pranë QSUT .[1]Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike Tiranë

Abstrakt

Hipotiroidizmi është një gjendja ku gjendra e tiroides nuk prodhon sasi të mjaftueshme të hormoneve tiroidiene në qarkullimin e gjakut. Kjo bën që metabolizmi pacientëve të diagnostikuar me hipotiroidizëm të ngadalësohet .Hipotiroidizmi është një gjëndje tepër e zakonshme e cila zakonisht ndodh gjatë një shtatëzanie dhe simptomat që ajo shkakton janë tepër të ngjashme me simptomat e një shtatëzanie normale,prandaj shpesh herë një vonesë në diagnostikimin e kësaj gjëndjeje mund të sjellë pasoja të rënda për fetusin dhe nënën. Vlerat normale te hormonit TSH në shtatëzani

Tremujori i parë 0.6–3.4 mU/L < 0.6 mU/L Tremujori i dytë 0.37–3.6 mU/L < 0.3 mU/L Tremujori i tretë 0.38–4.0 mU/L < 0.3 mU

Qëllimi: Të monitohen hormone e tiroides sipas algorit .Fokusi është vënë në përshkriminin e hipotirozës si mit e hipotirozës gjatë shtatëzanisë .Të jemi të kujdesshëm për një sjellë një fetus sa më të shëndetshëm .Gjithashtu rëndësi të vecantë zë edhe parandalimi i kësaj gjëndjeje tepër të zakonshme në shtatëzani duke iu referuar vlerave normale të hormonit të tiroides përgjatë gjithë 9 mujorit të shtatëzanisë.

Konkluzione: Ndjekia me përpikmëri e këshillave të mjekut endokrinolog dhe gjinekolog do të monitorojnë më së miri shëndetin e nënës dhe fetusit .

Fjalë kyc: hipotiroza , shtatëzania hormoni I tiroides

SËMUNDJET ALERGJIKE DHE ROLI I KORTIKOSTEROIDËVE NË TRAJTIMIN E TYRE

Laerta Pupo[1] , Monika Fida[2] , Blerta Lame[3]
Alergologe-Imunologe klinike, Klinikë Private
Dermatologe-Venerologe, QSUT
Alergologe-Imunologe klinike, Klinikë Private

Abstrakt

Sëmundjet alergjike përbejnë një grup të gjerë çrregullimesh multifaktoriale, kryesisht të shkaktuara nga një reaksion imunologjik IgE-vartes ndaj një alergeni. Ndërveprimi i faktorëvë gjenetike, ambjentalë dhe atyre socioekonomike janë determinues në shfaqjen e fenotipeve të shumta të këtyre sëmundjeve. Sëmundjet alergjike prekin më shumë se 20% të popullsisë në mbarë boten, vecanërisht në vendet e industrializuara dhe vazhdojnë të jenë në trend rritje. Sëmundjet alergjike kronike kryesore përfshijne rinitin, astmën, dermatitin atopik, sëmundjet gastrointestinale dhe urtikarien. Hapi me i rëndësishëm i në parandalimin e reaksioneve alergjike dhe reduktimin e simptomave është shmangia e alergenit, por shpesh herë alergeni mbetet i paevidentuar dhe trajtimi mendikamentoz mbetet një nga shtyllat kryesore të trajtimit të sëmundjeve përbëjnë një nga medikamentet bazë të tajtimit të sëmundjeve alergjike, që ushtrojnë efekte anti-inflamatore përmes dy rrugëve atë të rrugës së transaktivizimit dhe rrugës së transrepresionit. Gjejnë përdorim në të gjitha formëdozat e tyre, si me inhalacion, perdorim lokal, orale e sistemike. Qëllimi i përdorimit të tyre është trajtimi ose kontrolli i sëmundjes dhe ulja e riskut për të patur ekzacerbime. Mënyra e administrimit, përllogaritja e dozave dhe kohëzgjatja e përdorimit duhet të behet sipas një plani të personalizuar nga mjeku.

Fjalë kyç : Sëmundjet alergjike , trajtimi mendikamentoz , dermatiti atopik

METASTAZAT E TUMOREVE BENINJE

Dr. Sci. Leart Berdica, Agim Deda, Eva Luniku, Haki Guri, Indri Bibaja, Justi Gjoni, Melina Alimadhi, Meri Vasha, Xhensila Lilaj

Abstrakt

Hyrje: Tumori beninj është një rritje jokanceroze, e cila nuk invadon indet afër e nuk shpërndahet në pjesët e tjera të trupit **(Error! Reference source not found.**. Por a është e mundur që një tumor i tillë të metastazojë? Ky punim është një rishikim i literaturës mbi rastet e shfaqjes së këtij pseudomalinjiteti.

Objektivat: 1. Identifikimi i rasteve të referuara me metastaza beninje. 2. Pasqyrimi i koncepteve tipike të një patologjie neoplazike beninje (përkufizim, etiologji, epidemiologji, prognozë, pamje mikro dhe makroskopike etj.) duke u bazuar në studimet dhe raportimet e këtyre metastazave.

Metodat: Të dhënat janë mbledhur nga database mjekësore (Medscape, Pubmed, National Center for Biotechnology Information), studime nga mjekë dhe profesorë nga departamente të ndryshme të universiteteve botërore.

Rezultatet: Raportime të ndryshme vërtetojnë ekzistencën e disa tumoreve beninje që japin metastaza, nga të cilët ne kemi trajtuar adenomën pleomorfe të gjendrave salivare, meningeomën, osteoklastomën dhe leiomiomën. Incidenca e këtyre rasteve është e ulët. Mekanizmi kryesor i metastazimit nuk është bërë ende i qartë, por ka hipoteza për rrugë përhapje limfogjene, hematogjene etj. Kanë risk më të lartë pacientët me histori rekurencash të tumorit, ose ata që mbartin diagnozën prej shumë vitesh. Histologjikisht meastazat paraqesin strukturë beninje. Vendet kryesore të përhapjes janë pulmonet, kockat, hepari dhe strukturat cervikale. Prognozat janë të ndryshme në varësi të tumorit. Terapia konsiston kryesisht në metodat konvencionale (ekcizion kirurgikal, radioterapi, kimioterapi)

Përfundimi: Rastet e përsëritura të tumoreve beninje kërkojnë ndjekje dhe monitorim te zgjatur në vite. Prognoza e metastazimeve nuk është gjithmonë e mirë. Terapitë

konvencionale për patologjitë neoplazike, kur tumori vlerësohet i paoperueshëm, nuk kanë gjithmonë rezultate. Ende është një koncept kontravers mes mjekëve.

Fjalët kyç: tumor beninj, metastazë, meningioma, adenoma pleomorfe e gjendrave salivare, osteoklastoma, prognozë, etiologjia, epidemiologjia, pamje histologjike etj

NDRYSHIMET PATOLOGJIKE ORGANORE NË PACIENTËT E PREKUR ME COVID-19

Bjorn Eski[1], Blerina Vidhishta[1], Sadet Zala[1], Fabjola Kamberi[1], Anxhela Laze[1], Kevin Zykaj[1], Dr. Sci. Leart Berdica[2]

Abstrakt

Hyrja: SARS-CoV-2 u identifikua në fund të vitit 2019 në Wuhan, Kinë. Ky virus u përhap me shpejtësi në mbarë botën duke shkaktuar të ashtuquajturën sëmundjen e koronavirusit që shoqërohet me simptoma minimale duke vazhduar me pneumoni apo sindromin e rëndë akut respirator e deri në vdekje. Ekzaminimi post-mortem dhe shpesh herë metodat imunohistokimike, na ofrojnë një informacion thelbësor në të kuptuarit e natyrës së dëmtimeve dhe në përcaktimin e skemave të mjekimit të pacientëve, sidomos të atyre në gjendje të rëndë. Ky raport i shkurtër përshkruan tiparet e autopsive (karakteristikat makro- dhe mikroskopike) të pacientëve të prekur nga COVID-19 përgjatë pandemisë.

Metodat: U krye një kërkim sistematik i literaturës anglosaksone dhe një rishikim i studimeve të mbledhura në mënyrë elektronike nga fillimi i bazës së të dhënave deri në dhjetor 2021. Termat e kërkimit ishin: "Covid-19", "SARS-CoV-2", "Autopsi". Procesi i mbledhjes së të dhënave përfshinte përzgjedhjen e studimeve dhe nxjerrjen e të dhënave.

Rezultatet: Sëmundja e koronavirusit është sëmundje karakteristike e traktit të poshtëm respirator. Tipari kryesor histologjik i zbuluar në mushkëri është dëmtimi difuz alveolar me formimin e membranës hialinike, trashje të mureve alveolare, intersticium me infiltrate limfocitare, hiperplazi të pneumociteve të tipit 2 dhe me mbushje të hapësirës alveolare me eksudat. Gjithashtu janë zbuluar tromboza të venave të thella dhe emboli pulmonare të shpeshta. Përpos sistemit respirator që përbën targetin kryesor të infektimit me COVID, infeksioni mund të shprehet edhe me shenja që përfshijnë disfunksion të veshkave, të sistemit kardiovaskular, gastro-intestinal etj.

Fjalët kyç: patologji, covid-19, pacientë.

MATASTAZAT JATROGJENIKE

Fiorela Mulellari, Kejda Ymeri, Luena Seferasi, Sara Selgjekaj, Sibora Lohja, Uarda Kraja
Fakulteti i Mjekësisë

Abstrakt

Një masë jonormale indi e cila formohet kur qelizat e saj fillojnë (për shkaqe jo të cituara këtu)të ndryshojnë dhe rriten jo normalisht. Përhapja e këtyre qelizave nga 1 vend (vatër mëmë) në 1 vend tjetër apo shkëputja e tyre nga tumori primar quhet metastazim. Implantimi i këtij malinjiteti/eksfoliacioni qelizor, i cili ndodh si gjatë procesit diagnostifikues dhe atij trajtues quhet metastazimjatrogjenik.

Qëllimi: 1.Pavarsisht informacionit mbi mekanizmat implantues të metastazës,teknikave preventuese apo incidencës për fatalitet (në këtë lloj metastazimi) mbetet një boshllëk mbi njohjen që kemi ne për të përcaktuar se cilët do të jenë guideline-et që do ndiqen dhe sa do të ndikoj individualiteti i pacientit në të. 2.Një tjetër argument është se pse njëra teknike diagnostifikuese ka risk më të lartë se tjetra dhe a ndikon zhvillimi normal i historisë së sëmundjes apo flasim për një paradoks ku vetë trajtimi bëhet shkak i sëmundjes. Detyra jonë është që bazuar në raportet e rasteve të marra të kuptojmë rëndësinë e pranisë së këtij fenomeni dhe sfidës së të ardhmes kur vetë trajtimi na sjell risqe por në të njëjtën kohë është dhe zgjidhja e vetme jetë shpëtuese.

Metodat: Këtu kemi përdorur disa studime të bazuara ato vetë në raste report, studime kohort, studime eksperimentale, rishikime të vet literaturës së studimeve.

Rezultatet:Këto rishikime të literatures na treguan se revolucionet terapeutike ndodhin kur zhvillohet kriza dhe kuptohet se intervimet klinike nuk po prodhojnë rezultate pozitive. Trajtojmë pacientin në tërësinë e tij dhe i themi po diversitetit të rrugës terapeutike që do të ndiqet pa arritur në përfundime përgjithsuese dhe detyruese.

Përfundime: Bazuar në studimet dhe incidencat e paraqitura në lidhje me metastazimin jatrogjenik arrijmë në përfundimin se ky i fundit ka qenë dhe vazhdon të jetë i pranishëm në praktikën tonë si mjeke ku tentativa për trajtim të sëmundjes mund të na cojë në përkeqësimin e mëtejshëm të gjëndjes së pacientit nëpërmjet shfaqjes së metastazave jatrogjenike që mund të cojnë deri në fatalitet. Është e rëndësishme të kuptojmë që me përparimin e shkencës dhe teknologjisë mundësitë për të parandaluar fenomene të tilla metastazike sa vijnë dhe shtohen, duke filluar që nga ndërgjegjësimi në lidhje me kujdesin që duhet të tregohet në përdorimin e instumentave ekzaminuese si dhe kirurgjikale në sitet tumorale. Gjithashtu vlen për t'u përmendur ndikimi që ka individualiteti i pacientit në trajtimin dhe sëmundshmërinë e tij qoftë dhe nga metastazimi jatrogjenik

Fjalë kyç: metastaza jatrogjenike, malinjiteti, inde.

TUMOROGJENEZA VIRALE

Geri Gega, Kendi Haskaj, Meri Suta, Patris Gjoka, Sindi Cahani
Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë Tiranë

Abstrakt

Metodat: Zhvillimi i punës kërkimore duke shqyrtuar artikuj shkencorë mbi tumorogjenezën virale dhe onkoviruset, si dhe paraqitja e përpunuar e gjetjeve të tyre.

Rezultatet: Tumorogjeneza është një proces gjatë të cilit ngjarjet gjenetike dhe epigjenetike përcaktojnë transformimin nga një gjendje qelizore normale në atë malinje.
Sipas të dhënave të OBSH, kanceri është shkaku kryesor i vdekjeve në mbarë botën, duke llogaritur rreth 10 milionë vdekje në vitin 2020, ose gati një në gjashtë vdekje. Përafërsisht

12% e rasteve të diagnostikuara me kancer në 2018, në nivel global i atribuohen infeksioneve kancerogjene, duke përfshirë papillomavirusin njerëzor (HPV), virusin e hepatitit B & C, virusin Epstein-Barr, herpesvirusin e lidhur me sarkomën Kaposi dhe papillomavirusin e qelizave Merkel.
Një numër i madh i popullsisë botërore mbart të paktën një nga këto viruse kancerogjene, të quajtura gjithashtu onkoviruse, por vetëm një pjesë e vogël e këtyre individëve zhvillojnë kancer. Onkoviruset, si parazitë intraqelizorë targetojnë gjenomën humane duke ndikuar në aktivizimin e onkogjenëve apo inhibimin e gjeneve supresore tumorale, rezultati i së cilës lidhet drejtpërsëdrejti me shfaqjet tumorale.
Në këtë punim synojmë të përshkruajmë:
1) Lidhjen që ekziston mes viruseve dhe tumoreve dhe rolin e viruseve në etiologjinë tumorale
2) Rastet e para të raportuara ku një virus ka qenë shkaktari kryesor i formës tumorale
3) Incidencat dhe prevalencat përkatëse
4) Diagnozën e formave të tumoreve në fjalë
5) Hipoteza lidhur me rolin e SARS-CoV-2 në shfaqje të mundshme tumorale bazuar në artikuj apo konkluzione shkencore

Konkluzionet: Onkoviruset jo vetëm që përfaqësojnë agjentë etiologjikë për shumë tumore njerëzore, por kanë shërbyer gjithashtu si mjete për të zbuluar mekanizmat që përfshihen në të gjitha tumoret malinje njerëzore.

Fjalë kyç: tumorogjeneza virale, onkoviruset.

PLAZMOCITOMA EKSTRAMEDULARE E GJUHËS.

Leart Berdica[1,2], Teona Bushati[1,2], Alfred Aga[2], Emirjona Vajushi[2], Erion Sukaj[2], Albina Ndoja[1]
[1]Fakulteti i Mjekësisë i UMT,
[2]Spitali Amerikan.

Abstrakt

Hyrje: Plazmocitoma ekstramedulare e gjuhës është një patologji shumë e rrallë. Pavarësisht nga rastet e rralla, plazmocitoma ekstramedulare duhet të konsiderohet si një diagnozë diferenciale në rast të një mase në gjuhë. Gjithsej 19 raste janë raportuar me PMM në literaturën angleze së bashku me rastin që do të trajtojmë. Karakterizohet nga një proliferim neoplazik monoklonal i qelizave plazmatike në mungesë të mielomës multiple (MM). Histopatologjia dhe imunohistokimia është shumë e rëndësishme për diagnozën dhe diagnozën diferenciale.

Paraqitja e rastit: Rasti që do të përshkruajmë është një zonjë 80 vjeçare nga Shqipëria e cila paraqitet me një lezion vegjetativ në formën e një pllake të trashë në pjesën dorsale të gjuhës me përmasa 6 x 5 x 1.5 cm. Nga lezioni është marrë një material me diametër 0.5 cm për biopsi. Pas ekzaminimit histopatologjik, ekzaminimeve imunohistokimike dhe pas korrelacioneve me të dhënat laboratorike, klinike dhe imazherike, u arrit në diagnozën e plazmocitomës ekstramedulare të gjuhës. Pacienti iu nënshtrua terapisë me radioterapi.

Përfundime: EMP është një tumor i rrallë, që përbën 3% të neoplazmave plazmoqelizore dhe <1% të të gjithë tumoreve të kokës dhe qafës. Diagnoza e EMP në këtë rast u arrit me biopsi, imunohistokimi dhe korrelacioni me të dhënat laboratorike dhe imazherike. Do të

tregojmë rëndësinë e biopsisë së bashku me imunohistokiminë në diagnostikimin dhe diagnozën diferenciale të plazmocitomës ekstramedulare të gjuhës.

Fjalë kyç: plazmacitoma, imunohistokimi, biopsi, plazmoqeliza.

MENAXHIMI INFERMIEROR NË INFEKSIONET NOSOKOMIALE

Ledi Necaj[1], Elsa Hallidri

Abstrakt

Infeksionet nosokomiale (intra spitalore) janë quajtur ato infeksione të cilat nuk kanë qenë prezente në kohën kur pacienti është hospitalizuar por janë shfaqur pas hospitalizimit.
Qëllimi I studimit është të hetojë në lidhje me njohuritë, sjelljet dhe praktikat infermierore për parandalimin dhe menaxhimin e infeksioneve nosokomiale në QSUT.
Infermierët janë pjesë e kujdesit shëndetësor që luajnë rol të rëndësishëm në kontrollin e infeksioneve nosokomiale. Stafi mjekësor duhet të ketë nivel të përshtatshëm të perfomancës lidhur me infeksionet spitalore.

Fjalët kyç: infeksione spitalore, kujdes infermieror, mikroorganizma, higjena, dezifektimi, sterilizimi.

PËRCAKTORËT PSIKOLOGJIK TANI KONSIDEROHEN FAKTORË TË RËNDËSISHËM NË PACIENTËT E SËMUNDJEVE TË ZEMRËS

Ledi Neçaj[1], Rozana Dore[2], Ervin Marku[1], Zamir Damani[1]
[1]Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti Mjekësor i Tiranës
[2]Shërbimi i djegieve-plastikës, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Përcaktuesit psikologjikë konsiderohen kohët e fundit si ndër faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në shëndetin në përgjithësi dhe në rrugët kardio-metabolike në veçanti. Në të vërtetë, përgjigjet biologjike, njohëse dhe psikologjike ndaj stresit kronik mund të luajnë një rol në sëmundjet e zemrës si një faktor nxitës ose i pavarur që ndikon në rezultatet kardiake. Tani ka prova të konsiderueshme të forta shkencore në mbështetje të kësaj hipoteze. Tani është koha për të marrë parasysh këtë ndërveprim të mundshëm psikobiologjik. Në këtë kontekst, gjatë rehabilitimit kardiak, duhet të përpiqet të menaxhojë çrregullimet psikologjike te pacientët që vuajnë nga sëmundjet e zemrës për të reduktuar efektet negative të stresit. Studime të mëtejshme do të duhet të kryhen për të vëzhguar ndikimin e terapisë psikologjike në përgjithësi dhe terapive të tjera të sakta si ushqimi specifik gjenomik në rezultatet e mundshme kardiake në pacientët që vuajnë nga sëmundjet kardiake. Çrregullimet emocionale dhe ngjarjet kardiovaskulare ndajnë një epidemiologji standarde dhe një korrelacion të fortë, duke sugjeruar kështu rrugët themelore biologjike që lidhin këto sëmundje të ndryshme. Ka prova në rritje që nxjerrin në pah ndikimin e faktorëve psikologjikë në sëmundjet somatike. Aspektet e statusit socio-ekonomik, sjellja shëndetësore dhe tiparet e personalitetit, madje edhe rrugët biologjike mund të kontribuojnë në rrjedhën e

çrregullimit. Ngjarjet kardiake ndodhin papritur dhe episodet janë shpesh traumatike për njerëzit që nuk janë të përgatitur për të trajtuar ngjarje të tilla. Autorët trajtojnë çështjen e mekanizmave psikobiologjikë të stresit, gjatë një qasjeje patofiziologjike ndaj rrugëve themelore që lidhin trurin me zorrët. Argumente janë paraqitur nga perspektiva të ndryshme psikologjike, biologjike dhe gjenetike në mbështetje të hipotezës se mekanizma të ndryshëm etiologjikë gjithashtu mund të përfshihen.Në të vërtetë, në këtë kontekst, rehabilitimi kardiak me qasjen e tij globale, duket se është i gatshëm të diagnostikojë çrregullime emocionale si ankthi dhe depresioni, dhe të ndihmojë njerëzit të përballen me ngjarje stresuese.

Fjalë kyç: Rehabilitimi kardiak, Stresi kronik, Ankthi, Çrregullimi, Depresioni.

OSTOTOMIA E FIBULËS PROKSIMALE SI NJË TRAJTIM ALTERNATIV NDAJ OSTEOARTTRITIT MEDIAL TE GJURIT

L.Fezollari, A.Gega, G.Biba, prof V.Ruci, F.Vellku, R.Nela, A.Kristo, MD E.Selmani

Abstrakt

Osteotomia e fibulës është një teknikë e përdorur vitet e fundit, si një trajtim me kosto të ulët, minivaziv, rehabilitim i shpejtë.

Në literaturën botërore ka pak studime për këtë teknikë. Janë vënë re rezultate të hershme 12 muaj pas ndërhyrjes ka përmirësim të dhimbjes së kyçeve, ekuilibër të hapësirës artikulare mediale me atë anësore, përmirësim të ecjes.Teoria mbi të cilën bazohet teknika në fizikë.

Mbi moshën 55 vjeçare vihet re një kolaps i zonës kockore spongjioze të pllajës tibiale, i shprehur medialisht, sepse në kondilin anësor të tibisë fibula qëndron si një suport kortikal pa kolaps.

Në rastin e gjurit varus, kur kryhet osteotomia e fibulës, forca e reaksionit zvogëlohet, për pasojë forcat mediale balancohen me ato anësore në pllajën tibiale.

Tek individët e shëndetshëm, transmetimi i peshës nga kondili femoral në tibi është i barabartë në të dy kondilet. Në rast të osteoporozës, kocka subkondrale e tibisë dobësohet. Mbështetja e fibulës mbi kondilin anësor ndihmon tibinë e kondilit lateral të transmetojë peshë, por tibia e kondilit medial nuk ka një mbështetje të tillë, gjë që çon në vendosje jo uniforme. Mbështetja anësore e fibulës në pllajën tibiale konsiderohet si faktori vendimtar që çon në vendbanimi jo uniform. Rezulton në një zhvendosje mediale të boshtit mekanik, që rezulton në deformim varus dhe degjenerim të nyjës së gjurit.

Një osteotomi e fibulës proksimale dobëson mbështetjen fibulare anësore, dhe për këtë arsye sforcimet zhvendosen nga kompartimenti medial në ndarjen posterolaterale të gjurit

Teknika kirurgjikale konsiston në ostotomi të fibulës 6-10 cm nga koka fibulare, me qasje posterolaterale që kujdeset për nervin peroneal. Rehabilitimi fillon menjëherë, me mbajtje të pjesshme të peshës.

Për shkak të mungesës së provave të plota në literaturë, nevojiten më shumë studime dhe meta-analiza për të standardizuar teknikën novatore, që do të rekomandohet për përdorim klinik rutinë.

Literatura aktuale është e kufizuar në seri rastesh të vogla dhe raporton rezultate të mira me dhimbje duke përfshirë korrigjimin e deformimit të varusit në medial OA. Kërkohen studime të mëtejshme për të vendosur vendin e PFO-së në algoritmin e menaxhimit të OA ndarëse mediale përpara se të rekomandohet për përdorim klinik rutinë.

Fjalë kyç : Osteotomia e fibulës , dhimbje , osteoporoza.

PROTEZA TOTALE REVERSE E SUPIT, NJË CASE REPORT NË SHQIPËRI

L.Fezollari, T.Alia, A.Gega, G.Biba

Abstrakt

Pacienti mashkull 70-vjeçar bie nga biçikleta dhe i nënshtrohet një frakture të komunitive të qafës së humerusit.
Shtrohet në spital dhe pas një analize të detajuar të frakturës me skaner 3D dhe konsultimit me kirurgun ortoped te supit që bën veçanërisht kirurgjinë e shpatullave, rekomandohet artroplastika e reverse e shpatullave.

Prezantimi: Artroplastia e kundërt e shpatullave është një lloj artroplastie e shpatullave që përdor një top hemisferik glenoid konveks dhe një kupë artikuluese konkave të humerusit për të rindërtuar artikulacionin glenohumeral.
Artroplastika e kundërt e shpatullave konsiderohet të jetë një nga përparimet më të rëndësishme teknologjike në kirurgjinë rikonstruktive të shpatullave gjatë 30 viteve të fundit. Është në gjendje të zvogëlojë me sukses dhimbjen dhe të përmirësojë funksionin për pacientët me dëmtim masiv të manshetës rrotulluese ose fraktura komunitive proksimale të humerit.

Rehabilitimi:
1.Rehabilitimi i menjëhershëm
Pacienti vendoset në suport supi pas operacionit
2.Rehabilitimi i hershëm**.**
Lëvizje pasive ose me asistencë aktive vetëm gjatë rehabilitimit të hershëm
3.Rehabilitimi post 3 javë
Suporti supit ndërpritet pas 3 javë nëse subscapularis NUK riparohet dhe 6 javë nëse subscapularis riparohet
-Kufizoni rotacionin ekstern pasive ose rotacionin intern aktive gjatë kësaj kohe
-Shmangni shtyrjen nga karrigia gjatë rehabilitimit akut
Shenim:Ri-këputja e subscapularis do të çonte në paqëndrueshmëri të përparme të shpatullës, trajtimi i të cilës është eksplorimi dhe riparimi i hershëm.

Shumica e pacientëve e ngrenë supin lart pas 6 javësh nga operacioni.
Ushtrimet më rezistence progressive vazhdohen pas 12 javësh. Rezultati final arrihet ndërmjet periudhës 6-12 muaj pas operacionit.

Fjalë kyç: proteza reverse, rehabilitim.

ROLI I HISTEROSKOPISË NË DIAGNOSTIKIMIN DHE TRAJTIMIN E PATOLOGJISË SË MITRËS.

Ledja Toro
Departmenti i Gjinekologjisë, Spitali Salus, Tiranë.

Abstrakt
Histeroskopia është bërë zgjidhja e parë për pacientët me dyshime për lezione intrauterine. Diagnoza dhe trajtimi histeroskopik është i thjeshtë, kryhet në një seancë, i pranuar mirë nga pacienti, ka një profil të ulët rreziku dhe është një qasje me kosto efikase. Vizualizimi i drejtpërdrejtë in vivo, në kohë reale, me ngjyrë reale, i hidratuar, i ndriçuar mirë i zgavrës së mitrës, e bëjnë këtë mjet diagnostikues shumë të saktë për të zbuluar patologjinë fokale endometriale dhe lezione të vogla përndryshe të pamundura. Ky studim trajton vlerat e histeroskopisë në saktësinë diagnostike dhe efektivitetin e saj në qasjen terapeutike me një ndalesë. Ky është një studim prospektiv i pacientëve të shtruar në ambulatorin e Gjinekologjisë të Spitalit Salus, Tiranë nga prilli 2018-shkurt 2020 për një qasje diagnostike dhe terapeutike me një ndalesë. Përzgjedhja e pacientit është bërë në ultratinguj transvaginal ose në patologji klinike. Mosha mesatare ishte 48 vjet. Shumica e tyre u paraqitën me gjetje me ultratinguj. Gjetjet histeroskopike pas vlerësimit histeroskopik u ndanë në dy grupe: 1. Lezionet e zgavrës së mitrës-(mioma, polipe, hiperplazi endometriale, sinekia, septum, etj.), 2. Karakterizimi endometrial (endometri i hollë ose atrofik, endometriti, karcinoma etj.).

Konkluzioni: Ne arritëm në përfundimin se kryerja ambulatore e vizualizimit të drejtpërdrejtë të zgavrës së mitrës me histeroskopi, garanton një saktësi të lartë diagnostike, duke lejuar kryerjen e biopsive dhe trajtimin kirurgjik të lezioneve të vizualizuara.

Diskutim: Ekografia transvaginale është një metodë e vlefshme për të identifikuar gratë në rrezik për sëmundje endometriale, por vlera e saj është e kufizuar në karakterizimin endometrial. Gjithashtu nuk arrin të diferencojë anomalitë intrauterine (mioma, polipe etj) duke pasur një ndjeshmëri të ulët diagnostikuese që varion nga 76% në 96%. Ajo lidhet gjithashtu me pozicionin e mitrës, lezionet e miometrisë, zgjidhjen e teknologjisë së imazherisë, kohën e periudhës menstruale ose statusin e menopauzës. Ekzaminimi histeroskopik mund të parashikojë lezione endometriale me një saktësi të mirë si dhe karakterizimin e aspektit endometrial duke e bërë më të lehtë korrelacionin midis gjetjeve histeroskopike dhe rezultateve histopatologjike.

Fjalë kyç: histeroskopi, patologjitë e mitrës, lezion.

NJOHURITË E STUDENTËVE TË ALBANIAN UNIVERSITY MBI PARANDALIMIN E COVID-19

Dr. Liljana Loci[1], Migena Neli[2]
[1]*Iranian Polyclinic, Tirana*
[2]*Albanian University, Tirana*

Abstrakt

Hyrje: Pandemia e COVID-19 është një problem global i shëndetit publik me ndikim shëndetësor dhe ekonomik. Të rinjtë, veçanërisht studentët e universitetit, janë në rrezik për t'u infektuar me COVID-19 dhe për t'ua transmetuar infeksionin të tjerëve për shkak informacioneve të gabuara, të ndjenjës së tyre të paprekshmërisë dhe rezistencës ndaj vaksinave. Megjithëse shumë vaksina kundër Covid 19 janë autorizuar për përdorim, hezitimi ndaj vaksinave luan një rol kyç në përhapjen e pandemisë COVID-19.

Qëllimi: Të vlerësohen njohuritë e studentëve të Albanian University lidhur me Covid 19 për të hartuar ndërhyrje parandaluese

Metodologjia: Kemi kryer një anketë online për të vlerësuar njohuritë e studentëve të Albania University lidhur me Covid 19

Rezultate: Studimi zbuloi se studentët kanë perceptim të ulët të ashpërsisë së Covid 19 dhe perceptim të ulët të rrezikut personal për t'u infektuar me COVID-19. Studentët e universitetit ishin të sigurt se ishin më pak në rrezik për t'u infektuar nga COVID-19. Shumica e studentëve mendonin se për shkak të moshës së tyre, ata nuk përbënin rrezik për të infektuar të tjerët. Ndër faktorët që ndikojnë në hezitimin për kryerjen e vaksinës, ishin faktorët specifikë të lidhur me vaksinën si psh vaksina është e re dhe kërkon kohë për të përcaktuar efektet anësore".

Përfundime: Rritja e ndërgjegjësimit të studentëve dhe kufizimi i dezinformatave rreth vaksinave është i nevojshëm për t'i dhënë fund pandemisë së Covid 19. Fushatat e IEC dhe strategji të tjera për të trajtuar hezitimin ndaj vaksinave janë të nevojshme për të nxitur marrjen e vaksinave COVID-19, për të promovuar pranueshmërinë e vaksinës COVID-19 duke rritur besimin në efikasitetin dhe sigurinë e vaksinave.

Fjalë kyç: njohuri, studentë universitar, vaksinë, Covid 19, pandemic.

TRAJTIMI FIZIOTERAPEUTIK I TORTICOLLIS

Dr. LinditaVata
Reparti i Fizioterapisë Pediatrike Q.S.U. "Nënë Tereza" Tiranë.

Abstrakt

Prezantimi: Torticollis (Latinisht: tortus – përdredhje et collum – qafë) , torticollis është një patologji në të cilën koka e pacientit është e anuar në njërën anë dhe e kufizuar në lëvizje (ulje të ROM-it artikular). Torticollis mund të jetë kongenital ose i fituar.

Etiologjia: Subluksacioni rotator atlanto – aksial është spostim rotator i vertebrave cervikale C1-C2. Afro gjysma e ROM-it të qafës kryhet nga rotacioni i C2-C1. Kjo formë e Torticollis shfaqet më shpesh pas traumave të lehta ose të rënda dhe rrallë nga infeksione të indeve të buta të qafës ose rrugëve të sipërme respiratore. Fëmijët e moshës 2 – 12 vjeç preken më shpesh nga kjo patologji pasi kanë elasticitet ligamentar më të shprehur.

Shenjat dhe Simptomat: Inspeksioni: Animi i kokës lateralisht nga ana e prekur është konstatimi i parë. Tek këta fëmijë vërehet dhe zhvillim asimetrik kranio – facial, skoliozë

kompensatore kryesisht në nivel Torakal si dhe në disa raste të rënda dhe Plagiocefali apo asimetri e kafkës.
Palpacioni: me anë të palpacionit vlerësojmë konsistencën e muskulit, gjatësinë dhe trajektoren e tij.

Diagnostikimi: Diagnostikimi i Torticollis bazohet kryesisht në ekzaminimin klinik të pacientit. Në inspeksionin dhe palpacionin e muskulit të prekur. Mjetet e tjera diagnostikuese imazherike apo laboratorike si radiografia cervikale CT (skaner) apo MRI. Rezonanca magnetike është ekzaminimi gold standart për vlerësimin e patologjive të vertebrave cervikale. Gjithashtu dhe (NCV – nerve condition velocity apo NCS – nerve condition study) janë aparatura ndihmëse në ekzaminimin e funksionit neural apo transmetimeve të impulseve elektrike neurale.

Trajtimi: Fillohet me masazh të butë, drejtohen gistat e mëdhenj të dorës të cilët lëvizin përgjatë muskulit sternocleidomastoideus (anës së prekur) dhe me butësi ushtrojmë presion lehtësisht në pikat e cakuara përgjatë këtij muskuli. Gama e lëvizjes pasive. Vlerësohet rrotacioni i kokës dhe amplituda e lëvizjes së qafës. Rrotullimi (mjekërr – shpatull). Vendoset dora në shpatullën e fëmijës, kapet koka e fëmijës me dorën tjetër. Ngadalë kthehet koka e fëmijës duke mbështetur mjekrën. Mbahet fëmija në këtë pozicion për 10 – 15 sek. Gradualisht e rrisim kohëzgjatjen si dhe amplitudën e lëvizjes paralelisht me nivelin e tolerancës së fëmijës.

Fjalët kyc: Torticolis, subluksacion, ROM, rotacion, asimetri, plagiocefali, ekzaminim klinik, CT, MRI, NCV, NCS, amplituda e lëvizjes.

KONSIDERATA EPIDEMIOLOGJIKE E DIAGNOSTIKE TË ANEMISË FERRO-DEFICITARE NË FËMIJËT.

Dr.Lorena Sila, Prof.Dr.Anila Godo, Prof.Dr.Eleni Nastas, Dr.Shk.Mirela Xhafa, Prof.As.Dr. Donjeta Bali, Dr.Mirzana Kapllani, Prof.As.Dr.Manika Kreka.
Q.S.U. "Nënë Teresa", Tirane. Departamenti i Pediatrise. Sherbimi i Onko – Hematologjise.

Abstrakt

Qëllimi: Synimi i këtij hetimi, pas vënies në dukje të karakteristikëve socio-demografike të rasteve në studim, ka qenë: vënia në dukje e shkaqeve të kësaj anemie, bazuar në të dhënat anamnestike e ato laboratorike. Hetimi i këtyre parametrave do të ndihmojë mjekun dhe pediatrin e familjes, në një diagnostikim të saktë e sa më të hershëm të AFD, në një ndjekje e terapi të përshtashme; analiza e korrelacioneve të disa alterimeve laboratorike, do të ndihmojë në qëndrim të drejtë diagnostik e terapeutik edhe në kushtet e mungesës së një akcesi laboratorik me standartin e pretenduar.

Metodika e materiali: 96 fëmijë, të moshës 4 muaj-14 vjec, të ndjekur në sektorin e konsultave të hematologjisë (70/96) të apo të shtruar fillimisht në repart (26/96), gjatë periudhës, 2017–2019 , kanë qenë objekt i këtij studimi. Në pjesën e parë të studimit është realizuar një hetim. Për pjesën e dytë të studimit, pacientët, janë grupuar në 4 grupe (A,B,C,D). Në ndihmë të diagnozës diferenciale me talasemia minor (TM), janë ndarë dhe 2 grupe të tjera (F,D). Shoqëruar edhe me analizën statistikore, janë studiuar korelacionet midis parametrave të alteruar në hemogramë (Er, Hb, Ht, MCV, RDW) dhe biokimike (Ferritinemia, sideremia, elektroforeza e Hb).

Konkluzione e Rekomandime : barra binjake, prematuranca, gabimet në ushqyerje rezultuan si situatat më të shpeshta shkaktare të AFD. Në shifra për tu konsideruar ishte dhe moskonsiderimi i AFD në adoleshencë apo në parazitoza. Korrelacioni i ngushtë, i drejtë, besnik i ferritinemisë me MCV, rezultoi mjaft në ndihmë të një diagnoze të saktë, ndjekur si pasojë nga një qëndrim terapeutik e profilaktik të përshtatshëm. Korrelacion më i dobët rezultoi në rastet me TM apo AFD+TM.

Fjalë kyç: AFD, profilaksia, menaxhimi.

PERCEPTIMET E STUDENTEVE FEMRA TË ALBANIAN UNIVERSITY RRETH KANCERIT TË QAFËS SË MITRËS

Dr. Lumturi Merkuri, Borana Salollari
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Albanian University, Tiranë.

Abstrakt

Hyrje: Kanceri i qafës së mitrës është një problem madhor i shëndetit publik, kanceri i katërt më i zakonshëm tek gratë në mbarë botën dhe një nga shkaqet kryesore të vdekshmërisë nga kanceri tek femrat. Të kesh shumë partner seksual dhe marrëdhënie të hershme seksuale janë kryesisht faktorë rreziku për kancerin e qafës së mitrës. Vaksinimi dhe depistimi për HPV janë mënyra kryesore për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës. Studime të ndryshme kanë treguar se megjithëse studentet kanë patur njohuri të mira dhe qëndrime të favorshme rreth kancerit të qafës së mitrës, sjelljet e tyre mbi depistimin ishtin të papërshtatshme.

Qëllimi: Të vlerësohen njohuritë e studenteve lidhur me kancerin e qafës së mitrës, për të hartuar ndërhyrje parandaluese

Metodologjia: Kemi kryer një anketë online për të vlerësuar perceptimet e studenteve të Albanian University lidhur me kancerin e qafës së mitrës

Rezultatet: Studimi tregoi se studentet shqiptare të universitetit kishin njohuri të pamjaftueshme për rrugët e transmetimit dhe mënyrat e parandalimit të kancerit të qafës së mitrës. Njohuritë për HPV testin dhe Pap testin ishin edhe më të pakta. Studentet kishin mungesë informacioni për ekzistencën e testit apo qendrat ku mund të bëhet Pap dhe HPV testi. Vetëm 1% e tyre kishin informacion për ekzistencën e vaksinës HPV.

Konkluzione: Studentet femra kishin njohuri të pakta dhe të pasakta për kancerin e qafës së mitrës. Duhet të zbatohen strategji të ndryshme për rritjen e ndërgjegjësimit të studentëve femra dhe kufizimin e dezinformatave në lidhje me kancerin e qafës së mitrës. Nevojiten fushata informimi, komunikimi, edukimi për të rritur ndërgjegjësimin e studentëve femra për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës. Është e rëndësishme të zgjidhen dhe përdoren një sërë kanalesh e mjetesh të përshtatshme për këtë target grup.

Fjalë kyç: kanceri i qafës së mitrës, HPV, studente universitare, perceptime, njohuri.

SHËNDETI MENDOR, PANDEMIA COVID-19 DHE NDIKIMI TE STAFI MJEKËSOR

Dr Majlinda Murati

Abstrakt

Në kushtet aktuale një krize globale të Shëndetit Publik nga Pandemia COVID-19, Punonjësit e kujdesit shëndetësor janë mjaft të ekspozuar nga një Ezaurim Fizik dhe Mendor (burnout) nga Nevoja e marrjes së Vendimeve të vështira, sic janë dhimbja nga humbja e jetës së pacientëve apo Kolegëve, rreziku i infektimit për veten dhe familjarët e tyre. Burnout është një sindromë psikologjike që përkufizohet si një gjëndje vetë-raportimi e Stresit Mendor apo Fizik, të lidhur me Aktivitetin mjekësor në Punë apo Kujdesin që pasohen me Ezaurim Emocional, Depersonalizim dhe një sens i ulur i Performancës personale. Kjo është një pasojë jo e pritshme, rrjedhojë e një kulture organizative të paaftë për të balancuar identitetin personal të stafit me Kontekstin organizativ dhe social të Kujdesit shëndetësor e për pasojë kompromenton dhe konsumon përpjekjet e vazhdueshme në sferën Mendore për t'u përballur me trysninë në punë.
Numri ende i lartë i rasteve të Infektimit dhe i Vdekjeve me Covid 19, si dhe Valët e mundshme në ngritje të shifrave të infektimit, rrisin natyrshëm ndërgjegjësimin për kushtet në pune mjaft sfiduese, si dhe nevojën për t'a adresuar këtë ezaurim mendor, duke kërkuar gjetjen e zgjidhjeve të mundshme. Masat që sugjerohen për të parandaluar ose minimizuar Burnout konsistojnë në 3 nivele të ndryshme, konkretisht:
1. Nivel Individual (si psh, aktivitetin fizik, diet e balancuar, rutina e një gjumi të mirë, suporti familjar, marrëdhënie sociale /shpirtërore efektive, Yoga,Lutje, diskutim /konsulta në grupe të vogla).
2. Nivel Organizativ (mjedise joparagjykuese për shkëmbim përvojash dhe këshillash, Gjithëpërfshirje në vendimmarrje, të ekipeve mbështetese multi-disiplinare psikosociale, mjedise të sigurta për tiu shmangur shpejt situatave stresuese, axhende ditore e mirë-përcaktuar, suporti shoqëror), dhe
3.Nivel Kulturor (përfshirja e stafit të kujdesit parësor në zhvillim, zbatim, testim dhe vlerësim të masave kundër burnout). Megjithë përpjekjet për heqjen e barrierave psikologjike që suportojnë përballimin e stresit të lidhur me punën, ende ka nevojë për ndryshim social kundër stigmës së shoqëruar me sëmundjet mendore.
Qëllimi është të ofrohen qasje te reja për punonjësit e vijës së parë ne Kushte Pandemie, me menyra konkrete për të promovuar shërimin për punonjësit e vijës së parë në muajt qe vijne.

Fjalë kyç: shëndeti mendor, pandemi, staf mjekësor.

EPIDEMIOLOGJIA DHE PËRDITËSIMET E SISTEMIT JETË-SHPËTUES SIPAS GUIDELINES TË ERC REANIMACIONIT 2021.

Prof. Asc. Dr. Majlinda NAÇO Md, PhD [1´2].
[1]Universiteti i Mjekësisë i Tiranës, Shqipëri.
[2] Shërbimi i Anestezisë dhe Kujdesit Intensiv në Kirurgjinë e Përgjithshme, QSUT "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt

Udhëzimet e para të ERC (Këshilli Evropian i Reanimacionit) u prezantuan në Brighton në vitin 1992. Në vitin 2000, udhëzimet ndërkombëtare u prodhuan në bashkëpunim me Komitetin Ndërkombëtar të Ndërlidhjes për Reanimim (ILCOR) që nga viti 2015 që kreu vlerësimin e provave. Nga viti 2017, ERC ka publikuar përditësime vjetore të lidhura me botimet e publikimeve të ILCOR dhe CoSTR (Consensus on Science and Treatment Recommendation).
Në prill 2020, u botuan udhëzime që mbulojnë ringjalljen në kontekstin e sëmundjes së koronavirusit 2019. Në Mars 2021 Udhëzimet ERC paraqesin një përditësim të madh mbi shkencën e ringjalljes dhe ofrojnë udhëzimet më të përditësuara të bazuara në prova për personat e thjeshtë, ofruesit e kujdesit shëndetësor dhe ata përgjegjës për politikat shëndetësore nëpër Evropë. ILCOR ekziston për të shpëtuar më shumë jetë globalisht përmes reanimimit. Udhëzimet ERC bazohen në ILCOR, CoSTR. Aty ku rekomandimet e trajtimit jepen nga ILCOR, ato janë miratuar nga ERC. Ne do të flasim për dy kapituj të këtij udhëzuesi, epidemiologjia dhe sistemi shpëtojnë jetë që mund të përmirësojnë shërbimin tonë. Epidemiologjia e Udhëzimeve të ERC 2021 jep disa prova kryesore. Incidenca vjetore e arrestit kardiak jashtë spitalit në Evropë është nga 67-170/100 000 banorë. Shkalla e CPR-së nga kalimtarët ndryshon midis dhe brenda vendeve (mesatarisht 58%, varion nga 13% në 83%). Përdorimi i defibrilatorëve të jashtëm të automatizuar (AED) mbetet i ulët në Evropë (mesatarisht 28%, varion nga 3.8% në 59%) dhe shkalla e mbijetesës në daljen nga spitali është mesatarisht 8% (0-18%). Ndërsa në spital, incidenca vjetore në Evropë është midis 1.5 dhe 2.8 për 1000 pranime në spital. Shkalla e mbijetesës në 30 ditë/dalje nga spitali varion nga 15% në 34%. Ne duhet të luftojmë për të shpëtuar më shumë jetë. Këshilli Evropian i Reanimacionit ka prodhuar këto udhëzime për Sistemet që Shpëtojnë Jetë, të cilat bazohen në Konsensusin Ndërkombëtar të 2020 mbi Shkencën e Reanimacionit Kardiopulmonar me Rekomandime

Trajtimi: Temat e mbuluara përfshijnë zinxhirin e mbijetesës, matjen e performancës së ringjalljes, mediat sociale dhe aplikacionet e telefonave inteligjentë për angazhimin e komunitetit, Dita Evropiane e Rinisjes së Zemrës, Rinisja Botërore e fushatave si: Dita Zemres, *Kids Save Lives etj*. Akademia Evropiane e Reanimacionit dhe Aleanca Globale e Reanimimit , rezultatet e paralajmërimit të hershëm, sistemet e reagimit të shpejtë dhe ekipi i urgjencës mjekësore, qendrat e arrestit kardiak dhe roli i dispeçerit. Duhet të informojmë se këto mund të bëhen përmes ndërgjegjësimit për CPR (ringjalljen kardiopulmonare) dhe defibrilimin jo vetëm për shërbimin shëndetësor, por për sa më shumë qytetarë, për të zbatuar teknologjitë duke përdorur përgjigjen e duhur në fillim të arrestit kardiak, për të mësuar të gjithë fëmijët e shkollës bëni CPR, për të rritur qendrën e arrestit kardiak dhe më në fund për të dërguar ndihmën gjatë CRP.

Fjalë kyçe*:* CPR, Arrest kardiak, Defibrilim.

ROLI I INFERMIERES SË BLLOKUT OPERATOR NË NEUROENDOSKOPI

Msc Manjola Pjetri[1], Klea Kazazi[2], Eralda Ymeraj[2], Xhulja Sulaj[2], Arilda Dedaj[2]
[1]*Infermiere në bllokun operator shërbimi neurokirurgji, QSU "Nënë Tereza" Tiranë*

Abstrakt

Qëllimi: Të evidentojë rolin e instrumentares në neuroendoskopi.

Metoda: Është një studim retrospektiv i kryer në bllokun operator të neurokirurgjisë, janë marrë në studim pacientët e trajtuar me endoskopi në vitin 2020, lloji i endoskopit të perdorur dhe menyra e sterilizimit.

Rezultatet: Neuroendoskopi përdoret në trajtimin e hidrocefalive dhe tumoreve ventrikulare, tumoret e hypofizes dhe si ndihmës në kirurgjinë mikroskopike. Janë analizuar pacientët e operuar me endoskopi në vitin 2020. Janë kryer 115 intervente (nga 1060 në total) me neuroendoskop, (ventriculocisternostomi, kirurgji hypofize, marrje biopsie). Sterilizimi i endoskopit dhe instrumentave është kryer në autoklav (tharje dhe sterilizim) dhe ruajtjes në ambjente formaldehide. Vetëm në tre raste është raportuar infection i rrugës operatore.

Konkluzione: Neuroendoskopia është një procedurë ku neurokirurgu përdor të dyja duart, prandaj roli i instrumentares në këtë manipulim është i rëndësishëm për mbarëvajtjen e operacionit. Roli i infermieres konsiston në: informimin mbi procedurën kirugjikale, përgatitjen e tavolinës operatore me instrumentat e nevojshme, përgatitjen e kujdesshme të neuroendoskopit, asistencën e vazhdueshme gjatë gjithë procedurës kirurgjikale, cmontimin, larje - tharjen, vendosjen e kujdesshme dhe dezifektimin e sigurt..
Manipulimi, instrumentimi, përdorimi dhe kujdesi për pastrimin, larjen dhe sterilizimin janë detyrë thelbësore e infermieres së bllokut operator.

Edukimi në vazhdim i infermiereve të bllokut operator është mënyra e duhur në minimizimin e komplikacioneve kirurgjikale.

Fjalë kyç: hipofizë, kujdes infermieror, hidrocefali, neuroendoskop.

RËNDËSIA E ANA DHE FLUORESHENCA CITOPLAZMIKE NË SËMUNDJET AUTOIMUNE HEPATIKE

Margarita Kurti Prifti
Departamenti i Laboratorëve, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë

Abstrakt

Hyrje: Sëmundjet autoimune të heparit janë sëmundje kronike të shkaktuara nga mekanizma autoimune. Ato shfaqen me simtoma klinike të ndryshme. Në sëmundjet autoimune të heparit vecohen tre sëmundje kryesore, hepatiti autoimun, cirozë biliare primare dhe kolangiti primar sklerotizues.
Janë të shumta rastet e hepatitit dhe të kolestazës me etiologji të panjohur për të cilët antitrupat anti nukleare (ANA) shoqërohen me antitrupa specifikë për sëmundjet e heparit si: antitrupat anti-Mitokondrial (AMA) dhe antitrupat anti-Muskuj të Lëmuar (SMA). Me interes për sëmundjet autoimune të heparit është karakteri fluoreshent i bërthamës dhe fluoreshenca citoplazmike që ne i identifikojmë kur vlerësojmë ANA. Në laboratorin tonë dhe në Evropë, përgjithësisht preferohet që përcaktimi i autoantitrupave të kryhet me teknikën e Imunofluoreshencës Indirekte (IFI).

Qëllimi i studimit: Vlerësimi i pozitivitetit të ANA dhe fluoreshencës citoplazmike. Korelacioni i pozitivitetit të fluoreshencës citoplazmike me pozitivitetin e antitrupave AMA dhe SMA.

Rezultatet: Në studim u përfshinë 218 individë. Prej tyre 136 (62.4%) ishin femra. Me diagnozë hepatit dhe kolestazë me etiologji të panjohur u dërguan 133 (61%) dhe 85 (39%) respektivisht. Mosha mesatare e tyre ishte 42.5±17.0. Ndër 218 raste, 74 (29.4%) rezultuan si ANA pozitiv dhe 120 (55%) rezultuan me fluoreshencë citoplazmike pozitiv. Për të gjithë individet, ANA ishte kërkuar e shoqëruar me AMA dhe SMA. ANA rezultoi pozitiv vetëm në 29 raste. 45 raste rezultuan ANA pozitiv dhe fluoreshencë citoplazmike pozitiv. Me interes për studim ishin 75 rastet në të cilat ANA rezultoi negativ dhe fluoreshenca citoplazmike pozitiv. Përqindja e karakterit të pikëzuar të fluoreshencës citoplazmike ishte më e lartë në ANA pozitiv sesa në ANA negativ (p=0.044). 69 (36.2%) individë nga 218 rezultuan seronegativ. Të gjithë rastet me pozitivitet të fluoreshencës citoplazmike, pavarësisht rezultatit të ANA rezultuan: 82 SMA pozitiv, 3 AMA pozitiv dhe SMA pozitiv, 35 AMA pozitiv. Bazuar në pozitivitetin e antitrupave AMA dhe SMA, karakteri citoplazmatik retikular rezultoi më i shprehur në AMA pozitiv sesa SMA pozitiv (86.8%) dhe karakteri citoplazmatik i pikëzuar rezultoi më i shprehur në SMA pozitiv sesa AMA pozitiv (64.6%).

Përfundime: Gjatë vlerësimit të ANA me IFI nëse vërehet prania e fluoreshencës në citoplazmë ose fluoreshencë perinukleare duhet përshkruar në përgjigjen e ANA. Ky pozitivitet mund të lidhet me pozitivitetin e AMA dhe SMA. Fluoreshenca citoplazmike duhet të vlerësohet dhe përshkruhet vecanërisht për individë që dyshohen për hepatit autoimun dhe cirozë biliare primare. Negativiteti i ANA nuk përjashton këto diagnoza. IFI është teknika më e përdorur për përcaktimin e antitrupave kur dyshohet për sëmundje autoimune të heparit dhe ndihmon për diagnozen e tyre.

Fjalë kyc: Antitrupa antinuklearë, antitrupa anti-Mitokondrial, antitrupa anti-Muskuj të lëmuar, Imunofluoreshencë Indirekte.

GRAVES'DISEASE, GRAVES'ORBITOPATI DHE COVID-19.

Marjeta Kermaj[1], Ina Mihaj[1], Ardita Muja[1], Sindi Bushati[1], Agron Ylli[1].
[1]*Shërbimi I Endokrinologjise, Q.S.U."Nene Tereza", Tirane.*

Abstrakt:

Fjalet kyce: Graves'disease, Graves'orbitopati, Covid-19, Sars-Cov-2, tiroide, autoimunitet.

Hyrje: Sëmundja Coronavirus-2019 (COVID-19) është asimptomatike në shumicën e rasteve, por është dhe fatale tek njerëzit e brishtë dhe të moshuar. SARS-CoV-2 shkakton demtime të ndryshme në shumë organe vitale, përfshirë dhe tiroiden, te cilat jane te pasura me receptoret e ACE2 qe bejne te mundur hyrjen e virusit ne qelizat e ketyre organeve.

Metoda:Një rishikim sistematik i kohëve të fundit analizoi shtatë raporte të pavarura të përbërë nga 1237 raste me COVID-19, të cilat zbuluan qartë praninë e disfunksionit të tiroides në një përqindje të konsiderueshme të rasteve me COVID-19. Gjëndra tiroide ka të ngjarë të mos funksionojë si pasojë e efekteve të drejtpërdrejta ose të tërthorta të SARS-CoV- 2 infeksion. Ne qelizat pritese, SARS-Cov-2 aktivizon sinjalizimin molekular, stuhinë e citokinave duke cuar ne mosfunksionim të tiroides gjate dhe pas Covid-19 Jane raportuar raste me Tiroidit subakut, Graves'disease (GD), Tiroidit Hashimoto. Siç vërehet në COVID-19, aktivizimi i citokinës është gjithashtu i implikuar në çrregullime të ndryshme të tiroides të ndërmjetësuara nga autoimuniteti, duke sugjeruar se infeksioni viral mund të luajë një rol në autoimunitetin latent ose të ri.

Rezultatet: Kohët e fundit, Mateu-Salat et al, për herë të parë, treguan se SARS-COV-2 është një nxitës për sëmundjen e Graves në rastet post-COVID-19.
Faktorët e rrezikut mjedisor, duke përfshirë viruset dhe stresin, shpesh përfshihen në sëmundjet autoimune të tiroides. Hiperaktivizimi i kushteve pro-inflamatore i ndërmjetësuar nga infeksioni SARS-CoV-2 mund të riaktivizojë sëmundjen e Graves duke shkaktuar një kaskadë imunologjike. Megjithatë, ajo mbetet e pa kuptuar plotësisht, pasi përgjigja imune e lidhur me gjendjen inflamatore është studiuar pjesërisht në sëmundjen e Graves. Megjithatë, duke pasur parasysh njohuritë në rritje për zhvillimin e çrregullimeve autoimune gjatë ose pas COVID-19, një rol i këtij infeksioni nuk mund të përjashtohet. Nje studim i kohëve te fundit, paraqiti tre raste të Graves' disease me fillim të ri që kanë ndodhur pas COVID-19, por të gjitha pa Graves'Orbitopati klinikisht të dukshme. Duke qenë GD shkaku më i shpeshtë i hipertiroidizmit dhe GO manifestimi i tij më i shpeshtë ekstratiroidal, lidhja mund të jetë shkakësore. Ne paraqesim rastin klinik te nje pacienti, mashkull 75 vjec, diagnostikuar me hipertireoze per here te pare ne teren te Graves' disease dhe ne te njejten kohe me Graves' Orbitopati forme e lehte, 1 muaj pas kalimit te Covid-19. Ai u trajtua me unimazol dhe mjekime lokale per syte. Pati ecuri shume te mire dhe eshte ne status eutiroidien me doze mbajtese te unimazolit dhe stabilitet te orbitopatise.

Konkluzion: Studimet e fundit, kujtojne qe mjekët duhet të jenë më vigjilentë për lidhjen e mundshme mes SARS-CoV-2 dhe sëmundjes GD dhe sëmundjeve të ndryshme të tiroides , duke bere një vlerësim te rregullt te funksionit të tiroides në pacientët me COVID-19. Për më tepër, epoka post-COVID është periudha ku me shumë gjasa shihet efekti i COVID-19 në tiroide.
Zbulimi i patofiziologjisë së disfunksionit të tiroides të shkaktuar nga SARS-CoV-2 mund të ndihmojë opsionet përkatëse terapeutike dhe menaxhimin e këtyre pacientëve si gjatë dhe pas COVID-19.

SINDROMI I SUPLEMENTIT TE KALCIUMIT

Marjeta Kermaj[1], Edlira Bucpepa[1], Albana Dulevic[1], Agron Ylli[1].
[1]Shërbimi i Endokrinologjise, Q.S.U."Nënë Tereza", Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Hiperkalcemia karakterizohet nga vlera të kalciumit në gjak mbi vlerat normale (8,5-10,2 mg/dl). Hiperkalcemia në varësi të nivelit mund të jetë asimtomatike ose me simptoma të sistemit muskulo-skeletik, renal, kardiovaskular, cerebral etj. Nevojat ditore për kalcium ndryshojnë në varësi të moshës dhe gjinisë. Nga ana tjeter, vitamina D luan rol kyc ne absorbimin e kalciumit nga organizmi, ndaj shumica e suplementeve të kalciumit bashkëshoqërohen me vitaminen D. Marrja e këtyre suplementëve ne menyre te pakontrolluar, con në shfaqjen e sindromit të suplementit të kalciumit, nje shkak qe ndeshet here pas here ne praktiken klinike ne stadin e komplikacioneve te parikthyeshme.

Metodologjia: Studime të ndryshme paraqesin raste pacientësh që vuajnë nga hipoparatiroidizmi pas paratiroidektomisë. Keta paciente, paraqesin sindromin e suplementit të kalciumit pas trajtimit për një kohë të gjatë dhe në dozë jo adekuate me suplemente te kalciumit dhe vitamines D. Artikuj te ndryshem, trajtojnë këtë sindrom te ndeshur edhe në njerëz të shëndetshëm pa patologji shoqëruese, por që mernin suplemente me calcium dhe vitamine D, shpeshherë pa kështillën e mjekut.

Rezultatet: Nëse individet e shëndetshëm marrin sasi te mjaftueshme kalciumi me anë të ushqimit, nuk është e nevojshme marja e suplementeve. Individet që vuajnë nga hypokalcemia dhe kanë të nevojshme marjen e suplementeve të kalciumit dhe vitaminës D, duhet të ndiqen në mënyrë të rregullt nga mjeku me matje të nivelit të kalciumit e vitaminës D në gjak. Parandalimi i shfaqjes së sindromit të suplementit të kalciumit është shumë i rëndësishmë, pasi komplikacionet mund të jenë nga më të thjeshtat deri të rrezikshme për jetën.

Konkluzion: Trajtimi i hypokalcemise me preparate kalciumi dhe vitaminë D, duhet bërë nën kontroll periodik mjekësor, ku komunikimi mjek- pacient, luan rol mjaft të rëndësishëm për të parandaluar sindromin e suplementit të kalciumit. Kjo gjë vlen për të gjithë pacientet që kanë hipokalcemi nga shkaqe të ndryshme dhe fillojne trajtimin, por edhe per personat me nivel normal kalcemie e vitamine D që fillojnë suplementet pa komunikuar me mjekun.

Fjalë kyç: Kalcium, vitamin D, suplement

LIMFOMA GASTRIKE ME QELIZA B JO HODGKIN

Dr.Marsela Shani[1], Dr Griselda Pelo[2], Dr.Jerina Todhe[3]
[1]Spitali Shëndetësor i Burgut (Spitali Universitar Nënë Tereza) Tiranë
[2]Spitali Shëndetësor i Burgut (Spitali Universitar Nënë Tereza) Tiranë
[3]Nr 1 Qendra Shëndetësore Tiranë

Abstrakt

Limfoma është një tumor malinj i indit limfoid. Indet limfoide shpërndahen në të gjithë traktin gastrointestinal; megjithatë, vetëm në traktin e sipërm aerodigjestiv dhe në ileumin terminal ai organizohet në struktura të ngjashme me ato të pranishme në organet e tjera limfoide dytësore si shpretka dhe nyjet limfatike. Në shumicën e rasteve organizimi i indit limfoid në struktura funksionale. është e panevojshme sepse kalimi intestinal është i shpejtë dhe mjedisi nuk është aq i favorshëm për mikroorganizmat. Në situata specifike kur ka prani të një inflamacioni, infeksioni ose një tumori, është e mundur që një stimul antigjenik i vazhdueshëm të favorizojë zhvillimin e indit limfoid të organizuar në të tilla një mënyrë që i ngjan indit të lidhur me mukozën, i pranishëm në vende të tjera. Në kushte normale, ky ind limfoid mund të vërehet në apendiksin cekal. Janë përshkruar tre lloje të qelizave të pranishme në indin limfoid të këtyre organeve. E para, e përbërë nga agregate të vërteta limfoide të membranës mukoze me qendra germinale, zona mantele dhe një kurorë limfocitesh periferike të quajtura limfocitet "zona margjinale". E dyta, etiketon indin limfoid të shpërndarë në të gjithë lamina propria, dhe i treti përfshin limfocitet intraepiteliale. Mund të evidentohen kushte të ndryshme që ndryshojnë strukturën normale të indit limfoid. Procese të tilla si fenomenet hiperplastike, çojnë në procese inflamatore që pasohen nga zmadhimi i indit limfoid normalisht të pranishëm. Ekzistojnë gjithashtu kushte që rrisin popullatën e limfociteve T. Këto përfshijnë disa procese imunologjike dhe infeksione të Helicobacter pylori në stomak.

Trajtimi: Në shumicën e rasteve limfoma gastrike MALT është një formë me rritje të ngadaltë (indolente) dhe mund të rekomandohet një strategji "WATCH dhe WAIT". Kjo u lejon disa pacientëve të eliminojnë terapi të tilla për shumë vite dhe madje edhe dekada në disa raste, duke eliminuar kështu përvojën e efekteve anësore të lidhura me trajtimin. Pacientët me limfomë gastrike MALT në fazën e hershme të kufizuar në stomak, mund të trajtohen vetëm me terapi antibiotike. Çrrënjosja e H. pylori me antibiotikë konsiderohet si një terapi fillestare për individët me limfomë gastrike MALT në një fazë të hershme. Ndjekja

e vazhdueshme është e nevojshme sepse limfoma gastrike MALT mund të kthehet nëse një person ri-infektohet me H. pylori.

Fjalë kyç: Limfoma gastrike, non Hodgkin.

PREVALENCA E RREGULLIMIT TË FUNKSIONIT KONJITIV, ÇRREGULLIMIT TË GJUMIT DHE SINDROMIT TË KËMBËS SË SHQETËSUAR NË PACIENTË ME STAD TË PËRPARUAR TË SRK DHE TERAPI RENALE ZËVËNDËSUESE DHE VLERËSIMI I FAKTORIT TË RRISKUT

Merita Rroji[1], Larisa Shehaj[1]

Abstrakt

Hyrje: Dëmtimi njohës (CFK) është një shkak i rëndësishëm gjithnjë e më i identifikuar i paaftësisë kronike që evidentohet në pacientët me sëmundje kronike të veshkave (SRK). Së bashku me sindromën e këmbës së shqetësuar (RLS) dhe hipersomninë, kontribuojnë në një cilësi më të ulët të jetës dhe pasqyrojnë çrregullimet metabolike në SRK. Njohja e lidhjes midis insuficiencës renale dhe këtyre çrregullimeve mund të përmisoje ecurinë e ketyre patologjive duke ndërhyrë herët ne këto mekanizma. Studimi ynë synoi të vlerësonte prevalencën e CFK, dhe crregullimeve të gjumit në pacientët me SRK stadi 4-5, hemodializë, dializës peritoneale dhe pacientëve të transplantuar si dhe vlerësimin e faktorëve të tyre të rriskut.

Metoda: Ky është një studim transversal që vlerësoi 167 pacientë që plotësuan kriteret e përfshirjes në studim. Nga këto, 39% ishin në Hemodializë, 22% në Dializë Peritoneale, 19% në Transplant dhe 20% me SRK stadi IV-V. Dëmtimi njohës në popullatën e studimit u vlerësua bazuar në testin e MOCA-së. Pacientët me rezultat global të MoCA-së 24/30 u konsideruan me dëmtim të funksionit konjiktiv...

Rezultatet: Frekuenca e CFK bazuar në klasifikimin e provës është 20% e butë, 61% e moderuar, 15% e rëndë dhe 3% shumë e rëndë. Në popullatën e studiuar, u vu re se ekziston një lidhje e rëndësishme midis CKF moshës ($p < 0.002$, HD ($p < 0.001$) dhe etiologjisë së sëmundjes bazë($p = 0.0011$). Në analizën shumë variabile u panjë lidhje pozitive të rëndësishme midis CKF me shkallën e kalcifikimit, kalciumit dhe një shoqërie të anasjelltë me nivelin e magnezit dhe hemoglobinës. Në vlerësimin e RLS u gjet se shkalla e moderuar e RLS kish lidhje me shkallën e kalcifikimit ($p = 0,033$), kalciumit ($p = 0,03$), Alp ($p = 0,041$), dhe shkalla e rëndë me nivelin Ac. Uric ($p = 0,039$). Për më tepër, u zbulua se çdo një vit në SRK apo ne TRZ shoqërohej me një rritje prej 0,397 në shkallën matëse të gjumit..

Konkluzione: Në këtë studim, ne pamë ndikimin e SRK dhe TRZ në prevalencën relativisht të lartë të CKF dhe çrregullimeve të gjumit.. Rezultatet tona treguan se biomarkuesit e kockave, pikëzimi i kalcifikimit vaskular dhe inflamacioni kontribuojnë dhe shoqërohen në mënyrë të pavarur me ndryshime longitudinale në disa fusha të funksionit njohës në pacientët me SRK duke shkuar paralelisht me patogjenezën e demencës vaskulare dhe Alzheimerit.

Fjalë kyç : funksioni konjitiv, frekuenca e CFK, terapi renale.

HIPERTENSIONI SI FAKTOR I RËNDËSISHEM RRISKU NË SËMUNDJEN RENALE KRONIKE.

Dr Merita Rroji PhD
Lektor në Universitetin e Mjekësisë Tiranë.
Nefrolog në Shërbimin e Nefrologjisë QSUNT.

Abstrakt

Sëmundja kronike e veshkave (SRK) është një nga problemet kryesore të shëndetit publik që prek miliona gra dhe burra në mbarë botën, e përcaktuar si dëmtim i vazhdueshëm i veshkave i shoqëruar nga një ulje e shkallës së filtrimit glomerular (GFR) dhe prania e albuminurisë. HTN është raportuar të ndodhë në 85% deri në 95% të pacientëve me SRK (fazat 3-5). Marrëdhënia midis HTN dhe SRK është ciklike, e identifikuar si një faktor rreziku vendimtar për zhvillimin e SRK, përparimin në fazën e fundit të sëmundjes renale (ESRD), sëmundjet kardiovaskulare (CVD) dhe vdekshmërinë. Prandaj, disa udhëzime rekomandojnë zbulimin dhe trajtimin e hershëm të HTN për të vonuar përparimin e sëmundjes dhe për të zvogëluar komplikimet e saj. Marrëdhënia e ndërsjellë e SRK dhe HTN thekson më tej rëndësinë e arritjes së kontrollit të BP dhe uljes së proteinurisë, nëse është e pranishme. Agjentët që reduktojnë proteinurinë përveç presionit të gjakut janë përgjithësisht linja e parë. Bazuar në gjetjet, udhëzimet rekomandojnë terapinë me ACE frenues ose ARB si trajtim të linjës së parë për ata me diabet ose ata që paraqesin sëmundje jodiabetike të veshkave, HTN dhe proteinuri. Të dhënat tregojnë se frenuesit ACE dhe ARB janë po aq efektivë në uljen e presionit të gjakut dhe reduktimin e proteinurisë. Megjithatë, pacientët shpesh mund të kenë nevojë për tre deri në katër agjentë antihipertensivë për të arritur qëllimet e tyre dhe për të minimizuar rrezikun e tyre për CVD dhe ESRD. Për më tepër, modifikimet e një stili jetese të shëndetshëm duhet të konsiderohen gjithmonë një komponent jetik i çdo regjimi të terapisë antihipertensive.

Fjalë kyç: sëmundja renale kronike, hipertensioni.

KRIOLIPOLIZA SI METODË PËR REDUKTIMIN E DHJAMIT DHE KONTURIMIT TE TRUPIT EFEKTET ANËSORE TË SAJ

Dr. Migena Gega PhD
Lektore, Fakulteti i Shkencave Mjekesore, UMT.

Abstrakt

Hyrje: Kriolipoliza është një teknikë jo kirurgjikale për reduktimin e dhjamit të lokalizuar. Trajtimi i dhjamit të lokalizuar nëpërmjet kriolipolizës paraqet një metode premtuese për konturimin jo kirurgjikal të trupit, me rritjen e riskut të komplikacioneve nga metoda të tjera invazive si psh liposuksioni. Në këtë temë prezantohen efikasiteti, siguria, mënyra e kryerjes së procedurës dhe efektet anësore të saj.

Metoda: Të identifikojmë studime të ndryshme klinike të cilat tregojnë për efektet e kriolipolizës dhe komplikacionet e saj.

Rezultatet: Efektet e kriolipolizës tregojnë rezultate të kënaqshme në humbjen e perimetrit në zona të caktuara dhe reduktimin e dhjamit. Nuk vihet re asnjë crregullim i nivelit të lipideve ose në funksionimin e heparit. U vunë re vetëm efekte anësore të lehta e të përkohshme si eritema në vendin e aplikimit nxirje e zonës, enjtje dhe dhimbje.

Konkluzioni: Kriolipoliza është një procedurë e sigurt dhe efikase për reduktimin e dhjamit të lokalizuar dhe konturimin e trupit duke qënë një metodë alternative kundrejt metodave të tjera invazive.

Fjalë kyç: kriolipoliza, komplikacione.

PSORIASIS VULGARIS DHE RISKU KARDIOVASKULAR

M.Vargu[1], E.Vasili[1], P.Vargu[2], S.Dedej[1]
[1]Klinika Dermato-Venereologjise
[2]Klinika e kardiologjise
Qendra Spitalore Universitare"Nënë Tereza", Tirana, Shqipëri.

Abstrakt

Hyrje: Shumë studime dhe artikuj po vënë në dukje faktin që Psoriasis Vulgaris është sëmundje inflamatore kronike, e shoqëruar me një risk të lartë për sëmundje kardiovaskulare.

Qëllimi i studimit: a)Të përcaktojmë prevalencën e sëmundjeve të arterieve koronare në pacientët me psoriasis. b)Të përcaktojmë faktorët riskantë kardiovaskulare në pacientët me psoriazë duke i krahasuar ata me grupin e kontrollit(pa psoriasis).

Të dhënat dhe metoda: Studimi në fjalë është i llojit rast –kontroll, i cili përmban gjithashtu elemente cross- sectional. Rastet e studiuara konsistojnë në një grup pacientësh me psoriazë dhe një grup kontrolli, të cilët janë individë pa psoriaze.

Rezultatet:Në grupin me psoriasis vlerat e hs-CRP dhe TNF-alfa, janë të lidhura me shkallën e PASI-t(psoriasis area and severity index). Në analizën e faktorëve të tjerë riskantë kardiovaskulare (HTA, diabet, duhanpirja, dyslipidemia), pacientët me psoriazë ishin më të riskuar , krahasuar me grupin e kontrollit me nje vlere $p<0.05$, statistikisht sinjifikante.

Konkluzioni:Në këtë studim përcaktuam që pacientët me psoriasis, janë më të riskuar për të zhvilluar sëmundje të arterieve koronare, krahasuar me individët pa psoriase. Gjithashtu, u vu re një prevalencë e lartë e faktorëve riskante kardiovaskulare, ku hs-CRP dhe alfa-TNF, rezultuan faktorë risku të pavarur.

Fjalë kyc: risku kardiovaskular, inflamacion, aterogenezë.

KANCERI DHE TRAUMA PSIKOLOGJIKE QË PËRJETON INDIVIDI DHE FAMILJARËT

Mimoza Dosti

Abstrakt

Një nga interpretimet e Traumës psikologjike është "plagë e shpirtit", diçka që thyen dhe ndërhyn në jetën e një personi duke tronditur dhe mënyrën e të perjetuarit. Ekzistojnë forma të ndryshme të eksperiencave traumatike. Në rastin e njohjes dhe diagnostifikimit me kancerin, individi dhe familjarët e tij përjetojnë një eksperience traumatike e madhe "T". Situata në të cilën ndodhet individi paraqitet e bashkëshoqëruar me një diagnozë e cila kërcënon integritetin fizik, psikologjik dhe social të personit. Njëkohësisht kjo diagnozë prek drejtpërsëdrejti në aspektin psiko-emocional dhe familjarët, të cilët bëhen njëkohësisht mbështetës të familjarit të tyre por dhe bashkëvuajtës jo në aspektin e vuajtjes fizike, por të asaj psiko-traumatike si pasojë e gjëndjes shëndetësore ku ndodhet familjari i tyre. Përjetimi i procesit traumatik duhet theksuar që është Individual dhe merr forma të ndryshme përjetimi nga persona te ndryshëm. Në bazë të përjetimit të traumës lënë gjurmë dhe pasojat e saj, të cilat mund të jenë të lehta, mesatare dhe të rënda, me shtrirje në kohë përkatesisht afatshkurtër, afatmesme, afatgjatë. Njohja dhe pranimi i kësaj diagnoze është një nga fazat më të vështira për individin. Nën efektin e traumës ndodh që individi tashmë (pacient) të mos e pranojë këtë diagnozë. Mohimi është një nga fazat e përpunimit të traumës. Kjo fazë kthehet në një problematikë serioze për pacientin, sa më e gjatë të jetë periudha e mohimit të diagnozës akoma më e vështirë bëhet marrja e trajtimit të nevojshëm për pacientin. Kjo diagnozë sjell jo vetëm problematika fizike por dhe problematika psiko-traumatik të cilat i ndryshojnë rrjedhën e jetës individit. Kjo lloj traume e çorienton individin në drejtim të të menduarit, të përjetuarit dhe të sjellurit. Ky përjetim nuk e ndihmon aspak situatën shëndetësore ku ndodhet personi. Përveç këtyre ajo çka i mundon më së shumti personat e traumatizuar nga sëmundja e kancerit është dhe pyetja "PSE"?, e cila ka të bëjë me përpunimin e ngjarjes traumatike, me mos gadishmërinë si dhe me paaftësinë e personit për ta pranuar atë që po i ndodh. Ky proçes vështirësohet si pasojë e mosintegrimit të diagnozës brenda historisë së vet. Personi në mënyrë të pavetëdishme e ngadalson këtë proçes dhe favorizon shfaqen e disa fazave të tjera si faza e stresit akut, faza e stresit post traumatik. Në situata të tilla individi tashmë pacient duhet të ndihmohet jo vetëm në drejtim te mirëqënies së shëndetit fizik por dhe në drejtim te mirqënies së shëndetit psikologjik. Në këto kushte pacientit i vijnë në ndihmë mjekët të cilët përmes protokolleve mjekësore kujdesen për shëndetin fizik të pacientit. Gjithashtu figurë e rëndesishme janë edhe psikologët, psikoterapeutët që ju ofrojnë ndihmë për të pranuar dhe përpunuar përjetimin e këtij momenti të vecantë. Kjo realizohet duke treguar përkujdesjen e tyre profesionale në mbështetjen, këshillimin individual dhe familjar. Suporti që i ofrohet këtyre personave është vetë përpunimi I traumës. Ky bashkpunim dhe kjo përkujdesje ndihmon që rrjedha e përpunimit të traumës të jetë sa më e përshtatëshme për personin. Duke qënë e tillë dhe pritshmëria për një shëndet sa më të qëndrueshem fizik dhe psikologjik do të ishte sa më e lartë. Pacienti pa konflikt psikologjik dhe në gjendje paqeje me diagnozën përcjell tek të afërmit besimin dhe shpresën për të ardhmen.

Fjalë kyç : trauma , bashkëpunimi , diagnoza , gjëndje shëndetësore

NDËRVEPRIMI I SINJALIZIMIT TË HIPOKSISË NË MOSFUNKSIONIMIN DHE INFLAMACIONIN MITOKONDRIAL NË SËMUNDJET KARDIOVASKULARE DHE KANCERIN:NGA MEKANIZMAT MOLEKULARË NË QASJET TERAPEUTIKE

Mimoza Tamizi

Abstrakt

Motivazione: Sëmundjet kardiovaskulare (CDV)dhe kanceri vazhdojnë të jenë shkaku kryesori i vdekshmërisë në mbarë botën dhe mekanizmat e tyre patologjikë, janë një proces kompleks dhe multifaktorial.

Problema: Mosfunksionimi mitokondrial prek të gjitha nivelet e trupit,dhe shpesh është faza fillestare e sëmundjes .Mitokondri jo vetem që regullon prodhimin e energjisë dhe riparimin strukturor ,por gjithashtu vendos ,bazuar në sinjalet kimike që mer, nëse qeliza duhet te vetshkatërohet,nëpërmjet apoptozes. Ky mekanizëm qëndron në themel të mbrojtjes bazë të kancerit.

Studime: Disponueshmeria e pamjaftueshme e oksigjenit (hipoksia)luan një rol kritik në patogjenezen e sëmundjeve kardiovaskulare dhe kancerit dhe faktori 1 i induktueshëm nga hipoksia (HIF-1)sensori kryesor i hipoksisë, vepron si një regullator i objektivit të shumë gjeneve në trupin e njeriut.

Rezultati: Dëshmitë e grumbulluara tregojnë se mitokondritë janë objektivi kryesor i dëmtimit hipoksik, burimi me i zakonshëm i specieve reaktive të oksigjenit gjatë hipoksisë dhe elementet kyc per rregullimin e inflamacionit gjatë zhvillimit të sëmundjeve kardiovaskulare dhe kancerit.

Konkluzioni: Vëzhgimet sygjerojnë se hipoksia,anomalitë mitokondriale,stressi oksidativ,inflamacioni në sëmundjet kardiovaskulare dhe kanceri janë të lidhura ngushtë.

Fjalë kyç: hipoksi, sëmundje kardiovaskulare, kanceri.

SHËNDETI OKULAR TEK FËMIJËT, ROLI INFERMIEROR

Mirela Tushe[1]

Abstrakt

Metodologjia dhe metodat-Metodologjia e përdorur për hartimin e kësaj teze diplome është metoda e studimit përshkrues (deskriptiv): survejim (studim) transversal. Është përdorur metodologjia e anketave ku me anë të pyetësorit nxirren të dhëna sasiore dhe cilësore nga sondazhi statistikor në një periudhë 2 javore nga data 8-22 shtator 2020.
Gjithashtu është përdorur metoda e rishikimit të literaturës shkencore bashkëkohore lidhur me rezultatet e marra.
Pyetësori u plotësua nga prindër nga stafi i Universitetit Aldent dhe prindër të fëmijëve të klinikës Uzllova Tiranë.
"Pyetësori mbi shëndetin okular për prindër me fëmijë deri në 18 vjeç" përmban 26 pyetje në total. Prindërit e interesuar kanë plotësuar pyetësorin me dëshirë të plotë dhe pa u ndikuar nga askush, kanë dhënë përgjigje me shkrim.
Në këtë pyetësor specifik për një grupmoshë nga 0-18 vjeç janë përfshirë gjithsej 100 prindër.
Formulari i pyetësorit i adresohet prindërve nga trojet shqiptare dhe jashtë saj.
Është bërë ndarje e grupmoshave nga 0 - 24 muaj, mbi 2-6 vjeç, mbi 6-18 vjeç duke marrë në konsideratë edhe ndryshimet që pëson fëmija gjatë rritjes dhe zhvillimit të tij.
Rezultatet janë nxjerrë nga përpunimi statistikor me programin SSP dhe janë shprehur në %.

Rezultatet -Nga rezultatet e marra del se nënat përbëjnë numrin më të madh të pjesëmarrjes në këtë anketim në raportin 80%:20% me baballarët. Të anketuarit nga vendi ynë përbëjnë numrin më të madh të të anketuarve në krahasim me ata jashtë trojeve shqiptare në raportin 83%:17%. Pjesa më e madhe jetojnë në qytet dhe pak në fshat në raportin 92%/8%. Më

shumë të anketuar ka patur nga Tirana 66%, Jashtë teritorit të Shqipërisë 17% dhe një numër shumë i vogël nga rrethe të tjera të Shqipërisë. Vetëm 13% e prindërve të anketuar përdorin vetë syze apo lente. Prindërit kanë plotësuar pyetësorin për fëmijët e tyre ku numri më i madh është femra 65% dhe pjesa tjetër meshkuj. Grupmosha e fëmijëve me numrin më të madh është nga mbi 2-6 vjeç:83%, mbi 6-18 vjeç: 12% dhe 0-2 vjeç: 5%. Pjesa më e madhe e fëmijve shkojnë në çerdhe 78% dhe kopësht 84% dhe një pjesë e vogël nuk shkojnë në çerdhe 22% dhe kopësht 16%. Shumica e prindërve kanë treguar se i kanë kryer kontroll të syve fëmijëve në moshën mbi 2-6 vjeç: 70%, 0-2 vjeç: 16%, 6- 18 vjeç: 13%, prindi mendon se nuk ka nevojë fëmija për kontroll të syve 1%. 76 % e prindërve kanë kontrolluar fëmijët tek mjeku specialist dhe 24% e tyre nuk kanë kryer ndonjë kontroll ndonjëherë. Ata i kanë vizituar në pjesën më të madhe para 1 viti 54%, para 6 muaj 6%, para 1 muaji 5%, para 4 vitesh 2%, mbi 6 vite 2% dhe nuk kanë kryer asnjë kontroll për fëmijën 30%. Prindërit kanë vizituar fëmijët e tyre 1 herë 54% të tyre, asnjëherë 30%, 2 herë 19%, 4 herë 6%, dhe mbi 6 herë 5%. 49% e prindërve dinë se fëmijën duhet ta vizitojnë kur vërejnë një problem apo sëmundje të syve të fëmijës, 33% kur fëmija s'ka asnjë problem, 15% kur fëmija ankohet vetë dhe 3% mendojnë që fëmija i tyre nuk ka nevojë për asnjë kontroll. Prindërit në masën 55% nuk dinë se kur duhet bërë. Prindërit marrin informacion mbi shëndetin okular nga mjeku i syve dhe stafi i specializuar në oftalmologji 80%, libra mjekësorë 10%, interneti 6%, mjeku i familjes 2% dhe vetëm 2 % nuk i intereson informacioni.

Fjalë kyç: trajtimi , rezultatet , statistika.

ANEMIA FANCONI. PREZANTIM RASTI

Mirzana Kapllanaj[1], Eleni Dervishi[2], Mirjana Lama[4], Nevila Kapllanaj[5], Donjeta Bali[1], Mirela Xhafa[1], Anila Babameto-Laku[3], Anila Godo[1].
[1]Shërbimi i Onko-Hematologjisë Pediatrike. QSUNT.
[2]Specializante Pediatri
[3]Sherbimi i Gjenetikes, QSUNT
[4]Mjeke
[5]Farmaciste.

Abstrakt

Hyrje: Anemia Fanconi është forma më e shpeshtë e anemisë aplastike në incidence 1:100.000 lindje të gjalla në vit. Transmetohet në mënyrë autosomale recesive. Paraqitet në forma të ndryshme me citopeni të një ose disa linjave me predispozit për malinjzim dhe kombinohen me anomali kongenitale multiple. Diagnoza vendoset midis moshës 3-14 vjec.

Fëmija BF 7 vjec (mosha staturale 5.3 vj), (F) vjen me diagnozë: Pancitopeni për determinim. Gjëndje febrile. Rapid test –negativ.

E lodhur, e zbehtë, astenike, staturë e vogël, palydactyly, njolla në lekurë -caffe au lait dhe hematoma, dhimbje abdominale, hepar et lien 1-2 cm nën harkun brinjor.

Qëllimi:Të prezantohemi me këtë sëmundje të rrallë nëpërmjet një rasti. Hemograma: anemi, leukopeni, trombocitopeni. (Pancitopeni). Mielograma vërehet lama të varfëra me elementë te aglutinuar. Aparati mega-kariocitar shumë i rrallë.

Konsulte Gjenetisti: Kariotipi-46 XX me thyerje komozomike. Anemia Fanconi. Hipotiroidizem subklinik. Echo kardiake ductus botalli apertum. RTg mani prezenca e folongut proximal e distal pa oss metacarpal.

Trajtimi: Mase eritrocitare, kortizonikë , vitaminoterapi Antibiotikoterapi. OBS.

Konkluzione.Kjo sëmundje me prekje multiorganore kërkon trajtim të zgjatur dhe specifik deri në transplant të palcës kurrizore. Ndaj në një fëmijë të lindur me anomali të ndryshme skeletore dhe multiorganore, ekzaminimi gjenetik dhe ndjekia multidisiplinore është e detyrueshme.

Fjalët kyç: pancitopeni, anomali multiorganore, mjekim i zgjatur transplant.

SINDROMA PASH – NJË SËMUNDJE E RRALLË DHE NJË MUNDËSI E RE TRAJTIMI

Monika Fida[1],Arbnore Tafica[1], Elda Semanjaku[1], Arjana Aliaj[2]
[1]Departamenti i Dermatologjisë, Universiteti i Mjekësisë i Tiranës, Shqipëri.
[1]QSUT "Nënë Tereza", Shërbimi Dermatologjik, Tiranë, Shqipëri.
[2]Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Fakulteti i Mjekësisë

Abstrakt

Hyrje: Sindroma PASH është një sindromë autoinflamatore e trashëguar e identifikuar kohët e fundit e përbërë nga dermatoza të shumta neutrofilike duke përfshirë pyoderma gangrenosum (PG), aknet dhe hidradenitis suppurativa (HS). Hidradeniti supurativ dhe pyoderma gangrenosum duket se ndajnë rrugë të ngjashme patogjene që përfshijnë një sistem imunitar të lindur të çrregulluar, me inflamacion neutrofilik, të ndërmjetësuar nga IL-1β, i kontrolluar nga rruga inflamazome NALP3.

Raporti i rastit: Raportojmë një rast të një pacienti mashkull 21-vjeçar i diagnostikuar me hidradenit supurativ që në moshën 18-vjeçare, akne konglobata prej më shumë se 5 vitesh dhe tashmë i paraqitur me plagë të hapura në rajonet aksilare, gluteale, abdominale dhe femorale, të cilat janë sekrecioni purulent i dhimbshëm dhe i shkarkimit. Në bazë të gjetjeve klinike dhe biopsisë së lezioneve, u vendos diagnoza e Pyoderma gangrenosum. Pacientit tonë i mungonte ndonjë episod i artritit piogjen apo sëmundjes së zorrës së irrituar, prandaj e diagnostikuam me sindromën PASH.

Sindroma PASH konsiderohet se përfaqëson një entitet të dallueshëm në grupin e sëmundjeve autoinflamatore dhe duhet të dallohet nga sindromat e tjera si PAPA (artriti piogenik, pyoderma gangrenosum dhe aknet), PsAPASH (artriti psoriatik, pyoderma gangrenosum, aknet dhe hidradeniti supurativ), PAP, (artriti piogjenik, puçrrat, gangrenosum pioderma dhe hidradeniti supurativ), PASS (gangrenoza pyoderma, aknet, spondiloartriti) ose PAC (gangrenoz pioderma, aknet dhe koliti ulceroz). Meqenëse antagonistët e TNF janë një trajtim premtues për PASH, ne vendosëm ta trajtojmë pacientin tonë me Adalimumab.

Fjalët kyç: sindroma PASH, Pyoderma Gangrenosum, Adalimumab.

FYTYRË E KUQE PËR SHKAK TË AKNEVE DHE REAKSIONEVE AKNEIFORME

Prof.As. Monika Fida, Klea Kalemi
Departamenti i Dermatologjisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë i Tiranës, Shqipëri
Universiteti i Mjekësisë i Tiranës.

Abstrakt

Hyrje: Aknet dhe reaksioni akneiform janë sëmundje që mjekët e familjes (GP) dhe dermatologu po i diagnostikojnë dhe i trajtojnë shumë shpesh gjatë praktikës së përditshme. Më së shumti vërehen tek adoleshentët por edhe tek të rriturit.

Qëllimi i prezantimit: Të tregojë disa raste klinike të diagnostikuara dhe trajtuara në Repartin Ambulator UHCT "Nënë Tereza" me njolla eritematoze në fytyrë dhe sëmundje si: puçrra neonatum, akne vulgaris, akne steroide, akne rosacea, reaksione akneike. Për të theksuar veçoritë klinike, diagnozën, dallimet dhe protokollin e trajtimeve të këtyre rasteve.

Rezultatet: Aknet, reaksionet akneike dhe akne rosacea janë me të vërtetë shpesh sëmundje dermatologjike që kanë nevojë për synimin e mjekëve të përgjithshëm dhe dermatologut në një mënyrë për t'i diferencuar ato në mënyrë korrekte dhe për t'i trajtuar këto sëmundje bazuar në protokollet e përditësuara. Diagnozat e sakta vendosen në bazë të karakteristikave klinike, por vetëm në disa raste është kryer një biopsi për të vendosur diagnozën e saktë.

Përfundim: Llojet e ndryshme të akneve dhe reaksioneve akneiforme duhet të diferencohen saktë dhe për këtë të gjithë duhet të jenë të vetëdijshëm për karakteristikat specifike klinike. Protokollet e reja të përditësuara të trajtimit janë vërtet të dobishme për trajtimin e këtyre sëmundjeve.

Fjalë kyç: Akne, reaksion akneiform, akne neonatum, puçrra steroide, akne rosacea.

NDJEKJA E PACIENTIT ME MELANOME – CFARË DUHET TË DIJË NJË DERMATOLOG DHE MJEK FAMILJE.

Monika Fida1, Ermira Vasili1, Edlira Lashi2
[1] Departamenti i Sëmundjeve Infektive dhe Dermatologji, UMT, QSUT "Nënë Teresa" Tiranë, Shqipëri.
[2] Shërbimi Ambulator Parësor, Poliklinika Nr. 1, Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt

Hyrje: Melanoma është një sëmundje malinje me incidencë që po rritet ndjeshem vitet e fundit. Incidenca në Europë llogaritet rreth 25 raste në 100,000 persona. Faktorët e riskut të

Melanomës janë të ndryshëm dhe të shumtë: predispozita familjare, ekspozimi në rrezatimin ultraviolet, djegiet në diell gjatë fëmijërisë, numri i madh i nevuseve në lëkurë, fenotipi I,II i lëkurës, trajtimi me preparate imunosupresore.

Qëllimi i Prezantimit: Të theksohet rëndësia e ndjekjes së pacientit të diagnostikuar dhe trajtuar me Melanomë. Të theksohet rëndësia e stadifikimit të patologjisë dhe ndjekjes së pacientit në bazë të stadifikimit dhe udhërrëfyesve.

Materiali dhe Metoda: Pacientë të diagnostikuar dhe trajtuar me Melanomë pranë Shërbimit të Dermatologjisë, QSUT "Nënë Teresa" Tiranë.

Konkluzione: Pacienti i diagnostikuar me Melanomë duhet të jenë nën kujdesin e vazhdueshëm gjatë gjithë jetës për shkak të riskut të rritur për Melanomë sekondare primare ose rreziku i rekurencës. Intensiteti i vizitave dhe ndjekjes është më i madh gjatë 5- 10 viteve të para pas diagnostikimit të Melanomës. Stadifikimi i Melanomës është shumë i rëndësishëm jo vetëm për alternativat e trajtimit të pacientit por dhe për ndjekjen e pacientit në kohë. Stadifikimi referon dhe për prognozën e patologjisë dhe është bazë për mjekun për të krijuar një plan ndjekje të pacientit bazuar në udhërrëfyesit dhe për të shmangur ekzaminimet laboratorike dhe radiologjike të panevojshme. Këto ekzaminime kanë jo vetëm efekt financiar për pacientin dhe sistemin shëndetësor por dhe efekt psikologjik tek pacienti.

Fjalë kyç: Melanoma, protokolle të ndjekjes, stadifikim.

KUJDESI INFERMIEROR TE PACIENTËT ME KANCER GJIRI (RAPORT CASE)

MSc.Muhamet Kadrija, MSc.Erald Cocka, Msc.Argjiro Alija, MSc.Sabrije Kelmendi Bardhaj
Universiteti "Fehmi Agani" i Gjakovës.
KSHI-Kerkime Shkencore ne Infermieri

Abstrakt

Hyrja dhe qëllimi: Kanceri i gjirit është një nga shkaktarët e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë në vendin tonë. Kanceri i gjirit është një tumor që zhvillohet nga vetë qelizat e gjirit dhe paraqet një ndër ndërlikimet më të shpeshta tek gjinia femerore, dhe diku afër 2% edhe te gjinia mashkullore. Rritja e qelizave në mënyrë të pa kontrolluara duke përfshirë dhe indet e gjirit, e zhvilluar në mënyrë latente shpesh herë duke kaluar fazën e parë dhe të dytë pa simptoma krijon një problem në diagnostikimin e hershëm dhe në trajtimin e duhur dhe në kohë.Pavarësisht zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë, prapë sëmundja e kancerit të gjirit është një nga rastet me të shpeshta që haset tek pacientë. Mungesa e edukimit shëndetësor, depistimi i vonuar bëjnë që shpesh kjo sëmundje të zbulohet në stadet kur jep edhe metastaza, dhe kurimi bëhet dhe më i vështirë. Infermierët, kanë një rol thelbësor në kujdesin ndaj pacientëve me kancer të gjirit, si dhe në edukimin e pacientëve me rrezik potencial për kancer të gjirit. Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë nivelin e kujdesit dhe praktikat infermierore te të sëmurët me kancer të gjirit në qytetin e Gjakovës.
Metodologjia: Ky është një studim rasti, i realizuar gjatë periudhës kohore Janar 2022. Pacienti përcillet në detaje nga pranimi në klinik anamneza, ekzaminimi, analizat laboratorike, hulumtimet imazherike, diagnostikimi dhe trajtimi. Për këtë studim është përdorur plani i kujdesit infermieror të detajuar në pesë fazat duke filluar me vlerësimin fillestar, diagnozën infermierore, planifikimin, zbatimin dhe evoluimin infermieror.

Rezultatet: Duke u bazuar në rezultatet e studimit pacientja pranohet në Kirurgjinë Torakale ne QKUK, e vetëdijshme me ankesa lodhje, plogështi, dhimbje therëse në gjirin e majtë, dhembje të muskujve, nauze, anoreksi, ndjenjë jo e rehatshme, e shoqëruar me sëmundje sekondare si Diabet tip 1dhe HTA. Me anën e lokalizimit te akrepave të orës në pozitën e shtrirë të pacientes vërehet një formacion 'në orën 3', distanca e formacionit nga 'nipples & aureola' i është afër 7 cm, madhësia e formacionit ishte 3x1.5cm, konsistencë me intensitet mesatar, lëvizshmëria ishte mesatarisht e fiksuar. Nga ndërhyrja e varur dhe e pavarur infermierore rezultatet e ekzaminimit të pacientes ishin: Ta :170\90 mmHg, Pulsi 70\min, resp: 20 min, testet Lab glukoza : < 3 mmol\l, kolasteroli 9 mmol/l, tregliceridet 3mmol/l, se eritrociteve : 57mm/h, hemoglobina 200g/l, MCV 104 femtoliter, MCH 40 pikogram, MCHC 400g/l, Neutrofile 80%, Eozinofile 10%, Bazofile 2,5%, Limfocite 50%. Pas planit infermieror, zbatimit te planit dhe kujdesit mbi sëmundjet sekondare normalizimit të vlerave të glukozës dhe tensionit arterial, identifikimi i problemeve potenciale, që mund të ndodhin nga kundërindikimet e mundshme të terapisë për hipertension arterial, diabet miellitus,dhe kimioterapise. Pas zbatimit të planit të kujdesit kemi një përmirësim të vlerave të shenjave vitale, ashtu dhe testeve laboratorike.

Përfundimi: Në bazë të zbatimit të planit të kujdesit infermieror, dhe ndryshimeve në vlera të shenjave vitale dhe testeve laboratorike, nga data e pranimit të pacientes në klinikë dhe normalizimit të tyre në vlera referente gjatë qëndrimit në klinikë, vërtetojmë se plani ishte efikas.

Fjalë kyç: kujdes, kanceri i gjirit, infermier.

RISITË BASHKËKOHORE NË KANCERIN E STOMAKUT.

Prof.As.Myzafer Kaci, Albjona Demushi

Abstrakt

Hyrje: Kanceri i stomakut vazhdon të mbetet ndër patologjitë më të shpeshta në botë, përfshirë këtu dhe Shqipërinë. Edhe pse incidenca e tij ka rënë ndjeshëm, ai vazhdon të mbetet një problem global i kujdesit shëndetësor, shkak prevalenca e tij e lartë dhe shkalla e rritur e vdekshmërisë. Për vazhdimësinë e trajtimit, është e rëndësishme që diagnoza të vendoset në kohë, sepse zakonisht diagnostikimi ndodh me vonesë duke qenë që sëmundja nuk shfaq simptomatologji të dukshme në fazat e saj fillestare.

Qëllimi i këtij studimi është njohja me risitë bashkëkohore në diagnostikimin dhe trajtimin (kryesisht kirurgjikal) sa më efikas të kancerit të stomakut në varësi të 6 faktorëve: stadi i tumorit,tipi\histologjia e tij, lokalizimi, përhapja në nyjet limfatike, morbiditeti perioperator dhe funksioni gastro-intestinal në terma afatgjatë. Punimi ynë do të ketë në fokus kryesisht karcinomën gastrike.

Metodat: Për të realizuar qëllimin e këtij studimi, janë gjetur artikuj shkencorë përmes një pune kërkimore sistematike në website mjekësore si PubMed,Medline,bazuar edhe në regjistrat klinike të Shërbimit të Parë të Kirurgjisë QSUT, të cilët janë përzgjedhur për t'u shqyrtuar për vazhdimësinë e këtij punimi.

Rezultate\Konkluzione: Karcinomat gastrike në 90% të rasteve kanë shkaktuar primar helicobacter pylori, por përmendim dhe dietën, duhanin apo raste sporadike. Patogjeneza molekulare dhe trajtimi i karcinomës gastrike është kompleks. Terapia me trupa monoklonale ka si objekt parësor produktin e onkogjenit HER-2, kurse diagnostika po vendos gjithmonë

e më shumë theksin mbi laparoskopinë, e cila lejon dhe vizualizimin e drejtpërdrejtë dhe të sipërfaqes hepatike, peritoneumit dhe limfonodujve lokale. Madje ajo lejon dhe marrjen e citologjisë te pacientët që s'kanë shenja të dukshme të infiltrimit në peritoneum.

Fjalë kyç: Karcinoma gastrike, helicobacter pylori, trupa monoklonale, laparoskopi.

DEPRESIONI NË KOSOVË GJATË PANDEMISË COVID-19 SIPAS GJASHTË STUDIMEVE NË PERIUDHA TË NDRYSHME KOHORE.

Prof. Asoc. Dr. Naim Fanaj[1]
Dr. Sci. Sevim Mustafa[1]
[1]QSHM Prizren, Kosovë

Abstrakt

Hyrje: Pandemia e COVID-19 ka ndikuar në shëndetin duke sfiduar sistemet shëndetësore në mbarë botën në një mënyrë të paprecedentë. Një rishikim sistematik i kohëve të fundit i literaturës tregon se globalisht studimet e popullatës së përgjithshme zbulojnë përkeqësim të mirëqenies psikologjike dhe nivele më të larta për ankthin dhe depresionin në krahasim me periudhën para COVID-19. Qëllimi i këtij studimi është të paraqesë shkallët e depresionit gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë dhe të eksplorojë lidhjet e mundshme me variablat sociodemografikë.

Metoda: Është një studim krahasues. Ne shqyrtuam të dhënat e gjashtë anketimeve kros-seksionale në internet dhe një sondazhi të drejtpërdrejtë të kryer gjatë tre periudhave në 2020 dhe tri periudhave në 2021. Pjesëmarrësit ishin të anketuar online në vitin 2020 (T1 = 196, T2=1715 dhe T3 = 147) dhe në 2021 (T4=348, T5=156 dhe T6=408); ka pasur gjithashtu një anketë të drejtpërdrejtë në vitin 2021 (T4=101). Pjesëmarrësit plotësuan versionin shqip të PHQ-9. Përpunimi i të dhënave është kryer me SPSS 21.0 dhe Microsoft Excel 2007.

Rezultatet: Përkeqësimi psikologjik është raportuar në shifrat nga 53.6 % (T6) në 73.3 % (T4). Nivelet klinike të depresionit rezultuan nga 22.8 % (T4) në 57 % (T6). Këto shifra nuk janë të lidhura me numrin e rasteve të reja dhe vdekjeve nga COVID-19. Në periudhën T4 janë shënuar 6408 raste të reja / 124 vdekje ndërsa në periudhën T6 janë regjistruar 444 raste të reja / 2 vdekje. Kanë rezultuar edhe disa shoqërime/dallime sinjifikative sipas gjinisë, moshës, statusit socioekonomik.

Konkluzione: Nivele të larta klinike të depresionit kanë rezultuar por që nuk janë treguar të jenë të lidhura sinjifikativisht me përkeqësimin e kushteve pandemike. Një histori e mëparshme e çrregullimeve mendore / depresionit shfaqet si faktorë të qëndrueshëm kontribues në këto gjetje. Për këtë kategori indikohen përpjekje parandaluese dhe trajtimi.

Fjalë kyçe: COVID-19, depresioni, PHQ-9, online, Kosovë.

SËMUNDJET RENALE DHE MIELOMA MULTIPLE.

Olta Qurku[1], Prof.Dr.Alma Idrizi[2]
[1]Nefrologe, Departamenti i Mjekësisë Interne, Spitali Rajonal "Omer

Nishani",Gjirokastër.
[2]Nefrologe, Departamenti i Nefrologjisë,Hipertensionit,Dializës dhe Transplantit, QSUT, Tiranë.

Abstrakt

Mieloma multiple (MM) është një çrregullim malinj i qelizave plazmatike dhe përbën 10% të të gjithë sëmundjeve hematologjike malinje. Fillesa e saj ka shumë të panjohura por studimet e njëpasnjëshme kanë evidentuar se ekziston tashmë një patologji e veçantë që progreson drejt mielomës multiple siç është MGUS. Të dhënat e deri tanishme flasin për një transformim malinj të qelizave plazmatike centrale post-germinale. Pra Mieloma Multiple e ka origjinën nga qelizat B prekursore në nivel të nodujve limfatik të cilët migrojne më vonë drejt palcës së kuqe të kockave. Zhvillimi i Mielomes multiple kalon në dy stade të rëndësishme sic janë shfaqja e MGUS-it dhe më pas progresioni i MGUS-it në MM. Sapo popullata e qelizave klonale plazmatike formohet duke dhënë Mielomën Multiple, pacienti shfaq simptoma të lidhura me infiltrimin e organeve nga qeliza plazmatike ose nga vargjet e lehta dhe të rënda të imunoglobulinave. Përqindja e rasteve të diagnostikuara me MGUS që progresojnë drejt MM është vetem 1% në vit. Ekspozimi ndaj radiacionit, benzeneve, solventëve organik, herbicideve dhe insekticideve kanë treguar një rritje të frekuencës së progresionit të MGUS në MM. Një nga komplikacionet më të shpeshta të Mielomës Multiple është dëmtimi renal i cili mund të shfaqet klinikisht në formën e dëmtimit renal akut ose si sëmundje renale kronike. Kështu afersisht 50% e pacientëve të diagnostikuar me MM përjetojnë në një moment të zhvillimit të sëmundjes së MM një dëmtim akut ose kronik renal. Lezonet tubulare në këtë rast do të shfaqen klinikisht me sindromin Fanconi.Vargjet e lehta/të rënda të Ig mund te depozitohen jo vetem në qelizat tubulare por dhe në kompartimente të tjera të veshkës duke shkaktuar AL-amiloidozën si dhe sëmundjet me depozita të Ig monoklonale (MIDD). Në një studim të realizuar me 190 pacientë të diagnostikuar me MM u vunë re 12 raste me lezione të kombinuara të lidhura me paraproteinat si "cast" nefropati dhe MIDD, "cast" nefropati dhe amiloidosis ose "cast" nefropati dhe glomerulonefritis fibrilar,të cilat u shpjeguan me sjelljen e ndryshme të vargjeve monoklonale në mjedise të ndryshme.

Konkluzion: Rezultatet e biopsive renale treguan se dëmtimet renale nga MM kanë pamje histologjike të ndryshme si dhe manifestime klinike të ndryshme. Pra është e rëndësishme realizimi i biopsise renale si një proçedure rutinë e ofruar veçantërisht nga nefrologët. Komplikacionet e biopsisë renale perkutane janë shumë të pakta dhe lehtësisht të menaxhueshme nga një ekspert. Ka shumë studimet që e pershkruajnë atë si një ekzaminim miniinvaziv të sigurt. Njëkohësisht është e rëndësishme që në vendin tonë të krijohet një "database" për dëmtimet renale nga MM bazuar në të dhënat e biopsive renale. Aty të përshkruhen gjithashtu terapia e aplikuar te pacientët si dhe rezultatet e saj duke u shndërruar kështu në një "librari" mjekësore për nefrologët e rinj. Ky dokumentim do të krijonte një frymë bashkëpunimi midis specialiteteve të ndryshme respektivisht midis nefrologeve dhe hematologeve. Eksperienca dhe dokumentimi është baza e progresit.

Fjalë kyç: sëmundje renale, mieloma multiple.

MENAXHIMI I PACIENTËVE ME KANCER GJATË PANDEMISË COVID-19: PËRVOJA E QENDRËS SË VETME PUBLIKE E NJËSISË SË RADIOTERAPISË (RT) NË SHQIPËRI

O. Spahiu[1], B. Shima[1], E. Kozma[1], E. Hafizi[1], E. Karaulli[1], F. Kraja[1], B. Jahaj[1], U. Bitri[1], G. Hysa[1], A. Qehajaj[1], R. Buci[1], U. Gjoka[1], R. Jorgo[1], J. Saveta[1]
[1]Njësia e Radioterapisë, Shërbimi Onkologjik, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza

Abstrakt

Hyrje: Është analizuar ndikimi i pandemisë globale të koronavirusit (COVID-19) në pacientët me kancer në Njësinë RT, Spitali Universitar Nënë Tereza. Trajtimi RT i pacientëve me kancer nuk u vonua.
Qëllimi i përmbledhjes është të paraqesë përvojën në menaxhimin e pacientëve me kancer gjatë pandemisë globale COVID-19 të qendrës së vetme publike të RT në Spitalin Universitar Nënë Tereza. Ky artikull eksploron përvojën dhe aftësitë tona për të shmangur vonesat në trajtimin e tumoreve duke siguruar një strategji të integruar përmes procedurave të kufizimeve dhe menaxhimit të rreziqeve të imponuara nga pandemia.

Zhvillim: Njësia RT në Spitalin Universitar Nënë Tereza është i vetmi spital publik në vend që ofron trajtimin e 90% të të gjithë pacientëve me kancer, mesatarisht rreth 1700 pacientë në vit. Gjatë COVID-19 qendra u përball me domosdoshmërinë për të përshtatur procedurat komplekse të menaxhimit për të siguruar rrjedhën e qetë të punës dhe për t'iu përgjigjur nevojës së pacientëve për trajtim RT. Protokollet e trajtimit të qendrës u përshtatën bazuar në literaturën dhe punët e para të botuara në revista të ndryshme ndërkombëtare dhe udhëzime të shpejta të nxjerra nga qendrat kryesore globale të trajtimit të RT.
Për të maksimizuar efikasitetin në ofrimin e trajtimit me RT u analizuan dhe u morën parasysh si kujdesi mjekësor i pacientëve me kancer dhe siguria shëndetësore e stafit në përputhje me rekomandimet e autoriteteve kombëtare për menaxhimin e pandemisë. Masat e sigurisë përfshinin izolimin e pacientëve të shtruar në spital dhe kthimin në shtëpi, deri në shërimin nga Covid-19.

Përfundim: Pandemia globale, COVID-19 është një sëmundje afatgjatë me valë të ndryshme dhe ndikim të rëndësishëm në shëndetin publik dhe veçanërisht në kategorinë e pacientëve me kancer. Një infeksion i tillë përbën një rrezik të madh për pacientët me kancer për shkak të cënueshmërisë së tyre dhe komplikimeve që mund të shkaktojë mbivendosje me sëmundjen kryesore të pacientit. Përgjigja e menaxhimit për të garantuar sigurinë gjatë pandemisë nuk rezultoi në vdekshmëri midis pacientëve nën trajtim. Kufizimet e Covid-19 rezultuan në një ulje të numrit të pacientëve të paraqitur në qendrën tonë për trajtim nga 1700 në 1560 duke përfaqësuar një ulje prej 8.3% të numrit total të pacientëve që marrin trajtim me RT në qendrën tonë.

Fjalë kyç: covid-19 , pandemi globale , njësia RT.

FAKTORËT QË NDIKOJNË NË VONESËN E TË FOLURIT.

MSc. MA Orla Kaimi, Elma Prifti, Kis Mahmutaj, Kaltrina Gashi, Kejsi Balla

Abstrakt

Qëllimi i këtij studimi është që të zbulojë faktorët që ndikojnë më së shumti në vonesën e të folurit. Në këtë studim morën pjesë 56 logopedë nga institucionet private e shtetërore në Shqipëri, ku vetëm 4 logopedë nuk u intervistuan për faktin se nuk kishin asnjë rast me vonesë të të folurit. Logopedët janë shprehur se mosha më e shpeshtë e pacientëve me vonesë të të folurit që vlerësohen e marrin trajtim është 3-5 vjec. Sipas logopedëve, problematikat ose simptomat kryesore, të cilat vihen re që në konsultën e parë janë: strukturë e pazhvilluar e fjalive, artikulim jo i saktë/Dislali dhe fjalor i varfër. Ato shprehën se faktorët kryesorë që ndikojnë në vonesën e të folurit janë: përdorimi elektronikës, mbikujdesi/ neglizhenca prindërore dhe qëndrimi në shtëpi & hospitalizimet. 43 logopedë e klasifikojnë elektronikën si faktor madhor që ndikon në vonesën e zhvillimit të gjuhës dhe të të folurit. Indikator i rëndësishëm është se një pjesë e madhe prej 34 logopedësh ka treguar se 60-80% e pacientëve me vonesë së të folurit janë meshkuj. Pjesa më e madhe prej 28 logopedësh kanë thënë se prindërit janë mjaftueshëm bashkëpunues me logopedin, në lidhje me programin në shtëpi dhe për të eleminuar faktorët riskues.

Fjalë kyçe: Alalia/ vonesa e të folurit, logopedë, mosha, eksperienca, elektronika, mbikujdesi/neglizhenca prindërore, qëndrimi në shtëpi & hospitalizimet, faktor, mashkull.

VËSHTIRËSITË E LOGOPEDIT NË PACIENTË ME ÇRREGULLIME TË SJELLJES

MSc.MA Orla Kaimi [1], Eneida Buzi [2]

Abstrakt

Çrregullimet e sjelljes janë përgjithësisht, bashkëshoqëruese të një çrregullimi tjetër. Ato e vështirësojnë punën logopedike dhe zgjasin kohën për një rezultat pozitiv. Përvec kësaj, sjelljet gjatë seancës teraputike janë një sfidë për logopedin.
Për këtë arsye, u ndërmor një studim me 63 logopedë në të gjithë Shqipërinë për të evidentuar vështirësitë që has logopedi gjatë punës së tij, si dhe metodat që ai përdor me pacientët, të cilët kanë çrregullime të sjelljes. Në këtë studim 61 logopedë kishin pacientë me crregullime të sjelljes kurse vetëm 2 logopedë nuk kishin asnjë rast me këtë crregullim.
Diagnozat në të cilat shfaqin më tepër vështirësi në menaxhimin e sjelljeve janë: Çrregullim i Spektrit të Autizmit , ADHD / ADD dhe vonesat gjuhësore e të të folurit.Sipas tyre, jo vëmendja, sjelljet dëmtuese dhe hiperaktiviteti pengojnë më së shumti seancat logopedike dhe metoda që përdornin më së tepërmi logopedët për të eleminuar sjelljet ishte shmangia.
Mbi ecurinë që kanë këta pacientë, 41 logopedë treguan se rezultatet ishin mjaftueshëm të kënaqshme.
Shumica e logopedëve janë shprehur se e kanë mbështetjen e familjarëve.
Profesioni i logopedit kërkon shumë durim edhe në situatat kur mund të jetë e vështirë ta ruash këtë cilësi. Për këtë, 42 logopedë janë shprehur se logopedia është një profesion shumë i konsumueshëm.

Fjalë kyçe: Çrregullime të sjelljes, shmangia, logopedë, jo vëmendja, sjelljet dëmtuese, hiperaktiviteti.

NDIKIMI I GJUHËS RECEPTIVE NË ZHVILLIMIN E GJUHËS VERBALE.

MSc.MA.Orla Kaimi

Abstrakt

Ky studim synon të evidentojë ndikimin e gjuhës receptive në gjuhën verbale për fëmijët e grupmoshës 2-6 vjeç. Vihet re se studimet e degës së logopedisë i mungojnë në vendit tonë. Studimi është një përpjekje për të kuptuar nëse gjuha receptive lë pas ndonjë efekt në gjuhën ekspresive. Ky studim u shtri në një periudhë 6 mujore: prill – shtator 2021. Plotësimi i pyetësorëve dhe analizimi i të dhënave të përftuara kryen gjatë muajit korrik. Rezultatet e këtij studimi tregojnë për një fluks rastesh me dëmtim të gjuhës receptive dhe ekspresive , si dhe shfaq 100 % ndikimin e gjuhës receptive në gjuhën verbale. Gjithashtu me rëndësi janë edhe rezultatet që tregojnë për nevojë replikimi të të njëjtit studim, edhe për zhvillim më të gjerë të tij. Studimi ofron rekomandime që lidhen me ndërmarrjen e studimeve më të gjera në këtë fushë si dhe më të drejtpërdrejta, duke pasur kontakt me fëmijët. Rekomandohet që një studim i tillë të bëhet edhe me grupmosha të ndryshme. Gjithashtu, replikimi nga specialiste të tjerë logopedë, neuropediatër, psikologë, neuropsikiatër, psikologë ,na ndihmon të analizojmë elementë të tjerë në këndvështrimin mjekësor dhe profesional tek fëmijët. Në këtë mënyrë do të përftohen më shumë informacione për problematikat e ndryshme të fëmijëve jo vetëm në gjuhën receptive dhe verbale por edhe në aspekte të tjera të zhvillimore.

Fjalë kyç: studim, gjuha receptive, gjuha ekspresive, fëmijë, logopedë.

TRAJTIMI I SUPIT TË NGRIRË ME LASERNEEDLEACUPUNCTURE

Dr.RABIT SADIKU[1]
[1]Aku Center - Gjilan, Kosovë

Abstrakt

Hyrja: Supi i ngrirë apo Periartritis humero scapularis (PHS). Në pasqyrën klinike përfshin të gjitha ndryshimet degjenerative dhe pezmatimet e të gjitha strukturave anatomike që përfshihen në ndërtimin e supit. Për shkak të ndryshimeve të pasqyrës klinike pasojat organike dhe funksionale sikundër ato lokale dhe distale më mirë do të duheshin trajtuar si një sindromë.
Pamja dhe tabloja klinike e PHS është njëkohësisht edhe e njëjte dhe e ndryshme nga rasti ne rast. Gjatë studimit kemi observuar dy simptoma: amplitudën e lëvizjes dhe dhimbjen e supit të sëmurë. Simptomat tjera nuk kanë qënë interes i studimit.

Metoda: Grupi i të sëmurëve me PHS ka qënë i trajtuar në Aku Center-Gjilan; Kosovë. Janë trajtuar gjithsej 20 pacientë. Trajtimi ka zgjatur 5-10 ditë seanca. Janë stimuluar 6-8 pika të akupunkturës me Laserneedleakupunturë. Është përcjellë abduksioni dhe rrotullimet e jashtme të supit të ngrirë dhe shkalla e dhimbjes. Amplituda e lëvizjes ka qënë bazike për funksionimin e supit, përderisa dhimbja është simptomë e pranishme objektive. Për suksesin e mjekimit ka qënë e nevojshme vetëm 5 seanca por shumica ka vazhduar deri në 10 seanca.

Rezultatet:Të gjithë pacientët kanë rezultuar duke reaguar me Laserneedleakupunturë; dhe kjo ka ndikuar në rritjen e amplitudës së lëvizjeve në supin e ngrirë. Pacientët qe kishin rritur amplitudën e lëvizjeve ne 80-90% pas aplikimit të 5 seancave nuk janë trajtuar me tutje. Nga kjo kemi mësuar se nëse arrijmë të rrisim abduksionin në të njëjtën kohë kemi arritur të përmirësojmë edhe rrotacionin e jashtëm të supit. Përmirësimi i amplitudës së lëvizjes para dhe pas trajtimit ka qënë dukshëm i rritur në statistikat tona. Edhe dhimbja si një ndjenjë

subjektive ka qënë e vlerësuar si: dhimbje e fortë, dhimbje me intensitet mesatar, dhimbje e butë dhe pa dhimbje.
Përfundimi: Trajtimi me Laserneedleakupunturë arrihet duke vendosur nëpër pika të akupunturës rreze laserike pa gjilpëra dhe shpim. Kombinimi i rrezeve infra të kuqe, jeshile, blu dallojnë në penetrim dhe stimulimi është kryesisht biologjik dhe pa efekte anesore. Në Aku Center Laseroakupuntura aplikohet që nga viti 1993. Rezultatet janë shumë të mira.

Fjalë kyc: Laserneedleacupunture, PHS

HIDRADENOMA PAPILLIFERUM ME FOKUSE TË KARCINOMËS SKUAMOZE: RAST KLINIK NË SUOGJ 'KOCO GLIOZHENI'.

Rezart Ajazi.MD.PHD, Kizjona Perdja.MD

Abstrakt
Hidradenoma Papilliferum është një tumor beninj, i rrallë, cistik, papillar që shfaqet më së shumti në regjionin anogenital të femrave. Mbivendosja e patologjisë malinje në Hidradenomën Papilliferum në kuadrin e karcinomës skuamoze është një entitet jashtëzakonisht i rrallë. Ne prezantojmë një rast të ri të një gruaje 43 vjec, që u paraqit me një nodul në rritje në labia major. Në ekzaminimin histopatologjik rezultoi Hidradenoma Papilliferum, me fokuse të karcinomës skuamoze. Për konfirmimin e diagnozës u kërkua ekzaminimi i imunohistokimisë. Trajtimi definitiv u realizua përmes ekcizionin total.
Ky është një rast I vecantë klinik, I cili thekson rëndësinë e bashkëpunimit ndërdisiplinor mjekësor për arritjen e një diagnoze të saktë, sidomos në raste të tilla me vështirësi diagnostike.

Fjalë kyç: Hidradenoma Papilliferum, karcinoma skuamoze, labia major, imunohistokimia.

ERITRODERMIA PËR SHKAK TË DERMATITIT SEBORRHEIK , PSORIASIS , DERMATITIT .

Ritjona Mala[1], Valbona Zenelaj[2], Prof.As. Monika Fida[3]
[1]Njësia e Dermatologjisë, Spitali Rajonal Kavajë, Shqipëri.
[2] Njësia e Dermatologjisë, Spitali i Traumës, Tiranë, Shqipëri
[3]Departamenti i Dermatologjisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë i Tiranës, Shqipëri

Abstrakt

Hyrje: Eritrodermia është një manifestim i lëkurës për shkak të sëmundjeve të ndryshme të lëkurës ose një manifestim i një tumori të organit të ngurtë ose një sëmundje tjetër malinje.

Qëllimi i prezantimit: Të tregojë disa raste klinike të diagnostikuara dhe trajtuara në Departamentin e Dermatologjisë UHCT "Nënë Tereza" me Eritrodermi të fytyrës: Dermatit Seborrheic, Psoriasis Vulgaris, Dermatit Alergjik Kontakt Mycosis Fungoide. Për të theksuar veçoritë klinike, dallimet dhe protokollin e trajtimeve të këtyre rasteve.

Rezultatet: "Burri me fytyrë të kuqe" është një term që mund të përfshijë sëmundje të ndryshme të lëkurës, por të gjitha ato manifestohen me njolla skuamoze eritematoze në

fytyrë. Diagnoza e saktë bëhet në bazë të anamnezës, karakteristikave klinike dhe biopsisë. Trajtimi bazohet në protokolle të përditësuara dhe zbatohet për shkak të nevojave individuale.

Përfundim: Llojet e ndryshme të gjendjeve të "burrit me fytyrë të kuqe" duhet të diferencohen saktë dhe për këtë të gjithë duhet të jenë të vetëdijshëm për karakteristikat specifike klinike. Biopsia e lëkurës duhet të jetë një domosdoshmëri për diagnozën e saktë. Protokollet e trajtimit dhe kujdesit të përditshëm të lëkurës janë vërtet të dobishme për trajtimin e këtyre sëmundjeve.

Fjalë kyç: Fytyrë e kuqe, Dermatiti Seborrheik, Psoriasis, Dermatiti Alergjik i Kontaktit, Mycosis Fungoide.

HIPOTENSIONI ARTERIAL PAS INDUKSIONIT TË ANESTEZISË SË PËRGJITHSHME.

Bleris Bushati
Fakulteti i Mjekësisë, Viti VI, Universiteti Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt

Hyrje: Hipotensioni gjatë anestezisë dhe në periudhën perioperatore është një komplikacion relativisht i shpeshtë. Incidenca raportohet në artikuj të ndryshëm në literaturë rreth 11%. 25% e pacientëve që bëjnë hypotension janë të predispozuar për arrest kardiak intraoperator. Konsiderohet hypotension ulja e presionit arterial sistolik nën 80-90 mmHg, ulja e presionit mesatar arterial nën vlerat 60 mmHg dhe/ose rënia me mbi 40% e presionit mesatar, ose rënia me mbi 30% e presionit arterial sistolik nga niveli bazal i futjes në sallë. Hipotensioni konsiderohet faktor risku për komplikacione madhore kardiovaskulare, cerebrovaskulare dhe renale duke ndikuar ndjeshëm në prognozen e pacientit.

Materiali dhe metoda: Studimi i tipit prospektiv dhe deskriptiv është realizuar në periudhen kohore mars 2022-maj 2022, në bllokun operator të Klinikës 3, QSUNT dhe në bllokun operator të Spitalit Amerikan 3. Janë marrë në studim pacientet ASA1/3, nën anestezi gjenerale, pa semundje endokrine, jo kirurgji endokrine. Kriteret përjashtuese janë ASA 4, kombinim me anestezi spinale apo epidurale, sëmundje endokrine, dhe BMI mbi 40. Janë memorizuar pervec të dhënave të pacientit, sëmundjet kardiovaskulare paraprake, prania e HTA preekzistues, medikamentet antihipertensive dhe përdorimi i tyre, anestetikët e përdorur në induksion, vlerat e SAP/MAP/DAP përpara induksionit, 10 minuta pas induksionit, 20 minuta pas induksionit. Pikat end-point janë vlerësimi i incidencës së hipotesionit, lidhja shkak-pasojë e lëndëve anestetike, lidhja shkak-pasojë e medikamenteve antihypertensive, si dhe trajtimi i hipotensionit.

Diskutimi: Hipotensioni intraoperator është pasojë e shumë faktorëve, të vecuar ose të kombinuar së bashku. Përgjithësisht nuk ka qendrim standard, por duhen respektuar veçorite hemodinamike të çdo pacienti. Mekanizmat që justifikojnë hipotensionin intraoperator janë: efekti vazodilatator dhe inotrop negativ i anestetikeve, hypovolemia dhe/ose hemorragjia, pozicioni i pacientit gjatë interventit, mosha geriatrike, medikamentet antihipertensive, ventilimi me presion pozitiv, dhe anestezia spinale/epidurale. Në serine tonë ne jemi perpjekur të shohim shkaqet e hipotensionit, mënyrën e trajtimit, incidencën e hipotensionit.

Konkluzionet: Hipotensioni gjatë anestezisë është faktor prognoztik negativ dhe shkak për komplikacione madhore kardiovaskulare, cerebrovaskulare, dhe renale. Çdo pacient ka profilin e tij hemodinamik dhe vlerat e presionit arterial intraoperator meritojnë të respektojne veçoritë e pacientit. ACE-I nderpriten të paktën 24 orë përpara interventit.

Fjalë kyç: anestezi gjenerale, hipotension, monitorim hemodinamik.

ROLI I PROKALCITONINËS NË TERAPINË ME ANTIBIOTIKE NE ICU DHE REPARTET E EMERGJENCËS

Rudin Domi, Gent Huti, Asead Abdyli, Driola Hoxha
Departamenti i Anestezisë dhe Terapisë Intensive, Spitali Amerikan 3, Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Antibiotikët (AB) që janë sot në përdorim janë në numër të limituar dhe ende nuk ka antibiotikë të rinj të zbuluar. Përdorimi jo racional i antibiotikëve do të na shpjerë në situatën që shpejt antibiotikët do të jenë jo efektiv si pasojë e rezistencës polimikrobiale. Sipas Interagency Coordination Group (IACG) si pasojë e rezistencës mikrobiale në vitin 2050 llogariten më shumë se 10 milion vdekje në rang botëror. WHO Global Action Plan për Antimicrobial Resistance të 2015 raporton që kriza e rezistencës mikrobiale do jetë mjaft e rëndësishme dhe sigurisht kërkon një qasje mjaft të shpejtë dhe të mirë koordinuar nga ekipet mjekësore. Një pistë është minimizimi i antibiotikëve duke përdorur prokalcitoninën.

Materiali and metoda: është fakt i ditur që 75% e antibiotikëve përdoren për infeksionet respiratore edhe pse shpesh herë origjina mund të jetë virale. Matjet e PCT dhe përdorimi i nivelit të saj për strategjinë e përdorimit të antibiotikëve (fillimi, kohëzgjatja, përfundimi) na ndihmon në minimizimin e antibiotikëve dhe efektet anësore nga abuzimi me to. Matjet e herëpashërshme përdoren edhe për trajtimin e pacientëve në sepsis.

Diskutimi: Nëse antibiotikët përdoren korrekt, shpesh shikohet një rënie drastike të PCT me gati 30%. Infeksionet intrabdominale janë shkak madhor për mortalitet dhe trajtimi me antibiotikë është sa i nevojshëm po aq edhe i diskutueshëm. Nësë përdoret PCT raportohet në literaturë që mund të reduktohen deri në 5 ditë terapia me antibiotikë. Edhe në sepsis neonatal raportohen reduktime të ditëve nën antibiotikë nëse PCT matet rregullisht.

Konkluzion: PCT ndihmon për të përshkruar në mënyrë racionale antibiotikët, duke minimizuar efektet anësore, koston, dhe mbi të gjitha rezistencën multimikrobiale.

Fjalë kyç: *procalcitonin, antibiotics, microbial resistance*

DERMATITI EKSFOLIATIV SEVER NË NJË FËMIJË 3 MUAJSH ME COVID-19

Ermira Vasili[1], Monika Fida[1], Sabina Dedej[1], Dea Klironomi[2]
[1]Departamenti i Dermatologjisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Shqipëri
[2]Universiteti Mjekësor i Vjenës, Viena, Austri.

Abstrakt

Dermatiti eksfoliativ i gjeneralizuar, ose eritrodermia, është një inflamacion i rëndë i të gjithë sipërfaqes së lëkurës që mund të prekë të gjitha grupmoshat, duke përfshirë edhe infantët. Në këto pacientë është e domosdoshme të merret një histori e saktë mjekësore dhe të realizohet një ekzaminim fizik i detajuar që drejton në diagnozën e duhur dhe për të parashikuar komplikimet e mundshme. Diagnozat diferenciale janë të gjera, me theks në dermatitin atopik, psoriasis vulgaris dhe dermatitin alergjik në moshën pediatrike. Një bashkëpunim i kujdesshëm midis dermatologëve dhe mjekëve pediatër është e një rëndësie të jashtëzakonshme për të arritur rezultatin më të mirë terapeutik. Rasti klinik që prezantojmë ka të bëjë me një pacient tre muajsh me histori të dermatitit atopik dy mujore, me fillimin akut të dermatitit eksfoliativ të gjeneralizuar dhe irritabilitetit të shtuar. Pacienti u diagnostikua me infeksion Covid-19 në hospitalizim. Veçantia e ketij rasti konsiston në qasjen e duhur mjekësore dhe sfidën e menaxhimit dhe mbivendosjes së tre patologjive: dermatitit atopik, eritrodermisë akute dhe Covid-19.

Fjalë kyç: dermatitis eksfoliativ, eritrodermia.

DIAGNOSTIKIMI DHE MENAXHIMI I KRIPTORKIDIZMIT.

Dr.Sh.M. Sander KOLA[1], Dr.Erinda FRROKU[2], Dr.Gezim Shehu[3]
[1,2,3]Klinika Mjekësore "Egian" Tiranë.

Abstrakt

Hyrje : Kriptorkidizmi ose testi i pazbritur (UDT) është një nga çrregullimet më të shpeshta pediatrike të sistemit endokrin mashkullor dhe çrregullimi gjenital më i zakonshëm i identifikuar pas lindjes. Incidenca e kriptorkidizmit është 1% - 4% te të porsalindurit ne term dhe deri në 45% të foshnjave meshkuj të lindur parakohe . Kjo patologji con ne rritje të rrezikut të infertilitetit dhe tumorit të qelizave germinale.

Qëllimi i studimit: Të vlerësojmë diagnostikimin ,menaxhimin dhe dekursin e pacientëve të paraqitur me kriptorkidizëm.

Metodat: Studim retrospektiv. Ne shqyrtuam dhe analizuam 10 raste, të pacientëve me kriptorkidizëm. Janë marrë në studim pacient të paraqitur në Klinikën Mjekësore "Egian", Tiranë nga Tetor 2017 - Janar 2019. Mosha e pacientëve varionte nga 1 deri në 40 vjeç. 9 pacientë ishin fëmijë, një pacient ishte 40 vjeç. Diagnoza e kriptorkidizmit u vendos klinikisht me (ënjtje inguinale, me masë të fortë në palpim, nauze, të qara të forta te fëmijët dhe dhimbja në fossa iliake të djathtë që imiton apendicitin) dhe u konfirmua nga eksplorimi i kanalit inguinal me Color-Doppler ultrasound (CDU).

Rezultatet: Në 8 raste testi është ruajtur ku është kryer orkiopeksia, ndërsa në 2 raste është kryer orkidektomia për shkak të gangrenës testikulare dhe te tumorit testikular. Ultrasonografia u krye 3 dhe 12 muaj pas operacionit për të vlerësuar vëllimin e testikujve. Kjo e fundit është llogaritur duke përdorur formula 0.52 gjatësia, gjerësia, trashësi e elipsoid testicular. Atrofia testikulare u përkufizua si diferenca >50% midis testit të prekur dhe kontralateralit. Hipotrofia testikulare u përkufizua si një ndryshim >20%. Kriptorkidizëm ne anën e majtë ishin 5 raste dhe ne anën e djathtë 3 raste, kriptorkidizëm bilateral në 2 pacientë. Operacioni u krye pas përpjekjeve të pasuksesshme të reponimit manual dhe trajtimit hormonal. Me anë të examinimit fizik dhe Echografik Doppler pas 3 dhe 12 muajsh u konstatua se, 2 pacientë vuanin nga atrofia e testit mesatarisht pas 12 muajsh, 2 pacientë kishin testikuj hipotrofik pas 8 muajsh, 4 pacient kishin testikuj normal pas 12 muajsh.

Konkluzione : Komplikimet më serioze të kriptorkidizmit janë infertilitetit I mundshëm dhe një incidencë e lartë e kancerit të testit . Orkiopeksia është mirë të bëhet para vitit të parë të jetës për të parandaluar komplikacionet e mësipërme. Theksohet rëndësia e ekzaminimit të organeve gjenitale të jashtme, me anë të examinimt fizik për pacientet me dhimbje inguinale nga mjekët e urgjencës, mjekët e kujdesit parësor, mjeku pediatër, si dhe konfirmimi i diagnosës nga mjeku imazherist, me examinimin Echografia Color Doppler.

Fjalë kyç: Echo Color Doppler, kriptorkidi, enjtje, fëmijë, dhimbje inguinale.

PËRPARËSIA E CT NË EKZAMINIMIN RADIOLOGJIK TË COVID-19. (RIVIEW)

Dr.Sh.M. Sandër KOLA[1], Irena KOLA[2], Erinda Frroku[3]
[1,3]Departamenti i Imazherisë Spitali Universitar "Nënë Tereza", Tiranë.
[2]Departamenti I Reumatologjisë Spitali Universitar "Nënë Tereza", Tiranë.

Abstrakt

Definicioni: Që nga fillimi i pandemisë së COVID-19 e deri sot, imazheria radiologjike, dhe posaçërisht CT, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në diagnostikimin e sëmundjes dhe ecurinë e pacientit me COVID-19
Kjo, për arsyen se sensitiviteti i CT-se është shumë i lartë, mbi 90%, por edhe për faktin se u dëshmua si metodë e saktë në ecurinë e sëmundjes, duke dhënë informata të sakta për prekjen e organeve të prekura si dhe komplikimet eventuale.

Matëriali dhe metoda: Në disa studime të bëra në Itali, Angli, Spanjë , tregojnë se CT ka sensivitet , më të lartë se ai i testit PCR dhe që aktualisht është dhe mbetet standard i artë (Gold Sandard) për diagnostikimin e kësaj sëmundjeje. Studimet tregojnë se infeksioni me SARS-CoV-2 çon në një incidencë të shtuar për trombozë, prandaj kështillohet që për ekzaminimin me CT të përdoret një protokoll me dozë të reduktuar të rrezatimit dhe pa kontrast intravenoz , vetëm kur nuk kemi dyshime për komplikime eventuale, nëse rritet vlera e D-dimerëve ose nëse ka dyshime për emboli pulmonare. Morfologjia e pneumonisë COVID-19 në CT është e ngjashme te shumë pacientë. Zakonisht prezantohet me zona me densitet te reduktuar ose forma të përziera të zonave me reduktim densiteti dhe konsolidime , gjithashtu një CT pa shenja inflamatore nuk e përjashton një sëmundje COVID-19.
Konkluzione: Si konkluzion mund te themi se CT është më e ndjeshme se sa testi PCR dhe që realisht është dhe mbetet "standardi i artë" diagnostik. Ka patur raste që testi për Covid-19 ishte negativ, ndërsa me CT ka patur ndryshime radiologjike, specifike për sëmundje COVID-19.

Fjalë kyç: CT, COVID-19, sëmundje, testi PCR, contrast.

SHPESHTËSIA E HASJES SË ASTMËS BRONKIALE PARA DHE PAS PANDEMISË NË LEZHË

Shkelqime Poga – Tobli [1], Erjona Frroku [2]
Instituti i Shëndetit Publike
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike

Abstrakt

Hyrje: Astma bronkiale është sëmundje respiratore e shpeshtë, e karakterizuar nga simptoma të përsëritura dhe të kthyeshme, që shoqërohen me ngushtim të rrugëve të frymëmarrjes. Mendohet se shkaktohet nga një kombinim faktorësh gjenetikë dhe mjedisor.Astma karakterizohet me sulme të përsëritura të vështirësisë në frymëmarrje dhe fishkëllimës, të cilat ndryshojnë nga personi në person, si në ashpërsi dhe në frekuencë. Tek individët e sëmurë simptomat mund të shfaqen disa herë në ditë apo javë dhe tek disa njerëz ato mund të përkeqësohen gjatë aktivitetit fizik ose gjatë natës.

Metoda: Ky studim përshkruan shpeshtësinë e hasjes së Astmës Bronkiale tek banorët e qytetit të Lezhës. Janë verifikuar të dhënat e regjistrave të pacientëve të paraqitur në Qendër Shëndetësore gjatë viteve 2018, 2019, 2020, 2021. Vlerësimi i të dhënave të sëmundshmërisë dhe analizimi i prevalencës së sëmundjes sipas grupmoshave, gjinisë, vendbanimit 2018-2021.

Rezultati: Janë studiuar 47 pacientë me Astmë Bronkiale të paraqitur pranë Qendrës Shendetësore në Lezhë. Shpërndarja e rasteve sipas viteve të marra në studim tregon për nivele të frekuencës me 21.2 % të rasteve në vitin 2018, 19.1 % të rasteve në vitin 2019, 29.8 % të rasteve në vitin 2020 dhe 29.9 % të rasteve në vitin 2021. Konstatohet një rritje e frekuencës gjatë viteve të pandemisë 2020 dhe 2021. Nga të dhënat konstatohet se 53.2 % e rasteve janë meshkuj dhe 46.8 % janë femra. Shpeshtësia më e lartë e rasteve vërehet në grup moshën 41-50 vjec dhe konkretisht 23.4 % të rasteve. Vizitat në spital nga personat që vuajnë me astmë janë më të shpeshta gjatë muajve Shkurt dhe Maj për fëmijët, ndërsa gjatë dimrit më shumë për të rriturit. Nga studimi vlerësohet se 48 % e rasteve janë duhanpirës.

Përfundimi: Rekomandohet diagnostikimi i hershëm me qëllim trajtimin në kohë dhe parandalimin e komplikacioneve. Identifikimi dhe ulja e ekspozimit ndaj faktorëve të riskut. Vaksinimi i gripit është i rëndësishëm për njerëzit me astmë.

Fjalë kyç: astma bronkiale , pandemia , duhanpirja.

EFEKTIVITETI I ANTIBIOTIKËVE PARA, GJATË DHE PAS PERIUDHËS SË PANDEMISË NË SHKODËR

Shkëlqime Poga – Tobli [1],
Uendi Bizi [2] , Anxhela Prendi [3] , Kostandina Doçaj [4] , Amela Ademi [5]
Instituti i Shëndetit Publik
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike

Abstrakt

Hyrje: Antibiotikët janë substanca kimike që mundohen të shkatërrojnë mikroorganizmat patogjene pa shkaktuar dëmtime në organizmin e individit. Mirëpo, rritja e përdorimit dhe përdorimi i paarsyeshëm i tyre janë dy faktorë kyç që përshpejtojnë shfaqjen dhe përhapjen e rezistencës antimikrobike.

Metodat: Studimi përfshin informacionin e përpunuar nga analizimi i të dhënave të pyetësorëve të plotësuar nga intervistimi me banorët e qytetit të Shkodrës. Vlerësimi i të dhënave përfshin periudhën kohore 2019-2021, shpërndarjen sipas gjinisë, grupmoshat, llojin e antibiotikut të përdorur më shpesh nga popullata. Të dhënat u paraqitën në trajtën e

diagramëve dhe grafiqeve të punuara me Ëord ose Exel.

Rezultate: Në studim u përfshinë 150 banorë të qytetit të Shkodrës, ku 74% femra dhe 26% meshkuj. Grupmosha e përfshirë më tepër është grupmosha 18-24 vjeç me 67.3%. Pyetjes nëse ishin infektuar me COVID-19, 62.7% u pergjigjen se e kishin kaluar, kurse 37.3% nuk e kishin kaluar ose të paktën nuk e dinin. Dhe nga ato që e kishin kaluar, 50% nuk janë paraqitur te mjeku i familjes fizikisht gjatë periudhës së pandemisë, 45.3% kanë pasur kontakt me mjekun e familjes fizikisht 1-2 herë , dhe pjesa tjetër mbi 3 herë. Gjithashtu nga rezultatet konstatohet se 70.3% kanë marre antibiotikë me rekomandimin e mjekut. 50% e të anketuarve referojnë se kanë kaluar gripin më rëndë dhe kanë marrë antibiotikë gjatë periudhës me simptoma gripi të cilat nuk e kanë përmirësuar gjendjen shëndetësore të tyre.

Konkluzione: Rekomandohet përdorimi racional i antibiotikëve tek pacientët e kujdesit parësor. Kontributi i mjekëve të kujdesit parësor në perceptimin dhe qëndrimin e pacientëve për sëmundjen e tyre dhe nevojën për antibiotikë. Të pengohet blerja në farmaci e antibiotikëve pa reçetën e mjekut.Të përforcohet sistemi i mbikqyrjes së rezistencës antimikrobike dhe i konsumit të antibiotikëve. Edukimi i vazhdueshëm i mjekëve në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor.

Fjalë kyç: pandemia , antibiotikët , shkodër

NIVELI I DEPRESIONIT TEK MOSHA E TRETË DHE NDËRLIDHJA E TIJ ME KUALITETIN CILËSOR TË JETËS

Shqipe Vitija

Abstrakt

Në këtë studim janë përfshirë gjithsejtë 70 subjekt, prej tyre 25 meshkuj dhe 45 femra të moshës mbi 60 vjeç. Ndërsa 22 nga këta pjesëmarrës kanë qenë banues të shtëpisë së pleqve dhe 48 të tjerë kanë qenë banues në ambiente familjare. Të dhënat janë mbledhur nga dy pyetësorë vetë-raportues: inventari i Beck-ut për depresionin dhe shkalla multidimensionale mbështetjes sociale, Zimet, Dahlem, Zimet & Farley (1988). Studimi është udhëhequr nga dy hipoteza. Hipoteza e parë të këtij hulumtimi ka qenë: "Ekzistojnë dallime në nivelin e përjetimit të depresionit në mes të moshuarve që jetojnë në ambiente familjare dhe atyre në shtëpi të pleqve", është bërë analiza e t-testit. Të moshuarit që jetojnë në ambient familjar treguan mesatare (M=22.62) ndërsa të moshuarit që jetojnë në shtëpi të pleqve treguan mesatare (M=49.22), rezultati i t-testit [**t** (1.68) -8.879 **p**= 0.000], këto rezultate janë të rëndësishme dhe e mbështesin këtë hipotezë, pasi që të moshuarit që jetojnë në shtëpi të pleqve kanë shfaqur dukshëm nivel më të lartë të depresionit krahasuar me të moshuarit që jetojnë me familje. Hipoteza e dytë të këtij hulumtimi ka qenë: "Kualiteti cilësor i jetës tek personat e moshës së tretë ndërlidhet me simptomat depresive", është bërë analiza e korrelacionit dhe është raportuar ky rezultat [**r=** (1.68) -.601**, **p**= .000], këto rezultate janë të rëndësishme pasi që është raportuar një ndërlidhje negative por signifikante në mes këtyre dy variablave, rezultat ky që e mbështet hipotezën e dytë.

Fjalët kyç: depresion, mbështetje, kualitet cilësor, të moshuar

KONCEPTI I HARMONIZIMIT DHE ROLI I EQA NË MJEKËSINË LABORATORIKE.

Sidorela Dervishi
Laboratori i Qendrës Intermedica

Abstrakt
Mungesa e krahasueshmërisë së rezultateve të pacientëve është një çështje kryesore për mjekësinë laboratorike. Vendimet klinike kërkojnë rezultate ekuivalente nga procedurat e matjeve laboratorike klinike. Rritja e sigurisë së pacientit duke përmirësuar interpretimin e rezultateve të laboratorit mjekësor kërkon që rezultatet e testeve të jenë të krahasueshme midis qendrave mjekësore dhe metodave analitike. Harmonizimi është një aspekt themelor i cilësisë në mjekësinë laboratorike pasi qëllimi i tij përfundimtar është të përmirësojë rezultatet e pacientit përmes ofrimit të informacionit laboratorik të saktë dhe të zbatueshëm. Profesionistët supozojnë se testet laboratorike klinike të kryera nga laboratorë të ndryshëm në kohë të ndryshme në të njëjtën mostër dhe ekzemplar mund të krahasohen dhe se rezultatet mund të interpretohen në mënyrë të besueshme dhe të qëndrueshme. Duhet të theksohet se shkaku i dallimeve midis rezultateve të testeve të marra në laboratorë të ndryshëm mund të gjendet kudo në Procesin e Testimit Total (TTP). Vlerësimi i jashtëm i cilësisë (EQA) identifikoi se rezultatet nuk ishin ekuivalente në laboratorë të ndryshëm duke filluar nga viti 1947, kështu që duhet roli i EQA për të vëzhguar dhe monitoruar laboratorët. Qasjet për të përdorur të njëjtat metoda u promovuan në vitet 1950 dhe 1960. EQA është një burim i nevojshëm informacioni mbi vërtetësinë dhe saktësinë dhe duhet të zhvillohet plotësisht për të gjitha degët e laboratorit klinik. Për fazën analitike, EQA është një shtyllë qendrore në procesi i sigurimit të harmonizimit pasi skemat EQA janë të vendosura në mënyrë të shkëlqyeshme për të vlerësuar dy, burimet kryesore të mungesës së harmonizimit: ndryshueshmërinë dhe paragjykimin ndërmjet metodave analitike. Me synimin për të reduktuar paragjykimet ndërmjet metodave dhe për të përmirësuar paqartësinë, është interesante të eksplorohet se çfarë do të ishte e mundur nëse EQA të ndryshme siguron bashkimin e forcave dhe kombinon të dhënat e tyre të raportuara në një bazë të përbashkët të dhënash.

Fjalët kyç: Harmonizimi, EQA, procesi i testimit total (TTP), standardizimi.

ETIOLOGJIA, DIAGNOZA, PARAQITJET KLINIKE DHE TRAJTIMI I URTIKARIES

Dr.Sc. Sonila Borici[1]
Pneumoalergolog Pediatri
Shërbimi i Pneumoalergologjise Pediatrike, QSUT

Abstrakt

Zhvillimi:Urtikaria karakterizohet nga pllaka eritematoze, edematoze, kruarje dhe kalimtare që përfshijnë lëkurën dhe mukozën. Shumë faktorë si infeksionet, ilaçet, ushqimi, faktorët psikogjenë dhe alergjenët respiratorë akuzohen për etiologji, por ndonjëherë, është idiopatike. Ajo klasifikohet si urtikari akute dhe urtikari spontane kronike. Paraqitja klinike përfshin pllaka të kuqe, ënjtje dhe kruajtje. Lezionet zakonisht zgjidhen spontanisht brenda 2-3 orëve pa gjurmë. Ndonjëherë shoqërohet me angioedemë që mund të përfshijë traktin respirator, mukozën: qepallat, buzët, fryrje me dhimbje dhe ndjesi djegieje. Diagnoza është zakonisht klinike, sëmundjet auto-inflamatore, vaskuliti urtikarial, urtikaria kronike e

induktueshme, angioedema e fituar dhe e trashëguar, gjithashtu duhet të përjashtohen. Për trajtim preferohen antihistaminet H1 dhe, ndonjëherë, kortikosteroidet sistematike afatshkurtra; Opsione të tjera trajtimi, si omalizumabi, ciklosporina dhe antagonistët e receptorit të leukotrienit, mund të merren parasysh për rastet rezistente.

Fjalë kyç: urtikarie, akute, kronike

HIPERKOAGULIMI NË COVID-19

Sotiraq Lako, Hematolog, Spitali Amerikan, Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt

Hyrje :Megjithëse është e dokumentuar mirë që COVID - 19 manifestohet kryesisht si një infeksion i traktit respirator, të dhënat tregojnë se COVID-19 duhet të konsiderohet si një sëmundje sistemike, që përfshin shumë sisteme organesh: kardiovaskular, respirator, gastrointestinal, neurologjik, hematopoietik dhe imunitar. Virusi SARS - CoV - 2 invadon organet, duke u lidhur në sipërfaqen e qelizave përkatëse me receptorin angiotensin-converting enzyme 2 (ACE2). COVID - 19 është një infeksion sistemik me një ndikim të rëndësishëm në sistemin hematopoietik dhe hemostazën. Çrregullimet e Hemostazës, hiperkoagulemia, tendenca për tromboza venoze (më pak arteriale) është e zakonshme tek pacientëve e shtruar në spital me COVID V 19. Nivelet e rritura të D-Dimer raportohen vazhdimisht, ndërsa rritja e tyre gjatë ecurisë së sëmundjes shoqërohet, veçanërisht me përkeqësimin e sëmundjes. Zgjatja e PT dhe aPTT, rritja e produktet e degradimit të fibrinës, të bashkëshoqëruara me trombocitopeni, mund të jenë treguesit e KID, kërcënues për jetën, pra kërkon vigjilencë të vazhdueshme dhe ndërhyrje të shpejtë. Për pacientët me rrezik të lartë, tromboprofilaksia e hershme, është e rekomanduar.

Fjalë kyç : hiperkoagulim , covid-19 , tromboprofilaksi

CRVO (OKLUZIONI I VENËS CENTRALE TË RETINËS) DHE TRAJTIMI I SAJ ME ANTI -VEGF

Stela Ceca [1]

Abstrakt

Hyrja: Bllokimi i venës qëndrore të retinës, e njohur gjithashtu si CRVO, është një gjëndje në të cilën vena kryesore që drenon gjakun nga retina mbyllet pjesërisht ose plotësisht. Në disa raste mund të jetë një formë e lehtë por në pjesën më të madhe të rasteve ajo shoqërohet me humbje të shikimit për shkak të edemës makulare. Në pjesën më të madhe të rasteve ajo shfaqet vetëm një njërin sy . Edhe pse hipertensioni ose diabeti përbëjnë faktor rreziku, shkaku i saj i vërtetë mbetet akoma i pa njohur. Diagnoza bëhet në bazë të shenjave klinike por angiografia me fluoreshecnë na ndihmojnë të ndajmë formën ishemike nga ajo jo ishemike ndërsa OCT e makulës të masim nivelin e edemës makulare. Injeksionet intravitreale me anti-VEGF kanë rezultuar shumë efikase në trajtimin e edemës makulare në rastin e CRVO. Rasti klinik i rrallë i një pacienteje në moshë të re (38 vjec) me CRVO pas manovrës Valsalva e trajtuar me sukses me injeksionet intravitreale me Aflibercept.
Fjalë kyç: okluzion , retina , crvo.

MENAXHIMI PERIOPERATOR I PACIENTËVE AMBULATOR NË TERAPI ME ANTIKOAGULANTË NË PACIENTË COVID-19.

PhD. Suela Mumajesi[1], MD. Grisilda Demiri [2], Prof. Dr. Nestor Thereska[3], Prof. Dr. Myftar Barbullushi[1]
1 UHC "Mother Teresa"-Tirana, Albania
2. University Trauma Hospital- Tirana,ALBANIA
3. American Hospital- Tirana, Albania

Abstrakt

Pandemia globale SARS-CoV-2 theksoi shumë çështje që lidhen me pacientët e infektuar me COVID-19, të cilët duhej t'i nënshtroheshin një operacioni. COVID-19 prek njerëz të ndryshëm në mënyra të ndryshme. Shumica e njerëzve të infektuar kishin zhvilluar sëmundje të lehtë deri në mesatare dhe shëroheshin pa shtruar në spital. COVID-19 shoqërohet gjithashtu me një gjendje pro-trombotike dhe janë propozuar skema të ndryshme të profilaksisë së trombit si për pacientët e shtruar në spital ashtu edhe për pacientët pas daljes nga spitali, në mënyrë të ngjashme dhe për asnjë pacient me sëmundje kritike me COVID-19. Një numër i madh pacientësh me COVID-19 janë trajtuar me antikoagulantë të ndryshëm të rinj oralë (NOCAs) për të parandaluar tromboembolizmin venoz (VTE). Rritja e përdorimit të NOCA-ve shoqërohet me zgjerimin e rrezikut të komplikimeve perioperative në pacientët që i janë nënshtruar një operacioni elektiv ose urgjent. Ndërgjegjësimi për përdorimin e NOAC-ve në periudhën perioperative është i rëndësishëm për kujdesin optimal. Qasja më e mirë për vlerësimin e rrezikut të gjakderdhjes nga përdorimi i NOCA-ve, në kushte zgjedhore dhe emergjente, kërkon njohuri të duhura për: kohën e marrjes së fundit të barit, farmakokinetikën, farmakodinamikën, metodën e eliminimit dhe ndërveprimet e tyre me barna. Ky artikull përpiqet të plotësojë boshllëkun e njohjes së përdorimit perioperativ të NOCA-ve dhe të ndihmojë klinikët dhe kirurgun të ofrojnë kujdesin më të mirë për pacientët e tyre.

Fjalë kyç: antikoagulant, COVID-19, kirurgji, etj.

SËMUNDJA ISHEMIKE E ZEMRËS NË QENDRËN SHËNDETËSORE GJERGJAN DHE SHIRGJAN NË RRETHIN E ELBASANIT NË VITIN 2020

Dr. Svetllana Bitincka, Marsida Lleshi

Abstrakt

Sëmundja ishemike e zemrës është mjaft e përhapur në popullatë.
Faktorët e riskut si duhani, diabeti, HTA e shpërthejnë atë. Klinika është atipike dhe e rrezikshme në pacientë që nuk kanë informacion dhe nuk i drejtohen mjekut në kohë.
Kryerja e Check-upit vitet e fundit ka ndërgjegjësuar këta pacientë të kontrollohen dhe ka rritur besimin në procedurat e kontrollit.
Në studimin tonë kemi marrë të dhënat e grumbulluara gjatë 1 viti nga Kontrolli i Checkup në 8942 pacientë 29 rezultuan me sëmundje ishemike të zemrës.
Kemi kontrolluar kartelat e këtyre pacientëve te mjeku i familjes.
Rezultatet konfirmuan diagnozën e sëmundjes ishemike të zemrës në një numër pacientësh që nuk referonin të kishin vuajtur nga sëmundjet e zemrës.

Trajtimi dhe shtrimi në spital është bërë i mundur mbas vënies së diagnozës.

Fjalët kyç: sëmundje ishemike, qendra shëndetësore.

BENEFITET E MJEKIMIT HERËT NË TË SËMURËT ME MIELOFIBROZË

Tatjana Caja, Adela Perrolla, Elsuarta Calliku
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë
Shërbimi i Hematologjisë

Abstrakt

Mielofibroza është një nga neoplazitë mieloproliferative hematologjike e karakterizuar nga proliferimi mieloid me maturim morfologjik variabël, që diagnostikohet deri në moshën 40 vjeç në 5% të rasteve, dhe mbi moshën 50 vjeç në 17% të rasteve. Rreth 50 -70% e të sëmurëve kanë simptoma të përgjithshme si dobësi, 25 – 50% e të sëmurëve kanë rritje të lienit, 5 – 20% kanë temperaturë dhimbje të kocave djersë natën, 15 – 30% janë asimptomatik. Diagnoza bëhet e mundur kur fillon investigimi i splenomegalisë që gjendet në 90% të pacientëve, i hepatomegalisë që gjendet në 40 – 70% ose i çrregullimeve të gjakut periferik. Pruriti është gjetur ne 16% të 566 pacienteve me mielofibroze primare. Zmadhimi i lienit dhe heparit janë dy markeret e hemopoezës ekstramedulare që shoqërojnë mielofibrozen primare. Në analizën retrospektive të 205 pacientëve me PMF, 13.2% kishin ngjarje trombotike që në diagnozë. Shpesh diagnoza e Mielofibrozës vendoset në stade të avancuara, prandaj

Qëllimi i prezantimit: Rruga e diagnozës së hershme në praktikën klinike, kriteret. Diagnoza e hershme dhe rëndësia e saj. Ti jepet përgjigje pyetjes a mund të trajtohet herët Mielofibroza.

Proliferim megakariocitik dhe atipi (megakariocite të vegjël e të mëdhenj me një raport aberrant nuklear/citoplazmik dhe hiper-kromatik, bulos, ose nuclei të çrregullt). (Foto 2)

Studimet kanë treguar përmirësim në madhësinë e shpretkës, me mjekim të filluar herët. Reduktimi i *JAK2* V617F me terapi për kohë të gjatë, përmirësim dhe stabilizim i fibrozës së palcës kockore që vihet re në 48% të pacientëve të trajtuar herët. Të sëmurët e trajtuar herët kanë risk më të ulët për vdekje në 33% të rasteve.

Konkluzione: Është e nevojshme që të përmirësohet diagnoza e hershme në të sëmurët me Mielofibrozë. Çdo mjek kudo që punon le të suspektoj Mielofibrozën në çdo rast me splenomegali. Diagnoza e hershme dhe mjekim i hershëm do të përmiresoj simptomat, cilësinë e jetës dhe mbijetesën e të sëmurëve me mielofibrozë.

Fjalë kyç : mielofibroza , proliferim megakariocitik.

TERATOMA APO TUMORI "MREKULLI"

Dr.Sci.Teona Bushati Berdica, Ardenis Kapllani, Elma Fejzullahi, Endina Kelmendi, Erta Hyka, Kelt Kalaj, Kristia Dorre, Laura Qamili, Melisa Zejnuni, Ornela Rustemi, Pamela Feratai, Regi Çota, Sara Memsuri, Viola Canoku,

Zahide Lleshi
Departamenti i Patologjisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë Tiranë.

Abstrakt

Hyrja: Teratomat sipas përkufizimit mjekësor janë tumore që "nën sipërfaqen e tyre të brendshme, kanë një organizim të ngjashëm me atë të lëkurës, të aftë për të formuar epidermë, papila, dermë, gjëndra dhjamore, gjëndra djerse, qime, ind dhjamor nënlëkuror, material të lirë dhjamor dhe yndyror, kocka dhe dhëmbë". Do të njihemi fillimisht me aspektin e gjerë të saj, për t'u thelluar më vonë në detaje rreth historisë, epidemiologjisë, etiologjisë, klasifikimit, histopatologjisë, fiziopatologjisë, evolimit, diagnozës, trajtimit dhe prognozës së tyre.

Metodat: Rishikim literature duke bërë kërkim në artikuj mbi teratomat në website dhe studime shkencore.

Rezultatet: Sjellja biologjike e teratomave varet nga variabla të ndryshëm klinikë dhe epidemiologjikë të ndërvarur, si mosha në diagnozë, gjinia, vendi i tumorit, histologjia, ku të gjitha lidhen me devijime të ndryshme biologjike citogjenetike dhe molekulare. Kështu, teratomat testikulare neonatale janë përgjithësisht beninje. Rrjedhimisht, teratomat prepubertale nuk tregojnë devijime gjenetike citogjenetike ose molekulare. Nga ana tjetër, teratomat testikulare postpubertale mund të paraqiten si tumore malinje klinikisht dhe mund të shfaqin devijime komplekse citogjenetike. Sipas studimeve vendet më të shpeshta të tumorit (në rend zbritës) janë: regjioni sakrokoksigjeal (33,8%), vezoret (31,2%) dhe testikujt (10,5%). Rrallë lokalizimet përfshijnë mediastinin, retroperitoneumin, regjionin e kokës dhe qafës si dhe sistemin nervor qendror. Klasifikimi i OBSH-së i tumoreve të qelizave germinale dallon teratomat mature dhe të papjekura si dhe teratomat me transformim malinj, nga të cilat teratomat e pjekura janë më të shpeshta. Origjina e malinjitetit somatik mendohet të jetë nga transformimet degjenerative që pëson qeliza primordiale. Diagnoza e teratomave vendoset nga kombinimi i një sërë vlerësimesh klinike, testeve laboratorike, ekzaminimeve imazherike, biopsisë dhe të dhënave histopatologjike. Prognoza e tumorit varet nga shkalla e malinjitetit dhe trajtimi i tyre bëhet me anë të ndërhyrjeve kirurgjikale dhe ndjekja postoperative me metoda të kemio dhe radioterapisë.

Përfundimet: 1-origjina e teratomave si tumore te vecante eshte ne vetvete qeliza gjerminale pluripotente
2-diagnoza imazherike dhe vecanërisht ajo histopatologjike është iluminuesi dhe drejtuesi më i mirë drejt diagnozës dhe një trajtimi efikas
2-prognoza dhe trajtimi i tumorit janë unike dhe varen nga shkalla e diferencimit te qelizave dhe infiltrimi i indeve qe permban.

Fjalë kyç: tumor, teratoma.

STUDIMI I MUTACIONEVE ALK, EGFR DHE PD-L1 NË KARCINOMAT PULMONARE NËPËRMJET IMUNOHISTOKIMISË.

Teona Bushati [1,2], Leart Berdica [1,2], Jeta Memçaj [1]
1.UMT
2.Spitali Amerikan.

Abstrakt

Hyrje: Kanceri i mushkërive, me rreth 2.2 milionë raste të reja dhe 1.8 milionë vdekje, është kanceri i dytë më i diagnostikuar dhe shkaku kryesor i vdekjeve nga kanceri në vitin 2020. Imunohistokimia (IHC) tani përdoret jo vetëm për të diagnostikuar dhe klasifikuar tumoret e mushkërive në nëntipe , por edhe për të përcaktuar përshtatshmërinë e pacientëve për terapi të ndryshme të synuara molekulare.

Objektivat: Studimi i mutacioneve ALK, EGFR dhe PD-L1 në Karcinomat pulmonare nëpërmjet ekzaminimeve imunohistokimike për të ndihmuar në përcaktimin e prognozës dhe rasteve që mund të përfitojnë nga terapia e synuar. Zbulimi i lidhjeve të mundshme midis ALK, EGFR, PD-L1 dhe variablave të tjerë si mosha, seksi, entiteti histologjik dhe shkalla e diferencimit të tumorit.

Materialet dhe Metodologjia: Studimi është retrospektiv dhe përfshin 266 pacientë të diagnostikuar me kancer në mushkëri, të cilët i janë nënshtruar biopsisë në Spitalin Amerikan në periudhën 2016-2020. Indet e marra iu nënshtruan ekzaminimit IHC duke përdorur antitrupa kundër faktorëve TTF-1, ki67, EGFR, ALK, PD-L1 etj. Këto inde shfaqën karcinoma pulmonare të llojeve të ndryshme histologjike dhe me shkallë të ndryshme diferencimi. Të dhënat e marra janë përpunuar në bazë të gjinisë, moshës, tipit histologjik, shkallës së diferencimit të adenokarcinomës dhe të dhënave IHC për markerët e mësipërm.

Rezultatet: Studimi tregoi se nga 266 pacientë, 24% e rasteve me kancer të mushkërive janë femra dhe 64% janë meshkuj. Mosha mesatare ishte 61.8 vjeç. Nuk u gjet asnjë lidhje statistikisht domethënëse midis ALK, PD-L1 dhe EGFR me variabla si mosha, gjinia dhe shkalla e diferencimit të adenokarcinomave. Nuk u gjet asnjë lidhje e rëndësishme midis ALK dhe PD-L1 dhe entitetit histologjik, por u gjet një lidhje e rëndësishme midis EGFR dhe tipit histologjik të karcinomave pulmonare. Konkluzione: Kanceri i mushkërive është një nga kanceret më të shpeshta, i cili gjendet kryesisht te meshkujt, por edhe te femrat. Në ditët e sotme, IHC ndihmon jo vetëm në diagnostikimin e kancerit të mushkërive, por edhe në përcaktimin e pacientëve që mund t'i përgjigjen terapisë së synuar dhe prognozës së tyre. Prandaj, përdorimi i IHC për të zbuluar mutacionet ALK, EGFR, PDL-1 dhe lidhjet e tyre me karakteristikat e pacientit po bëhet gjithnjë e më i nevojshëm.

Fjalë kyç: kanceri i mushkërive, imunohistokimi (IHC), ALK, PD-L1, EGFR.

GINGIVITI DHE SHTATËZANIA

Dshm Dr Ob/Gyn T.Bare, E.Paparisto, N.Bare

Abstrakt

Shtatëzania me rritjen e nivelit hormonal të progesteronit krijon terren të përshtatshëm për zhvillimin e bakterieve që cojnë në gingivit. Simptomat që vihen re janë: edemë e gingivave, gingiva të dhimbshme, gjakosje të gingivave, skuqje e tyre, erë e keqe. Gingiviti në shtatëzani zhvillohet midis muajit të dytë dhe të tetë dhe mund të arrijë kulmin gjatë tremujorit të tretë të saj. Shtatëzanat përballen edhe me rrezik të rritur për dëmtim të dhëmbëve deri në ekstraktimin e tyre. Në rastet kur kemi komplikime të gingivitit mund të përdoren antibiotikë oral dhe kirurgji. Gjatë shtatëzanisë i kushtohet kujdes parandalimit të gingivitit: Praktikimi i një higjene të mirë orale, larje e dhëmbëve dy herë në ditë, përdorimi i pastave të dhëmbëve me fluoride që jep mbrojtje më të madhe, përdorimi i fijes dentare një herë në ditë. Zbatimi i një regjimi ushqimor të shëndetshëm me fruta, zarzavate, grurë i plotë ,produkte bulmeti,

mënjanimi i produkteve ushqimore që përmbajnë sheqer maja që dëmtojnë dhëmbët dhe gingivat. Aplikimi i gargarave me kripë deti që redukton inflamacioni dhe ndihmon në shërimin e gingivave, 1 lugë caji me kripë deti në i gotë me ujë. Kryerja e vizitave tek Stomatologu dy herë në vit.

Fjalë kyç: progresteroni, gingivit, shtatëzani.

RËNDËSIA E VAKSINËS ANTICOVID 19 TEK MOSHAT E REJA

Tone Sokoli-Imeraj, Mimoza Sinjari, Blegina Arapi, Aurora Xhixha, Majlinda Çuedari, Mejreme Ndreu, Gazmend Doda.
Departamenti i Laboratoreve NJVKSH Tiranë.

Abtrakt

Hyrje: Në Shqiperi rasti i parë me COVID-19 u konfirmua me 8 Mars 2020. Deri me 11 Janar 2021(dita e parë e vaksinimit antiCovid 19 në Shqipëri), janë konfirmuar 61705 raste dhe 1223 vdekje të shkaktuara nga COVID-19. Incidenca e sëmundjes deri në këtë datë 2155 raste për 100,000 banorë, ndërsa vdekshmëria 42.7 vdekje për 100000 banorë. Vdekshmëria më e lartë u vu re në grup moshën mbi 75 vjeç, ndërsa pesha më e madhe e infeksionit u vu re në grup moshën 55-64 vjeç.

Qëllimi: Rëndësia e vaksinës antiCovid 19, tek moshat e reja 18-35 vjeç, në dekursin e sëmundjes te personat Covid 19 pozitiv.

Materiali dhe metoda: U morën në studim 200 individë, mosha 18-35 vjeç, Covid 19 pozitiv: Grupi i parë 100 individë kishin marrë 2 doza vaksinë antiCovid 19; Grupi i dytë 100 individë nuk kishin marrë asnjë doze vaksinë antiCovid 19. U ndoq dekursi i sëmundjes për të gjithë individët(dy grupet).

Rezultati: Në grupin e parë, individët Covid pozitiv, që kishin marrë 2 doza vaksine antiCovid19: 5% gjendja më e rënduar (2 individë në spital me sëmundje kardiovaskulare); 15% me shenja të nivelit mesatar dhe 80% me shenja të lehta, ose pa shenja. Në grupin e dytë, individët Covid pozitiv, që nuk kishin marrë vaksinën antiCovid 19: 40% e tyre e kaluan rëndë sëmundjen (10% në spital-pothuajse të gjithë me sëmundje kronike: kardiovaskulare; pulmonare; renale; diabet etj); 45% me shenja të nivelit të mesëm dhe 15% me shenja të lehta, ose pa shenja.

Konkluzioni: Siç shihet nga rezultatet, edhe tek moshat 20-35 vjeç, individët Covid 19 pozitiv, që kanë marrë vaksinën antiCovid 19 kanë dekursin e sëmundjes më të lehtë krahasuar me individët Covid 19 pozitiv, që nuk kanë marrë vaksinën antiCovid 19. Vërehet lidhje e fuqishme dhe statistikisht e rëndësishme ndërmjet individëve Covid 19 pozitiv (të vaksinuar për Covid 19) dhe dekursit të sëmundjes. $p<0.001$.

Fjalë kyç: Vaksinë; Covid 19; Mosha 20-35 vjeç; Dekursi i sëmundjes.

ETHET E KAFSHIMIT TË MIUT, NJË SËMUNDJE E LËNË PAS DORE NË SHQIPËRI.

Tritan Kalo
Shërbimi i Sëmundjeve Infektive, QSUT "Nënë Tereza" (Shën Tereza), Tiranë.

Abstrakt

Hyrje: Vlerësimet nga Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve thonë se zona të mëdha metropolitane përjetojnë kafshime miu në shkallën 10 për 100 000 njerëz në vit. Kështu, qytetet e mëdha përbëjnë rreth 3000 deri në 4000 kafshime miu në vit. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë në Shqipëri raporton rreth 60 – 70 kafshime kafshësh në muaj vetëm në qytetin e Tiranës, por shumica prej tyre lidhen me kafshimet e qenve. Për momentin nuk kemi asnjë informacion statistikor për rastet e kafshimeve të riteve në Tiranë apo në qytetet e tjera të Shqipërisë. Shqetësimi kryesor i Autoriteteve tona të Shëndetit Publik (APSH) në lidhje me praninë e minjve në zonat urbane apo rurale, lidhet me frikën e një shpërthimi të mundshëm të: 1- Leptospirozës dhe/ose 2- Etheve hemorragjike me sindromën renale ndër popullsia e atyre zonave.

Qëllimi i këtij studimi retrospektiv është të paraqesë dhjetë raste me ethet e kafshimit të miut, e cila është ende një sëmundje e lënë pas dore dhe jo e njohur në Shqipëri.

Materiali dhe metoda: Në periudhën kohore nga janari 2011 deri në nëntor 2019, në Shërbimin e Sëmundjeve Infektive të QSUT janë diagnostikuar me ethe nga kafshimi i miut, dhjetë pacientë të moshës mesatare 37 vjeç, gjashtë meshkuj dhe për femra. "Nënë Tereza", dhe të gjithë ishin në ndjekje ambulatore.

Rezultatet: Në të dhjetë rastet u dëshmua pickimi i tyre nga një miu gri (Ratus ratus), i cili është një specie e përhapur shpesh në mjediset tona publike. Të gjithë ata paraqitën një lloj ethe të përsëritur 10-14 ditë pas kafshimit të tyre nga një mi gri, si dhe: dhimbje koke, mialgji, skuqje në pjesët e sipërme dhe të poshtme (në shumicën e rasteve të një lloji purpurik) dhe dhimbje poliartralgjie të tip migrator dhe shenja inflamatore të artikulacioneve interfalangeale (ënjtje, skuqje, dhimbje), pa asnjë shenjë radiologjike të artritit suppurativ.

Diskutim: Incidenca e infeksionit të plagës pas kafshimit të miut është raportuar të jetë shumë e ulët. Plaga primare zakonisht shërohet menjëherë, por pas një periudhe inkubacioni prej 1 deri në 22 (zakonisht < 10) ditë, një sindromë e ngjashme me virusin zhvillohet papritur, duke shkaktuar të dridhura, ethe, të vjella, dhimbje koke dhe dhimbje shpine dhe kyçesh.

Konkluzione: "Ethet e kafshimit të miut" është një sëmundje shumë e rrallë dhe duhet të merret parasysh pas çdo kafshimi nga një miu. Njohja dhe trajtimi i hershëm i RBF do të eliminonte evoluimin e tij drejt një forme septikemike të rënduar të sëmundjes, si dhe do të reduktonte vdekshmërinë, e cila varion nga 10-13% të rasteve. Ethet mund të kthehen, duke u shfaqur në mënyrë të parregullt gjatë një periudhe prej javësh deri në muaj.

Fjalë kyç: ethet e kafshimit të miut, RBF.

PROBLEMET E SHËNDETIT MENDOR GJATË PANDEMISË COVID-19 NË IRAN, INDI, SHQIPËRI DHE NIGERI

Valbona Alikaj, Elona Dashi[1], Valmira Skëndi[1]
[1]Departamenti i Neuroshkencës, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Hyrje: Pasi e tërë bota u përball me shfaqien e infektimit me coronavirusin e ri (COVID-19) në 31 Dhjetor 2019, Wuhan (KINE), rritja e informacionit dhe shqetësimit në popullatë ka sjellë ndikimin e saj në shëndetin mendor në mbarë njerëzimin. Është mëse e dukshme që, në rastet e infektuara apo dyshuara me COVID-19, përveç simptomave fizike, mjaft persona ndjejnë një presion psikologjik dhe probleme të tjera të shëndetit mendor. Efektet direkte dhe indirekte sociale dhe psikologjike të pandemisë coronavirus (COVID-19) janë pervazive dhe mund të prekin shëndetin mendor të individit në të tashmen dhe në të ardhmen. (Holmes et al., 2020) (Li et al., 2020).

Qellimi: Qëllimi kryesor i këtij studimi ishte të hetonim mbi prevalencën e problemeve te shëndetit mendor të lidhura me COVID-19 dhe problemet e zakonshme të shendetit mendor në popullatën e përgjithshme në katër shtete: Indi, Iran, Nigeri dhe Shqipëri.

Metoda: U realizua një pyetësor online 'cross-sectional' nëpërmjet 'google form' dhe një studim ndërkombëtar në këto shtete. U studiuan variablat demografikë dhe u administruan pyetësor për depresionin, ankthin, pagjumësinë, frikën nga coronavirus, ankthin nga coronavirus.

Rezultatet: Në analizën finale u përfshinë 1787 pjesmarrës (përjashtuan duplikatat 43 subjekte, 98 persona refuzuan dhe 23 të tjerë dorëzuan pyetësor të papërfunduar). Prevalenca e problemeve të shëndetit mendor ishte më e lartë në popullatën Iraniane në krahasim me popullatat e tjera. Frika, depresioni, ankthi dhe mosha ishin variabla të rëndsishëm për ankthin ndaj coronavirusit.

Konkluzione: Emergjenca ndaj problemeve të shëndetit mendor gjatë një pandemie është e zakonshme, ndonëse e vështirë për tu adresuar si për shkak të kompleksitetit te vet pandemisë edhe për mungesën e të dhënave për epidemiologjinë e problemeve të shëndetit mendor të lidhura me të dhe të ndërhyrjeve të nevojshme për trajtim.

Fjalët kyç: shëndeti mendor, pandemia, probleme.

PANORAMA SIMPTOMATOLOGJIKE E KLINIKE E PACIENTËVE ME COVID-19 NË PERIUDHËN POST AKUTE SI DHE NE LONG-COVID.

Valbona Gashi[1]
[1]Mjeke Infeksioniste,Spitali Hygeia Tirane

Abstrakt

Hyrje :Virusi SARS-COV2 është një virus tepër infektues i cili shkakton sëmundjen Covid-19.Pjesa më e madhe e popullatës kalojnë forma asimptomatike apo të lehta të infeksionit. Shumica e pacientëve që kalojnë sëmundjen e Covid-19 shërohen brenda 2-6 javësh, por disa zhvillojnë simptoma që zgjasin në kohë.Pacientë të tjerë që kalojnë forma të rëndë të sëmundjes,mund të bëjnë komplikacione të cilat kërkojnë hospitalizime ,apo/edhe rehabilitime të gjata pas hospitalizimit.
Pacientët të cilët kalojnë forma të lehta apo mesatare shpesh vetëshërohen ,por rrallë lënë sekuela apo simptoma të cilat zgjasin disa kohë.Simptomat përfshijnë:lodhje,dobësi e theksuar trupore,vështirësi në përqëndrim ,harresë,crregullim të humorit,gjumit,cefale,diarre apo të vjella,humbje të shijes,nuhatjes,tharje fyti,vështirësi në gëlltitje,rash cutan,cefale,dispne,palpitacione,shfaqje e diabetit mellitus apo të HTA.
Këto simptoma zgjasin nga disa javë-disa muaj,dhe mund të shfaqen dhe në persona në moshë të re,apo pa sëmundje shoqëruese.
Sipas WHO 20% e personave nga 18-34 vjec raportojnë simptoma të covidit të zgjatur.
Rreth 10-15% e pacientëve që kalojnë Covid-19 mund të zhvillojnë forma të rënda të sëmundjes,rreth 5% forma kritike .Këto pacientë zhvillojnë më së shumti simptomat e covidit të zgjatur.Prekjet organore më të shpeshta janë:
-Mushkritë: dispne apo fibroza pulmonare.
-Sistemi kardio-vaskular:rreth 20-30% e pacientëve të hospitalizuar mund të zhvillojnë prekje të muskulit të zemrës(miokarditis),perikarditis,TVT apo TEP.
-Sistemi nervor:nevralgi,dëmtime të koshiencës.
Pacientët që kanë patur hospitalizime të gjata ,apo janë trajtuar me ventilim mekanik kanë rrisqe më të larta për simptoma të zgjatura të covidit,dhe kërkojnë suport apo rehabilitim.
-Efektet long-term të Covid-19 në shëndetin mendor përfshijnë stresin,ankthin,depresionin ,crregullimet e gjumit,traumen psikologjike apo crregullimet e stresit post-traumatik.

Qëllimi:Të njihen dhe të evidentohen sa më shpejë simptomat e Covidit të zgjatur në pacientët të cilët paraqiten me ankesa jo specifike ne vizitë.
Të orientohen drejt diagnozës dhe shërbimit përkatës pacientët me këto simptoma për të përfituar maksimalisht në trajtimin e sëmundjes

Konkluzioni:Infeksioni nga SARS-COV2,i cili shkakton Covid-19 paraqet një gamë të madhe të simptomave,që zgjasin në kohë deri në 1 vit,me prekje të shumtë organore,ku më të shpeshtat janë ato kardiake,pulmonare dhe të sistemit nervor.

Fjalë kyç: SARS-COV2 , sistemi nervor.

TRAJTIMI ME INFLIXIMAB NË PACIENTËT ME ARTRIT REUMATOID

V.Salko, A.Zoto, E.Rapushi, T.Backa, A.Ndoja

Abstrakt

Hyrje: Artriti reumatoid është një sëmundje inflamatore kronike sistemike që karakterizohet nga dhimbja dhe enjtja e artikulacioneve sinoviale,shkatërrim i tyre si dhe manifestime të tjera ekstraartikulare, që mund të cojë në invaliditet dhe deri në vdekje të parakohshme. Diagnostikimi i hershëm dhe fillimi i terapisë së duhur janë të domosdoshme për të parandaluar dëmtimin e strukturës artikulare dhe uljen e cilësisë së jetesës. Barnat kyce për të reduktuar sinovitin dhe inflamacionin sistemik dhe që përmirësojnë funksionin janë barnat

modifikues të sëmundjeves(DMARDs). Biologjikët zënë një pjesë shumë të rëndësishme të këtij grupi. Ato janë proteina inxhinierike që vijnë nga gjene humane dhe imitojnë funksione të caktuara,në pacientët me AR reduktojnë dhe rregullojnë përgjigjen inflamatore qe shkakton artritin. Infliksimabi është një preparat biologjik që bllokon veprimin e TNF-alfa në patogjenezën e arthritit rheumatoid duke ulur ndjeshëm aktivitetin e sëmundjes.

Qëllimi : Investigimi i efektit dhe sigurisë së trajtimit me Infliximab në aspektin klinik dhe laboratorik në pacientët me Artrit Rheumatoid,tek të cilët kanë dështuar terapitë me DMARDs konvencional(MTX)

Metodologjia : Ky është një studim kohort prospektiv ku janë përfshirë 37 pacientë me AR në aktivitet, sipas kritereve të ACR/EULAR, në periudhën korrik 2015-nëntor 2018. Të dhënat janë marrë nga kartelat në shërbimin e Reumatologjisë QSUT, të hospitalizimeve ditore të këtyre pacientëve. Të gjithë pacientët kanë përdorur më përpara MTX. Infliximabi është administuar me perfusion IV me cikle 0-2-6-dhe më pas cdo 8 javë. Për vlerësimin e aktivitetit të sëmundjes është përdorur sistemi DAS28(ERS). Gjithashtu u monitorua modulimi i vlerave te PCR,FR,anti-CCP,fibrinogjrni dhe korelacioni i mundshëm midis tyre.

Rezultatet: Mosha mesatare (±SD) e pacientëve është 49.8 vjec (±11.7). Kohëzgjatja mesatare (±SD) e sëmundjes është 8.1 vite (±4.2). Paciente femra janë 32 (86%) dhe meshkuj janë 5 (14 %).Përpara trajtimit 33 pacientë (89.19%) ishin me aktivitet të lartë DAS 28 > 5.1 dhe 4 paciente(10.81 %) me aktivitet të moderuar DAS 28 < 5.1 dhe > 3.2.Ndërkohë që pas trajtimit me infliximab rezultoi 1 pacient (2.7 %) me aktivitet të lartë,29 pacientë (78.38%) me aktivitet të moderuar të sëmundjes dhe 7 pacientë (18.92%) me aktivitet të ulët ose në remision.Vlera mesatare e DAS28 në fillim të trajtimit ishte 5.71(±0.45) dhe pas trajtimit 4.08(±0.73).Vlera mesatare e ERS u ul me 42%,PCR me 42.7% dhe fibrinogjeni me 5.5%.Përsa u përket autoantitrupave pati një reduktim 43% të vlerës mesatare të FR dhe 9% të vlerës se anti-CCP.

Konkluzioni: Trajtimi me infliximab në pacientët me AR,refraktarë ndaj trajtimit me MTX rezultoi efikas dhe i sigurtë në uljen e aktivitetit të sëmundjes. Gjithashtu ndikoi ndjeshëm në modulimin e vlerës së FR dhe PCR, pa ndikim sinjifikant në modulimin e anti-CCP dhe fibrinogjenit. Nuk u evidentua korelacion ndërmjet markuesve të inflamacionit dhe autoantitrupave.

Fjalë kyç: Artriti reumatoid, infliximab.

PSIKOTERAPIA NË SHQIPËRI: LUKS APO DOMOSDOSHMËRI?! SFIDA DHE BARRIERA KULTURORE!

Valmira Skendi[1], Valbona Alikaj[2], Elona Dashi[3]
[1]Psikologe klinike, PhD. Shërbimi i Psikiatrisë së Fëmijëve/Adoleshentëve. QSU "Nënë Tereza" Tiranë.
[2]Psikiatre për fëmijë/adoleshentë., Proff.asc., Pedagoge e brendshme, Fakulteti i Mjekësisë
[3]Mjeke psikiatre për fëmijë dhe adoleshentë.

Abstrakt

Profesioni i psikologut në Shqipëri përbën profesion relativisht të ri, por të domosdoshëm për shoqërinë. Gjatë 20 vjetëve të fundit kanë ndodhur zhvillime të rëndësishme në fushën e psikoterapisë psh., lulëzimi i psikoterapive konjitivo-biheviorale që ndryshonin prej terapive psikodinamike. (Suli A., 2000). Psikoterapia si modalitet trajtimi ka lindur më vonë në Shqipëri.

Psikoterapia merret me trajtimin e psikopatologjike të ndryshme si trajtim i linjës së dytë ose linjës së parë. Psikoterapeuti shpesh është një person (psikolog, psikiatër) që specializohet në psikoterapi (Elyssa Barbash, 2017). Psikoterapia është quajtur ndryshe edhe kura e shpirtit apo kurim nëpërmjet marrëdhënies (Hysenaj I., 20013).

Objektivi dhe metoda: Ky mini studim përbën një reflektim teorik panoramik që ka për synim të sjellë në vëmendje mbi disa çështje të psikoterapisë dhe për të theksuar rëndësinë e saj si nevojë më tepër se luks (Charles-Albert Morin, 2016). A kanë nevojë shqiptarët për pikoterapi? A e përballojmë dot koston financiare të psikoetarpisë dhe a kemi mjaftueshëm profeionistë të kualifikuar për të ofruar këtë modalitet trajtimi psikoaterapi? A ka instrumenta matës për rezultatin e terapisë?

Rezultate: Psikoterapia në Shqipëri është larg të qënit një kulturë massive (Pango Y., 2004) ndërsa në botë shumëkush ka psikologun personal, në Shqipëri përbën ende risi të flasësh për psikoterapinë e aq më tepër të ketë një prirje të popullatës për të kërkuar ndihmë terapeutike dhe për shëndetin e mendjes ka ende njohje të përcipta. Nuk ka ende një ligj që rregullon psikoterapinë si profesion, përveçse atyre që rregullojnë praktikën private.

Konkluzion: Profesioni i terapistit kërkon profesionalizëm, etikë, kohë e durim, megjithatë, klinikat psikoterapeutike në Tiranë mbeten ende një luks.

Fjalë kyç: psikoterapive konjitivo-biheviorale.

IDENTIFIKIMI I TEKNIKAVE TË PËRBALLIMIT TË SITUATËS TEK PRINDËRIT E FËMIJËVE ME AUTIZËM

Dr. VenetikeMerkaj[1], Dr. Brizida Refatllari[1], Dr.Ergeta Nika Ktona [1] M.a. Fjorda Dragoti[2]

[1]Universiteti i Mjekësisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Tiranë
[2]Qëndra Kombëtare e Mirërritjes Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve, Tiranë.

Abstrakt

Hyrje: Prindërimi ndaj një fëmije me autizëm është një eksperiencë stresuese duke filluar që nga momenti i njohjes me diagnozën, e në vazhdimësi gjatë gjithë jetës. Prindërit e fëmijëve me autizëm, përdorin stile të ndryshme të përballimit të situatës. Studimet kane treguar se teknikat konsiderohen si faktor mbrojtës, suporti social si ai real dhe ai i perceptuar mund të konsiderohet si një faktor lehtësues, që ndihmon në reduktimin e nivelit të stresit.

Qëllimi: Ky studim ka si qëllim identifikimin e teknikave të përballimit (sjelljet) tek nënat dhe baballarët e fëmijëve me autizëm dhe krahasimin ndërmjet nënave dhe baballarëve për teknikat e përdorura. Sjelljet reflektojnë përpjekjet prindërore për të kuptuar dhe përdorur informacionin e dobishëm për përballimin e sëmundjes të anëtarit të familjes.

Metodologjia: Studimi është sasior, instrumenti i përdorur në këtë studim është Inventari i Sjelljeve Përballuese Për Prindërit. Ky pyetësor i përdorur tek 80 prindër të fëmijëve me autizëm ka 45 çështje të ndara në 3 nënshkallë: (1) Nënshkalla e parë përcaktohet si: ruajtja e integritetit familjar, bashkëpunimi, si dhe përcaktimi optimist i situatës. (2) Nënshkalla e dytë përcaktohet si: mbështetja sociale, vetëvlersimi dhe stabiliteti psikologjik. (3) Nënshkalla e tretë përcaktohet si kuptueshmëria e situatës mjekësore.

Rezultatet: Nga studimi rezultoi se teknikat e integrimit familjar janë përdorur më tepër, më pas teknikat e mbështetjes sociale dhe më pas ato të kuptueshmërisë së situatës. Nga studimi nuk rezultoi ndonjë ndryshim sinjifikativ në përdorimin e teknikave të përballimit të situatës mes nënave dhe baballarëve të fëmijëve me autizëm, jo vetëm në total, por dhe për nënshkallët e (1) integrimit familjar, (2) mbështetjes sociale dhe (3) kuptueshmërisë së situatës. Vihen re ndryshime sinjifikative në teknika të veçanta të këtyre nënshkallëve (por siç u përmend më lart në total nuk ka ndryshime). Në pyetësorin e inventarit të sjelljeve të përdorur, prindërit kanë përcaktuar si shumë të nevojshme: së pari (1) teknikat e integrimit të familjes, kooperimit, përcaktimit optimist të situatës; së dyti (2) kuptueshmërisë së situatës dhe së treti (3) mbështetjen sociale. Nënat kanë përdorur më tepër teknikat e integrimit të familjes dhe kuptueshmërisë së situatës dhe më pak teknikat e mbështetjes sociale.

Konkluzione: Studimi tregoi se pavarësisht se nuk ka ndryshime sinjifikative në përdorimin e teknikave në total, vihen re ndryshime sinjifikative në disa teknika të veçanta të këtyre nënshkallëve: Angazhimi në marrëdhëniet, punësimi jashtë shtëpisë, përfshirja në aktivitete sociale, ku baballarët i përdorin më tepër këto teknika. Ndërsa nënat përdorin më tepër këto teknika me ndryshim sinjifikativ krahasuar me baballarët: kujdesin për pajisjet, të ushqyerit, besimin në Zot, zhvillimin e vetes si person, bërjen e aktiviteteve bashkarisht në familje, investim i kohës në punë.

Fjalë kyç: autizëm, prindërim, bashkëpunim.

EFEKTI I KËSHILLIMIT NË GRUP KUNDREJT STRESIT TEK NËNAT Ë FËMIJËVE ME AUTIZËM

Dr. VenetikeMerkaj[1], Dr. Brizida Refatllari[1], Dr.Ergeta Nika Ktona[1], M.a. Fjorda Dragoti[2]
[1]Universiteti i Mjekësisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Tiranë
[2]Qëndra Kombëtare e Mirërritjes Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve, Tiranë.

Abstrakt

Hyrje: Studimet kanë treguar se prindërit e fëmijëve me autizëm, përjetojnë nivel të lartë të stresit, ankthit dhe depresionit. Prindërit e fëmijëve me autizëm, kanë nivele më të larta të depresionit, krahasuar me prindërit e fëmijëve kliniksht të shëndetshëm ose prindërit me probleme të tjera zhvillimi, si dhe nivele më të larta të ankthit. Në një studim të kryer tek 140 nëna me fëmijë dhe adoleshentë të moshës 3 vjeç-16 vjeç me çrregullime të spektrit autik, për të vlerësuar lidhjen e simptomave të ankthit dhe depresionit me problemet e sjelljes të fëmijëve dhe adoleshentëve rezultoi se problemet e sjelljes rrisin stresin prindëror, i cili interferon në vetë-efikasitetin prindëror dhe në mënyrë të vazhdueshme rrit ndjenjat e ankthit dhe depresionit tek nënat e fëmijëve me autizëm. Simptomat e çrregullimit të spektrit autik mund të ndikojnë eksperiencat prindërore, veçanërisht në terma e stresit, i cili lidhet me

rritjen e fëmijëve me çrregullime të spektrit autik dhe efektet e një stresi të tillë ndikojnë në perceptimet dhe kompetencat prindërore.

Qëllimi: Ky studim ka si qëllim të vlerësojë efektin e këshillimit në grup kundrejt stresit që shfaqin nënat e fëmijëve me autizëm. Qëllimi i programit të këshillimit me fokus manaxhimin e stresit ka qënë: reduktimi i simptomave të stresit, edukimi i nënave rreth natyrës dhe efekteve të tij, si dhe mësimi i një sërë aftësish intrapersonale dhe interpersonale në përballjen me të në mënyrë konstruktive.

Metodologjia: Studimi është sasior. Prindërit e përfshirë në proçesin e këshillimit janë 12 nëna të fëmijëve me autizëm 3- 6 vjeç, të cilat shërbyen si grup eksperimental dhe 12 nëna të grupit të kontrollit, të cilat nuk u përfshinë në proçesin e këshillimit në grup. Si instrumentet matës para dhe pas seancave të këshillimit është përdorur DASS (Shkalla e Ankthit, Stresit, Depresionit (Lovibond & Lovibond, DASS 42). Numri i seancave të këshillimit 16, për një periudhë dy mujore. Në këtë studim nuk është përdorur një drejtim i vetëm teorik, por është përdorur një këndvështrim eklektik. Disa nga tipet kryesore të terapive, ku është bazuar proçesi i këshillimit në grup kanë qënë: elementë të terapisë kognitive biheviorale, humaniste nën një model ndërhyrje psiko-edukues.

Rezultatet: Rezultatet treguan se nënat e fëmijëve me autizëm të përfshirë në proçesin e këshillimit në grup shfaqin nivel më të ulët të simptomave të stresit krahasuar me nënat, të cilat nuk përfshihen në proçesin e këshillimit. Nënat e grupit eksperimental treguan një reduktim të simptomave të stresit, një reduktim të simptomave të depresionit me ndryshim sinjifikativ, reduktim të simptomave të ankthit, por jo me ndryshime sinjifikative. Vërehet që pikëzimi i shkallës totale te DASS tek prindërit e fëmijëve autikë është më i ulët pas këshillimit krahasuar me nivelin e DASS para periudhës së këshillimit me ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre, $p<0.0$.

Konkluzione: Programi i këshillimit në grup, tek grupi i nënave të përfshira në proçesin e këshillimit rezultoi efikas duke reduktuar në mënyrë sinjifikative simptomat e stresit dhe depresionit.

Fjalë kyç : autizëm , stresi ,DASS.

ENIGMA KOMPLEKSE E QASJES TERAPEUTIKE Të DISLIPIDEMISë Në SëMUNDJEN RENALE KRONIKE (SRK)

Vilma Cadri

Abstrakt

Prevalenca globale e sëmundjes renale kronike(SRK) vazhdon të rritet progresivisht si pasojë e rritjes së prevalencës së diabetit, hypertensionit, obesitetit, rritjes së jetëgjatësisë, dhe së fundmi dhe pandemia COVID-19. Të dhënat e fundit tregojnë që prevalenca globale e SRK sot është 13.4% (11.7-15.1%) ndërkohë që prevalenca e SRK në Shqipëri sot është 9.5%. SRK sot klasifikohet faktor risku i panvarur për sëmundje kardio-vaskulare (SKV), ndërkohë SKV vazhdon të mbetet edhe në ditët e sotme shkaku kryesor i mortalitetit në SRK kështu që bashkëegzistenca e SRK dhe SKV te i njëjti pacient do shpërthente stuhinë perfekte. Hallka lidhëse ndërmjet dy sëmundshmërive është dislipidemia. Dislipidemia është faktori më i rëndësishëm i riskut i modifikueshëm që përmison outcomin kardio-vaskular në pacientë me SRK.

Crregullimi lipidik starton herët përgjatë progresionit të SRK dhe njëkohësisht është heterogjen ndërmjet stadeve të ndryshme të SRK. Profili tipik lipidik në SRK karakterizohet nga rritja e triglicerideve, ulja e HDL-Cholesterolit, dhe ulje minimale ose aspak ndryshim i vlerës së LDL-Cholesterolit. Menaxhimi i riskut kardio-vaskular është prioritet në pacientë me SRK dhe vlerësimi i këtij risku devijon nga vleresimi i riskut kardio-vaskular në popullatën e përgjithshme pasi këtu braktisen nivelet target të lipideve që synohen si objektiv. Ky vlerësim risku në pacientët me SRK bazohet në riskun absolut për të manifestuar event koronar, moshën dhe klirensin e kreatininës së pacientëve. Rekomandohet profil lipidik i plotë për cdo pacient SRK që prezantohet për herë të parë ndërkohë nuk rekomandohet ndjekjeve e vlerave të tyre në dinamike për subpopullaten tonë të pacientëve. Menaxhimi i dislipidemisë në pacientët me SRK bazohet në guidelinet e praktikës klinike të përditësuara nga KDIGO në 2013 që trajton menaxhimin lipidik dhe trajtimin e adultëve ku përfshihen të gjitha format E SRK.
Trajtimi i pacientëve me SRK është sfidues si pasojë edhe e problemeve komplekse mjekësore që i bashkëshoqëron edhe si pasojë e ndryshimeve të shpejta që ndodhin në dekursin dhe progresionin e SRK. KDIGO 2013 tregoi përfitim të qartë të trajtimit me statine\statine-ezetimibe në stadin 1-5 (jo paciente ne dialize) dhe pacientë të transplantuar, ndërkohë që ky përfitim nuk shihet dhe nuk konfirmohet si trajtim në pacientë me dializë kronike, kryesisht si pasojë e riskut të tepruar konkurrues.

Fjalë kyç: Sëmundja renale Kronike (SRK), Semundja Kardio-Vaskulare(SKV), Dislipidemia

"SARKOMA KAPOSI FAMILJARE, GJATË COVID-19" RASTI I PARË NË SHQIPËRI

D.SH.M Violeta Dajci[1], Dr.Briseida Ziu[1] , Dr. Ada Dajci[2], D.SH.M. Ardiana Sinani[3]

[1] Klinika Dermatologji-Venerologji, Qëndra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"
[2] Departamento di chirurgia vascolare e endovasculare, Policlinico UmbertoI Universita "La Sapienza Roma"
[3]Spitali i Traumës, Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Sarkoma Kaposi është një tumor angio-proliferativ i cili prek qelizat endoteliale të enëve të gjakut dhe sistemit limfatik. Sëmundja prek lëkurën dhe mukozat. Sarkoma Kaposi ka incidencë te ulet, por rastet familjare janë akoma më të rralla. Prekja kutane karakterizohet fillimisht nga macula në ngjyrë të kuqe të cilat zmadhohen në pllaka me ngjyrë kafe dhe më vonë në noduse jo te dhimbshëm kryesisht në ekstremitetet inferiore me ngjyrë violetë. Vihen re katër forma të Sarkoma Kaposi 1. Forma klasike 2. Forma endemike 3. Forma e varur nga Terapia me Imunosupresorë 4.Forma e lidhur me Sindromen e imunodeficences.

Prezantim Rasti: Pacienti mashkull, 68 vjec, me iniciale P. R,paraqitet në shërbimin e Dermatologjisë me noduse të shumtë në ngjyrë të kuqe-violetë në anësitë e poshtme, të sipërme dhe në trung. Pacienti referon për shfaqjen e këtyre elementeve në mënyre të menjeherëshme gjatë mjekimit me imunosupresorë në spitalin rajonal Lezhë për Covid-19 rreth 3 muaj para paraqitjes në pavionin tonë. Ne anamnezën familjare u gjet qe i ati ishte diagnostikuar dhe trajtuar për Sarcoma Kaposi para 10 vitesh. Pas shtrimit në Kliniken Universitare te Dermato-Venerologjise, pacientit ju moren të gjitha ekzaminimet dhe biopsia

kutane. Rezultoi: HIV-negativ dhe biopsi Sarcome Kaposi, faza nodulare. Pacienti u transferua për trajtim në Klinikën Onkologjike.

Konkluzione: Sarkoma Kaposi është një patologji malinje, e cila në rastin tonë shfaq predispozitë gjenetike dhe ku kompromentimi i gjendjes imunitare për arsye të infeksionit me COVID-19 dhe trajtimi me kortikosteroide kanë shërbyer si faktorë shperthyes i patologjise.

Diskutim: Rasti i raportuar aludon për një lidhje të fortë të sëmundjeve dermatologjike me Covid-19 dhe është shembull tipik i shfaqjes së një patologjie në mënyre agresive I ndikuar nga faktorë imunosupresiv.

Fjalë kyç: Sarkoma Kaposi, Covid-19, Kortikosteroide, Trashëgueshme.

"PREHABILITIMI", NJË PËRQASJE MULTIMODALE QË KONTRIBUON NË PËRMIRËSIMIN E ECURISË POSTOPERATORE TË PACIENTËVE KIRURGJIKALË ADULTË

Vjollca Shpata[1], Xhensila Prendushi[3], Alma Nurçe[3], Nertila Kodra[2], Klejda Tani[1]
[1]Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit, Universiteti i Sporteve i Tiranës.
[2]Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë.
[3]Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Abstrakt

Hyrje: "Prehabilitimi" është një përqasje multimodale që fokusohet në nutricionin dhe ushtrimet fizike. Tashmë është provuar që kontribuon në përmirësimin e ecurisë postoperatore të pacientëve kirurgjikalë adultë.

Qëllimi i studimit: Të vlerësojë ndikimin e riskut nutricional të rëndë dhe patologjive të mëparshme të pulmoneve në komplikacionet postoperatore të pacientëve pas kirurgjisë abdominale.

Metoda: Studim prospektiv i kryer në Shërbimin e Kirurgjisë së Përgjithshme në QSUNT, në pacientët që iu nënshtruan kirurgjisë abdominale.

Rezultatet: Studimi përfshiu 540 pacientë kirurgjikalë, mosha mesatare 62.3 ± 12.5 vjeç, 318 meshkuj (58.9%). Nga 540 pacientë, 276 (51.1%) ishin në risk nutricional të rëndë (SNR) (përqëndrime të ulëta të albuminës serike dhe/ose humbje të paqëllimshme në peshë e kohëve të fundit). SNR rrit riskun për komplikacione postoperatore (OR: 2.14, 95% CI: 1.51-3.05, P < 0.0001), respektivisht pulmonare (OR: 2.65, 95% CI: 1.80-3.89, P < 0.0001), dhe komplikacione kirurgjikale (OR: 3.53, 95% CI: 2.06-6.04, P < 0.0001).
Pacientët me sëmundje të mëparshme të mushkërisë (11.5%) demonstruan një risk më të rritur për komplikacione pulmonare pas kirurgjisë (OR: 10.46, 95% CI: 5.56-19.65, P < 0.0001) dhe për komplikacione kardiovaskulare (OR: 2.30, 95% CI: 1.26-4.21, P = 0.006).
Asnjë nga pacientët nuk mori suport nutricional pre-operator, pavarësisht riskut të rëndë nutricional.

Konkluzionet: Sëmundjet e mëparshme pulmonare ose risku nutricional i rëndë ndikojnë negativisht ecurinë e pacientëve adultë pas kirurgjisë abdominale. "Prehabilitimi" mund të sjellë përfitime në ecurinë e pacientëve, veçanërisht në pacientët me sëmundje të mëparshme

të pulmoneve dhe me risk nutricional të rëndë, të cilët kanë një rezervë të ulët funksionale dhe fiziologjike, dhe për pasojë një risk më të rritur për komplikacione postoperatore.
Masat parandaluese për optimizimin e gjendjes pre-operatore duhet të përfshijnë terapinë mjekësore, por gjithashtu edhe trajnimin e muskujve inspiratorë, fizioterapinë respiratore dhe suportin nutricional pre-operator.

Fjalët kyç: kirurgji abdominale, risk nutricional i rëndë, prehabilitimi, komplikacionet postoperatore, fizioterapia respiratore, suporti nutricional.

SI TË ARRIHET NJË PAMJE RINORE NË ZONËN PERIORBITALE?

Vladimir Filaj[1], Ina Kola[2], Erisa Kola[3]
[1]Departamenti i Djegieve dhe Kirurgjise Plastike, Qendra Spitalore Nene Tereza, Tirane, Shqiperi
[2]Departamenti i Djegieve dhe Kirurgjise Plastike, Qendra Spitalore Nene Tereza, Tirane, Shqiperi
[3]Departamenti i Patologjisë, Spitali Gjirokastër, Shqipëri

Abstrakt

Syri është një komponent i rëndësishëm i estetikës së fytyrës dhe blefaroplastika mund të luajë një rol jetik në harmonizimin e fytyrës dhe procesin e plakjes. Blefaroplastika është një nga procedurat kozmetike më të zakonshme të fytyrës, e vetme ose e kombinuar me operacione të tjera estetike si ngritja e vetullave ose heqja e fytyrës ose përtëritje të tjera të fytyrës dhe lëkurës. Vlerësimi i ankesave të pacientit duhet të verifikohet gjatë shikimit në pasqyrë. Janë bërë fotografi para operacionit që përfshijnë një pamje të përparme, anësore dhe një pamje nga afër të syve. Shikimi lart ndihmon në vlerësimin e sasisë së lëkurës së tepërt në kapakun e sipërm dhe yndyrës së tepërt orbitale në kapakun e poshtëm respektivisht. Ne përdorim testet e shpërqendrimit dhe "kthimit të shpejtë" për të ekzaminuar dobësinë e qepallës së poshtme. Ky prezantim synon të ofrojë një përmbledhje të teknikave të blefaroplastikës së qepallës së sipërme dhe të poshtme me disa prezantime të rasteve të ilustruara, përzgjedhjen e duhur të pacientëve, planifikimin e përpiktë paraoperativ, duke përfshirë matjet e sakta dhe vëzhgimin e çdo asimetrie në tiparet e fytyrës, vlerësime të kujdesshme të anatomisë periorbitale dhe shenjave të plakja, këshilla se si të menaxhoni komplikimet dhe për pacientët më të kënaqshëm.

Konkluzione: Blefaroplastika e sipërme dhe e poshtme janë operacione teknikisht kërkuese që kërkojnë planifikim të kujdesshëm dhe ekzekutim të përpiktë për të arritur rezultate optimale dhe për të shmangur komplikimet.

Fjalë kyç: blefaroplastika.

KANCERI MEDULAR I TIROIDES. DIAGNOZA/ TRAJTIMI/ NDJEKJA.

Justina Sinani[1], Xheladin Draçini[2], Dorina Ylli[2], Adela Haxhiraj[2], Agron Ylli[2].
[1]Student – Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë Tiranë.
[2]Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Q.S.U "Nënë Tereza", Tiranë.

Abstrakt

Hyrje: Kanceri medullar i tiroides (MTC) është një tumor neuroendokrin i qelizave parafolikulare ose ndryshe qelizave C të gjëndrës tiroide. MTC mund të jetë sporadike (75%) ose familjare (25%) dhe përbën rreth 5% të kancereve të tiroides. Për këtë arsye prognoza është e vështirë. Ky lloj kanceri zakonisht përparon nga tiroidet në nyjet limfatike. Nëse nuk diagnostikohet herët mund të përhapet në inde të tjera të qafës dhe përfundimisht të arrijë në mëlçi, mushkëri, kockë dhe tru. Sa më e madhe të jetë përhapja në pjesët e tjera të trupit, aq më i ulët është probabiliteti për shërim. Prandaj diagnostifikimi i hershëm është thelbësor për të pasur një perspektivë sa më pozitive për shërimin e tij.

Qëllimi: Mënyra për diagnostikimin e hershëm të MTC, trajtimin dhe ndjekjen e tij.

Metodologjia: MTC mund të jetë sporadike ose familjare. Forma familjare mund të jetë e izoluar ose shprehje e një neoplazie endokrine multiple të tipit II. Mutacionet e proto-onkogjenit RET janë identifikuar në ADN-në e brezit të pacientëve me sindromën MTC familjare. Testimi gjenetik mund të identifikojë pacientët e prekur, duke lejuar diagnozën e hershme dhe kurimin e mundshëm. Trajtimi fillestar është kirurgjikal dhe operacioni adekuat konsiston në tiroidektominë totale. Matjet e kalcitoninës në plazmë janë tregues të shkëlqyer për ndjekjen pas operacionit. Studimi i imazherisë mund të ndihmojë në zbulimin e sëmundjeve të përsëritura ose metastatike. Terapia ndihmëse përfshin radioterapi dhe kimioterapi. Radioterapia është e rezervuar për metastazat e kockave ndërsa kimioterapia për pacientët me MTC progresive.

Rezultate: Prodhimi i kalcitoninës është një tipar karakteristik i këtij tumori. Diseminimi metastatik në nyjet limfatike qendrore dhe latero-cervikale ndodh në deri në 90% të pacientëve me një tumor më të madh se 4 cm në diametër. Niveli i kalcitoninës mund të përdoret si faktor prognostik. Shumë regjime kimioterapeutike janë provuar dhe rezultatet janë akoma të diskutueshme.

Fjalë kyç: endokrinologji, kanceri i tiroides, qeliza parafolikulare, nyje limfatike, prognoza, kalcitonina, tiroidektomia, radioterapi, kimioterapi.

QËLLIMI DHE APLIKIMI I AFEREZËS TERAPEUTIKE: EKSPERIENCA E QENDRËS KOMBËTARE TË TRASFUZIONIT TË GJAKUT.

Xh.Beqoviq, D.Kroni, A.Dukaj

Abstrakt

Hyrje: Ne po paraqesim përvojën tonë përgjatë 10 viteve të fundit (2009-2021), përgjigjen klinike dhe komplikacionet e hasura gjatë proçedurës së aferezës terapeutike (TA), e cila kryhet në rast indikacionesh të ndryshme pranë Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut. Studimi është një analizim në retrospektivë i 1030 proçedurave të aferezës terapeutike (TA), të aplikuara në 234 pacientë përgjatë periudhës Janar 2009-Tetor 2021. Për secilin pacient janë regjistruar të dhënat: si mosha, gjinia, pesha, indikacioni klinik, matjet para nisjes së proçedurës: si matja e HTC, presioni arterial i gjakut dhe frekuenca kardiake. Për secilën proçedurë të kryer, u analizuan këto parametra: lloji i aksesit venoz (qendron/preiferik), vëllimi i gjakut dhe plazmës së proçesuar, sasia e antikoagulantëve të përdorur, lloji dhe sasia e likidit zëvendësues, përgjigja ndaj terapisë dhe efektet anësore/ reaksionet e mundshme.

Prej 1030 proçedurave të aferezës terapeutike të kryera 59% u kryen për patologji neurologjike, 31% për ato hemato-onkologjike, 5% nefrologjike,1% patologji imunologjike dhe 4% ishin patologji të ndryshme. Shumica e pacientëve i përkisnin kategorisë ASFA I dhe II (n=132,78%).
Zakonisht, 30-40 ml/kg ishte sasia e plazmës së hequr (1-1.5 e vëllimit plazmatik) në secilën procedurë dhe më pas u zëvendësua me solucion izotonik 5% albumin humane (100% e pacientëve morën solucionin e albuminës humane-HAS si likide zëvendësuese, numri gjithsej i HAS të përdorur përgjatë 10 viteve ishte 3049 njësi me 500 ml dhe 3401 njësi me 250 ml).
Shkalla e përgjithshme e përgjigjes ishte 96.5%, me përgjigje domethënëse në TTP (92.31% pa rekurenca pas një numri mesatar të 14 sesioneve TPE të kryera) dhe çrregullimet neurologjike (95.8%, u vunë re vetëm 2 rekurenca 1-3 vjet pas kryerjes së ciklit të parë të TPE). Efekte anësore gjatë dhe pas procedurës u raportuan në 15.4% të pacientëve dhe në 7.73% të proçedurave. Manifestimet më të shpeshta ishin hipotensioni, bradikardia dhe tremor.

Konkluzione: Rezultatet tona për TPE në crregullimet neuorologjike, PTT dhe sindormin nefritik janë inkurajuese. Aktualisht lind nevoja për krijimin e Regjistrit Kombëtar të Aferezës për të bërë të mundur shtrirjen e indikacioneve të përshtatshme dhe të aplikueshme për TPE, TA në të gjithë vendin me qëllimin përfundimtar aplikimin e Citoaferezës.

Fjalë kyç: afereza terapeutike, transfusion i gjakut.

NDIKIMI AFATGJATË I INFEKSIONIT COVID-19 NË SHËNDET

Autorët: Xhensila Prendushi[1], Vjollca Shpata[2], Najada Gjylameti[3], Alketa Domi[3].
[1] *Universiteti i Mjekësisë, Tiranë (UMT)*
[2] *Universiteti i Sporteve, Tiranë (UST)*
[3]*Qëndra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" (QSUNT)*

Abstrakt

Hyrje: Pandemia e COVID-19, e njohur gjithashtu si pandemia e koronavirusit, vazhdon të jetë ende prezente dhe u identifikua për herë të parë në Dhjetor 2019 në Wuhan, shkaktuar nga virusi i sindromit të rëndë respirator akut (SARS-CoV-2). Sindromi i zgjatur i Covid-it është një term përgjithësues për të treguar vazhdimësinë e simptomave tek individët që janë shëruar nga infeksioni SARS-CoV-2.

Materiali dhe metoda:U mblodhën e u përpunuan rezultatet e një sondazhi të kryer online, nga 425 individë që zgjodhën të jepnin pëlqimin, të merrnin pjesë në projektin kërkimor dhe t'i përgjigjeshin pyetësorit tonë.

Rezultatet: Gjithnjë e më tepër po pranohet se SARS-CoV-2 mund të prodhojë komplikacione afatgjata, pas shërimit të infeksioni akut. Raporti përmbledh analizën e simptomave afatgjata, të vetë-raportuara nga një grup popullate të përbërë nga 237 raste COVID-19+ konfirmuar nga testet laboratorike dhe 52 individë të patestuar. Të dhënat e individëve që futën informacione kontradiktore ose shfaqën simptomat e para të Covid-19 jo më herët se 3 muaj përkatësisht nga fillimi i studimit, u përjashtuan. Shumica e rasteve tona me COVID-19+ janë forma klinike të lehta e mesatare, ku vetëm 9 nga 237 rastet COVID-19+ rezultojnë të hospitalizuar. Mosha minimale e pjesëmarrësve në kohort është 18

vjeç, ku 84.4% janë femra dhe 17.6% meshkuj. Në kohën e vlerësimit, vetëm 127 (44%) ishin plotësisht të lirë nga shenja apo simptoma lidhur me infeksionin COVID-19, ndërsa (56%) raportuan vazhdimësi të paktën të 1 simptome, ku predomimojnë veçanërisht lodhja dhe dhimbja e kokës.

Konkluzione: Menaxhimi i Covid-it të zgjatur përbën një sfidë të re për klinicistët & sistemet shëndetësore.

Fjalë kyçe: Covid-19, "COVID i zgjatur", "Sindromi Post-Covid".

FIZIOLOGJIA E MPLAKJES TE APARATIT LOKOMOTOR DHE FRAKTURAT OSTEOPORIKE.

Dr.Zamir Demiraj, Dr.Ilir Hasmuca, Dr.Enea Grazhdani.
Spitali Universitar i Traumes, Tirane Shqiperi.

Abstrakt

Dekadat e fundit i janë kushtuar studime të shumta fiziologjisë së mplakjes së organizmit dhe kjo ka bërë të mundur një progres të dukshëm në geriartri. Definicioni i mosheës së 'pleqërisë' sipas literaturës anglo-saksone dhe frankofone është kufiri i 65 vjec, por jo gjithmonë ky koncept kalendarik është i saktë. Ka një koncept tjetër duke e ndarë këtë grup popullate në tre nëngrupe të tjera: a) personat e moshuar që bëjnë një jetë të pavarur; b) personat fragile; c) personat e varur nga një shoqërues. Ky koncept i ri për geriartrinë do të na ndihmojë për të vendosur taktikën e trajtimit dhe prognozën e frakturave osteoporotike, të cilat po bëhen gjithnjë e më të shpeshta në kohën tonë. Frakturat osteoporotike karakterizohen nga frekuenca e lartë, kjo për shkak të rritjes së moshës mesatare të popullsisë. Këto fraktura ndodhin edhe mbas një traume minimale në kushte shtëpie. Lokalizimi më i shpeshtë i tyre është fundi distal i radiusit, frakturat e qafës së femurit, frakturat e skajit proximal humeral, frakturat kompresive të trupave vertebralë. Trajtimi i këtyre frakturave has vështirësi për disa arsye ku dy me madhorët janë: komorbiditeti ose sëmundjet shoqëruese; kualiteti i dobët kockor, për arsye të osteoporozës, i cili çon në vështirësi teknike të osteosintezës.

Fjalët Kyç*:* osteoporozë; frakturë; osteosintezë; geriartri.

SUICIDET DHE TENTATIVA SUICIDALE NË AMBIENTET E PARABURGIMIT TË PERONAVE ME VARTËSI NGA DROGA , ILUSTRIM I NJË RASTI TIPIK SUICIDAL

Dr. Shk. Zija Ismaili (ekspert mjek ligjor) Dr. Shk. Bledar Xhemali (ekspert mjek ligjore) Dr. Ilir Decolli (eksperte mjek ligjore)

Abstrakt

Suicidet dhe tentativat suicidale në ambientet e paraburgimit janë një fenomen që cdo ditë është në rritje.
Një nga shkaqet që çon në këtë fenomen (tentativa suicidale) është dhe izolimi i personave me vartësi nga droga.

Pyetja që ngelet për tu zgjidhur nga organet e drejtësisë dhe policisë është se a duhet të izolohen këta persona në këto ambiente apo duhet të trajtohen në institucione të vecanta për tu detoksikuar nga vartësia e drogës.
Në Shqipëri fenomeni në fjalë po përhapet me shpejtësi cdo ditë. Numri i personave që janë përdorues të lëndëve narkotike është në rritje.
Bazuar në nenin 238 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë të gjithë këta persona izolohen në ambientet e paraburgimit që në momentin e arrestimit në flagrance.

Fjalë kyç: suicide, paraburgimi, lende narkotike.

ABSTRAKTET E DENTISTRISË

ABSTRACTS OF DENTISTRY

ABSTRAKTET E DENTISTRISË/ ABSTRACTS OF DENTISTRY

INTERNATIONAL EDUCATED DMD PROGRAM OPPORTUNITIES

Rosa Chaviano Moran

Abstract

The mission of the exchange section of the Rutgers School of Dentistry is to help new dentists and after graduated students to succeed and support the advancement of the health of the public. We are guided by our core values, which include integrity, excellence, and a dedication to bring you evidence-based insights that empower you to provide quality oral care for all patients.

We advocate for public health by focusing on crucial issues such as access to care, the rules and regulations that surround the practice of dentistry and much more.

The cooperation between two universities in academic staff and students is a source to change the new experiences, to share latest research on oral health, along with helpful practice guidelines, data on industry trends and a host of practical programs that support your personal health and success. The role of the dental team in promoting dental health and general health through oral health. The two major dental diseases are related to diet and dirt. These are common risk factors for a number of chronic diseases. A logical approach to the prevention of chronic diseases is to focus on risk factors rather than on specific diseases, a common risk factor approach using health promotion. Health promotion is the process of enabling individuals and communities to increase control over the determinants of health and thereby improve their health. The concepts incorporated in health promotion include a promotion of health through public policy, creating supportive environments, developing personal skills, strengthening community action and reorienting health services. The dental team should incorporate the following principles: integration with general health education, encouraging participation of the community, the public and staff in the planning process; making healthy choices the easier choices. By adopting a Common Risk Factor Strategy incorporated into Primary Health Care, dental teams can promote dental health and general health. The latter objective will be achieved by reducing pain and suffering related to dental diseases. A much broader remit for dental teams is outlined, one which will do justice to the abilities and training of all members of the team.

MUNDËSITË NDËRKOMBËTARE PËR PROGRAMIN E EDUKIMIT TË STOMATOLOGJISË

Rosa Chaviano Moran

Abstrakt

Misioni i shkëmbimit në Shkollën e Dentrisë Rutgers është të ndihmojë dentistët e rinj dhe studentët pas diplomimit të kenë sukses dhe të mbështesin avancimin e shëndetit të popullatës. Ne udhëhiqemi nga vlerat tona bazë, të cilat përfshijnë integritetin, përsosmërinë dhe përkushtimin për t'ju sjellë njohuri të bazuara në evidenca shkencore. Kjo ju mundëson përmirësimin e cilësisë së trajtimit të shëndetit oral për të gjithë pacientët. Ne mbështesim shëndetin publik duke u fokusuar në çështje thelbësore si në kujdesin, rregullat dhe parimet që përfshijnë fushën e stomatologjisë. Bashkëpunimi ndërmjet dy universiteteve për stafin akademik dhe studentët është një mundësi për të shkëmbyer eksperienca të reja, për të ndarë kërkimet më të fundit mbi shëndetin oral, së bashku me udhëzimet praktike, të rejat në tregun e stomatologjisë dhe një sërë programesh praktike që mbështesin shëndetin dhe suksesin tuaj personal. Roli i ekipit dentar në promovimin e shëndetit oral dhe shëndetit të përgjithshëm është thelbësor. Dy sëmundjet kryesore të dhëmbëve lidhen me dietën dhe papastërtitë. Këta janë faktorë risku të përbashkëta për një sërë sëmundjesh kronike. Një qasje logjike për parandalimin e sëmundjeve kronike përbën fokusimi më shumë në faktorët e riskut krahasuar me fokusin në sëmundjet specifike. Si rezultat, është i rëndësishëm realizimi i një programi të përbashkët ndaj faktorëve të riskut për promovimin e shëndetit. Promovimi i shëndetit është proçesi që u mundëson individëve dhe komuniteteve të rrisin kontrollin mbi faktorët determinantë të shëndetit dhe në këtë mënyrë të përmirësojnë shëndetin e tyre. Konceptet e përfshira në promovimin e shëndetit përfshijnë përdorimin e politikave publike, krijimin e mjediseve mbështetëse, zhvillimin e aftësive personale, përforcimin e veprimit të komunitetit dhe riorientimin e shërbimeve shëndetësore. Ekipi dentar duhet të përfshijë parimet e mëposhtme: integrimin me edukimin e përgjithshëm shëndetësor, inkurajimin e pjesëmarrjes së komunitetit, publikut dhe stafit në proçesin e planifikimit; duke bërë zgjedhjet e shëndetshme ato më të lehtat. Duke miratuar një Strategji të Përbashkët të Faktorëve të Riskut të përfshirë në Kujdesin Parësor Shëndetësor, ekipet dentare mund të promovojnë shëndetin dentar dhe shëndetin e përgjithshëm. Objektivi final do të arrihet duke reduktuar dhimbjet dhe shqetësimet që lidhen me sëmundjet dentare. Një përfshirje më e gjerë e stafit dentar është e nevojshme, e cila do t'i japë rëndësinë e duhur aftësive dhe trajnimit të të gjithë anëtarëve të ekipit dentar.

NAVIGATION IN IMPLANT DENTISTRY

Florian Beuer

Abstract

When aiming for long-term success in implant dentistry, various factors should be considered before planning implant surgeries. Available or missing hard and soft tissues, the distances between teeth and neighboring implants and anatomically critical structures such as nerves, vessels and maxillary sinuses must be respected. Prosthetically driven implant placement in combination with backward planning should be used to achieve predictable functional and esthetic outcomes. Thus, a meaningful combination of implant surgery and implant prosthodontics is necessary for satisfactory long-term results. The lecture gives an overview over static and dynamic navigation for the placement of dental implants. Advantages and disadvantages will be discussed and an outlook into the future will be made.

NAVIGIMI NË IMPLANTOLOGJINË DENTARE.

Florian Beuer

Abstrakt

Kur synohet suksesi afatgjatë në implantologji, duhet të merren parasysh faktorë të ndryshëm përpara se të planifikohen ndërhyrjet e implanteve dentare. Duhen respektuar indet e forta dhe të buta të disponueshme ose që mungojnë, distancat midis dhembëve dhe implanteve fqinje dhe strukturave kritike anatomike si nervat, enëve të gjakut dhe sinuseve maksilare. Vendosja e implantit të drejtuar në mënyrë protetike në kombinim me planifikimin paraprak duhet të përdoret për të arritur rezultate të parashikueshme funksionale dhe estetike. Kështu, një kombinim kuptimplotë i kirurgjisë implantare dhe pjesës përkatëse protetike është i nevojshëm për rezultate të kënaqshme afatgjata. Leksioni jep një pasqyrë të navigimit statik dhe dinamik për vendosjen e implanteve dentare. Përparësitë dhe disavantazhet do të diskutohen dhe do të bëhet një analizë për të ardhmen.

Fjalë kyç: implantologji, sukses.

INNOVATIONS IN ENDODONTICS

Gianluca Gambarini, Alessio Zanza

Abstract

In recent decades, the field of endodontics has thoroughly changed thanks to remarkable advances and innovation both in terms of technologies and materials. Since the introduction of nickel-titanium alloy as the material of choice for the manufacturing of endodontic rotary instrument, the percentage of positive outcomes of root canal treatments has increased. This is fundamentally due to the greater mechanical and metallurgical performance of instruments that has led to more efficient, predictable, and conservative shaping of endodontic systems, also reducing the operative time requested for root canal treatments. Since the 2000s, the development of technologies and materials has never stopped, guaranteeing to endodontists several instruments with innovative design and heat treatment, which ensure the possibility to have flexible and high cyclic fatigue resistant instruments at intracanal temperature, being in the martensitic crystallographic phase. However, improvements are still in progress, and in-depth knowledge of mechanical and metallurgical properties of innovative instruments is required to select them properly according to anatomical and case-related factors. With the introduction of this innovative heat-treatments it is possible to modify shaping protocols minimizing iatrogenic errors, reducing time, costs and number of instruments used. In addition to the shaping, the concept of obturation of root canal systems is also changing. Regarding this, special attention is going to be given to the recently introduced bioactive materials (calcium silicate-based endodontic sealers) that release growth factors and form hydroxyapatite-like layers when they come into contact with tissue fluids. thanks to their enhanced biological properties, such as cytocompatibility and differentiation of multipotent stem cells.

INOVACIONET NË ENDODONCI

Gianluca Gambarini, Alessio Zanza

Abstrakt

Në dekadat e fundit, fusha e endodoncisë ka ndryshuar rrënjësisht falë përparimeve dhe inovacioneve të jashtëzakonshme si në aspektin e teknologjive ashtu edhe në materialet. Që nga prezantimi i aliazhit nikel-titan si materiali i zgjedhur për prodhimin e instrumentëve rotatorë endodontik, përqindja e rezultateve pozitive të trajtimeve të kanaleve është rritur. Kjo është kryesisht për shkak të performancës më të madhe mekanike të instrumenteve që ka çuar në përpunimin më efikas, të parashikueshëm dhe konservativ të sistemit endodontik, duke reduktuar gjithashtu kohën operative të kërkuar për trajtimet e kanaleve. Që nga vitet 2000, zhvillimi i teknologjive dhe materialeve nuk ka të ndalur asnjëherë, duke u garantuar endodontëve disa instrumente me dizajn inovativ dhe trajtim termik, të cilat sigurojnë mundësinë për të patur instrumente fleksibël dhe rezistente ndaj lodhjes së lartë ciklike në temperaturën intrakanalare, në fazën kristalografike. Megjithatë, zhvillimet janë ende në progres dhe kërkohet njohuri e thelluar e vetive mekanike të instrumenteve novatore për t'i përzgjedhur ato siç duhet sipas faktorëve anatomikë dhe rasteve klinike. Me prezantimin e këtij trajtimi termik inovativ, është e mundur të modifikohen protokollet e përpunimit duke minimizuar gabimet iatrogjenike, duke reduktuar kohën, kostot dhe numrin e instrumenteve të përdorura. Krahas përpunimit po ndryshon edhe koncepti i mbylljes së sistemeve të kanaleve. Lidhur me këtë, një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet materialeve bioaktive të futura së fundi (izolues endodontik me bazë silikati kalçiumi) që çlirojnë faktorët e rritjes dhe formojnë shtresa të ngjashme me hidroksiapatitin kur bien në kontakt me fluidet indore, falë vetive të tyre biologjike të përmirësuara, të tilla si citokompatibiliteti dhe diferencimi i qelizave staminale multipotente.

Fjalë kyç: endodonci, nikel-titan.

THE POWERS OF DIGITAL INSTRUMENTS APPLIED TO CLINICAL SOLUTIONS

Prof. Giampietro Farronato[1]
[1]Full professor UNIMI

Abstract

Two-dimensional imaging has the limitation to reproduce distortion, super imposition and differential magnification of the cranio-facial complex. In cephalometrics it can bring to reduced measurement accuracy and to misleading diagnosis.

The advantages of CBCT will be analyzed in a 40-years journey. The cephalometric analysis of the Postgraduate school of orthodontics at the university of Milan allows to obtain more precise results and with several advantages when compared to the conventional technique such as a true representation of the anatomical structures, less risk of errors occurring due to clinician skills and absence of overlapping anatomical structures. Thus, affecting the clinical procedure and the digital workflow for many extended uses in the Orthodontic practice.

FUQITË E INSTRUMENTEVE DIXHITALE TË APLIKUARA NË ZGJIDHJET KLINIKE

Prof. Giampietro Farronato[1]
[1]*Full professor UNIMI*

Abstrakt

Imazhi dy dimensionale ka kufizimin për të riprodhuar deformimin, mbivendosjen dhe zmadhimin diferencial të kompleksit kranio-facial. Në cefalometrinë mund të zvogëlojë saktësinë e matjes dhe diagnozën mashtruese.
Përparësitë e CBCT do të analizohen në një udhëtim 40-vjeçar. Analiza cefalometrike e shkollës pasuniversitare të ortodoncisë në universitetin e Milanos mundëson marrjen e rezultateve më të sakta dhe me disa avantazhe në krahasim me teknikën konvencionale si për shembull një paraqitje e vërtetë e strukturave anatomike, më pak rrezik për gabime që ndodhin për shkak të aftësive kliniciste dhe mungesa e strukturave anatomike të mbivendosura. Kështu, duke ndikuar në procedurën klinike dhe rrjedhën e punës dixhitale për shumë përdorime të zgjeruara në praktikën Ortodontike.

Fjalë kyç: kompleksi kranio-facial, ceflometri.

RISK OF RADIOACTIVE CONTAMINATION IN THE DENTAL OFFICE BY THE PATIENT WHO HAS RECENTLY UNDERGONE NUCLEAR MEDICAL IMAGING.

Roberto Pasquarelli

Abstract

The purpose of this report is to provide simple radio-protectionist information on the possible radioactive contamination by any Patient, who arrived for dental treatment, having been subjected to medical-nuclear investigations in the first few previous days.

A rare occurrence… but probably possible!

At present. there are many equipment used in nuclear medical metabolic diagnostics and specific are radiopharmaceuticals, administered to patients, having different risk times depending on the radioactive half-life.

The risk of contamination in the dental room, in addition to the "dental unit", may also concern the health Team in charge of dental care due to irradiation and contamination by the "radioactive" Patient in the dental room.

RREZIKU I KONTAMINIMIT RADIOAKTIV NË KLINIKAT DENTARE NGA PACIENTË TË CILËT SË FUNDMI I JANË NËNSHTRUAR IMAZHERISË MJEKËSORE NUKLEARE.

Roberto Pasquarelli

Abstrakt

Qëllimi i këtij studimi është të ofrojë informacion të thjeshtë për mbrojtjen ndaj kontaminimit te mundshëm radioaktiv nga çdo pacient, i cili është paraqitur për të realizuar një proçedurë dentare, pasi i është nënshtruar imazherise mjekësore nukleare në ditët e mëparshme. Një dukuri e rrallë... por ndoshta e mundur! Aktualisht ka shumë pajisje mjekësore diagnostikuese për realizimin e imazherive nukleare që kanë substanca radioaktive, të administruara tek pacientët, me kohë të ndryshme risku në varësi të gjysmë-jetës radioaktive. Rreziku i kontaminimit në zyrën dentare, ekziston përveç se për "unitin dentar", por mund të preket edhe ekipi shëndetësor përgjegjës për kujdesin dentar për shkak të rrezatimit dhe kontaminimit nga pacienti "radioaktiv" në zyrën dentare.

Fjalë kyç: kontaminimi radioaktiv, imazheria mjekësore nukleare.

DIRECT AND INDIRECT VENEERS

Vincenzo Campanella

Abstract

Dental veneers are a thin layer of composite (direct veneers) or porcelain (indirect veneers) that bonds to the tooth surface. Compared to crowns, porcelain veneers are a conservative treatment to improve the aesthetics of the anterior teeth and have a long history of documented success. The preparation of the veneers should be based on the trial smile so that the result is as aesthetic as possible and take into account all the components: shape, color, position of the margins. It is important that the preparation is based on the planned final wax-up and not on the original tooth. If it is not done in this way, we may risk removing more parts than the healthy tooth needs. All our efforts should be made to keep the preparation in the enamel, because this ensures a long and reliable connection between the restoration and the tooth tissue. The preparation on dentine should be avoided because there is less reliability on the connection between dentine and veneer restoration. Also, the modules of elasticity and flexibility between dentine and porcelain vary more. As a result porcelain has a higher risk of fracture. Dentin bonded veneers are 10 times more likely to debond and fail than enamel veneers.

Keywords: direct veneers, indirect veneers.

FASETAT DIREKTE DHE INDIREKTE

Vincenzo Campanella

Abstrakt

Fasetat dentare janë një shtresë e hollë kompoziti (fasetat direkte) apo porcelani (fasetat indirekte) që bondohet mbi sipërfaqen e dhëmbit. Në krahasim me kurorat, fasetat e porcelanit janë trajtim konservativ për të përmirësuar estetikën e dhëmbëve anterior dhe kanë një histori të gjatë suksesi të dokumentuar. Përgatitja e fasetave duhet të bazohet në buzëqeshjen finale që rezultati të jetë sa më estetik dhe të merren në konsideratë që gjithë komponentët: forma, ngjyra, pozicioni i margove. Është e rëndësishme që cfarëdo preparimi të kërkohet, të bazohet mbi wax-upin përfundimtar të planifikuar dhe jo mbi dhëmbin original. Nëse nuk bëhet në këtë mënyrë, mund të rrezikojmë të heqim më shumë pjesë sec të duhet të dhëmbit të shëndoshë. E gjitha përpjekja jonë duhet bërë qëë mbahet preparimi në smalt, sepse kjo siguron një lidhje të gjatë dhe të besueshme mes punimit dhe indit dhëmbor. Preparimi në dentinë duhet të shmanget sepse ka me pas besueshmeri mes lidhjes së dentinës dhe punimit të fasetës dhe modulet e elasticitetit dhe fleksibilitetit mes dentinës dhe porcelanit ndryshojnë më shumë. Kjo e vendos porcelanin në një risk të lartë frakturimi. Fasetat e bonduara mbi dentinë kanë 10 herë më shumë shans të shkëputen dhe të dështojnë krahasuar me fasetat mbi smalt.

Fjalë kyç: faseta direkte, faseta indirekte.

TREATMENT WITH HUMAN PLACENTAL LACTOGEN (HPL-A) IMPROVES GLUCOSE HOMEOSTASIS ONE YEAR AFTER PANCREATIC ISLETS TRANSPLANTATION IN MICE ANTERIOR EYE CHAMBER

Giulia Donadel

Abstract

Type 1 diabetes (T1D) is a chronic disease characterized by destruction of insulin producing beta cells in the pancreas. In addition to conventional insulin treatment, islets transplantation represents an alternative and promising therapeutic approach to treat patients with T1D. Increasing evidences suggest that human placental lactogen (hPL), a polypeptide placental hormone, is able to promote islets survival and proliferation *in vitro*, however it is unknown its implication *in vivo* models. Therefore, in the present study, we used hPL isoform A (hPL-A) to evaluate the role of this hormone in murine engrafted islets.

T1D was induced in C57BL6/J male mice by a single intraperitoneal high dose (180 mg/kg) of streptozotocin (STZ). Collagenase p and a Histopaque 1110 gradient solution were used to isolate pancreatic islets. The anterior chamber of the eye was used to inject isolated islets. The engraftment was evaluated by confocal microscopy and immunohistochemical staining

on section of the right and left eye. Glucose tolerance test (GTT) was used to assess glucose tolerance in mice.

First, we evaluated the engraftment of freshly isolated pancreatic islets. Iris dissections showed a positive staining for insulin and glucagon. Second, since 2 months after transplantation, STZ-treated mice injected with islets stimulated with hPL-A, showed an improvement in fed glycaemia compared to STZ-treated mice transplanted with islets alone, and non-transplanted STZ-treated mice, for a follow-up of 1 year. Furthermore, mice treated with hPL-A, showed GTT with a similar pattern to untreated control mice. Third, islets vascularization and angiogenesis were confirmed using CD31 showing a better result in hPL-A treated mice.

Conclusion: Taken together, present results provide evidence that hPL-A could have a long-term effect on islet graft function and survival through enhancing glucose homeostasis.

TRAJTIMI ME LAKTOGJEN TË PLACENTËS HUMANE (HPL-A) PËRMIRËSON HOMEOSTAZËN GLUKOZALE NJË VIT PAS TRANSPLANTIMIT TË ISHUJVE PANKREATIK NË DHOMËN E PËRPARME TË SYRIT TË MINJVE.

Giulia Donadel

Abstrakt

Diabeti i tipit 1 (T1D) është një sëmundje kronike e karakterizuar nga shkatërrimi i qelizave beta që prodhojnë insulinë në pankreas. Përveç trajtimit konvencional me insulinë, transplantimi i qelizave përfaqëson një qasje terapeutike alternative dhe premtuese për trajtimin e pacientëve me T1D. Dëshmitë në rritje sugjerojnë se laktogjeni i placentës njerëzore (hPL), një hormon polipeptid placentar, është në gjendje të promovojë mbijetesën dhe përhapjen e qelizave in vitro, megjithatë nuk dihet implikimi i tij në modelet in vivo. Prandaj, në studimin aktual, ne përdorëm izoformën A të hPL (hPL-A) për të vlerësuar rolin e këtij hormoni në qelizat e transplantuar tek minjtë. T1D u nxit në minjtë meshkuj C57BL6/J nga një dozë e vetme e lartë intraperitoneale (180 mg/kg) e streptozotocinës (STZ). Kolagjenaza p dhe një solucion 1110 u përdorën për të izoluar qelizat pankreatike. Dhoma anteriore e syrit u përdor për të realizuar injektimin e ishujve pankreatikë. Mostra u vlerësua me mikroskop konfokal dhe ngjyrosje imunohistokimike në seksionin e syrit të djathtë dhe të majtë. Testi i tolerancës së glukozës (GTT) u përdor për të vlerësuar tolerancën e glukozës tek minjtë. Së pari, ne vlerësuam transplantimin e ishujve pankreatik të sapoizoluar. Diseksionet e irisit treguan një ngjyrosje pozitive për insulinën dhe glukagonin. Së dyti, që prej 2 muajsh pas transplantimit, minjtë e trajtuar me streptozotocin të cilëve i janë injektuar ishuj të stimuluar me hPL-A, treguan një përmirësim të glicemisë në krahasim me minjtë e trajtuar me streptozotocin, të cilëve i janë transplantuar vetëm ishujt pankreatikë dhe minjtë e trajtuar me streptozotocin pa transplant, për një periudhë prej 1 viti. Për më tepër, minjtë e trajtuar me hPL-A, treguan tolerancë të glukozës të ngjashme me minjtë e kontrollit të patrajtuar. Së treti, vaskularizimi dhe angiogjeneza e ishujve u konfirmuan duke përdorur CD31 (proçes diferencimi) duke treguar një rezultat më të mirë në minjtë e trajtuar me hPL-A. Konklузioni: Të marra së bashku, rezultatet e tanishme ofrojnë dëshmi se hPL-A mund të ketë një efekt afatgjatë në funksionin dhe mbijetesën e transplantit të ishujve nëpërmjet rritjes së homeostazës së glukozës.

Fjalë kyç: laktogjen, placenta humane, homeostaza glukozale.

MEDICAL EMERGENCIES IN DENTISTRY: ARE WE READY? ROLE OF UNIVERSITY EDUCATION AND CONTINUING EDUCATION

F. Coniglione[1,2], E. Cule[1], E. Pashaj[1], B. Rrapi[1], Sh. Mulla[1], A. Kerci[1], F. Vinjolli[1], F. Rulli[1]
[1]*Catholic University Our Lady of Good Counsel, Tirana, Albania*
[2]*Tor Vergata University, Rome, Italy*

Abstract

The dentist's first responsibility is to guarantee the patient's interest and health, always acting to this end: "primum non nocere". Essential for this purpose is the able of dentist to prevent, diagnose and treat any Urgency and Medical Emergencies (ME) that may arise in dental practice. For the sake of clarity we recall that "urgency" is defined as a pathological condition that requires treatment within 24 hours and that "emergency" means a pathological condition that requires treatment within 1 hour. Fortunately, ME s in the dental area are rare; nevertheless it is necessary that the dentist and his collaborators (dental hygienist, armchair assistant, etc.) are able to recognize and treat, within their recognizable limits, the ME, in consideration that modern dentistry has not only increased numerically but has made the interventions more aggressive and long lasting, very often on elderly or physically compromised patients and on pediatrics.

The opinions in the literature and in the international guidelines is that, despite the rarity of the ME in dentistry, in particular for some of them, the dental area staff must however be competent ("be competent" of the Anglo-Saxon authors) in practices of the BLS-D, have the theoretical-practical knowledge ("have knowledge" of the Anglo-Saxon authors) necessary to recognize an emergency situation, be accustomed ("be sure" of the Anglo-Saxon authors) to adequately treat the ME within recognized limits dentist. Currently, these required standards are not observed or met by the Italian dentist, having not been adequately prepared to face and resolve each ME. We must also stress that this professional lack of preparation is favored by the lack of guidelines regarding the education and professional training of the dentist in the specific field of emergencies. It is known, for example, that in many Italian dental offices there is no source of oxygen and many other both instrumental and pharmacological principals that can be used in ME.

"EMERGJENCAT MJEKËSORE NË DENTISTRI: A JEMI GATI? ROLI I ARSIMIT UNIVERSITAR DHE EDUKIMI I VAZHDUESHËM."

F.Coniglione[1,2] E.Cule[1], E.Pasha[1], B.Rrap[1], Sh.Mulla[1], A.Kerci[1], F. Vinnjolli[1], F.Rulli[1].
[1]Universiteti Katolik Zoja e Këshillit të Mirë, Tiranë. (Shqipëri)
[2]Universiteti Tor Vergata, Romë. (Itali)

Abstrakt

Përgjegjësia primare e mjekut stomatolog është të garantojë interesin dhe shëndetin e pacientit, duke vepruar gjithmonë për këtë qëllim: "primum non nocere". Thelbësore për këtë qëllim është aftësia e dentistit për të parandaluar, diagnostikuar dhe trajtuar çdo Urgjencë dhe Emergjencë Mjekësore (EM) që mund të lindë në praktikën dentare. Kujtojmë se "urgjenca" përkufizohet si një gjendje patologjike që kërkon trajtim brenda 24 orëve dhe se "emergjencë" nënkupton një gjendje patologjike që kërkon trajtim brenda 1 ore. Për fat të mirë, EM-të në fushen dentare janë të rralla; megjithatë është e nevojshme që stomatologu dhe bashkëpunëtorët e tij (higjienist dentar, asistent dentare etj.) të jenë në gjendje të njohin dhe trajtojnë brenda limiteve të tyre EM, duke qenë se stomatologjia moderne jo vetëm është zhvilluar në anën sasiore, por ka zhvilluar edhe ndërhyrjet më agresive dhe afatgjatë edhe tek pacientët e moshuar ose të kompromet uar fizikisht dhe në moshat pediatrike. Mendimet në literaturë dhe në udhëzimet ndërkombëtare janë se, pavarësisht nga rrallësia e EM në stomatologji, veçanërisht për disa prej tyre, stafi i fushës dentare duhet të jetë kompetent në praktikat e BLS (basic life support), të kenë njohuritë teoriko-praktike të nevojshme për të njohur një situatë emergjente, të jenë të mësuar për të trajtuar në mënyrë adekuate EM brenda kufijve të njohur të dentistit. Aktualisht, këto standarde të kërkuara nuk respektohen ose plotësohen nga mjeku stomatolog italian, duke mos qenë i përgatitur në mënyrë adekuate për të përballuar dhe zgjidhur çdo EM. Duhet të theksojmë gjithashtu se kjo mungesë e përgatitjes profesionale favorizohet nga mungesa e udhëzimeve për edukimin dhe formimin profesional të stomatologut në fushën specifike të urgjencave. Dihet, për shembull, që në shumë klinika dentare italiane nuk ka pajisje oksigjeni dhe shumë pajisje të tjera instrumentale me principet përkatëse farmakologjike që mund të përdoren në EM.

Fjalë kyç: emergjencat, edukimi në vazhdimësi.

FUNDAMENTALS OF IMPLANT SURGERY AT THE ESTHETIC ZONE

Burak Demiralp

Abstract

In the anterior maxilla, the esthetic outcome and its long-term stability is of paramount importance. This is the most important goal of implant therapy, followed by proper function and phonetics. An optimal esthetic outcome requires a thorough understanding of the underlying biological processes of bone and soft tissue healing following tooth extraction. With the knowledge of tissue biology in postextraction sites, well defined selection criteria are available today. Choosing the right timing of implant placement directly affects the outcome of the treatment. Not only the timing of implant placement but also the management and manipulation of the soft tissue and also working as a team is important. In this lecture; the audience can learn the selection criteria for the timing of the implant placement, how the soft tissue managements affect the outcomes of the treatment, and the common mistakes which are done at the esthetic zone during implant surgery.

BAZAT E KIRURGJISË IMPLANTARE NË ZONËN ESTETIKE.

Burak Demiralp

Abstrakt

Në maksilën anteriore, rezultati estetik dhe stabiliteti afatgjatë është i një rëndësie të madhe. Ky është qëllimi më i rëndësishëm i terapisë implantare, i ndjekur nga funksioni dhe fonetika e duhur. Një rezultat estetik optimal kërkon një kuptim të plotë të proçeseve biologjike themelore të shërimit të kockave dhe indeve të buta pas ekstraksionit dentar. Me njohuritë e biologjisë së indeve në zonat pas ekstraksionit, sot janë të disponueshme kritere përzgjedhjeje të përcaktuara mirë. Zgjedhja e kohës së duhur të vendosjes së implantit ndikon drejtpërdrejt në rezultatin e trajtimit. Jo vetëm koha e vendosjes së implantit, por edhe menaxhimi dhe manipulimi i indeve të buta dhe gjithashtu puna si ekip është e rëndësishme. Në këtë leksion audienca do të mësojë kriteret e përzgjedhjes për kohën e vendosjes së implantit, si ndikojnë menaxhimet e indeve të buta në rezultatet e trajtimit dhe gabimet e zakonshme që bëhen në zonën estetike gjatë ndërhyrjes implantare.

Fjalë kyç: estetikë, stabilitet afatgjatë.

THE INFLUENCE OF PARAFUNCTIONAL HABITS ON MASTICATORY AND NECK MUSCLES

Prof. Gianluca Martino Tartaglia[1]
[1]UNIMI

Abstract

To assess the surface electromyographic spectral characteristics of masticatory and neck muscles during the performance of maximum voluntary clench (MVC) tasks, were examined. Electromyography of masseter, temporalis and upper trapezius muscles was performed during 5-s MVCs either on cotton rolls or in intercuspal position. Using a fast Fourier transform, the median power frequency (MPF) was obtained for the first and last seconds of clench, and compared between sexes, muscles, sides, tests and time intervals using ANOVAs. On average, the MPFs did not differ between sexes or sides ($p>0.05$), but significant effects of muscle (MPF temporalis larger than masseter, larger than trapezius muscles), test (larger MPFs when clenching in intercuspal position than when clenching on cotton rolls) and time (larger MPFs in the first than in the fifth second of clench) were found. Reference values may assist in the assessment of patients with alterations in the cranio-cervical-mandibular system.

NDIKIMI I ZAKONEVE PARAFUNKSIONALE NË MUSKUJT PËRTYPËS DHE TË QAFËS.

Prof. Gianluca Martino Tartaglia
[1]UNIMI

Abstrakt

Për të vlerësuar karakteristikat spektrale elektromiografike sipërfaqësore të muskujve mastikator dhe të qafës gjatë kryerjes së performances se sforcimit vullnetar maksimal (MVC), u ekzaminuan. Elektromiografia e muskujve maseter, temporalis dhe trapezius të sipërm është kryer gjatë MVC-ve 5-s, qoftë në rrotulla pambuku ose në pozicion ndërkuspal. Duke përdorur një transformim të shpejtë të Furierit, frekuenca e fuqisë mesatare (MPF) u mor për sekondat e para dhe të fundit të shtrëngimit dhe u krahasua midis gjinive, muskujve, anëve, testeve dhe intervaleve kohore duke përdorur ANOVA. Mesatarisht, MPF-të nuk ndryshonin midis gjinive ose anëve ($p>0.05$), por efektet domethënëse të muskujve (MPF temporalis më i madh se masazhi, më i madh se muskujt e trapezit), testi (MPF më të mëdha kur shtrëngohen në pozicionin interkuspidues sesa kur kafshon në rolete e pambukut) dhe koha (MPF më të mëdha në të parën se në sekondën e pestë të shtrëngimit) u gjetën. Vlerat e referencës mund të ndihmojnë në vlerësimin e pacientëve me ndryshime në sistemin kranio-cervikal-mandibular.

ENTREPRENEURSHIP IN DENTISTRY, A SKILL YOU CAN LEARN

Maher Almasri[1]
[1]*President of Dental School "College of medicine and Dentistry", Birmingham UK*

Abstract

Becoming a dentist and then owning your own practice might be a dream come true but balancing the responsibilities of being a dentist and a successful business owner that will grow is not an easy task. You can divide "Dentists" up into those who love stimulation and surprises and those who get worried by surprise and only like a moderate amount of stimulation. Yes, it can be in your wiring, but you can learn to overcome it and compensate, you can learn to manage that preference in a way that suits you. The speaker will discuss whether you can be a dental entrepreneur or they are made! He will embrace the fact that entrepreneurship is not just about starting a business. But it is about being more enterprising, being more of a creative, risk-taker in essence. Professor Almasri will not only build your imagination, which is considered the most important tool of any successful entrepreneur's toolkit, but he will go beyond that; he will let you turn your ideas into a vision for the future and show you how to make it a reality. Regardless of your personality, background or financial situation, you will learn the techniques and methods to become a successful dental entrepreneur.

SIPËRMARRJA NË DENTISTRI, NJË AFTËSI QË MUND TË MËSONI.

Maher Almasri
Presidenti i Shkollës Dentare "Kolegji i Mjekësisë dhe Stomatologjisë, Birmingam, U.K.

Abstrakt

Të bëhesh mjek stomatolog dhe më pas të zotërosh klinikën tënde mund të jetë një ëndërr e realizuar, por balancimi i përgjegjësive të të qenit dentist dhe një pronar biznesi i suksesshëm që do të rritet nuk është një detyrë e lehtë. Ju mund t'i ndani "Dentistët" në ata që duan stimulimin dhe surprizat dhe ata që shqetësohen nga befasia dhe pëlqejnë vetëm një sasi të

moderuar stimulimi. Në këtë leksion do të diskutohet nëse ju mund të jeni një sipërmarrës dentar apo ata janë të lindur! Sipërmarrja nuk ka të bëjë vetëm me fillimin e një biznesi. Por ka të bëjë me të qënit më sipërmarrës, më shumë krijues dhe rrezikues në thelb. Profesor Almasri jo vetëm që do të ndërtojë imagjinatën tuaj, e cila konsiderohet si mjeti më i rëndësishëm për çdo sipërmarrës të suksesshëm, por ai do të shkojë përtej kësaj; ai do t'ju lejojë t'i ktheni idetë tuaja në një vizion për të ardhmen dhe do t'ju tregojë se si ta bëni atë realitet. Pavarësisht nga personaliteti, prejardhja ose situata juaj financiare, ju do të mësoni teknikat dhe metodat për t'u bërë një sipërmarrës i suksesshëm dentar.

Fjalë kyç: sipërmarrës.

MINIMALLY INVASIVE APPROACH FOR ORAL LESIONS: ADVANCES IN PHOTODYNAMIC THERAPY

Prof. Antonio Romano[1]
[1]Università Napoli Vanvitelli

Abstract

Nowadays, clinical effort and scientific research increasingly sight towards the development of new aid tools and minimally invasive techniques for novel therapeutic approach. Photodynamic concepts arise as considerable development areas of research for therapeutic clinical applications. Photodynamic therapy (PDT) is considered a viable treatment option in several branches of oral medicine. The therapeutic effects of PDT derive from a light radiation on a tissue treated with photosensitizers. By photoactivating with a radiant source, the photosensitizing molecules, in fact, it is possible to induce necrosis at the level of the lysosomes and at level of the cell membranes in which photosensitizers are located. The standardization of PDT techniques has generated excellent results, which have been obtained in various branches of medicine, mainly for the treatment of lesions concerning the head and neck region. In the last decade, photodynamic therapy has found wide use in various surgical branches, showing remarkable results in the treatment of neoplastic lesions. In particular, in the oral cavity, topical photodynamic therapy has guaranteed remarkable results in the treatment of lichenoid lesions, fungal infections and preneoplastic lesions. Despite literature offers considerable heterogeneity in the clinical protocols, our data screening validates the effectiveness of this technique. Ultimately, minimal invasiveness, low cost and high patient comfort make PDT a valid surgical therapeutic option for benign, malignant and potentially malignant lesions of the oral mucosa.

QASJET MINIMALISHT INVAZIVE PËR LEZIONET ORALE: ZHVILLIMET NË TERAPINË FOTODINAMIKE.

Prof. Antonio Romano[1]
[1]Universiti Napoli Vanvitelli

Abstrakt

Në ditët e sotme, përpjekjet klinike dhe kërkimi shkencor gjithnjë e më shumë synojnë zhvillimin e mjeteve të reja ndihmëse dhe teknikave minimale invazive për një qasje të re terapeutike. Konceptet e fotodinamikës lindin si pjesë e fushave në zhvillim për aplikime

klinike terapeutike. Terapia fotodinamike (PDT) konsiderohet një opsion i qëndrueshëm trajtimi në disa degë të mjekësisë orale. Efektet terapeutike të PDT rrjedhin nga një rrezatim drite në një ind të trajtuar me fotosensibilizues. Duke fotoaktivizuar me një burim rrezatues molekulat fotosensibilizuese, në fakt, është e mundur të shkaktohet nekrozë në nivelin e lizozomeve dhe në nivelin e membranave qelizore në të cilat ndodhen fotosensibilizuesit. Standardizimi i teknikave të PDT-së ka sjellë rezultate të shkëlqyera, të cilat janë marrë në degë të ndryshme të mjekësisë, kryesisht për trajtimin e lezioneve të rajonit të kokës dhe qafës. Në dekadën e fundit terapia fotodinamike ka gjetur përdorim të gjerë në degë të ndryshme kirurgjikale, duke treguar rezultate të jashtëzakonshme në trajtimin e lezioneve neoplazike. Në veçanti, në kavitetin oral terapia fotodinamike topikale ka garantuar rezultate të jashtëzakonshme në trajtimin e lezioneve likenoide, infeksioneve mykotike dhe lezioneve pre-neoplazike. Pavarësisht se literatura ofron heterogjenitet të konsiderueshëm në protokollet klinike, shqyrtimi ynë i të dhënave vërteton efektivitetin e kësaj teknike. Në fund të fundit, invaziviteti minimal, kostoja e ulët dhe komoditeti i lartë i pacientit e bëjnë PDT një opsion terapeutik të vlefshëm kirurgjikal për lezionet beninje, malinje dhe potencialisht malinje të mukozës orale.

Fjalë kyç: terapi fotodinamike.

DIGITAL CROSS-MOUNTING: A NEW OPPORTUNITY IN PROSTHETIC DENTISTRY

Piero Venezia

Abstract

The prosthodontic management of complex rehabilitations requires several stages of treatment including one or more provisional restorations.
The design an adjustment of the provisional are made to achieve an optimal functional and aesthetic outcome for the patient.
However, the adjustments needed are both and cost consuming.
Therefore. Once a satisfactory provisional is made, the information should not be lost during the following stages of treatment.
The Digital Cross-Mounting is a procedure used to precisely transfer information from the temporary restoration to the final fixed rehabilitation according a digital workflow.

MONTIMI DIXHITAL: NJË MUNDËSI E RE NË PROTETIKËN DENTARE

Piero Venezia

Abstrakt

Menaxhimi protetik i rehabilitimeve komplekse kërkon disa faza të trajtimit duke përfshirë një ose më shumë restaurime provizore. Dizajni dhe rregullimet e provizorit janë bërë për të arritur një rezultat optimal funksional dhe estetik për pacientin.
Megjithatë, rregullimet e nevojshme kërkojnë kohën dhe kostot përkatëse.
Prandaj, pasi të jetë bërë një punim provizor i kënaqshëm, të dhënat nuk duhet të humbasin gjatë fazave të mëtejshme të trajtimit. Montimi dixhital është një proçedurë e përdorur për të

transferuar me saktësi informacionin nga restaurimi i përkohshëm në rehabilitimin përfundimtar fiks sipas një rrjedhe pune dixhitale.

Fjalë kyç: montim dixhital, menaxhim protetik.

ENDODONTICS VS IMPLANTOLOGY: A RATIONAL CHOICE

Luca Testarelli, Rodolfo Reda

Abstract

Thanks to the developments of new technologies and materials in endodontics, such as heat-treated nickel-titanium rotary instrument, irrigates activators and bioactive endodontic sealers, the success rate of root canal treatments increased exponentially. However, there are several factors that can modify the outcome of endodontic treatments. First of all, the presence of apical periodontitis is the most important factor influencing treatment outcome. The success rates for teeth without apical periodontitis range from 82.8%–97.3%, whereas teeth with apical periodontitis varies from 75.6%–87.77%. Considering the alternative therapy to the treatments of non-vital teeth, tooth extraction and implantology seem to have success rate very similar to those of root canal treatments. According to this, the survival rate of dental implants varies from 91.8%–100% after 1 to 10 years, However, although the success of root canal treatment, retreatment, and apical surgery is defined by complete radiographic healing and the absence of clinical signs and symptoms, the majority of studies on dental implants only refer to survival rates and not to success rates. For this reason, is very difficult to directly compare those treatments in terms of outcome since the evaluating factor are very different.

Nevertheless, the treatment plan cannot be based on number and success percentage, but it must be decided on the specific case according to patient needs, preferences and expectation. There are several factors that could guide the clinicians towards a therapy or another one. The scope of this meeting is to discuss, evidence and analyse the possible different clinical scenarios in order to give you a practical decision-making tree to follow in most of cases.

ENDODONCIA KUNDREJT IMPLANTOLOGJISË: NJË ZGJEDHJE RACIONALE

Luca Testarelli, Rodolfo Reda

Abstrakt

Falë zhvillimeve të teknologjive dhe materialeve të reja në endodonci, si instrumentët rotatorë të trajtuar me nxehtësi nikel-titan, aktivizuesit e irrigantëve dhe izoluesit endodontikë bioaktivë, shkalla e suksesit të trajtimeve të kanaleve është rritur në mënyrë eksponenciale. Megjithatë, ka disa faktorë që mund të modifikojnë rezultatin e trajtimeve endodontike. Para së gjithash, prania e periodontitit apikal është faktori më i rëndësishëm që ndikon në rezultatin e trajtimit. Shkalla e suksesit për dhëmbët pa periodontit apikal varion nga 82.8% -97.3%, ndërsa në dhëmbët me periodontit apikal varion nga 75.6% -87.77%. Duke marrë parasysh terapinë alternative për trajtimet e dhëmbëve jo vitalë, ekstraksioni

dentar dhe implantologjia duket se kanë shkallë suksesi shumë të ngjashëm me ato të trajtimeve të kanaleve. Sipas kësaj, shkalla e mbijetesës së implanteve dentare varion nga 91.8% -100% pas 1 deri në 10 vitesh. Megjithatë, megjithëse suksesi i trajtimit të kanaleve, ritrajtimit dhe kirurgjisë apikale përcaktohet nga shërimi i plotë radiografik dhe mungesa e shenjave klinike dhe simptomave, shumica e studimeve mbi implantet dentare i referohen vetëm përqindjeve të mbijetesës dhe jo përqindjeve të suksesit. Për këtë arsye, është shumë e vështirë të krahasohen drejtpërdrejt këto trajtime për sa i përket rezultatit, pasi faktorët vlerësues janë shumë të ndryshëm.
Megjithatë, plani i trajtimit nuk mund të bazohet në numrin dhe përqindjet e suksesit, por duhet vendosur në rastin konkret sipas nevojave, preferencave dhe pritshmërive të pacientit. Ka disa faktorë që mund t'i udhëheqin mjekët drejt një terapie ose një tjetër. Qëllimi i këtij leksioni është të diskutojë, evidentojë dhe analizojë skenarët e ndryshëm të mundshëm klinikë në mënyrë që t'ju japë një panoramë praktike vendimmarrëse për t'u ndjekur në shumicën e rasteve.

Fjalë kyç: endodoncia, implantologjia.

PREVENTION IN ORTHODONTICS: VERTICAL AND SAGITTAL CONTROL

Prof. Attilio Castaldo[1]
[1]*Università di Milano San Raffaele*

Abstract

Orthodontic diagnosis and orthodontic therapy involve the three-dimensional evaluation of the orofacial components in the three planes of space to obtain a neuro-muscular balance.

PARANDALIMI NË ORTODONCI: KONTROLLI VERTIKAL DHE SAGITAL

Prof. Attilio Castaldo[1]
[1]*Universiteti Milano, San Raffaele*

Abstrakt

Diagnoza ortodontike dhe terapia ortodontike përfshijnë vlerësimin tredimensional të komponentëve orofacialë në tre rrafshet e hapësirës për të marrë një ekuilibër neuro-muskulor.

Fjalë kyç: kontrolli vertikal, kontroll sagital.

EFFECT OF IMPLANT SURFACE ROUGHNESS AND MACRO- AND MICRO-STRUCTURAL COMPOSITION ON WEAR AND METAL PARTICLES RELEASED

Prof. Gaetano Marenzi

Abstract

Dental implants are commonly used in daily practice for functional and aesthetic rehabilitation after tooth loss. Titanium and its alloy are the most commonly used materials due to their biocompatibility, mechanical characteristics and chemical stability. However, many studies do not focus on the properties of dental implant materials when they are broken down to smaller particle. As a consequence of implant placement, microfractures and compression can occur at the bone side and the implant surface can be simultaneously subjected to a combination of torsional and frictional forces, which may alter the original implant surface. However, little is known about macro and microstructural components of the dental implant surface which can influence the wear onset and the particles released during implant placement. In order to increase the contact area between the living bone and the fixture, manufacturers have introduced many surface treatments, namely chemical (acid-etching) and mechanical (sandblasting) or a combination of the two. These different manufacturing techniques promote different surface topographies at both the micro- and nano-scales and superficial chemical compositions. At present, none of the previous industrial techniques proposed to increase surface roughness is able to prevent the release of titanium particles from the implant surface following insertion into the bone. Generally, these particles are highly difficult to eliminate from the peri-implant tissues and their concentration can be able to procure local inflammation and modify the osteoblast and osteoclast balance.

EFEKTI I ASHPËRSISE SË SIPËRFAQES SË IMPLANTIT DHE PËRBËRJA MAKRO DHE MIKRO-STRUKTURORE E GRIMCAVE METALIKE TË LËSHUARA.

Prof. Gaetano Marenzi

Abstrakt

Implantet dentare përdoren zakonisht në praktikën e përditshme për rehabilitimin funksional dhe estetik pas humbjes së dhëmbëve. Titani dhe aliazhi i tij janë materialet më të përdorura për shkak të biokompatibilitetit, karakteristikave mekanike dhe stabilitetit kimik. Megjithatë, shumë studime nuk fokusohen në vetitë e materialeve të implanteve dentare kur ato ndahen në grimca më të vogla. Si pasojë e vendosjes së implantit, mikrofrakturat dhe ngjeshja mund të ndodhin dhe sipërfaqja e implantit mund t'i nënshtrohet njëkohësisht një kombinimi të forcave rrotulluese dhe fërkuese, të cilat mund të ndryshojnë sipërfaqen origjinale të implantit. Megjithatë, dihet pak për komponentët makro dhe mikrostrukturorë të sipërfaqes së implantit dentar dhe grimcat e lëshuara gjatë integrimit të implantit. Për të rritur zonën e kontaktit midis kockës dhe materialit të inseruar, prodhuesit kanë prezantuar shumë trajtime sipërfaqësore, përkatësisht kimike (me acid) dhe mekanike (sandblasting) ose një kombinim i të dyjave. Këto teknika të ndryshme promovojnë topografi dhe përbërje kimime të ndryshme të sipërfaqes si në nivel mikro ashtu edhe në nano. Aktualisht, asnjë nga teknikat e mëparshme industriale të propozuara për të rritur vrazhdësinë e sipërfaqes nuk është në

gjendje të parandalojë çlirimin e grimcave të titanit nga sipërfaqja e implantit pas futjes në kockë. Në përgjithësi, këto grimca janë shumë të vështira për t'u eliminuar nga indet peri-implantare dhe përqendrimi i tyre mund të jetë në gjendje të prodhojë inflamacion lokal dhe të modifikojë ekuilibrin e osteoblasteve dhe osteoklasteve.

Fjalë kyç: makro strukturë, mikro strukturë.

DENTAL IMPLANT BEHAVIOR IN REGENERATES ALVEOLAR SOCKET MAXILLARY SITES WITH AN INNOVATIVE TOOTH DERIVED AUTOLOGOUS BIOMATERIAL: AN IN VIVO 1 YEAR FOLLOW-UP STUDY

Prof. Filiberto Mastrangelo[1]
[1]Università di Foggia

Abstract

Evaluate the efficacy of autologous demineralized graft materials from extracted tooth in implant rehabilitation after guide bone regeneration procedures in a multicenter study. After alveolar sockets preservation (ASP) procedures with autologous graft materials from demineralized fresh extracted tooth, 382 implants were inserted in 319 patients. After 1 year to the prosthetic loading follow-up, the complications after ASP procedures were 1,83% (7 cases) and the global implant survival rate was 97,91%. In only 8 cases it was necessary to remove the dental implant (in early period after loading for no osseointegration of the dental implant). Within the early follow up and the limitation number of the dental implants used in the study, the results appear more encouraging showing similar implant survival rate in ASP sites with autologous tooth grafts materials to that obtained in native bone sites. Several studies will be need to understand the clinical implications in all surgical bone procedures, however the results obtained, suggested that the autologous demineralized grafts from tooth extracted it is a promising clinical outcome when used for alveolar ridge augmentation to support dental implant placement.

PËRGJIGJIA E IMPLANTIT DENTAR NË RIGJENERIMIN E ALVEOLAVE MAKSILARE ME NJË BIOMATERIAL INOVATIV AUTOLOG QË DERIVON NGA DHËMBI: NJË STUDIM IN VIVO 1-VJEÇAR.

Prof. Filiberto Mastrangelo[1]
[1]Università di Foggia

Abstrakt

Qëllimi i studimit ishte vlerësimi i efikasitetit të materialeve të graftit të demineralizuar autolog nga dhëmbi i ekstraktuar në rehabilitimin e implantit pas proçedurave të rigjenerimit të drejtuar kockor. Pas proçedurave të ruajtjes së alveolave (ASP) me materiale grafti autologe nga dhëmbi i freskët i demineralizuar i ekstraktuar, u vendosën 382 implante në 319 pacientë. Pas 1 viti nga ndjekja e ngarkimit protetik, komplikimet pas proçedurave të ASP

ishin 1,83% (7 raste) dhe shkalla globale e mbijetesës së implantit ishte 97,91%. Vetëm në 8 raste duhej te hiqej implanti dentar (në periudhën e hershme pas ngarkimit për mos osteointegrim të implantit dentar). Brenda ndjekjes së hershme dhe numrit të kufizuar të implanteve dentare të përdorura në studim, rezultatet duken më inkurajuese duke treguar shkallë të ngjashme të mbijetesës së implantit në zonat e ASP me grafte autologe të dhëmbëve krahasuar me graftet nga zonat kockore autologe. Do të nevojiten disa studime për të kuptuar implikimet klinike në të gjitha proçedurat kirurgjikale të kockave, megjithatë rezultatet e marra sugjeruan që graftet autologe të demineralizuara nga dhëmbi i ekstraktuar janë një rezultat klinik premtues kur përdoret për shtimin e kreshtës alveolare për të mbështetur vendosjen e implantit dentar.

Fjalë kyç: alveola maksilare, biomaterial inovativ autolog.

TITANIUM FUNCTIONALIZED WITH POLYLYSINE HOMOPOLYMERS: IN VITRO ENHANCEMENT OF CELLS GROWTH

Prof. ssa Marina Di Domenico[1]
[1]*Università di Napoli Full professor*

Abstract

The success and durability of dental implants are guaranteed by the formation of bone tissue around the implant and by the integrity of the peri-implant mucosa seal, which adheres to the abutment, preventing bacterial penetration and colonization near the external parts of the implant. Nowdays, the research is focused on for substances useful to coat the titanium surface that guarantees the formation and persistence of peri-implant bone, as well as the integrity of the mucous perimeter surrounding the implant crown. The aim of this study is to establish the potential clinical application of titanium evaluating in vitro the effects of a titanium surface coated with polylysine homopolymers on the cell growth of dental-derived stem cells (D-dSCs) and keratinocytes.The reported preliminary data suggest the usefulness of polylysine coating to speed the post-surgery mucosal healings and to guarantee appropriate peri-implant epithelial seals and to protect the fixture against bacterial penetration, responsible for compromising the implant survival osteoinduction.

TITANI I VESHUR ME HOMOPOLIMERË POLILIZINE: ZHVILLIMI I RRITJES QELIZORE IN VITRO.

Prof. Marina Di Domenico
Universiteti Napoli, Full professor

Abstrakt

Suksesi dhe qëndrueshmëria e implanteve dentare garantohen nga formimi i indit kockor rreth implantit dhe nga integriteti i mbylljes së mukozës peri-implantare, e cila atashohet në abutment, duke parandaluar depërtimin dhe kolonizimin bakterial pranë pjesëve të jashtme të implantit. Në ditët e sotme, kërkimi është fokusuar në substancat e dobishme për veshjen e sipërfaqes së titanit që garanton formimin dhe qëndrueshmërinë e kockës peri-implantare,

si dhe integritetin e mukozes që rrethon kurorën e implantit. Qëllimi i këtij studimi është të vendosë aplikimin e mundshëm klinik të titanit duke vlerësuar in vitro efektet e një sipërfaqe titani të veshur me homopolimerë polilizine në rritjen e qelizave staminale me prejardhje dentare (D-dSCs) dhe keratinociteve. Të dhënat paraprake të raportuara sugjerojnë dobinë e veshjes së polilizinës për të përshpejtuar shërimet e mukozës pas operacionit, për të garantuar mbylljen e duhur të epitelit peri-implantar dhe për mbrojtjen ndaj depërtimit bakterial, përgjegjës për kompromentimin e osteoinduksionit të mbijetesës së implantit.

Fjalë kyç: titan, homopolimerë polilizine.

CLINICAL EFFICACY OF A NEW CETYLPYRIDINIUM CHLORIDE-HYALURONIC ACID-BASED MOUTHRINSE FOR LONG-TERM ORAL DISEASES PROTECTION

Prof. Santosh Kumar Tadakamadla

Abstract

To compare the effectiveness of a novel cetylpyridinium chloride (CPC)-hyaluronic acid (HA)-based mouthrinse with chlorhexidine (CHX) and placebo mouthrinses in preventing plaque and gingivitis. The secondary outcomes were calculus, extrinsic stains, oral malodour and occurrence of adverse events. CPC-HA and CHX had similar effectiveness in preventing plaque accumulation, while no differences were observed between the mouthrinses for preventing gingivitis. Dental staining was caused by CHX and the placebo mouthrinses but not by CPC-HA mouthrinse.

EFIKASITETI KLINIK I SHPËLARËSIT TË RI TË GOJËS ME BAZË KLORUR CETILPIRIDINIUM- ACID HIALURONIK PËR MBROJTJEN AFATGJATË NGA SËMUNDJET ORALE.

Prof. Santosh Kumar Tadakamadla

Abstrakt

Qëllimi: Krahasimi i efektivitetit të një shpëlaresi goje të ri të bazuar në klorur cetilpiridinium (CPC)-acid hialuronik (HA) me shpëlarësit e gojës me klorheksidin (CHX) dhe placebo në parandalimin e pllakës dhe gingivitit. Rezultatet dytësore ishin gurët, njollat e jashtme, aroma e keqe e gojës dhe shfaqja e efekteve të padëshiruara. CPC-HA dhe CHX kishin efektivitet të ngjashëm në parandalimin e akumulimit të pllakës, ndërsa nuk u vërejtën dallime midis shpëlarësve të gojës për parandalimin e gingivitit. Ngjyrosja dentare u shkaktua nga CHX dhe shpëlarësit placebo, por jo nga shpëlarësit CPC-HA.

Fjalë kyç: klorur cetilpiridinium- acid hialuronik, sëmundjet orale.

IMPACT OF DENTAL CARIES ON ACADEMIC PERFORMANCE OF SCHOOLCHILDREN

Prof. Faeq Al Quadri

Abstract

Objective: There is a lack of empirical evidence explaining the pathway model of any specific oral health condition leading to poor academic performance. Objective of this research was to test the hypothesis that dental caries operates through toothache to disrupt learning activities and results in poor academic performance.

Methods: A cross-sectional (CS) study was carried out on a sample of schoolchildren aged 12-14 years in Jazan, Saudi Arabia (sample size=700). The outcome measures were a pass/fail GPA grade and teacher perception of the child's academic performance. The exposure parameters comprised the common oral health conditions in children, which were assessed by clinical examinations and a self-perceived questionnaire. The relationships between poor oral health-impacted sleep and study activities, and academic performance were also assessed. The univariate, bivariate, and multiple regressions were carried out using the SPSS software (version 24.0) and mediation analysis was performed using the PROCESS add-on software.

Results: Findings showed that dental caries, gingivitis, plaque deposits, toothache, tooth discoloration, and oral health impacts related to sleeping and studying were significantly associated with academic performance ($p<0.001$). Dental caries was identified as the most likely oral health condition that can be linked to poor academic performance (Adjusted OR=3.09; SE=0.16). Subsequently, the pathway analysis confirms the indirect effect of caries on academic performance through its influence onpain, and sleep (Bootstrap 95%CI:1.37, 12.81) and study (Bootstrap 95%CI: 0.10, 0.82) activities. The investigation of a causal relationship using the Bradford Hill criteria further supported the pathway models.

Conclusion: Dental caries is identified as the best predictor of poor academic performance among the examined OH conditions, and decay severity (DT), the best measure. There is a plausible causal relationship between dental caries and academic performance based on the pathway analysis and application of the Bradford Hill criteria.

NDIKIMI I KARIESIT DENTAR NË PERFORMANCËN AKADEMIKE TË NXËNËSVE.

Prof. Faeq Al Quadri

Abstrakt

Objektivi: Ka mungesë të provave empirike që shpjegojnë impaktin e çdo gjendjeje specifike të shëndetit oral në performancën e dobët akademike. Objektivi i këtij hulumtimi ishte testimi i hipotezës që kariesi dentar vepron përmes dhimbjes së dhëmbit për të ndërprerë aktivitetet e të mësuarit dhe rezulton në performancë të dobët akademike.

Metodat: Një studim (CS) u krye në një kampion nxënësish të moshës 12-14 vjeç në Jazan, Arabia Saudite (madhësia e mostres = 700). Kriteret e rezultatit ishin një notë kaluese/dështuese dhe perceptimi i mësuesit për përformancën akademike të fëmijës. Parametrat që ndikonin në kushtet e shëndetit oral te fëmijët u vlerësuan nga ekzaminimet klinike dhe një pyetësor vetë-vlerësimi. Marrëdhëniet midis gjumit të ndikuar nga probleme të kavitetit oral dhe aktiviteteve të studimit e performancës akademike u vlerësuan gjithashtu. Regresionet me një variabël, dy variabla dhe variabla multiple u realizuan duke përdorur softuerin SPSS (versioni 24.0) dhe analiza krahasuese u krye duke përdorur softuerin shtesë PROCESS.

Rezultatet: Gjetjet treguan se kariesi dentar, gingiviti, depozitat e pllakave, dhimbja e dhëmbëve, ndryshimi i ngjyrës së dhëmbëve dhe ndikimet e shëndetit oral lidhur me gjumin dhe studimin ishin të lidhura ndjeshëm me performancën akademike ($p < 0.001$). Kariesi dentar u identifikua si gjendja më e mundshme e shëndetit oral që mund të lidhet me performancën e dobët akademike (OR = 3.09; SE = 0.16). Më pas, analizat konfirmuan efektin indirekt të kariesit në performancën akademike përmes ndikimit të tij në dhimbje, dhe aktivitetet e gjumit (Bootstrap 95% CI: 1.37, 12.81) dhe studimore (Bootstrap 95% CI: 0.10, 0.82). Hetimi i një marrëdhënieje shkakësore duke përdorur kriteret e Bradford Hill mbështeti më tej modelet shkak-pasojë. Konkluzion: Kariesi dentar është identifikuar si faktori parashikues më i mirë i performancës së dobët akademike midis kushteve të ekzaminuara të kavitetit oral, dhe grada e kariesit (DT), matja më e mirë. Ekziston një lidhje shkakësore midis kariesit dentar dhe performancës akademike bazuar në analizën dhe aplikimin e kritereve të Bradford Hill.

Fjalë kyç: karies, perfomanca akademike.

SALIVARY SURVEILLANCE FOR NEURODEGENERATIVE DISEASES

Stephen Thaddeus Connelly

Abstract

Understanding of the pathophysiology driving neurodegenerative diseases such as Alzheimer's disease has greatly increased in recent decades. Despite these scientific advances, we have yet to achieve any measurable progress at prevention, control, or reversal of this group of disorders. One important step towards solving this problem is the identification of disease-specific biomarkers and the ability to reliably measure them over time. Fortunately, biomarker development work has made significant strides in recent years, and many are now available to diagnosis and track various neurodegenerative diseases. Further, the problem of access to those biomarkers has been solved with the development of salivary biosensors. Saliva is in general a reflection of the blood plasma and is a functionally convenient and reliable way to access molecules of interest. It is now possible to design an accurate and sensitive biosensor that can be placed in the mouth and monitor fluids over a prolonged period. This approach makes both disease diagnosis and tracking possible and will greatly influence how neurodegenerative diseases are managed in the future.

STUDIMI I SALIVËS PËR SËMUNDJET NEURODEGJENERATIVE

Stephen Thaddeus Connelly

Abstrakt

Kuptimi i patofiziologjisë që nxit sëmundje neurodegjenerative si sëmundja e Alzheimerit është rritur shumë në dekadat e fundit. Pavarësisht këtyre përparimeve shkencore, ne ende nuk kemi arritur ndonjë përparim të matshëm në parandalimin, kontrollin ose rikthimin e këtij grupi çrregullimesh. Një hap i rëndësishëm drejt zgjidhjes së këtij problemi është identifikimi i biomarkerëve specifikë të sëmundjes dhe aftësia për t'i matur ato në mënyrë të besueshme me kalimin e kohës. Për fat të mirë, puna për zhvillimin e biomarkerëve ka bërë përparime të rëndësishme vitet e fundit dhe shumë prej tyre tani janë në dispozicion për të diagnostikuar dhe gjurmuar sëmundje të ndryshme neurodegjenerative. Më tej, problemi i aksesit të këtyre biomarkuesve është zgjidhur me zhvillimin e biosensorëve salivar. Saliva është në përgjithësi një reflektim i plazmës së gjakut dhe është një metodë funksionale e përshtatshme dhe e besueshme për të patur akses tek molekulat me interes. Tani është e mundur të hartohet një biosensor i saktë dhe sensitiv që mund të aplikohet në gojë dhe të monitorojë fluidet për një periudhë të zgjatur. Kjo qasje bën të mundur diagnozën dhe gjurmimin e sëmundjes dhe do të ndikojë shumë në mënyrën se si menaxhohen sëmundjet neurodegjenerative në të ardhmen.

Fjalë kyç: saliva, sëmundjet neurodegjenerative

UPDATES ON THE EFFICACY OF AUTOLOGOUS PLATELET CONCENTRATES FOR HEALING PROMOTION IN ORAL SURGERY

Massimo Del Fabbro[1]
[1]Full Professor Università Milano

Abstract

The use of autologous platelet concentrates (APC) in the oral field has become widespread in the last 15 years, mainly due to their regenerative properties. Considerable technological advances, due to the efforts of the different Companies involved in this topic, allowed to increasing the applicability and predictability of such products. Pre-clinical and experimental research permitted to deepen the knowledge on the features and biological activity of APC. In this lecture, in addition to an initial overview, will be presented the most recent developments and the research trends regarding the various types of APC currently available. The efficacy of these products for regenerative procedures in the oral and maxillofacial field will be presented through the analysis of evidence-based studies like systematic reviews and meta-analyses. A brief overview of the use and efficacy of APC in other medical disciplines will also be outlined.

PËRDITËSIMI MBI EFIKASITETIN E KONCENTRATEVE AUTOLOGE TË TROMBOCITEVE PËR PROMOVIMIN E SHËRIMIT NË KIRURGJINË ORALE

Massimo Del Fabbro[1]
[1]Profesor, Universiteti Milano

Abstrakt

Përdorimi i koncentrateve autologe të trombociteve (APC) në fushën orale është përhapur në 15 vitet e fundit, kryesisht për shkak të vetive të tyre rigjeneruese. Përparimet e konsiderueshme teknologjike, falë përpjekjeve të kompanive të ndryshme të përfshira në këtë temë, lejuan rritjen e zbatueshmërisë dhe parashikueshmërisë së produkteve të tilla. Hulumtimet paraklinike dhe eksperimentale lejuan të thellojnë njohuritë mbi veçoritë dhe aktivitetin biologjik të APC. Në këtë leksion, përveç një pasqyre fillestare, do të prezantohen zhvillimet më të fundit dhe tendencat e kërkimit në lidhje me llojet e ndryshme të APC-ve aktualisht të disponueshme. Efikasiteti i këtyre produkteve për proçedurat rigjeneruese në fushën orale dhe maksilofaciale do të paraqitet përmes analizës së studimeve të bazuara në prova si rishikimet e literaturës dhe meta-analizat. Një përmbledhje e shkurtër e përdorimit dhe efikasitetit të APC në disiplina të tjera mjekësore do të prezantohet gjithashtu.

Fjalë kyç: koncentratet autologe të trombociteve.

PREVENTION AND MANAGEMENT OF VASCULAR OCCLUSIONS OF INJECTABLE AESTHETIC PROCEDURES

Prof. Patricia Oyole, DDS, OMS, MBA

Abstract

As we evolve from clinicians that come from a number of therapeutic backgrounds into professionals that can and might choose to perform minimally invasive aesthetic procedures, we face reactions and complications of those that challenge aesthetics outcome, post-operative healing time and patient expectations.

Vascular complications arise on a variety of intensity levels and rely on timing for identification and action, since damage is a function of blood flow for all tissues. On this lecture I'll present a few vascular reactions displays and illustrate how a vascular occlusion might look like from the inside.

PARANDALIMI DHE MENAXHIMI I OKLUZIONEVE VASKULARE TË PROCEDURAVE ESTETIKE TË INJEKTUESHME.

Prof. ssa Patricia Oyole

Abstrakt

Ndërsa ne evoluojmë, nga mjekë që vijnë nga një përvoje terapeutike në profesionistë që mund të zgjedhin të kryejnë proçedura estetike minimale invazive, ne përballemi me reagim të atyre që sfidojnë rezultatin estetik, kohën e shërimit pas operacionit dhe pritjet e pacientëve. Komplikimet vaskulare lindin në nivele të ndryshme intensiteti dhe mbështeten në kohën për identifikimin dhe veprimin, pasi dëmtimi është një funksion i rrjedhjes së gjakut për të gjitha indet. Në këtë leksion unë do të paraqes disa shfaqje të reagimit vaskular dhe do të ilustroj se si mund të duket një mbyllje vaskulare nga brenda.

Fjalë kyç: okluzione vaskulare, procedura estetike.

NEW TECHNOLOGIES IN ODONTOSTOMATOLOGY AND ORAL PATHOLOGY

Prof. Gianfranco Favia[1], Dott.ssa Luisa Limongelli[1]
[1]University of Bari

Abstract

In odontostomatology and oral pathology there is an increasing attempt to achieve diagnostic accuracy using non-invasive or minimally invasive diagnostic techniques. The same applies to the choice of treatment. In achieving this goal, new technologies such as high-definition ultrasound and laser-mediated diagnostic and therapeutic techniques are of great help.

TEKNOLOGJITË E REJA NË ODONTO-STOMATOLOGJI DHE PATOLOGJI ORALE.

Prof. Gianfranco Favia[1], Dott.ssa Luisa Limongelli[1]
[1]Universiteti i Barit

Abstrakt
Në odontostomatologji dhe patologji orale ka një përpjekje në rritje për të arritur saktësinë diagnostike duke përdorur teknika diagnostike jo-invazive ose minimalisht invazive. E njëjta gjë vlen edhe për zgjedhjen e trajtimit. Në arritjen e këtij qëllimi, teknologjitë e reja si ultratingujt me cilësi të lartë dhe teknikat diagnostikuese dhe terapeutike me lazer janë një ndihmë e madhe.

Fjalë kyç: odontostomatologji, patologji orale, muskujt përtypës dhe të qafës, elektromiografia.

ARTHROSCOPIC PROCEDURE FOR HABITUAL DISLOCATION OF THE TEMPOROMANDIBULAR JOINT

Prof. Aldo Bruno Giannì, Dott. Antonio Russillo

Abstract

Habitual temporomandibular joint (TMJ)luxation is a serious condition for the patient, and is often managed by extensive open joint surgery. A unique surgical technique, arthroscopic eminoplasty associated to electrothermal capsulorrhaphy was performed. The aim of this study is to evaluate the therapeutic effects and side effects of arthroscopic eminoplasty with electrothermal capsulorrhaphy in habitual TMJ luxation.

PROCEDURA ARTROSKOPIKE PËR DISLOKIMIN HABITUAL TË ARTIKULACIONIT TEMPOROMANDIBULAR.

Prof. Aldo Bruno Gianni, Dott. Antonio Russillo

Abstrakt

Luksacioni habitual i artikulacionit temporomandibular (ATM) është një gjendje serioze për pacientin dhe shpesh menaxhohet nga ndërhyrje ekstensive e artikulacionit. U realizua një teknikë unike kirurgjikale, eminoplastia artroskopike e lidhur me kapsulorrafinë elektrotermale. Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë efektet terapeutike dhe efektet anësore të eminoplastikës artroskopike me kapsulorrafi elektrotermale në luksacionin habitual të ATM.

Fjalë kyç: artikulacioni temporobandibular, procedura atroskopike.

ORAL MICROBIOTA, PERIODONTITIS AND OSTEOPOROSIS: BIDIRECTIONAL INTERRELATIONSHIPS AND CLINICAL IMPLICATIONS

Prof. Maria Contaldo[1], Prof. Rosario Serpico[2]
[1]*Università Napoli Vanvitelli*
[2]*Full professor*

Abstract

Osteoporosis and periodontal disease share many risk factors, and both diseases have a significant impact on the quality of life of affected individuals. A typical and characteristic element of both is the progressive alveolar bone resorption. It can occur simultaneously or metachronously with the systemic decline in bone mineral density during osteoporosis. Finally, it is a fact that osteoporosis does not spare the alveolar bones of the jaws. The relationships between the two pathologies will then be defined in light of the metabolic alterations and oral dysbiosis that they share. Any potential link of causality between the two pathologies will be reported, if this is bidirectional or unidirectional, or if, on the contrary, this association is only random free of intercorrelations. Therefore, we will address the problem from two points of view, posing two complementary questions: Is osteoporosis a risk factor for periodontal disease? And vice versa: Can the periodontopathic patient's microbiome influence bone resorption and local and systemic bone metabolism?

MIKROBIOTA ORALE, PERIODONTITI DHE OSTEOPOROZA: MARRËDHËNIET E NDËRSJELLA TË DYFISHTA DHE IMPLIKIMET KLINIKE.

Prof. Maria Contaldo[1], Prof. Rosario Serpico[2]
[1]*Università Napoli Vanvitelli*
[2]*Full professor*

Abstrakt

Osteoporoza dhe sëmundja periodontale ndajnë shumë faktorë rreziku, dhe të dyja sëmundjet kanë një ndikim të rëndësishëm në cilësinë e jetës së individëve të prekur. Një element tipik dhe karakteristik i të dyjave është rezorbimi progresiv i kockës alveolare. Mund të ndodhë njëkohësisht ose ne veçanti me rënien e densitetit mineral kockor gjatë osteoporozës. Së fundi, është fakt që osteoporoza nuk kursen as kockat alveolare të nofullave. Marrëdhëniet midis dy patologjive do të përcaktohen më pas në dritën e ndryshimeve metabolike dhe disbiozës orale që ato ndajnë. Çdo lidhje e mundshme e shkakësisë midis dy patologjive do të raportohet, nëse kjo është e dyanshme ose e njëanshme, ose nëse, përkundrazi, kjo lidhje është vetëm e rastësishme pa ndërlidhje. Prandaj, ne do ta trajtojmë problemin nga dy këndvështrime, duke shtruar dy pyetje plotësuese: A është osteoporoza një faktor rreziku për sëmundjen periodontale? Dhe anasjelltas: A mund të ndikojë mikrobioma e pacientit periodontopatik në rezorbimin e kockave dhe metabolizmin lokal dhe sistemik të kockave?

Fjalë kyç: mikrobiotika orale, osteoporoza.

ADVANCES AND INSIGHTS IN ADJUVANT SUPPLEMENTS-ASSISTED APPROACHES FOR BONE HEALING

Prof. Felice Lorusso[1], Prof. Antonio Scarano[1]
[1]*University of Chieti, Full professor*

Abstract

The bone defects treatment is a regenerative medicine field that consider a multidisciplinary approach for the treatment of the damaged hard tissue and mineral homeostasis restoration after trauma, degenerative diseases, neoplasms, or congenital disorders. The recent applications in this field are oriented to novel applications of molecules characterized by a biological activity on the mesenchymal cells osteogenic differentiation and new bone formation in vivo. The aim of the present investigation was to evaluate the mesenchymal cells osteogenic differentiation and proliferation and the in vivo new bone formation through adjuvant supplements-assisted therapy by curcumin, apigenin and resveratrol. In vitro, it was demonstrated an up-regulation of COLL1, COLL4 and COLL5 genes in presence of Apigenin, Curcumin and Resveratrol. In vivo, the apigenin induced a significant increase of bone healing in critical size defects in rats calvaria whose evidence encourages a translational application of adjuvant supplements-assisted therapy for the bone defects repair. Given what is already known about the effects of these molecules, longer term studies in models of experimental bone defects might be required to elucidate their effects.

PËRPARIMET DHE ZHVILLIMET MBI SUPLEMENTET NDIHMËSE PËR SHËRIMIN KOCKOR.

Prof. Felice Lorusso[1], Prof. Antonio Scarano[1]
[1]*University of Chieti, Full professor*

Abstrakt
Trajtimi i defekteve kockore është një fushë e mjekësisë rigjeneruese që konsideron një qasje multidisiplinare për trajtimin e indeve të forta të dëmtuara dhe restaurimin e homeostazës minerale pas traumave, sëmundjeve degjenerative, neoplazmave ose çrregullimeve kongjenitale. Aplikimet e fundit në këtë fushë janë të orientuara në aplikime të molekulave të reja të karakterizuara nga një aktivitet biologjik në diferencimin osteogjenik të qelizave mezenkimale dhe formimin e kockave të reja in vivo. Qëllimi i këtij investigimi ishte të vlerësonte diferencimin dhe proliferimin osteogjenik të qelizave mezenkimale dhe formimin in vivo të kockave të reja nëpërmjet terapisë së asistuar nga suplementet ndihmëse me kurkumin, apigenin dhe resveratrol. In vitro, u demonstrua një rritje e gjeneve COLL1, COLL4 dhe COLL5 në prani të Apigenit, Kurkuminit dhe Resveratrol. In vivo, apigenina shkaktoi një përmirësim të konsiderueshëm të shërimit kockor në defektet e madhësisë kritike në mostrën e minjve, provat e të cilave inkurajojnë një aplikim të terapisë së asistuar nga suplementet ndihmëse për riparimin e defekteve kockore. Duke pasur parasysh atë që dihet tashmë për efektet e këtyre molekulave, mund të kërkohen studime afatgjata në modelet e defekteve eksperimentale të kockave për të sqaruar efektet e tyre.

Fjalë kyç: shërim kockor, defekt kockor.

DENTAL ERUPTION ANOMALIES IN INTERCEPTIVE ORTHODONTICS

Prof. Ssa Daniela Di Venere[1]
[1]*Associated professor, University of Bari*

Abstract

Dental eruption is influenced by genetic, systemic, general and local factors. In this report, the main pictures of eruption disorders of the permanent first and second molars will be presented, with a focus on ectopic eruption of the upper permanent first molar.

ANOMALITË E ERUPSIONIT DENTAR NË ORTODONCINË INTERCEPTIVE

Prof. Asoc. Daniela Di Venere[1]
[1]*Associated professor, University of Bari*

Abstrakt

Erupsioni dentar ndikohet nga faktorë gjenetikë, sistemikë, të përgjithshëm dhe lokalë. Në këtë raport do të prezantohen pikat kryesore të çrregullimeve të erupsionit të molarit të parë

dhe të dytë të përhershëm, me fokus në erupsionin ektopik të molarit të parë të përhershëm të sipërm.

Fjalë kyç: erupsion, anomali, ortodonci interceptive.

KRITERET E SUKSESIT TË TRAJTIMEVE TË KANALIT TË RRËNJËVE.

Lumnije Kqiku

Abstrakt

Qëllimi kryesor i trajtimit endodontik është të sigurojë një mbyllje të ngushtë apikale dhe koronale. Një vulosje hermetike lejon shërimin e indit periapikal, parandalon periodontitin apikal dhe ndalon infeksionin e kanalit të rrënjës. Janë propozuar metoda të ndryshme të mbylljes së kanalit të rrënjës për mbushje të plota dhe të papërshkueshme. Edhe nëse kondensimi anësor i ftohtë ende konsiderohet teknika më e përdorur, ka alternativa të shumta që përdorin nxehtësinë për të arritur përshtatjen optimale të guta-perkës në hapësirën e kanalit të rrënjës. Teknika e hedhjes së kanalit me një kon që përdor vetëm konin kryesor ka fituar popullaritet me ardhjen e sistemeve të instrumenteve rrotulluese me nikel titan. Në prezantimin aktual, do të shihet suksesi i trajtimit endodontik të teknikave të ndryshme veçanërisht të teknikës së guta-perkës së ngrohtë.

Fjalë kyç: guta-perka, vulosje hermetike.

THE EVOLUTION OF REGENERATIVE PERIODONTAL SURGERY

Beatrice Femminella

Abstract

Starting from the first experiments of the Scandinavian Research Groups on Periodontal Regeneration, the evolutionary process of reconstructive therapy of periodontal tissues is described.

After showing the biological basis of regenerative periodontal therapy, the evolution of the surgical technique and materials passing through the different types of membranes, Regenerative Therapy Combined with Fillers and Periodontal Regeneration Induced with Amelogenins is illustrated. Therefore, the new frontiers of Regeneration are envisaged using Growth Factors and Tissue Engineering based on the use of Periodontal Stem Cells.

EVOLUCIONI I KIRURGJISË PERIODONTALE RIGJENERATIVE

Beatrice Femminella

Abstrakt

Duke u nisur që nga eksperimentet e para të realizuara nga grupet kërkimore Skandinave mbi Rigjenerimin Periodontal e deri më sot, do të përshkruhet proçesi evolucionar i terapisë rikonstruktive të indeve periodontale. Pas prezantimit të bazave biologjike të terapisë rigjenerative periodontale, do të ilustrohet evolucioni i teknikës kirurgjikale dhe materialeve me llojet e ndryshme të membranave, Terapia Rigjenerative e Kombinuar me Filler dhe Rigjenerimi periodontal me Amelogeninë. Prandaj, perspektivat e reja të Rigjenerimit parashikohen në përdorimin e faktorëve të rritjes dhe në inxhinierinë indore bazuar në përdorimin e qelizave staminale periodontale.

Fjalë kyç: kirurgjia periodontale rigjenerative, amelogeninë.

INTRAORAL SCANNER AND BASIC CONCEPTS OF ITS USE IN DENTAL PROSTHETICS

Lorenzo Arcuri

Abstract

Digital dental technology has evolved rapidly since the introduction of the computer-aided design and computer-aided manufacturing (CAD-CAM). Nowadays, intraoral scanner (IOS) and CAD/CAM provide easier treatment planning, case acceptance, communication with dental technicians, operative time reduction, storage optimization, and reduced treatment times. The last decade has seen an increasing number of optical IOSs, and these are based on different technologies; the choice of which may impact on clinical use. Nevertheless, the clinical application of IOSs in fixed prosthodontics and implantology necessarily requires knowledge and a learning curve as well as a constant update due to the fast evolution of these technologies.

SKANERI INTRAORAL DHE KONCEPTET BAZË TË PËRDORIMIT TË TIJ NË PROTETIKËN STOMATOLOGJIKE.

Lorenzo Arcuri

Abstrakt

Teknologjia dentare dixhitale ka evoluar me shpejtësi që nga prezantimi i dizajnit dhe prodhimit me ndihmën e kompjuterit (CAD-CAM). Në ditët e sotme, skaneri intraoral (IOS) dhe CAD/CAM ofrojnë planifikim më të lehtë të trajtimit, pranim të rasteve, komunikim me teknikët dentarë, reduktim të kohës operative, optimizim dhe shkurtim të kohës së trajtimit. Në dekadën e fundit është parë një numër në rritje i skanerave optikë, dhe këto janë të bazuara në teknologji të ndryshme; zgjedhja e të cilave mund të ndikojë në përdorimin klinik. Megjithatë, aplikimi klinik i skanerëve intraoral në protetikën fikse dhe implantologji kërkon domosdoshmërisht njohuri si dhe një përditësim të vazhdueshëm të dijeve për shkak të evolucionit të shpejtë të këtyre teknologjive.

Fjalë kyç: skaner intraoral, protetika stomatologjike.

PERIIMPLANTITET DHE TRETMANI I TYRE NË STOMATOLOGJINË MODERNE

Doc. Dr.Arbëresha Bexheti Ferati, Doc. Dr. Kenan Ferati, Ass.Dr. Jeta Bexheti
University of Tetova

Abstrakt

Implantologjia paraqet shkencë të rëndësishme në stomatologjinë moderne. Implementimi implanteve dentare në Stomatologjinë moderne qëllimi i së cilës është të zëvendësojë dhëmbët e humbur biologjik.
Që nga implantimi i implanteve ne ndeshemi me sëmundje të ndryshme të sistemit orofacial. Perimukoziti dhe Periimplantiti janë sëmundjet më të shpeshta te të cilët shkaktar kryesor për paraqitjen e tyre janë mikrooorganizmat e zgavrës orale.
Mikroorganizmat atakojnë në fillim indet siperfaqësore mukozën orale dhe pastaj progredojnë në indet e forta, me çka vjenë deri te ndryshimet ireverzibile patologjike të mukozës përreth implantit. Progredimi i procesit patologjik shpien në osteolizë të kockës përreth implantit.
Në studimin tonë do të paraqesim mënyrat bashkëkohore të trajtimit të periimplantiit te pacientët me implante dentare.

Fjalë kyce: Mikroorganizmat,Bakteret, implantet, peri-implantit.

ÇRREGULLIMET E NYJES TEMPOMANDIBULARE SI PASOJË E PUNIMEVE PROTETIKE JOADEKUATE

Teuta Pustina

Abstrakt
Artikulacioni temporo-mandibular si të gjithë artikulacionet tjera të organizmit preket nga sëmundje të ndryshme. Patologjia më e shpeshtë që haset në praktikën stomatologjike është çrregullimi disfunksional i tij. Çrregullimet mund të jenë me natyrë të ndryshme inflamatore, jo inflamatore, degjenerative, tumorale, traumatike. Në rutinën stomatologjike hasim shpesh në disfunksione të artikulacionit, si pasojë e punimeve protetikore. Mospërputhshmëritë okluzale, që mund të vijnë si pasojë e punimeve protetike joadekuate, në vargjet dentare, raportet e ndërsjella /në relacion qëndror, në okluzion qëndror/ provokojnë dëmtimë traumatike të nyjes ose shkaktojnë spazma muskulore, andaj gjatë mbarimit të punimeve protetike duhet të respektohen në perpikmëri fazat e punës të cilat kanë të bëjnë me përputhshmëritë okluzale ndërmjet punimeve protetikore dhe dhëmbëve natyralë si dhe ndërmjet punimeve protetikore në të dy nofullat. Ndryshimet që ndodhin në vargjet dentare dhe në artikulacionin temporomandibular mund të jenë të natyrës reversibile apo në raste më të rënda edhe të natyrës joreversibile, që mund të përcillen me humbjen e dhëmbëve apo edhe me dëmtim të nyjes tek pacientët tonë.

Fjalë kyç: artikulacioni temporo-mandibular, relacion qëndror, okluzion qëndror.

REVERSE ENGINEERING ANALYSIS OF DIMENSIONAL CHANGE IN POST-EXTRACTION ALVEOLAR RIDGE

Gianmaria d'Addazio[1,2], Manlio Santilli[1,2], Imena Rexhepi[1,2], Sergio Caputi[1,2], Bruna Sinjari[1,2]

[1]Department of Innovative Technologies in Medicine and Dentistry, University "G. d'Annunzio" Chieti-Pescara, 66100 Chieti, Italy

[2]Electron Microscopy Laboratory, University "G. d'Annunzio" Chieti-Pescara, 66100 Chieti, Italy

Abstract

Teeth Extractions are one of the most common procedures in oral surgery. After tooth extraction, the alveolar ridge undergoes a series of biological and physiological events that lead to bone resorption and remodeling. Clinical studies show more pronounced resorption in the first year and in the vestibular side. Several techniques have been used to assess the degree of resorption. CBCT, histological evaluation, clinical parameters.

The objective of this observation study was to evaluate *in vivo*, using reverse engineering software, the degree of bone resorption of post-extraction alveoli treated with socket preservation protocols. A total of 20 patients were considered. Among these,10 patients undergoing single root tooth extractions were included in the study. The patients were treated with socket preservation protocols with allograft material and collagen membrane. 10 patients undergoing extraction and spontaneous healing were used as controls. Pre-extraction intraoral optical impressions and scans carried out 3 months after the extraction, were used for comparison. Images were overlaid using the software's registration algorithm to compare the change between patients. Changes in alveolar height and width were measured and analyzed. Statistical analysis was used to examine differences between groups.

The results demonstrate a statistically significant difference in the degree of resorption in patients treated with socket preservation and spontaneous healing protocols ($p<0.05$). In vivo analysis with reverse engineering software allowed to obtain repeatable measure of the volumetric differences between patients.

In conclusion, socket preservation protocols with collagen membranes allows to guarantee a statistically significant reduction in resorption. Moreover, reverse engineering software permits to monitorize the dimensional change in the alveolar ridge, eliminating unnecessary radiation doses. Further research is needed to verify these findings.

ANALIZA INXHINIERIKE E NDRYSHIMIT DIMENSIONAL NË KRESHTËN REZIDUALE PAS EKSTRAKSIONIT.

Gianmaria d'Addazio, Manlio Santilli, Imena Rexhepi, Sergio Caputi, Bruna Sinjari

Departamenti i Teknologjive Inovative në Mjekësi dhe Stomatologji, Universiteti "G. d'Annunzio" Chieti-Pescara, 66100 Chieti, Itali.

Laboratori i Mikroskopisë Elektronike, Universiteti "G. d'Annunzio" Chieti-Pescara, 66100 Chieti, Itali.

Abstrakt

Ekstraksioni dentar është një nga procedurat më të zakonshme në kirurgjinë orale. Pas ekstraksionit dentar, kreshta reziduale i nënshtrohet një sërë ndryshimesh biologjike dhe fiziologjike që çojnë në rezorbimin dhe rimodelimin e kockës. Studimet klinike tregojnë rezorbim më të theksuar në vitin e parë dhe në anën vestibulare. Janë përdorur disa teknika për të vlerësuar shkallën e rezorbimit: CBCT, vlerësimi histologjik, parametrat klinikë.Objektivi i këtij studimi ishte të vlerësonim shkallën e rezorbimit kockor të alveolave pas ekstraksionit të trajtuara me protokolle të ruajtjes së alveolës duke përdorur softuerin inxhinierik, in vivo. Janë marrë në konsideratë gjithsej 20 pacientë. Midis tyre, në studim u përfshinë 10 pacientë që i nënshtroheshin ekstraksionit të dhëmbëve mono radikular. Pacientët u trajtuan me protokolle të ruajtjes së alveolave me material alograft dhe membranë kolagjeni. 10 pacientë që i nënshtroheshin ekstraksionit dhe shërimit spontan u përdorën si grup kontrolli. Për krahasim u përdorën impresionet para-ekstraksionit dhe skanimet intraorale të kryera 3 muaj pas ekstraktimit. Imazhet u mbivendosën duke përdorur algoritmin e regjistrimit të softuerit për të krahasuar ndryshimin midis pacientëve. Ndryshimet në lartësinë dhe gjerësinë alveolare janë matur dhe analizuar. Analiza statistikore u përdor për të ekzaminuar dallimet midis grupeve. Rezultatet demonstrojnë një ndryshim statistikisht domethënës në shkallën e rezorbimit në pacientët e trajtuar me protokolle të ruajtjes së alveolës dhe shërimit spontan ($p < 0.05$). Analiza in vivo me softuerin inxhinierik lejoi të përftohej matje e përsëritshme e dallimeve volumetrike midis pacientëve. Si përfundim, protokollet e ruajtjes së alveoles me membranat e kolagjenit garantojnë një reduktim statistikisht të rëndësishëm të rezorbimit. Për më tepër, softueri inxhinierik lejon monitorimin e ndryshimit të dimensioneve në kreshtën alveolare, duke eliminuar dozat e panevojshme të rrezatimit. Nevojiten kërkime të mëtejshme për të verifikuar këto gjetje.

Fjalë kyç: kreshta reziduale, ndryshim dimensional.

DIGITAL DENTISTRY AND NEW TECHNOLOGIES

Prof. Marco Farronato

Abstract

The contemporary practice is highly influenced by the digital workflow. Recent trends allow the clinician to operate in a fully digital workflow. The new technologies can help not only for the 3D analysis but also for guided operations. We studied new technologies and their applications in the field of orthodontics and oral surgery in general. One of those promising disruptive technologies that can be used today is the Augmented Reality.

DENTISTRIA DIXHITALE DHE TEKNOLOGJITË E REJA

Prof. Marco Farronato

Abstrakt

Praktika bashkëkohore është shumë e ndikuar nga rrjedha e punës dixhitale. Tendencat e fundit i lejojnë klinicistit të operojë në një rrjedhë pune plotësisht dixhitale. Teknologjitë e reja mund të ndihmojnë jo vetëm për analizën 3D, por edhe për nderhyrjet e drejtuara. Ne studiojmë teknologjitë e reja dhe aplikimet e tyre në fushën e ortodoncisë dhe kirurgjisë orale

në përgjithësi. Një nga ato teknologjitë premtuese që mund të përdoret sot është Realiteti i Shtuar.

Fjalë kyç: dentistria dixhitale, analiza 3D.

LASER ASSISTED TREATMENT FOR DENTINAL HYPERSENSITIVITY

Prof. Ioana Roxana Bordea

Abstract

Dentinal hypersensitivity (DH) is defined as a chronic disorder in which there is an abnormal response to various thermal, chemical and tactile stimuli of the exposed vital dentine. Lasers being the latest treatment options, a study was conducted to evaluate the efficacy of lasers as an adjuvant device for the treatment of dentinal hypersensitivity.

TRAJTIM I ASISTUAR ME LAZER NË HIPERSENSITIVITETIN DENTINAR.

Prof. Ioana Roxana Bordea

Abstrakt

Hipersensitiviteti dentinar (DH) përkufizohet si një çrregullim kronik në të cilin ka një përgjigje jonormale ndaj stimujve të ndryshëm termikë, kimikë dhe taktil të dentinës vitale të ekspozuar. Lazerat duke qenë opsionet më të fundit të trajtimit, u zhvillua një studim për të vlerësuar efikasitetin e lazerit si një pajisje ndihmëse për trajtimin e mbindjeshmërisë dentinare.

Fjalë kyç: lazer, hipersensitivitet dentinar.

ORTHODONTIC INTRUSION OF UPPER INCISORS IN A PERIODONTOPATHIC PATIENT: A CASE REPORT

Dott. Ssa. Giuseppina Malcangi

Abstract

The aim of this study is to illustrate a case of intrusion of severely compromised maxillary periodontal incisors through the application of light orthodontic forces and diode laser without periodontal side effects and with good finalization of the orthodontic treatment. In 11 months of treatment, intrusion and levelling of 21 and 22 were obtained, with improvement of mobility and depth of periodontal pockets.The application of light forces associated with the monitoring of bacterial plaque and biostimulation of periodontal sockets using the diode laser allowed the control of the inflammatory state of periodontal sockets preventing their progression.

INTRUZIONI ORTODONTIK I INCIZIVËVE TË SIPËRM NË NJË PACIENT PERIODONTOPATIK: RAPORTIM RASTI

Dr. Giuseppina Malcangi

Abstrakt

Qëllimi i këtij studimi është të ilustrojë një rast të intruzionit të incizivëve maksilarë të komprometuar rëndë në aspektin periodontal nëpërmjet aplikimit të forcave të lehta ortodontike dhe lazerit diodë pa efekte anësore periodontale dhe me një finalizim të mirë të trajtimit ortodontik. Në 11 muaj trajtim, u arrit intruzioni dhe nivelim i 21 dhe 22, me përmirësim të lëvizshmërisë dhe thellësisë së xhepave periodontal. Aplikimi i forcave të lehta së bashku me monitorimin e pllakës bakteriale dhe biostimulimin e xhepave periodontale duke përdorur lazerin diodë lejoi kontrollin e gjendjes inflamatore të xhepave periodontale duke parandaluar avancimin e tyre.

Fjalë kyç: intruzioni ortodontik, pacient periodontopatik.

OCCLUSAL SPLINTS AND ORTHODONTIC TREATMENT IN GROWING PATIENTS WITH TEMPOROMANDIBULAR DISORDERS

Dott. Ssa Ludovica Nucci[1], Dott. Ssa Fabrizia D'apuzzo
[1]Universitety of Napoli Vanvitelli

Abstract

Temporomandibular disorders (TMD) include several clinical problems involving the craniofacial muscles, the temporomandibular joints or both. Although TMD affects adults more frequently, signs and symptoms are observed in 16 to 68% of children and adolescents. The prevalence is higher in females than in males and increases during the pubertal development. The etiopathogenesis of TMD in growing patients includes systemic, pathological, psychosocial, traumatic, hormonal, genetic, skeletal and occlusal factors. The diagnosis of DTM is based on medical history collection, clinical examination and instrumental diagnosis. For clinical diagnosis we use the Diagnostic Criteria for Temporomandibular Disorders (DC/TMD), recently updated for young patients. The objectives of the treatment of TMD are the restoration of function, the reduction of pain, the control of any aggravating or contributing factors and overall an improvement of the quality of life. The purpose of an occlusal splint is to provide orthopedic stability to the TMJ before beginning orthodontic treatment in permanent dentition. Splints temporarily alter the patient's occlusion and can be used to reduce parafunctional activity and pain. Some of the young patients with TMD are affected by juvenile idiopathic arthritis (JIA), the most common pediatric chronic rheumatic disease. JIA is a chronic autoimmune inflammation with unknown etiology. It can affect one or more joints, with symptoms that persist for more than six weeks and occur before the age of 16 years, and TMJ involvement ranges from 17% to 87%.

Typical craniofacial changes that may occur in patients with JIA include open skeletal bite, various types of malocclusion, and facial asymmetries. Specific signs and symptoms of TMD in patients with JIA are inflammation of the synovial membrane, presence of "pannus", demineralization of the condylar cartilage and joint degeneration, pain and sound, functional limitations of movement and headache. Treatment in patients with JIA is multidisciplinary and includes drugs, behavioral therapy, physical, gnathological, orthodontic and surgical therapies and continuous follow-up by the rheumatologist.

SPLINTET OKLUZALE DHE TRAJTIMI ORTODONTIK NË PACIENTËT NË RRITJE ME ÇRREGULLIME TEMPORO-MANDIBULARE.

Dr. Ludovica Nucci1, Dr. Fabrizia D'apuzzo
[1]*Universiteti Napoli Vanvitelli*

Abstrakt

Çrregullimet temporomandibulare (TMD) përfshijnë disa probleme klinike që përfshijnë muskujt kraniofacialë, artikulacionet temporomandibulare ose të dyja së bashku. Megjithëse çrregullimet e ATM prekin më shpesh të rriturit, shenjat dhe simptomat vërehen në 16 deri në 68% të fëmijëve dhe adoleshentëve. Prevalenca është më e lartë tek femrat sesa tek meshkujt dhe rritet gjatë zhvillimit të pubertetit. Etiopatogjeneza e TMD në pacientët në rritje përfshin faktorë sistemik, patologjik, psikosocial, traumatik, hormonal, gjenetik, skeletal dhe okluzal. Diagnoza bazohet në marrjen e historisë mjekësore, ekzaminimin klinik dhe ekzaminimet shtesë. Për diagnozën klinike ne përdorim Kriteret Diagnostike për Çrregullimet Temporomandibulare (DC/TMD), të përditësuar së fundmi për pacientët e rinj. Objektivat e trajtimit janë rivendosja e funksionit, reduktimi i dhimbjes, kontrolli i çdo faktori rëndues ose kontribues dhe në përgjithësi një përmirësim i cilësisë së jetës. Qëllimi i një splinti okluzal është të sigurojë stabilitet ortopedik të ATM-së përpara fillimit të trajtimit ortodontik në dhëmbët e përhershëm. Splintet ndryshojnë përkohësisht okluzionin e pacientit dhe mund të përdoren për të reduktuar aktivitetin parafunksional dhe dhimbjen. Disa nga pacientët e rinj me çrregullim të ATM janë të prekur nga artriti idiopatik juvenil (JIA), sëmundja më e zakonshme reumatoide kronike pediatrike. JIA është një inflamacion kronik autoimun me etiologji të panjohur. Mund të prekë një ose më shumë artikulacione, me simptoma që vazhdojnë për më shumë se gjashtë javë dhe ndodhin para moshës 16 vjeç, dhe përfshirja e ATM varion nga 17% në 87%.
Ndryshimet tipike kraniofaciale që mund të ndodhin në pacientët me JIA përfshijnë kafshimin skeletal te hapur, lloje të ndryshme malokluzionesh dhe asimetri të fytyrës. Shenjat dhe simptomat specifike të TMD në pacientët me JIA janë inflamacioni i membranës sinoviale, prania e "pannusit", demineralizimi i kërcit kondilar dhe degjenerimi i artikulacioneve, dhimbja dhe zhurmë, kufizimet funksionale të lëvizjes dhe dhimbje koke. Trajtimi në pacientët me JIA është multidisiplinar dhe përfshin medikamente, terapi të sjelljes, terapi fizike, gnatologjike, ortodontike dhe kirurgjikale dhe ndjekje të vazhdueshme nga mjeku reumatolog.

Fjalë kyç: splinte okluzale, trajtim ortodontik.

THE EFFECT OF ELASTODONTIC THERAPY IN CHILDREN WITH ANTERIOR OPEN BITE AND TONGUE DYSFUNCTION

Dott. Filippo Cardarelli[1]
[1]*University of Bari*

Abstract

Elastodontics is a revolutionary orthodontic technique that employs elastic forces to correct malocclusions in children and acts in a threedimensional manner in the oral cavity affecting bone bases growth, removing functional disorders and repositioning teeth. Elastodontic devices can be premade or constructed of soft plastic material and are appropriate to play a skeletal, dental, muscular and postural action. Infact, by harmonizing the perioral, oral, and lingual muscles, elastodontic treatment aims to address the skeletal and dentoalveolar components of malocclusions and restore a normal muscular function.

EFEKTI I TERAPISË ELASTODONTIKE TEK FËMIJËT ME KAFSHIM TË HAPUR ANTERIOR DHE MOSFUNKSIONIM TË GJUHËS.

Dott. Filippo Cardarelli[1]
[1]*Universiteti i Barit*

Abstrakt

Elastodontika është një teknikë revolucionare ortodontike që përdor forca elastike për të korrigjuar malokluzionet tek fëmijët dhe vepron në mënyrë tredimensionale në zgavrën e gojës duke ndikuar në rritjen e bazave kockore, duke hequr çrregullimet funksionale dhe duke ripozicionuar dhëmbët. Pajisjet elastodontike mund të bëhen paraprakisht ose të ndërtuara nga një material plastik i butë dhe janë të përshtatshme për të luajtur një rol skeletal, dentar, muskulor dhe postural. Në fakt, duke harmonizuar muskujt perioral, oral dhe gjuhësor, trajtimi elastodontik synon të trajtojë komponentët skeletal dhe dentoalveolarë të malokluzioneve dhe të rivendosë një funksion normal muskulor.

Fjalë kyç: kafshim i hapur anterior, terapia elastodontike.

DEMINERALIZED VS MINERALIZED TOOTH MATRIX IN BONE REGENERATION

Dott. ssa Denisa Hazballa

Abstract

Background: The tooth material material serves as a perfect scaffold because of its composition when 65% is the inorganic part, hydroxyapatite which is similar to that of bone. The organic part 35% consist mainly of type 1 collagen and non-collagenic proteins such as grown factors (BMPs). When tooth matrix is treated correctly BMPs offers

osteoinductive properties to this material. BMPs have a strong osteoinductive potential, but used alone are very soluble and lose their properties. The combination of BMPs with biomaterials serves as a carrier for them.

Some authors declare that mineralized tooth matrix takes longer time to re-absorb and fails to trigger the new bone regeneration instead the demineralization process can also lead to the complete destruction of dentinal tubules and a low osteogenic potential because eliminate the proteins. When dental matrix is partially demineralized has a greater regeneration potential. Partially demineralization process does not eliminate BMPs and collagen. In fact, the demineralized surfaces are the most adherent for osteoblasts and also decalcification serves to make the dentin matrix more accessible to collagenolytic enzymes.

From the physio-chemical side, the tooth matrix can be considered a material comparable to bone but with higher mineralization. A total demineralization as well as a mineralized tooth matrix did not produce good results in bone regeneration. Partially demineralized dentine is a promising way to use tooth graft in bone regeneration.

MATRICA E DEMINERALIZUAR KUNDREJT MATRICËS SË MINERALIZUAR DHËMBORE NË RIGJENERIMIN E KOCKAVE

Dr. Denisa Hazballa

Abstrakt

Hyrje: Materiali dhëmbor shërben si një matricë perfekte për shkak të përbërjes së tij ku 65% është pjesa inorganike, hidroksiapatiti i cili është i ngjashëm me strukturën kockore. Pjesa organike 35% përbëhet kryesisht nga kolagjen i tipit 1 dhe proteina jo kolagjenike si faktorët e rritjes (BMP, Proteina morfogjenetike kockore). Kur matrica dhëmbore trajtohet në mënyrë korrekte, BMP-të i ofrojnë këtij materiali veti osteoinduktive. BMP-të kanë një potencial të fortë osteoinduktiv, por të përdorura vetëm janë shumë të tretshme dhe humbasin vetitë e tyre. Kombinimi i BMP-ve me biomaterialet është i nevojshëm për to. Disa autorë deklarojnë se matrica e mineralizuar e dhëmbëve kërkon më shumë kohë për t'u ri-absorbuar dhe nuk arrin të nxisë rigjenerimin e kockës së re, por dhe procesi i demineralizimit mund të çojë gjithashtu në shkatërrimin e plotë të tubulave dentinare dhe në një potencial të ulët osteogjenik për shkak të eliminimit të proteinave. Kur matrica dentare demineralizohet pjesërisht ka një potencial më të madh rigjenerimi. Procesi i demineralizimit në mënyrë të pjesshme nuk eliminon BMP-të dhe kolagjenin. Në fakt, sipërfaqet e demineralizuara janë më ngjitëse për osteoblastet dhe gjithashtu dekalcifikimi shërben për ta bërë matricën e dentinës më të aksesueshme për enzimat kolagjenolitike. Nga ana fiziko-kimike, matrica e dhëmbit mund të konsiderohet një material i krahasueshëm me kockën, por me mineralizim më të lartë. Demineralizimi total si dhe matrica e mineralizuar e dhëmbëve nuk dhanë rezultate të mira në rigjenerimin e kockave. Dentina pjesërisht e demineralizuar është një mënyrë premtuese për të përdorur graftin dhëmbor në rigjenerimin e kockave.

GNATHOLOGY AND POSTURE: CLINICAL CASE

Dr. Zagaria Luigi

Abstract

The imbalance of the TMJ along with other gnathological problems is often the cause of postural problems. When the jaw and mandible are not in a correct relationship with each other, a series of compensations are established that affect the musculoskeletal bands outside the stomatognathic system. These compensations most of the time lead to situations of imbalance, and the imbalance leads to problems of back pain, neck pain and lumbago with consequent alteration of posture. With the description of a clinical case, Dr. Zagaria will show how thanks to the use of a muscle relaxant bite it is possible to improve the potural structure of patients with TMJ dysfunction.

GNATOLOGJIA DHE POSTURA: RAST KLINIK

Dr. Luigi Zagaria

Abstrakt

Çekuilibri i ATM-se së bashku me problemet e tjera gnatologjike është shpesh shkaku i problemeve posturale. Kur nofulla dhe mandibula nuk janë në një marrëdhënie korrekte me njëra-tjetrën, krijohen një sërë kompensimesh që prekin brezat muskuloskeletorë jashtë sistemit stomatognatik. Këto kompensime në shumicën e rasteve çojnë në situata të çekuilibrit, dhe çekuilibri çon në probleme të dhimbjes së shpinës, qafës dhe lumbagos me pasojë ndryshimin e qëndrimit. Me përshkrimin e një rasti klinik, Dr. Zagaria do të tregojë se si falë përdorimit të një stimuli relaksues të muskujve është e mundur të përmirësohet struktura posturale e pacientëve me mosfunksionim të ATM.

DIGITAL DENTISTRY FOR DIAGNOSIS AND TREATMENT OF MAXILLARY MALIGNANCY: A CASE REPORT

Dott. Giuseppe Barile, Dott. Alessio Inchingolo

Abstract

Aim: Large radiopacities have a wide range of differential diagnosis: from benign tumor to malignancy. In this study authors report digital aid from pre-operative diagnosis to follow up visits of an asymptomatic, not bleeding, painless, net margins radiopacity maxillary lesion.

Materials and methods: A male patient of 74 years old came to U.O.C. of Odontostomatology of Policlinic of Bari. Digital exams were performed: OPT presented a wide maxillary radiopacity, TC Cone Beam showed a direct communication between oral cavity and nasopharyngeal cavities, RMN to assess entity of relation with nasopharyngeal soft tissue. Finally, was executed an Ultrasonography HD with a dedicated linear probe to evaluate lesion vascularization. Patient was subjected to excisional surgery, after been classified as ASA IV from anesthesiologist. Oral and neck ultrasonography was used every month to detect a possible recurrency, with semestral radiograph images.

Results: Histologic exam confirms digital diagnostic hypothesis: squamous cell carcinoma treated with a complete excision. Patient's total removable prosthesis was used as a tray of surgical cement to permit wound healing, then was modified with a conditioning tissue

material to rehabilitate functionally and aesthetically this oncological patient. Every follow up ultrasonography shows a remained oral-nasal communication, free from neoplastic recurrency confirmed also by nasal endoscopy.

Conclusion: Digital imaging could represent an important help from first pre-operative diagnosis to recurrency detection in oncological patients.

DENTISTRIA DIXHITALE PËR DIAGNOSTIKIMIN DHE TRAJTIMIN E MALINJITETIT NË MAKSILË.

Dr. Giuseppe Barile, Dr.Alessio Inchingolo

Abstrakt

Qëllimi: Radio-opacitetet e mëdha kanë një gamë të gjerë diagnozash diferenciale: nga tumori beninj në malinj. Në këtë studim autorët raportojnë ndihmën dixhitale që nga diagnoza pre-operative deri ne vizitat follow up të një lezioni maksilar asimptomatik, pa hemoragji, pa dhimbje, me kufij të pastër radiopak.

Materialet dhe metodat: Një pacient mashkull 74 vjeç erdhi në Poliklinikën odontostomatologjike të Barit. U kryen ekzaminimet dixhitale: panorameksi prezantoi një radiopacitet të gjerë në maksilë, skaneri CBCT tregoi një komunikim të drejtpërdrejtë midis kavitetit oral dhe kaviteteve nazofaringeale, Rezonanca magnetike për të vlerësuar lidhjen me indin e butë nazofaringeal. Më në fund, u krye një ultrasonografi HD me një sondë lineare specifike për të vlerësuar vaskularizimin e lezionit. Pacienti i është nënshtruar një operacioni ekscizional, pasi është klasifikuar si ASA IV nga anesteziologu. Ultrasonografia e gojës dhe e qafës është përdorur çdo muaj për të zbuluar një përsëritje të mundshme, me imazhe radiografike.

Rezultatet: Ekzaminimi histologjik konfirmon hipotezën diagnostike dixhitale: karcinoma skuamoze e trajtuar me një ekscizion të plotë. Proteza totale e lëvizshme e pacientit u përdor për të lejuar shërimin e plagëve, më pas u modifikua me një material kushtëzues indor për të rehabilituar funksionalisht dhe estetikisht këtë pacient onkologjik. Çdo ekografi pasuese tregon një komunikim oro-nazal të mbetur, pa përsëritje neoplazike të konfirmuar edhe nga endoskopia e hundës.

Konkluzion: Imazheria dixhitale mund të përfaqësojë një ndihmë të rëndësishme që nga diagnoza para ndërhyrjes deri në zbulimin e rekurencës në pacientët onkologjikë.

Fjalë kyç: imazheria dixhitale, radio-opacitet.

THE IMPACT OF PERIODONTAL INFLAMMATION ON ENDOTHELIAL FUNCTION ASSESSED BY CIRCULATING LEVELS OF ASYMMETRIC DIMETHYLARGININE (ADMA)

Dott. Biaggio Rapone[1]
[1]*Univeristy of Bari*

Abstract

Endothelial dysfunction is one of the early pathogenic events in the pathophysiology of atherosclerotic progression and it has been associated with the imbalance in pro- and anti-oxidant activity and low chronic inflammation. Severe periodontitis is considered to be an independent contributing risk factor of the pathophysiology of endothelial dysfunction. Inflammatory outcomes from periodontal pathogens involve a consistent and sustained host response. The complex biological reaction can have interindividual-differential effects on immunity, having profound and long-lasting adverse effects on endothelial function. As such, abrogation of periodontal inflammation might have clinical relevance, affecting the asymmetric di-methylarginine (ADMA), an L-arginine analogue that inhibits NO formation. High blood concentration of ADMA is emerged as one of the most powerful independent risk predictors of cardiovascular disease. Elevated blood concentrations of ADMA explain the occurrence of endothelial dysfunction through the impairment of vascular function. Despite scientific evidence exists on the impact of periodontal disease on endothelial function, insufficient clinical evidence exists to draw clear conclusions regarding the long-term effects and even less evidence is available especially on ADMA concentrations and its relationship with periodontitis. The objective of my studies was to evaluate the effects of intensive periodontal treatment in modulate the endothelial function via the assessment of ADMA concentration in patients diagnosed severe periodontitis**.**

NDIKIMI I INFLAMACIONIT PERIODONTAL NË FUNKSIONIN E ENDOTELIT, I VLERËSUAR NGA NIVELET QARKULLUESE TË DIMETIL-ARGININËS ASIMETRIKE (ADMA)

Dr. Biaggio Rapone[1]
[1]*Universiteti i Barit*

Abstrakt

Disfunksioni endotelial është një nga ngjarjet e hershme patogjene në patofiziologjinë e progresit aterosklerotik dhe është i shoqëruar me çekuilibër në aktivitetin pro- dhe anti-oksidues dhe inflamacion të ulët kronik. Periodontiti i rëndë konsiderohet të jetë një faktor risku i pavarur që kontribuon në patofiziologjinë e disfunksionit endotelial. Rezultatet inflamatore nga patogjenët periodontal përfshijnë një përgjigje të qëndrueshme të organizmit pritës. Reaksioni kompleks biologjik mund të ketë efekte ndërindividuale-diferenciale në imunitet, duke patur efekte negative të thella dhe afatgjata në funksionin endotelial. Si i tillë, inflamacioni periodontal ka rëndësi klinike, duke ndikuar në dimetil-argininën asimetrike (ADMA), një analog i L-argininës që pengon formimin e NO. Përqëndrimi i lartë i ADMA në gjak është shfaqur si një nga faktorët e pavarur të riskut më të fuqishëm të sëmundjeve kardiovaskulare. Përqendrimet e ngritura të ADMA në gjak shpjegojnë shfaqjen e mosfunksionimit endotelial përmes dëmtimit të funksionit vaskular. Pavarësisht se ekzistojnë prova shkencore mbi ndikimin e sëmundjes periodontale në funksionin endotelial, prova klinike të pamjaftueshme ekzistojnë për të nxjerrë përfundime të qarta në lidhje me efektet afatgjata dhe akoma më pak prova janë të disponueshme veçanërisht mbi përqendrimet e ADMA dhe lidhjen e saj me periodontitin. Objektivi i studimit ishte vlerësimi i efekteve të trajtimit intensiv periodontal në funksionin endotelial nëpërmjet vlerësimit të përqëndrimit të ADMA në pacientët me diagnozë të periodontitit të rëndë.

Fjalë kyç: inflamacion periodontal, endotel.

POST-EXTRACTION AND IMMEDIATE LOADING IMPLANTATION IN MODERN PERIO-IMPLANTOLOGY

Dr. Christian Monti
Graduated in Dentistry and Dental Prosthetics at the University of Milan.

Abstract

In the modern treatment plan, the positioning of post-extraction and immediate loading implants that follow precise indications and rigorous surgical and prosthetic protocols is now validated by the international literature. However, the long-term success of these rehabilitations cannot be separated from the correct management of the soft tissues around the implants, both in the moment of implant surgery and in the second surgical phase of uncovering. The new trend, called Perio-Implantology, thus shifts the attention of the practitioner from the bone towards the soft tissues which are the real protagonists of this change.

Keywords: perio-implantology, post-extraction, implants.

NGARKIMI I MENJËHERSHËM POST EKSTRAKTIV I IMPLANTEVE NË PERIO-IMPLANTOLOGJINË MODERNE

Dr. Christian Monti
I diplomuar në Stomatologji dhe Protetikë Dentare në Universitetin e Milanos.

Abstrakt

Në planin modern të trajtimit, pozicionimi i implanteve pas ekstraksionit dhe ngarkimi i menjëhershëm duke ndjekur indikacionet e sakta dhe protokollet rigoroze kirurgjikale dhe protetike tashmë është miratuar nga literatura ndërkombëtare. Megjithatë, suksesi afatgjatë i këtyre rehabilitimeve nuk mund të veçohet nga menaxhimi korrekt i indeve të buta rreth implanteve, si në momentin e inserimit të implantit ashtu edhe në fazën e dytë kirurgjikale. Trendi i ri, i emërtuar Perio-Implantologji, e zhvendos kështu vëmendjen e klinicistit nga kocka drejt indeve të buta, të cilat janë protagonistët e vërtetë të këtij ndryshimi.

Fjalë kyç: perio-implantologji, post-ekstraksion, implante.

UPREGULATION OF DIFFERENT MIRNAS IN PERIODONTOPATHIC PATIENTS AND THEIR RELATIONSHIP WITH IL-6 AND TNFA

Erica Costantini

Abstract

Background: Periodontitis is one of the main frequent intraoral diseases. Pathogenesis triggers are the immune response with the production of pro-inflammatory cytokines and the non-coding RNAs expression under the epigenetic control.

Objectives: The purpose of the present study was to evaluate the involvement of selected miRNAs in various stages of periodontitis and their relationship with the levels of inflammatory mediators in gingival crevicular fluid (GCF).

Materials and Methods: For this study, 36 subjects (21 with periodontal disease, 15 healthy controls) were selected in the age mean of 46.5 years. The subjects were classified into four groups: Group I (control), Group II (chronic periodontitis with Radiographic Bone Loss (RBL) 31%), Group III (chronic periodontitis with RBL 65%), and Group IV (chronic periodontitis with RBL 80%). Clinical parameters included plaque index, gingival index, sulcus bleeding index, Pocket Depth, and clinical attachment level. The GCF samples were taken by using capillary paper. The levels of miRNA in GCF were estimated using a Real-Time PCR and TNFα and IL-6 levels were assessed by enzyme-linked immunosorbent (ELISA) assay.

Results: The results indicated that the miRNA-103a-3p, miRNA-423-5p, miRNA-23a-3p, miRNA-15a-5p, and miRNA-223 -3p were significantly upregulated with respect to healthy controls. Significant differences were observed for miRNA-103a-3p, miRNA-423-5p, miRNA-23a-3p levels, in accord with the disease stages. Inflammatory mediators evaluated in GCF correlate well with the clinical parameters and with the severity of the periodontal disease, with differences with respect to control.

Conclusion: miRNA can represent biomarkers of disease stage and can be investigated as a possible therapeutic target, as well as levels of TNFα and IL-6 may drive the disease progression acting as prognostic markers.

PËRGJIGJIA E RRITUR E MIKRO-ARN-VE TË NDRYSHME NË PACIENTËT PERIODONTOPATIKË DHE LIDHJA E TYRE ME IL-6 DHE TNFA.

Erica Costantini

Abstrakt

Hyrje: Periodontiti është një nga sëmundjet më të shpeshta intraorale. Shkaktarët e patogjenezës janë përgjigjia imune me prodhimin e citokinave pro-inflamatore dhe shprehjen e mikro-ARN-ve jo-koduese nën kontrollin epigjenetik. Objektivat: Qëllimi i këtij studimi ishte të vlerësonte përfshirjen e mikro-ARN-ve të përzgjedhura në faza të ndryshme të periodontitit dhe lidhjen e tyre me nivelet e ndërmjetësve inflamatorë në fluidin cervikal gingival (GCF).

Materialet dhe Metodat: Për këtë studim u përzgjodhën 36 subjekte (21 me sëmundje periodontale, 15 persona të shëndetshëm) në moshën mesatare 46.5 vjeç. Subjektet u klasifikuan në katër grupe: Grupi I (kontrolli), Grupi II (Periodontiti kronik me Humbje Kockore Radiografike (RBL) 31%), Grupi III (Periodontiti kronik me RBL 65%) dhe Grupi IV (Periodontiti kronik me RBL 80 %). Parametrat klinikë përfshinin indeksin e pllakës, indeksin gingivar, indeksin e hemoragjise së sulkusit, Thellësinë e Xhepit dhe nivelin e atashimit klinik. Mostrat GCF janë marrë duke përdorur letër kapilar. Nivelet e mikro-ARN

në GCF u vlerësuan duke përdorur një PCR RealTime dhe nivelet e TNFα dhe IL-6 u vlerësuan me analizën imunosorbente të lidhura me enzimën (ELISA). Rezultatet: Rezultatet treguan se miARN-103a-3p, miARN-423-5p, miARN-23a-3p, miARN-15a-5p dhe miARN-223 -3p janë rritur ndjeshëm në lidhje me grupin e kontrollit te shëndetshem. Janë vërejtur ndryshime të rëndësishme për nivelet e miARN-103a-3p, miARN-423-5p, miARN-23a-3p, në përputhje me fazat e sëmundjes. Ndërmjetësuesit inflamatorë të vlerësuar në GCF korrelojnë mirë me parametrat klinikë dhe me nivelin e sëmundjes periodontale, ndryshe nga grupi i kontrollit. Konkluzion : miARN mund të shërbejnë si biomarkues të fazës së sëmundjes dhe mund të vlerësohet si një target i mundshëm terapeutik. Nivelet e TNFα dhe IL-6 mund të drejtojnë përparimin e sëmundjes duke vepruar si shënues prognostikë.

Fjalë kyç: mikro-arn, periodontiti.

THE EFFICACY OF CURCUMIN LIPOSOME-BASED GEL AS AN ADJUNCT TO NON-SURGICAL PERIODONTAL TREATMENT: A RANDOMIZED CONTROLLED CLINICAL TRIAL

Imena Rexhepi[1], Beatrice Femminella[1], Ida Uccello[1], Michele Paolantonio[1]
[1]Department of Innovative Technologies in Medicine and Dentistry, University "G. d'Annunzio" of Chieti-Pescara, 66100 Chieti, Italy

Abstract

Curcumin has gain popularity in the last 50 years due to its multiple therapeutic functions. Extensive research has shown that curcumin possesses anti-inflammatory, antioxidative, antiangiogenic, immunoregulatory and antibacterial properties. It has been proven to be effecace in the treatment of rheumatoid arthritis, inflammatory bowel disease and oral diseases, such as oral mucosal disease, oral lichen planus, oral squamous cell carcinoma and periodontal disease. This lecture aims to present the results of a clinical trial on the use of curcumin as an co-adiuvant to nonsurgical periodontal treatment (NPT). A total of 23 patients, aged 30 to 60 years and affected by Stage III periodontitis, were enrolled in this study. Patients were divided into four groups: SRP+Lipo Curcumin Gel, SRP+Lipo Gel, SRP+white Gel and the control Group. After the SRP, the gel was applied to the selected sites which were closed with cyanoacrylate. Periodontal parameters such as CAL gain, GR and PD were evaluated at baseline and 12 weeks after the treatment. The results demonstrated significant improvements for CAL, GR and PD parameters in the sites treated with the Curmunin gel compared to the other 3 groups. Our data demonstrated how local administration of curcumin might be a co-adjuvant in SRP in the improvement of periodontal parameters of patients affected by Stage III periodontitis.

EFIKASITETI I LIPOZOM KURKUMINËS NË TRAJTË XHELI SI NJË ALTERNATIVË NDIHMËSE NDAJ TRAJTIMIT PERIODONTAL JOKIRURGJIKAL: STUDIM KLINIK

Imena Rexhepi[1], Beatrice Femminella[1], Ida Uccello[1], Michele Paolantonio[1]
[1]Departamenti i Teknologjive Inovative në Mjekësi dhe Stomatologji, Universiteti "G. d'Annunzio"nga Chieti-Pescara, 66100 Chieti, Itali.

Abstrakt

Kurkumina ka fituar popullaritet në 50 vitet e fundit për shkak të funksioneve të shumta terapeutike. Hulumtimet e shumta kanë treguar se kurkumina posedon veti anti-inflamatore, antioksiduese, antiangiogjene, imunorreguluese dhe antibakteriale. Është vërtetuar se është efikase në trajtimin e artritit reumatoid, sëmundjeve inflamatore intestinale dhe sëmundjeve të gojës, të tilla si sëmundje të mukozës orale, liken planus oral, karcinomës së qelizave skuamoze orale dhe sëmundjes periodontale. Ky leksion synon të paraqesë rezultatet e një studimi klinik mbi përdorimin e kurkuminës si një substancë bashkëshoqëruese në trajtimin paradontal jokirurgjikal (NPT). Në këtë studim u regjistruan gjithsej 23 pacientë, të moshës 30 deri në 60 vjeç dhe të prekur nga periodontiti i Fazës III. Pacientët u ndanë në katër grupe sipas llojit të trajtimit: Pastrim periodontal (Scaling & Root Planning SRP) + Lipo Kurkumin Xhel, Pastrim + Lipo Xhel, Pastrim + Xhel i bardhë dhe Grupi i kontrollit. Pas pastrimit, xheli u aplikua në zonat e përzgjedhura të cilat u mbyllën me cianoakrilate. Parametrat periodontalë si CAL (humbja e nivelit të atashimit), GR (recesion gingivar) dhe PD (thellësia e sondimit) u vlerësuan në fillim dhe 12 javë pas trajtimit. Rezultatet treguan përmirësime të rëndësishme për parametrat CAL, GR dhe PD në vendet e trajtuara me xhelin kurkumin krahasuar me 3 grupet e tjera. Të dhënat tona treguan se si administrimi lokal i kurkuminës mund të jetë një bashkë-shoqërues në pastrimin periodontal për përmirësimin e parametrave periodontalë të pacientëve të prekur nga periodontiti i fazës III.

Fjalë kyç: kurkumina, trajtim periodontal.

ORAL SQUAMOUS CELL CARCINOMA(OSCC), FROM EPIDEMIOLOGY TO MULTIDISCIPLINARY APPROACH: A VIDEO CASE REPORT

Manlio Santilli[1,2], Gianmaria d'Addazio[1,2], Imena Rexhepi[1,2], Arnaldo Filippini[3], Bruna Sinjari[1,2]

[1]Department of Innovative Technologies in Medicine and Dentistry, University "G. d'Annunzio" Chieti-Pescara, 66100 Chieti, Italy

[2]Electron Microscopy Laboratory, University "G. d'Annunzio" Chieti-Pescara, 66100 Chieti, Italy

[3]Private Practice Surgeon, Malatesta Novello, 47521 Cesena, Italy

Abstract

Squamous cell carcinoma is the most frequent malignant cancer of the oral cavity. Epidemiological data indicate that oral cancer is far from being rare. In the last years, an increase of over 300,000 new oral squamous cell carcinoma (OSCC) cases has been recorded at global level. Moreover, a decrease in the average age and a higher number of female patients were reported. Metastasis involvement is one of the most relevant prognostic factors in terms of survival probability. Patients with oral cancers often undergo extensive *en bloc* resection of the mandible and maxilla, with or without cervical nodal dissection, based on the presence or occult risk of regional metastases. The multidisciplinary team included surgical oncologists, oral and maxillofacial surgeons, and otolaryngologist. The purpose of this lecture is to provide an overview of epidemiology, risk factors, diagnosis and treatment of OSCC. During the lecture a video case report of a 60-years-old man who underwent maxillectomy with neck dissection as well a reconstruction with combination of multiple vascularized free flaps will be presented.

KARCINOMA E QELIZAVE SKUAMOZE ORALE (OSCC), NGA EPIDEMIOLOGJIA Në QASJEN MULTIDISIPLINARE.

Manlio Santilli[1,2], Gianmaria d'Addazio[1,2], Imena Rexhepi[1,2], Arnaldo Filippini[3], Bruna Sinjari[1,2]

[1]Departamenti i Teknologjive Inovative Mjekësi dhe Stomatologji, Universiteti "G. d'Annunzio" Chieti-Pescara, 66100 Chieti, Itali.
[2]Laboratori i Mikroskopisë Elektronike, Universiteti "G. d'Annunzio" Chieti-Pescara, 66100 Chieti, Itali.
[3]Kirurg në Klinikë Private, Malatesta Novello, 47521 Cesena, Itali.

Abstrakt

Karcinoma e qelizave skuamoze është kanceri malinj më i shpeshtë i kavitetit oral. Të dhënat epidemiologjike tregojnë se kanceri oral nuk është aspak i rrallë. Në vitet e fundit, në nivel global është regjistruar një rritje prej mbi 300,000 rastesh të reja të karcinomës së qelizave skuamoze orale (OSCC). Për më tepër, u raportua një rënie në moshën mesatare dhe një numër më i lartë i pacientëve femra. Përfshirja e metastazave është një nga faktorët më të rëndësishëm prognostikë për sa i përket probabilitetit të mbijetesës. Pacientët me kancer oral shpesh i nënshtrohen rezeksionit të gjerë në bllok të mandibulës dhe maksilës, me ose pa diseksion cervikal nodular, bazuar në praninë ose rrezikun okult të metastazave regjionale. Ekipi multidisiplinor përfshin onkologë kirurg, kirurg oral dhe maksilofacialë dhe otolaringologë. Qëllimi i këtij leksioni është të ofrojë një pasqyrë të epidemiologjisë, faktorëve të riskut, diagnozës dhe trajtimit të OSCC. Gjatë ligjëratës do të prezantohet një video-raport i rastit të një mashkulli 60-vjeçar i cili iu nënshtrua maksilektomisë me diseksion të qafës si dhe një rikonstruksion me lembo të lira multiple të vaskularizuara.

Fjalë kyç: karcinoma e qelizave skuamoze orale.

NON-SURGICAL GINGIVAL PHENOTYPE MODIFICATION IN RECESSION ASSOCIATED WITH A NON-CARIOUS CERVICAL LESION USING THE ROOT PLASTIC TECHNIQUE (RPT). A PROSPECTIVE CASE SERIES.

Luigi Romano

Abstract

Intro: This study introduces and prospectively validate the root plastique technique (RPT) which aims to modify the gingival phenotype of sites with gingival recessions (GRs) associated with Non-Carious Cervical Lesions (NCCLs) prior to surgical treatment.

Methods: RPT was performed in 22 subjects with 53 RT1 A/B+ GRs. Changes in keratinized tissue thickness (KTT), keratinized tissue width (KTW), relative gingival recession (RGR), relative clinical attachment level (RCAL) and probing pocket depth (PPD) were measured from baseline (T0) to 2 months after the procedure was performed (T1). All analyses were performed by means of hierarchical models.

Results: Statistically significant changes ($p<0.01$) for the KTT (0.45 ± 0.04 mm), RGR (0.80 ± 0.13), KTW (0.67 ± 0.07mm), RCAL (-0.72 ± 0.16mm) and KTW (0.67 ± 0.07). No changes were found for PPD ($p>0.05$). Regression analyses of KTT increase and RGR reduction by non-carious cervical lesion depth (CLD) at T0 showed statistically significant correlation between the 2 variables ($p<0.05$). All the teeth with a KTT of <0.8mm at T0 (N=14) reached or passed this threshold at T1.

Conclusion: RPT increases KTT and KTW. In most of the teeth, a slight reduction in GRs was achieved.

MODIFIKIMI JO-KIRURGJIKAL I FENOTIPIT GINGIVAR Në RECESIONE Të SHOQèRUAR ME LEZIONE CERVIKALE JO-KARIOZE DUKE PèRDORUR TEKNIKèN E PLASTIKèS RADIKULARE (RPT).

Luigi Romano

Abstrakt

Hyrje: Ky studim prezanton dhe vërteton në mënyrë prospektive teknikën e plastikës radikulare (RPT) e cila synon të modifikojë fenotipin gingivar të zonave me recesione gingivare (GRs) të shoqëruara me lezione cervikale jo-karioze (NCCLs) përpara trajtimit kirurgjikal. Metodat: RPT u krye në 22 subjekte me 53 RT1 A/B+ GR. Ndryshimet në trashësinë e indit të keratinizuar (KTT), gjerësinë e indit të keratinizuar (KTW), recesionin relativ gingivar (RGR), nivelin relativ klinik të atashimit (RCAL) dhe thellësinë e xhepit periodontal (PPD) u matën nga fillimi (T0) deri në 2 muaj pas proçedurës (T1). Të gjitha analizat janë kryer me anë të modeleve hierarkike. Rezultatet: Ndryshime statistikisht të rëndësishme ($p<0.01$) u gjeten për KTT (0.45 ± 0.04 mm), RGR (0.80 ± 0.13), KTW (0.67 ± 0.07 mm), RCAL (-0.72 ± 0.16 mm) dhe KTW (0.607 ±) . Nuk u gjetën ndryshime për PPD ($p>0.05$). Analizat e rritjes së KTT dhe reduktimit të RGR nga thellësia e lezionit cervikal jo-karioz (CLD) në T0 treguan korrelacion statistikisht domethënës midis 2 variablave ($p<0.05$). Të gjithë dhëmbët me KTT <0.8mm në T0 (N=14) arritën ose e kaluan këtë prag në T1. Konkluzion : RPT rrit KTT dhe KTW. Në shumicën e dhëmbëve, u arrit një reduktim i lehtë i GRs.

Fjalë kyç: fenotipi gingivar, plastika radikulare.

ESSENTIAL LINES: A NEW TECHNIQUE TO SIMPLIFY POSTERIOR COMPOSITE RESTORATIONS.

Vincenzo Tosco, Riccardo Monterubbianesi, Giuseppe Chiodera, Giovanna Orsini and Angelo Putignano

Abstract

Dental direct restoration is one of the most popular medical interventions in the human body. It is estimated that more than 290 million restorations are placed each year worldwide. Resin-based composites have become the gold standard for the direct posterior restoration for their fundamental role in guaranteeing excellent aesthetics and function. Nevertheless, the

execution of these restorations, especially the reproduction of the anatomical morphology of the tooth, still remain the principal challenge for most clinicians. Nowadays, direct composite restorations are usually performed using the incremental filling technique, which minimizes polymerization shrinkage. Using this technique, the composite is built up in individually cured increments, but is time-consuming. Due to the superior physical and chemical properties of the newly introduced bulk-fill composites, it is possible to replace the incremental filling technique with a more time-efficient bulk-fill technique, whereby the composite is placed and modeled in one single layer up to the occlusal surface. This presentation introduces a novel technique, called “Essential lines”, which reproduces the occlusal morphology of the posterior teeth when executing direct posterior composite restorations. This procedure can be used by beginners and expert practitioners alike in various clinical situations to produce direct posterior composite restorations with optimal function and aesthetics.

LINJAT THELBËSORE: NJË TEKNIKË E RE PËR TË THJESHTUAR RESTAURIMET POSTERIORE TË KOMPOZITIT

Vincenzo Tosco, Riccardo Monterubbianesi, Giuseppe Chiodera, Giovanna Orsini and Angelo Putignano

Abstrakt

Restaurimet direkte dentare janë një nga ndërhyrjet mjekësore më të njohura në organizmin e njeriut. Është vlerësuar se më shumë se 290 milionë restaurime realizohen çdo vit në mbarë botën. Kompozitet me bazë rezine janë bërë standardi i artë për restaurimin direkt posterior, për rolin e tyre themelor në garantimin e estetikës dhe funksionit të shkëlqyer. Megjithatë, realizimi i këtyre restaurimeve, veçanërisht riprodhimi i morfologjisë anatomike të dhëmbit, mbetet ende sfida kryesore për shumicën e mjekëve. Në ditët e sotme, restaurimet direkte të kompozitit zakonisht kryhen duke përdorur teknikën e mbushjes me pjesë, e cila minimizon tkurrjen e polimerizimit. Duke përdorur këtë teknikë, kompoziti formohet nga pjesë që polimerizohen secila më vete, por kërkon kohë. Për shkak të vetive fizike dhe kimike superiore të kompoziteve, është e mundur të zëvendësohet teknika e mbushjes me pjesë (seksionale) me një teknikë më efikase në kohë, të mbushjes në një etapë, ku përbërja vendoset dhe modelohet në një shtresë të vetme deri në sipërfaqen okluzale. Ky leksion prezanton një teknikë të re, të quajtur "Linjat thelbësore", e cila riprodhon morfologjinë okluzale të dhëmbëve posteriorë gjatë realizimit të restaurimeve direkte posteriore prej kompoziti. Kjo proçedurë mund të përdoret si nga fillestarët ashtu edhe nga klinicistët ekspertë në situata të ndryshme klinike për të prodhuar restaurime direkte posteriore prej kompoziti me funksion dhe estetikë optimale.

Fjalë kyç: restaurime direkte kompoziti.

RESEARCH ON NEW MATERIALS IS THE FOUNDATION OF THEIR CLINICAL APPLICATION

Riccardo Monterubbianesi*, Vincenzo Tosco, Angelo Putignano, Giovanna Orsini

Abstract

Minimally invasive dentistry and resin-based materials represent the gold standard of dental treatment for direct or indirect restoration because they allow not only an aesthetic result, but even a restoration with physical property like those of dental tissues. However, common issues, as polymerization shrinkage stress, gap formation, microleakage and debonding, related to resin-based materials may provoke the failure of restoration and represent a huge challenge for dental clinicians. In the last few years, to minimize the occurrence of these problems, nanotechnology has been applied to resin-based materials. New analytical techniques were also performed trying to go deeper in the knowledge of physical, chemical, aesthetic and biocompatibility properties of dental materials. Vibrational Spectroscopy has been employed in dental research since it is a non-destructive technique allowing to evaluate the chemical composition of dental hard tissues and resin-based materials. Micro-CT also has recently been introduced to evaluate the internal and external adaptation of resin composites in dental cavity and, due to the penetrating capacity of X-rays, micro-CT allows clinicians to accurately analyze the restoration without sectioning the samples. This presentation aims to describe the properties of new dental materials for both direct and indirect restorations by using a multidisciplinary approach focusing on their chemical, physical and biological properties.

KËRKIMI SHKENCOR MBI MATERIALET E REJA ËSHTË BAZA E APLIKIMIT TË TYRE KLINIK

Riccardo Monterubbianesi, Vincenzo Tosco, Angelo Putignano, Giovanna Orsini

Abstrakt

Dentistria minimalisht invazive dhe materialet me bazë rezine përfaqësojnë standardin e artë të trajtimit dentar për restaurimet direkte ose indirekte, sepse ato paraqesin jo vetëm rezultat estetik, por edhe restaurime me veti fizike të përafërta me ato të indeve dentare. Megjithatë, karakteristika të tilla si stresi i tkurrjes nga polimerizimi, formimi i hapësirave, mikrorrjedhja dhe decementimi, që lidhen me materialet me bazë rezine mund të provokojnë dështimin e restaurimit dhe përfaqësojnë një sfidë të madhe për mjekët stomatologë. Në vitet e fundit, për të minimizuar shfaqjen e këtyre problemeve, nanoteknologjia është aplikuar për materialet me bazë rezine. Teknika të reja analitike për thellimin e njohurive përreth vetive fizike, kimike, estetike dhe biokompatibilitetit të materialeve dentare janë përdorur. Spektroskopia vibruese është përdorur në kërkimin dentar pasi është një teknikë jo-destruktive që lejon vlerësimin e përbërjes kimike të indeve të forta dentare dhe materialeve me bazë rezine. Mikro-CT gjithashtu është prezantuar së fundmi për të vlerësuar përshtatjen interne dhe eksterne të kompoziteve të rezinës në kavitetet dentare dhe, për shkak të aftësisë depërtuese të rrezeve X, mikro-CT u lejon klinicistëve të analizojnë me saktësi restaurimin pa ndarë në seksione mostrat. Ky prezantim synon të përshkruajë vetitë e materialeve të reja dentare për restaurimet direkte dhe indirekte duke përdorur një qasje multidisiplinare duke u fokusuar në vetitë e tyre kimike, fizike dhe biologjike.

Fjalë kyç: dentistria invazive, spektroskopia vibruese.

EVALUATION OF TECAR TECHNOLOGY DURING ORTHODONTIC TREATMENT: A CASE REPORT

Anna Maria Ciocia

Abstract

Introduction: Several strategies have been proposed in the literature to accelerate tooth movement, many of which are invasive and have numerous side effects such as surgical techniques (corticotomy, Piezocision technique). The aim of this research is to investigate how much T.E.C.A.R. (capacitive and resistive energy transfer) can accelerate the orthodontic alignment phase.

Materials and Methods: A patient with a lower crowding index of the same magnitude was selected. The orthodontic treatment with Nickel-Titanium (NiTi) thermal arc .015 in the lower arch was performed, associated with a weekly application of TECAR using the intraoral handpiece. The total duration of treatment was three weeks. During each session, an intraoral transducer was employed to activate the hard and soft tissues of the left dental hemiarch, which was also aligned like the right.

Results: Comparing the dental movements of the two hemiarches, it was found that the rotation and translation of 8 teeth covered larger spaces in the same unit of time on the TECAR side, increasing the displacement speed.

Conclusions: The use of TECAR, according to the authors, is a non-invasive approach that speeds up the orthodontic alignment phase without compromising patients' compliance and with a reduction in treatment duration, resulting in a lower risk of caries, gingival recessions, root resorptions and patient compliance improvement, without side effects. Further studies will be needed to confirm the findings.

VLERËSIMI I TEKNOLOGJISË TEKR GJATË TRAJTIMIT ORTODONTIK.

Anna Maria Ciocia

Abstrakt

Hyrje: Në literaturë janë propozuar disa strategji për të përshpejtuar lëvizjen e dhëmbëve, shumë prej të cilave janë invazive dhe kanë efekte të shumta anësore si teknikat kirurgjikale (kortikotomia, teknika Piezo-incizion..). Qëllimi i këtij hulumtimi është të hetojë se sa T.E.K.R. (transferimi i energjisë kapacitive dhe rezistente) mund të përshpejtojë fazën e drejtimit ortodontik.

Materialet dhe Metodat: U zgjodh një pacient me një indeks më të ulët të grumbullimit dentar. U realizua trajtimi ortodontik me hark termik Nikel-Titanium (NiTi) .015 në arkaden e poshtme, i shoqëruar me aplikimin javor të TEKR duke përdorur pajisjen intraorale. Kohëzgjatja totale e trajtimit ishte tre javë. Gjatë çdo seance, një transduktor intraoral u

përdor për të aktivizuar indet e forta dhe të buta të semi-arkadës të majtë dentare, e cila gjithashtu u drejtua si ana e djathtë.
Rezultatet: Duke krahasuar lëvizjet dentare në të dy arkadat, u konstatua se rrotullimi dhe translacioni i 8 dhëmbëve mbulonte hapësira më të mëdha në të njëjtën njësi kohore në anën TEKR, duke rritur shpejtësinë e zhvendosjes.

Konkluzione: Përdorimi i TEKR, sipas autorëve, është një qasje jo-invazive që përshpejton fazën e drejtimit ortodontik pa kompromentuar pajtueshmërinë e pacientëve dhe me një reduktim të kohëzgjatjes së trajtimit, duke rezultuar në një risk më të ulët të kariesit, recesioneve gingivare, rezorbimeve te rrenjes dhe përmirësimin e pajtueshmërisë së pacientit, pa efekte anësore. Studime të mëtejshme do të nevojiten për të konfirmuar rezultatet.

Fjalë kyç: teknologjia tekr, trajtimi ortodontik.

ENDO-PERIO LESIONS, A CASE REPORT

Anna Netti

Abstract

Aim: Treatment of endo-perio lesion is a highly challenging task to dentist because differentiating between periodontal and endodontic problems can be difficult.

In this work we present the characteristics and the classification of endoperio lesions, to identify the elements that can help the clinician in the diagnostic process; then we show a clinical case of a patient in which endodontic treatment was planned before than periodontal one.

Matherials and Methods: This is a case report of a 40 year old male patient, current smoker, complaining of pain and pus discharge from the third quadrant. He has positive familiar anamnesis for periodontal disease, pain localized on 3.7 tooth, M1 mobility; there is purulent exudate and spontaneous gingival bleeding on the same element. The presence of deep periodontal pocket measuring 13mm on the distal root was observed and there is furcation involvement.

LEZIONET ENDO-PERIODONTALE.

Anna Netti

Abstrakt

Qëllimi: Trajtimi i lezionit endo-periodontal është një detyrë shumë sfiduese për dentistin, sepse diferencimi midis problemeve periodontale dhe endodontike mund të jetë i vështirë. Në këtë leksion do të paraqesim karakteristikat dhe klasifikimin e lezioneve endo-periodontale, për të identifikuar elementët që mund të ndihmojnë klinicistin në procesin e diagnostikimit; në prezantim do të tregojmë një rast klinik të një pacienti në të cilin trajtimi endodontik ishte planifikuar më parë se ai periodontal.

Materialet dhe metodat: Ky është një rast i një pacienti mashkull 40 vjeç, duhanpirës aktual, që ankohet për dhimbje dhe rrjedhje pusi nga kuadrati i tretë. Ka anamnezë pozitive të njohur për sëmundje periodontale, dhimbje të lokalizuara në dhëmbin 3.7, lëvizshmëri M1; në të njëjtin element ka eksudat purulent dhe hemoragji spontane gingivare. U vu re prania e një xhepi të thellë periodontal me përmasa 13 mm në rrënjën distale dhe ka përfshirje furkacioni.

Fjalë kyç: lezion endo-periodontal.

ELASTODONTIC THERAPY OF HYPERDIVERGENT CLASS II PATIENTS USING AMCOP® DEVICES

Dott. Ssa. Assunta Patano, Dr. Sabino Ceci

Abstract

The management of a hyperdivergent growth pattern is one of the most challenging in orthodontics and different treatments are advocated. The present study analyses the effectiveness of elastodontic therapy with AMCOP® devices in treating children with hyperdivergent class II malocclusion and the effect on the upper airway patency.

TERAPIA ELASTODONTIKE E PACIENTËVE TË KLASËS II HIPERDIVERGJENTE DUKE PËRDORUR PAJISJEN AMCOP

Dr. Assunta Patano, Dr Sabino Ceci

Abstrakt

Menaxhimi i një modeli të rritjes hiperdivergjente është një nga më sfidueset në ortodonci dhe rekomandohen trajtime të ndryshme. Ky studim analizon efektivitetin e terapisë elastodontike me aparaturën AMCOP® në trajtimin e fëmijëve me malokluzion hiperdivergjent të klasës II dhe ndikimin në kalueshmërinë e rrugëve të sipërme të frymëmarrjes.

Fjalë kyç: terapia elastodontike, amcop.

PROSTHETIC ASPECTS IN ORAL IMPLANTOLOGY.

Bruno G. Scalise

Abstract

Oral implantology has now reached a hight level of success.

Osseointegration is now a scientifically consolidated phenomenon. The restoration of dental implants rappresents a fundamental aspect, capable to conditioning the aesthetic and funcional result of the reabilitation, and last but not last , the maintanance of osseointegration.

ASPEKTET PROTETIKE NË IMPLANTOLOGJINË ORALE.

Bruno G. Scalise

Abstrakt

Implantologjia orale tani ka arritur një nivel të lartë suksesi.
Osteointegrimi është tashmë një fenomen i konsoliduar shkencërisht. Restaurimi protetik i implanteve dentare përfaqëson një aspekt themelor, i aftë të kushtëzojë rezultatin estetik dhe funksional të rehabilitimit dhe e fundit por jo më pak e rëndësishme, ruajtjen e osteointegrimit.

Fjalë kyç: protetikë, implantologji.

THE IMPACT OF BREASTFEEDING AND NON-NUTRITIVE SUCKING HABITS ON INFANT HEALTH

Chiara Di Pede, Giulia Palmieri

Abstract

Breastfeeding is important for the correct psychophysical development of the child and has repercussions on the growth and functions of the orofacial complex. Breast milk also provides for the maturation of the immune system and the composition of the baby's intestinal and oral microbiota. Lack of breastfeeding, prolonged use of pacifiers and thumb sucking predispose to the development of malocclusions such as cross bite, anterior open bite and class II relationship with increased overjet. Breastfeeding could also be a protective factor for the onset of ECC compared to infant formula. In addition, there are numerous studies that claim that breastfeeding is potentially a protective factor against infant snoring, bruxism and sleep breathing disorders. Dentists have a fundamental role in the prevention of maternal-infant oral health and they must promote the first visits from pregnancy and from 12-18 months after birth, encourage breastfeeding and intercept bad habits, incorrect lifestyles to guide the growth of the orofacial complex avoiding the onset of malocclusions.

NDIKIMI I USHQYERJES ME GJI DHE VESEVE THITHËSE JOUSHQYESE NË SHËNDETIN E FOSHNJAVE

Chiara Di Pede, Giulia Palmieri

Abstrakt

Ushqyerja me gji është e rëndësishme për zhvillimin korrekt psikofizik të fëmijës dhe ka pasoja në rritjen dhe funksionet e kompleksit orofacial. Qumështi i gjirit siguron gjithashtu maturimin e sistemit imunitar dhe formimin e mikrobiotës intestinale dhe orale së foshnjës. Mungesa e ushqyerjes me gji, përdorimi i zgjatur i biberonëve dhe thithja e gishtit të madh predispozojnë për zhvillimin e malokluzioneve si kafshimi i kryqëzuar, kafshimi i hapur anterior dhe raporti i klasës II me overjet të rritur. Ushqyerja me gji mund të jetë gjithashtu një faktor mbrojtës për shfaqjen e ECC në krahasim me formulën e foshnjave. Përveç kësaj, ka studime të shumta që pretendojnë se ushqyerja me gji është potencialisht një faktor

mbrojtës kundër gërhitjes së foshnjave, bruksizmit dhe çrregullimeve të frymëmarrjes gjatë gjumit. Mjekët stomatolgë kanë një rol themelor në parandalimin dhe informimin e shëndetit oral nënë-fëmijë. Ata duhet të promovojnë vizitat e para që nga shtatzënia dhe 12-18 muaj pas lindjes. Gjithashtu duhet të inkurajojnë ushqyerjen me gji dhe të ndërpresin veset e këqija, stilet e gabuara të jetesës për të mundësuar zhvillimin korrekt të kompleksit orofacial duke shmangur krijimin e malokluzioneve.

Fjalë kyç: vese, kompleksi orofacial.

MANAGEMENT OF INFRA-OCCLUDED PRIMARY MOLARS

Dott. Ssa. Claudia Laudadio

Abstract

The ability to identify and diagnose infra-occluded primary molars is crucially important for their subsequent management. Knowledge of the different treatment options and their relevance in different clinical situations is important to prevent orthodontic consequences.

MENAXHIMI I MOLARËVE PRIMARË TË INFRA-OKLUDUAR.

Dr. Claudia Laudadio

Abstrakt

Aftësia për të identifikuar dhe diagnostikuar molarët primar infra-okludues është thelbësore për menaxhimin e tyre të mëvonshëm. Njohja e opsioneve të ndryshme të trajtimit dhe rëndësia e tyre në situata të ndryshme klinike është e rëndësishme për të parandaluar pasojat ortodontike.

Fjalë kyç: molarët primarë të infraokluduar.

ORTHODONTIC PURPOSES OF CORTICOTOMY

Daniela Azzollini

Abstract

In orthodontics settings, time is both a friend and an enemy, indeed only after several months or years, the best results are gained. But often patients require to save their time asking for a faster procedure. Some procedures aid and support orthodontic therapy, allowing for a quicker but still effective outcome. One of these, is the corticotomy, a surgical procedure that allows the removal of part of the cortical bone without affecting the medullary component. The aim of this strategy is to shorten the orthodontic therapeutic duration by speeding it up.

QËLLIMET ORTODONTIKE TË KORTIKOTOMISË.

Daniela Azzollini

Abstrakt

Në fushën e ortodoncisë koha është edhe mik edhe armik. Në të vërtetë vetëm pas disa muajsh apo vitesh arrihen rezultatet më të mira. Por shpesh pacientët kërkojnë të kursejnë kohën e tyre duke kërkuar një proçedurë më të shpejtë. Disa proçedura ndihmojnë dhe mbështesin terapinë ortodontike, duke lejuar një rezultat më të shpejtë, por edhe efektiv. Një prej tyre është kortikotomia, një proçedurë kirurgjikale që lejon heqjen e një pjese të kockës kortikale pa prekur komponentin medular. Qëllimi i kësaj strategjie është të shkurtojë kohëzgjatjen terapeutike ortodontike duke e përshpejtuar atë.

Fjalë kyç: ortodonci, kortikotomi.

DIGITAL DENTISTRY – NEW MILESTONE IN DENTAL PROFESSION

Danimir Jevremovic

Abstract

Digital dentistry is more than just a way to create prosthodontic artworks. In enables new workflow, which is faster, more precise and less prone to errors. It favourises simplicity, repeatability, productibility and finally, offers better overall results.

Intraoral scanners, such as Vivascan, are used in digital dentistry for rapid image-taking of the patient's intraoral structures. The images, called digital impressions, are then imported into the CAD/CAM software to design and manufacture dental restorations, such as dentures, crowns, veneers and dental implants. The digital impressions are also useful to plan orthodontic treatments and create orthodontic appliances.

Central occlusion preservation, digital mock-up, import of other digital media, such as photography enables a completely new approach to dental restoration. In this lecture, complete workflow of digital dentistry is shown on practical examples. Via cases, advantages of intraoral scanning are really getting more prominent. From one tooth to a complete mouth restoration, digital dentistry presents a new milestone in dental profession.

DENTISTRIA DIXHITALE-ARRITJE INOVATIVE NË FUSHËN DENTARE.

Danimir Jevremovic

Abstrakt

Dentistria dixhitale është më shumë se thjesht një mënyrë për të krijuar vepra arti në fushën e protetikës. Ajo mundëson rrjedhën e re të punës, e cila është më e shpejtë, më e saktë dhe

më pak e prirur ndaj gabimeve. Dentistria dixhitale favorizon thjeshtësinë, përsëritjen, produktivitetin dhe së fundi, ofron rezultate më të mira të përgjithshme.
Skanerët intraoral, të tillë si Vivascan, përdoren në stomatologjinë dixhitale për marrjen e shpejtë të imazhit të strukturave intraorale të pacientit. Imazhet, të quajtura impresione dixhitale, importohen më pas në softuerin CAD/CAM për të projektuar dhe prodhuar restaurime dentare, të tilla si proteza, kurora, fasetat dhe implantet dentare. Impresionet dixhitale janë gjithashtu të dobishme për planifikimin e trajtimeve ortodontike dhe krijimin e aparateve ortodontike.
Ruajtja e okluzionit qendror, modeli dixhital, importi i skedarëve të tjerë dixhitale, si fotografitë që mundësojnë një qasje krejtësisht të re në restaurimet dentare.Në këtë leksion rrjedha e plotë e punës nëpërmjet dentistrisë dixhitale do të demonstrohet me shembuj praktikë. Nëpërmjet rasteve klinike, avantazhet e skanimit intraoral po bëhen vërtet e më të dukshme. Nga restaurimi i një dhëmbi në rehabilitimin total, stomatologjia dixhitale paraqet një erë të re në fushën dentare.

Fjalë kyç: dentistri dixhitale, protetikë.

ORTHODONTIC TREATMENT IN A PERIODONTAL PATIENT: CASE REPORT

Elisabetta De Ruvo

Abstract

Aim: The purpose of this case report is the description of an orthodontic treatment of a periodontal patient aimed at aesthetic-functional rehabilitation

Materials and Methods: A 52-year-old patient requires aesthetic and functional treatment. After the first dental examination and compilation of periodontal chart, Rx-OPT, photos and impressions were collected. The patient showed gingivitis and periodontal sockets of medium size with bleeding on probing. Periodontal therapy with scaling and diode laser was planned**.**

Results and Conclusions: After reaching a physiological gingival condition, fixed orthodontic therapy with the Roth technique was carried out. After 13 months a correct alignment and occlusal plan was achieved with the constant control of professional every 3 months and home hygiene. At the end of treatment upper and lower essix in association with upper (13-23) and lower (33-43) retainers were applied. Monitoring periodontal health before, during and after an orthodontic treatment in an adult patient with periodontal disease, satisfactory orthodontic.

TRAJTIMI ORTODONTIK I PACIENTËVE PERIODONTALË.

Elisabetta De Ruvo

Abstrakt

Qëllimi: Qëllimi i këtij raport rasti është përshkrimi i një trajtimi ortodontik të një pacienti me kompromentim periodontal që synon rehabilitimin estetiko-funksional.

Materiale dhe metoda: Një pacient 52-vjeçar kërkon trajtim estetik dhe funksional. Pas ekzaminimit të parë dentar dhe përpilimit të tabelës periodontale, radiografitë, fotot dhe masat u morën në studim. Pacienti paraqiti gingivit dhe xhepa periodontale me përmasa mesatare me hemoragji gjatë sondimit. U planifikua terapi periodontale me "scaling" dhe lazer diodë.

Rezultatet dhe konkluzionet: Pas arritjes së gjendjes fiziologjike të gingivës, terapia ortodontike fikse me teknikën "Roth" u realizua. Pas 13 muajsh u arrit një drejtim dhe plan okluzal korrekt me kontrollin e vazhdueshëm të profesionistëve çdo 3 muaj dhe higjienës ne shtëpi. Në fund të trajtimit u aplikuan "retainer essix" në pjesën e sipërme dhe të poshtme (13-23), (33-43). Monitorimi i shëndetit periodontal para, gjatë dhe pas një trajtimi ortodontik në një pacient adult me sëmundje periodontale lidhet ngushtë me rezultate ortodontike te kënaqshme.

Fjalë kyç: trajtim ortodontik, pacientë periodontal.

THE INTRAMASCELLAR AND EXTRAMASCELLAR IMPLANTOLOGY USED IN FULL ARCH REHABILITATIONS

Dr. Enrico Andreoli

Abstract

More and more dentists are asking for solutions to restore fixed teeth to edentulous patients even in cases of severe atrophy and poor quality bone. This advanced course is aimed both at those who already face full arch rehabilitations with confidence but often stop in front of the most challenging cases, especially in the atrophic upper jaw, and at those who want to perfect the all on 4/6 protocol with mixed rehabilitations with zygomatic implants. , nasal, pterygoid, vomer and nasal horn implants. If you are looking for solutions this is the course for you. After this course you will be able to treat more patients with the full arch protocol and solve almost any situation with specially developed graftless solutions.

Keywords: intramascellar, extramascellar, implantology.

IMPLANTOLOGJIA INTRASINUSALE DHE EKSTRASINUSALE E PËRDORUR NË REHABILITIMET TOTALE

Dr. Enrico Andreoli

Abstrakt

Gjithnjë e më shumë stomatologët po kërkojnë zgjidhje për të restauruar punime fikse tek pacientët edentulozë edhe në rastet e atrofisë së rëndë dhe kockave me cilësi të ulët. Ky kurs i avancuar u drejtohet si atyre që tashmë përballen me rehabilitimin total të arkadës me plot vetëbesim, por që shpesh ndalen para rasteve më sfiduese, veçanërisht në nofullën e sipërme

atrofike, ashtu edhe për ata që duan të përsosin protokollin "all on 4/6" me rehabilitim miks me implante zigomatike, implante nazale, pterigoide, të septumit/kreshtës nazale. Nëse jeni duke kërkuar për zgjidhje të këtyre rasteve, ky është kursi për ju. Pas këtij kursi ju do të jeni në gjendje të trajtoni më shumë pacientë me rehabilitim total sipas protokollit përkatës dhe të zgjidhni pothuajse çdo situatë në mënyrë të avancuar pa grafte.

Fjalë kyç: intrasinusale, ekstrasinusale, implantologji.

FORSUS FATIGUE RESISTANT DEVICE: A TYPE OF NON-COMPLIANCE DEVICE IN THE TREATMENT OF CLASS II

Fabio Piras

Abstract

Aim: The effectiveness and efficiency of the FORSUS functional appliance in the treatment of Class II mandibular retrusion in the CS3 growth phase was analysed from both a dental, skeletal point of view.

Methods: A 13-year-old girl with mandibular retrusion, a high overjet and a convex facial profile was first treated with a round nickel-titanium wire in alignment and levelling phase, followed by the insertion of rectangular steel arches 19X25, after the FORSUS was placed for 5 weeks of the active phase in the CS3 phase. After the finishing phase, the multibrackets were dismantled. The cephalometric findings, the aesthetic analysis and the otorhinolaryngology were then evaluated.

Results: improvement of the patient's profile, of the overjet indices and an achievement of canine class I and molar class I, decrease of the SNA angle and ANB and an increase of the SNB angle indicating an anterior repositioning of the mandible. As the functional therapy was carried out in the CS3 phase, the maximum increase in height and length of the mandible was obtained, also leading to a horizontal displacement of the hyoid bone and volumetric increase of the upper airway both anteroposteriorly and transversely.

Conclusions: Forsus is a functional appliance with the advantage that it does not require cooperation from the patient. In addition to the dental and skeletal benefits at mandibular level, improvements are obtained with regard to respiratory problems such as snoring and the reduction of arterial pressure, thus preventing bruxism and oral breathing and obstructive sleep apnoea in adulthood.

PAJISJA REZISTENTE NDAJ LODHJES "FORSUS": NJË PAJISJE E CILA NUK KËRKON BASHKËPUNIMIN E PACIENTIT ME QËLLIM TRAJTIMIN E KLASËS II

Fabio Piras

Abstrakt

Qëllimi: Efikasiteti i aparatit funksional FORSUS në trajtimin e retruzionit mandibular të klasës II në fazën e rritjes CS3 u analizua nga pikëpamja dentare dhe skeletale. Metodat: Një vajzë 13-vjeçare me retruzion mandibular, me overjet të lartë dhe një profil konveks facial u trajtua fillimisht me një tel të rrumbullakët nikel-titan në fazën e drejtimit dhe nivelimit, e ndjekur nga inserimi i harqeve drejtkëndëshe çeliku 19X25, pasi FORSUS u vendos për 5 javë të fazës aktive të fazës CS3. Pas seancës së fundit, multi-braketat u çmontuan. U vlerësuan gjetjet cefalometrike, analiza estetike dhe analiza lidhur me fushëne otorinolaringologjisë. Rezultatet: Përmirësimi i profilit të pacientit, i indeksit të overjet-it një arritje e klasës I molare dhe kanine, ulje e këndit SNA dhe ANB dhe rritje e këndit SNB që tregon një ripozicionim anterior të mandibulës. Duke qenë se terapia funksionale u krye në fazën CS3, u arrit rritja maksimale në lartësi dhe gjatësi e mandibulës, duke çuar gjithashtu në një zhvendosje horizontale të kockës hyoide dhe rritje volumetrike të rrugës së sipërme të frymëmarrjes si anteroposteriorisht ashtu edhe në drejtim transversal. Konkluzion: Forsus është një pajisje funksionale me avantazhin se nuk kërkon bashkëpunim nga pacienti. Përveç përfitimeve dentare dhe skeletale në nivelin mandibular, janë arritur përmirësime në lidhje me problemet e frymëmarrjes si gërhitja dhe ulja e presionit arterial, duke parandaluar kështu bruksizmin dhe frymëmarrjen orale dhe apnenë obstruktive të gjumit në moshën madhore.

Fjalë kyç: forsus, retruzioni mandibular.

ORTHODONTIC ALIGNERS & PERIODONTAL IMPLICATION: WHY ARE CLEAR ALIGNERS ON MOST PERIODONTALLY INVOLVED CASES SUPERIOR TO FIXED APPLIANCES?

Fotis Exarchou

Abstract

Orthodontic treatment of patients with periodontal implication represent always a challenge for the clinician. Supportive bone loss is drastically changing not only mandatory biomechanics, but also the biological response to applied forces. In addition and in relation to the level of previous bone loss and inflammation, treatment time frame should be obviously shorter to protect the tissues from overload while giving the patient the ability to regain his mandatory excellent oral hygiene procedure. Having these factors in mind, when it comes to choose the orthodontic appliance the obvious advantages of clear aligners become evident.

This presentation will highlight all positive parameters that clear aligners provide to a periodontally involved orthodontic treatment. The digital planning of treatment device with the obvious advantage of altering the velocity and sequence of tooth moment, while simultaneously setting posterior anchorage as “unmovable”, is crucial for the protection of supportive periodontal tissues. In addition the absence of friction, a major disadvantage of any fixed appliance approach, is contributing to a more “respectful” to periodontal tissues tooth movement, specially when it comes to mandatory intrusion of incisors and frontal space closure.

Every aspect of digital planning of an orthodontic treatment with clear aligners on a periodontal patient will be discussed. The differences in biomechanics compared to labial and lingual fixed appliances will be extensively highlighted, giving on that way the opportunity of an assessment of the benefit that clear aligner therapy provide not only for the patient, but also for the clinician.

"ALIGNERS" & IMPLIKIMET PERIODONTALE: PSE JANË "CLEAR ALIGNERS" SUPERIORË NË SHUMICËN E RASTEVE ME IMPLIKIME PERIODONTALE KRAHASUAR ME APARATET FIKSE ORTODONTIKE?

Fotis Exarchou

Abstrakt

Trajtimi ortodontik i pacientëve me implikim periodontal është gjithmonë një sfidë për klinicistin. Humbja kockore ndryshon në mënyrë drastike jo vetëm biomekanikën, por edhe përgjigjen biologjike ndaj forcave të aplikuara. Në lidhje me niveli e humbjes kockore dhe i inflamacionit: afati kohor i trajtimit duhet të jetë dukshëm më i shkurtër për të mbrojtur indet nga mbingarkesa, por duke i dhënë dhe pacientit mundësinë për të rifituar rutinën e nevojshme për mbajtjen e higjienës orale. Duke pasur parasysh këta faktorë, kur bëhet fjalë për zgjedhjen e aparatit ortodontik, avantazhet "Clear Aligners" bëhen të dukshme. Ky prezantim do të nxjerrë në pah të gjithë parametrat pozitivë që ofrojnë "Clear Aligners" për një trajtim ortodontik me kompromentim periodontal. Planifikimi dixhital i trajtimit me avantazhin e dukshëm të pajisjeve me ndryshim të shpejtësisë dhe sekuencë së lëvizjes së dhëmbit, duke mbajtur njëkohësisht ankorimin posterior si "të palëvizshëm", është vendimtar për mbrojtjen e indeve paradontale mbështetëse. Përveç kësaj, mungesa e fërkimit, një dizavantazh i madh i çdo pajisjeje fikse, kontribuon në një lëvizje më të "respektueshme" të dhëmbëve në lidhje me indet periodontale, veçanërisht kur bëhet fjalë për intruzion të incizivëve dhe mbyllje të hapësirës frontale. Në leksion do të diskutohet çdo aspekt i planifikimit dixhital të një trajtimi ortodontik me "clear aligners" në një pacient me probleme periodontale. Diferencat në biomekanikë krahasuar me aparatet fikse labiale dhe linguale do të theksohen gjerësisht, duke dhënë në këtë mënyrë mundësinë e vlerësimit të përfitimit që ofron terapia e " clear aligner" jo vetëm për pacientin, por edhe për klinicistët.

DIGITAL PLANNING IN ALIGNER ORTHODONTICS: SCIENCE OR FICTION? LUCK OR STRATEGY?

Fotis Exarchou

Abstract

Aligner designing software programs are considered by many orthodontists and technicians as digital tooth movement planning tools. In fact this is unfortunately not true, as they represent actually a progressive aligner surface change from the very beginning of an orthodontic intervention until the final outcome. Which factors do we have to consider when designing the orthodontic appliance for a complex case? Do we have to focus on a “perfect” digital setup or on a proper force system by the progressively changing aligner surface? How

can we achieve balance in pushing a tooth in three planes? Why is sequence and staging so crucial in terms of achieving outstanding results and avoiding posterior open bites even during treatment?

On this presentation the lecturer will tackle some of the most challenging topics in aligner orthodontics. He will help you to:

-Get a firm grasp on the fundamental principles behind treatment modalities with clear aligners on moderate and severe A/P and crossbite malocclusions

-Open your mind to ideas, possibilities and principles you may not be aware of

-Understand what aspects of orthodontic treatment planning you may improve in order to reach a new level of expertise

-See real examples of how a complex case is planned and evaluate the treatment modalities afterwards.

PLANIFIKIMI DIXHITAL NË "ALIGNERS": SHKENCË APO IMAGJINATË? FAT APO STRATEGJI?

Fotis Exarchou

Abstrakt

Programet e softuerit të dizajnit të "aligners" konsiderohen nga shumë ortodontë dhe teknikë si mjete dixhitale për planifikimin e lëvizjes së dhëmbëve. Cilët faktorë duhet të kemi parasysh kur dizajnojmë pajisje ortodontike për një rast kompleks? A duhet të përqëndrohemi në një konfigurim dixhital "të përsosur" apo në një sistem të duhur të forcës në lidhje me sipërfaqen e pajisjes që ndryshon në mënyrë të vazhdushme? Si mund të arrijmë ekuilibrin në shtyrjen e një dhëmbi në tre plane? Pse etapat janë kaq të rëndësishme në drejtim të arritjes së rezultateve të dukshme dhe shmangies së kafshimeve të hapura posteriore edhe gjatë trajtimit? Në këtë prezantim, ligjëruesi do të trajtojë disa nga temat më sfiduese në fushën e "aligner"-s. Ai do t'ju ndihmojë të: -Merrni njohuri mbi parimet themelore që qëndrojnë pas modaliteteve të trajtimit me "clear aligners" për malokluzionet A/P të moderuar dhe të rëndë dhe malokluzione të kryqëzuara.
-Hapni mendjen tuaj ndaj ideve, mundësive dhe parimeve për të cilat mund të mos jeni në dijeni. -Kuptoni se cilat aspekte të planifikimit të trajtimit ortodontik mund të përmirësoni në mënyrë që të arrini një nivel të ri ekspertize.
-Shihni shembuj real se si është planifikuar një rast kompleks dhe vlerësoni modalitetet e trajtimit.

Fjalë kyç: aligners, implikime periodontale, clear aligners.

III CLASS TREATMENT WITH LOWER TEETH DISTALIZATION

Dr. Giovanni Coloccia

Abstract

III class with lower distalization can reduce need of ortho-surgical treatments and improve compromise orthodontic treatment finishing. It will be presented case reports with aligners, fixed orthodontics with or without the use of Tads.

TRAJTIMI I KLASËS III ME DISTALIZIM TË DHËMBËVE TË POSHTËM.

Dr. Giovanni Coloccia

Abstrakt

Klasa III me distalizim të dhëmbëve inferiorë mund të zvogëlojë nevojën për trajtime ortodonto-kirurgjikale dhe të përmirësojë përfundimin e trajtimit ortodontik. Në këte leksion do të paraqiten raporte rastesh me "aligners", trajtime nëpërmjet ortodoncisë fikse me ose pa përdorimin e "Tads".

Fjalë kyç: klasa III, distalizim inferior.

EXTRACTIVE VS NON-EXTRACTIVE ORTHODONTIC TREATMENTS: DIAGNOSTIC ELEMENTS

Giulia Latini

Abstract

Introduction: The need for tooth extraction in some orthodontic cases has always been a subject of controversy. Planning teeth extraction is one of the most challenging aspects of achieving functional and esthetic orthodontic outcomes as well as long-term stability.

Aim: The aim of this work is to determine which factors are relevant for appropriate diagnosis and can be used as guidelines for treatment selection.

Matherials and methods: Some malocclusions have a questionable diagnosis as to whether or not extractions are required.

In order to establish a precise diagnosis and a correct treatment plan, it is crucial to analyze the dental, facial, and skeletal features of each patient, especially in borderline cases.

In this paper, seven factors were examined that are important for appropriate diagnosis and may be used as suggestions for therapy selection: Compliance, TAD (Tooth-Alveolar

Discrepancy), Cephalometric discrepancy and Facial profile, Skeletal age and Antherior-Posterior Relationship, Dental asymmetries, facial pattern, dental diseases and disorders.

Results and Conclusion: According to the selected parameters, this work suggests that alveolar-tooth discrepancy is not the only aspect to consider; other factors should also be examined in order to improve facial aesthetics and ensure the stability of the patient's outcome.

KRAHASIMI I TRAJTIMIT ORTODONTIK ME DHE PA EKSTRAKSIONE: ELEMENTET DIAGNOSTIKE

Giulia Latini

Abstrakt

Hyrje: Nevoja për ekstraksione dentare në disa raste ortodontike ka qenë gjithmonë objekt polemikash. Planifikimi i ekstraksioneve dentare është një nga aspektet më sfiduese të arritjes së rezultateve ortodontike funksionale dhe estetike, si dhe me stabilitetit afatgjatë. Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të përcaktojë se cilët faktorë janë të rëndësishëm për diagnozën e duhur dhe mund të përdoren si udhëzime për përzgjedhjen e trajtimit.

Materialet dhe metodat: Disa malokluzione kanë një diagnozë të dyshimtë nëse kërkohen apo jo ekstraksione. Për të vendosur një diagnozë të saktë dhe një plan trajtimi korrekt, është thelbësore të analizohen tiparet dentare, të fytyrës dhe skeletale të çdo pacienti, veçanërisht në rastet e dyshimta. Në këtë studim, u ekzaminuan shtatë faktorë që janë të rëndësishëm për diagnozën e duhur dhe mund të përdoren si sugjerime për zgjedhjen e terapisë: Përputhshmëria, TAD (Diskrepanca Dento-Alveolare), Mospërputhja cefalometrike dhe profili facial, mosha skeletale dhe marrëdhënia anteriore-posteriore, asimetritë dentare, modeli i fytyrës, sëmundjet dhe çrregullimet dentare.

Rezultatet dhe përfundimi: Sipas parametrave të përzgjedhur, ky studim sugjeron se diskrepanca alveolo-dentare nuk është i vetmi aspekt që duhet marrë parasysh; duhet të ekzaminohen edhe faktorë të tjerë për të përmirësuar estetikën e fytyrës dhe për të siguruar stabilitetin e rezultatit të pacientit.

Fjalë kyç: ekstraksion, planifikim.

IMPACTED CANINES: AETIOLOGY, DIAGNOSIS AND ORTHODONTIC MANAGEMENT

Grazia Garofoli

Abstract

Impaction of maxillary and mandibular canines is a frequently encountered clinical problem, the treatment of which usually requires an interdisciplinary approach. After the third molar, the canine is the most frequently impacted tooth. Bringing the impacted canine into a normal position is important for functional occlusion and the final aesthetics of the orthodontic

treatment. The keys to treat the impacted canines successfully include accurate localization, use of appropriate surgical procedure and orthodontic biomechanics.

KANINËT E IMPAKTUAR: ETIOLOGJIA, DIAGNOZA DHE MENAXHIMI ORTODONTIK.

Grazia Garofoli

Abstrakt

Impaktimi i kaninëve maksilar dhe mandibular është një problem klinik i hasur shpesh, trajtimi i të cilit zakonisht kërkon një qasje ndërdisiplinore. Pas molarit të tretë, kanini është dhëmbi që preket më shpesh. Pozicionimi i kaninit të impaktuar në një pozicion normal është i rëndësishëm për okluzionin funksional dhe estetikën përfundimtare të trajtimit ortodontik. Çelësat për trajtimin e suksesshëm të kaninëve të impaktuar përfshijnë lokalizimin e saktë, përdorimin e proçedurës së përshtatshme kirurgjikale dhe biomekanikën ortodontike.

Fjalë kyç: impaktimi i kaninëve, trajtim ortodontik.

DENTAL ANOMALIES IN NON-SYNDROMIC PATIENTS WITH CLEFT LIP AND PALATE

Dott. Ssa. Grazia Marinelli

Abstract

Non-syndromic cleft lip and palate are craniofacial dysmorphisms involving approximately 1 in 700 live births. Individuals with clefts have an increased risk of developing dental anomalies such as agenesis, supernumerary, transpositions, and the severity of the anomalies appears to be directly related to the cleft gravity. This condition requires a multidisciplinary approach.

ANOMALITË DENTARE NË PACIENTËT JO SINDROMIKË ME ÇARJE TË BUZËS DHE QIELLZËS.

Dr. Grazia Marinelli

Abstrakt

Çarja e buzës dhe qiellzës jo sindromike janë dismorfizma kraniofacialë që përfshijnë afërsisht 1 në 700 lindje të gjalla. Individët me klefte kanë një risk në rritje të zhvillimit të anomalive dentare si agenezia, dhëmbë supra-numeratum, transpozicionet, dhe niveli i anomalive duket të jetë i lidhur drejtpërdrejt me llojin e kleft-it. Kjo gjëndje kërkon një qasje multidisiplinare.

Fjalë kyç: anomali dentare, çarje e buzës dhe e qiellzës.

MARPE: AN EASY WAY TO PERFORM IT. A CASE REPORT

Irene Ferrara

Abstract

Aim: In early young patients with permanent dentition, the daily challenge is how to perform the correction of the transversal discrepancy. This case report shows how the midpalatal suture stadiation through a novel classification method for individual assessment of midpalatal suture morphology with CBTC scan, can drive the treatment plan between traditional rapid maxillary expansion and surgically assisted rapid maxillary expansion.

Material and methods: This is a case report of a 10+6 years old female patient who had menarche six months before therapy began. She had permanent dentition, an ogival-shaped palate, a transversal discrepancy of about 6-8 mm, crowding upper and lower arch, presence of dental compensation.

The patient midpalatal suture stadiation belonging to Angelieri et al. results to be in stage C, in which fusion of the suture already has occurred partially or totally, and so it is suggested to perform surgically assisted RME.

Therefore we used a hybrid rapid palatal expander on 2 miniscrews, giving 5 turns at the moment of insertion, and then 1 turn per day for 20 days.

Results: We achieve a skeletal maxillary expansion of 6 mm, avoiding dental compensation on first molars, which is the negative side effect of traditional dental-supported rapid maxillary expansion.

Conclusion: In borderline cases, such as early permanent dentition, early menarche already occurred, with the presence of dental compensation and need for skeletal expansion, the midpalatal suture stadiation through CBCT can help the decision-making process.

EKSPANSIONI I SHPEJTË PALATINAL PËRMES MINIVIDAVE (MARPE): NJË MËNYRË E LEHTË PËR TA REALIZUAR.

Irene Ferrara

Abstrakt

Qëllimi. Në pacientët e rinj me denticion të përhershem, sfida e përditshme është se si të kryhet korrigjimi i diskrepancës transversale. Ky prezantim rasti paraqet mënyrën se si stadi i zhvillimit të suturës mid-palatinale përmes një metode të re klasifikimi për vlerësimin individual të morfologjisë së suturës mid-palatinale me skanim CBTC, mund të drejtojë planin e trajtimit midis ekspansionit tradicional të shpejtë maksilar dhe zgjerimit të shpejtë maksilar të asistuar kirurgjikal.

Materiali dhe metodat: Ky është një raport rasti e një pacienteje femër 10+6 vjeç. Ajo kishte denticion të përhershëm, qiellzë të lartë dhe të ngushtë, diskrepance transversale rreth 6-8 mm, arkadë të sipërme dhe të poshtme me denticion të grumbulluar, prani të kompensimeve dentare. Stadi i sutures mid-palatinale e pacientit sipas Angelieri et al. rezultoi të jetë në fazën C, në të cilën bashkimi i suturës tashmë ka ndodhur pjesërisht ose plotësisht, dhe kështu sugjerohet të kryhet RME e asistuar kirurgjikal (zgjerim i shpejtë maksilar). Prandaj kemi përdorur një zgjerues hibrid të shpejtë palatinal me 2 minivida, duke dhënë 5 rrotullime në momentin e inserimit dhe më pas 1 rrotullim në ditë për 20 ditë. Rezultatet. Ne arritëm një zgjerim skeletal të nofullës prej 6 mm, duke shmangur kompensimin dentar në molarët e parë, që është efekti anësor negativ i ekspansionit tradicional të shpejtë të nofullës me suport dentare.

Konkluzioni: Në rastet ne limit, të tilla si denticioni i hershëm permanent , me praninë e kompensimit dentar dhe nevojën për zgjerimin skeletal, sutura mid-palatinale përmes CBCT mund të ndihmojë ne procesin e vendimmarrjes.

Fjalë kyç: ekspansion palatinal, minivida.

IS THERE A FUTURE FOR DENTAL CERAMICS?

Jan Schünemann MDT

Abstract

Developments are unstoppable and we are always unsure where the journey goes, what the future looks like. Climate change - CO2 emissions - Electromobility? No one knows exactly where the development is going, but one thing is for sure, change is a natural endeavor. We had countless discussions about the entry of CAD-CAM, or currently about generative finishing processes. Curse or benefit? It is a question of positioning, strategy and personal touch. The key to a rational, and yet premium aesthetics is the symbiosis of both worlds. Machines can not replace our curiosity! An almost perfect crown is and remains a unique piece of craft, more than ever, because the demands of the patients have grown. Ceramic concepts with minimal effort and maximum aesthetics are future-oriented strategies in the fight against industrial production.

A KA TË ARDHME PËR QERAMIKËN DENTARE?

MDT Jan Schünemann

Abstrakt

Zhvillimet janë të pandalshme dhe ne jemi gjithmonë të pasigurt se ku shkon rrugëtimi, si duket e ardhmja. Ndryshimet klimatike - Emetimet e CO2 - Elektromobiliteti? Askush nuk e di saktësisht se ku po shkon zhvillimi, por një gjë është e sigurt, ndryshimi është një përpjekje e natyrshme. Ne patëm diskutime të panumërta rreth hyrjes së CAD-CAM, ose aktualisht rreth proçeseve gjeneruese të përfundimit. Mallkim apo përfitim? Është çështje pozicionimi, strategjie dhe tendence personale. Çelësi për një estetikë racionale është simbioza e të dy botëve. Makineritë nuk mund të zëvendësojnë kuriozitetin tonë! Një kurorë pothuajse perfekte është dhe mbetet një punim unik, tani më shumë se kurrë, sepse kërkesat e pacientëve janë rritur. Punimet qeramike me preparim minimal dhe estetikë maksimale janë strategji të orientuara drejt së ardhmes në luftën kundër prodhimit industrial.

Fjalë kyç: qeramika dentare.

THE IMPORTANCE OF A REASONED DIAGNOSIS FOR A CORRECT TREATMENT PLANNING IN ORTHODONTICS

Mariagrazia Garibaldi

Abstract

The success of orthodontic therapy depends on 45% from diagnosis and treatment planning, 10% from technique, and 45% from patient cooperation. Many authors such as Angle, Sassouni, Moorrees studied the concept respectively of traditional diagnosis, rational diagnosis, and global diagnosis because we have to consider that the teeth are inserted in the mouth and in the face in a body that interacts with the outside world.

Therefore, the object of an Orthodontist is to formulate a correct diagnosis and treatment planning for having success.

RËNDËSIA E NJË DIAGNOZE TË ARSYETUAR PËR NJË PLANIFIKIM KORREKT TË TRAJTIMIT NË ORTODONCI.

Mariagrazia Garibaldi

Abstrakt

Suksesi i terapisë ortodontike varet 45% nga diagnoza dhe planifikimi i trajtimit, 10% nga teknika dhe 45% nga bashkëpunimi i pacientit. Shumë autorë si Angle, Sassouni, Moorrees studiuan konceptin përkatësisht të diagnozës tradicionale, diagnozës racionale dhe diagnozës globale sepse duhet të kemi parasysh që dhëmbët janë të inseruara në kavitetin oral dhe në fytyrë në një trup që ndërvepron me botën e jashtme.
Prandaj, objekti i një ortodonti është të formulojë një diagnozë të saktë dhe plan trajtimi që të ketë suksesin maksimal më të mundshëm.

Fjalë kyç: ortodonci, diagnozë.

THE ART OF SAFE ROOT CANAL SHAPING

Prof. Mehmet Baybora Kayahan

Abstract

The aim of root canal treatment is to prevent or cure apical periodontitis. Shaping the root canal system is one of the most important steps in root canal treatment. However, during the shaping procedure, problems such as instrument separation, ledge formation, and transportation of the canal can be encountered which affects the outcome of root canal treatment. To avoid these complications and for safe root canal shaping, steps of the treatment

such as preparing adequate endodontic access, preflaring, negotiation, and glide path preparation should be followed rigidly. In addition using Nickel-Titanium rotary files plays a key role in the success of root canal shaping. In this lecture, the steps of root canal shaping will be reviewed and strategies for safer preparations will be discussed.

ARTI I FORMËSIMIT TË SIGURT TË KANALEVE RADIKULARE.

Prof. Mehmet Baybora Kayahan

Abstrakt

Qëllimi i trajtimit të kanalit të rrënjës është parandalimi ose trajtimi i periodontitit apikal. Formësimi i sistemit të kanaleve të rrënjëve është një nga hapat më të rëndësishëm në trajtimin e kanaleve. Megjithatë, gjatë proçedurës së përpunimit të kanaleve, mund të hasen probleme të tilla si thyerja e instrumentit dhe formimi i pragjeve, të cilat ndikojnë në rezultatin e trajtimit të kanaleve të rrënjës. Për të shmangur këto komplikacione dhe për përpunimin e sigurt të kanalit të rrënjës, hapat e trajtimit si preparimi i aksesit adekuat endodontik, zgjerimi paraprak me instrumenta manual dhe preparimi i rrugës së trajtimit nga orificiumi i kanalit në foramenin apikal duhet të ndiqen me rigorozitet. Përveç kësaj, përdorimi i instrumentave rotatorë Nikel-Titan luajnë një rol kyç në suksesin e formësimit të kanalit të rrënjës. Në këtë leksion do të shqyrtohen hapat e përpunimit të kanalit radikular dhe do të diskutohen strategjitë për preparimet më të sigurta.
Endo e lehtë: Pastroni, jepni formë dhe obturoni!
Në këtë prezantim pjesëmarrësit do të mësojnë: përpunimin e kanaleve me instrumentë të tipit K, zgjerimin paraprak të kanalit, preparimin e rrugës me instrumenta rotatorë Ni-Ti, irrigimin e kanaleve në mënyrë efektive, formësimin e kanaleve me "EndoArt Touch Blue", me sistemin e instrumentave rotatorë blu Ni-Ti të trajtuar me nxehtësi. Kanalet e përpunuara do të obturohen me teknikat e kondensimit lateral në të ftohtë dhe me një kon. Në këtë kurs do të përdoren gjithashtu blloqe endodontike trajnuese me kanale të harkuar.

Fjalë kyç: kanalet radikulare, periodontitis apikal.

EVALUATION WITH CBCT OF VERTICAL BONE AUGMENTATION IN THE MAXILLARY SINUS LIFT TECHNIQUE WITH LATERAL APPROACH: A CASE REPORT

Merigrazia Campanelli, Pasquale Avantario

Abstract

Introduction: Nowadays, there are more and more adult patients showing generalized bone resorption, due to systemic, metabolic, periodontal problems and/or because of to advancing age, which is related to systemic bone reworking particularly in the orofacial area, with resorption of the alveolar bone. This leads to loss of dental elements, as they are no longer supported by an adequate amount of bone tissue. Consequently, there is a further reworking of the bone tissue and the functional loads exerted on the residual crest, which are

transformed into compressive loads, favor the bone resorption in the centripetal and cranio-caudal sense, while in the upper jaw district there is a progressive pneumatization of the maxillary sinus.

Materials and methods: A 63-year-old female patient presented to our unit to rehabilitate the area of 16 and 17. The anamnesis reveals hypotension, osteoporosis and hypothyroidism. Orthopantomography showed the presence of a periapical lesion of 15. After physical examination, this lesion results of degree 1 of mobility. The patient required fixed rehabilitation, therefore CBCT was performed to evaluate the bone present in the area of 15-16-17 elements. After viewing the CBCT, it was detected that the area is strongly atrophic with a vertical height of about 4 mm, therefore, in order to rehabilitate a maxillary sinus lift operation with a lateral approach was performed. It was planned to extract 15 element and, 4 months after the operation, the sinus lift was performed through a crestal approach. A full thickness vestibular flap and osteotomy were performed to create a lateral window in the sinus and, after having detached the Schneiderian membrane, heterologous bone and a fibrin sponge were affixed. The flap was sutured and antibiotic and anti-inflammatory therapy was prescribed to the patient, showing a complete healing of the soft tissues after 15 days.

VLERËSIMI ME SKANER CBCT I NGRITJES VERTIKALE KOCKORE NË TEKNIKËN E NGRITJES LATERALE TË SINUSIT MAKSILAR.

Merigrazia Campanelli, Pasquale Avantario

Abstrakt

Hyrje. Në ditët e sotme, ka gjithnjë e më shumë pacientë adult që shfaqin rezorbim të përgjithshem kockor, për shkak të problemeve sistemike, metabolike, periodontale dhe/ose për shkak të moshës në rritje, e cila lidhet me rimodelimin kockor, veçanërisht në zonën orofaciale dhe me rezorbimin e kockës alveolare. Kjo çon në humbjen e elementeve dentarë, pasi ato nuk mbështeten më nga një sasi adekuate e indit kockor. Rrjedhimisht, ka një ripërpunim të mëtejshëm të indit kockor dhe ngarkesat funksionale të ushtruara në kreshtën reziduale, të cilat shndërrohen në ngarkesa shtypëse, favorizojnë rezorbimin kockor në drejtim qendërsynues dhe kranio-kaudal, ndërsa në nofullën e sipërme ka një pneumatizim progresiv të sinusit maksilar.

Materiale dhe metoda: Një paciente 63-vjeçare u paraqit në repartin tonë për rehabilitimin e zonës 16 dhe 17. Nga anamneza evidentohet hipotension, osteoporozë dhe hipotiroidizëm. Ortopantomografia tregoi praninë e një lezioni periapikal tek 15. Pas ekzaminimit fizik, ky lezion rezulton i shkallës 1 të lëvizshmërisë. Pacientit iu realizua rehabilitim fiks, prandaj iu realizua CBCT për të vlerësuar kockën e pranishme në zonën 15-16-17. Pas shikimit të CBCT, u konstatua se zona është shume atrofike me një lartësi vertikale rreth 4 mm, prandaj për rehabilitimin e saj është kryer procedura e ngritjes se sinusit. U planifikua ekstraksioni i 15 dhe 4 muaj pas operacionit u krye ngritja e sinuseve me drejtim krestal. U realizua një lembo vestibulare dhe osteotomi për të krijuar një dritare anësore në sinus dhe pasi u shkëput membrana Schneiderian, u vendos kocka heterologe dhe një sfungjer fibrine. Lemboja u suturua dhe pacientit iu përshkrua terapi me antibiotike dhe anti-inflamatorë, duke treguar një shërim të plotë të indeve të buta pas 15 ditësh.

Fjalë kyç: ngritje kockore, sinusi maksilar.

CORRELATION BETWEEN THE THIRD FINGER MIDDLE PHALANX MATURATION METHOD AND THE CERVICAL VERTEBRAL MATURATION METHOD IN ORTHODONTIC DIAGNOSIS

Nicole De Leonardis

Abstract

In orthodontic diagnosis, skeletal maturity is important since it determines the treatment plan selection. Interceptive and functional therapies require proper timing; special attention must be paid to the phase of maximum growth, during which orthodontic therapy has a greater response. Several approaches for identifying skeletal maturation stages have been proposed throughout the years, with the cervical vertebrae evaluation method and the hand-wrist radiograph analysis method proving to be effective.

LIDHJA MIDIS MATURIMIT TË FALANGËS SË MESME TË GISHTIT TË TRETË DHE MATURIMIT TË VERTEBRËS CERVIKALE NË DIAGNOZËN ORTODONTIKE.

Nicole De Leonardis

Abstrakt

Në diagnozën ortodontike, maturimi skeletal është i rëndësishëm pasi përcakton zgjedhjen e planit të trajtimit. Terapitë interceptive dhe funksionale kërkojnë kohën e duhur; vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet fazës së rritjes maksimale, gjatë së cilës terapia ortodontike ka një përgjigje më të madhe. Disa qasje për identifikimin e fazave të maturimit skeletal janë propozuar gjatë viteve, me metodën e vlerësimit të vertebrave cervikale dhe metodën e analizës radiografike të kyçit së dorës që rezultojnë të jenë efektive.

Fjalë kyç: maturimi skeletal, terapi interceptive.

TRUE BONE REGENERATION – WHAT THE BODY NEEDS. TRANSLATING BIOLOGY INTO SUCCESSFUL IMPLANT DENTISTRY.

Prof. Dr. Peter JM Fairbairn

Abstract

In modern Dental Implantology, like in Orthopedics and Regenerative Medicine, our aim is to restore the form and function of the lost bone, so that we can give back to our patients

exactly the same tissue, a healthy bone tissue which can remodel and adapt to the transmitting occlusal forces. Only the host can regenerate bone so especially in the aesthetic zone we need to work with and up-regulate this host healing for optimal long-term outcomes

A new generation of novel alloplastic materials may elicit a controlled action and reaction to the host tissue environment, whilst exhibiting controlled chemical breakdown and resorption with an ultimate replacement by new bone. As surgeons, if bone *regeneration* is the aim of our treatment, a fully resorbable material should be used so that the newly formed bone will be in identical to the lost host bone and no residual graft should be present in the long term. Long-term incorporation of non-resorbable graft particles in the augmented bone leads to *incomplete regeneration*, so in these cases *repair* or bone *augmentation* are more appropriate terms.

Novel synthetic biomaterials are designed to be not only osteoconductive but also osteoinductive, i.e. to stimulate the differentiation of multipotent cells towards osteoblasts capable of depositing bone matrix, and there are currently numerous medical research papers showing this. All this medical research can teach us how to engineer functional bone in Dentistry and Implantology, we can learn and understand the role of periosteum, the importance of angiogenesis and biomechanics, so that we translate this knowledge into clinical applications for the benefit of our patients.

The aim of this lecture is to discuss these concepts and developments, and to present new minimally invasive protocols in order to optimize the host regeneration.

Learning Objectives:

- To understand the importance of bone as the foundation for successful implant restorations.
- To be aware of the various types of bone grafting materials and the modern techniques available for alveolar ridge preservation and augmentation in everyday clinical practice.
- To understand the make-up of new synthetic graft materials
- To discuss the key role of bone quality on the long-term stability and function of dental implants.
- To examine the importance of Histology and Histo-morphometry in the true evaluation of bone quality.

RIGJENERIMI I VËRTETË I KOCKOR – ÇFARË I NEVOJITET TRUPIT. BIOLOGJIA NË DENTISTRINË IMPLANTARE TË SUKSESSHME.

Peter JM Fairbirn

Abstrakt

Në Implantologjinë Dentare moderne, në Ortopedinë dhe Mjekësinë Rigjeneruese, qëllimi ynë është të rivendosim formën dhe funksionin e kockës së humbur, në mënyrë që të mund

t'u japim pacientëve tanë saktësisht të njëjtin ind, një ind kockor të shëndetshëm që mund të rimodelohet dhe përshtatet me forcat okluzale transmetuese. Vetëm organizmi prites mund të rigjenerojë kockën, kështu që veçanërisht në zonën estetike duhet të punojmë për shërim me rezultate optimale afatgjata. Një gjeneratë e re e materialeve të reja aloplastike mund të nxisë reagim të kontrolluar, ndërkohë që sjellin ndarje të kontrolluar kimike dhe rezorbim me një zëvendësim përfundimtar me kockë të re. Si kirurgë, qëllimi i trajtimit tonë është rigjenerimi i kockave, për këtë duhet të përdoret një material plotësisht i absorbueshëm, në mënyrë që kocka e sapoformuar të jetë identike me kockën e humbur të organizmit prites dhe të mos ketë graft të mbetur për një kohë të gjatë. Inkorporimi afatgjatë i grimcave të graftit jo të absorbueshëm në kockën e shtuar çon në rigjenerim jo të plotë, kështu që në këto raste riparimi ose shtimi i kockës janë terma më të përshtatshëm.
Biomaterialet e reja sintetike janë projektuar që të jenë jo vetëm osteokonduktive, por edhe osteoinduktivë, pra për të stimuluar diferencimin e qelizave multipotente drejt osteoblasteve të afta për të depozituar matricën e kockave, dhe aktualisht ka studime të shumta kërkimore mjekësore që tregojnë këtë. I gjithë ky kërkim mjekësor mund të na mësojë se si të inxhinierojmë kockën funksionale në Stomatologji dhe Implantologji, ne mund të mësojmë dhe kuptojmë rolin e periostumit, rëndësinë e angiogjenezës dhe biomekanikës, në mënyrë që ta përkthejmë këtë njohuri në aplikime klinike për të mirën e pacientëve tanë. Qëllimi i këtij leksioni është të diskutojë këto koncepte dhe zhvillime dhe të paraqesë protokolle të reja minimalisht invazive në mënyrë që të optimizohet rigjenerimi.

Objektivat e mësimit: Për të kuptuar rëndësinë e kockave si bazë për restaurimet e suksesshme të implanteve.
Të perftohen njohuri për llojet e ndryshme të grafteve kockore dhe teknikat moderne të disponueshme për ruajtjen dhe shtimin e kreshtës alveolare në praktikën e përditshme klinike. Për të kuptuar përbërjen e materialeve të reja sintetike të graftit. Për të diskutuar rolin kryesor të cilësisë së kockave në stabilitetin dhe funksionin afatgjatë të implanteve dentare. Për të ekzaminuar rëndësinë e Histologjisë dhe Histo-morfometrisë në vlerësimin e vërtetë të cilësisë së kockave.

Fjalë kyç: rigjenerim kockor, restaurim implantar.

SYSTEMATICS OF IRRIGATION IN ENDODONTICS

Silvio Buongiorno

Abstract

Root canal irrigation in endodontics is the practice whereby the doctor uses a disinfectant substance repeatedly to mechanically and chemically cleanse the root canal system.

The aim of irrigation is to remove the infected part of the canals, which can consist of several elements: Viruses and bacteria, debris generated by the mechanical action of the instruments, vital and necrotic tissue, other micro-organisms and their degradation products.

There are three conditions that hinder root canal cleaning: firstly, the polymicrobial nature of bacteria and their organisation in biofilms. When bacteria organise in co-aggregated communities they form a matrix that acts as a mechanical barrier to antibacterial solutions.

The smear layer created in the presence of debris produced by mechanical instruments and the complex anatomy of the canals themselves also make it difficult to absorb the irrigant and thus to disinfect the canal.

It is precisely because of these difficulties that it is essential to thoroughly clean the root canals before any obturation. Sloppy cleaning leaves room for infected elements to survive and thrive inside the tooth, creating complications over time that lead to failure of the filling.

SISTEMI I IRRIGIMIT NË ENDODONCI

Silvio Buongiorno

Abstrakt

Irrigimi i kanalit të rrënjës në endodonci është procedura ku mjeku përdor një substancë dezinfektuese në mënyrë të përsëritur për të pastruar mekanikisht dhe kimikisht sistemin e kanalit të rrënjës.
Qëllimi i irrigimit është heqja e pjesës së infektuar të kanaleve, e cila mund të përbëhet nga disa elementë: viruset dhe bakteret, mbeturinat e krijuara nga veprimi mekanik i instrumenteve, indet vitale dhe nekrotike, mikroorganizma të tjerë dhe produktet e degradimit të tyre. Janë tre gjendje që pengojnë pastrimin e kanalit të rrënjës: së pari, natyra polimikrobike e baktereve dhe organizimi i tyre në biofilma. Kur bakteret organizohen në bashkësi të bashkuara, ato formojnë një matricë që vepron si një pengesë mekanike ndaj solucioneve antibakteriale.
Shtresa e krijuar në prani të mbeturinave të prodhuara nga instrumentet mekanike dhe anatomia komplekse e vetë kanaleve gjithashtu e bëjnë të vështirë thithjen e irrigantit dhe në këtë mënyrë dezinfektimin e kanalit.
Është pikërisht për shkak të këtyre vështirësive që është thelbësore që të pastrohen tërësisht kanalet e rrënjës përpara çdo mbylljeje. Pastrimi i ngadaltë i lë hapësirë elementëve të infektuar të mbijetojnë dhe të lulëzojnë brenda dhëmbit, duke krijuar me kalimin e kohës komplikime që çojnë në dështimin e mbushjes.

Fjalë kyç: irrigim, endodonti.

FORENSIC DAMAGE ASSESSMENT OF TEMPOROMANDIBULAR JOINT: A REVIEW

Stefania Costa

Abstract

Aim: Recent studies highlight the underestimation of traumatic orofacial lesions and related individual sequelae. Forensic assessment should not be limited to the detection of dental fractures and traumas, and the persistence of painful symptomatology, functional and muscular limitation should be considered pathological. The purpose of this study is to determine whether there is a relationship between damage assessment and TMD.

Methods: The research for the keywords "*damage assessment*" and "*TMD"* joined by the boolean operator "*AND*"*, on the* search engine PubMed, until February 2022, produced 69 results. There were 5 articles included that satisfied the question: 4 retrospectives, and 1 prospective study.

Results: All studies show direct proportionality between severity and type of trauma with soft tissue changes. Damage assessment should always be supported by diagnostic examination on both sides of the face, regardless of the characteristics of the impact: TMJ is often subject to involvement by indirect trauma, despite the restitutio ad integrum.

Conclusion: This review wants to expose the existing correlation between orofacial damage and the individual sequelae that in direct and indirect ways involve in good percentage the TMJ. Future studies will clarify the real extent of a traumatic event, as well as its management and treatment.

VLERËSIMI MJEKO-LIGJOR I DËMTIMIT TË ARTIKULACIONIT TEMPOROMANDIBULAR.

Stefania Costa

Abstrakt

Qëllimi: Studimet e fundit nxjerrin në pah nënvlerësimin e lezioneve traumatike orofaciale dhe pasojat e lidhura me to. Vlerësimi mjeko-ligjor nuk duhet të kufizohet në zbulimin e frakturave dhe traumave dentare, dhe persistenca e simptomatologjisë së dhimbshme, kufizimi funksional dhe muskulor duhet të konsiderohet patologjik. Qëllimi i këtij studimi është të përcaktojë nëse ka një lidhje midis vlerësimit të dëmtimeve dhe crregullimeve të ATM.

Metodat: Hulumtimi për fjalët kyçe "vlerësimi i dëmtimit" dhe "Crregullim i ATM" të bashkuar nga lidhësja "Dhe", në motorin e kërkimit PubMed, deri në shkurt 2022, nxorri 69 rezultate. U përfshinë 5 artikuj që plotësonin pyetjen: 4 retrospektiva dhe 1 studim prospektiv.

Rezultatet: Të gjitha studimet tregojnë proporcion të drejtpërdrejtë midis nivelit dhe llojit të traumës me ndryshimet e indeve të buta. Vlerësimi i dëmtimit duhet të mbështetet gjithmonë nga ekzaminimi diagnostik në të dy anët e fytyrës, pavarësisht nga karakteristikat e dëmtimit: ATM shpesh i nënshtrohet traumave indirekte.

Konkluzion: Ky rishikim dëshiron të ekspozojë korrelacionin ekzistues midis dëmtimit orofacial dhe pasojave individuale që në mënyre direkte dhe indirekte përfshijnë në përqindje të mirë ATM-në. Studimet e ardhshme do të sqarojnë shtrirjen reale të një ngjarjeje traumatike, si dhe menaxhimin dhe trajtimin e saj.

Fjalë kyç: artikulacioni temporomandibular, vlerësim mjeko-ligjor.

OBJECTIVE ASSESSMENT OF PATIENT COMPLIANCE WITH REMOVABLE ORTHODONTIC APPLIANCES

Dott. Ssa. Valentina Montenegro

Abstract

Young patients, regardless of gender or psychological development, have a low level of compliance with removable braces. Patients typically overestimate the length of time they should use the devices and in fact use their devices for much less time than recommended and self-reported. Patient awareness of monitoring can improve compliance. While awareness of monitoring appears to increase compliance, such systems can be a useful way for a dentist to obtain objective data on their patients' compliance. The aim is to undertake an objective assessment of the level of compliance in young patients who have been prescribed removable appliances, as well as to identify the impact of the type of device, duration of treatment, age, gender, maturity psychological and compliance awareness monitoring.

VLERËSIMI OBJEKTIV I PAJTUESHMËRISË SË PACIENTIT ME APARATE ORTODONTIKE TË LËVIZSHME.

Dr. Valentina Montenegro

Abstrakt

Pacientët e rinj, pavarësisht nga gjinia apo zhvillimi psikologjik, kanë një nivel të ulët të përputhshmërisë me aparatet e lëvizshme. Pacientët zakonisht mbivlerësojnë kohëzgjatjen që duhet t'i përdorin pajisjet dhe në fakt përdorin këto pajisje për shumë më pak kohë sesa rekomandohet dhe vet-raportohet. Ndërgjegjësimi i pacientit për monitorimin mund të përmirësojë pajtueshmërinë. Ndërsa ndërgjegjësimi për monitorimin duket se rrit përputhshmërinë, sisteme të tilla mund të jenë një mënyrë e dobishme për mjekun stomatolog për të marrë të dhëna objektive mbi pajtueshmërinë e pacientëve të tyre. Qëllimi është të ndërmerret një vlerësim objektiv i nivelit të përputhshmërisë në pacientët e rinj të cilëve u janë përshkruar aparate të lëvizshme, si dhe të identifikohet ndikimi i llojit të pajisjes, kohëzgjatja e trajtimit, mosha, gjinia, maturia psikologjike dhe monitorimi i ndërgjegjësimit për pajtueshmërinë.

Fjalë kyç: aparat ortodontik i lëvizshëm.

ATYPICAL SWALLOWING: DIAGNOSIS AND THERAPY IN THE GROWING PATIENT

Viapiano Fabio

Abstract

Aim: Atypical swallowing is a myofunctional disorder that consists in the incorrect positioning of the tongue during the act of swallowing. Deepening this topic is fundamental because this altered neuromuscular pattern can determine changes in the normal development of the craniomaxillofacial complex in the growing patient. In this work we wanted to illustrate the physiological, diagnostic, clinical and therapeutic aspects of this disorder with the aim of understanding, intercepting and preventing skeletal discrepancies.

Methods: A review of the literature available in the MEDLINE database through the PubMED search engine was conducted, searching for the keywords “atypical swallowing”, “growing patient”, “atypical swallowing in the child”.

Results: Atypical swallowing is one of the most frequent bad habits in growing patients. This swallowing anomaly is frequently associated with clinical aspects of malocclusion and alterations in craniofacial growth. According to some authors, disorders of lingual behavior are an etiological factor for alterations in growth patterns, for others they are a consequence of pre-existing dysmorphosis for which they represent an aggravating factor.

Conclusion: Evaluating the changes that atypical swallowing determines during the development of the craniofacial complex, analyzing the phases of the development of swallowing and the anomalies, formulating a correct diagnosis, selecting an interceptive, myofunctional and functional therapy in the growing patient has the aim of avoiding the realization of real skeletal discrepancies, which at the end of the growth phase would require a more invasive surgical treatment.

The multidisciplinary, orthodontic and myofunctional therapeutic approach, early diagnosis and timely intervention significantly influence the outcome of the therapy.

GËLLTITJA ATIPIKE: DIAGNOZA DHE TRAJTIMI TEK PACIENTËT NË RRITJE

Viapiano Fabio

Abstrakt

Qëllimi: Gëlltitja atipike është një çrregullim miofunksional që konsiston në pozicionimin e gabuar të gjuhës gjatë aktit të gëlltitjes. Thellimi i kësaj teme është thelbësor sepse ky model i ndryshuar neuromuskular mund të përcaktojë ndryshimet në zhvillimin normal të kompleksit kraniomaksilofacial në pacientin në rritje. Në këtë leksion ne kemi dashur të ilustrojmë aspektet fiziologjike, diagnostike, klinike dhe terapeutike të këtij çrregullimi me synimin për të kuptuar dhe parandaluar diskrepancat skeletale.

Metodat: Një rishikim i literaturës së disponueshme në bazën e të dhënave MEDLINE përmes faqes së kërkimit PubMED, duke përdorur fjalët kyçe "gëlltitje atipike", "pacient në rritje", "gëlltitje atipike tek fëmija" u realizua.

Rezultatet: Gëlltitja atipike është një nga veset e këqija më të shpeshta tek pacientët në rritje. Kjo anomali e gëlltitjes shoqërohet shpesh me aspekte klinike të malokluzionit dhe ndryshimet në rritjen kraniofaciale. Sipas disa autorëve, çrregullimet e sjelljes gjuhësore janë

një faktor etiologjik për ndryshimet në modelet e rritjes, për të tjerë janë pasojë e dismorfozës pre-ekzistuese për të cilën ato përfaqësojnë një faktor rëndues.

Konkluzione: Vlerësimi i ndryshimeve që përcakton gëlltitja atipike gjatë zhvillimit të kompleksit kraniofacial, analizimi i fazave të zhvillimit të gëlltitjes dhe anomalive, formulimi i një diagnoze të saktë, zgjedhja e një terapie interceptive, miofunksionale dhe funksionale tek pacienti në rritje ka për qëllim shmangien e diskrepancave reale skeletale, për të cilat në fund të fazës së rritjes do të kërkonin një trajtim kirurgjikal më invaziv.
Qasja terapeutike multidisiplinare, ortodontike dhe miofunksionale, diagnostikimi i hershëm dhe ndërhyrja në kohë ndikojnë ndjeshëm në rezultatin e terapisë.

Fjalë kyç: gëlltitja atipike, diagnoza, terapi multidisiplinare.

SURGICAL-ORTHODONTIC THERAPY OF A RIGHT LOWER CANINE INCLUDED: CASE REPORT

Vincenzo Carpentiere

Abstract

Aim of the work: In this work is documented a case of bone inclusion of the mandibular right canine restored in the arch with an orthodontic surgical approach.

Methods: Some of the causes of bony inclusion of the canine are: failure of resorption of the deciduous canine, obliteration of the gubernaculum dentis with loss of eruptive guidance, lack of space in the arch, ect. In a 12-year-old patient, there is an absence of permanent canines and retention of deciduous canines. After a radiographic evaluation with opt x-ray, a dental inclusion of the 4.3 element with the crown inclined towards the apices of the lower incisors was evidenced. CBCT was also performed for a correct planning of the intervention, of the localization of the dental elements and of the anatomical structures. After local anesthesia we proceeded with the avulsion of the deciduous element (8.3), the execution of a full-thickness flap with mesial vertical incision at 4.1 to expose bony cortical and the crown of 4.3. Using an adhesive technique, an orthodontic button was placed on 4.3 to which a metal ligature was attached for traction in the arch, and finally, non-resorbable sutures were applied.

Results: After 8 months from surgery and subsequent orthodontic traction, the included canine was returned to the arch.

Conclusions: For a successful orthodontic surgical therapy of included canines, an early and accurate diagnosis made with clinical and radiological examinations such as OPT and CBCT radiographs and the evaluation of predictive factors of dental eruption is essential.

TRAJTIMI KIRURGJIKALO-ORTODONTIK I KANINIT MANDIBULAR TË DJATHTË TË IMPAKTUAR.

Vincenzo Carpentiere

Abstrakt

Qëllimi i studimit: Në këtë leksion është dokumentuar një rast i mbulimit kockor të kaninit të djathtë mandibular të pozicionuar në arkadë me një nderhyrje kirurgjikale ortodontike.

Metodat: Disa nga shkaqet e mbulimit kockor të kaninit janë: dështimi i rezorbimit të kaninit primar, obliterimi i gubernaculum dentis me humbje të guides eruptive, mungesa e hapësirës në hark, etj. Në një pacient 12-vjeçar, ka mungesë të kaninëve të përhershëm dhe persistencë të kaninëve primarë në arkadë. Pas një vlerësimi radiografik me panorameks, u evidentua impaktim i 4.3 me kurorën e anuar drejt apekseve të incizivëve të poshtëm. CBCT u realizua gjithashtu për një planifikim korrekt të ndërhyrjes, për lokalizimin e elementëve dentarë dhe të strukturave anatomike. Pas anestezisë lokale realizuam ekstraksionin e dhëmbit të qumështit (8.3), ekzekutimin e një lembo me trashësi të plotë me prerje vertikale meziale në 4.1 për të ekspozuar kortikalen kockore dhe kurorën e 4.3. Me anë të teknikës ngjitëse, tek 4.3 u vendos një buton ortodontik, të cilit iu ngjit një ligaturë metalike për tërheqje në hark dhe në fund u vendosën sutura jo të absorbueshme.

Rezultatet: Pas 8 muajsh nga operacioni dhe tërheqja ortodontike, kanini i impaktuar u pozicionua në arkadë.

Konkluzione: Për një terapi të suksesshme kirurgjikale ortodontike të kaninëve të impaktuar, një diagnozë e hershme dhe e saktë e bërë me ekzaminime klinike dhe radiologjike si radiografitë panoramike, skaner CBCT dhe vlerësimi i faktorëve predispozues të erupsionit dentar është thelbësor.

Fjalë kyç: trajtim kirurgjikalo-ortodontik, kanin i impaktuar.

ASSOCIATION BETWEEN INTRAOSSEOUS MALPOSITIONED CANINE AND MESIALISATION OF THE FIRST PREMOLAR

Vito Settanni

Abstract

Aim: The study of this paper is based on the early diagnosis and prognosis of canine included, through different methodologies of sectorial and angular measurements that several authors have proposed over the years by orthopantomography to statistically identify an association between intraosseous dislocated canine and the mesioversion of the first upper premolar. or on the lateral incisor, the angulation of the same on the bicondylar plane according to Lindauer.

Material and Methods: On a sample group of 211 RX orthopantomography with unilaterally or bilaterally malpositioned canines aged 9 to 12 years, measurements were made and different levels of inclusion severity were identified. The analyzed cases were subjected to the following radiological evaluations bilaterally, in particular, were examined unilaterally: patient, sex, age, overlapping sectors s, angle α, distance d, according to Ericson and Kurol; angle Ω, overlapping sectors of the lateral incisor, according to Lindauer; stage of formation of the first upper premolar E, F and G, MDP (Mesially Displaced upper Premolar), EDC (the early displacement of the adjacent permanent canine), angle η, angle π.

Results And Conclusion: We can affirm, through the studies carried out and the measurements made, analyzed by statistical data such as the Chi-Square test, that the mesialization of the first upper premolar is a malposition of the tooth inherent to the development associated with the displacement of the permanent canine in the mixed dentition, and that interceptive treatments, if well performed with the complete collaboration of the patient, can facilitate the physiological eruption in the arch of the upper canines, without resorting later to surgical treatment of orthodontic recovery.

LIDHJA MIDIS KANINIT TË KEQPOZICIONUAR INTRAKOCKOR DHE MEZIALIZIMIT TË PREMOLARIT TË PARË.

Vito Settanni

Abstrakt

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi bazohet në diagnozën e hershme dhe prognozën e kaninit nëpërmjet metodologjive të ndryshme të matjeve sektoriale dhe angulare që disa autorë kanë propozuar ndër vite. Qëllimi është indentifikimi i një lidhje midis kaninit të dislokuar intrakockor dhe mezializimit të premolari të parë të sipërm ose angulimit të incizivit lateral në rrafshin bikondilar (Lindauer).

Materiali dhe metodat: Matjet u realizuan në një mostër prej 211 ortopantomografish. Rastet përfshinin pacientë të moshës 9-12 vjeç ku viheshin re: kaninë të keqpozicionuar unilateral ose bilaterale. Lloje dhe nivele të ndryshme impaktimi u identifikuan. Rastet e analizuara iu nënshtruan vlerësimeve radiologjike të mëposhtme në të dyja anët. Në veçanti, u ekzaminuan: gjinia, mosha, sektorët s të mbivendosur, këndi α, distanca d, (sipas Ericson dhe Kurol); këndi Ω, mbivendosja e imazheve të incizivit lateral, (sipas Lindauer); faza e formimit të premolarit të parë të sipërm E, F dhe G, MDP (premolari maksilar i zhvendosur mezialisht), EDC (zhvendosja e hershme e kaninit të përhershëm), këndi η, këndi π.

Rezultatet dhe përfundimi: Ne mund të pohojmë, nëpërmjet studimeve të kryera dhe matjeve të bëra, të analizuara me të dhëna statistikore si testi Chi-Square, se mezializimi i premolarit të parë të sipërm është një keqpozicionim i dhëmbit, i lidhur me zhvendosjen e kaninit të përhershëm në denticionin miks dhe se trajtimet parandaluese, nëse kryhen mirë me bashkëpunimin e plotë të pacientit, mund të lehtësojnë eruptimin fiziologjik në arkadë të kaninëve të sipërm, pa iu drejtuar më vonë trajtimit kirurgjikal të rikuperimit ortodontik.

Fjalë kyç: kanini i keqpozicionuar intrakockor, mezializim i premolarit.

AVULSIONI I DHËMBIT DHE REIMPLANTIMI I INCIZIVIT CENTRAL MAKSILAR

As.Prof.Dr. Abdyl Izairi

Abstrakt

Dëmtimet nga traumat dentoalveolare shkaktohen nga një ndikim i jashtëm në dhëmbë, palatum, mandibul, maksilë dhe gingivë. Këto dëmtime mund të rezultojnë në një kontuzion dentar deri në një zhvendosje totale të dhëmbit nga alveola e tij, e njohur si avulsion i

dhëmbit. Një sasi e konsiderueshme e forcës është zakonisht e nevojshme për zhvendosjen e dhëmbëve nga alveola dhe në këto raste duhet të dyshojmë për dëmtime të tjera të strukturave përreth. Ky leksion do të rishikojë vlerësimin, diagnozën dhe menaxhimin e avulsionit të dhëmbëve dhe thekson rolin e kujdesit profesional të bazuar në ekip për pacientët e prekur. Reimplantimi është trajtimi i duhur për këtë situatë klinike dhe menaxhimi i kohës dhe ruajtja e duhur e dhëmbit të shkëputur janë faktorë vendimtarë që garantojnë një prognozë të mirë. Terapia e anti-rezorbimit është një teknikë inovative që parandalon inflamacionin e zakonshëm që përjetojnë dhëmbët pas reimplantimit, duke përdorur një kombinim të antibiotikëve dhe kortikosteroideve. Vendosja e shinave (fiksimi) dhe antibiotikoterapia në trajtë sistemike përfshihen gjithashtu në trajtimin e pacientit me avulsion të dhëmbit. Në fund, vizitat e kontrollit janë të një rëndësie të madhe, ku dhëmbi do të vlerësohet klinikisht dhe radiografikisht për të konfirmuar vitalitetin e dhëmbit dhe për të përjashtuar rezorbimin e rrënjës ose ankilozën.

Fjalët kyç: avulsion dentar, traumë dentoalveolare, reimplantimi, incizivë, ankilozë.

FLUORI NË MILENIUMIN E TRETË.

Adelajda Ruci, Prof. As Edit Xhajanka

Abstrakt

Hyrje: Fluori është një element, ku prania e tij në dhëmbë e forcon strukturën dhe i mbron nga kariesi.
Marrja e fluorit bëhet kur dhëmbët janë në formim e sipër, konkretisht nga lindja ku dhëmbët e qumështit janë drejtë mineralizimit e deri në moshën 12 vjec, ku përfundon edhe dalja e dhëmbëve të përhershëm.

Qëllimi: Të kuptojmë çfarë është fluoroza.
Si ndikon fluori në parandalimin e kariesit.
Cilat janë dy rrugët kryesore që merret fluori.
Rreziqet e mbidozimit me fluor.
Doza e fluorit sipas grupmoshës.

Zhvillimi: Sa është doza specifike e marrjes së fluorit nga grupmoshat 6 dhe 16 vjeç.
Pastat që duhet të marrim sipas moshës me përqindjen e duhur pa kaluar në fluoroz.
Mospërdorimi i suplementeve të fluorit pa këshillën e mjekut apo dentistit.

Konkluzioni: Konluzioni u mbështet në këto pika kyçe: Që fluori meret në:
1) Pacientë me higjenë të dobët.
2) Dietë ushqimore të varfër.
3) Defekte të smaltite.
4) Renie e sasisë së pështymës, e për pasojë gojë e thatë.
5) Çrregullime të të ushqyerit.
6) Ekspozimi i rrënjës së dhëmbit si pasojë e tërheqjes së gingivave. (paradontopati)

Fjalë kyç: fluori, përqindja e duhur.

NDIKIMI I PANDEMISË NË SHËNDETIN E PËRGJITHSHËM DHE ORAL

Dr. Afërdita Salihu Fazliu PhD cand[1], Dr Gazmend Fazliu
[1]*Kirurge orale*

Abstrakt

Hyrje: COVID-19 mund të ketë ndikim negativ në shëndetin e përgjithshëm dhe atë oral për shkak të infeksioneve dhe pasojave të ndryshme si: xerostomia humbja e shijes dhe nuhatjes, ankthit dhe komplikimeve të tjera.

Materiali dhe metodat: Hulumtimi është zhvilluar në formë anketimi me pyetje për problemet shëndetësore që kanë pasur gjatë kohës së pandemisë. Mostra ka qenë e rastësishme. Hulumtimi është realizuar në 200 anketues, të cilët janë ndarë në dy grupe, grupi 1 bënin pjesë 100 anketues të grupmoshës 18 –30 vjeçare dhe grupi 2 ishin 100 anketues të grupmoshës 30 deri 60 vjeçare.

Rezultatet: - Te grupi i parë: 60 % e tyre pandemia nuk ka pasur ndikim ose kanë qenë të qetë ndërsa 40 % e tyre kanë qenë të shqetësuar. 70 % prej tyre në pandemi nuk kanë pasur dhimbje, ndërsa 10% kanë pasur dhimbje të dhëmbit. Kur ata kanë pasur dhimbje 20 % kanë vizituar mjekun ose stomatologun, 40% kanë përdorur barëra pa konsultuar mjekun. Barërat që kanë përdorur më së shumti janë analgjetikët 35% ndërsa 15 % kanë përdorur antidepresivë. Higjiena orale në 70 % ka qenë e mire. Problemet që i kanë pasur me dhëmbë 45% prej tyre e kanë vazhduar trajtimin pas lirimit të masave të pandemisë, 65% prej tyre kanë pasur humbje të shijes. 90 % të pacientëve që kanë humbur shijen dhe nuhatjen gjatë infektimit me Covid iu është rikthyer shija dhe nuhatja brenda 3 muajve. 60% prej tyre kanë pasur xerostomi. - Te grupi i dytë: 18 % e tyre pandemia nuk ka pasur ndikim ose kanë qenë të qetë kurse 82 % e tyre kanë qenë të shqetësuar. 50 % prej tyre në pandemi nuk kanë pasur dhimbje ndërsa 3% kanë pasur dhimbje të dhëmbit. Kur ata kanë pasur dhimbje 35 % kanë vizituar mjekun ose stomatologun 30% kanë përdorur barëra pa konsultuar mjekun. Barërat që kanë përdorur më së shumti janë analgjetikët 50 %, ndërsa 10 % kanë përdorur antidepresivë. Higjiena orale në 65 % ka qenë e mirë. Problemet që i kanë pasur me dhëmbë 45% prej tyre e kanë vazhduar trajtimin pas lirimit të masave të pandemisë, 50% prej tyre kanë pasur humbje të shijes dhe nuhatjes. 80 % të pacientëve që kanë humbur shijen dhe nuhatjen gjatë infektimit me Covid iu është rikthyer shija dhe nuhatja brenda 3 muajve. 50% prej tyre kanë pasur xerostomi.

Përfundim: Me rritjen e moshës, shqetësimi ka qenë më i madhë, moshat e reja kanë pasur dhimbje të përgjithshme më pak, ndërsa dhimbje dhëmbi më shumë. Moshat e reja më pakë e kanë vizituar mjekun dhe stomatologun. Përdorimi i barnave pa konsulta mjekësore ka qenë më e shprehur tek të rinjët. Pas kalimit të pandemisë nuk ka pasur dallime mes grupeve në vazhdimin e trajtimeve dentare.

Fjalët kyç: Covid-19, shëndeti oral, dhimbje dhëmbi, terapit në pandemi.

SI DUHET TË MENAXHOHEN TË RRITURIT ME KANCER NGA MJEKËT STOMATOLOGE NËSE KANË NEVOJË PËR TRAJTIM DENTAR

Aida Sadiku

Abstrakt

Në mënyrë ideale, ekipi i onkologjisë ose hematologjisë i pacientit është përgjegjës për organizimin ose kryerjen e të gjithë trajtimit aktiv dentar ndërkohë që pacienti është aktualisht duke marrë trajtimin e kancerit, kështu që gjithmonë lidhuni me mjekun specialist përpara se të filloni një procedurë dentare gjatë kësaj kohe. Siguroni trajtim urgjent dentar për një pacient që aktualisht merr kimioterapi ose radioterapi në kokë ose qafë, ose që ka marrë kimioterapi ose radioterapi në kokë ose qafë në gjashtë muajt e mëparshëm, ose ka pasur transplantim të qelizave staminale/palcës kockore në gjashtë muajt e mëparshëm vetem pas kontaktit me ekipin onkologjik ose hematologjik të pacientit për të zbuluar nëse trajtimi mund të kryhet në mënyrë të sigurt. Nëse kjo nuk është e mundur, referojeni pacientin urgjentisht në kujdesin dytësor dentar. Mos ofroni trajtim dentar invaziv zgjedhor për një pacient që aktualisht merr kimioterapi ose radioterapi në kokë ose qafë, ose atyre që kanë marrë kimioterapi ose radioterapi në kokë ose qafë në gjashtë muajt e mëparshëm, ose kanë pasur një transplantim të qelizave staminale/palcës kockore në zgjasin gjashtë muaj, pa marrë këshilla nga ekipi onkologjik ose hematologjik i pacientit.

Fjalë kyç: trajtim dentar, onkologji, hematologji.

MENAXHIMI I LEZIONEVE TË NJOLLAVE TË BARDHAVE

Alba KAMBERI[1] , Olja TANELLARI[1]
[1] Universiteti Aldent, Fakulteti i Shkencave Dentare, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Hyrje: Lezionet e njollave të bardha (WSLs) janë përkufizuar si një njollë opake e bardhë, e cila shfaqet si rezultat i demineralizimit të shtresës nënsipërfaqësore të smaltit. Ky demineralizim nënsipërfaqësor sjell ndryshime në indeksin refraktar të smaltit dhe manifestohet klinikisht si opacitet i bardhë si shkumës ose ndryshe WS.
Njollat e bardha gjithashtu mund të shfaqen në dhëmbë për shkak të : 1. Fluorozës, 2. Hipoplazisë së smaltit, 3. Traumat dentare në fëmijërinë e hershme, 4. Pas një trajtimi ortodontik me aparat fiks

Qëllimi: Nëpërmjet këtij studimi kemi për qëllim të tregojmë cilët janë faktorët kryesorë të riskut në shfaqjen e njollave të bardha si dhe mënyrat më efikase të parandalimit duke bazuar jo vetëm në eksperiencën tonë klinike, por dhe në studimet e viteve të fundit të literaturës.

Materiale dhe metoda: Është bërë një rishikim literature përsa i përket WSLs që nga faktorët etiologjike, prevalenca, diagnoza e saktë, mënyrat e parandalimit dhe përmirësimit të tyre deri në trajtimin e tyre sipas llojit të formës klinike. Do të përqendrohemi në mënyrë të detajuar në etapat e sakta të aplikimit dhe të suksesit në trajtimin që ka përdorimi i Icon - White Spot/ Infiltrimi Rezinoz.

Rezultate: Përdorimi i Icon - White Spot/ Infiltrimit Rezinoz rezulton të jetë një trajtim mikroinvaziv efikas për lezionet e njollave të bardha (WSLs), duke lejuar trajtimin e lezioneve në një seancë të vetme dhe jo traumatike, sipas studimeve të viteve të fundit si in vitro po ashtu edhe in vivo.

Konkluzione : Sipas studimeve të shumta ka mënyra të ndryshme të trajtimit të lezioneve të njollave të bardha, ku do të përmendim përdorimin e kalciumit dhe fosforit, pastave dentare me 1000ppm ose varnishet e fluorit, probiotikët , antiseptikët dhe trajnimi nëpërmjet lazerit. Por përdorimi i ICON – White Spot/ Infiltrimit rezinoz ka rezultuar se është i shpejtë , i lehtë në përdorim , dhe me rezultate të larta efektive. Megjithatë, higjiena e mirë orale është masa më e rëndësishme profilaktike në pacientët ortodontikë fiks për të parandaluar WSLs.

Fjalë kyçe : Njollat e bardha, WSLs, Infiltrim Rezinoz, faktorë etiologjikë, prevalencë, probiotikë, antiseptikë, lazer.

OSSEODENSIFIKIMI, NJË TEKNIKË ALTERNATIVE E OSTEOTOMISË TRADICIONALE

Dr. Albi Skilja[1], Prof. Asc. Dr. Erda Qorri[2], Dr. Gerila Tafaj[3]
[1]Implantolog Ass. Petagog pranë Albanian University, Departamenti Stomatologjisë, Ordinator i Kirugjisë Orale.
[2]Dekane e Albanian University. Drejtuese e Klinikës Universitare"Çerçiz Mingomataj".
[3]Ass. Petagoge pranë Albanian University, Departamenti Stomatologjisë, Ordinatore e Periodontologjisë.

Abstrakt

Qëllimi: Rritja e njohurive tek stomatologët e rinj rreth teknikave të ndryshme alternative për oseodensifikim. Teknikat e studiuara janë me menyrën "under prep", me osteotomë dhe me frezat kockore.

Materiale dhe metoda: Ky është një punim bazuar në literaturë review, ku sipas elementëve përfshirës për këtë studim rezultuan 7 artikuj të cilët përmbushën kriteret përzgjedhëse. Për përzgjedhjen e artikujve u përdorën burimet online si PubMed, Google Scholar me një periudhë kohore 2000-2021.

Rezultate dhe diskutime: Oseodensifikimi është një metodë alternative nga osteotomia tradicionale. Relativisht lehtë e arritshme, me kosto të ulët financiare me rezultate të provuara shkencërisht dhe e implementuar për raste nga më të ndryshme të insertimit implantar. Teknikë e cila duhet të jetë një aset i vyer për çdo profesionist që merret me implantologjinë tradicionale dhe akoma më shumë me atë të avancuar si në rastet e implanteve post ekstraktive deri tek densifikimi për të arritur karikimin imediat.

Fjalët kyç: osseodensification, dental implant, implant primary stability, implant stability, literature review.

NJË ANALIZË MBI IMPLANTIMIN IMEDIAT ME NGARKESË IMEDIATE

Dr.Aldo Vangjeli (Phd)1, Dr.Enkelejda Elbasani2, Dr. Erion Gjiknuri3
[1]*Kirurg Oro-Maxilo-Facial Albanian University*
[2]*Albanian University*
[3]*Perla Dent*

Abstrakt

Implantimi imediat nënkupton vendosjen e menjëhershme të implantit ose implanteve menjëherë pas një ekstraksioni ose një manipulimi më të madh. Pra kemi një problematikë të dytë në dukje sekondare e cila duhet zgjidhur më së pari, bile edhe në mënyrën më të mirë të mundshme, pasi ajo në momente të caktuara bëhet vendimtare në zgjedhjen kirugjikale të rastit.
Në këtë pikë mjeku duhet të zgjedhë në vlerësimin e tij midis pozitivitet por edhe riskut në trajtimin implantar me një ose disa seanca të pacientit.

Qëllimi: Me anë të rasteve klinike të trajtuara në klinikën tonë dua të tregoj që ndërhyrjet kirurgjikale implantare imediate pavarësisht patologjive primare qofshin këto edhe formacione kistike të shoqëruara me destruksion kockor, të diagnostikuara dhe të dokumentuara është më mirë të kryhen me një seancë të vetme.

Materiali e metoda: Për këtë punim kam shfrytëzuar eksperiencën time personale teoriko-praktike në trajtimin kirurgjikal të pacientëve të cilët janë paraqitur dhe i janë nënshtruar ndërhyrjeve kirurgjikale dhe jo vetëm. Në këtë punim do të paraqes raste klinike të ndryshme në shërbim të shtjellimit temës jo vetëm si ide por edhe si koncepte që shtrohet për zbatim nga mjekët të cilët aplikojnë implantologjinë në klinikat e tyre.

Rezultatet: Vendimarrja e vazhdimit të procesit të implantimit në rastet me patologji kistike mundet të vendoset edhe në mënyrë aktive gjatë ndërhyrjes kirurgjikale, por është mirë që kjo ndërhyrje të cilësohet si primare nga mjeku në momentin e planifikimit të interventit. Përpunimi i gjakut të pacientit, diferencimi i elementëve të pasuruar pavarësisht kohës së centrifugimit dhe emërtimit të tyre është një faktor shumë pozitiv që na dhuron një përqindje të lartë suksesi, ndaj aplikimi i saj si procedurë standarde është një arsye më shumë për ti qëndruar idesë për një ndërhyrje të vetme.

Konkluzion: Implantimi imediat paraqet disa avantazhe domethënëse por që mbështeten absolutisht në profesionalizmin e mjekut.Kjo teknikë redukton intervalin kohor për vendosjen e suprastrukturës,ndalon rezorbimin e kockës alveolare në gjerësi dhe lartësi pasi vlen të kujtohet që pas ekstraksionit të dhëmbit gjatë vitit të parë kemi 15 - 25 % humbje në gjerësi dhe 2 – 4 mm në lartësi të kockës së nofullës, përdoret pjesërisht aksi i dhëmbit, ul kohën e shërimit por edhe mund të shtojmë koston më të reduktuar të pacientit.
Autorët Pecara, Asmau japin të dhëna se sukseset e implantit imediat në pesë vite janë 94,1 % , madje ka edhe autor që mendojnë se implanti imediat është më i mirë se implanti normal. Mos suksesi sipas kirurgut Gelb sillet rreth 2 – 7 % te rastet me implantim imediat.
Rastet me patologji kistike në regionin oral tek pacientët që kanë nevojë për ndërhyrje kirurgjikale implantare janë panoramë e së njëjtës fushë operatore ndaj ti ndash ato nga njëra-tjetra është shumë e vështirë. Megjithatë standardet e ndërhyrjes në secilën prej tyre mbeten të pandryshuara.

Fjalët kyç: Trajtimin implantar, patologji kistike, destruksioni kockor.

KANCERI I BUZËS DHE ROLI I MJEKUT STOMATOLOG NË ZBULIMIN E HERSHËM TË TIJ.

Dr Shk Algen Isufi[1*], Dr Shk Irina Isufi [2], Prof Dr Ramazan Isufi
[1]Shërbimi i Kirurgjisë OMF, Qëndra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë
[2]Isufi Dental Clinic, Tiranë

Abstrakt

Nga studimet e autorëve të ndryshëm në botë dhe në Shqipëri rezulton se kanceri i buzës përbënrreth 25-30% të tumoreve malinje të rregjionit OMF. Ky kancer preferon më shumë buzën e poshtme në rreth 95% të rasteve ku rreth 50% tyre shoqërohen edhe me metastaza në qafë.
Menaxhimi i kancerit të buzës përfshin jo vetëm kontrollin e tumorit parësore në kufij të shëndetshëm onkologjikisht por edhe kontrollin e kujdesshëm për përhapjen e mundshme metastatike në qafë dhe rikonstruksioni i mëvonshëm. Rikonstruksion është një sfidë kirurgjikaleveçanërisht për lezionet e avancuara dhe me shtrirje të gjerë.
Tumoret e stadit të hershëm kanë rezultate të mira prognostike, estetike dhe funksionale pas operacionit në krahasim me trajtimin e lezioneve të avancuara, të cilat ndryshojnë pamjen dhefunksionalitetin e buzës.
Stadi në diagnozë është treguesi më i rëndësishëm prognostik për kanceret e qelizave skuamozetë gojës. Fatkeqësisht, afërsisht 50% e këtyre kancereve identifikohen vonë (stadi III ose IV).
Zakonisht pacientët janë asimptomatike në stadet e para të sëmundjes, arsye kjo që çon në identifikimi dhe trajtimin me vonesë të tyre. Mjeku stomatolog është ndër të vetmit mjek që ekzaminon rregullisht gojën e pacientëve ndaj ka një rol kyç në zbulimin e hershëm të kanceritoral duke përfshirë edhe identifikimin e kushteve që mund të paraprijnë fillimin e kancerit invaziv. Krahas depistimit të hershëm, monitorimit dhe referimit të mjeku specialist, mjeku stomatolog duhet të marri pjesë në mënyrë aktive në proceset e rehabilitimit të pacientëve me kancer oral përmes ekzaminimeve të rregullta të ndjekjes klinike dhe restaurimit të funksionit intraoral.

Fjalë kyç: kanceri i buzës, stomatolog, lezione.

TRAJTIMI KIRURGJIK ORAL I PACIENTËVE ME SËMUNDJE SISTEMIKE.

Amet Demiri[1], Seha Demiri –Mustafai [2,3], Armed Demiri[2]
[1]Klinika për Kirurgji Orale "Kirurgjia Estetike Orale" Tetovë
[2]Klinika Dentare "Vivadent", Tetovë
[3]Programi Studimor Stomatologji, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Shtetëror i Tetovës

Abstrakt

Hyrje: Në përgjithësi, është e rëndësishme të vlerësohet historia mjekësore e pacientëve përpara se të fillohet çdo trajtim. Në veçanti, pacientët që kërkojnë trajtim kirurgjik oral mund të kenë kushte të rëndësishme mjekësore që mund të ndikojnë në diagnozën dhe/ose të ndryshojnë trajtimin e ofruar. Vlerësimi para operacionit është thelbësor për të parandaluar komplikimet kirurgjikale pas operacionit.

Qëllimi i studimit: Ky studim synoi të përcaktojë profile sasiore dhe cilësore të çrregullimeve sistemike dhe t'i ndërlidhë ato me komplikacionet potenciale kirurgjikale postoperative në pacientët që i nënshtrohen intervenimeve kirurgjike orale.

Metodat: Të dhënat u mblodhën nga të dhënat mjekësore të 1278 pacientëve që iu nënshtruan intervenimeve kirurgjike orale nga viti 2016 deri në 2021 përmes një analize të detajuar të dosjeve të anamnezës. Të dhënat e mbledhura u renditën në tabela dhe u konvertuan në përqindje për të lehtësuar diskutimin dhe krahasimin me raportet në literaturë.

Rezultatet: Nga 1278 pacientë, 682 (53.36%) ishin të rrezikuar nga ana sëmundjeve sistemike me një prevalencë më të lartë të hipertensionit 527 (41,24%), e ndjekur nga diabetit mellitus, 497(38.89%), sëmundjet kardiovaskulare 491 (38.42%), dhe sëmundjet e frymëmarrjes 227 (17.76 %) ishin gjendjet më të zakonshme të identifikuara.

Përfundim: Prevalenca e sëmundjeve sistemike te pacientët me kirurgji orale është e lartë, prandaj është e detyrushme një histori e plotë dhe një ekzaminim klinik detal
Kjo do të çojë në identifikimin e pacientëve me gjendje të sëmundjeve sistemike dhe jo vetëm Rezultojnë në modifikimin e trajtimit kirurgjik oral, por edhe më e rëndësishmja, vendosjen e menaxhimit të duhur.
Pacientët me probleme mjekësore do të jenë në gjendje terapi e shumëfishtë medikamentoze, dhe kirurgët oral duhet të jenë të vetëdijshëm për këto barna dhe ndërveprimet e tyre kur përshkruajnë medikamente për procedurat e kirurgjikale orale.

Fjalët kyç: prevalencë, sëmundje sistemike, kirurgji orale, gjendje mjekësore.

TRAJTIMI I MALOKLUZIONIT TË KLASËS SË III

MSc. Andia Kusta[1]
[1]*Mjeke stomatologe, specializante në Ortognatodonci*

Abstrakt

Malokluzioni i klasës së III përfaqëson një anomali dentofaciale të rritjes i cili mund të shoqërohet me një maksilë të retruduar, me një mandibul të protruduar apo një kombinim i të dyja këtyre. Ai klasifikohet në tre tipe: pseudo, dentoalveolare dhe skeletale. Shpesh është problematikë gjenetike dhe paraqet vështirësi në trajtim.

Ky studim është një rishikim literature, qëllimi i të cilit lidhet me identifikimin e mënyrave të ndryshme të trajtimit në pacientë në mosha të ndryshme, e lidhur kjo edhe me faktin sesa i rëndë është malokluzioni.

Trajtimi i malokluzionit të klasave të treta u grupua në tre kategori: a. trajtimi i hershëm vetëm ortodontik, b. trajtimi ortodontik dhe ortopedik dhe c. trajtimi ortodontik dhe kirurgjikal ortognatik. Përdorimi i minividave si ankorim skeletik, bën më efektiv modifikimin e rritjes dhe gjithashtu rrit mundësinë e kamuflimit për pacientët jo të përshtatshëm për kirurgji. Megjithatë, trajtimi ortodontik i kombinuar me kirurgjinë ortognatike mbetet opsioni i vetëm për pacientët me malokluzion të rëndë skeletik të klasës së III.

ZGJEDHJA E DHËMBËVE ANTERIORË NË PROTEZËN TOTALE

Anisa Hallaçi[1], Bianka Bermuça[1], Alketa Qafmolla[2].
[1]Studente, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.
[2]Departamenti i Ortopedisë Stomatologjike, Fakultetin e Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Abstrakt

Hyrje: Përzgjedhja e dhëmbëve artificialë në protezën totale përbën në vetvete një sfidë, pasi ata luajnë një rol shumë të rëndësishëm estetik dhe funksional. Aspekti estetik duhet të shihet në disa drejtime: biologjik, fiziologjik, biomekanik dhe psikologjik. Përzgjedhja e dhëmbëve artificialë bëhet duke ndjekur rregulla dhe kritere të caktuara, zbatimi i të cilave bën të mundur realizimin e një proteze në harmoni me fytyrën dhe formacionet e tjera anatomike.

Qëllimi: Të evidentojmë parametrat e nevojshëm që duhen pasur parasysh për të arritur një nivel estetik, funksional dhe fonetik të kënaqshëm në dhëmbët anteriorë të protezës totale. Gjithashtu, përzgjedhja në mënyrë korrekte e dhëmbëve anteriorë ruan dimensionin vertikal dhe parandalon dëmtimin e kreshtës reziduale.

Metoda: Për realizimin e këtij punimi u shqyrtuan literatura të huaja. Pikat kryesore ku bazohet studimi jonë përfshijnë përmasat, formën, ngjyrën dhe materialin. Përzgjedhja e dhëmbëve anteriorë bëhet duke marrë parasysh një sërë faktorësh: përmasat e nofullave, raportet ndërnofullore, kreshtat reziduale, formën e fytyrës, buzët, gjininë, moshën, flokët, sytë.

Rezultatet: Me rritjen e moshës ka një tendencë për përzgjedhje më të errët të ngjyrës së dhëmbëve artificialë. Për të përcaktuar përmasat bazohemi kryesisht në linjat estetike ndihmëse dhe në matjet me Indikatorin Facial. Zgjedhja e formës sipas metodës së Pound dhe Williams bazohet në konformacionin e dhëmbit, profilin lateral dhe profilin mezio-distal. Forma e dhëmbëve përzgjidhet në harmoni me arkadën dentare. Pacientëve picnichabitus iu përshtatet forma katrore, leptosomëve forma trekëndëshe ndërsa atletikëve forma ovale. Gjithashtu, në pacientët meshkuj preferohet formë më katrore ndërsa tek femrat tendencat janë drejt formave të rrumbullakosura dhe ovale.

Përfundimet: Mjeku luan një rol të rëndësishëm në orientimin e pacientit për të bërë zgjedhjen e duhur. Ai duhet të vizualizojë estetikën në lidhje me pacientin dhe më pas ta përkthejë atë në një rezultat estetik të pranueshëm. Arti i dentistrisë i rikthen buzëqeshjen pacientit bashkë me vetëbesimin dhe vetëvlerësimin. Kjo ndihmon dhe lehtëson ruajtjen e shëndetit fizik dhe psikologjik të tij.

Fjalët kyç: protezë, estetikë, përzgjedhje, harmoni, përmasa, ngjyrë, formë.

TERAPIA ANTIBIOTIKE NË INFEKSIONET ODONTOGJENE

Armend Demiri[1], Seha Mustafai[1,2], Amet Demiri[3]
[1]Klinika Dentare "Vivadent", Tetovë
[2]Programi Studimor Stomatologji, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Shtetëror i Tetovës
[3]Klinika për Kirurgji Orale "Kirurgjia Estetike Orale" Tetovë

Abstrakt

Proceset inflamatore odontogjene në rajonin oro-maksiofacial më shpesh janë forma purulente të infeksionit dhe paraqesin pjesën dërmuse të patologjisë në stomatologji.
Qëllimi i këtij studimi është që të përcaktohet se cila florë mikrobiologjike mbisundon në infeksionet odontogjene dhe të caktohet terapia tranzitore antibiotike deri në momentin e marrjes të rezultateve të antibiogramit dhe zgjedhjes të antibiotikut definitiv.
Materialin klinik e përbëjnë strishot e marra prej plagëve incizale, apekseve të dhëmbëve të ekstrahuar, prej proceseve akute të inflamuar, nga plagët e infektuara të dhëmbëve të ekstrahuar, kisteve të infektuara si dhe proceseve periapikale nga pacientë të të dy gjinive të trajtuar në mënyrë kirurgjike në repartin tonë në një periudhë kohore prej 5 viteve.
Prej proceseve inflamatore në indet e buta (abscese dhe flegmona), identifikimi bakteriologjik i shkaktarit është kryer te 74 raste. Identifikimi mikrobiologjik gjithashtu është realizuar në 38 raste në plagët e infektuara ekstrakcionale, 34 kiste të infektuara dhe 63 dhëmbë me procese periapikale kronike.
Në bazë të rezultateve të hulumtimit tonë mund të konkludohet se:

1. Frekuenca e bakstereve në infeksionet e indeve të buta dhe odontogjene është dominante te bakteret aerobe dhe fakultative anaerobe.
2. Infeksionet akute odontogjene deri në zgjedhjen e antibiotikut adekuat mund të trajtohen me antibiotikë të grupit të penicilinës, preparateve të penicilinës gjysëm sintetike, streptomicinës dhe cefalosporineve.

Fjalët kyç: infeksionet, rajoni oro facial, terapia antibiotikët.

KOMPLIKACIONET LOKALE TË IMPLANTEVE DENTARE DHE MENAXHIMI I TYRE

Benarda Beqaraj

Abstrakt

Hyrje: Implantet dentare përdoren me sukses si një trajtim për të zëvendësuar mungesat e dhëmbëve si nga ana funksionale ashtu edhe nga ajo estetike.

Qëllimi: Qëllimi i këtij prezantimi është të njihemi me komplikacionet lokale të implanteve dentare. Këto i ndajmë në komplikacione të hershme dhe të vona.

Materiale dhe metoda: Janë marrë në konsideratë pacientë me mbi 500 implante të trajtuar në klinikën dentare Smile Dental Studio. Në komplikacionet e hershme mund të përmendim: hemorragjinë, lezione të indeve të buta, dëmtim i nervave, mungesë e stabilitetit primar, përforcime kockore, pozicionim e vendosje e gabuar e implantit, thyerje apo gelltitje e instrumentave etj. Komplikacionet e vona janë rezultat i ngjarjeve gjatë ndërhyrjes ose gjatë fazës së shërimit. Ky grup komplikacionesh përfshin: mungesë osteointegrimi, infeksion, edema, hematoma, shkolitja e lembos etj.

Përfundime: Shumica e komplikacioneve në kirurgjinë implantare mund të parandalohen duke përzgjedhur dhe trajtuar saktë pacientët. Mjeku duhet të njoh mirë komplikacionet e

hershme dhe të vona, të mundohet ti shmangë ato duke pasur informacionin e duhur dhe planin e duhur të trajtimit për çdo pacient.

Fjalët kyç: implante, komplikacion, lezione indeve të buta.

RIKONSTRUKSIONI I BUZËS SË POSHTME

Bisela Asllanaj[1]
[1]Kirurge Oro-Maksilo-Faciale

Abstrakt

Rikonstruksioni funksional i buzës së poshtme sidomos pas defekteve të lindura apo pas ekscizionit të tumoreve të mëdhaja, avulsionit traumatik, djegieve apo infeksioneve mbetet një sfidë për kirurgët. Buza është qendra dinamike e 1/3 së poshtme të fytyrës dhe ka rëndësi në estetikën e fytyrës, mimikë, në të folur, ushqyer dhe gëlltitje. Prandaj rikonstruksioni funksional i gjithë trashësisë së buzës ka vlerë në ndihmë të pacientit për të vazhduar aktivitetin e tij jetësor cilësor. Teknika të ndryshme kirurgjikale në varësi të shkallës së defektit e lejojnë kirurgun të arrijë rezultate të kënaqshme.

Qëllimi i studimit tonë është të tregojmë cilat teknika kirurgjikale janë më të përshtatshme në varësi të defektit të buzës së poshtme dhe rëndësia e vlerësimit të kujdesshëm të rastit para se ti nënshtrohet interventit për të maksimizuar rezultatet postoperatore.

EFIKASITETI KLINIK I PASTËS SË DHËMBËVE ME PËRMBAJTJE LAKTAT ALUMINI DHE KLORHEKSIDINE LIDHUR ME FORMIMIN E PLLAKËS DENTARE DHE GINGIVITIT

Dr. Bisela Asllanaj, Prof. Dr. Nicole B. Arweller, Prof. Dr. E. Hellwig

Abstrakt

Qëllimi i studimit ishte vlerësimi i efektit të reduktimit të formimit të pllakës dentare dhe gingivitit midis një grupi pacientësh që përdori pastë dhëmbësh me përmbajtje laktat alumini dhe klorheksidine dhe një grupi që paralelisht përdori pastë dhëmbësh me përmbajtje fluoride, pa agjent mikrobial. Të dy popullatat në studim vuanin nga gingiviti. Koha e studimit ishte 6 muaj.

Materiali dhe metoda: Ky studim prospektive përfshiu 59 pacient dhe koha e studimit të tyre ishte një periudhe 6-mujore. Pllaka dentare, gingiviti, formimi i gurëzave dhe ngjyrimi i dhëmbëve u vlerësuan për 59 pacient, të cilët u ndanë në grupe paralele. Pacientët që përdorën një pastë dhëmbësh që përmban klorheksidinë dhe laktat alumini (grupi i testimit) ishte njëri grup dhe grupi tjeter I kontrollit përfshinte pacientët që përdorën një pastë dhëmbësh pa përbërësit aktiv (grupi i kontrollit). Parametrat u vlerësuan në fillim të studimit dhe përsëri pas 1, 3 dhe 6 muajsh.

Rezultatet: Pas 6 muajsh përdorim të produktit, grupi testimit kishin më pak gingivit krahasuar me grupin e kontrollit, ($p<0.001$). Nga ana tjtër , grupi i testit që kishte përdorur pastë dhëmbësh me klorheksidin dhe laktat alumini tregoi vlera më të ulta dhe statistikisht domethënëse të indeksit gingivar krahasuar me grupin e kontrollit ($p=0.001$).

Konkluzioni: Ka një ndryshim statistikisht domethënës në 6 muaj midis grupeve të testit dhe kontrollit. Reduktimi I indeksit gingivar me 60% midis pacientëve në grupin e testit që përdori Lakalut aktiv, dhe diferenca statistikisht domethënëse, tregojnë që ky rezultat do konsideruar klinikisht si domethënës.

KRAHASIMI I DY METODAVE TË POLIMERIZIMIT TË PLASTMASËS NË PROTEZAT E LËVIZSHME, METODA TRADICIONALE VS METODA E POLIMERIZIMIT ME PRESION

MSc. Dervish Kërçuku

Abstrakt

Hyrje: Në ditët e sotme teknologjia po rritet me hapa të mëdha. Ky zhvillim, si në çdo fushë tjetër ka pasur ndikimin e tij në ortopedi duke sjellë përsosjen e vazhdueshme të materialeve të përdorura për bazën e protezave të lëvizshme dhe perfeksionimin e procedurave të përgatitjes së këtyre materialeve. Në pjesën më të madhe të rasteve protezat me bazë rezine polimerizohen me metodën e zakonshme. Rezina e protezës pëson ndryshime dimensionale giatë ciklit të polimerizimit. Me metodën e injektimit me presion është vënë re reduktim i këtyre ndryshimeve dhe përmirësim i vetive fizike të bazës së protezave.

Qëllimi: Krahasimi i parametrave të protezave sipas dy metodave të ndryshme të polimerizimit të rezinës.

Materiali dhe metoda: Ky studim u realizua për një periudhë 6 mujore, duke nisur në dhjetor të vitit 2019 dhe duke përfunduar në maj të vitit 2020 prane ambjenteve te Klinikës Universitare në 12 pacientë. Pacientët i përzgjodhëm me kushte anatomike pak a shumë të njëjta, duke analizuar në këtë aspekt gradën e atrofisë, reziliencën e mukozës, individualitetin e fomacioneve të ndryshme anatomike. Pacientët u kontrolluan pas 1-3-6 muajsh.

Rezultate: Parakontaktet janë minimale (10%) ose mungojnë plotësisht në protezën e polimerizuar me presion, ndërkohë vihen re në të gjitha protezat e polimerizuara me metodën e zakonshme (90%). Nuk patëm ndryshime në lartesinë e okluzionit me metodën e polimerizimit me presion, ndërkohë në 40% të pacienteve të protezuar me metodën tradicionale u vu re ngritje e lartesisë së okluzionit. Hasëm dekubituse në 80% të pacientëve me proteza të zakonshme dhe në 20% të pacientëve me metodën e polimerizimit me presion. Nuk hasëm ngacmime të mukozës në asnjë nga pacientet me metodën e polimerizimit me presion, nderkohë u vu re në 20% të pacientëve me metodën tradicionale.

Konkluzione: Metoda e zakonshme e polimerizimit ka një serë disavantazhesh, të cilat reflektohen me probleme në pacientët e protezuar. Këto probleme lidhen me precizionin e

protezës, me funksionimin e saj, adaptimin e pacientit dhe ndikimin e protezës mbi indet ku ajo mbështetet. Metoda e polimerizimit me presion i redukton në mënyrë të ndjeshme të gjitha këto probleme.

Fjalë kyç: Polimerizimi me presion, lartësia e okluzionit, ngacmime mukozale, polimerizimi tradicional.

ANESTEZIA LOKALE. TIPET DHE SOLUCIONET QË PËRDOREN NË KLINIKAT TONA.

Dorian Kostandini[1], Sara Zeneli[2]
[1]*Doktor i Shkencave Mjekësore*
[2]*Studente*

Abstrakt

Qëllimi: Anestezia e ka lehtësuar sot punën e stomatologëve në kontrollin e dhimbjes dhe e ka rritur komfortin e pacientëve. Në praktikën e përditshme mjekë të ndryshëm kanë mësuar të përdorin solucione anestetike dhe teknika të cilat më shumë i përshtaten atyre, gjë që është perfeksionuar me kohën. Këto teknika janë gjithmonë të lidhura së bashku me metodat e përdorura të injektimit.

Materiale dhe metoda: Ne organizuam një pyetësor të thjeshtë mbi llojet e solucioneve anestetike të përdorura në rreth 100 klinika dentare në Tiranë dhe rrethe. Po kështu, në pyetësor u përfshinë edhe ndërlikimet që mund të jepte anestezia lokale.

Rezultate dhe diskutime: Bazuar edhe në literaturën bashkëkohore, si edhe në të dhënat e mbledhura, ne nxorëm disa përfundime. Lidokainë 2% rezultoi solucioni më i përdorur. Anestezia lokale, falë teknikave, mjeteve dhe solucioneve gjithnjë e më pak alergjike doli se jepte ndërlikime të papërfillshme.

Fjalë kyç: anestezia lokale, solucione, klinika.

PROTOKOLLI OPTIMAL PËR REALIZIMIN E RESTAURIMEVE POSTERIORE DIREKTE.

Dorina Mele

Abstrakt

Megjithë zhvillimin e gjerë që ka dentistria sot, mbushjet direkte në regjionin posterior zënë një vend të rëndësishëm në praktikën e përditshme klinike. Për të realizuar mbushje cilësore, estetike dhe eficiente duhet një protokoll pune që kombinon disa faktorë si izolimin e mirë të fushës operatore, përzgjedhjen e kompozitit, agjentit lidhës (bondit), llampës së polimerizimit, instrumentave modelues dhe atyre të finiturës. Të gjithë këto komponente bazohen në teknologji të avancuara si “Assencio”, “Poliwave”, ”Polyvision” etj, si dhe në dizenjo inovatore objektiv i këtij prezantimi.

Fjalë kyç: restaurime, assencio, poliwave, polyvision.

PËRCAKTIMI I PARAMETRAVE TË DHËMBËVE SIPAS TEORISË SË AUTORËVE FRUSH DHE FISHER GJINI PERSONALITET MOSHË

Prof. Asoc. Edit Xhajanka, Dr. Endrit Paparisto, Tedi Vercani
[1]Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Departamenti i Protetikës, Tiranë.
2Klinika Dentare Paparisto, Tiranë.

Abstrakt

Përcaktimi i parametrave të dhëmbëve frontalë në protezat e lëvizshme është një proces që realizohet si bashkëpunim ndërmjet laborantit, mjekut dhe pacientit, të cilët mund të bazohen në të dhëna pre apo post ekstraktive. Kriteret estetike përcaktojnë këtë zgjedhje. Autorë të ndryshëm kanë përpunuar teori të ndryshme. Mjeku mund të marrë për bazë teoritë që i gjykon me të besueshme dhe më të sukseshme. Zgjedhja bëhet duke patur parasysh individualitetin dhe vecoritë e cdo pacienti.

Qëllimi i prezantimit është të paraqesë mënyrat dhe teoritë e zgjedhjes së dhëmbëve duke synuar krijimin e një proteze që përshtatet me individualitetin e pacienti, fytyrën, nofullat, zhvillimin trupor etj. Ka shumë metoda që ndërlidhin parametrat e dhëmbëve me parametrat facialë, konstitucionalë, me formën dhe madhësinë e nofullave, linja të profilit të pacientit, llojin e okluzionit, etj.

Materiali dhe metoda: Këto metoda janë zbatuar në 245 pacientë me proteza totale dhe subtotale, ku është bërë përshtatja e dhëmbëve sipas parametrave të fytyrës dhe të nofullave. Teoria e autorëve Frush dhe Fisher "gjini-personalitet-moshë" është teoria ku bazohet zgjedhja e formës, kurbaturave, dhe gjithë parametrave sipas dy tipologjive soft dhe bold të dhëmbëve, bazuar në moshën dhe karakterin e pacientit. Mjaft interesant dhe i thjeshtë është edhe përdorimi i Indikatorit Facial, i konstruktuar sipas studimeve të autorit Pound.
Në leksion tregohen teori të shumë autorëve për të përzgjedhur dhëmbët frontalë dhe distalë të përshtatshëm si nga ana estetike, dhe funksionale.

Konkluzionet: zgjedhja e dhëmbëve është proces bashkëpunimi, ndërthurja e teorive të ndryshme, nëpërmjet matjeve apo analizave të fytyrës dhe nofullave con në harmonizimin e dhëmbëve me tipologjine e pacientit. Synohet në përshtatjen e modulit të dhëmbëve frontalë me fytyrën dhe parametra individual të pacientëve sipas kritereve estetike, ndërsa zgjedhja e dhëmbëve distalë bazohet në kriteret funksionale.

Fjalë kyç: gjini, personalitet, moshë.

NDIKIMI I VITAMINËS D NË ZHVILLIMIN E DHËMBËVE

Dr.Shk.Mj.Eglantina Bejko, Dr.Edlira Mulo

Abstrakt

Hyrje: Vitamina D luan një rol të rëndësishëm tek fëmijët në mineralizimin e indeve të forta të trupit siç është skeleti dhe dhëmbët. Zhvillimi i dhëmbëve primarë ndodh gradualisht gjatë shtatëzanisë së nënës. Në lindje, të gjithë dhëmbët primarë janë akoma në zhvillim dhe pjesërisht të kalçifikuar. Paralindjes nivelet e vitaminës D mendohet të jenë të rëndësishme për zhvillimin dentar. Molari i parë i përhershëm (një ndër dhëmbët kyç në kavitetin oral)

fillon kalçifikimin në javën e 32-të të shtatëzanisë.

Qëllimi: Të tregohet rëndësia që ka administrimi i hershëm i vitaminës D (gjatë periudhës së shtatëzanisë së nënës) në kalçifikim dentar.

Metodat: Ky është një studim koherent i cili përfshin në total 20 fëmijë të moshës 1-2 vjeçare, të cilët janë egzaminuar për nivelet 25(OH)D. Këta fëmijë janë ndjekur dhe egzaminuar përsëri për karies dhe hipoplazi të zmaltit në moshën 7 vjeçare. Niveli i kariesit në dhëmbët e përhershëm është aksesuar duke përdorur indeksin DMFT.

Rezultatet: Niveli kryesor i 25(OH)D në moshën 1-2 vjeçare ishte më i vogël se 10 ng/ml. Në egzaminimin e dytë në moshën 7 vjeçare, të gjithë fëmijët rezultuan me MIH(hipomineralizim) të incizivëve dhe molarëve të parë të përhershëm.

Konkluzione: Është e kështillueshme kontrollimi i vitaminës D gjatë shtatëzanisë dhe i fëmijëve në mënyrë periodike më qëllim që të mbahet nën kontroll niveli i saj.

Fjalë kyç: Vitamina D, zhvillimi i fëmijëve.

MATERIALET E MASËS TË PËRDORURA NË PUNIMET PROTETIKE FIKSE DHE TË LËVIZSHME

Elisa Cesaj[1], Prof. Asc. Edit Xhajanka [2]
Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Masë – quhet negativi i indeve të buta dhe të forta të gojës. Ky negativ merret me ndihmën e materialeve të posaçme. Sipas masës, pra negativit, nxirret pozitivi ose modeli, mbi të cilin përgatitet punimi protetik. Masa merret me anë të lugëve të posaçme të cilat mund të jenë të parafabrikuara ose lugë individuale.

Klasifikimi i materialeve: Nga ana mekanike ndahen në: Materiale elastike, (përdoren në pacientë me defekte dentare te pjesshme apo të plota).Materialet jo elastike (rigide) , përdoren vetëm në mungese të plotë dhembësh.Sipas mekanizmit të forcimit :Materiale të forcuara kimikisht dhe materiale të forcuara fizikisht .Materialet për masën primare,(anatomike).Materiale për masën funksionale (sekondare).

Qëllimi i studimit: të përcaktojmë saktë fushën dhe indikacionet e përdorimit të secilit material , sipas vecorive të materialeve të masës, t`i përdorim ato në klinikë, në konstruktimin e punimeve të ndryshme protetike ,të përcaktojmë precizionin e këtyre materialeve, lidhur me saktësinë dhe suksesin e vetë punimit.

Materiali dhe metoda: Gjate 1 viti , në Klinikën Universitare ALDENT u përzgjodhën për protezim 5 pacientë me punime fikse dhe 8 pacientë me proteza të lëvizshme; nga këto 5 proteza parciale dhe 3 proteza totale. Në urat fikse dhe koronat përdorëm silikonet e kondensimit dhe të adicionit (Zeta plus dhe oranëash, si dhe Elite HD) . Masën funksionale e morëm me Elitë HD, light. Në protezat totale , për masën funksionale përdorëm repinën, pastë oksid Zink-Eugenoli. Në rregullimin funksional përdorëm kerr, për metodën seksionale dhe silikon adicioni ne bordazhin global.

Konkluzione : Materialet e masës janë pjesë e rëndësishme e protetikës stomatologjike. Gjatë përdorimit të tyre në pacientët e protezuar gjatë këtij studimi modest arritëm në konkluzion se : Saktësia dhe vetitë e materialeve të masës lidhen direkt me precizionin e punimit protetik. Në protetikën fikse përdoren silikonet A dhe C. Në protetikën e lëvizshme përdoren alginatët. Në nofullat pa dhëmbë për masën funksionale përdoret Pasta e ZnO-Eugenolit.

Fjalë kyç: protetika fikse, materialet e masës , alginate.

KONSIDERATA DIAGNOSTIKE NË PLANIFIKIMIN E TRAJTIMIT TË KAFSHIMIT TË THELLË.

Elona Kongo[1], Giovanni Manes Gravina[1].
[1]*Departamenti i Stomatologjisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University*

Abstrakt

Kafshimi i thellë është një nga shenjat më të hershme të malokluzionit. Rritja e mbulimit incisal është manifestimi klinik i diskrepancave dentare dhe skeletike. Kombinimi i faktorëve dentare dhe atyre skeletike vështirëson trajtimin dhe stabilitetin afatgjatë.
Korrigjimi i kafshimit të thellë është një nga objektivat e trajtimit ortodontik. Plani i trajtimit kushtëzohet nga rëndesa dhe mosha e pacientit. Në dispozicion të ortodontëve për trajtimin e kafshimit të thellë ka shumë mënyra trajtimi me avantazhet dhe disavantazhet përkatëse. Përzgjedhja e protokollit bazuar në veçoritë individuale të çdo pacienti kërkon diagnozë të saktë, dhe aplikimin korrekt të mekanikave ortodontike.

Fjalë kyç: kafshim i thellë, malokluzion, diskrepanca.

TRAJTIMI I KOMBINUAR I ANOMALISË SË KLASËS II/1 ME KAFSHIM TË THELLË TRAUMATIK TE DY PACIENTË ADOLESHENTË

Dr. Emire Çitaku, Dr. Ekrem Çitaku, Dr. Burak Shabani, Dr. Minire Çitaku, Dr. Teuta Pustina, Dr. Shkurte Çitaku

Abstrakt

Qëllimi: Qëllimi i këtij prezantimi është të përshkruajë rezultatet e trajtimit të kombinuar të anomalisë të klasës II/1 me kafshim të thellë traumatik.

Materialet dhe metoda: Pacientja: Femër 18 vjeç, ka kërkuar korrigjimin e dhëmbëve te sipërm te përparmë te shtyrë përpara.
Ekzaminimi ekstra oral zbuloi një fytyrë asimetrike, profil konveks, buzë të sipërme të shkurtër, buzë inkopetente dhe frymëmarrje me gojë.
Ekzaminimi intraoral zbuloi denticion të përhershëm, incivë maksilarë të protruduar, over jet 15 mm, kafshim i thellë traumatik anterior 7 mm.
Pacientja: Femër 15 vjeçare erdhi në klinikën tonë me ankesën se buzëqeshja e saj është joestetike.

Ekzaminimi ekstra oral: buzë e sipërme e shkurtër, buzë in kompetente, profil konveks dhe frymëmarrje përmes gojës.
Ekzaminimi intraoral: denticion i përhershëm, incizivë maksilarë të protruduar, over jet 10 mm, kafshim i thellë anterior 6 mm.

Trajtimi: Te të dy pacientet kemi bërë nxjerrjen e dhëmbëve.
Aplikuam aparate aktive mobile dhe aparate fikse.
Në fazën përfundimtare aplikuam aparatet për retencion.

Rezultatet: Të dyja pacientet u trajtuan në mënyrë aktive gjatë dy viteve. Si pasoje e një trajtimi adekuat te pacientja N.N. 18 vjeç u arritën këto rezultate: over-jet i reduktuar nga 15 mm në 2 mm, over bite 3 mm.
Kurse te pacientja N.N. 15 vjeç: over jet i reduktuar nga 10 mm në 3 mm, over bite 2 mm. Pas korrigjimit të anomalisë të klasës II/1 buzët e pacientit janë kompetente dhe frymëmarrja është me hundë.

Konkluzionet: Anomalia e klasës II/1 me kafshim të thellë traumatik mund të jetë komplekse për t'u korrigjuar dhe për t'u mbajtur nëse nuk trajtohet siç duhet dhe në kohën e duhur.

Fjalët kyç: anomali, adoleshentë, dhëmbë.

PROTEZA TOTALE E ARDHSHME DHE PËRGATITJA NËPËRMJET PLLAKAVE BAZALE

Dr. Endrit Paparisto, Dr. Alketa Qafmolla, Neada Hysenaj, Tedi Vercani
Klinika Paparisto,
Fakulteti i Mjekësisë Dentare

Abstrakt

Hyrje: Ka mënyra të ndryshme të përgatitjes së protezave të plota dhe saktësia e sipërfaqes mukozale përcakton qëndrueshmërinë e protezës dhe suksesin e saj.

Qëllimi*:* Paraqitja e një metode të ndryshme nga metoda tradicionale, ku fillimisht krijohet baza definitive e protezës dhe më pas, në këtë bazë të saktë dhe të pandryshuar në formë dhe në funksion, mjeku do të bëjë regjistrimet për okluzionin qendror, provën estetike , fonetikën etj.

Materiali dhe metoda: Në 25 pacientë me atrofi të shprehur (të gradës së tretë), aplikuam një metodë të ndryshme, ku fillimisht përgatitëm bazën e protezave me rezinë termopolimerizuese. Më pas , me këto baza definitive regjistrohet okluzioni qendror, rreshtohen dhëmbët artificialë dhe bëhet prova me dhëmbë. Në këto faza ekziston mundësia e kontrollit dhe vlerësimit të qëndrueshmërisë së protezës, akoma pa e përfunduar plotësisht atë dhe duke patur mundësi korigjimesh të ndryshme, nëse këto janë të nevojshme. Pastaj vazhdohet me zëvendësimin me rezinë të dyllit që bashkon dhëmbët me pllakën. Rezultatet: Në pacientët e protezuar u vu re qëndrueshmëri e protezave, e verifikuar që në fazën e përcaktimit të OQ dhe provës me dhëmbë. U evituan deformimet e bazës së zakonshme dhe zhvendosjet e mundshme të saj gjatë përcaktimit të OQ dhe provës estetike. Gjithashtu, reduktohet ndjeshëm tkurrja e protezës gjatë polimerizimit tradicional.

Konkluzionet: Metoda e pllakave bazale paraqet më efikasitet në nofulla me atrofi të shprehur, ku deformimi dhe lëvizja e bazës së shabllonave jep pasaktësi të shprehura në okluzion dhe paratakime të shumta në protezën e përfunduar. Është mjeku që vendos përdorimin e metodës tradicionale apo të metodës së pllakave bazale gjatë përgatitjes së protezave totale.

Fjalë kyç : proteza totale, pllaka bazale , polimerizimi tradicional.

ETAPAT KRYESORE NË KRIJIMIN E DIAGNOZËS PERIODONTALE.

Eni Jani[1], Endrit Paparisto[1], Anis Thodhorjani[1], Dhimitër Jani[1], Eneida Prifti[1]
[1]*Fakulteti i Mjekësisë, Klinika Stomatologjike Universitare.*

Abstrakt

Periodontiti është sëmundje inflamatore që haset shpesh në popullatë. Gingiviti prek shumicën e popullatës, dhe periodontiti i avancuar vlerësohet se prek 5-15% të tërriturve. Zbulimi dhe diagnostikimi i këtyre sëmundjeve është një komponent thelbësisht irëndësishëm i kujdesit të shëndetit oral. Të gjithë pacientët duhet t'i nënshtrohen një vlerësimi periodik si pjesë e ekzaminimit rutinë oral. Ekzaminimi periodontal duke përdorur metoda të tilla si Ekzaminimi Periodontal Bazë / Indeksi Periodontal duhet të kryhet për të gjithë pacientët e rinj, dhe gjithashtu rregullisht si pjesë e kujdesit të vazhdueshëm të shëndetit oral. Nëse identifikohet periodontiti, kërkohet një vlerësim i plotë periodontal, i cili përfshin regjistrimin e të dhënave të plota të sondimit oral dhe gjakderdhjes, së bashku me vlerësimin e parametrave të tjerë përkatës si niveli i pllakës,përfshirja e furçës, recesioni dhe lëvizshmëria e dhëmbëve. Vlerësimi radiografik i nivelevetë kockave alveolare nxitet nga situata klinike dhe kërkohet për të vlerësuar shkatërrimin ekockave në pacientët me periodontit. Vlerësimi i rrezikut (si vlerësimi i statusit të diabetit dhe pirja e duhanit) dhe menaxhimi i rrezikut (siç është promovimi i ndërprerjes së duhanit) duhet të jenë një komponent qëndror i terapisë periodontale.
Si të ndërtojmë bazën e asaj që do jetë më vonë trajtimi klinik i një pacienti periodontal? Midis fazës të takimit të parë me pacientin dhe fillimit të trajtimit është e rëndësishme vendosja e duhur e diagnozës.
Ky prezantim do të zbërthej katër tema të rendësishme të cilat na vijnë në ndihmë në arritjen e diagnozës së duhur dhe në fillimin e një trajtimi të sukseshmën për pacientin që vuan nga sëmundja periodontale.
Do të flitet për: Klasifikimin e ri të sëmundjes periodontale Screening Periodontal Stadifikimin e Sëmundjes periodontale Gradimin e sëmundjes periodontale.
Ky prezantim jep udhëzime në lidhje me metodat dhe frekuencat e ekzaminimeve të përshtatshme klinike dhe radiografike për të vlerësuar statusin parodontal, për të mundësuar zbulimin dhe diagnostikimin e duhur të kushteve periodontale.

Fjalë kyç: screening periodontal, indeksi periodontal, ekzaminim.

TRAJTIMI I FRAKTURËS SË KOMPLIKUAR NË DHËMBËT ME APEKS TË PAFORMUAR (RAST KLINIK).

Dr. Shk. Enida Petro[1], Albina Kulla[1,2], Megi Terziu[1], Oliverta Hoxha[1], Laureta Vaja[1]
[1]*Fakulteti i Mjekësisë Dentare*

[2]*Klinika dentare dhe maxillo-faciale "KOKONA", Tiranë*

Abstrakt

Hyrje: Traumat e indeve të forta të dhëmbëve, veçanërisht në moshat pediatrike, përbëjnë një emergjencë klinike. Ato janë më të shpeshta në dhëmbët frontalë, sidomos ne rastet e fëmijëve me overjet anterior. Trajtimi i hershëm, jo vetëm parandalon ndërlikime të mëtejshmë, por rivendos funksionin, estetikën dhe siguron një prognozë të mirë. Mungesa e trajtimit në frakturat e komplikuara me ekspozim të pulpës, sjell zhvillimin e patologjive periapikale që mund të cojnë deri ne humbje të dhëmbit.

Qëllimi: Përshkrimi i rastit klinik me frakturë të komplikuar të smaltit dhe dentinës, me ekspozim të pulpës në dhëmbin 21, me apeks të paformuar, i komplikuar në abces periapikal.

Metodologjia: Diagnistikimi në bazë të anamnezës, ekzaminimit klinik dhe radiologjik. Përshkrimi i recetës me antibiotik dhe ndjekja e disa seancave për përpunimin kimik dhe mekanik të kanalit si dhe aplikimin e hidroksidit të kalciumit. Gjatë rikontrolleve të vazhdueshme u vlerësuan shenjat klinike dhe radiologjike.

Konkluzionet: Frakturat e komplikuara mund të çojnë në patologji të ndryshme periapikale, evitimi i të cilave bëhet me anë të trajtimit të hershëm të tyre. Seancat e shpeshta dhe kontrolli i vazhdueshëm janë të domosdoshme për trajtimin e këtyre kompikacioneve. Prania e një overjeti të rritur paraqet një situatë predispozuese për frakturat dentare në dhëmbët frontalë, prandaj rekomandohet trajtimi i hershëm i këtij malokluzioni.

Fjalë kyç: fraktura, apeks, hidroksid kalciumi.

PULPEKTOMIA VITALE NË DHËMBËT FRONTALË NË FËMIJË

Dr. Shk. Enida Petro[1], Loreta Gjoni[1], Miki Geci [1], Teufik Mula [1], Çlirim Mata[1]
Fakulteti i Mjekësisë Dentare

Abstrakt

Pulpa e dhëmbit është një ind lidhor me funksion mbrojtës, ushqyes, formues dhe rigjenerues. Ekziston një gamë e gjërë e ndërhyrjeve terapeutike në pulpën e dhëmbëve të përhershëm në fëmijë në varësi dhe të stadit të formimit të rrënjëve. Aspekti më i vështirë dhe i rëndësishëm i terapisë pulpare është përcaktimi i gjëndjes shëndetësore të pulpës ose stadit të inflamacionit të saj, të cilat përcaktojnë planin e trajtimit. Në të gjitha rastet e trajtimit të dhëmbëve të përhershëm tek fëmijët, synimi është ruajtja e vitalitetit të pulpës duke krijuar kushte për zhvillimin e mëtejshëm të rrënjës dhe ruajtjes së integritetit të kompleksit pulpë-dentinë. Ruajtja e vitalitetit të pulpës arrihet me anë të disa metove të trajtimit që perfshijnë mbulimin direkt, mbulimin indirekt dhe pulpotominë vitale. Në rastet kur këto metoda dështojnë ose janë të kundërindikuara duhet të kryhen proçedurat e trajtimit endodontik, një ndër të cilat është pulpektomia vitale që nënkupton heqjen e pulpës së dhëmbit me një seancë. Në trajtimin e dhëmbëve të përhershëm monorradikular në fëmijë, pulpektomia vitale është një metodë e përzgjedhur trajtimi kur formimi i apeksit të rrënjës ka përfunduar. Përzgjedhja e kësaj metode varet sidomos nga bashkëpunimi me fëmijën si kusht i domosdoshëm për nje trajtim të suksesshëm.

Fjalët kyç: pulpektomia, dhëmbët frontalë, dentinë.

AVANTAZHET E PËRDORIMIT TË GLASSIONOMER CEMENTEVE ME REZINË TË MODIFIKUAR NË DENTISTRINË PEDIATRIKE

Dr. Shk. Enida Petro[1], Sagita Doda[1], Kristi Licaj[1], Klejda Seiti[1], Erni Prifti[1]
[1]Fakulteti i Mjekësisë Dentare

Abstrakt

Glassionomer cementet (GIC) gjejnë një sërë përdorimesh në praktikën stomatologjike, por në veçanti në dentistrinë pediatrike. Kjo për shkak të avantazheve të shumta që kanë treguar në krahasim me materialet e tjera restorative kur përdoren në moshat pediatrike. Glassionomer cementet janë zbuluar fillimisht në vitin 1972 nga Wilson & Kent. Që prej asaj kohe është punuar vazhdimisht për të përmirësuar vetitë e tyre dhe për të sjellë në treg materiale sa më të favorshme në përdorim. Këto materiale mund të përdoren jo vetëm si shtresa vecuese dhe izoluese, por edhe si cemente adezive, silante dhe materiale restorative. Një moment kyç në historinë e tyre ishte viti 1990, kur u prezantuan për herë të parë glassionomer cementet me rezinë të modifikuar (RMGIC). Glassionomerëve konvencionalë iu shtua në përbërje rezina fotopolimerizuese. Këto materiale mund të konsiderohen hibride sepse kanë ruajtur vetitë pozitive të glassionomerëve klasike si adezioni me strukturën dhëmbore, çlirimi i joneve të fluorit, metoda bulk-fill e restaurimit, sensitiviteti i ulët ndaj teknikës dhe lagështisë, biokompatibiliteti, efekti kariostatik dhe koha e shkurtër e punës. Përvec këtyre vetive të përbashkëta me glassionomerët konvencionalë, RMGIC kanë treguar shumë avantazhe kundrejt tyre si përshtatshmeria me ngjyrën natyrale të dhëmbit, fortësimi i menjëhershëm nën veprimin e dritës, rezistenca mekanike, adaptimi marginal më i mire si dhe lustrimi brenda së njëjtës seacë. Kjo bën që këto materiale të jenë një zgjedhje e preferuar gjatë punës me fëmijë, sidomos në rastet me risk karioz të lartë ose në fëmijët jo bashkëpunues.

Fjalët kyç: glassionomer cementet, dentistri, pediatri.

VLERËSIMI I BRUKSIZMIT NË MOSHAT E REJA

Dr. Shk. Enida Petro[1], Salushe Çela[1], Aurora Bylykbashi[1]
[1]Fakulteti i Mjekësisë Dentare

Abstrakt

Bruksizmi është një fenomen shumë i përhapur në moshat e reja, i cili karakterizohet me kërcitje, shtrëngim të pavullnetshëm të dhëmbëve dhe në shumicën e rasteve personat që janë të prekur nuk janë në dijeni. Dukuria e bruksizmit kohët e fundit paraqet një frekuencë të lartë në këto mosha dhe kjo shoqërohet me disa faktorët si droga, alkooli, ankthi e stresi. Shumica e pacientëve të rinj që vuajnë nga bruksizmi nuk marin masa parandaluese për këtë problem. Pasojat e bruksizmit me kalimin e kohës bëhen shumë shqetësuese për pacientin, prandaj sa më herët të zbulohet aq më i lehtë është menaxhimi i tij. Synimi i këtij punimi është të vlerësojë prezencën e bruksizmit në moshat e reja, të evidentojë praninë e simptomave si dhe të përcaktojë faktorët e riskut që lidhen me këtë fenomen. Grumbullimi i të dhënave në këtë studim është realizuar nëpërmjet një pyetësori për një grup studentësh, të

cilët kanë pranuar të pergjigjen duke ruajtur anonimatin e tyre. Pyetesori përmban pyetje rreth vetëdijësimit nëse ata janë të prekur nga bruksizmi apo informimit nga personat e afërt, simptomave të pranishme, veseve dhe problemeve shëndetësore shoqëruese si dhe përdorimit të metodave që mund të ndihmojnë në parandalimin apo trajtimin e tij.

Fjalët kyç: bruksizmi, moshat e reja, simptomat.

SHKAQET E EKSTRAKSIONEVE NË KLINIKAT DENTARE DHE NDËRLIKIMET KRYESORE GJATË DHE PAS NDËRHYRJES

Prof.Ass.Dr. Erda Qorri, Gloria Demnika

Abstrakt

Qëllimi: Ekstraksionet janë një fenomen i zakonshëm në praktikën e përditshme stomatologjike. Ato kryhen për shkaqe nga më të ndryshmet dhe prekin të gjithë grupdhëmbët, si ata të qumështit ashtu edhe ata të përhershëm. Duke qenë se ekstraksioni është një ndërhyrje kirurgjikale, ai mund të shoqërohet edhe me një numër të madh komplikacionesh.

Materiale dhe metoda: Në studimin tonë u mblodhën të dhëna nga rreth 100 klinika dentare (në Tiranë dhe në rrethe) të cilat përfshinin shërbimin e kirurgjisë. Ne nxorrëm përfundime mbi numrin e dhëmbëve të ekstraktuar, arsyet që çonin në këto ekstraksione dhe komplikacionet më të shpeshta gjatë dhe pas procedurës kirurgjikale.

Rezultate dhe diskutime: Rezultatet e përftuara në shpërndarjen sipas llojit të shërbimit të marrë dhe gjinisë treguan që gjinia femër është më frekuente në të gjitha tipet e shërbimeve orale. Gjithashtu rezultatet e testit Chi-Square treguan se ekzistonte një marredhenie e rëndësishme
statistikore midis llojit të shërbimit dhe grup-moshës (P= 0.030). Për sa i përket shërbimit të kirurgjisë, frekuencë më te lartë me 77.90% kanë zonat urbane dhe % 22.10% zonat rurale. Kjo falë dhe faktiti se numri më i madh i pacinetëve të marrë në studim i përkiste mjedisit urban. Shkaqet e ekstrasioneve janë kryesusht destruksione koronare të parekuperueshme, granulom ose kist radikular, probleme periodontale etj.

Fjalët kyç: ekstraksione, ndërlikime, kirurgji.

QASJE MULTIDISIPLINARE NË TRAJTIMIN E DHËMBËVE TË IMPAKTUAR.

Erda Qorri[1], Claudio Taglia[1], Giovani Manes Gravina[1], Isida Marko[1], Erion Ostreni[2], Merilda Tarja[1], Rezart Qorri[3], Nertsa Cunoti[4]

[1]Faculty of medical sciences, department of dentistry, school of specialization, Albanian University.
[2]Dipartimento scienze della vita e del ambiente, University of l'Aquila, Italy.
[3]Heinrich-Braun-Hospital, Zwickau, Germany.
[4]University Klinik, Leipzig, Germany.

Abstrakt

Hyrje: Menaxhimi i dhëmbëve të impaktuar është i rëndësishëm për sa i përket estetikës dhe funksionit. Klinicistët duhet të formulojnë plane trajtimi që janë në interesin më të mirë të pacientit dhe ata duhet të kenë njohuri për shumëllojshmërinë e opsioneve të trajtimit. Në këtë studim është paraqitur një pasqyrë e incidencës dhe pasojave, si dhe e konsideratave kirurgjikale, periodontale dhe ortodontike në menaxhimin e dhëmbëve të impaktuar.

Qëllimi i këtij studimi është të nxjerrë në pah rëndësinë e bashkëpunimit ndërdisiplinor kirurgjikal dhe ortodontik për suksesin e trajtimit klinik si dhe përcaktimi i indikacioneve të qasjes ndaj tyre.

Materiale dhe metoda: Studimi bazohet në një grup pacientësh 50 raste klinike 164 dhëmbët të retenuar, nga të cilët 45.1% ndodhen në mandibul dhe 54.9% në maksilë.Pacientët janë paraqitur në Klinikën Universitare "Çerçiz Mingomataj" në Albanian University gjatë periudhës 2013-2018.

Rezultate: Për pacientët të cilët i nënshtrohen trajtimeve ortodontike, vendimi për heqjen ose jo të dhëmbëve të retenuar, molarëve të tretë mund të shtyhet deri në përfundimin e trajtimit ortodontik, me përjashtim të situatave në të cilat heqja e një molari të tretë është e detyrueshme që nga fillimi i trajtimit. Një vlerësim pasues i pozicionit të molarit të tretë gjatë trajtimit mund të kontribuojë në një prognozë më realiste të vendimit të këtyre dhëmbëve. Nëse trajtimi ortodontik përfundon përpara se të arrihet pozicionimi përfundimtar i këtyre dhëmbëve, pacienti duhet të rivlerësohet me ekzaminim klinik dhe radiografi periodike.

Fjalët kyç: dhëmbë të retinuar, trajtim kirurgjikal, trajtim ndërdisiplinor, trajtim ortodontik.

SINUSITI MAKSILAR ODONTOGJEN.

Eriola Lleshi[1], Dr.Shk.Msc.Nineta Fino[2]
[1]*Student: Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri*
[2]*Pedagog: Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri*

Abstrakt

Hyrja: Sinusiti maksilar odontogjen (OMS) është një gjendje inflamatore e sinuseve maksilare që vjen si rezultat i patologjive dentare, më së shpeshti pasojë e procedurave të mëparshme dentoalveolare, infeksioneve të dhëmbëve ose traumave dentare.

Qëllimi: Të shqyrtojmë çfarë është sinusiti maksilar; cilat janë shkaqet odontogjenike të tij; klasifikimi; mënyrat e diagnostikimit, trajtimi si dhe prevenimi.

Materialet dhe metodologjia: Rishikimi i literaturës mbështetur në studime dhe tekste akademike mbi sinusitin maksilar odontogjen.

Konkluzionet: Ky punim përshkruan sinusitin maksilar odontogjen. Ndër shkaqet odontogjenike mund te përmendim abceset periapikale, periodontiti kronic apikal, ekstraksione dentare etj. Mund të jetë akut ose kronik, ku secila formë shoqërohet me simptomat, mënyrat e diagnostikimit dhe trajtimin përkatës. OMS zakonisht manifestohet unilateralisht dhe në ekzaminimin oral shikojmë shkakun. Simptoma kryesore e sinuzitit është dhimbja kryesisht pasdite, që fillon te mollëzat dhe përfshin gjysmën e kokës e

manifestuar në dhëmbët maksilar të kësaj ane. Trajtimi është sipas fazës dhe mund të jetë farmakologjik ose farmakologjik dhe kirurgjikal, por e rëndësishmë është që në çdo rast të eleminohet shkaku odontogjen. Patologjitë e sinusit maksilar, shpesh në praktikë, kërkojnë vemendje dhe ekzaminime të sakta për të përcaktuar diagnozën dhe trajtimin korrekt të tyre. Në disa raste kërkohet një konsultë e përbashkët ndërmjet shumë specialiteteve: kirurgut maksilo-facial, otorinolaringologut, imazheristit, neurokirurgut etj.

Fjalët kyçe: sinusiti maksilar, klasifikimi, faktorët etiologjik odontogjen, diagnoza, trajtimi etj.

ESTETIKA NË ZGJEDHJEN E DHËMBËVE FRONTALE NË PROTEZAT E LËVIZSHME

Dr. Eris Kotorri[1], Prof. Asc. Edit Xhajanka[1], Dr. Ejonis Ibrahimi[1]
[1]Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Departamenti i Protetikës

Abstrakt

Hyrje: Proçesi i zgjedhjes së dhëmbëve artificialë bëhet duke ruajtur individualitetin dhe veçoritë estetike të çdo personi. Roli estetik që luajnë në protezë dhëmbët frontalë është maksimal meqë janë përcaktues të estetikës së ardhshme të protezës së lëvizshme.

***Qëllimi*:** Zgjedhja e dhëmbëve sa më të përshtatshëm frontalë, duke përdorur sa më shumë metoda bashkëkohore që përshtasin parametrat e dhëmbëve me fytyrën dhe përmasat e saj, me formën dhe madhësinë e nofullave, linja të profilit të pacientit, etj.

Materiali dhe metoda: Në repartin e protetikës u protezuan 150 pacientë me proteza totale dhe subtotale. Për zgjedhjen dhëmbëve frontalë u bazuam në teori të shumë autorëve duke krijuar individualitet të protezës. Gjatë konstruktimit të protezave u përdorën dhëmbët Ivoclar, Major dhe Vita.

Rezultatet: Forma më e përzgjedhur në studim ishte forma ovale dhe më pak e përdorur forma katrore. Në 38% të pacientëve u përdorën dhëmbë me formë trekëndëshi, në 41% të pacientëve u përshtatën dhëmbët me formë ovale dhe në 21% formë katrore. Përmasat u përcaktuan sipas formulave të Pound me anë të indikatorit facial.

Konkluzionet: Zgjedhja e dhëmbëve është proçes bashkëpunimi ndërmjet mjekut, laborantit dhe pacientit. Synohet në përshtatjen e modulit të dhëmbëve frontalë me fytyrën dhe parametra individual të pacientëve sipas kritereve estetike.

Fjalët kyç: estetika, dhëmbët frontal, proteza.

ETIOLOGJIA, DIAGNOZA DHE TRAJTIMI I KANINEVE DHE PREMOLARËVE TË IMPAKTUAR

Dr. Eriselda Simoni[1], As Prof. Merita Bardhoshi[2], Dr. Anis Thodhorjani[1], Dr. Denis Kadaifciu[1], Dr. Renato Isufi[1]
[1]Klinika Stomatologjike Universitare, Tiranë
[2]Fakulteti i Mjekesise Dentare, Tiranë

Abstrakt

Një dhëmb quhet i erruptuar normalisht kur është zhvilluar gjysma ose tre të katërtat e gjatësisë së rrënjës. Dhëmb i përmbajtur quhet dhëmbi që vazhdon të mbetet në kockë edhe pasi ka kaluar koha e erruptimit. Dhëmbët e impaktuar më tepër janë në palatum. Zhvillimi i plotë i premolarëve dhe veçanërisht i kanineve luan një rol të rëndësishëm në formimin e duhur të harkut dentar duke luajtur rol thelbësor në funksion dhe estetikë. Në më të shumtën e rasteve dhëmbët e impaktuar zbulohen rastësisht nga dentistët e përgjithshëm ose ortodontët kur pacienti vjen në kabinetin dentar për një kontroll rutinë. Nëse dimë zhvillimin, incidencën, dhe etiologjinë e kanineve dhe premolarëve të impaktuar mund të vendosim një diagnozë të saktë dhe një plan korrekt trajtimi, veçanërisht në përzgjedhjen e ndërhyrjes së duhur kirurgjikale. Trajtimi kërkon një bashkëveprim multidisiplinar ndërmjet ortodontit, kirurgut dhe disa herë edhe ndërmjet periodontologut dhe protezistit. Këtu prezantohet një përmbledhje e prevalencës, etiologjisë, diagnozës, trajtimit dhe komplikacioneve të lidhura me kaninet dhe premolarët e impaktuar. Një seri rastesh klinike janë përdorur për të ilustruar forma të caktuara trajtimi.

Fjalët kyç: etiologjia, diagnoza, kaninet, premolarë.

EKSTRAKSIONI I DHËMBËVE NË PERSONA DIABETIKË DHE HIPERTENSIVË

Erisilda Biçaku[1], Dr. Nineta Saraçi[2]
[1]Student, Fakulteti i mjekësisë dentare, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri
[2]Pedagog, Fakulteti i mjekësisë dentare, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ekstraksioni i dhëmbëve është një proçedurë invazive, që konsiston në nxjerrjen e dhëmbit nga alveola. Kjo proçedurë krijon një plagë të hapur në ambientin septik të gojës. Marrja e një anmneze dhe kryerja e një egzaminimi korrekt, luajnë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e proçedurës. Kujdes të veçantë duhet pasur për përcaktimin e indikacioneve dhe kundërindikacioneve për ekstraksion. Diabeti Mellitus dhe Hipertensioni janë patologji kronike që përbejnë kundërindikacion relativ për ekstraksion dentar.

Diabeti Mellitus është një patologji kronike endokrine, që shoqërohet me nivele të larta të glukozës në gjak dhe rrjedhimisht dëmtime indore, ulje të përgjigjes imunitare dhe vonesë në shërimin e plagëve si pasojë e kompromentimit të aftësive rigjeneruese të organizmit.

Hipertensioni, një sëmundje kronike që karakterizohet nga vlera të presionit arterial sistolik më të madh se 140mmHg dhe të presionit diastolik më të madh se 90mmHg. Ky presion i rritur në lumenin e enëve të gjakut shkakton ndryshime morfologjike në vazat e kalibrit të madh, por gjithashtu edhe në ato më të vogla. Problematikat që mund të shfaqen gjatë një ekstraksioni dentar në pacientë hipertensivë apo diabetikë të pa stabilizuar, janë të shumta dhe duhen marrë parasysh nga mjeku stomatolog.

Pra mjeku stomatolog, duhet të vlerësojë mirë këto patologji në pacientë, mjekimin që ata marrin dhe në raste mund të bëhet edhe konsultë me mjekët specialistë përkatës.

Fjalët kyç: kirurgji orale, diabeti mellitus, hipertension, kujdesi i stomatologut.

OPTIMIZIMI I ESTETIKËS DHE PARASHIKUESHMËRISË SË IMPLANTEVE POSTEKSTRAKTIVE.

Erta Xhanari

Abstrakt

Edhe pse kemi mbi 20 vjet eksperiencë në implantologjinë moderne, maksila anteriore mbetet gjithmonë një sfidë më vete për kirurgun dhe protezistin.
Mundesitë e trajtimit të mungesave në zonën anteriore variojnë nga proteza parciale e lëvizshme, maryland apo protezë fikse. Megjithatë rritja e kujdesit të pacientit për shëndetin oral e mbi të gjitha ndërgjegjësimi për vlerën që ka pjesa estetike, kanë bërë që të rriten kërkesat, ndaj gjithnjë e më shumë implantologjia po behet zgjedhja parësore e mënyrës së trajtimit.
Për të arritur një rezultat estetik të kënaqshëm për ne dhe pacientin, vendosja e implantit në zonë estetike kërkon një njohje të mirë të anatomisë, biologjisë, aftësi kirugjikale dhe principe protetike thelbësore.
Trajtimi i menjëhershëm me implant eviton reduktimin e indeve të forta dhe të buta, duke ofruar nje stabilitet më të madh të punimit implantar. Gjithashtu një implant i menjëhershëm i shoqëruar me graft kockor mund të jetë një alternativë e mirë për të ruajtur arkitekturën kockore.

Fjalë kyç: impant, estetikë, graft kockor.

ARSYET E PËRDORIMIT DHE MOSPËRDORIMIT TË SHËRBIMEVE DENTARE TEK ADOLESHENTËT

EVA HABAZAJ(Dhima), Matilda Shena, Xhanina Gavazi, Anis Thodhorjani
Klinika Stomatologjike Universitare, Fakulteti i Mjekësisë.

Abstrakt

Qellimi: Zbulimi i arsyes së përdorimit dhe mospërdorimit të shërbimeve dentare tek adoleshentët e gjimnazit "Qemal Stafa" në Tiranë.

Metoda: Në studim u përfshinë 200 nxënës të gjimnazit "Qemal Stafa" në Tiranë të moshës 15-18 vjeç. Mbledhja e të dhënave u krye në bazë të pyetësorëve dhe ekzaminimeve të drejtpërdrejta me gojë.

Rezultatet: Studimi zbuloi se 40% e adoleshentëve kishin të paktën 2 vjet pa shkuar në një klinikë dentare dhe arsyeja kryesore pse ata kishin shkuar në një klinikë dentare (55.5%) ishte dhimbja. Shumica (45%)iu referuan se kishin pasur një ekstraksion dentar në takimet e kaluara. Arsyeja kryesore që ata dhanë për të mos shkuar te dentisti ishte mungesa e një problemi ose problemi nuk kishte qenë aq i madh sa të kërkonte trajtim dentar (45%).

Konkluzionet: Shumica e adoleshentëve mund të konsiderohen si pacientë të orientuar drejt trajtimeve dentare sesa drejt trajtimeve parandaluese.

Fjalet Kyç*:* Trajtime dentare, adoleshentë, klinikë dentare, gjimnaz, frikë.

TRAJTIMI I RASTEVE ME ATROFI EKSTREME NËPËRMJET RIBAZIMEVE ME MATERIALE ELASTIKE

Fabjola Gjini[1], Prof. Asc. Edit Xhajanka[2]
[1]Studente, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.
[2]Prof. Asc në Fakultetin e Mjekësisë Dentare, Departamenti i Ortopedisë Stomatologjike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Abstrakt

Hyrja: Në atrofi ekstreme mukoza nën protezë redukton trashësinë duke humbur efektin amortizues. Forcat përtypëse transmetohen direkt në indet nën mukozë duke rritur ngarkesën funksionale të tyre. Si pasojë e shtypjes së mukozës së hollë joreziliente (midis protezës dhe kockës) mund të shkaktohen lezione, irritime, diskomfort dhe dhimbje difuze. Kjo trashësi dhe viskozitet i humbur i mukozës kompensohet duke përdorur materiale ribazimi elastike, rezina ose silikone elastike.

Qëllimi i studimit: Qëllimi i studimit është paraqitja e një metode që konsiston në veshjen e sipërfaqes mukozale të protezës me një material elastik për të amortizuar presionin gjatë përtypjes, si dhe përcaktimin e avantazheve dhe gamës së përdorimit të materialeve reziliente.

Materiali dhe metoda: Në 50 pacientë të grupmoshës së tretë (70-90 vjeç), me atrofi ekstreme dhe diskomfort nga proteza totale janë kryer ribazime direkte (33 pacientë) dhe ribazime indirekte (17 pacientë) me materiale të ndryshme elastike. Në 37 raste janë kryer në proteza në nofullën e poshtme dhe në 13 raste në proteza në nofullën e sipërme. Në 22 raste materialet elastike janë përdorur për lehtësim ortopedik të formacioneve të shprehura anatomike si (torus palatinal ose mandibular), ndërsa në 26 raste për lehtësim ortopedik të ekzostozave. Materialet që u përdorën janë: rezina akrilike elastike, silikone elastike adicioni dhe kondicionues indorë.

Rezultatet: Vlerësimi i rezultateve është bërë duke ndjekur pacientët direkt pas vendosjes së protezave të ribazuara, si dhe në periudhën 3-12 mujore deri në 6 vite. Në 36 pacientë (72%) u vu re rritje e qëndrueshmërisë së protezave totale (12 pacientë me protezë të sipërme dhe 24 pacientë me protezë të poshtme). Në 42 pacientë (84%) u vu re ulje e dekubituseve dhe lezioneve të mukozës. Në 47 pacientë (92.5%) u vu re rritje e komfortit gjatë përdorimit të protezës. Gjatë kontrolleve afatgjatë (6-7 vite), si pasojë e strukturës poroze, u vu re një shpërbërje graduale e materialit elastik. Kondicionuesit indorë 3 muaj, rezina elastike 6-12 muaj, silikonet elastike 6-7 vjet, pra silikonet ruajnë elasticitetin, ndërsa materialet e tjera e humbasin gradualisht atë.

Konkluzione: Përdorimi i materialeve reziliente ka rezultuar i suksesshëm në raste të ndryshme klinike, si në amortizimin e forcave ashtu edhe në rritjen e qëndrueshmërisë së protezës. Ribazimet me këto materiale rrisin komfortin e pacientit dhe kufizojnë ndërhyrjet kirurgjikale. Në ribazimet indirekte materiali paraqet veti fiziko-kimike më të larta krahasuar me ribazimet direkte.Vetitë elastike mund të humbasin me kalimin e kohës, prandaj duhet të ndërrohen periodikisht.

Fjalë kyçe: atrofi ekstreme, mukozë joreziliente, materiale elastike.

RUAJTJA E DHËMBËVE DHE IMPLANTEVE, QËLLIMI FINAL

Gurien Demiraqi, Eriola Noçka, Ervin Sulaj, Edlira Baruti

Abstrakt

Qëllimi: Pacientët janë çdo ditë më kërkues, duke përdorur zgjidhjet e implanteve për të zgjidhur problemet e tyre të edentulizmit dhe gjithashtu duke u përpjekur të ruajnë dhëmbët e tyre për sa më gjatë të jetë e mundur. Ata padyshim që do të preferonin t'i zgjidhnin ato në më pak seanca kirurgjikale të mundshme. Në shumicën e rasteve, indet e forta dhe të buta në të dy nofullat ndryshojnë ndjeshëm me plakjen dhe faktorë të ndryshëm. Shpesh, kërkohet vendosja e materialeve të ndryshme të graftit për të ruajtur vëllimin e indeve të forta dhe të buta dhe për të ruajtur kështu dhëmbët dhe implantet në kohë.

Metoda: Materiali ideal për graftimin e indeve të forta është osteopërçues, osteoinduktiv dhe osteogjen. Kjo është arsyeja pse grafiti autolog i kockave konsiderohet të jetë grafti referues "standard i artë". Kocka autologe ka nevojë për vende donatore për t'u marrë, gjë që zakonisht çon në nevojën për ndërhyrje shtesë, jo gjithmonë e preferuar për pacientin dhe e lehtë për mjekun dentar që trajton. Megjithatë, ekziston një biomaterial tjetër autolog, i cili ka të njëjtat karakteristika dhe konsistencë si kockat kortikale që shpesh i kemi në dispozicion dhe nuk i përdorim. Ky material është një dhëmb i ekstraktuar. Disa sisteme aktualisht lejojnë që një dhëmb i ekstraktuar të transformohet në grimca dhëmbësh të dekontaminuara dhe/ose të dekalcifikuara, por edhe blloqe, të gatshme për implantimin autolog. Unica lejon mbledhjen e kockave në alveolën e implantuar që po krijojmë ose në distancë. Gjeneratat e fundit të biomaterialeve lejojnë një furnizim të mirë të sasisë së kërkuar, e cila nuk mund të mblidhet në mënyrë autologe. Sistemet e grumbullimit të gjakut venoz si BCGF lejojnë formimin e membranave fibrinike për mbulimin e tyre dhe gjithashtu fibrinën e lëngshme që kompakton grimcat kockore në "Sticky Bone" dhe "Sticky Tooth". Teknologjitë më të fundit CBCT dhe CAD-CAM lejojnë një programim praktik shumë realist. Disqet më të fundit dhe teknologjitë Piezo lejojnë ndarjen dhe zgjerimin e saktë të kreshtës alveolare ose graftit kockor autolog. Kompaktorët dhe kondensatorët e kockave lejojnë ngjeshjen e kockave për të përmirësuar stabilitetin parësor. Bone Scrapers lejon mbledhjen e kockave kortikale me lehtësi. Së bashku, ato lejojnë që problemet pa dhëmbë të zgjidhen në një ndërhyrje kirurgjikale të vetme.

Rezultatet: Ne përdorëm sistemin autolog të bluarjes së dhëmbëve, Smart Dentine Grinder, BCGF, Safe Scraper, Unica, Piezo CAD-CAM, Cervico VPI, CBCT dhe biomateriale të ndryshme të gjeneratës së fundit, në procedura të ndryshme që përfshijnë përmirësimin e gjendjes së indeve të dhëmbëve dhe vendeve të implanteve, me disa teknika mini-invazive.

Konkluzione: Përdorimi i transplanteve autologe, kockash dhe dhëmbësh, kur është e mundur, paraqet një procedurë jo gjithmonë të lehtë për t'u aplikuar. Procedura për përgatitjen e transplantatit të indeve të buta dhe të forta nuk është gjithmonë e thjeshtë dhe shpesh kërkon kohë për të fituar dhe po ashtu edhe aftësitë teknike të nevojshme. Megjithatë, graftet e fituara shfaqin qëndrueshmëri dhe lehtësi në përdorim shumë të mirë. Gjithashtu, kostoja është e krahasueshme me materialet sintetike dhe heterologe të graftimit, duke pasur një kosto të mirë. Sistemet e menaxhimit të implanteve dhe ato që krijojnë një profil urgjence implanti të krahasueshëm me dhëmbët natyralë janë gjithashtu një pasuri e vlefshme në dorën tonë. Konceptet e reja në vendosjen e implanteve si ajo Umbrella e inkorporuar në të ndikojnë fuqishëm në suksesin e tyre afatgjatë.

Fjalët kyç: implante, CAD-CAM, ruajtja e dhëmbëve.

NEURALGJIA TRIGEMINALE, VECORITË E DIAGNOZËS DHE TË REJAT NË TRAJTIM

Ilirjana Xhediku[(1)], Dr. Nineta Saraçi[(2)]
[1]*Student, Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri*
[2]*Pedagog, Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri*

Abstrakt

Neuralgjia trigeminale është një patologji kronike. Karakterizohet nga një dhimbje e fortë, therëse ose shpuese me kohëzgjatje të shkurtër, që prek një nga degët e nervit trigeminal. Nervi Trigeminal është nerv ndjesor me vetëm një degë motorike. Është përgjegjës për ndjeshmërinë në fytyrë dhe në gojë.
Kjo patologji prek moshat mbi 40 vjeç me një predispozitë më të lartë te femrat krahasuar me meshkujt.
Për shumë vite shkaqet e neuralgjisë trigeminale kanë qenë të panjohura. Kohët e fundit ka marr rëndësi teoria e ngacmimit që i bën arteria cerebrale bërthamës së nervit. Klinikë të neuralgjisë mund të shfaqin dhe patologji të tjera si skleroza multiple, tumoret cerebrale ose në terren traumash kraniale.
Marrja e anamnezës dhe kryerja e ekzaminimit korrekt, luajnë një rol të rëndësishëm në vendosjen e diagnozës dhe diagnozës diferenciale. Diagnoza e saktë është thelbësore për një trajtim korrekt të patologjisë.

Fjalët kyç: nervi trigeminal, neuralgjia trigeminale, diagnozë diferenciale.

EFEKTET E KLORHEKSIDINËS TEK SHTRESA HIBRIDE

Dr.Shk.Med. Ilma Robo, Edona Hasanaj[1]
[1]*Studente viti 5 Albania University.*

Abstrakt

Hyrje: Shtresa hibride mënyra sesi ajo është e ndërtuar përbën interes kundrejt faktit sesi ajo ndikon tek jetëgjatësia klinike e një restaurimi me kompozit. Duke qenë strukturë "çelës" dhe me karakteristika tepër specifike, ka qenë gjithmonë në qendër të vëmendjes të botimeve të shumta me natyrë kërkimore.

Materialet dhe metodat: Studimi është i llojit review me qëllimin e mbledhjes së infomacioneve më të fundit rreth mënyrës sesi klorheksidina, ky solucion me karakter disinfektues aplikohet dhe sesi ai ndikon në performancën klinike të shtresës hibride. Kërkimi elektronik është kryer vetëm në faqen PubMed.

Rezultatet: Bazuar në përzgjedhjen e artikujve nga kombinimi i fjalëve çelës të përzgjedhura, u analizuan rreth 44 artikuj me përmbajtje informacione rreth studimeve in vitro apo in vivo të aplikimit të klorheksidinës.

Përfundime: Nga analizimi i informacionit të mbledhur del e qartë se mënyra e aplikimit të klorheksidinës ka protokoll pune të paracaktuar, në të cilin përfshihen edhe elementet se çfarë faze paraprirëse indikohet ose kundërindikohet në rastet e aplikimit të këtij solucioni. Ka të dhëna të mirë-dokumentuara që e klasifikojnë këtë solucion më avantazhsjellës se çdo inhibitor tjetër të metaloproteinazave. Ka qëndrime kontradiktore në kuadër të evoluimit edhe

të rezinave adhezive, por asnjëherë duke ulur rëndësinë e klorheksidinën si solucion që pengon degradimin e shtresës hibride.

Fjalët kyç: shtresa hibride, klorheksidinë, degradim.

SUTURAT PERIODONTALE, DISA TË DHËNA MBI KARAKTERISTIKAT SPECIFIKE SIPAS RASTEVE KLINIKE

Dr.Shk.Med. Ilma Robo, Glorja Demika[1]
[1]*Studente viti 5 Albania University.*

Abstrakt

Hyrje: Suturimi i indeve periodontale si procedurë gjithmonë paravlerësohet nga lloji i suturës së përdorur, bazuar mbi karakteristikën e sasisë së forcave të aplikuara kundrejt mureve lehtësisht të dëmueshëm të lembove periodontale.

Materiale dhe metoda: Studimi është i llojit review me qëllimin e mbledhjes së infomacioneve më të fundit rreth llojeve të ndryshme të suturave të aplikuara gjatë procedurave kirurgjikale periodontale. Kërkimi elektronik është kryer vetëm në faqen PubMed.

Rezultate: Bazuar në përzgjedhjen e artikujve nga kombinimi i fjalëve çelës të përzgjedhura, u analizuan informacionet e gjetura në website-in e paracaktuar, duke bërë paraqitje tabelare të karakteristikave të llojeve të ndryshme të suturave të indikuara në procedurat kirurgjikale periodontale.

Përfundime: Karakteristikat fizike të suturës ndikohen ndjeshëm edhe nga invazioni bakterial i florës orale që godet materialin e sutures, sidomos nëse përbërja e tij është me elemente organike që bihen "pre" e shpërbërjes bakteriale. Kohëzgjatja e ditëqëndrimit të materialit të suturës në kavitetin oral rrit kohëzgjatjen e invazionit bakterial dhe kolonizimit bakterial mbi këtë material, pavarësisht se sutura është e përbërë nga material natyral, apo nga material sintetik. Elementi tjetër që e zbukuron akoma më shumë tablonë, është edhe fakti që sutura është monofilamentoze apo e thurur, pasi kjo e fundit shton hapësirat tredimesionale për kolonizimin bakterial që nuk preket apo ndikohet nga pastrimi mekanik i zonës. Të gjithë këta elementë të gërshetuar me njëri-tjetrin vlerësohen në këtë studim një nga një dhe me efektin që secili prej tyre jep apo krijon tek elementi tjetër.

Fjalët kyç: suturë, periodontale, karakteristika, ndërtim.

FRIKA E FËMIJËVE NDAJ DENTISTËVE, METODA INNOVATIVE PËR AFRIMIN E FËMIJËVE DREJT KABINETEVE DENTARE

Dr.Shk.Med. Ilma Robo, Kristina Myftaraj[1]
[1]*Studente viti 3 Albania University.*

Abstrakt

Hyrje: Ofrimi i shërbimeve cilësore dentare prioritet ka qasjen e pacientëve kundrejt trajtimit pa dhimbje tek dentisti. Dhimbja e përjetuar nga trajtimet dentare të mëparshme, nxit shfaqen e ndjesisë së frikës që paraprin ndërhyrjen dentare të radhës. Kjo tablo vjen e vështirësohet akoma më shumë kur flasim për moshën pediatrike dhe ndjesinë e frikës apo ankthit të përjetuar prej kësaj moshe përpara trajtimit dentar. Frika ndaj dentistëve e ka fillesën në fëmijëri, prandaj me llogjikë, nëse duhet analizuar frika dhe ankthi ndaj ndërhyrjeve dentare, mosha e studimit mbi këtë temë duhet të jetë specifikisht moshë pediatrike.

Materiale dhe metoda: Studimi është i llojit *review* bazuar në artikujt e mbledhur mbi vlerësimin e frikës dhe ankthit tek moshat pediatrike. Në total 14 artikuj dhe burim të literaturës, që u mblodhën duke u bazuar në kriteret e përzgjedhjes së studimit. Studimi është hartuar në kuadrin e përballjes së shifrave të të dhënave të botuara nga artikujt e ndryshëm mbi frikën dhe ankthin dentar tek mosha pediatrike specifikisht.

Rezultate: Bazuar në të dhënat e mbledhura, 23% e fëmijëve raportonin për shqetësim emocional në përballjen me stomatologun ku vetëm 12% e tyre e shprehnin ndjenjën e frikës. 64% e pacientëve e vlerësojnë mënyrën e veshjes së mjekut, me përparëse të bardhë duke i dhënë më tepër siguri dhe jo frikë. 70% e pacientëve fëmijë nuk kishin ndjesinë e frikës nga mbajtja e maskës gjatë trajtimeve dentare. Ndjesia e frikës sipas raportimeve të fëmijëve, largohet tek një klinikë e dekoruar në përshtatje me moshën.

Konkluzione: Ruajtja e higjienës orale çon në status të shëndetshëm dentar që nuk përballet me dhimbjen me origjinë nga dhëmbi, e për pasojë, duke mos e njohur dhimbjen reduktohet ndjeshmëria edhe pritshmëria ndaj frikës apo ankthit dentar. Pamja vizive e klinikës dhe e mjekut që flet me gjuhën e trupit, ndikon në pritshmërinë në nivel perceptimi të frikës përpara trajtimit dentar.

Fjalë kyç: frikë, ankth, trajtim dentar, higjienë.

LLOJET E SUTURIMIT PERIODONTAL, AVANTAZHET DHE DISAVANTAZHET NË APLIKIM

Dr.Shk.Med. Ilma Robo, Migerta Çafaj[1]
[1]Studente viti 3 Albania University.

Abstrakt

Objektivi kryesor i suturimit është pozicionimi dhe sigurimi i flapave kirurgjikale për të promovuar shërimin optimal (shërimin primar). Me fjalë të tjera, mund të themi se lembot janë të imobilizuara për të stabilizuar plagën.
Suturimi zvogëlon dhimbjen pas operacionit dhe rrit rehatinë e pacientit. Gjithashtu zvogëlon shanset e infeksionit në indet më të thella, si kockat. Suturimi është bërë me shekuj dhe aktualisht ka shumë materiale për të arritur këtë qëllim. Kujdesi adekuat i plagës dhe përafrimi i përsosur i suturave janë jashtëzakonisht të rëndësishme për arritjen e rezultateve të mira pas operacioneve periodontale dhe procedurave rigjeneruese. Mbyllja dhe shërimi i plagës ndikohet nga dëmtimi fillestar i indit i cili në thelb shkaktohet nga penetrimi i gjilpërës.
Për procedura të ndryshme kirurgjikale si procedurat periodontale, përzgjedhja e teknikës së duhur të suturimit, llojet e suturimit, filli dhe gjilpëra që do të përdoren për suturime janë të dhëna të rëndësishme.

Fjalët kyc: suturim periodontal, plagë, avantazh, disavantazh.

VENEERS APO LUMINEERS

Ilvia Tabaku Alimehmeti, Klea Mazelli, Pamela Tushe, Igli Kllomollari

Abstrakt

Hyrja: Fasetat janë mbulesa të holla që vendosen në pjesën vestibulare të dhëmbëve natyral. Përshtaten për të përmirësuar pamjen e dhëmbëve dhe ngjyrën për të krijuar një buzëqeshje të bukur.

Qëllimi: Të nxjerrim në pah avantazhet dhe disavantazhet e veneers/lumineers.
Krahasimi i dy llojeve të punimeve në disa këndvështrime për të lehtësuar zgjedhjen njërës apo tjetrës formë.

Materialet dhe metodat: Rishikim literature bashkëkohore online për të 2 llojet e punimeve. Bazuar në burime zyrtare me faktor të lartë impakti dhe me besueshmeri shkencore.

Përmbajtja: Pas përshkrimit të detajuar të secilës prej metodave, bëjmë krahasimin e rasteve që mund të trajtohen, efektin estetik maksimal, kostot, sasia e konsumit të dhëmbit që kërkojnë të dy punimet.

Konkluzioni dhe rekomandimi: Përparësitë e veneers dhe lumineers dhe arritjet e qëllimit estetik nëpërmjet secilit prej tyre. Rekomandimi për përmirësimin e cilësive dhe shtrirjen më të gjerë të përdorimit të tyre.

Fjalë kyç: Veneers, lumineers, estetikë.

RIVASKULARIZIMI : PROTOKOLLET E REJA DHE KONSIDERATA KLINIKE (RISHIKIM LITERATURE).

Ilvia Tabaku Alimehmeti, Zajbeita Alimehmeti, Daniela Kume, Ama Mino

Abstrakt

Hyrje: Rigjenerimi i pulpës së humbur nga trauma ose sëmundje që e kanë prekur atë është koncept me interes të madh në dentistrinë moderne; dhe pikërisht rigjenerimi nëpermjet formimit të koagulit është lehtësisht i realizueshëm dhe praktik. Kjo metodë është praktikuar prej një kohe të gjatë me rezultate të kënaqshme të raportuara në studime të ndryshme por deri më tani , konsensusi per zhvillimin e këtij protokolli si dhe lloji indeve të formuara po mungojnë.

Qëllimi: Objektivi i këtij studimi është një rishikim literature për te vlerësuar metodat e ndryshme të rivaskularizimit ne sistemit kalanar te rrënjëve, dhe veçanerisht rivaskularizimit nëpërmjet koagulit në sistemin kanalar si dhe diskutim mbi rekomnadimet me kontemporane për një proçes të sukseshëm.

Materiali dhe metoda: Përmbledhje e literaturës bashkëkohore mbi metodat e ndryshme te rivaskularizimit dhe në mënyrë më specifike e rivaskularizimit nëpërmjet formimit të

koagulit ,u rishikuan materiale të botuara së fundmi në faqe shkencore serioze si pubmed, research gate, health line etj si dhe publikimet në revista të ndryshme me faktorë impakti.

Përmbajtja: Nga rishikimi i materialeve të ndryshme u përmblodhen:

1. Rishikim i mënyrave të ndryshme me anë të të cilave mund të bëjmë rivaskularizimi kanalar i rrënjeve dhe raste të ndryshme klinike të raportuara.
2. Konkluzione për suksesin e metodave më bashkëkohore.
3. Aplikime në vendin tonë.
4. Përshkrimi i metodës së rivaskularizimit me anë të formimit të koagulit.

Konkluzione dhe rekomandime: Secili nga aplikimet e ndryshme për të arritur rivaskularizimin ka përparësitë dhe limitet e tij të aplikimit. Rivaskularizimi i rrënjeve të një dhembi nëpërmjet koagulimit të gjakut është një aplikim relativisht i thjeshtë dhe praktik i cili mund të realizohet me mjete dhe materiale që cdo dentist i ka në dispozicion. Ndërkohë që mundësia e flakjes apo mos përshtatjes nga sistemi imunitar shmanget duke qënë se sistemi kanalar i rrënjës mbushte me qeliza të gjakut të vetë pacientit.

Fjalë kyç: traumë, rivaskularizim, sistemi kanalar.

KOMPLIKACIONET E COVID-19 NË REGJIONIN MAKSILO-FACIAL

Dr. Jakup Vrioni, Dr.Deniada Zhupa, Dr.Kleida Selhanej, Dr.Grei Malo

Abstrakt

COVID-19 po shkakton një pandemi në botë. Me rritjen e numrit të pacientëve, ka patur një rritje të ndjeshme të incidencës së komplikacioneve të ndryshme. Vecanërisht infeksione dhe semundje inflamatore të fytyrës dhe nofullave janë vërejtur në pacientë me COVID-19 në fazat e hershme të sëmundjes, po ashtu edhe në fazat e mëvonshme. Në kavitetin oral janë evidentuar: ulcera, njolla të kuqe dhe inflamacion i gjëndrrave salivare. Pacientët me COVID-19 janë në rrezik të lartë të infeksioneve kërpudhore, të tilla si mukormikoza, që mund të jene rezultat i drejtpërdrejt nga infeksioni COVID-19 dhe/ose si një efekt anësor i barnave të përdorura në protokollin e trajtimit COVID-19, të tilla si deksametazon, hidroksiklorokinë, dhe antibiotikët.
Rasti i paraqitur në këtë artikull është një komplikacion serioz i COVID-19, me ecuri të ndryshme nga osteomieliti.

Fjalë kyç: Covid, regjioni maksilo-facial, komplikacion.

KAPACITETI PUFERIK I PËSHTYMËS DHE IHO SI FAKTOR RREZIKU I KARIESIT

Jetmire Alimani Jakupi

Abstrakt

Shkenca bashkëkohore identifikon si faktor kryesor të përfshirë në shfaqjen e kariesit: mikroorganizmat patogjen, ushqimi jo i rregullt dhe kserostomia, si dhe disa faktor mbrojtës:

pështyma, mbyllja e fisurave, përdorimi i mjeteve antimikrobe, fluroidet dhe ushqimi i rregullt.
Qëllimi i punimit tonë është determinimi i faktorëve të rrezikut për sjellje të rrezikshme të cilat çojnë deri te dallimet ose në jo prevalencën e kariesit te fëmijët: Determinimi i indeksit të higjienës orale (IHO), Determinimi i kapacitetit puferik të pështymës pH), Determinimi i prevalencës së kariesit dhe Determinimi i raporteve korelative të kariesit me indeksin – IHO dhe kapacitetin puferik të pështymës.
Rezultatet e përfituara tregojnë prevalencë të lartë të kariesit te të dy grupet e hulumtuara, por më e lartë është te hulumtuesit e zonave rurale. Përfaqësimi i lartë i kariesit është rezultat i shprehive të këqija dhe mos ekzistimit të programeve të organizuara në kontinuitet për mbrojte primare shëndetësore, e cila është në pajtueshmëri me kushtet socio-ekonomike, kulturore ose demografike që sigurojnë rezultate më optimale.

Fjalët kyç: OHI, kapaciteti puferik, kariesi.

ARRITJA E VENDOSJES SË FONETIKËS OPTIMALE NË PACIENTË ME PROTEZA TOTALE

Jonida Roçi[1], Prof. Asc. Edit Xhajanka[2]
[1]Studente, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.
[2]Prof. Asc në Fakultetin e Mjekësisë Dentare, Departamenti i Ortopedisë Stomatologjike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Abstrakt

Hyrje: Gjatë protezimit të pacientëve me proteza totale rikthejmë funksionet përtypëse, estetikën dhe fonetikën. Fonetika paraqet një element shumë të rëndësishëm në protezim e cila varet nga lartësia vertikale e okluzionit, niveli i planit të okluzionit qëndror dhe pozicionimi i dhëmbëve frontale dhe distale.

Qëllimi: Qëllimi i studimit tonë është zbatimi i kritereve fonetike gjatë etapave të ndryshme të protezimit dhe rivendosja e funksionit fonetik.

Materiale dhe metoda: Në studim u përfshin 100 pacientë ku disa ishin me protezë totale, subtotale dhe ½ totale të sipërme. Nga këto pacientë 75 pacientë ishin të protezuar nga klinika stomatologjike universitare dhe 25 nga klinika të tjera. Në pacientët e protezuar nga ne 35 ishin meshkuj dhe 40 femra dhe pacientët e protezuar nga të tjerë ishin 9 meshkuj dhe 16 femra. U analizuan të dyja grupet gjatë shqiptimit të gërmave të ndryshme. Në pacientët e klinikës tonë u ndoqën kriteret fonetike gjatë përcaktimit të okluzionit qëndror ndërsa pacientët e klinikave të tjera u kontrolluan problemet fonetike duke bërë korrigjimin e tyre.

Rezultatet: Në këtë studim, pacientët e klinikës universitare, problemet e fonetikës u paraqitën në 6.6% të pacientëve ku: 1.3% paraqitën probleme në shqiptimin e gërmave "f"' dhe "v", 2.6% në gërmën "s" dhe 2.6% në gërmat "sh" dhe "zh". Ndërsa në pacientët e klinikave të tjera, 32% e pacientëve paraqitën probleme në fonetikë ku: 12% kishin probleme në shqiptimin e gërmave "f" dhe "v", 12% në gërmën "s" dhe 8% në gërmat "sh" dhe "zh".

Konkluzione: Rezultatet e paraqitura tregojnë një diferencë statistikash mjaft të rëndësishme dhe kjo vjen si pasojë sepse shumica e mjekëve u kushtojnë më shumë rëndësi rikthimit të funksionit përtypës dhe estetikës dhe anashkalojnë funksionin e fonetikës. Një rol kyç në këtë studim është zbatimi me përpikmëri e fazave gjatë përcaktimit të okluzionit qëndror dhe

provës me dhëmbë. Pacientët që paraqesin probleme fonetike të bëjnë të mundur përsëritjen e protezës.

Fjalët kyç: fonetika optimale, proteza, përcaktimi okluzionit qëndror, probleme fonetike.

PADHËMBËSIA E PJESSHME E VARGJEVE DHËMBORE PERMANENTE DHE FREKUENCA E SAJ

Kaltrina BEQIRI[1], Sherif SHAQIRI[1,2], Amet DEMIRI[2,3], Seha MUSTAFAI[4]
[1]Klinika Dentare Specialistike Për Protetik "Protetika Ag", Tetovë
[2]Programi Studimor Stomatologji, Fakulteti I Shkencave Mjekësore, Universiteti I Tetovës
[3]Klinika Dentare Specialistike Për Kirurgji Orale "Oral Estetika", Tetovë
[4]Klinika Dentare "Vivadent ", Tetovë

Abstrakt

Qëllimi: Qëllimi i studimit tonë është që, nëpërmjet të dhënave të përftuara nga ekzaminimet klinike në popullatën e Tetovës dhe rrethinat e saj, të përcaktojmë padhëmbësinë e pjesshme te vargjet dhëmbore permanente sipas: gjinisë, nofullave, grup moshave dhe kohëzgjatjes.

Materiali dhe metodat: Për këtë qëllim në periudhën kohore 2017-2021 në klinikën dentare specialistike "Protetika Ag" në Tetovë u ekzaminuan 1125 pacientë me padhëmbësi të pjesshme të cilët kanë ardhur në klinikën tonë duke shprehur ankesat e tyre që kanë të bëjnë me sistemin stomatognatik. Nga ky grupim 52.83% e tyre ishin pacientë të gjinisë mashkullore ndërsa 47.17% e tyre ishin paciente të gjinisë femërore. Me anë të ekzaminimit klinik intra-oral u përcaktua padhëmbësia e pjesshme e vargjeve dhëmbore permanente sipas gjinisë, nofullave, rajoneve dhëmbore, gup moshave dhe kohëzgjatjes.

Rezultatet: Nga numri i përgjithshëm i1125 pacientëve me padhëmbësi të pjesshme, rezultatet e grafikut 1 flasin për një dominim të kësaj patologjie te gjinia femërore me 55% (615) të rasteve kundrejt gjinisë mashkullore me 45% (510) të rasteve. Po kështu, nga numri i përgjithshëm prej 1815 nofullave me padhëmbësi të pjesshme, sipas rezultateve të grafikut 2, mandibula dominon bindshëm me 62% (1125) kundrejt maksillës me 38% (690) të rasteve. Rezultatet e grafikut 5 tregojnë se lokalizimi i padhëmbësisë së pjesshme në të dyja nofullat, në përqindje absolute 71% (1288) ndodhet në rajonin trans-kanin i pasuar nga rajoni inter-kanin me 22% (391) dhe ai inter-trans kanin me 7% (136). Sipas grup-moshave, rezultatet e tabelës 1 tregojnë se përqindje më të lartë të padhëmbësisë së pjesshme në vargjet dhëmbore kemi hasur te grup-mosha 50-59 vjeç, ndërsa përqindje më të ulët kemi në grup-moshën deri më 19 vjeç vetëm me 4.13% të rasteve e ndjekur nga grup-mosha 20-29 vjeç me 6.61% të rasteve.

Përfundim: Frekuenca e lartë e padhëmbësisë së pjesshme te pacientët me denticion të përhershëm është një tregues i qartë i mbizotërimit të sëmundjeve të dhëmbëve dhe suksesit ose dështimit të higjienës orale dhe kujdesit dentar.

Fjalët kyç: padhëmbësia e pjesshme, frekuenca, pacientë.

NDËRHYRJET KIRURGJIKALE TË INDEVE TË BUTA, NË FUNKSION TË PROTEZIMIT

Kevin Ndreu[1], Prof. Ass. Merita Bardhoshi[2]
[1]Klinikë private dentare, Tiranë

[2]*Departamenti i Kirurgjisë Oromaksilofaciale, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*

Abstrakt
Një pjesë e rëndësishme e praktikës së përditshme në kabinetet dentare, është protezimi i suksesshëm dhe afatgjatë në pacientët me edentulizëm total apo parcial. Ndërhyrjet kirurgjikale në indet e buta luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e një fushe protetike të përshtatshme, si në aspektin cilësor dhe sasior, për protezim.
Kritere të rëndësishme për tu vlerësuar përpara protezimit janë: prezenca e patologjive intra dhe ekstraorale, gjendja e mukozës fikse dhe të levishme, gjuha dhe gjendrat e pështymës, konsistenca e indeve të buta, muskulatura etj.
Plani i trajtimit konsiston në marrjen e saktë të anamneza vitae: vlerësimi i patologjive të përgjithshme të pacientit duke vlerësuar kundërindikacionet e interventit, testet laboratorike, niveli i Ca, fosfateve që mund të shkaktojnë rezorbim kockor, vlerësimi i ankesës kryesore të pacientit për të qartësuar rezultatin e ndërhyrjes, arsyet e dështimeve protetike të mëparshme si dhe ekzaminimet radiologjike.

Në indet e buta ndërhyrjet kirurgjikale përfshijnë: Korigjimin e frenulumeve, plikave, mënjanimin e hiperplazive gingivare, thellimin e sulkuseve, menaxhimin e tumoreve beninje të indeve të buta, repozicionimin e nervit mental, komisuroplastikën.

Fjalët kyç: protezim, inde të buta, kirurgji

PREPARIMI VERTIKAL ME MBROJTJE BIOLOGJIKE I DHËMBËVE, BOPT, PËRKUNDREJT METODAVE BAZË TË PREPARIMIT.

Laureta Peposhi, Spec.Msc Egida Haldeda

Abstrakt
Nga njohuritë bazë që kemi, preparimi i dhëmbëve për restaurime protetike fikse ndahet në,

1. Preparim me linjë fundore , chamfer ose shpatull.
2. Preparim teh thike.

Disa vite pas trajtimit ortopedik fiks është vënë re që dëmtohet shëndeti periodontal i dhëmbëve të protezuar, ku në përqindje më të lartë ndodh recension gingivar. Qëllimi i këtij punimi është që të paraqesim preparimin vertikal me mbrojtje biologjike, BOPT, që siguron shëndetin periodontal të dhëmbëve si në zonën anteriore dhe atë posteriore si në punimet metal - qeramik ose zircon.
Gjithashtu në këtë punim do të referojmë se teknika BOPT krahasuar me Chamfer ose Shpatull, është më e lehtë dhe më e shpejtë në marrjen e masës, në përgatitjen e koronave provizore dhe në krijimin e profilit të emergjencës deri në restaurimin protetik fiks.

Fjalë kyce: BOPT, profil emergjence, koronë provizore , gingivë marginale.

REHABILITIMI I MAKSILËS ATROFIKE ME ANËN E IMPLANTEVE ZIGOMATIKË

Prof. Asc. Dr. Luan Mavriqi, Dr. Denis Argjiri.

Abstrakt

Rehabilitimi i maksilës edentuloze është shumë shpesh një proçedurë e ndërlikuar në ata pacientë që dëshirojnë nje punim të palëvizshëm. Shumë shpesh vendosja e implanteve në maksilën e pasme është e pamundur pa graft kockor paraprakisht ose në të njëtën kohë me vendosjen e implanteve. Ky vëllim i kockës i pamjaftueshëm për vendosjen në mënyrën tradicionale të implanteve përbën një sfidë për kirurgun. Kësaj sfide i shtohet dhe ngarkimi i menjëhershëm i implanteve për vendosjen e funksionit dhe estetikës. Një zgjidhje e cila shkurton kohën e trajtimit dhe të jep siguri në këto raste është implanti zigomatik.

Fjalë kyç: Implante zigomatike, implante ekstrasinusale, kocka zigomatike, atrofi maksilare.

SILANTET NË PROFILAKSINË E KARIESIT

Dr. Shk Manola Kelmendi, Jorisa Malaj

Abstrakt
Silantet janë një trajtim dentar i aplikuar në dhëmbët posterior me qëllim mbrojtjen nga kariesi. Ulin riskun e kariesit deri në 80 %. Sipas materialit bazë ato klasifikohen në: Silante me bazë glassionomer cement dhe në silante me bazë rezine.
Silantet me bazë glasionomer cemente kanë disa avantazhe në krahasim me ato me bazë rezine:
1. Janë hidrofilik
2. Shërbejnë si burim fluoridesh
3. Lejojnë përhapjen e lehtë të joneve të kalciumit dhe fosfatit nga pështyma në dhemb
4. Penetrojnë më thellë fisurat e smaltit sesa ato me bazë rezine
Silantet me bazë rezine: Kanë retension më të lartë sesa Glassionomer cement silantet dhe vulosje totale të dhembit nga mjedisi i jashtëm.

Qëllimi: Të evidentohet efekti parandalues i dy tipeve të silanteve.

Materiali dhe metodat: Janë marrë në studim 30 fëmijë të moshave nga 4-10 vjec. Në 15 prej tyre janë aplikuar silante me baze glassionomer si në molarët primare ashtu edhe në molarin e parë të përhershëm dhe në 15 fëmijë është aplikuar silant me baze rezine në po të njëjtët dhëmbë.

Konkluzioni: Është vënë re dukshëm reduktimi i kariesit në siperfaqen okluzale në molarët e përkohshëm dhe të përhershëm.

Fjalë kyç: Silant, dhemb primar, parandalimi i kariesit.

TRAJTIMI I PATOLOGJISË PULPARE NË DENTICIONIN E PËRKOHSHËM.

Dr.Shk Manola KELMENDI, Ornela HYSENAJ

Abstrakt

Hyrje: Trajtimit endodontik tek fëmijët konsiston në eleminimin e infeksionit , inflamacionit dhe lehtësimin e dhimbjeve shoqëruese. Ekzistojnë dy metoda për trajtimin e denticionit primar: terapia me pulpë vitale dhe jo vitale. Metoda e trajtimit me pulpë vitale ofron tre opsione: mbulimi direkt i pulpës, mbulimi indirekt i pulpës dhe pulpotomia. Kur lezioni karioz progreson duke dhënë nekrotizim të pulpës, atëherë kryhet pulpektomia.MIP është një teknikë që lë në fund të zgavrës një pjesë të kariesit për të shmangur ekspozimin e pulpës, duke e mbuluar me një material biokompatibël.MDP është një procedurë në të cilën ka një ekspozim të pulpës, e cila do të mbulohet nga një material biokompatibël. Pulpotomia është një meodë që aplikohet kur ka ekspozim të pulpës gjatë pastrimit të kariesit, në të cilën pulpa koronare hiqet e gjitha, realizohet hemostaza e pulpës radikulare dhe trajtimi i saj mjekohet me medikamente. Pulpektomia është një trajtim jovital, që konsiston në trajtimin e kanalit të rrënjës me pulpë nekrotike ose të inflamuar prej traumave apo kariesit.

Qëllimi: Të krahasohet efikasiteti i pastave të ZnO dhe Hidroksid Kalciumi/ Jodoformit gjatë trajtimit të patologjive pulpare në denticionin primar.

Materiali dhe metodat: U morën në studim pesëdhjetë e katër molar primar mandibular të infektuar nga dyzetë e dy fëmijë të shëndetshëm të moshave nëntë muaj deri në tre vjeç, të cilët u paraqitën për trajtim me patologji pulpare. Kriteret për përfshirje janë: prezenca e lezioneve karioze të thella me ekspozim pulpar, prishja e vazhdueshmërisë së lamina durës dhe mungesa e patologjive shoqëruese. Kriteret për përjashtim janë : obliterimi i kanaleve të rrënjëve, rezorbimi intern dhe rezorbimi fiziologjik i rrënjës në më shumë se ⅓ e gjatësisë. Njëzetë e shtatë dhëmbë u trajtuan me Oksid Zink Eugenol gjatë procedurës së pulpektomisë dhe njëzetë e shtatë të tjerë u trajtuan me pastë me bazë Jodoform dhe Hidroksid Kalciumi në mënyrë rastësore midis tyre.

Konkluzioni: Suksesi klinik i të dy pastave nuk ndryshon ndjeshëm nga 6-12 muaj.

Fjalë kyç: trajtim, patologji pulpare, denticion primar, pulpektomia, ZnO.

TRAUMAT DENTARE

MSc. Marinela Malçi, MSc. Bujar Ferati

Abstrakt

Qëllimi: Të evidentohet rëndësia e dëmtimeve traumatike për mbarëvajtjen e sistemit dhëmbë–nofulla–inde të buta, prevalenca e traumave dentare, llojet më të shpeshta të dëmtimeve traumatike, faktorët kryesorë etiologjikë në mënyrë që të merren masa parandaluese për të minimizuar sadopak riskun e tyre, si dhe të evidentohet performanca e menaxhimeve sipas protokolleve të duhura të traumave në disa raste specifike klinike.

Hyrja: Trauma rrjedh nga fjala greke që do të thotë plagë, lëndim. Regjioni i fytyrës, kryesisht kaviteti oral, shpesh bëhet target i traumave fizike aksidentale, ku vendin kryesor e zënë dëmtimet e dhëmbëve dhe strukturave përreth, atyre veshëse dhe mbajtëse. Ajo konsiderohet një emergjencë dentare pasi shkakton efekte funksionale, estetike dhe psikologjike. Shkaqet më të shpeshta të traumave janë rrëzimet aksidentale, aksidentet automobilistike, dhuna, sportet, etj.

Materiali dhe metoda: Në një studim të kryer në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar (SUQU) dhe në 3 klinika dentare në Tiranë, u shqyrtuan regjistrat dhe kartelat mjekësore të

cilat i përkisnin një periudhë kohore të caktuar janar 2017 – qershor 2018, nga të cilat u konstatuan 35 raste me trauma të ndryshme dentare. Në këtë grup prej 35 subjektesh, 24 janë meshkuj dhe 11 femra. Gjithashtu nga 35 pacientë, kemi paraqitur 3 raste klinike ku kemi treguar konkretisht ekzaminimet përkatëse dhe sesi është menaxhuar trajtimi i një pacienti me traumë dentare.

Rezultatet: Nga studimi i kryer rezultoi se brenda 1 viti e gjysmë (janar 2017 – qershor 2018) janë regjistruar vetëm në Spitalin e Traumës 17 pacientë me traumë dentare. 16 prej tyre kishin pësuar traumë periodontale dhe vetëm 1 kishte edhe frakturë dentare (të komplikuar). Këto trauma kryesisht ishin shenja klinike shoqëruese të dëmtimeve më të mëdha faciale, si në rastet e kontuzionit facial, frakturave të nofullave apo proceseve alveolare. Në 18 rastet e tjera, të cilat u regjistruan nga kartelat klinike të 3 klinikave në Tiranë, u konstatua vetëm 1 pacient me të dyja llojet e traumave të pranishme dhe 17 fraktura koronare (me edhe pa ekspozim të dhomës pulpare) apo radikulare.

Përfundimi: Kaviteti oral shpesh bëhet targeti i traumave fizike e aksidentale. Nga studimi i kryer konkluduam se më shpesh preken kurorat e dhëmbëve frontalë për shkak të pozicionit të tyre anatomik. Veçanërisht në incizivë të protruduar, prognati maksilare apo në over-jet të theksuar, risku është dhe më i lartë. Janë grupmoshat 10 – 15 vjeç që rezultuan me numrin më të lartë të traumave dentare dhe gjinia e cila mbizotëron me një raport shumë herë më lartë është ajo mashkullore, madje sa më shumë rritet mosha aq më i theksuar bëhet ky raport. Gjithashtu, u vu re se kishte një tendencë që këto dëmtime traumatike të ndodhnin gjatë mbrëmjes. Shumica e traumave të evidentuara kishin ndodhur pas orës 18:00 dhe një pjesë e vogël e tyre gjatë ditës.

Fjalë kyç: trauma, fëmijë, studim, dhëmbë, faktorë etiologjik.

STUDIM RETROSPEKTIV NË MENAXHIMIN E TRAUMAVE DENTARE NË SPITALIN E TRAUMËS PËRGJATË VITEVE 2011-2020

Megi Taraj

Abstrakt

Hyrje: Kjo temë është e fushës së Kirurgjisë Orale dhe Maksilo-Faciale dhe paraqitet si një studim retrospektiv i rasteve klinike dhe trajtimit të tyre përgjatë viteve 2011-2020 në "Spitalin Universitar të Traumave". Në këtë temë do të trajtohen traumat dento-alveolare dhe menaxhimi i tyre. Traumat dentaro-alveolare janë të llojeve dhe të gradave të ndryshme dhe mund të takohen në të dy denticionet. Menaxhimi i traumave dento-alveolare niset me trajtimin emergjent të pacientit dhe në varësi të gradës së dëmtimit kryhen trajtime endodontike, fiksim rigid ose fleksibël, rezeksion apikal, trajtim ortodontik, ekstraksion kirurgjikal dhe vendosje e njëimplanti.

Qëllimi dhe objektivat: Qëllimi i këtij studimi është njohja me llojet e ndryshme të traumave dento-alveolare, shfaqjen klinike tek pacientët dhe menaxhimin e tyre, si dhe përcaktimin e prevalencës së traumave në lidhje me moshën e pacientëve, gjininë, shkakun dhe vendin ku ka ndodhur trauma. Objektivat e studimit janë:
Evidentimi i korrelacionit midis shkakut dhe vendit ku pacienti pëson traumën dento-alveolare. Evidentimi i grupmoshës më të prekur nga traumat dento-alveolare.
Njohja me etapat e menaxhimit të pacientit që nga momenti që paraqitet në

spital/klinikë. Krahasimi i metodave të ndryshme që përdoren për menaxhimin e traumave dento-alveolare.

Materiale dhe Metoda: Kampioni i pacientëve të marrë në studim përbëhet nga 119 persona të cilët janë trajtuar në "Spitalin Universitar të Traumave",Tiranë. Gjithsej janë 25 paciente femra dhe 94 pacientë meshkuj. Grupmosha e pacientëve të marrë në studim varion nga mosha 16 muajsh deri në 71 vjeç. Gjithashtu janë marrë të dhëna nga rishikime literature të librave të ndryshëm, studime të mëparshme të rasteve me trauma dento-alveolare si dhe literaturë online.

Rezultate dhe Konkluzione: Sipas të dhënave të rasteve nga ky studim meshkujt janë më të predispozuar për të pësuar një episod traumatik sesa femrat. Grupmosha 30 + vjeç është grupmosha që preket më shpesh nga traumat dento-alveolare. Shkaku më i shpeshtë nga i cili një individ pëson një traumë dento-alveolare është rrëzim nga lartësitë. Nofulla më e prekur është maksila. Dhëmbi që pëson më shpesh traumë dento-alveolare është Incizivi Central Maksilar. Mënyrat kryesore të menaxhimit të traumave dento-alveolare janë fiksim unimaksilar, vendosja e shinave unimaksilare dhe ligaturë tip Limberg.

Fjalët kyçe: Traumë dento-alveolare, luksacion, prevalencë, trajtim, reimplantim.

MANAXHIMI KIRURGJIKAL I DHËMBËVE TË PJEKURISË

Merita Bardhoshi, Manuela Ismailaj

Abstrakt

Molarët e tretë mandibular shpeshherë paraqesin disa vecori në erupsionin e tyre. Sipas rastit klinik ato mund të eruptojnë normalisht në arkadën dentare ose në disa raste ato mund të përmbahen në nofulla në pozicione të ndryshme. Manaxhimi i dhëmbëve të përmbajtur zë një pjesë të konsiderueshme të praktikës së përditshme të kirurgut oral.
Arsyet e përmbajtjes mund të jenë: Arkada dentare nuk ofron hapësirën e mjaftueshme për eruptimin e tyre.
Kocka është dense, traumat lokale, intervente të ndryshme në zonën ku është folikuli i këtij molari, në kuadrin e sindromeve të përgjithshëm, crregullimet endokrine. Pozicionimi anormal i këtyre molarëve : Mezial Horizontal, Distal, Vertikal.
Pregatitja preoperatore konsiston: Vlerësimi i rastit klinik, vlerësimi i gjëndjes së pacientit, preanestezia, pregatitja profesionale e kirurgut, kit operator, pregatitja e sallës operatore.
Faza operatore konsiston: Teknika kirurgjikale e përzgjedhur, etapat e ndërhyrjes, komplikacionet postoperatore, sherimi i plagës.

Fjalë kyç: Trauma, komplikacione, menaxhim kirurgjikal.

MANAXHIMI I PROCESEVE INFLAMATORE TË REGIONIT OMF

Merita Bardhoshi, Merisa Hate

Abstrakt

Absceset ndodhin kur një zonë e indeve bëhet e infektuar dhe sistemi imunitar i trupit përpiqet ta luftojë atë. Absceset mund të formohen në pothuajse çdo pjesë të trupit.

Regioni oromaxillofacial është një lokalitet i cili kompromentohet shumë nga proceset inflamatore kryesisht me natyrë odontogjene. Lëkura, nën lëkura dhe dhëmbët janë vendet më të zakonshme. Absceset mund të shkaktohen nga bakteret, parazitët dhe substancat e huaja. Në varësi të faktorit etiologjik mund të lokalizohen në hapësirën bukale, infratemporale, infraorbitare, submandibulare, pterigomandibulare, mentale. Proceset inflamatore shoqërohen me dhimbje, edemë, skuqje, trizmus dhe kompromentim të gjëndjes së përgjithshme të pacientit.
Mjekimi i proceseve inflamatore mund të jetë: Medikamentoz, në fazat seroze, konsiston në dhënien e antibiotikoterapisë, vitaminoterapi dhe analgjezik dhe kirurgjikal në fazat purulente duke realizuar incision dhe drenim, antibiotikoterapi. Duhet mbajtur në konsideratë dhe eleminimi i shkakut me qëllim parandalimin e riformimit të procesit inflamator.

Fjalë kyç: Proces inflamator, absces, faza seroze, purulente.

LEZIONET ORALE TEK PACIENTËT HIV POZITIV

MSc. Naile Bregu

Abstrakt

Vite më parë, teksa virusi i HIV-it u shfaq dhe u zbulua për njerëzimin dhe mjekësinë u shtua një sfidë e re. Përballja e parë me këtë virus ka qënë sa e vështirë aq edhe e frikshme dhe e panjohur. Ditët e sotme fantazma e këtij virusi vazhdon të na ndjekë por ndryshe nga vitet e mëparshme tanimë jemi më të përgatitur. Sot mjekësia ka avancuar dhe ka arritur në zbulime të arta, të cilat shpëtojnë dhe e bëjnë jetën e pacientëve më cilësore. Sëmundja që shkakton virusi i HIV-it prek të gjithë organizmin. Kështu edhe kaviteti oral është i prekur dhe vuan nga prezenca e këtij virusi.
Qëllimi i këtij punimi është të shqyrtojë lezionet e shfaqura në kavitetin oral në pacientët e spitalit infektiv të QSUT. Si lezione bazë janë marrë lezionet e studiuara dhe të publikuara në libra shkencorë të shkruajtur nga autorë të njohur në mbarë botën. Gjithashtu përpos shqyrtimit të lezioneve që janë shfaqur tek pacientët HIV pozitiv, punimi synon të nxjerrë të dhëna mbi trajtimin dhe mjekimin që u është bërë pacientëve të shtruar në spital. Një tjetër synim është padyshim edhe shpërndarja demografike e këtij virusi në vendin tonë. Kjo do të shërbejë në të ardhmen si një pikënisje për projekte të ndryshme profilaktike nga stafi mjekësor apo institucione të tjera.

Padyshim që sjellja jonë, pra e stafit mjekësor, apo e çdokujt tjetër në kontakt ose jo me personat e prekur nga ky virus duhet të tregojë maturi, qytetari, kujdes dhe tolerancë për të minimizuar sado pak vështirësitë dhe sfidat e tyre. Në veçanti mjekët stomatologë duhet të operojnë me të gjitha masat e nevojshme dhe me dëshirë dhe vullnet të fortë me të gjithë pacientët pa paragjykuar apo anulluar takimet me këta persona. Kështu do të arrihet një jetesë më e lehtë në komunitetin tonë për pacientët, të cilët jetojnë çdo ditë të jetës me sfidën e pranisë së HIV-it në trupin e tyre.

Fjalë kyç: Virus, HIV, lezione orale, shërbim mjekësor.

INCIDENCA E LEZIONEVE ORALE NË PACIENTËT E TRAJTUAR ME PROTEZA TOTALE TË LËVIZSHME.

Neada Hysenaj, Endrit Paparisto

Abstrakt

Hyrje. Komplikacionet bio-mekanike, risqet e proçedurave kirurgjikale dhe kostoja e restaurimeve implanto-protetike kanë bërë që numri i pacientëve që kërkojnë protezim total të lëvizshëm të mbetet akoma i lartë.

Qëllimi i studimit tonë ishte ekzaminimi dhe vlerësimi i frekuencës së lezioneve orale në pacientët e trajtuar me proteza totale të lëvizshme.

Materiale dhe metoda. Në studim u përfshin 186 pacientë të paraqitur në Klinikën Stomatologjike Universitare, Tiranë, nga mosha 50 deri në 85 vjeç. Kriteret e përfshirjes ishin pacientët që kishin proteza totale në njërën ose të dyja nofullat për të paktën 6 muaj. Kriteret e përjashtimit 1. Pacientët që kërkonin protezim për herë të parë 2. Pacientët që nuk pranuan të ishin pjesë e studimit. Të gjitha të dhënat u mblodhën dhe përqindjet u llogaritën. U analizuan: koha që pacientët ishin të protezuar, koha e mbajtjes së protezave, mënyra e pastrimit të protezave, gjinia, mosha, higjiena e pacientëve. Pacientët u ndanë në dy grupe kryesore: I. Pacientë të protezuar më gjatë se 5 vite dhe II. Pacientët të protezuar për më pak se 5 vite.

Rezultatet. Në studimin tonë lezionet më të shpeshta ishin stomatiti protetik (46.2%), i ndjekur nga ulçera traumatike (37.6%), hiperplazia (17.2%), keiliti angular (9.6%) dhe alergjia nga rezina (1%). Frekuenca e lezioneve orale ishte më e lartë tek femrat (64.5%) krahasuar me meshkujt (35.5%). Gjithashtu prevalanca e lezioneve orale ishte më e lartë tek pacientët që realizonin pastrim mekanik krahasuar me pacientët që realizonin pastrimin mekanik dhe kimik. Një diferencë statististikisht e rëndësishme u vu re ndërmjet pacientëve që mbanin protezën ditë-natë me pacientët që e mbanin vetëm ditën.

Konkluzione. Është e rëndësishme që pacientët e protezuar të udhëzohen për mbajtjen e higjienës orale dhe të protezave. Një rol kyç në zbulimin e hershëm të lezioneve orale luajnë edhe kontrollet periodike tek mjeku stomatolog.

Fjalët kyçe: Proteza totale të lëvizshme, lezione orale, frekuenca.

STOMATITI PROTETIK: RISHIKIM LITERATURE.

Dr. Neada Hysenaj[1], Prof. Asoc. Edit Xhajanka[2], Endrit Paparisto

[1]Klinika Stomatologjike Universitare, [2]Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Stomatiti protetik është një gjendje patologjike e shoqëruar me inflamacion dhe eritemë te mukozës orale nën fushën protetike të protezave totale dhe parciale të lëvizshme. Ky studim paraqet një përmbledhje të literaturës mbi stomatitin protetik dhe në vecanti mbi protokollet e trajtimit. Një rishikim i përgjithshëm i literaturës u realizua duke përdorur fjalë kyçe të ndryshme në bazën e të dhënave elektronike PubMed dhe Cochrane (nga 1975 deri në dhjetor 2022). Etiologjia e stomatitit protetik është multifaktoriale, megjithëse Candida albicans është zakonisht patogjeni shoqërues. Faktorët predispozues janë higjiena e ulur orale

dhe e protezave, traumat nga protezat, mbajtja e protezave gjatë natës dhe gjendjet sistemike favorizuese. Për shkak të etiologjisë së tij multifaktoriale, menaxhimi i stomatitit protetik është kompleks, ku përfshihen përdorimi i terapisë me antimykotikë, heqja e protezave gjatë natës dhe kontrolli efikas i pllakës dentare. Kërkimet e fundit kanë sugjeruar përdorimin e materialeve ribazuese që përmbajnë antimykotikë, shpëlarësit antiseptik dhe rrezatimin me mikrovalë, si faktorë që duhen marrë në konsideratë në trajtimin e stomatitit protetik. Konkluzione. Njohuria e mjekut stomatolog për opsionet moderne të trajtimit të stomatitit protetik do të ndihmojë në planifikimin gjithëpërfshirës të trajtimit. Megjithatë, metodat më të reja të trajtimit kanë nevojë për studime të mëtejshme përpara rekomandimit.

Fjalët kyçe: Stomatiti protetik, trajtimi, rishikim literature.

MENAXHIMI SPITALOR I INFEKSIONEVE ODONTOGJEN.

Dr. Nela Mataj; Dr.Shk Andis Qendro

Abstrakt

Infeksionet më të shpeshta të regjionit O.M.F janë më origjinë odontogjene shkaktuar nga një florë polimikrobiale. Këto infeksione mund të paraqiten më një klinikë të rëndë duke paraqitur nevojën për menaxhim spitalor.

Qëllimi: Të sigurojmë një qasje për menaxhimin e infeksioneve odontogjene tek të rriturit që paraqiteshin në urgjencë dhe që hospitalizoheshin.

Materiale dhe Metoda: Studimi është *cross-sectional* i realizuar në pacientët e paraqitur në urgjencë dhe të shtruar pranë shërbimit të OMF-së në Spitalin Francez, gjatë periudhës majgusht të vitit 2021. U përzgjodhën materialet me diagnoze pranimi:" Flegmona dhe abcese në regjione të tjera" ose "Sëmundje të indeve pulpare dhe periodontale".

Rezultatet: Nga 36 pacient të marrë në studim, 55% rezultojnë të jenë femra. Grup-mosha më e prekur është ajo 0-9 vjeç dhe 30-39 vjeç me nga 22.20% secila. Nga ato qe kishin marrë trajtime paraprakisht rezultojnë 48.30% të kenë përdorur antibiotikë dhe vetëm 17.24% trajtime nga shërbimët dentare. 83.30% e pacientëve janë trajtuar me ekstraksion e dhëmbit shkaktar. Sëmundjet mendore si sëmundje pre-eksistuese më frekuente në këtë grup pacientësh zënë 30.60 %. Kortikosteroidët u përdorën vetëm në 33% të rasteve ndërsa kombinim i tre antibiotikëve në 22.21 %. Vetëm te një pacient u krye trakeostomi.

Konkluzionet: Infeksionet odontogjen mund të jenë tepër të rrezikshme prandaj sigurimi i lirë i rrugëve ajrore, administrimi i medikamenteve dhe trajtimi kirurgjikal i dhëmbit shkaktar duhet të kryhen në kohë për ruajtjen e jetës së njerëzve.

Fjalët kyçe: Infeksion odontogjen, hospitalizim, menaxhim, faktor risku.

TRAJTIMI I KAFSHIMIT TË HAPUR NË PACIENTËT ME DINTICION MIKS

Prunela Poliçi, Ilsa Nini

Abstrakt

Kafshimi i hapur anterior përfaqëson një keqkafshim që akoma sot vazhdon të studiohet si për etiologjinë e tij ashtu edhe për mënyrat më efektive dhe më optimale të trajtimit tek pacientët në fazën e denticionit miks, pra pacientë në rritje. Shkaqet më të shpeshta të këtij keqkafshimi kanë të bëjnë me faktorë të jashtëm ambientale si psh frymëmarrja orale, veset e fituara si thithja e gishtit, e biberonit, gëlltitja atipike etj, përmasat e gjuhës dhe modeli i rritjes faciale vertikale dhe në postrotacion. Opsionet për trajtimin e hershëm të këtij keqkafshimi janë akoma të diskutueshme por një nga format më efektive ka rezultuar përdorimi i kafazit maksilar fiks i cili ndikon pozitivisht në humbjen e vesit të fituar dhe në rregullimin e posturës së gjuhës duke parandaluar kështu zhvillimin e kafshimit të hapur tek pacientët në rritje. Literatura dëshmon që ky aparat ka më shumë stabilitet.

Fjalët kyç: kafshimi, pacientë, dinticion miks.

KIRURGJIA PLASTIKE PARODONTALE – LLOJET E GRAFTEVE DHE TEKNIKAT PËR MBULIMIN E RECESIONEVE GINGIVARE

Gavazi R., Kërçi A., Lulaj Xh.

Abstrakt

Me kirurgji plastike periodontale nënkuptojmë ndërhyrjet kirurgjikale me qëllim modifikimin e margos gingivare dhe/ose sasisë dhe karakteristikave të indeve të buta marginale, tek dhëmbët dhe tek implantet.
Ndërhyrjet më të shpeshta janë: Shtimi i gingives, mbulimi i recesioneve, korigjimi i defekteve mukozale tek implantet, zgjatja e kurorave klinike, heqja e frenulumeve aberrant.

Qëllimi: Per korigjimin e këtyre defekteve ekzistojne një larmishmëri teknikash që ndryshojnë kryesisht nga përgatitja e lembos që mund të jenë me lëshime vertikale si: Lembo me ripozicionim apikal, Lembo me zhvendosje koronale, Lembo me traslacion lateral, ose pa lëshime vertikale si: Lembo semiluar, Tunneli tradicional dhe Tunneli i modifikuar, Vista etj.
Dallohen klasat e ndryshme të recesioneve:
Klasa 1: indi marginal i recesionit nuk shtrihet përtej linjes mukogingivare; nuk ka humbje kocke dhe gingive interdentale
Klasa 2: indi marginal i recesionit kalon përtej linjës mukogingivare; nuk ka humbje kocke dhe gingivë interdentale
Klasa 3: indi marginal i recesionit shkon ose dhe e kalon linjen mukogingivare; kemi humbje kocke dhe gingivë interdentale/ keqpozicionim i dhembit
Klasa 4: indi marginal i recesionit shkon ose/dhe e kalon linjen mukogingivare; humbje e madhe e kockës dhe gingivës interdentale ose keqposizionim i dhëmbit

Konkluzion: Ka pacient që i tremben graftit nga qiellza dhe kërkojnë alternativa. Në treg kanë filluar te dalin nga shumë kompani, alternativa si Mucoderm, Fibrogide, Alloderm, të cilat stimulojnë graftin epitelial ose lidhor në mënyrë pothujse perfekte, por kërkojnë të manipulohen ndryshe nga graftet autologe.

Fjalë kyç: graft, recession gingivar, ind marginal.

PARIMET BIOMEKANIKE DHE PLANI I TRAJTIMIT TË IMPLANTEVE DENTARE

Dr. Renato Isufi[1], Dr. Aurora Isufi[2], Dr. Eriselda Simoni[1], Dr. Denis Kadaifciu[1], Dr. Anis Theodhorjan
[1]*Klinika Stomatologjike Universitare*
[2]*Isufi Royal Dental*

Abstrakt

Hyrje: Parimet biomekanike kompromentojnë të gjithë ndërveprimet midis trupit dhe forcave që veprojnë mbi të. Kuptimi i këtyre parimeve është shumë i rëndësishëm për mjekët që vendosin implante por janë të rëndësishme të njihen edhe nga kërkuesit shkencor në këtë fushë. Këto parime janë të rëndësishme në çdo hap që nga plani i trajtimit deri në restaurimin protetik final. Mos respektimi i tyre çon në dështim të punimit.

Materialet dhe metodat: Ky prezantim përfshin një rishikim të literaturës për parimet biomekanike dhe përfshirjen e tyre në punën e përditshme.

R**ezultatet:** Aspektet praktike të punës sonë të kombinuara me literaturën bashkëkohore mund të shërbejnë si një guidë për prakticienët për të rritur suksesin e tyre në praktikë.

Konkluzioni: Asnjë lloj trajtimi nuk është pa komplikacione, një njohje e mirë e parimeve mekanike në implantologjinë orale çon në rritje të suksesit si të implantit dhe të punimit protetik mbi të.

Fjalët kyç: implantologjia orale, biomekanika, implant dentar.

DISFUNKSIONET ORALE

Rosela Xhemnica, Ana Golloshi

Abstrakt

Qëllimi: Qëllimi i këtij projekti është shtjellimi i temës së disfunsioneve orale; përkufizimi; prezantimi i metodave të diagnostikimit, etiologjisë, ndikimit në okluzion dhe mënyrat e trajtimit apo rehabilitimit të tyre.

Objektivat: -Njohja e përkufizimit të disfunksioneve orale dhe çfarë përfshijnë ato;
-njohja e metodave të diagnostikimit dhe evidentimi i disfunksioneve orale që në mosha të hershme;
-njohja me shkaktarët e disfunksioneve orale;
-njohja me efektet e disfunksioneve orale në okluzion;
-njohja e mënyrave të trajtimit të këtyre disfunksioneve.

Materialet dhe metodat: Gjatë kërkimeve dhe punës për këtë prezantim, janë shqyrtuar artikuj shkencorë të publikuar në revista shkencore dhe faqe si PubMed, MedLine Plus, Cochrane etj, duke kërkuar me fjalët kyçe "Disfunksionet orale".

Rezultatet: Disfunksionet orale shpesh vihen re që në moshë të hershme, por mund të vihen re dhe në faza të tjera të jetës. Përfshijnë frymëmarrjen orale, gëlltitjen atipike etj. Impakt të

madh në to kanë ushqyerja me gji te foshnjat, përmasat e reduktuara të indeve të buta, zakonet apo veset orale. Trajtimi ortodontik ndër të tjerash, mund të ndikojë në përmirësimin apo zhdukjen e këtyre disfunksioneve.

Konkluzioni: Disfunksionet orale shpesh bëhen shkak për malokluzione dhe çrregullime apo dismorfi të tjera të fituara të regionit oral e kraniofacial. Që këto probleme të trajtohen në mënyrë adekuate dhe të suksesshme (p.sh. me trajtimin ortodontik), dhe të arrihet stabilitet afatgjatë, është thelbësore të kuptohen dhe trajtohen shkaqet që në këtë rast janë disfunsionet orale.

Fjalë kyç: disfunksione orale, shkaktarë, malokluzion, trajtim ortodontik.

KANINI I IMPAKTUAR.

Rosela Xhemnica, Rael Hidi, Klaudia Legisi

Abstrakt

Parathënie: Kanini i impaktuar përkufizohet kanini, i cili nuk ka eruptuar në kavitetin oral pavarësisht se ka arritur koha fiziologjike e eruptimit, si pasojë e shkaqeve lokale, sistemike, apo gjenetike. Trajtimi e menaxhimi i tyre shpesh kërkon një strategji multi-disiplinare për të shmangur komplikacionet e mundshme në harkadën dhëmbore.

Qëllimi: Qëllimi i këtij projekti është prezantimi i teknikave të diagnostikimit të kaninit të impaktuar, shkaktarëve të impaktimit dhe metodave të trajtimit.

Objektivat:- Njohja e metodave të diagnostikimit dhe nxitja për evidentimin e hershëm të ekzistencës së një kanini të impaktuar;
- Njohja me faktorët fizikë, mekanikë dhe biologjikë, të cilët shkaktojnë impaktimin e kaninit;
- Prezantimi me metodat e trajtimit të kaninit të impaktuar në bazë të klasifikimit të tij;
- Njohja e komplikacioneve të mundshme, që janë rezultate të kaninit të impaktuar.

Materialet dhe metodat: Gjatë punës për këtë material janë shqyrtuar artikuj shkencorë të publikuar në revista shkencore (duke kërkuar në faqe si PubMed, Cochrane, MedLine me fjalët kyce “Kanin i impaktuar”).

Rezultatet: Grafia panoramike është metoda më e shpeshtë diagnostikuese, që çon në zbulimin e hershëm të kaninit të impaktuar, i cili mund të trajtohet me anë të ekstraksionit të kaninit primar, ekspozimit kirurgjikal të kaninit të impaktuar e trajtimit të mëtejshëm ortodontik, apo dhe të ekstraktohet, ose të lihet pa trajtuar.

Konkluzioni: Një menaxhim adekuat i kaninëve të impaktuar, nga këndvështrimi funksional dhe estetik, është i një rëndësie të madhe për suksesin e përgjithshëm të terapisë ortodontike. Profesionistët dentarë duhet të zgjedhin, midis shumë opsioneve të disponueshme të planit të trajtimit, atë që plotëson më mirë nevojat dhe interesat e pacientit.

Fjalë kyç: kanin i impaktuar, diagnozë, ndërlikime, trajtim interceptiv, trajtim kirurgjikal.

NDIKIMI I TORUSIT PALATINAL NË THYERJEN E PROTEZËS TOTALE.

Prof. Dr. Ruzhdie Qafmolla, Marjola Shehi, Endrit Paparisto

Abstrakt
Trajtimi protetik me proteza të lëvizshme parciale dhe totale bëhet i vështirë në rastin e një torus palatal shumë të zhvilluar, që ndikon në funksionin dhe stabilitetin e protezës.

Qëllimi i studimit është: Të përcaktojë llojin (1-5) e torusit palatal. - Të përcaktojë trajtimin. Për të parë rezultatet e marra sipas metodës së zgjedhur të trajtimit. Për të identifikuar mënyrat e ndryshme në trajtimin e të njëjtit rast dhe për të zgjedhur idealin.

Materiali dhe metoda: Kemi studiuar 200 modele të nofullës së sipërme, në 11% të rasteve ka qenë prezent torus palatal i zhvilluar. Klasifikimet i kemi bërë në bazë të konfigurimit dhe lokalizimit. Sipas lokalizimit e kemi ndarë në 5 forma. Matjet u realizuan më anë të kalibrit manual. Për gjatësinë u përdor matja me flos, duke u përshtatur në relievin e qiellzës. Flosi u mat në kalibër. Trajtimi bëhet në mënyrë protetike me, materiale elastike ose fletë plumbash (0,2 deri në 0,6 mm).

Rezultatet: Nga matjet dhe lokalizimi janë vërejtur se 4 % i përkisnin klasës 1, 1 % i përkisnin klasës 2, 2 % i përkisnin klasës 3, 4 % i përkisnin klasës 5. Konkluzione: Trajtimi me sekrecione protetike të torusit të palatit tregoi se është një metodë joinvazive dhe jep rezultate të mira, duke anashkaluar plagët dhe dëmtimet në këtë zonë. Rezultatet më të mira arrihen me përdorimin e materialeve elastike.

Fjalë kyç: torus palatinal, proteza totale.

NDËRLIDHJA NDËRMJET ÇRREGULLIMEVE MENDORE DHE BRUKSIZMIT

Prof.Dr.Rruzhdie Qafmolla, Mesuara Pasho, Alketa Qafmolla

Abstrakt

Bruksizmi është një patologji që ka të bëjë me një shtrëngim të fortë, të pavetëdijshem të dhëmbëve. Kjo quhet ndryshe simptomi i kërcitjes, që ndodh gjatë lëvizjeve së nofulles së poshtme. Vecanërisht kjo patologji komplikohet edhe më tej në të sëmurë me probleme psiqike. Në këtë rast këtyre pacientëve i mungon vetëdija subjektive dhe shkarkimin psiko-emocional e arrijnë nëpërmjet shtrëngimit të dhëmbëve. Bruksizmi është një sëmundje e përhapur në botë dhe kërkon vëmendje të vecantë dhe studime të shumta, që janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen nga autore të ndryshëm, duke dëshmuar për nevojen dhe rëndësinë e madhe që ka etiopatogjeneza në kurimin e kësaj patologjie.

Qëllimi: Studimi yne ka për qëllim që të përcaktojë nderlidhjen që ekziston ndërmjet pacientëve me crregullime psiqike me bruksizmin, duke patur si objektivë përcaktimin e faktorëve patogjenetik ,simptomat shoqëruese të bruksizmit si dhe mjetet dhe mënyrat e trajtimit te bruksizmit.

Fjalë kyç: bruksizmi, crregullime mendore.

PERICORONITIS: NJË STUDIM KLINIK DHE EPIDEMIOLOGJIK TË PACIENTËVE TË TRAJTUAR NË REPARTIN E KIRURGJISË ORALE TETOVË

Seha Demiri Mustafai[1,2], Armed Demiri[1];Amet Demiri[3]
[2]Klinika Dentare "Vivadent", Tetovë
[2]Programi Studimor Stomatologji, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Shtetëror i Tetovës
[3]Klinika për Kirurgji Orale "Kirurgjia Estetike Orale" Tetovë

Abstrakt

Qëllimi: Ky punim paraqet një analizë statistikore të karakteristikave epidemiologjike, klinike dhe radiografike të perikoronitit të lidhur me molarin e tretë.

Materiali dhe Metoda: Në periudhën 2012 – 2016 në Repartin e kirurgjisë orale në Tetovë janë kryer 2264 ekstraksione, prej të cilëve 854 (37,72%) ishin dhëmbë të impaktuar. Nga këto dhëmbë të impaktuar 18 ishin kanin, 219 dhëmbë ishin molar i tretë maksilar dhe 617 (27,25%) i takonin molarëve të tretë të impaktuar mandibular. Variablat e testuar përfshinin informacionin personal të pacientëve, parametrat e angulimit radiografik të molarit të tretë, niveli i impakcionit dhe klasifikimi i tyre në raport me ramus mandibule dhe molarit të dytë.

Rezultatet: Studimi ynë është kryer në 600 molar të tretë të impaktuar në gjithsej 458 pacientë nga të cilët 273 ishin femra dhe 185 meshkuj. Prevalenca e perikoronitit rezultoi të jetë në 68 raste ose 11,34%. Grupi i pacientëve nga 20 deri në 25 vjeç dominoi 49 ose në një përqindje prej 72.06%.

Konkluzione: Përdorimi i shpëlarjes së gojës së bashku me frekuencën adekuate të larjes së dhëmbëve duket se lidhet me një ulje statistikisht e rëndësishme e sëmundjes. Molarët me impakt vertikal kanë më shumë gjasa të paraqesin pericoronitis në masën 42 (61,76%); plani A dhe dhëmbët e impaktuar që janë të pozicionuar në skajin e përparmë të mandibulës sipas në klasën II, kanë një shkallë më të lartë të prevalencës. Së fundi, është gjithashtu një rishikim i shkurtër i literaturës në krahasim me studimin tonë të paraqitur.

Fjalët kyçe: Perikoroniti i lidhur me molarin e tretë, dhëmbët e pjekurisë së impaktuar, prevalencë, studim epidemiologjik.

FREKUENCA E SANIMIT PROTETIK TË VARGJEVE DHËMBORE PERMANENTE

Sherif Shaqiri[1,2], Kaltrina Beqiri[1]
[1]Klinika për protetikë "Protetika AG" - Tetovë
[2]Programi studimor stomatologji, fakulteti i shkencave mjekësore Tetovë

Abstrakt
Qëllimi i studimit tonë është që, nëpërmjet të dhënave të përftuara nga ekzaminimi klinik i pacientëve tanë të trajtuar të vlerësojmë frekuencën e sanimit të defekteve dhëmbore me punime protetike sipas gjinisë, nofullave, grupmoshave dhe kohëzgjatjes.

Për këtë qëllim në periudhën kohore 2007-2011 u ekzaminuan 1785 pacientë. Nga ky grupim 52.83% e tyre ishin pacientë të gjinisë mashkullore ndërsa 47.17% ishin paciente të gjinisë femërore. Mosha e të ekzaminuarve ishte prej 13 - 82 vjeç, me moshë mesatare 48.2 vjeç.
Metodologjia e punës u realizua përmes protokollit bazë të ndjekur që u zbatua në studimin tonë dhe i cili përbëhej mes tjerash edhe nga anamneza dhe ekzaminimi klinik intra-oral.
Të dhënat e fituara janë futur në kartela të pacientit duke përdorur formën e modifikuar të vlerësimit të shëndetit oral sipas OBSH-së, të përshtatur dhe modifikuar me natyrën e hulumtimit tonë.
Përpunimi statistikor i rezultatetve të fituara është bërë sipas gjinisë, grup-moshave dhe kohëzgjatjes së punimeve protetike. Është përdorur metoda statistikore deskriptive për shpërndarjen e të dhënave ne përqindje, ndërsa krahasimi u bë me anë të X^2-testit, testi student fisher, T-testi dhe koeficientit të probabilitetit (p).
Nga numri i përgjithshëm i pacientëve me sisteme dhëmbore protetikisht të sanuara (915), rezultatet tregojnë se përqindja e gjinisë mashkullore është 51% dhe përqindja e gjinisë femërore është 49%, ndërsa përqindja në maksillë është 58% dhe në mandibulë 42%.
Rezultatet për numrin e pajisjeve protetike prezente sipas kohëzgjatjes tregojnë se periudha kohore 6-10 vjeç ka përqindje më të lartë të pajisjeve protetike edhe atë 39.71% të rasteve, ndërsa përqindje më të ulët të pajisjeve protetike prezente kemi te grup-mosha 30 e më tepër vite me 1.15% të rasteve.
Në bazë të të dhënave të fituara paraklinike dhe klinike, nga studimi ynë mbi frekuencën e sanimit protetik të vargjeve dhëmbore permanente, si dhe në bazë të analizimit, përpunimit dhe prezantimit të tyre kemi arritur në këto përfundime:
1. Meshkujt dhe femrat e vlerësojnë shëndetin oral dhe tregojnë kujdes thuajse identik për sanimin protetik të vargjeve dhëmbore të tyre.
2. Sanimi protetik në përqindje më të lartë i vargut dhëmbor maksillarë tregon për rëndësinë që pacientët i kushtojnë estetikës.
3. Dallimet mes rezultateve të autorëve të ndryshëm sa u përket sistemeve dhëmbore të sanuara me punime protetike të pjesshme, sipas grup-moshave, mund të ju përshkruhen:
- variacioneve gjatë planifikimit të procesit studimor
- përfaqësimit tepër të madh të grup-moshave të caktuara.

Fjalët kyç: frekuenca, sanimi protetik, rezultate.

VLERËSIMI I HIGJENËS ORALE NË PACIENTË ME SËMUNDJE SISTEMIKE.

Skerda Bego, Prof.As Edit Xhajanka

Abstrakt

Qëllimi: Të vlerësojë higjenën orale në pacientët me sëmundje kronike, pasojat që shkaktohen në gojë pas përdorimit të medikamenteve për një kohë të gjatë si dhe të vlerësojë masat parandaluese për rritjen e kujdesit të gojës në këta pacientë.

Hyrja: Ndikimi i sëmundjeve sistemike në shëndetin e gojës. Është vërtetuar që pacientët që vuajnë nga sëmundje sistemike janë më të predispozuar të preken nga kariesi dhe sëmundje të ndryshme të gojës.

Zhvillimi: Janë marrë në studim 50 pacientë që vuajnë nga sëmundje të përgjithshme dhe 20 pacientë që nuk vuajnë nga ndonjë sëmundje. Janë krahasuar me njëri tjetrin. Është bërë indeksi për të parë se sa të prekur janë nga pllaka bakteriale dhe për sa kohë këta pacientë

janë kuruar me medikamente të ndryshme. Ka rezultuar se pacientët që vuajnë nga sëmundje të përgjitshme, qoftë kjo nga diabeti, sëmundje të zemrës etj, kanë një higjenë jo të mirë të gojës dhe janë të prekur shumë nga pllaka bakteriale, por dhe ju duhet një kohë e gjatë për t'u kuruar, kurse pacientët që nuk vuajnë nga ndonjë sëmundje, kanë një higjenë shumë të mirë të gojës dhe nuk janë të prekur nga pllaka bakteriale.

Konkluzionet: Arrijmë në përfundimin se të gjithë pacientët që vuajnë për një kohë të gjatë nga sëmundje sistemike, janë shumë të prekur nga kariesi, higjena e gojës në bazë të indeksit doli shumë e keqe. Medikamentet që ju jepen këtyre pacientëve ndikojnë shumë në uljen e sekretimit të salivës gjë kjo që sjell një nivel të lartë të kariesit. Për të pasur një përmirësim të higjenës tek këta pacientë duhet t'ju rekomandojmë një nxitës të salivës.

Fjalë kyç: higjena orale, sëmundje sistemike.

RIGJENERIMI KOCKOR

Dr. Uran Halimi1 PhD cand., Dr. Shqipe Krasniqi2
Specializant në Kirurgji Orale

Abstrakt

Hyrje: Rigjenerimi i drejtuar i kockave përdoret për të parandaluar resorbimin e kreshtës alveolare ose për të zgjeruar kreshtën alveolare. Sasia e kockës së rigjeneruar varet nga sasia e kockes artificiale dhe integrimi i saj. Llojet e ndryshme të kockav të vendosura nën membranë konsiderohen si standartë i artë sepse mundësojnë rigjenerimin kockor. Kjo sasi e kockës integrohet komplet dhe bëhet pjesë e kreshtës alveolare.

Rasti klinik: Një paciente femër, rreth 50 vjeç, me padhëmbësi totale e diagnostikuar me Sklerozë multiple e cila kishte mbajtur për një kohë të gjatë një protezë totale të lëvizshme, si pasojë e parehatisë, irritimit të vazhdueshëm, kërkon të heqë protezën dhe të bëjë një zgjidhje me punime fikse. Si pasojë e mungesës së kockës në nofullën e sipërme për vendosjen e implanteve, nevojitet rigjenerimi i kockave. Pacientja kishte marrë mendim me shkrim nga neurologu se i lejohet operacioni për rigjenerim kockor dhe vendosjen e implanteve, pavarësisht sklerozës multiple dhe nuk paraqet ndonjë kundërindikacion për këtë procedurë. Testet laboratorike hematologjike ishin normale. Analiza 3D tregoi mungesën e trashësisë dhe gjatësisë së kockës (rrafshin horizontal dhe vertikal) në maksillë.

Përfundimet: Pacientët me Sklerozë multiple zakonishtë kanë xerostomi, vështirësi në të foluri dhe në të ngrënë. Kontrolli i zvogëluar i muskujve rrit gjithashtu vështirësinë e pacientit për të mbajtë proteza mobile, andaj për këto arsye, implantet dentare ose protezat e mbështetura nga implanti shpesh rekomandohen si alternativa efektive, pasi ato reduktojnë ose eliminojnë këto sfida dhe ofrojnë një zgjidhje të përhershme, të natyrshme që mund të përmirësojë cilësinë e jetës.

Fjalët kyç: implantet dentare, skleroza multiple, rigjenerimi kockor, kocka artificiale, osteointegrimi

ÇRREGULLIMET DISFUNKSIONALE TË ATM-SË DHE LËVIZJET ATIPIKE.

MSc. Xhejna Matlija, Prof. Dr. Ruzhdie Qafmolla.

Abstrakt

Hyrje: Sistemi Stomatognatik preket nga patologji të ndryshme. Për më tepër shkaktarët e mundshëm dhe origjina e dhimbjes oro-faciale, si dhe të sëmundjes së artikulacionit temporo-mandibular janë të shumtë. Ai preket nga patologji të tilla si çrregullime disfunksionale të artikulacionit temporo-mandibular, çrregullimet e muskujve përtypës, etj. Klasifikime të ndyshme janë bërë për patologjitë e këtij aparati. Një ndër këto klasifikime është dhe ai i autorit Bell. Ai i klasifikon në çrregullime të kompleks-disk, sëmundjet inflamatore të vetë ATM-së ose papajtueshmëri strukturore e siperfaqeve të vetë artikulacionit etj.

Qëllimi i studimit. Studimi ynë ka për qëllim: Të përcaktojë se cilët janë shkaktarët më të rëndësishëm të lëvizjes atipike si edhe mënyrat më të përshtatshme të trajtimit.

Objektivat e Studimit:

1- Të diferencojmë pacientët me çrregullime të artikulacionit temporo-mandibular nga patologjitë e tjera të aparatit Stomatognatik.
2- Të zbatojmë ekzaminimin klinik për zbulimin e lëvizjes atipike.
3- Të zbatojmë terapinë e kombinuar fizike-protetike në trajtimin e pacientëve me lëvizje atipike.
4- Të vlerësojme rezultatet e trajtimit të kombinuar.

Materiali dhe Metoda. Gjatë një periudhe 6 mujore kontrolluam dhe trajtuam pranë Klinikës Stomatologjike Universitare 43 pacientë me dhimbje në ATM. Nga këto pacientë 23 Femra dhe 20 Meshkuj. Pacientët i ndamë në dy grupe: Grupi i parë, Grupi i trajtimit: Përfshin 22 pacientë (12 femra dhe 10 meshkuj); Grupi i dytë, Grupi i Kontrollit: Përfshin 21 pacientë (11 femra dhe 10 meshkuj). Përcaktuam skaktarët e lëvizjes atipke. Vendosëm diagnozën sipas protokollit të ekzaminimit klinik. Për trajtimin e pacientëve u përdor metoda Terapeutike-Protetike. Metoda Terapeutike-Fizike përfshin trajtimin medikamentoz / miorelaksantë, analgjezik. Metoda Fizike përfshin ushtrime të ndryshme të lëvizjes së gojës. Metoda Protetike: Përdorimi i shinave relaksuese. Kontrolluam dhe trajtuam pranë Klinikës Stomatologjike Universitare 43 pacientë me dhimbje në ATM.

Konkluzione:

1-Për të arritur rezultate të mira në trajtimin e lëvizjes atipike të mandibulës duhet të përcaktohen shkaktarët e saj.
2- Në trajtimin e kësaj patologjie rezultatet pozitive i morëm gjatë zbatimit të metodës së kombinuar terapeutike-fizike-protetike.
3- Në të gjitha situatat e testimit (gjatë muajit të parë. të dytë, të tretë, dhe pas gjashtë muajsh)

testi ka provuar rregulla të njëjta të trajtimit si për grupin e parë 81,82% dhe për grupin e dytë të kontrollit 95,24%.

FORMA E HARKUT ALVEOLO-DENTAR MAKSILAR E RËNDËSIA PROTETIKE E TIJ.

Xhoana Buzi, Prof. As. Edit Xhajanka

Abstrakt

Definicioni i harkut alveolo-dentar dhe kategorizimi konsiston në kufirin ndërmjet vestibulum oris dhe cavum oris propium. Faktori etnik dhe individual luan rol krucial në variacionet e formës. Konkretisht është marrë në shqyrtim variacioni anatomik i formës alveolo arcade maksilare.
Qëllimi: Evidentimi, frekuenca, rëndësia e variacioneve anatomike të formavë harkut alveolo-dentar të arkadës maksilare në subjekte shqiptare në sferën e protetikës.

Zhvillimi: Studimi u shtri në një diapason prej 190 rastesh nga të cilat 112 konsistojnë në pamje imazherike, 32 kafka, 14 modele allcie dhe 32 individë të grupmoshës 18-23 vjeç. Klasifikimi u përqëndrua në 4 forma të harkut maksilar (1/2 elipsi, π pi greke), 1/2 rrethi, V-je të përmbysur. Shpërndarja e rezultateve është 68.95%, 16.32%, 8.95%, 5.78% respektivisht për format e përmendura.

Konkluzioni: Importanca e formave mbështetet në 3 momente kyçe retensioni, mbështetja, stabiliteti. Nga aspekti protetik format më të favorshme janë ½ elipsi, ½ rrethi, π pi grek ndërsa V-ja e përmbysur kategorizohet më pak e favorshmja sepse retensioni, mbështetja dhe stabiliteti gjithashtu edhe estetika janë jooptimale ndryshe nga 3 format e mësiperme. Në mbështetje të këtij konstatimi V-ja e përmbysur ka frekuencën më të ulët ndërsa ajo e elipsit është me dominante pa shmangur praninë e formave të tjera rrethi dhe π.

Fjalë kyç: harku alveolo-dentar, variacionet anatomike.

MBINDJESHMËRIA E DENTINËS

Xhovana Myrtollari[1], Prof. Asc. Edit Xhajanka[2]

1- *Studente, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.*
2- *Prof. Asc në Fakultetin e Mjekësisë Dentare, Departamenti i Ortopedisë Stomatologjike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.*

Abstrakti

Hyrje: Në brendësi të dentinës ndodhen kanale dhe prezenca e tyre e bën atë të depërtueshme nga rrjedhja e lëngjeve. Nëse tubëzat dentinare ekspozohen ndaj stimujve të jashtëm ato shkaktojnë mbindjeshmëri të dentinës që karakterizohet nga dhimbje të forta dhe therëse. Mbindjeshmëria është një gjendje kronike e ndjeshmërisë së dhëmbëve e cila shpesh keq-diagnostikohet dhe keq-trajtohet dhe për këtë arsye profesionistët dentarë duhet t'i kenë në fokus të vazhdueshëm duke i edukuar dhe i ndihmuar për një menaxhim afatgjatë.

Qëllimi: Studimi ynë synon të theksojë faktorët, shkaqet, simptomat dhe menaxhimin e suksesshëm dhe afatgjatë të mbindjeshmërisë dentinare.

Materiale dhe metoda: Studimet mbi rastet klinike, literaturat shkencore dhe krahasuese janë konsideruar për realizimin e këtij studimi për të nxjerrë në pah faktorët etiologjikë dhe epidemiologjinë e mbindjeshmërisë dentinare.

Rezultatet: Rezultatet e trajtimit janë përpunuar në bazë të të dhënave klinike dhe shkencore. Në bazë të tyre kanë dalë përfundime nga Bordi Këshillues Kanadez mbi mënyrat e trajtimit me qëllim që të modifikohen faktorët e rrezikshëm dhe pacientët të ndryshojnë sjelljen e tyre.

Përfundimi: Pacientët me dhëmbë të mbindjeshëm kanë ngecur në një rreth vicioz, profesionistët dentarë duhet të merren me menaxhimin, edukimin e pacientëve dhe studimin e produkteve të cilat do të ndihmojnë këtë terapi. Kjo gjë do të rrisë pranimin e terapisë nga pacienti dhe do të sjellë rezultate në rritje, pa shkaktuar pakënaqësinë e pacientit.

Fjalët kyç: mbindjeshmëria dentinare, stimujt e jashtëm, acidet, tubëza, zbardhim.

LEZIONET ORALE NË SINDROMËN DOWN

Xhovana Saliasi[1], Prof. Asc. Edit Xhajanka[2]
[1]Studente, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
[2]Prof. Asc. Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Departamenti i Protetikës, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Njohja me karakteristikat e pacientëve me sindromën Down, patologjitë stomatologjike nga të cilat preken si dhe menaxhimi i tyre. Anomalitë skeletale, funksionale dhe malokluzionet ortodontike kërkojnë trajtime multidisiplinare. Rehabilitimi oral bazohet në veçoritë e tyre si: vonesë në zhvillimin mendor, skeletal e muskular, laksitet ligamentar dhe alterim i përgjigjes humanitare. Niveli I bashkëpunimit mjek – prind – pacient, fondamental për ruajtjen e shëndetit oral.

Qëllimi: Prevencioni dhe rehabilitimi stomatologjik, i domosdoshëm dhe jo i kundërindikuar në pacientët me sindromën Down.

Metoda dhe materiale: Studime statistikore, mjekësore, stomatologjike.

Konkluzione: Pacientët me sindromën Down frekuentojnë më shpesh strukturat stomatologjike, për shkak të prevalencës së lartë të patologjive orale. Trajtimi preventiv i kombinuar me atë ortopedik-ortodontik, është kyç, për ruajtjen e shëndetit oral dhe shmangien e patologjive sistemike.

Fjalët kyç: sindroma Down, patologji orale, trajtim stomatologjik.

DIXHITALIZIMI NË IMPLANTOLOGJINË MODERNE

Msc Ylli Menga, Prof Giovani Manes Gravina, Phd Dorian Kostandini, Phd Loreta Pojani , Dr Erjona Baci, Dr Brixhilda Neli.

Abstrakt
Teknologjia është duke u zhvilluar në mënyrë shumë të shpejtë dhe kjo gjë ka bërë të mundur që dhe dentistria të bëhet pjesë e këtij zhvillimi. Vitet e fundit më së shumti si

pasojë e përmirësimit të sistemeve kompjuterike dhe pajisjeve mjekësore dentare është bërë e mundur që cdo ndërhyrje të jetë më e shpejtë dhe më e saktë. Radiografia tridimensionale ka revolucionarizuar ekzaminimin e imazhit duke bërë të mundur një ekzaminim më të mirë të strukturave anatomike dhe arkitekturës tredimensionale të skeletit maksilofacial, nga ana tjetër përdorimi i ndihmës kompjuterike në dizenjim CAD dhe përdorimi i ndihmës kompjuterike në prodhim CAM kanë transformuar procesin e dizenjimit, prodhimit dhe shpërndarjes së shumë shërbimeve dentare. Për sa i përket implantologjisë si një nga specialitetet më të kërkuara dhe të studiuara në fushën e dentistrisë zhvillimi i teknologjisë ka sjell inovacione që deri para pak kohësh as që mund ti mendonim. Nëpërmjet programeve të specializuara sot kemi
mundësinë të bëjmë bashkë radiologjine dentare, kirurgjinë implantare dhe protetikën mbi implant duke bërë të mundur të kemi ndërhyrje shumë të sakta, minimale invasive dhe shumë estetike. Pra jemi në epokën e implantologjisë së guiduar nga protetika. Punimi ka si qëllim paraqitjen e rrugëtimit digital në implantologjinë e guiduar duke shpjeguar të gjitha etapat nëpërmjet rasteve klinike.

Fjalë kyç: Cad, Cam, kirurgji implantare.

ABSTRAKTET E FARMACISË

ABSTRACTS OF PHARMACY

ABSTRACTS OF PHARMACY/ ABSTRAKTET E FARMACISË

SFIDAT E ARKITEKTURËS SË PRAKTIKËS SË FARMACISË NË TRAJTIMIN E PANDEMISË COVID-19 – SHKËMBIMI I PËRVOJËS NGA PRAKTIKA FARMACEUTIKE NË KOSOVË

Arianit Jakupi[1,2], Arta Basha Jakupi[3]
[1]*Oda e Farmacistëve të Kosovës, Prishtinë, Kosovë.*
[2]*Institucioni i Arsimit të Lartë, Fakulteti i Farmacisë, Kolegji UBT, Prishtinë, Kosovë.*
[3]*Fakulteti i Arkitekturës, Universiteti - Hasan Prishtinë, Prishtinë, Kosovë.*

Abstrakt

Hyrje: Barnatoret komunitare ofrojnë një shërbim thelbësor të kujdesit shëndetësor, i cili është krijuar gjerësisht, duke përfshirë kontaktin parësor për pjesëtarët e komunitetit. Pandemia COVID-19 po vazhdon të zhvendosë rolet dhe shërbimet e barnatoreve për të përmbushur kërkesat e pacientëve. Vlera e rëndësishme e barnatoreve komunitare u theksua më shumë gjatë krizës pandemike kur ato duhej të merrnin masa të shumta paraprake për të shmangur infeksionin e kryqëzuar midis përdoruesve të hapësirës.

Objektivat: Qëllimi i këtij punimi ishte të eksplorojë gatishmërinë e barnatoreve të komunitetit në Kosovë për shpërthimin e COVID-19 në lidhje me modifikimet e dizajnit të barnatoreve duke siguruar menaxhim adekuat të barnave, informacion dhe shëndet publik.

Metodologjia: Metodat për këtë studim përfshijnë një anketë tërthortë të 104 barnatoreve të komunitetit që operojnë në shtatë komuna të Kosovës gjatë pandemisë. Mbledhja e të dhënave u krye nga data 1 tetor deri më 14 tetor 2021, duke përdorur pyetësorë të vetë-administruar online.

Rezultatet: Rezultatet tregojnë se komunitetet duhet të përgatiten më herët në lidhje me situatat emergjente dhe disa nga këto përgatitje mund të jenë gjithashtu pjesë e kërkesave të legjislacionit. Edhe pse pandemia ekspozoi shumë gabime në sistemin e barnatoreve komunitare të Kosovës, ajo gjithashtu ka zbuluar një mundësi unike për bashkëpunim dhe risi.

Konkluzione: Studimi përfundon me rekomandimin që dizajni arkitektonik i barnatoreve të pozicionohet si një ndërmjetës aktiv në luftën kundër COVID 19, me një mësim kritik që synon fleksibilitetin e hapësirës për të akomoduar situatat emergjente dhe krijimin e zonave alternative për përdorim.

Fjalë kyç: COVID-19, arkitektura e barnatoreve, barnatore komunitare.

FALSIFIKIMI I MEDIKAMENTEVE DHE SHITJA ONLINE E TYRE SI NJË NDËR SFIDAT GJATË PERIUDHËS SË PANDEMISË SË COVID-19

Artenca Shkeza Kraja

Abstrakt

Hyrje: Shqetësimi që lidhet me cilësinë e barnave është po aq i vjetër sa vetë barnat. Tregtia e barnave të falsifikuara është e përhapur ndërkombëtarisht dhe prek si vendet në zhvillim ashtu edhe vendet e zhvilluara. Gjatë dekadës së fundit fenomeni i falsifikimit të barnave është sjellë në vëmendjen e institucioneve dhe popullatës si kurrë më parë. Marrja e barnave të falsifikuara ose mungesa e trajtimit të duhur mund të dëmtojë shëndetin e një individi, duke filluar që nga reaksione të padëshiruara deri te toksiciteti dhe/ose anafilaksia. Barnat e falsifikuara mund të jenë gjithashtu kërcënuese për jetën. Këto sfida bëhen edhe më të rëndësishme me pandeminë COVID-19. Meqenëse gjatë kësaj periudhe nevojat për medikamente, teste dhe pajisje mbrojtëse për të luftuar pandeminë u rritën dhe këto kërkesa shpesh nuk mund të përmbusheshin në kohën e duhur, si dhe gjithashtu me kufizimet e furnizimeve mjekësore të lidhura me pandeminë u krijua një terren i përshtatshëm për falsifikimin dhe hedhjen në treg të produkteve farmaceutike dhe pajisjeve mjekësore të falsifikuara dhe nën standart. Tregtia në internet luan një rol kyç në shpërndarjen e produkteve farmaceutikëve të falsifikuara. Për shembull, u evidentuan reklamat e produkteve mjekësore të paligjshme të lidhura me COVID-19 në platformat e mediave sociale. Në bazë të studimeve rreth 50% e blerjeve të barnave të paligjshme bëhen përmes tregut online. Sanofi në vitin 2020 konkludoi se vetëm një e treta e të anketuarve janë të vetëdijshëm se ilaçet e rreme mund të gjenden në mjedisin online. Nga përdorimi i standardeve te tilla globale mund të merren përfitime të menjëhershme. Ato mund të përdoren nga pronarët e markave për ti mundësuar informacion klientëve dhe autoriteteve doganore, të cilët do të kenë akses në informacione që mund ti ndihmojnë ata për të identifikuar me saktësi medikamentet për qëllime të mëtejshme të vërtetimit të autenticitetit.

Fjalë kyç: Covid-19, farmaci, online.

STUDIM MBI PËRDORIMIN, PËRGATITJEN DHE VLERËSIMIN E PRODUKTEVE KOZMETIKE HALLALL NË BOTË DHE NË VENDIN TONË

Anxhela Kasapi[1], Brunilda Myftari[1]
[1] *Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*

Abstrakt

Qëllimi: Ky studim kërkon të pasqyrojë arritjet e deritanishme të produkteve kozmetike hallall në tregun botëror dhe ecurinë e përhapjes së tyre në vendin tonë.

Metodologjia. Hulumtimi, grumbullimi dhe përzgjedhja e literaturës shkencore botërore në lidhje me produktet Hallall. Përpilimi i një pyetësori të strukturuar në platformën Google mbi produktet kozmetike Hallall në vendin tonë dhe të dhënat u përpunuan statistikisht në Excel.

Rezultatet: Nga të dhënat teorike dhe ato të grumbulluara në terren mund të thuhet se ky studim mbi produktet kozmetike hallall është një subjekt i ri dhe me interes si për profesionistët e shëndetësisë, edhe për konsumatorin. Pyetësorit iu përgjigjën 112 pjesëmarrës në studim. Mosha mesatare e pjesëmarrësve në këtë studim varion nga 20 -50 vjeç. Ndërsa për sa i përket vendbanimit 108 persona (96.4 %) jetojnë në zona urbane dhe 4 (3.6 %) prej tyre jetojnë në zona rurale. Nga pyetësori rezultoi se me arsim të lartë kemi 107 individë (95.5 %) dhe me arsim të mesëm vetëm 5 individë (4.5 %). Duke marrë në shqyrtim përgjigjet për njohjen e produkteve hallall, vetëm 81 persona (72.3 %) e njohin fjalën Hallall, ndërsa 31 persona (27.7 %) nuk e njohin. Vetëm 4 persona (3.6 %) i njohin shumë mirë se çfarë janë dhe gati 54 (48.2%) nuk i njohin aspak produktet kozmetike hallall. Nga përgjigjet e dhëna në pyetësor kuptojmë se pjesa më e madhe e individëve të pyetur mendojnë se produktet kozmetike hallall mund të përdoren nga të gjithë, pavarësisht besimit të tyre.

Përfundime: Në dritën e rezultateve të marra nga ky studim mund të themi se produktet kozmetike hallall janë relativisht të reja në tregun kozmetik botëror e aq më tepër në atë shqiptar. Industria e prodhimit të produkteve kozmetike hallall është një ndërthurje e teknologjisë për prodhime cilësore kozmetike me parimet e fesë islame.

Kompanitë prodhuese janë të shpërndara në mbarë botën si Amara Cosmetics qysh nga 2010 në ShBA; Inika organics, 2006, Australi; Sampure minerals, 2009, Britani e Madhe; Malajzi, Kanada; Indonezi, Danimarkë, etj. Po kështu mund të thuhet se Produkte të kompanisë Daneze kanë hyrë edhe në Shqipëri si Shampo, maska, buzëkuqe, manikyre, ngjyra për tualetin e syve, lapsa etj.

Rekomandime: Zhvillimi i studimeve të mëtejshme për të zgjeruar njohuritë mbi këto produkte dhe teknologjitë e përdorura për përgatitjen e tyre.

Fjalë kyç: Kozmetikë, produkte hallall, teknologji, përdorim.

ROLI I TEKNOLOGJISE FARMACEUTIKE NE ZHVILLIMIN E TERAPIVE PER TRAJTIMIN E SËMUNDJES SË ALZHEIMERIT

Brunilda Myftari[1], Dea Cenomeri[1], Jola Habasllari[1]
[1]Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Abstrakt

Qëllimi: Ky punim synon të nxjerrë në pah rolin e teknologjisë në proceset e ndryshme për të formuluar dhe përgatitur barna të reja për trajtimin e Alzheimer-it.

Metodologjia: Hulumtimi dhe përmbledhja e të dhënave shkencore qysh nga historiku, epidemiologjia, kostoja, faktorët, simptomat si dhe detaje biologjike mbi këtë sëmundje, duke u fokusuar në trajtimet aktuale dhe terapitë e reja të mundshme për Alzheimer-in që aktualisht janë duke u testuar ose ende duke u studiuar.

Rezultatet: Bazuar në literaturën e studiuar rezulton se studimet mbi këtë sëmundje vazhdojnë në mënyrë intensive si nga pikëpamja epidemiologjike edhe ajo biologjike. Po kështu shkenca e teknologjisë farmaceutike po zhvillohet me hapa galopantë. Falë kombinimit të rezultatetve të këtyre studimeve nga fusha të ndryshme është arritur në përmirësimin e cilësisë së barnave që iu ofrohen pacientëve që vuajnë nga Alzheimeri. Këto barna të reja formulohen në mënyrë të tillë që të jenë jo vetëm efikase por edhe të përmirësojnë cilësinë e jetesës së këtyre pacientëve. Këtu vlen të përmenden barnat e përdorur si sisteme terapeutike transdermale apo ato bioteknologjike.

Përfundime: Studimet mbi sëmundjen e Alzheimerit vazhdojnë pasi faktorët dhe mekanizmi i zhvillimit të saj nuk është ende i qartë. Gjithësesi në këto përpjekje të vazhdueshme teknlogjia ka një rol të rënddësishëm në formulimin e barnave të reja Duke optimizuar përbërjen e bartësve dhe duke zgjedhur vektorët e duhur drejt objektivit, mund të merret një SShB shumëfunksionale, e cila mund të luajë një rol jetik në terapinë Alzheimer. Zhvillimi i SShB-ve me efikasitet të lartë terapeutik dhe efekte anësore minimale mund të kërkojë bashkëpunimin e ekspertëve nga fusha të ndryshme. Në këtë moment, përdorimi i DDS-ve të bazuara në nanoteknologji duket të jetë një drejtim premtues për terapinë e Alzheimer-it dhe kjo strategji do të zhvillohet më shumë në të ardhmen pasi do të sqarohet patofiziologjia e Alzheimer-it.

Fjalë kyç: demencë, Alzheimer, teknologji farmaceutike, forma farmaceutike, bioteknologji.

PËRSIATJE MBI FORMULIMIN DHE PËRGATITJEN E DISA SAPUNEVE PËR LËKURË TË THATË

Denis Meni[1], Brunilda Myftari[1]
[1]Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Sapunet janë produkte kozmetike, të cilat janë në kontakt me lëkurën në një frekuencë konsiderueshëm më të madhe sesa produktet e tjera kozmetike. Ndërthurja e produkteve të shumëllojta kozmetike, me llojet e ndryshme të lëkurës është një hallkë mjaft e rëndësishme në kujdesin e duhur për lëkurën. Lëkura e thatë, të paktën në një nga format e saj, është problem i rreth 60% të popullatës botërore. Sapunet për lëkurën e thatë janë pikërisht ato produkte, të cilat duhet të plotësojnë disa kushte specifike për t'u përdorur në këtë tip lëkure. Formulimi i sapuneve nga vajra bimore, organike dhe hipoalergjike, i bën këta sapune mjaft të pëlqyeshëm për lëkurën. Sasia e vogël e hidroksideve të metaleve apo karbonateve të tyre është çelësi kryesor i formimit të një sapuni të pranueshëm për lëkurën e thatë.

Qëllimi: Grumbullimi i të dhënave në lidhje me shtrirjen e problemit lëkurë e thatë, faktorët nxitës në popullatën shqiptare. Formulimi dhe stabiliteti i një sapuni natyral për lëkurë të

thatë, bazuar në shqyrtimin paraprak të punimeve dhe artikujve të kohëve të fundit, mbi përbërësit e ndryshëm të tyre duke u fokusuar tek ata bimorë.

Metodika: U zhvillua një pyetësor online në platformën Google Forms. Përpunimi statistikor i të dhënave u krye në mënyrë automatike nga kjo platformë. Pyetësori u shpërnda online në një numër të pacaktuar njerëzish. Në të morën pjesë 227 persona, farmacistë dhe konsumatorë. Përgatitja e sapunit u krye me metodën e sapunifikimit në të ftohtë. Për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme Covid-19 ishte e pamundur të vlerësohej qëndrueshmëria në kohë. Materialet e përdorura janë Vaj kokosi, Vaj ulliri, Aloe Vera, ekstrakt Calendula officinalis, enë qelqi, përzierës, peshore elektrike.

Rezultatet: Nga rezultatet e marra vihet re se sapunet e formuluar me lëndë ujësuese (hidratuese), në një bazë bimore, janë të përdorshëm në një përqindje të lartë të pjesmarrësve në këtë pyetësor.

Përfundime: Duke u bazuar në rezultatet e arritura në përfundim të këtij studimi konsiderohet e nevojshme informimi i personave që hasin lëkurë të thatë, mbi përdorimin e sapuneve mjekësore me përmbajtje të lartë të lëndëve hidratuese. U hodhën bazat teorike për formulimin e një sapuni me bazë bimore, por njëkohësisht të përshtatshëm edhe për lëkura të thata e të ndjeshme.

Fjalë kyç: Lëkurë e thatë, Sapun, Vaj kokosi, Vaj ulliri, Aloe Vera, Calendula officinalis, Sapunifikim në të ftohtë.

ROLI I VAJIT TË BIMËS CANABIS SATIVA L. NË PRODUKTET DERMOKOZMETIKE

Brunilda Myftari[1], Naola Egro[1], Megi Zeneli[1]
[1]*Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*

Abstrakt

Vaji i kanabisit është një ekstrakt bimor, për të cilin është provuar efekti dhe benefitet nga ana mjekësore dhe po bëhen studime në një sërë fushash, përfshirë këtu edhe në dermokozmetikë. Përdorimi i Kanabisit në fushën e bukurisë po merr përmasa të mëdha zhvillimi dhe përdorimi. Kozmetika aktualisht ka nisur projekte për të shfrytëzuar bimën, farat e saj dhe më pas vajin e pastër. Aktualisht kërkimet në këtë fushë kanë dalë në konkluzionin se bima duket se ka efekte mjaft pozitive për lëkurën. Aktualisht në SHBA, Kanada, Australi dhe disa vende të Evropës prodhimi i linjës kozmetike me bazë kanabis është i plotë. Bëhet fjalë për produkte të ndryshme si kremra, vajra, pastrues për lëkurën, locione të ndryshme për trupin dhe për kujdesin ndaj flokëve. Pas studimeve të shumta shkencore për të si dhe zbulimin e benefiteve të menjëhershme dhe efikase, ky vaj tashmë po merr një zhvillim edhe në vende të tjera. Shumë nga këto produkte janë të orientuara drejt përfitimeve anti-inflamatore, sepse receptori primar për vajin e kanabisit që gjendet në qelizat imune, ku ndodh inflamacioni. Shumë nga problemet e lëkurës janë të lidhura me inflamacionin, prandaj ka kaq shumë biseda për fuqinë e vajit të kanabisit në industrinë e bukurisë. Më shumë kërkime për vajin e kanabisit dhe përfitimet e tij janë të nevojshme, por

dermatologët theksojnë se aftësia e përbërësit për të rregulluar rritjen e qelizave, zvogëlimin e inflamacionit dhe stimulimin e yndyrave janë të rëndësishme për lëkurën dhe mund të ndihmojë në trajtimin e disa problemeve të lëkurës si lëkurë e thatë, psoriazë dhe ekzemë. Si përfundim duhet thënë që ky punim është i pari në Shqipëri në lidhje me përdorimin dermokozmetik të vajit të kanabisit. Së dyti në të përmblidhen në tërësinë e vet gjithë përdorimet e kësaj bime dhe efikasitetin e saj në dermokozmetikë bazuar në eksperiencën botërore. Së treti itë dhënat e tij krijojnë një bazë shkencore të dhënash për t'u përdorur në momentin që përdorimi i tij do të jetë i lejueshëm me ligj edhe në Shqipëri.

Fjalë kyç: Vaji i kanabisit, produkte dermokozmetike, inflamacion, trajtim lëkure.

VITILIGO, SHFAQJA E TIJ DHE ROLI FARMACISTIT NË KËTË SËMUNDJE

Brunilda Myftari[1], Ledjana Resulaj[1]
[1]Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Abstrakt

Vitiligo është një çrregullim i pigmentimit të lëkurës me etiologji të panjohur. Është një semundje jo vdekjeprurëse, jo e transmetueshme dhe e ndërmjetësuar nga imuniteti. Manifestohet në mënyrë asimptomatike me disa njolla të bardha në lëkurë të cilat nisin fillimisht në fytyrë rreth syve apo buzëve. Trajtimi i personave me vitiligo është i vështirë dhe i zgjatur sepse akoma nuk ka një trajtim të mirëfillt. Në këtë studim dua të tregojë impaktin apo rolin e farmacistit në këtë sëmundje duke e realizuar këtë me anën e një pyetësori të drejtuar farmacistëve.Gjithashtu kjo punë përfshin edhe një studim të zhvilluar në USA New York nga: "Vitiligo research foundation". Duke komunikuar me këtë organizatë bëm te mundur mbledhjen e të dhenave të këtij studimi i cili ka për qëllim të kontribuojë në hulumtimin dhe ekzaminimin e pacientëve me vitiligo. Me anën e 40 pyetjeve në formën e një pyetësori ky studim nxjerr në pah shumë të dhëna mbi mënyrën e shfaqjes, simptomat, kategoritë e individëve, shpenzimet për këtë sëmundje, etj. Kjo analizë ndihmon në njohjen më shumë të kësaj sëmundjeje si dhe bën më evidente rolin e farmacistit.

Fjalë kyç: vitiligo, trajtimi, farmacisti.

PËRDORIMI I SUPLEMENTEVE NË SHTATËZANI

Dajana Roshi, Antigona Shahinaj[1], Rexhina Leka[2]
[1]Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
[2]Fakulteti I Mjekësisë, Universiteti I Mjekësisë, Departamenti I Farmacisë, Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Suplementet prenatalë përbëjnë një gamë të gjerë të produkteve mjekësore ushqyese që përdorin nënat e ardhshme para, gjatë apo edhe pas shtatëzanisë për të siguruar vlerat e duhura ushqyese për vete dhe foshnjën e tyre. Zakonisht, janë të pasura me karbohidrate, proteina, yndyrna, vitamina dhe minerale që pasurojnë organizmin, por njëkohësisht i japin

ndihmë zhvillimit normal të fëmijës dhe shmangin shfaqjen e anomalive të ndryshme në rastet kur nëna ka defiçienca të theksuara të tyre nga kequshqyerja.

Qëllimi: Shqyrtimi mbi përdorimin e suplementeve plotësuese ushqyese në shtatëzani në botë dhe në vendin tonë.

Metodika: Kërkimi dhe përzgjedhja e studimeve shkencore si dhe shpërndarja e një pyetësori me temë "Përdorimi i vitaminave prenatale gjatë shtatëzanisë, rëndësia e acidit folik" drejtuar femrave me moshë të ndryshme që kanë lindur apo janë aktualisht shtatëzëna.

Rezultatet: Nga të dhënat e marra, u vu re se vetëm 2% nuk përdorin apo kanë përdorur këto suplemente dhe 98 % e tyre i kanë pëdorur ose janë duke i përdorur. Femrat i merrnin këto vitamina jo vetëm gjatë shtatëzanisë por edhe në hapat e parë të planifikimit familjar. Nga 79% e përdoruesëve, 49% përdornin acidin folik. Nga 94% e të anketuarave i kanë përdorur/përdorin suplementet prenatale me rekomandim të mjekut dhe vetëm 6% e tyre pa rekomandimin e mjekut.

Përfundime: Njohuritë lidhur me përdorimin dhe efektet e acidit folik apo edhe vetë shkalla e përdorimit në popullatë është e lartë dhe se roli i mjekut në këtë aspekt është mjaft i lartë si në përshkrimin e këtyre produkteve ashtu edhe në informimin e popullatës.

Fjalë kyç: Suplemente, acid folik, folate, vitamina prenatale**.**

SHURUPI I AMITRIPTILINËS, NJË SHEMBULL I GALENIKËS KLINIKE NË SHËRBIM TË PROBLEMATIKËS SË FORMË-DOZAVE

Delina Xhafaj[1], Sara Hamolli[2]
[1]Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Farmacisë.
[2]Student, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Farmacisë.

Abstrakt

Përgatitjet galenike janë thelbësore për kujdesin ndaj pacientit pasi mbyllet hendeku midis produkteve medicinale të licencuara të prodhuara nga industria dhe mungesës së opsioneve të mjekimit për grupe të caktuara pacientësh dhe pacientë individualë me kushte ose nevoja të veçanta mjekësore. Formë doza është një nga elementët kryesorë përgjatë marrjes së një bari por ka shume raste që një bar nuk ndodhet në treg me dozat apo formën farmaceutike të duhur. Një bar i tillë është dhe amitriptilina, një bar antidepresiv i cili përdoret nga grupmosha të ndryshme në doza të ndryshme, në patologji të ndryshme. Në bazë të diagnozave dhe në bazë të grupmoshave të ndryshme të pacientëve, bëhet i nevojshëm rregullimi i dozës. Qëllimi i punimit është të theksohet rëndësia e formulimit të amitriptilinës shurup, si dhe roli i farmacistit për përgatitjen e barit në formën e duhur farmaceutike. Përmes rishikimit të literaturës së përditësuar për amitriptilinën në rëndësinë e dozimit të saj si dhe realizimi i një formë doze shurup të amitriptilinës arrihet në rezultate të cilat tregojnë

kërkesën e përdorimit të amitriptilinës në formë doza të ndryshme nga ato të gjendura në treg si dhe kontributin që mund të japin farmacistët galenikë formulimit të përshtatshëm.

Fjalë kyç: amitriptilina, galenika farmaceutike, farmacisti.

GADISHMËRIA DHE ROLI I FARMACISTIT NË URGJENCA DHE FATKEQËSI KOMBËTARE

Delina Xhafaj[1], Vivian Haliti[2], Blerina Agushi[3], Eldisa Qoku[2], Dea Zaimi[2]
[1]Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Farmacisë.
[2]Studente, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Farmacisë.
[3]Farmacist, Universiteti i Shkencave Mjeksore 'Rezonanca', Prishtinë

Abstrakt

Urgjencat dhe katastrofat janë kërcënime të mëdha për sistemet e kujdesit shëndetësor. Sëmundja Coronavirus 2019 (COVID-19) është në qendër të një situate të fundit emergjente që kërkon vëmendje të shtuar nga profesionistët e kujdesit shëndetësor, përfshirë farmacistët. Ky studim ka për qëllim sigurimin e një pasqyre të roleve të farmacistëve në katastrofa dhe formulimin e një përkufizimi të roleve dhe detyrave të pritura përmes të cilave ata mund t'i kryejnë këto role siç duhet. Rolet e farmacistëve në parandalimin e emergjencave, përfshirë COVID-19, janë përqendruar në furnizimin dhe edukimin e barnave të sëmundjeve kronike. Lidhur me gatishmërinë e farmacistëve për të kryer rolet e tyre në katastrofa, ata ishin më të përqendruar në politikën shëndetësore dhe planifikimin shëndetësor të popullatës, veçanërisht në lidhje me pandeminë COVID-19. Kujdesi i drejtpërdrejtë për pacientët vazhdon të mbështesë pacientët përmes disponueshmërisë së barnave dhe rolet klinike të farmacistëve janë shembuj të përgjigjes së tyre ndaj katastrofave. Përveç kësaj, farmacistët kanë një rol të rëndësishëm në rikuperimin e katastrofave që përfshin disa aktivitete, të tilla si rimbushja e pajisjeve të urgjencës dhe rindërtimi i stokut normal.

Vazhdon debati lidhur me atë se cilat role "jotradicionale" të farmacistëve konsiderohen të përshtatshme nga profesionistë të tjerë të kujdesit shëndetësor. Ky ndryshim i roleve të farmacistëve drejt furnizimit farmaceutik dërgon mesazhin e gabuar të një spektri të ngushtë rolesh dhe inkurajon njerëzit të rikthehen në pamjen tradicionale, të njëanshme të farmacistëve. Në fakt, farmacistët mund të pretendojnë një grup të larmishëm rolesh, përfshirë koordinimin e politikave, integrimin e përgjigjes dhe menaxhimin e pacientit.

Fjalë kyç: farmacisti, emergjencë natyrore, katastrofë, roli i farmacistit.

PËRDORIMI I SUPLEMENTEVE TË MELATONINËS NË ÇRREGULLIMET E GJUMIT

Dorina Dervishi[1], Emi Panariti[2], Anjeza Rustemi[2], Sara Zavalani[1]
[1]Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti Europian i Tiranës, Shqipëri.
[2]Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University, Shqipëri.

Abstrakt

Melatonina është një përbërës natyror, një neuro- hormon i prodhuar kryesisht nga gjëndra pineale në gjitarë, por edhe nga zona të tjera, si trakti gastrointestinal. Sinteza e melatoninës është e lidhur me ritmin cirkadian gjum-zgjim dhe niveli i qarkullimit të saj, më i lartë gjatë natës dhe më i ulët gjatë ditës, mund të ndikojë në modelet e gjumit. Ajo është e përbërë në forma të ndryshme të dozimeve.

Melatonina është gjetur që përfshihet në aspekte të shumta të rregullimit biologjik dhe fiziologjik dhe gjithashtu ka potencialin për t'u përdorur në një numër të madh çrregullimesh. Efektshmëria e melatoninës është provuar për kushte të tilla si problemet e gjumit nga fluturimi nëpër zona të ndryshme kohore (jet lag), depresioni dhe pagjumësia. Disa studime tek fëmijët kanë treguar se, përdorimi i melatoninës në kombinim me ndërhyrjet e duhura të higjienës së gjumit mund të japë përfitime klinike për fëmijët me çrregullime të gjumit and çrregullime neuro-zhvillimore (NDDs) dhe potencialisht ngre mirëqenien e tyre.

Melatonina mund të shërbejë si agjent anti-inflamator, antioksidues e mund të modifikojë imunitetin, dhe efektshmëria e saj është demonstruar në modele të shumta eksperimentale sëmundjesh. Kështu, ajo është konsideruar si një trajtim potencial për Covid-19 dhe disa prova klinike janë bërë për të provuar efektshmërinë e saj.

Qëllimi i këtij studimi ishte të kryente një sondazh nëpërmjet një pyetësori për të hetuar përdorimet e melatoninës në Shqipëri. Pyetësori iu dërgua farmacistëve dhe në fazën e parë (Shkurt) të sondazhit u morën 101 përgjigje.

Shumica e tyre, 49%, u përgjigj se melatonina ishte përdorur kryesisht nga pacientët si një terapi plotësuese për çrregullimet e gjumit, në 3% prej të cilëve si terapi plotësuese gjatë Covid-19. 34 % deklaruan se pacientët e kanë përdorur atë si terapi të vetme për çrregullimet e gjumit dhe 17 % deklaruan se ishte përdorur për çrregullimet e gjumit në periudhën post Covid. Vetëm 10% e pjesëmarrësve deklaruan se ajo qe përshkruar nga mjekët. Melatonina ishte sugjeruar nga farmacistët ose specialistët më së shumti për gratë (92%). 62 % e farmacistëve deklaruan se i njëjti pacient ka kërkuar ripërtëritjen e terapisë për herë të dytë. Si përfundim, melatonina ka një shumëllojshmëri veprimesh dhe efekte biologjike, dhe efektet në çrregullimet e gjumit janë të njohura, por prova të limituara janë në dispozicion rreth përdorimit të melatoninës në Shqipëri kështu që duhen bërë hetime të mëtejshme.

Fjalë kyç: Melatonina, gjumi, çrregullimi, Covid-19.

PËRCAKTIMI I PAPASTËRTIVE NË BARNA, NJË HAP I RËNDËSISHËM PËR TË GARANTUAR CILËSINË

Lorena Karaj, Prof. Asoc. Ela Hoti

Abstrakt

Hyrja: Identifikimi i papastërtive është një proçes analitik kritik në prodhimin e barnave, qëllimi i të cilit është të zbardhë plotësisht strukturën kimike të papastërtisë të panjohur, të pranishme në lëndën aktive ose në produktet përfundimtare. Pasojat shëndetësore të papastërtive mund të jenë të rëndësishme për shkak të efekteve të tyre të mundshme teratogjenike, mutagjenike ose kancerogjene. Analiza e papastërtive në lëndët aktive dhe produktet përfundimtare, regjistrimi dhe raportimi i tyre është shpesh një sfidë për ekspertët shkencorë në prodhimin rutinë dhe kontrollin e cilësisë së barnave. Vendosja e specifikimeve për papastërtitë është një nga temat më kritike në zhvillimin e produkteve të reja. Ky studim fokusohet në teknikat e reja analitike që përdoren për të karakterizuar papastërtitë.

Metoda: Për këtë studimin u përzgjodhën artikuj të publikuar së fundmi në literaturën shkencore të cilët përshkruajnë metodat dhe teknikat e reja që përdoren në karakterizimin e papastërtive, duke synuar një përditësim të metodave të analizës farmaceutike për zbulimin dhe identifikimin e këtyre papastërtive, në laboratorë të specializuar. Janë hulumtuar çështje që kanë tërhequr vëmëndje kohët e fundit siç janë rastet e Ranitidinës dhe Valsartanit, të cilat vënë në dukje rëndësinë e një kuptimi të plotë të procesit të studimit të papastërtive kryesisht të grupit të N-Nitrozodimetilaminë (NDMA) dhe N-Nitrozodietilaminë NDEA. Metodat e reja të përdorura do të përshkruhen dhe krahasohen duke analizuar të mirat e të metat përkatëse.

Rezultatet: Rastet si Ranitidina dhe Valsartani tregojnë rëndësinë që ka njohja e thellë e procesit të studimt të papastërtive, kryesisht atyre të grupit të N-Nitrozodimetilaminës (NDMA) dhe N-Nitrozodietilaminës (NDEA). Ndër metodat e rekomanduara nga FDA për hetimin e NDMA në produkte farmaceutike është Kromatografia e Lëngët e kombinuar me Spektrometrinë e Masës me rezolucion të lartë (LC-HRMS). Kjo metodë duket të jetë më e përshtatshme për studimin e papastërtive të sipërpërmendura, krahasuar me metodën e Kromatografisë së Gaztë e kombinuar me Spektrometrinë e Masës (GC-MS) që përdoret zakonisht. Një ndër arsyet e përparësisë së metodës qëndron në temperaturat më të ulta që përdor LC-HRMS në krahasim me metodën e GC-MS.

Përfundime: Detektimi i papastërtive mbetet një sfidë e vazhdueshme në garantimin e cilësisë së barnave dhe sigurisë së tyre. Literatura bashkëkohore thekson rëndësinë e përdorimit të teknikave e pajisjeve moderne me performancë të lartë dhe metodave analitike të përshtatshme, të cilat mundësojnë detektimin dhe identifikimin e papastërtive në nivele gjurmë, për të përmbushur specifikimet e autoriteteve rregullatore.

Fjalë kyç: barna, ranitidina, valsartani.

COVID-19: CILI ËSHTË ROLI I RESVERATROL?

Elisa Domi[1], Malvina Hoxha[1], Bruno Zappacosta[1]
[1]Universiteti Katolik Zoja e Këshillit të Mirë, Fakulteti i Farmacisë, Departamenti i vlerësimit Kimiko-Toksikologjik dhe Farmakologjik i barnave, Tirana, Albania.

Abstrakt

Hyrje: Sindroma aktuale e rëndë akute respiratore coronavirus-19 (SARS-CoV-2) ose e njohur ndryshe COVID-19 ka sjellë ndryshime rrënjësore në sistemin shëndetësor global,

kështu që hartimi i një terapie efikase është nevojitur urgjentisht. Karakteristika kryesore që shfaqet në pacientët e prekur nga COVID-19 është çrregullimi i sistemit imunitar i cili si pasojë mund të çojë në mosfunksionim multiorganësh. Pasi përdorimi i integratorëve me bazë natyrale ka fituar interes në këtë drejtim, ne i kushtuam vëmendje resveratrolit, një molekule natyrale me strukturë polifenolike njohur për vetitë e tij antiiflamatore, antivirale dhe imunorregulluese.

Metoda: Burimet kryesore të përdorura për kërkimin tonë në literature kanë qenë PubMed dhe Scopus.

Rezultatet: Yang et al. kanë demonstruar aktivitetin antiviral të resveratrol në COVID-19 duke inhibuar infeksionin nga SARS-CoV-2 në kultura qelizore *in vitro*, duke sugjeruar kështu dhe efektin e tij potencial *in vivo*.

Ekzistojnë mekanizma të ndryshëm që shpjegojnë aktivitetin antiviral të resveratrol, duke përfshirë inhibimin e rrugëve p38MAPK dhe PI3K/AKT/mTOR, të përfshirë në inflamacion; stimulimin e sistemit imunitar; rregullimin e sistemit renin-angiotensin i cili modulon hyrjen e virusit në qeliza dhe aktivitetin antioksidant.

Përveç problemeve të frymëmarrjes, infeksioni COVID-19 çon në crregullim të homeostazës vaskulare. Falë efekteve të tij antitrombotike dhe antikoagulante, resveratrol përmirëson dhe këtë aspekt të patologjisë. Megjithatë, pavarësisht efekteve dobiprurëse, biodisponibiliteti oral i ulët mund të kufizojë përdorimin e tij.

Përfundimet: Si përfundim, resveratrol inhibon replikimin viral të SARS-CoV-2 dhe luan një rol të fuqishëm anti-inflamator. Pasi vepron duke përfshirë disa mekanizma, kemi një potencim të efektit të tij ndaj COVID-19. Megjithatë, profili i tij farmakokinetik nuk është më i miri, ndaj duhet të vendoset se si mund të përdoret duke optimizuar efektet e dobishme pa hasur efekte anësore. Mesazhet kryesore: Infeksioni SARS-CoV-2 është një emergjencë globale aktuale dhe midis qasjeve të ndryshme terapeutike përdorimi i integratoëve natyralë ka fituar interes. Resveratrol, falë efekteve të tij, duket të jetë një kandidat shumë premtues.

Fjalë kyç: resveratol, sindroma respiratore.

ANTIVIRALËT, DIZENJIMI DHE ZHVILLIMI I TYRE DERI NË PERIUDHËN COVID-19

Entela Haloci, Megi Selgjekaj, Megi Ndrecka

Abstrakt
Shfaqja e papritur e një virusi të quajtur SARS-CoV 2 dhe që u bë përgjegjës për përhapjen e sëmundjes tashmë të njohur COVID-19 në nivel pandemie, e gjeti fushën farmaceutike pa një bar apo terapi që mund të funksiononte në mënyrë efikase. Kjo solli nevojën e kërkimit dhe kryerjes së studimeve të shumta për të gjetur terapinë e duhur. Një ndër fokuset kryesore të studimeve u bënë komponimet antivirale. Të dhënat e mbledhura kanë drejtuar farmaceutikën drejt dizenjimit të komponimeve antivirale dukë marrë rezultate mjaft premtuese në lidhje me trajtimin e COVID-19.

Komuniteti shkencor në bashkëpunim me organizata private dhe publike të financimit, u organizuan për të gjetur agjentë efektivë antiviralë për të ndaluar krizën COVID-19. Përpjekjet mbresëlënëse në biologjinë molekulare, biokiminë dhe biologjinë strukturore të SARS-CoV-2 kanë dhënë me të vërtetë në një kohë shumë të shkurtër një sasi të madhe të të dhënave. Të dy analizat biokimike dhe strukturat 3D janë bërë publike për disa proteina virale dhe pritëse, ndërsa shqyrtimet fenotipike të sapo zhvilluara mund të lejojnë identifikimin e shpejtë të targeteve molekulare alternative dhe përbërjeve antivirale.
Qëllimi i këtij studimi ka të bëjë me dhënien e një tabloje të plotë të komponimeve antivirale që janë në studim për aktivitetin e tyre ndaj virusit SARS-CoV 2, targeteve kryesore të këtyre komponimeve, perspektivave të zhvillimit, dizenjimit e teknikave të përdorura për përftimin e barnave antivirale sa më efikase që mund të përdoren për COVID -19.
Metodologjia bazohet në Rishikim Literature i tipit konceptual dhe kritik, duke bërë një ekzaminim të detajuar të literaturës, në mënyrë që të krahasohen dhe vlerësohen një sërë këndvështrimesh mbi mundësinë e zhvillimit dhe dizenjimit të barnave të reja me aktivitet antiviral ndaj SARS-CoV 2 si dhe platformat apo programet më të përshtatshme për të realizuar këtë proces.

Fjalët kyç: antiviralët, covid-19, pandemi.

APLIKIMET AKTUALE DHE RISITË NË INFORMATIZIMIN E SISTEMIT FARMACEUTIK DHE MJEKËSOR SHQIPËTAR

Qerime Ruçi[1], Valbona Xhafa[1], Delina Troja[2], Ranela Ceci[3], Erjon Troja[1]
[1]Universiteti i Mjekësisë, Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri
[2]Zyra e Përfaqësimit ''Hoffmann-La Roche'', Tiranë, Shqipëri
[3]Agjensia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Evolucioni konstant i teknologjisë është një nga aspektet primare të shoqërisë dhe përditshmërisë sonë. Lidhja me teknologjitë dhe sistemet e informacionit është esenciale, shfaqet kudo, në çdo moment të jetës sonë private, publike, sociale dhe profesionale. Sistemet i informacionit kanë si qëllim primar mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e informacionit, duke kombinuar aktivitetin e individëve me pajisjet dhe teknologjitë që e mundësojnë atë.

Bazuar në rëndësinë e pohimeve të mësipërme, në fokusin tonë do të jetë rëndësia e sistemeve të informacionit në shëndetësi në përgjithësi dhe në farmaceutikë, në veçanti. Shëndetësia, për shkak të specifitetit të saj, si një sektor i lidhur drejtpërdrejti me jetën dhe mirëqënien e individit-pacient apo publikut të gjerë, kërkon përdorimin sa më korrekt dhe efektiv të "sistemeve të informacionit", duke mundësuar lehtësimin dhe përmirësimin e aktivitetit profesional të institucioneve, profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe maksimalizuar kujdesin ndaj pacientëve.

Për këtë qëllim, kjo tematikë prezantimi kërkon që shkurtimisht dhe në mënyrë të përmbledhur të preki realitetin historik dhe aktualitetin e viteve të fundit, të aplikimeve të sistemeve të informacionit në farmaceutikën shqiptare, si pjesë thelbësore e shëndetësisë tonë. Ndër pikat kryesore që do të trajtohen janë aspektet ligjore, objektivat e realizuar ose

të planifikuara për të ardhmen e afërt, risitë dhe përmirësimet e implementuara, rëndësinë e këtyre ndryshimeve si dhe ndikimin e pandemisë Covid-19.

Fjalë kyç: sistem informacioni, shëndetësia, aspekte ligjore, farmacist, Covid-19.

VETË-MJEKIMI NË MIGRENË

Dr. Eva Troja

Abstrakt

Qëllimi: Shpërndarja e migrenës dhe dhimbjeve të tjera të kokes, abuzimi me barna tek njerezit që kërkojnë vetë-mjekim dhe vlerësimin e migrenës me karakteristikat sociale, klinike dhe rrugën e kujdesit të ndjekur nga pacientët.

Metoda: Studimi u hartua në formën e një sondazhi të bazuar në intervistë duke përdorur pyetësorët e hartuar nga ekspertë dhe të bazuar në literaturë shkencore. Subjektet u përzgjodhën në bazë vullnetare dhe u ruajt anonimati i pyetësorit. Në këtë studim u përdor një screening migrene ID-MS për të klasifikuar pacientët në dy kategori. Nga 17 shkurti deri në 13 mars 2019 u intervistuan 185 persona në farmaci te mbare vendit.

Rezultatet: popullata e studimit përfshin më së shumti femra, njerëz me edukim të lartë dhe me një moshë mesatare 42 vjeç. Prevalenca e migrenës ishte 53% sinjifikante në femra dhe në personat me edukim të mesëm. Aferisht gjysma e personave që vuanin nga dhimbja e kokës dhe një e pesta e migrenozëve nuk e konsideronin kondicionin e tyre si një sëmundje. Brenda kampionit, shkalla e migrenës është më e lartë në edukimin e mesëm kurse dhimbjet e tjera të kokës janë dominante në edukimin e lartë. 40% e meshkujve migrenozë dhe 22% e femrave migrenoze përdorin triptanet. Anti-inflamatorët josteroide përdoren gjerësisht nga të dyja gjinitë për trajtimin e migrenës dhe dhimbjeve të tjera të kokës.

Përfundimet: Në studimin e dhimbjeve të kokës farmacisti ka rolin e vëzhguesit, këshilluesit dhe menaxhuesit të marrdhënies me pacientët që vuajnë nga dhimbja e kokës, veçanërisht për migrenozët e padignostikuar. Referimi i tyre tek mjeku i përgjithshëm dhe më pas tek specialisti mund të parandalojë fillimin e një migrene kronike dhe mbidozimin me barna.

Fjalë kyç: dhimbjet e kokës, migrenë, pyetësor, farmacisti.

PËRGATITJET GALENIKE: NJË SFIDË E FARMACISTIT SPITALOR PËR TË PLOTËSUAR NEVOJAT E PACIENTËVE PEDIATRIK

M.Sc.Fabiola Noga[1,3], Prof.Asoc. Ela Hoti[1], M.Sc. Enida Balla[2], M.Sc. Evis Lushaj[3]

[1]Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti Mjekësisë Tiranë
[2]Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë

[3]*Farmaci e rrjetit të hapur*

Abstrakt

Hyrje: Trajtimi farmakologjik i pacientëve pediatrik përbën një problem të vazhdueshëm për profesionistët e shëndetit, veçanërisht për farmacistin i cili duhet të përzgjedhi një formulim të përshtatshëm për një rast të caktuar. Në mungesë të një formulimi të gatshëm një rrugë e zgjedhur shpesh nga farmacistët spitalor është realizimi i përgatesave galenike të lëngëta, në fuqi dozimi të ndryshme, me eksipientë të padëmshëm për të plotësuar nevojat specifike të pacientëve pediatrik.

Qëllimi: Përcaktimi i barnave që kërkojnë përgatitje galenike për administrim në pacientët pediatrik në Qëndrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza". Zhvillimi i një përmbledhje gjithëpërfshirëse të formulimeve të lëngëta duke u nisur nga formë doza të miratuara dhe të disponueshme në treg.

Metoda: Studimi u realizua me të dhëna të identifikuara pas shqyrtimit të literaturës shkencore dhe teksteve të botuara që lidhen me fushën. Ky studim pasqyron vetëm formulat galenike të lëngëta të përgatitura nga forma doza të disponueshme në treg. Variablat specifikë të konsideruar përfshijnë përqendrimin, lëndët ndihmëse, të dhënat e stabilitetit dhe rekomandimet e ruajtjes.

Rezultate: Kjo përmbledhje gjithëpërfshirëse ofron një informacion të dobishëm për farmacistin spitalor në mënyrë që të lehtësoj proçesin e përzgjedhjes së një formule të përshtatshme për të plotësuar nevojat specifike të pacientëve pediatrik. Formulat e përzgjedhura adresojnë mungesën e disa prej barnave më të përshkruara në Qëndrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" që nuk janë të disponueshme në tregun tonë në formën ose fuqinë e kërkuar të dozimit.

Fjalë kyc: farmacist spitalor, përgatitje galenike, formulime të lëngëta, pacientë pediatrik.

ROLI I FARMACISTIT NË MENAXHIMIN E ASTMËS

Mr. Ph. Granit Çeku

Abstrakt

Hyrje: Astma bronkiale është një nga sëmundjet kronike jo të rralla, dhe një nga problemet e shpeshta të rrugëve të frymëmarrjes. Zhvillimi dhe shfaqja e astmës ndodhë si rrjedhojë e ndërveprimit të faktorëve të nikoqirit, ambientit, infeksioneve respiratore virale gjatë foshnjërisë dhe faktorëve të tjerë të mundshëm. Trajtimi farmakologjik tenton të mbajë nën kontroll klinik duke rralluar ose shmangur sulmet astmatike dhe përmirësuar e jetën e pacientit. Ky punim përmes shqyrtimit të literaturës moderne, dhe rezultateve të mbledhura synon të jap një pasqyrim rreth asaj, se cili është roli i farmacistit në menaxhimin e astmës. Hipoteza e parashtruar në këtë punim: Bashkëpunimi me farmacistin në menaxhimin e astmës është i domosdoshëm dhe ndikon pozitivisht tek pacienti.

Metodat: Për realizimin e këtij punimi është përdorur metodologji e kombinuar, që konsiston në rishikim të literaturës rreth rolit të farmacistit në menaxhimin e astmës, si dhe mbledhja e të dhënave përmes intervistave me pacientët dhe farmacistët në Kosovë, bazuar në këndvështrimin e tyre për rolin e farmacistit në menaxhimin e astmës. Pastaj të dhënat e mbledhura janë sistemuar dhe përpunuar në programin SPSS, dhe janë nxjerrë rezultatet e kërkuara.

Rezultatet: Bazuar në të dhënat e rishikimit të literaturës ekzistuese bashkëkohore, ne mund të pohojmë se roli tradicional i farmacistit mund të zgjerohet edhe më tutje në të ardhmen, në një sërë shërbimesh tjera, rreth menaxhimit sa më të mirë të astmës. Nga të dhënat e mbledhura rreth pyetjeve drejtuar farmacistëve dhe pacientëve shohim se ata në 70% të rasteve, pohojnë se farmacistët mund të japin edhe ndihmesë tjetër, përveç këshillave rreth barnave. Hipoteza e parashtruar pranohet ngase bashkëpunimi me farmacistin deklarohet i domosdoshëm, nga të dy palët.

Përfundime: Bazuar në rezultatet e punimit mund të themi se roli i farmacistit në menaxhimin e astmës, është shumë i rëndësishëm, qoftë në masat jofarmakologjike e sidomos nëato farmakologjike. Rekomandojmë që në të ardhmen të rritet edhe më tutje vetëdija dhe roli i farmacistit në menaxhimin e astmës, duke ndikuar kështu direkt në përmirësimin e shëndetit dhe cilësisë së jetës të pacientëve.

Fjalë kyç: farmacist, astma, menaxhim, pacient.

SIMPTOMAT E STRESIT, ANKTHIT DHE DEPRESIONIT NË PACIENTËT ME AKNE VULGARIS

MSc. Helena Hazizaj[1], Alma Hazizaj[2]
[1]*Agjensia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.*
[2]*Mjekësia Ligjore*

Abstrakt

Hyrje: Akne vulgaris është një inflamacion kronik i aparatit pilosebac, tek adoleshentët dhe adultët e rinj. Është çrregullimi më i zakonshëm që trajtohet nga dermatologët, i cili mund të prekë 85 % të popullsisë. Mund të shfaqet në çdo periudhë të jetës, por kryesisht prek moshat 12 deri 24 vjeç. Studime të ndryshme, kanë treguar se kjo sëmundje është në gjendje të shkaktojë alternime psiko-sociale, të lidhura me turpin, ankthin , stresin, deprivimin social.

Metoda: U përpilua një kartelë tip nëpërmjet së cilës u mundësua mbledhja e të dhënave për variablat e pavarur si: karakteristikat klinike të aknes tek pacientët (graviteti, kohëzgjatja dhe lokalizimi) dhe faktorët sociodemografike (gjinia, mosha, punësimi, gjendja civile dhe arsimimi). Më tej u bë vlerësimi me një pyetësor të validuar DASS 42 (Depression, Anxiety & Stress Scale), si instrument për mbledhjen e të dhënave për variablat e varura.

Rezultate: Nëpërmjet përdorimit te DASS 42, studimi tregoi se akne vulgaris ka një ndikim të rëndësishëm emocional tek pacientët që vuajnë prej saj. Pacientët me akne kanë

respektivisht 2.8, 3.2 dhe 2.26 herë më shumë gjasa për të shfaqur simptomat si stres, ankth dhe depresion klinik kundrejt grupeve të kontrollit, duke treguar se janë të riskuar për të shfaqur probleme serioze në të ardhmen.

Rekomandime: Menaxhimi i çrregullimeve psiko-dermatologjike kërkon një bashkëpunim efektiv ndërmjet mjekëve dermatologë, mjekut të familjes dhe profesionistëve të shëndetit mendor, për të arritur rezultat pozitiv tek pacientët. Ky studim thekson rendësinë e vlerësimit të duhur të pasojave jodermatologjike të aknes, e cila lejon mjekun për të trajtuar pacientin jo vetëm në sëmundjen e lekurës.

Fjalë kyç: akne vulgaris, stres, ankth, depresion klinik.

NDIKIMI I PANDEMISË SARS COVID-19 NË SHËRBIMIN FARMACEUTIK NË SHQIPËRI

Irsida Mehmeti[1], Silvi Bozo[2], Eftiola Pojani[3]
[1]Departamenti i Shkencave Farmaceutike, Fakulteti i Farmacisë, Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Tiranë, Shqipëri.
[2]Departamenti i Teknologjive Kimiko - Farmaceutike dhe Biomolekulare, Fakulteti i Farmacisë, Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Tiranë, Shqipëri.
[3]Departamenti i Vlerësimit Kimiko-Toksikologjik dhe Farmakologjik të Barnave, Fakulteti i Farmacisë, Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt

Hyrje: Asnjë sëmundje në historinë e kohëve të fundit sa COVID-19 nuk nënvizoi vlerën dhe rolin e profesionit të farmacistit si një profesionist mjekësor i vijës së parë. Rezultatet nga studimet e mëparshme tregojnë se farmacistët kanë dhënë një kontribut jetik në kontrollin e përhapjes së pandemisë COVID-19.

Objektivat: Objektivat kryesore të studimit janë vlerësimi i faktorëve që ndikojnë në cilësinë e shërbimit farmaceutik në Shqipëri. Prandaj, qëllimi i këtij studimi ishte kryerja e një sondazhi mbarëkombëtar për të vlerësuar njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e farmacistëve të komunitetit në Shqipëri si dhe ndryshimet kritike në tregun farmaceutik shqiptar gjatë pandemisë Covid-19 nga këndvështrimi i farmacistëve të komunitetit**.**

Materiale dhe metoda: Ky është një studim i kryqëzuar, në të cilin është përdorur një pyetësor online që synon farmacistët shqiptarë gjatë vitit 2021. Sondazhi u zhvillua nga një grup studiuesish dhe akademikësh pas një rishikimi të zgjeruar dhe të saktë të literaturës duke ndjekur udhëzimet e Komunikimit për Rrezikun e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH).

Rezultate: Në studim morën pjesë gjithësej 176 farmacistë (86,4% femra dhe 14,6% meshkuj). 51,7% e tyre u kategorizuan në grupmoshën 30-39 vjeç. Vetëm 7,8% e tyre kishin mbi 20 vjet përvojë pune. 75% e të anketuarve ishin nga Tirana. 72,3% e intervistuesve kishin

nevojë për më shumë trajnime për pandeminë Covid-19. 26% e të anketuarve deklaruan se kanë zgjatur orarin e punës gjatë pandemisë.

Konkluzione: SARS-COVID-19 ka sfiduar sistemet shëndetësore deri në limitet e tyre. Në këtë kohë pasigurie dhe emergjence, farmacistët në Shqipëri kanë treguar forcën, profesionalitetin dhe përkushtimin e tyre për të ofruar shërbimin farmaceutik në nivelin më të lartë.

Fjalë kyç: farmacistët**,** pandemia**,** Covid-19**,** shërbimi farmaceutik**,** njohuritë**,** perceptimet, praktikat.

KËNDVËSHTRIMI I FARMACISTËVE NË SHQIPËRI NDAJ "PËRSHKRIMI FARMACEUTIK"

MSc. Josiana Selami[1], MSc. Sindi Huti[2], Prof. Dr. Suela Këlliçi[3]
[1]SEMA Consulting Albania
[2]Farmaciste
[3]Universiteti i Mjekësisë Tiranë

Hyrje: Farmacistët në shumë vende të zhvilluara zotërojnë autoritet përshkrues, i cili njihet me termin "Përshkrimi farmaceutik" dhe bën pjesë në modelet e përshkrimit jomjekësor (*Non-Medical Prescription - NMP*). Megjithatë, kjo praktikë konsiderohet një koncept i ri për shumë vende të tjera në botë. Në Shqipëri, farmacistët nuk kanë autoritet përshkrues dhe nuk është kryer më parë një studim për të parë këndvështrimin e tyre ndaj tij.

Objektivi: Objektivi i këtij studimi është përcaktimi i këndvështrimeve të farmacistëve (përfshirë dhe studentët e farmacisë) mbi përshkrimin farmaceutik dhe identifikimi i barrierave apo/dhe mundësive për implementimin në Shqipëri.

Metodat: Si metodë studimi është përdorur anketimi i studentëve dhe farmacistëve nëpërmjet një pyetësori të zhvilluar *online*, i cili përmbante pyetje mbi njohuritë rreth përshkrimit farmaceutik dhe identifikonte gatishmërinë e të anketuarëve për të ndërmarrë rol përshkrues në të ardhmen.

Rezultatet*:* Shumica e të anketuarëve (76% e studentëve dhe 75% e farmacistëve) kishin njohuri mbi përshkrimin farmaceutik dhe mbi 85% e shihnin veten si farmacist përshkrues në të ardhmen. Nga ana tjetër, 69% e studentëve dhe 75% e farmacistëve ranë dakord se duhet të kryenin trajnime, kryesisht me fokus vlerësimin e pacientit dhe lëndë të tjera klinike. Mbi 90% e të anketuarëve shprehën se ishin dakord për hartimin e një kornize ligjore që do të përcaktonte detyrimet dhe kriteret minimale për ushtrimin e rolit përshkrues nga farmacistët.

Konkluzione: Shumica e farmacistëve të rinj dhe studentëve ishin entuziast për implementimin e përshkrimit farmaceutik në Shqipëri. Megjithatë, konsiderohet i nevojshëm hartimi i një ligji dhe ofrimi i trajnimeve të akredituara nga institucionet akademike.

Fjalë kyç: Përshkrim farmaceutik, Farmacist, Studentët e Farmacisë, Pyetësor, Shqipëri.

FARMAKOVIGJILENCA NDIKIMI I SAJ NË SHËNDETIN E NJERIUT. VAKSINAT KUNDËR COVID-19

MSc. Jovisa Marku, MSc. Dajana Roshi

Abstrakt

Hyrje: Ky referim shpjegon rëndësinë e Farmakovigjilences në Shqipëri, anëtarësimi i saj në UPPSALA MONITORING CENTER si anëtare e 142-të me drejta të plota në WHO Program for International Drug Monitoring. Pjesëmarrjen e saj në javën sensibilizuese #Medsafetyweek# të raportimeve të vaksinave së bashku me 67 agjenci të tjera të botës. Programi VigiFlow dhe hedhja e të dhenave të raportimeve lokale e pastaj analizimi i tyre në VIGILYZE.

Sipas PRAC në lidhje me vaksinat COVID 19 është vlerësuar se:

-ka raporte periodike të mbledhura në lidhje me gjakderdhjen e rëndë menstruale dhe amenohrrehea pas marrjes së vaksinave COMIRNATY dhe SPINEVAX COVID-19.

-raportet periodike të mbledhura mbi rrezikun e njohur të miokarditit dhe perikarditit pas vaksinimit me vaksinat COMIRNATY dhe SPINEVAX COVID-19.

Metodat: Nga funksionimi i sistemit të Farmakovigjilencës në Shqipëri kemi: 1-promovimin e Farmakovigjilencës, 2-identifikimin e sinjaleve, 3-vlerësimin e riskut dhe opsionet për menaxhimin e riskut. Rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për të raportuar efektet e padëshiruara gjë që çon në përmirësimin e standartit të jetesës. Kur mund të themi se një bar ka efekte të padëshiruara për të plotësuar një formular raportimi.

Përfundimet: Sensibilizim i profesionistëve të shëndetit dhe pacientëve në raportimin e efekteve të padëshiruara të barnave dhe vaksinave në mënyrë që të kemi një rritje të sigurisë së barnave e vaksinave.

Fjalët kyç: farmakovigjilencë, efekt i padëshiruar, formulari i raportimit, PSUR, VIGIFLOW, VIGILIZE, UMC.

PROVAT KLINIKE NË TUMORET E RRALLA GJINEKOLOGJIKE

Prof. Asoc. Klejda Harasani[1], Amelja Lala[2], Silvia Semanjaku[2]
[1]*Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Farmacisë*
[2]*Studente, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Farmacisë*

Abstrakt

Hyrje: Tumoret e rralla gjinekologjike përbëjnë rreth 50% të gjithë tumoreve gjinekologjike, pavarësisht incidencës së ulët të secilit nëntip (≤6 për 100.000 gra). Përfaqësimi i ulët i pacientëve me tumore të rralla gjinekologjike në prova klinike si dhe interesi i pakët i kompanive farmaceutike zvogëlojnë mundësitë e zhvillimit të terapive të reja për këto patologji.

Objektivi: Objektivi i studimit tonë është rishikimi sistematik i literaturës dhe provave klinike rreth tumoreve të rralla gjinekologjike, duke u fokusuar veçanërisht në trajtimin terapeutik të tyre.

Metoda: Për rishikimin sistematik do të ndiqen udhëzimet e PRISMA 2020 (Preferred Reporting Items for Systematic Reviews and Meta-Analyses). Do të konsultohen disa baza të dhënash për provat klinike dhe artikujt e publikuar në PubMed.

Rezultatet: Rezultatet paraprake tregojnë se provat klinike të randomizuara në fushën e tumoreve të rralla gjinekologjike janë të pakta. Shumë lloje tumoresh të rralla gjinekologjike përjashtohen nga provat klinike ose studiohen së bashku me tumore të tjera nga i njëjti organ por të ndryshme në nivel molekular. Duhet të nxitet më tej bashkëpunimi midis grupeve kërkimore ndërkombëtare dhe palëve të interesit me qëllimin përfundimtar zhvillimin e trajtimeve më të mira e të personalizuara për tumoret e rralla gjinekologjike. Krijimi i një përmbledhjeje referencë për provat klinike (të finalizuara dhe në vazhdim) do të ndihmojë në hartimin e strategjive për harmonizimin e provave të reja klinike për këto lloje tumoresh.

Fjalë kyç: tumore të rralla gjinekologjike, prova klinike, trajtim terapeutik.

MONITORIMI TERAPEUTIK I BARNAVE NË PACIENTËT E SHTRUAR NË SPITAL

Prof. Asoc. Klejda Harasani[1], Lediona Dautaj[2]
[1]*Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Farmacisë*
[2]*Studente, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Farmacisë*

Abstrakt

Hyrje: Ndryshimet e farmakokinetikës dhe farmakodinamikës së barnave në popullata të ndryshme pacientësh spitalorë vështirësojnë arritjen e rezultateve të dëshiruara terapeutike. Antibakterialët janë ndër barnat më të përdorur në mjediset spitalore dhe monitorimi terapeutik i tyre është një nga strategjitë e sugjeruara për optimizimin e trajtimit.

Objektivi: Objektivi i studimit tonë është përpilimi i një sinteze të rishikimeve sistematike të botuara, e njohur dhe me termin "umbrella review" në lidhje me monitorimin terapeutik të barnave antibakteriale.

Metoda: Ndoqëm udhëzuesin Aromataris për sintezën e rishikimeve sistematike si dhe versionin më të fundit të PRISMA 2020. Databazat e kërkimit ishin PubMed dhe Google Scholar. U përfshinë studimet rishikime sistematike (me ose pa meta-analizë) që raportonin për pacientë të trajtuar me antibakterialë në spital ku nivelet plazmatike të tyre ishin të disponueshme. Nuk u aplikuan kritere përjashtuese për moshën apo gjininë e pacientëve.

Rezultatet: U përfshinë mbi 200 artikuj në analizën fillestare dhe antibakterialët që monitorohen më shpesh në pacientët e shtruar në spital rezultuan aminoglikozidikët, vankomicina, beta-laktamikët (penicilinat e cefalosporinat), linezolidi dhe teikoplanina. Monitorimi terapeutik përbën një metodë të vlefshme për rregullimin e regjimit të dozimit sipas karakteristikave individuale të pacientëve, duke rritur efektshmërinë e antibakterialëve dhe pakësuar toksicitetin e tyre.

Kjo sintezë e rishikimeve sistematike jep një pasqyrë të përgjithshme të gjetjeve mbi monitorimin terapeutik të barnave antibakteriale në pacientët e shtruar në spital dhe jep rekomandime rreth aplikimit në praktikën klinike për të përmirësuar rezultatet terapeutike të këtyre pacientëve.

Fjalë kyç: monitorim terapeutik, antibakterialë, pacientë spitalorë.

PERCEPTIMI I FARMACISTËVE DHE PACIENTËVE PËR REDUKTIMIN APO ELEMINIMIN E NJË BARI OSE NJË GRUPI BARNASH (DEPRESCRIBING) NË PËRSHKRIME PËR DIAGNOZA TË NDRYSHME

Msc. Ledi Shehi[1], Dr. Shk. Klejda Harasani[1,2]
[1]Farmaci.al, Tiranë, Shqipëri
[2]Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Departamenti i Farmacisë, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Hyrje: Polifarmacia është një dukuri që haset shpesh dhe që ka marrë vëmendje të madhe vitet e fundit në fushën farmaceutike. 80% e pacientëve që vuajnë nga sëmundje të ndryshme akute apo kronike mjekohennga një sërë barnash në të njëjtën kohë, të cilat shpeshherë nuk janë të nevojshme. Reduktimi i një bari apo i një grupi barnash, për arsye të mungesës së efektit apo shkaktimit të dëmit në shëndetin e pacientit, njihet me termin ´deprescribing´.

Qëllimi: Ky studim ka për qëllim të analizojë aftësitë dhe përqasjet e stafit mjekësor, në vecanti të farmacistëve, si dhe vetë pacientëve, për të reduktuar përdorimin e medikamenteve specifike.

Metodologjia: Gjatë studimit janë analizuar 50 receta të përshkruara nga mjekë të specialiteteve të ndryshme për pacientë me diagnoza specifike. Është përpiluar një pyetësor drejtuar 50 farmacistëve në Shqipëri dhe një tjetër drejtuar 30 pacientëve me qëllim vlerësimin e përqasjes dhe problematikave që hasin këto dy grupe në aplikimin e

´deprescribing´ në vendin tonë. Janë përfshirë shembuj nga barnat kardiovaskulare dhe ato të përdorura në trajtimin e virozave stinore, infeksioneve dhe artritit.

Rezultate: 96% e farmacistëve pjesëmarrës në pyetësor ushtronin profesionin në farmaci të rrjetit të hapur. Farmacistët pohuan se ishin shumë të kufizuar për të realizuar një proces të tillë për një sërë shkaqesh që lidhen me me shumti me bashkepunimin e dobet mes farmacisteve dhe mjekeve dhe besimin e palëkundur e pacientëve te receta mjekësore. Nga ana tjetër, pacientët që plotësuan pyetësorin me moshë mesatare 60 vjec u shprehën pozitivë dhe shumë të gatshëm për reduktimin e medikamenteve. Gjithashtu, pothuajse të gjithë shfaqin pasiguri për eleminimin e medikamenteve nga ana e tyre edhe pse iu jepet informacioni i duhur për secilin bar që përdorin.

Konkluzione: Rezultatet tona treguan që farmacistët ngurojnë të reduktojnë barna, duke shprehur kërkesën për një bashkëpunim më të ngushtë me pacientët dhe mjekët në këtë drejtim. Për sa i përket pacientëve, ´deprescribing´ perceptohet si një proces me shumë interes, por që pranohet të realizohet vetëm nga profesionistë të shëndetit.

Fjalët kyç: polifarmaci, deprescribing, mjek, farmacist, pacient.

STUDIM PËR IDENTIFIKIMIN E PËRGATESAVE PEDIATRIKE QË MUNGOJNË NË RECEPTURË DHE MUND TË PËRGATITEN NGA FARMACISTI

Prof. Dr. Ledjan Malaj, MSc. Ani Tusha, MSc. Alkida Rraja
Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë (AL)
Akademia e Farmacisë "Eureka", Tiranë, (AL)
CFO Pharma, Tiranë, (AL)

Abstrakt

Galenika klinike pediatrike është një nga drejtimet kryesore të kërkimit tonë në fushën e përgatitjeve galenike. Në departamentin tonë janë sjellë studime të shpeshta në lidhje me këtë tematikë dhe në laboratorin tonë shkencor janë bërë formulime e përgatitje të shumta për pacientët e vegjël. Galenika klinike pediatrike është një instrument i vlefshëm për të garantuar një terapi të personalizuar për pacientin e vogël.

Formula e përgatitjes galenike pediatrike duhet të jetë e përshtatur për pacientin dhe në të njëjtën kohë duhet të garantojë cilësinë, sigurinë dhe efikasitetin, një shije të mirë dhe një periudhë të arsyeshme vlefshmërie. Gjithashtu, duhet të lehtësojë të rriturin gjatë administrimit te fëmija, pa harruar kompliancën e pacientit të vogël dhe të lejojë administrimin e dozës së duhur, pa shkaktuar gabime madhore në ambientin shtëpiak.

Studimi ynë ka për qëllim të sjellë, nëpërmjet hulumtimit të literaturës, formulime dhe lëndë të para të përdorura me sukses në galenikën klinike pediatrike. Gjithashtu, në këtë studim është sjellë edhe ndikimi i këtyre përgatesave në suksesin dhe aderencën terapeutike të pacientëve.

Për realizimin e punimit është kryer një studim retrospektiv i artikujve shkencorë të viteve të fundit në lidhje me këtë temë dhe një hulumtim në tregun farmaceutik në Shqipëri.

Fjalë kyç: galenikë klinike pediatrike, terapi e personalizuar, cilësi.

NDIKIMI I DEGRADIMIT TË SHIKIMIT NË ADERENCËN TERAPEUTIKE NË MOSHËN E TRETË

Prof. Dr. Ledjan Malaj[1], MSc. Sindi Huti[2], MSc. Josiana Selami[3]
[1]Shef i Departamentit të Farmacisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
[2]Farmaciste
[3]SEMA Consulting Albania

Abstrakt

Respektimi i regjimit të mjekimit është i vështirë për të gjithë pacientët dhe veçanërisht sfidues për të moshuarit. Kjo popullatë pacientësh ka vështirësi në leximin e udhëzimeve të mjekimit dhe mund të marrë mjekim të gabuar ose doza të pasakta të barnave, duke rezultuar në pasoja të rënda, duke përfshirë mbidozimin ose trajtimin e pamjaftueshëm të gjendjeve shëndetësore. Pavarësisht numrit në rritje të kësaj grupmoshe, masat e marra për lehtësimin e vështirësive që ato mund të hasin janë pothuajse minimale. Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë ndikimin që ka degradimi i shikimit në aderencën terapeutike në moshat e treta. Kjo u arrit përmes një pyetësori i cili synonte të identifikonte problemet kryesore me të cilat përplasej më shpesh popullata geriatrike gjatë marrjes së medikamenteve dhe nëse e kishin ndërprerë mjekimin pa konsultën e mjekut, duke specifikuar arsyet që i kishin shtyrë drejt këtij vendimi. Rezultatet treguan se leximi i fletëpalosjeses së barnave, udhëzimeve të farmacistit dhe dallimi i tabletave nga njëra-tjetra për shkak të ngjyrës së përafërt, përbënin problematikat bazë të lidhura drejtpërdrejt me shikimin. Ndërkohë që harresa dhe shfaqja e efekteve anësore ishin shkaktarët kryesorë për ndërprerjen e regjimit të mjekimit. Theksojmë se ky studim kryhet për herë të parë në Shqipëri. Si rrjedhojë rezultatet nuk priteshin të ishin optimale, pasi trajtohet një çështje e cila ka vend për përmirësime. Megjithatë falë përgjigjeve të marra nga intervistat dhe studimi i literaturës arritëm të paraqesim disa alternativa të cilat synojnë të lehtësojnë vështirësitë dhe përmirësojnë aderencën.

Fjalë kyç: aderencë terapeutike, të moshuar, dëmtim i shikimit, informimi i pacientit, ndërprerja e mjekimit.

MENAXHIMI I LABORATORIT GALENIK NË FUNKSION TË RRITJES SË PERFORMANCËS SË FARMACISË

Prof. Ledjan Malaj[1,2], Zehadin Gashi[3], MSc. Yllka Omuri[1], Drilon Gashi[4]
[1]Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë (AL)
[2]Akademia e Farmacisë "Eureka", Tiranë, (AL)
[3]Alma Mater Europaea, Campus Rezonanca, Prishtinë
[4]Barnatore Barkos, Prizren

Abstrakt

Në vendin tonë, profesioni i farmacistit përballet në mënyrë të vazhdueshme me sfida të reja, të cilat çojnë drejt plotësimit dhe zhvillimit të njohurive farmakologjike, teknologjike, bioteknologjike, kimike, kozmetike, fitoterapeutike, informatike, ekonomike, juridike, etj. Rikthimi në gjurmët e para të profesionit (përgatitësit të barit), si shprehje e identitetit profesional, ka bërë që të shtohet numri i kolegëve që bëjnë përgatitje në farmaci, që realizojnë kërkesa të veçanta të pacientëve dhe si rrjedhojë fitojnë vlerësimin e tyre. Ky punim ka për qëllim të nxjerrë në pah rëndësinë e laboratorit galenik në garantimin e cilësisë së shërbimit të farmacisë dhe në funksion të rritjes së performancës për furnizimin e popullatës më barna. Është bërë një hulumtim i plotë në literaturën e specialitetit dhe në legjislacionin përkatës, përfshirë farmakopetë, në 3 dhjetëvjeçarët e fundit. Rezultatet janë renditur duke dhënë fillimisht bazën ligjore dhe rregullatore të përgatitjes galenike në farmaci dhe të karakteristikave të laboratorit galenik. Përmendim të drejtën e farmacistit për të bërë përgatitje galenike në farmaci, garantimi e cilësisë së barnave që përgatiten në farmaci, kushtet që duhet të plotësojë farmacia në respekt të PMF, mjetet dhe enët e punës që duhet të ketë farmacia dhe laboratori galenik për të garantuar cilësinë e përgatesave galenike. Gjithashtu janë analizuar arsyet kryesore të përgatitjes së barnave në farmaci, detyrimet e farmacistit dhe proçedurat e ndjekura. Një pjesë interesante e rezultateve ka lidhje me hulumtimin e literaturës për të vënë në fokus, nga një këndvështrim ndryshe, aktivitetin e përgatitjes galenike. Këtë e gjejmë të pasqyruar në pjesën e rezultateve të titulluar "Laboratori Galenik në shërbim të farmacisë", shtjelluar me rëndësinë e njohjes së territorit për ngritjen e laboratorit galenik, etj. Në pjesën e fundit të rezultateve kemi bërë një udhëzues të dobishëm për koordinimin e punës në farmaci, të quajtur Banaku i farmacisë në shërbim të laboratorit galenik dhe Promovimi i produkteve të laboratorit galenik. Tema mbyllet me pjesën e përfundimeve dhe rekomandimeve në lidhje me përhapjen e galenikës në farmacitë shqiptare dhe kërkesat për lëndë të para e pajisje.

Fjalë kyç: laborator galenik, përgatitje galenike, PMF, performancë.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI VALIDIMIN E PROCESEVE TË PRODHIMIT NË INDUSTRINË FARMACEUTIKE

Eni Bushi, Ledjan Malaj
Departamenti i Farmacisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Abstrakt

Validimi është parametri më i njohur dhe më i rëndësishëm i c-GMP, si dhe një pjesë integrale e Garantimit të Cilësisë. Në industrinë farmaceutike testimi i produktit përfundimtar në vetvete nuk garanton cilësinë e produktit. Ndaj përdoren teknika të sigurimit të cilësisë siç është validimi i proçeseve, me qëllim përftimin e dëshmive të dokumentuara që vërtetojnë se proçesi i prodhimit siguron një produkt farmaceutik në përputhje me të gjitha kriteret e paracaktuara të cilësisë.

Ky punim fokusohet në prezatimin e qasjeve të validimit të proçesit të prodhimit, duke iu referuar në veçanti kërkesave të përcaktuara nga FDA dhe shpjegon në mënyrë konkrete çdo fazë të tij.

Udhëzimet e FDA-së mbi validimin, përfshijnë më shumë sesa testimet e ndërmjetme ose ato të produktit përfundimtar. Validimi duhet të mbulojë të gjithë ciklin prodhimit të produktit si dhe verifikimin në vazhdimësi të tij, në mënyrë që të reduktohet mundësia e ndonjë menaxhimi të dobët të cilësisë në zinxhirin e prodhimit. Në këtë drejtim, kontrolli mbi parametrat kritikë gjatë procesit të prodhimit merr një rëndësi thelbësore. Një nga mënyrat se si prodhuesit farmaceutike mund të sigurojnë vazhdimësi në validimin e proceseve, është krijimi i një strategjie që vendos fokusin tek cilësia në çdo hallkë të prodhimit.

Fjalë kyçe: Validim, Proçes prodhimi**,** Garantimi i Cilësisë, c-GMP, FDA.

ANALIZË MBI MUNDËSINË E VËNIES NË ZBATIM TË SISTEMIT "LEAN" NË SISTEMIN SHËNDETËSOR NË SHQIPËRI

Eni Bushi, Ledjan Malaj
Departamenti i Farmacisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Abstrakt

Filozofia e sistemit "Lean" qëndron në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë përmes eliminimit të humbjeve dhe maksimizimit të përfitimeve të ofruara. Megjithë interesin në rritje për zbatimin e sistemit Lean në sektorin e kujdesit shëndetësor, ka mungesë në identifikimin e indikatorëve që ndikojnë në përshtatjen sistemike të kësaj filozofie. Qëllimi i këtij punimi është të identifikojë dhe validojë indikatorët kritikë për zbatimin e suksesshëm të "Lean" në sektorin e kujdesit shëndetësor.

Për sa më sipër, u krye një rishikim sistematik i literaturës për të identifikuar faktorët e gatishmërisë së zbatimit të Lean në sistemin e kujdesit shëndetësor. Më tej këta faktorë u vlerësuan nga një panel ekspertësh të kujdesit shëndetësor në Shqipëri, nëpërmjet teknikës Delphi.

Nga rishikimit i literaturës u zbuluan njëmbëdhjetë faktorë si kontribues në zbatimin e sukseshëm të Lean në institucionet e kujdesit shëndetësor. Pas tre raundeve të Delphi, u arrit një konsensus i moderuar (Kendall's W=0.519; P<0.001) midis panelit të ekspertëve mbi nëntë faktorë.

Ndërsa Delphi konfirmoi shtatë faktorë që rrjedhin nga literatura (përfshirë mbështetjen dhe angazhimin e drejtuesve institucionalë, kulturën organizative dhe komunikimin efektiv), ai zbuloi disa faktorë të rinj të propozuara nga vetë ekspertët që lidhjen me implementimin dhe monitorimin strategjik të sistemit Lean.

Faktorët e konfirmuar mund të ndihmojnë institucionet e kujdesit shëndetësor në Shqipëri për të vlerësuar gatishmërinë e tyre përpara aplikimit të Lean me qëllim arritjen e përmirësimeve të qëndrueshme.

Fjalë kyç: Lean, Kujdes shëndetësor, Faktorë gadishmërie, Teknika Delphi.

SITUATA AKTUALE DHE SFIDAT E EDUKIMIT NË FARMACI

MS. Orion Dido, Prof. Ledjan Malaj

Abstrakt

Formimi i farmacistit karakterizohet nga njohuri të shumëanshme në teori dhe praktikë. Në botë, programi i studimit në farmaci ofrohet në disa modele të ndryshme. Synimi i të gjitha shkollave, që ofrojnë këtë program studimi, është përmirësimi i edukimit në këtë fushë. Departamenti i Farmacisë në UMT është ofruesi kryesor dhe me ekspertizën më të mirë në fushën e Farmacisë në Shqipëri. Si rrjedhojë, është gjithmonë në pararojë për ofrimin e formimit më të mirë dhe në përputhje me kohën për specialistët e farmacisë.

Qëllimi i studimit tonë është të studiojë dhe të analizojë preferencat dhe eksperiencat e gjimnazistëve, studentëve dhe të diplomuarve në programin e studimit në farmaci, në vendin tonë dhe referuar kryesisht programit të studimit të ofruar nga Universiteti ynë. Për të realizuar këtë qëllim u hartuan pyetësorë më tre objektiva kryesore. Objektivi i parë është i lidhur me atë që quhet studim tregu dhe ka lidhje me njohuritë e gjimnazistëve dhe me arsyet pse zgjedhin programin e studimit në farmaci. Objektivi i dytë është i lidhur me një analizë të përjetimeve të studentëve që studiojnë në degën e farmacisë dhe me propozime mbi mundësinë e përmirësimit të kurrikulës. Objektivi i tretë është i lidhur me mendimet e të diplomuarve për profesionin, përputhjen e formimit me realitetin dhe mbi mundësinë e kualifikimeve të nivelit të tretë.

Të dhënat për studimin u morën nga shpërndarja një pyetësori online te gjimnazistët, studentët dhe të diplomuarit e degës farmaci në Shqipëri. Këtë pyetësor e plotësuan 754 persona në total, nga të cilët 303 ishin studentë farmacie, 379 gjimnazistë dhe 72 të sapodiplomuar në degën e farmacisë.

Rezultatet e studimit treguan që programi i studimit të farmacisë është një program studimi i pëlqyer dhe që shikohet me perspektivë për të ardhmen nga të rinjtë, por që sigurisht ka nevojë për përmirësime.

Fjalë kyç: Programi i studimit farmaci, studentë farmacie, gjimnazistë, studime pasuniversitare.

NDIKIMI I TOKSICITETIT TË METALEVE TË RËNDA DHE PESTICIDEVE NË ÇRREGULLIMET MENDORE

Linda Matua[1], Alesia Vasku[2], Nadia korreshi[2], Marina Kuca[2]
[1] *Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, UMT*
[2] *Student*

Abstrakt

Hyrje: Neurotoksiciteti i shkaktuar nga metalet mund të shkaktojë dëmtime afatgjata në tru, mund të jetë akut ose kronik në varësi të ekspozimit dhe shpërndarjes biologjike. Gjurmët e metaleve janë të rëndësishme për funksionimin normal të organizmit të njeriut, por njw ekspozim afatgjatë dhe doza e lartë mund të jenë fatale ose mund të sjellin pasoja kronike për shkak të bioakumulimit, si stresi oksidativ, mosfunksionimi mitokondrial, fragmentimi i ADN-së, palosja e gabuar e proteinave dhe aktivizimi i apoptozws. Metalet mund të konsiderohen thelbësore dhe jo thelbësore kur janë të pranishëm si elementë gjurmë, sepse luajnë një rol të rëndësishëm në sinjalizimin e qelizave, homeostazën, neurotransmetimin dhe si ko- faktorë enzimatikw. Kur përqendrimi i tyre biologjik i gjurmës tejkalohet për shkak të kontaktit të drejtpërdrejtë, nëpërmjet thithjes së avujve, gëlltitjes dhe kontaktit me lëkurën, gjatë një periudhe të vogël kohore, një kaskadë e dëmshme reaksionesh do të mundësojë shkatërrimin e qelizave. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në neuronet, pasi ato rigjenerohen shumë ngadalë. Deri më sot, neurotoksiciteti i shkaktuar nga metalet është shoqëruar me sëmundje të shumta neurologjike, ndër të tjera, sëmundjen e Alzheimerit (AD), sklerozën laterale amiotrofike (ALS), çrregullimet e spektrit të autizmit (ASDs), sëmundjen e Huntington (HD), skleroza e shumëfishtë, sëmundjen e Parkinsonit. (PD).

Qëllimi: Studimi i literaturës dhe studimet e rasteve nga bazat e të dhënave të mëdha të artikujve dhe rishikimeve në mënyrë që të kemi një pasqyrë të përgjithshme të evolucionit nw kohw të sëmundjeve neurologjike të shkaktuara nga neurotoksiciteti i metaleve.

Metodat: Një numër i madh artikujsh u rishikuan bazuar në variabla specifike si lloji i metalit, sëmundjet neurologjike, neuroinflamacioni akut ose kronik, helmimi ose jo me kimikate të tjera si pesticidet, vendi i punës, kushte të tjera gjenetike ose mjekësore. Të dhënat u analizuan me T-test ose ANOVA, sipas rastit.

Rezultatet: Metalet specifike kur përqendrohen shumë mund të ndikojnë në tru duke tejkaluar lehtësisht BBB. Për shembull, akumulimi i tepërt në tru shkakton shkatërrimin e β-amiloidit, e cila është shenja kryesore dalluese e sëmundjes së Alzheimerit (AD). Mund të konkludojmë se midis komplikimeve të tjera, Alzheimer dhe Parkinson janë sëmundjet kryesore neurologjike të induktuara nga toksiciteti i shkaktuar nga metalet e rwnda.

Përfundim: Së fundmi, përdorimi i papërshtatshëm dhe kontakti aksidental me metale, përzierje metalesh ose ndonjë helmim tjetër kimik si pesticide mund të jetë fatale ose të çojë në sëmundje të dëmshme neurologjike.

Fjalë kyç: Metale, sëmundje neurologjike, Alzheimer, Parkinson, neurotoksicitet.

TOKSICITETI I INHIBITORËVE SELEKTIVË TË RIKAPJES SË SEROTONINËS GJATË TRAJTIMIT TË DEPRESIONIT E ANKTHIT TË SHKAKTUAR NGA PANDEMIA COVID-19

Linda Matua[1], Livia Nuhaj[2], Eva Leka[2]
[1]Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, UMT
[2]Student

Abstrakt

Sëmundja aktuale e koronavirusit të ri 2019 (COVID-19), një sëmundje infektive në zhvillim, është padyshim pandemia më sfiduese në shekullin e 21-të. Njerëzit me sëmundjen koronavirus (COVID-19) mund të kërkojnë shpesh trajtim me medikamente psikotrope, por në të njëjtën kohë janë në rrezik më të lartë për çështjet e sigurisë për shkak të gjendjes komplekse mjekësore dhe ndërveprimit të mundshëm me trajtimet medikamentoze. Në këtë punim, ne do të fokusohemi në frenuesit selektivë të rikapjes së serotoninës (SSRI-të: një klasë e barnave antidepresive me disponueshmëri të gjerë dhe një profil optimal tolerueshmërie) që potencialisht mund të përdoren për COVID-19 dhe aktualisht janë duke u testuar në prova klinike. Ne gjithashtu përmbledhim literaturën ekzistuese mbi atë që dihet për këto barna, duke përfshirë informacionin mbi fizpatologjinë, etiologjinë, diagnozën dhe 3 kriteret për diagnostikimin e sindromës së serotoninës, i cili është efekti anësor klinik kryesor i lidhur me konsumimin kronik të SSRI. Toksiciteti i serotoninës (ST) mund të zhvillohet me administrimin e çdo medikamenti për rritjen e serotoninës, duke përfshirë përdorimin terapeutik, polifarmacinë ose mbidozën aksidentale/të qëllimshme. Së fundmi, kur përshkruhen SSRI-të për çdo pacient, një analizë rrezik-përfitim duhet të përfshijë efektet e mundshme të trajtimit, efektet anësore dhe rreziqet e sëmundjes që do të trajtohet. Qëllimi i këtij punimi është të edukojë mjekët mbi efektet e mundshme anësore të SSRI-ve.

Fjalët kyç: COVID-19, serotoninë, frenuesë selektivë të rikapjes së serotoninës, efekte anësore.

KRITERET SHQIPTARE DHE EUROPIANE PËR HAPJEN E NJË FARMACIE

Irina Argjiri, Prof. Asoc. Mirela Miraçi
Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë Tiranë.

Abstrakt

Hyrje: Kujdesi farmaceutik është po aq i lidhur me cilësinë e punes se punonjësve të saj ashtu dhe me farmacinë si objekt dhe vendndodhje. Farmacite duhet të jenë të aksesueshme dhe të shpërndara mirë për të ofruar një shërbim të cilësor dhe të sigurtë. Por cilat janë kërkesat për hapjen e një farmacie të re në Shqipëri në krahasim me vendet e BE-së?

Metodologjia: Është bërë rishikim i literaturës mbi kërkesat dhe rregulloret ligjore gjatë historisë, si në vendin tonë ashtu edhe në vende të tjera të BE-së. Bëmë një krahasim mes Shqipërisë dhe Holandës, Francës, Italisë, Spanjës dhe Gjermanisë.

Rezultatet: Sipas te dhenave te literatures, shumica e vendeve të BE-së kishin rregulla strikte në lidhje me kriteret demografike dhe gjeografike përpara se të hapnin një farmaci. Disa vende gjithashtu kishin kërkesa shtesë në lidhje me pronarin e farmacisë dhe pronësinë pas vdekjes. Ndërsa ligji aktual shqiptar nuk kishte kërkesa të tjera përveç pranisë së një drejtuesi teknik apo kritereve të vecanta për farmacitë me kontratë me sigurimet shendetesore.

Konkluzione: Politikat shëndetësore dhe rregulloret ligjore duhet të bëhen për të promovuar shpërndarjen e barabartë të kujdesit farmaceutik.

Si rezultat i karakterit "liberal" të ligjit aktual, kemi një numer mbi kapacitetin e nevojshem të farmacive në zonat urbane, ndersa popullsia në zonat rurale shpesh nuk ka akses për farmaci.
Për t'u theksuar është fakti se vendet e BE-së me rregullore të forta ishin ato me numrin më të madh të farmacive, ndersa ato me ligje më liberale kishin me pak farmaci.

Fjalë kyç: hapja e farmacisë, kërkesat ligjore, kriteret demografike, kriteret gjeografike, shpërndarja e farmacive.

LEGJISLACIONI PËR SHËNDETIN MENDOR : KRAHASIMI MIDIS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR DHE LEGJISLACIONIT TË VENDEVE TË TJERA.

Lorena Karaj, Prof. Asoc. Mirela Miraci.

Abstrakt

Hyrje: Legjislacioni i shëndetit mendor është i nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave të personave me çrregullime mendore, të cilët janë një pjesë e cenueshme e shoqërisë. Ata përballen me stigmë, diskriminim dhe margjinalizim në të gjitha shoqëritë, dhe kjo rrit gjasat që të drejtat e tyre humane të shkelen.

Legjislacioni i shëndetit mendor mund të sigurojë një kuadër ligjor për adresimin e çështjeve kritike si: integrimi në komunitet i personave me çrregullime mendore, ofrimi i kujdesit të cilësisë së lartë, përmirësimi i aksesit në kujdes, mbrojtja e të drejtave civile dhe mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave në fusha të tjera kritike si strehimi, arsimi dhe punësimi.

Metodologjia: Ky rishikim është arritur përmes përdorimit të artikujve nga databaza të njohura duke bërë një përshkrim të evolimit të legjislacionit mbi shëndetin mendor që nga fillimet e hershme kur krijimi i këtij legjislacioni u pa i domosdoshëm, deri në risitë e tij në ditët e sotme. Në këtë kërkim, jemi fokusuar në objektivat e legjislacionit për shëndetin mendor, planet dhe programet e këtij legjislacioni, si dhe hapat që duhen marrë për të arritur në krijimin e tij. Gjithashtu kemi vënë theksin mbi ndryshimin e legjislacionit të shëndetit mendor në Shqipëri në krahasim me atë të vendeve të tjera të botës.

Rezultatet: Shumica e shoqërive kanë dispozita që rregullojnë trajtimin e pavullnetshëm të njerëzve me sëmundje mendore. Janë identifikuar dy qasje të gjera ndaj legjislacionit të shëndetit mendor. Të dyja kërkojnë praninë e një sëmundjeje mendore.

Qasja e parë: Duhet të ketë një nevojë shtesë për trajtim, i cili mund të jetë në interes të shëndetit ose sigurisë së individit ose sigurisë së të tjerëve.

Qasja e dytë: Përgjithësisht shihet si më e ngushtë në shtrirje, duhet të ketë dëshmi të rrezikut ose rrezikshmërisë përveç sëmundjes mendore.

Këto dy qasje kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë një temë debati në lidhje me faktin nëse legjislacioni për shëndetin mendor është mbrojtje apo diskriminim për individët te cilët ai përfshin.

Konkluzionet: Legjislacioni ofron një mekanizëm të rëndësishëm për të siguruar kujdesin dhe trajtimin e duhur dhe të përshtatshëm, mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave me çrregullime mendore dhe promovimin e shëndetit mendor të popullatës.

Fjalë kyç: legjislacion i shëndetit mendor, sistem shëndetësor, crregullime mendore, mbrojtje e të drejtave të njeriut.

TERAPIA GJENIKE DHE RREGULLIMI LEGJISLATIV

Olivera Hila, Prof.Asoc. Mirela Miraçi

Abstakt

Hyrje: Dy dekada pas provave fillestare të terapisë gjenetike dhe më shumë se 1700 provave klinike të miratuara në mbarë botën, janë fituar shumë informacione dhe njohuri të reja në lidhje me terapinë gjenetike në përgjithësi. Me përparimin e mjekësisë molekulare, janë zhvilluar vektorë më specifikë dhe efikasë të transferimit të gjeneve, të cilët tani po prodhojnë rezultate klinike.

Qëllimi i punimit: është njohja me legjislacionin dhe procedurat që rregullojnë funksionimin e terapisë gjenike dhe mbarëvajtjen e saj konform këtyre rregullave.

Metodologjia: Në këtë temë ne kemi trajtuar procedurat rregullative që zbatohen për prodhimin e barnave biologjikë në Evropë. Gjithashtu kemi analizuar përgatitjen e udhëzimeve për cilësinë dhe kontrollin e një sërë barnash biologjike dhe cështjet e reja të sigurise së produkteve të terapisë gjenike. Në mënyrë më specifike është trajtuar zhvillimi dhe rregullimi i barnave të terapisë gjenike nëGjermani dhe gjendja aktuale e rregullores së FDA-së për produktet e terapisë gjenike.

Rezultatet: Në Gjermani, barnat e terapisë gjenetike rregullohen në mënyrë të ngjashme me produktet e tjera mjekësore. Rregullimi sigurohet kryesisht nga ligji gjerman për barnat (Arzneimittelgesetz, AMG) dhe, në raste të caktuara, nga ligji professional i mjekëve (A¨ rztliches Standesrecht). Ligji per rregullimin e Teknologjisë Gjenetike Gjermane (Gentechnikgesetz, GenTG) zbatohet në kërkimin paraklinik dhe fazat e zhvillimit të terapisë gjenetike. Studimet klinke duke përdorur barna të terapisë gjenike mund të nisin në Gjermani brenda një afati të përgjithshëm kohor më pak se 6 muaj. FDA është përgjegjëse për zhvillimin e një kuadri rregullator dhe standardeve teknike për produktet e përdorura në terapinë e qelizave somatike dhe gjenetike që zbatojnë parimet e kontrollit të produktit. Kërkesat teknike janë më pak të rrepta në fazat e hershme të hetimit klinik dhe bëhen më rigoroze gjatë zhvillimit të mëvonshëm. Studimet klinike të agjentëve biologjikë hulumtues kryhen sipas një aplikacioni për Barnat e Rinj Hulumtues (IND) të paraqitur në FDA. Prodhuesit e produkteve biologjike duhet të kenë licenca si për produktet ashtu edhe për

objektet e tyre prodhuese. Prandaj, FDA duhet të miratojë aplikacionin për licencën e produktit të një sponsori dhe aplikimin për licencë themelimi për secilin produkt.

Përfundimi: Një kuader ligjor i pershtatshem ndikon pozitivitisht në problemet e cilësisë, testimit të sigurt dhe ndihmon qe terapia gjenike të gjejë vendin e saj në fusha specifike të mjekësisë klinike ku ka nevojë të paplotësuara.

Fjalë kyç: Terapi gjentike, rregullimi legjislativ.

RECEPTORËT TOLL (TLR), SHËNJESTËR E MUNDSHME TERAPEUTIKE PËR SHUMË BARNA TË RINJ

M.Sc. Sabihe Cenaj, Prof.Asoc. Ela Hoti
Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Farmacisë.

Abstrakt

Hyrje: Receptorët "toll-like" (TLR) janë receptorë formë-njohës që luajnë një rol thelbësor në përgjigjen imunitare të lindur dhe të fituar. Mbiaktivizimi dhe nënaktivizimi i tyre janë përgjegjës për prishjen e homeostazës imunitare. Ka një interes gjithmonë në rritje për të targetuar TLR-të për parandalimin ose trajtimin e kancerit, sëmundjeve inflamatore, sëmundjeve autoimune, dhe infeksionet. Shumë komponime të reja janë në vlerësim paraklinik dhe klinik, ku fokus të veçantë kanë agonistët dhe antagonistët që përdoren për të trajtuar sëmundjet e sipërpërmëndura.

Qëllimi: Qëllimet kryesore në këtë rishikim teorik janë njohja e barnave të aprovuar me target TLR-të, efektet e tyre, si dhe komponimet më premtuese që janë ende nën shqyrtim klinik.

Metodologjia: Në këtë rishikim sistematik, ndërmjet një kërkimi elektronik në Pubmed, ResearchGate dhe ScienceDirect për artikuj të botuar në intervalin kohor 2011-2022, raportohen rezultatet nga studime paraklinike ose klinike që sugjerojnë se agonistët/antagonistët e TLR-ve mund të përbëjnë strategji terapeutike të mira për trajtimin e shumë sëmundjeve. Numri i artikujve të identifikuar fillimisht ishte mbi 3000, nga të cilët 112 ishin të aksesueshëm. 81 artikuj u përjashtuan për të dhëna irrelevante. Në total 31 studime ishin të përshtatshëm dhe u morën në analizë.

Rezultate dhe diskutime: Antagonistët e TLR-ve kanë treguar se përbëjnë shënjestra premtuese për barna që trajtojnë sëmundjet inflamatore ose mund të përdoren si adjuvant me qëllim për të përmirësuar efikasitetin e vaksinave. Resatorvid (TAK-242) është një antagonist i TLR-4 që ka kaluar provat paraklinike dhe është mjaft premtues për trajtimin e artritit reumatoid. Agonistët kanë dhënë rezultat më shumë në rastet e infeksioneve apo neoplazive siç është rasti i imikuimodit, i cili është aprovuar nga FDA për trajtimin e karçinomave sipërfaqsore me qeliza bazale dhe lythave të jashtëm genital nga HPV. Pavarësisht përpjekjeve domethënëse të bëra për zhvillimin e llojeve të ndryshme të

komponimeve që targetojnë TLR-të, vetëm një numër i kufizuar i tyre kanë hyrë në prova klinike dhe akoma më pak janë aprovuar.

Përfundime: Nga studimet e kryera është konkluduar se kombinimi i antagonistëve të TLR-ve me barna që targetojnë qelizat T është mjaft premtues për përmirësimin e gjendjeve inflamatore. Për shkak të përfshirjes së tyre në përgjigje imune, imunologët dhe në përgjithësi i gjithë komuniteti shkencor mendojnë se targetimi i TLR-ve është një strategji shumë premtuese terapeutike.

Fjalë kyç: receptorët "toll-like", agonist, antagonist, prova klinike, strategji terapeutike.

SFIDAT E LIDHURA ME TERAPINË ME ANTIKOAGULANTË, TRAJTIMI FARMACEUTIK NË KËTO RASTE

MSc. Beti Faber[1], MSc Adela Canaj[1], Prof. Dr. Suela Këlliçi[2]
[1] *Farmaciste*
[2] *Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*

Abstrakt

Hyrje: Rritja e përshkrimit dhe përdorimit të antikoagulantëve, ka çuar në rritjen e rolit të farmacistit dhe përfshirjes së tij në kujdesin shëndetësor lidhur me trajtimin me antikoagulantë.

Qëllimi: Të identifikohet niveli i sigurisë së farmacistëve në menaxhimin e terapisë me antikoagulantë.

Metodologjia: Niveli i sigurisë u vlerësua nëpërmjet një pyetësori të shpërndarë në farmacitë e rrjetit të hapur. Në studim u përfshinë vetëm farmacistë, në një mostër përfaqësuese prej 71 individësh. Pyetësori ndahej në tre pjesë, ku tek pjesa e parë përfshihej informacion i përgjithshëm mbi moshën, gjininë, arsimin dhe eksperiencën si farmacist. Tek pjesa e dytë vlerësohej niveli i sigurisë në zbatimin e përshkrimeve me pëmbajtje të ndryshme antikoagulantësh, ndërsa pjesa tretë lidhej me informacionin e nevojshëm, mjaftueshmërinë ose jo të ciklit 5-vjeçar të studimeve në menaxhimin e terapisë antikoagulante dhe ndikimi i pandemisë së Covid-19 në rritjen e kompetencës profesionale të farmacistëve në këtë fushë.

Rezultatet: Farmacitët paraqitën një nivel më të lartë sigurie në menaxhimin e terapisë me antikoagulantë antagonistë të vitaminës K sesa me ata jo antagonistë të vitaminës K. Gjithashtu u konsiderua i nevojshëm edukimi në vazhdim dhe marrja e vazhdueshme e informacioneve në kuadër të rritjes së sigurisë në menaxhimin e terapisë antikoagulante.

Konkluzionet: Pandemia Covid-19 duket se ka ndikuar pozitivisht në aftësimin e farmacistëve lidhur me këshillimin e terapisë me barna antikoagulante.

Fjalët kyç: Antikoagulantë, terapi antikoagulante, informacion, nivel sigurie, farmacistë.

POLIFENOLET ME ORIGJINË BIMORE ME AKTIVITET TË MUNDSHËM ANTIVIRAL NDAJ SARS-COV-2

Tea Mastori, Fjoralba Shehu, Mario Shyti, Klea Spahiu, Prof. Dr. Vilma Papajani (Toska)
Departmenti i Farmacisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Që nga shpërthimi në Kinë (Wuan) dhe shpallja e mëvonshme e COVID-19 si pandemi në mars 2020, përpjekje të vazhdueshme dhe të bashkërenduara janë bërë nga komunitetet shkencore dhe shëndetësore mbarëbotërore për të kufizuar përhapjen e sëmundjes dhe për të gjetur dhe aplikuar terapitë e përshtatshme. Pavarësisht progresit të bërë në imunizimin e popullatës mbarëbotërore dhe zhvillimin e terapive farmakologjike, vërehet përhapje e mutacioneve të reja të COVID-19, duke e bërë më emergjente nevojën për të zbuluar barna antiviralë të rinj. Aktualisht një vëmendje e shtuar po tregohet ndaj mundësive që ofron fitoterapia në këtë drejtim. Vitet e fundit ka një sërë publikimesh shkencore mbi rolin aktiv të metabolitëve dytësore, të pranishëm në bimë mjekësore, në menaxhimin e infeksioneve virale të shkaktuara nga koronaviruset. Në këtë punim jemi fokusuar në komponimet polifenolike si një nga klasat kryesore të lëndëve kimike dytësore të pranishme në shumë bimë mjekësore si dhe në fruta, zarzavate, përbërës të dietës ushqimore. Përveç aktiviteteve të dokumentuara të këtyre komponimeve si antioksidues, anti inflamator dhe imunomodulator që ndikojnë në ecurinë e infeksionit viral; në studime të mëparshme, ato kanë dëshmuar gjithashtu aktivitet antiviral (inhibues të replikimit) ndaj koronaviruse të tjerë si SARS-CoV and MERS-CoV. Qëllimi i këtij punimi është të evidentojë polifenolet me efekt potencial kundër SARS-CoV-2 bazuar në evidenca shkencore, duke u ndalur në mekanizmat e mundshëm të veprimit të tyre. Për realizimin e punimit është shfrytëzuar literatura bashkëkohore (2019-2021) nga databaza të njohura si PubMed, Scopus, Google Scholar etj. Në kërkim u përdorën fjalëkycet: "Covid-19", "polifenole", "flavonoide", "SARS-CoV", "SARS-CoV-2", "aktivitet antiviral". Të dhënat e marra nga studimet "in silico" apo provat in vitro mbi aktivitetin e mundshëm anti SARS-CoV-2 të polifenoleve dëshmojnë se këto komponime mund të ndërveprojnë me proteinat virale (të tilla si $3CL^{pro}$ dhe proteina S) dhe/ose receptorët e qelizave bujtëse (ACE_2) duke ndikuar në hyrjen e virusit apo replikimin e tij në qelizën bujtëse. Screening-u "in silico" i një sërë komponimesh polifenolike të tilla si epigallokatekin-3-gallati (EGCG), epikatekin-gallati, baikalina, kuercetin-3-β galaktozidi, hesperidina, herbacetina etj. ka dëshmuar për aktivitet potencial inhibues të tyre ndaj proteazës $3CL^{pro}$ (M^{pro}) të SARS-CoV-2 duke krijuar bazën për studime të mëtejshme in vitro dhe in vivo. Ndërkohë kurkumina, epigallokatekin-3-gallati dhe teaflavina, mirecetina, resveratroli kanë dëshmuar aftësi inhibuese në replikimin e SARS-CoV-2 në prova in vitro. Ekstrakti i lëvoreve të shegës i pasur me eligatanine, punikalagin etj. mund të frenojë aktivitetin e SARS-CoV-2, duke vepruar me proteinën virale S dhe ACE_2. Përveç aktivitetit antiviral të mësipërm disa komponime fenolike të tilla si resveratroli, kurkumina, baikalina, naringenina etj. ndikojnë në patogjenezën e COVID-19 në sajë të vetive të tyre antiinflamatore dhe antioksiduese. Sidoqoftë studime të tjera in vivo dhe klinike duhet të kryhen për një vlerësim të plotë të efikasitetit terapeutik të këtyre komponimeve si parandalues dhe terapi ndihmëse në trajtimin e Covid-19, ose si molekula 'lead-er" për dizenjimin e barnave të reja antivirale.

Fjalë kyç: Polifenole, COVID-19, SARS-CoV-2, antiviral.

RËNDËSIA E UDHËZIMEVE PËR PËRDORIMIN E DREJTË TË BARNAVE DHE FAKTORËT QË NDIKOJNË NË MOSDHËNIEN E KËTYRE UDHËZIMEVE

Zehadin Gashi[1] , Ledjan Malaj[2], Drilon Gashi[3]
[1]*Alma Mater Europaea, Campus Rezonanca, Prishtinë*
[2]*Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Farmacisë, Tiranë.*
[3]*Barnatore Barkos, Prizren.*

Abstrakt

Sistemi shëndetësor, si tërësi, paraqet një zinxhir kompleks në parandalimin dhe mjekimin e sëmundjeve. Për t'u realizuar një mision i tillë, patjetër duhet të ekzistojë një lidhje ose thënë më mirë bashkëpunimi i pashmangshëm në mes të mjekut, farmacistit dhe të sëmurit.

Në këtë relacion vend shumë të rëndësishëm zë roli i farmacistit, i cili shërben si urë lidhëse në mes të mjekut dhe të sëmurit lidhur me marrjen e sigurt të barit. Fatkeqësisht, sot kjo lidhje dhe udhëzimet e tilla janë shumë pak të shprehura.

Qëllimi i këtijë prezentimi është të analizohet roli dhe rëndësia e farmacistit në dhënien e udhëzimeve të barnave dhe faktorët që ndikojnë në mosdhënien e duhur të këtyre udhëzimeve.

Metoda e hulumtimit është bazuar në pytësorin me të cilën objekt hulumtimi ishin 150 barnatore në Kosovë.

Nga 150 barnatore të cilat ishin objekt hulumtimi rezultojnë: 109 e barnatoreve nuk e kanë pasur prezent farmacistin, në 83 nuk janë marrë udhëzimet e nevojshme për barnat e caktuara edhe pas kërkesës së pacientëve për udhëzime shtesë, ndërsa në 117 barnatore udhëzimet kanë qenë numerike.

Duke u bazuar në rezultatet e fituara janë hulumtuar edhe faktorët që kanë ndikuar dhënien e këtyre udhëzimeve, ku janë vlerësuar se mungon trajnimi profesional lidhur me udhëzimet e barnave, mungon praktika profesionale në barnatore nga farmacistët e rinjë pas përfundimit të fakultetit dhe mungon vullneti i farmacistit dhe i pacientit për të komunikuar lidhur me përdorimin e barnave.

Si rekomandim, kemi ardh në përfundim se Urdhri, respektivisht Oda e Farmacistëve duhet të luajë rolin kryesor në mbarëvajtjen e mirëfilltë të praktikës profesionale e jo marrjen për bazë të një vërtetimi formal të kryerjes së praktikës profesionale, ushtrimin e kontrollit të farmacistit përgjegjës, respektivisht prezencën e farmacistit në barnatore, trajnimet profesionale të lidhura me punën në barnatore dhe zbatimin e rregullave të komunikimit dhe etikës profesionale.

Fjalë kyç*:* udhëzime, farmacist, hulumtim.

ABSTRAKTET ME POSTER

POSTER ABSTRACTS

POSTER ABSTRACTS/ ABSTRAKTET ME POSTERA

MENARKA NË MESIN E VAJZAVE ADOLESHENTE TË SHKOLLËS 9 –VJEÇARE FENIX

Alma Imami[1], Mark Lelcaj[2], Xhevahire Hajdari[3], Miranda Çela[1], Denisa Bego[1], Alketa Dervishi[1]
[1]Fakulteti Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti Mjekësisë Tiranë
[2]Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë", Tiranë
[3]Shkolla Anglo – Shqiptare "Fenix", Tiranë

Abstrakt

Qëllimi: Vlerësimi i moshës së menarkës dhe përjetimi emocional në mesin e nxënëseve të Shkollës Anglo – Shqiptare Fenix, Tiranë.

Metodologjia: Ky është një studim kros-seksional. Në këtë studim morën pjesë 82 nxënëse të shkollës 9 vjeçare Fenix. Të dhënat e studimit u mblodhën përmes një pyetësori. Mosha e vajzave pjesëmarrëse në studim ishte 10 – 15 vjeç.

Rezultatet: 70 % e vajzave në studim kishin përjetuar menarkën, ndërsa 30 % ende jo. Mosha mesatare e menarkës ishte 11.49 vjeç ± 0.94, mosha minimale 10 vjeç dhe ajo maksimale 13 vjeç. Rreth përjetimit emocional: 39% u ndjen të befasuara, 28% Po! Unë jam një vajzë e rritur tani, 25% të emocionuara, 18% të frikësuara, 11% të trishtuara. 58 % i treguan fillimisht mamasë së tyre për ardhjen e menarkës, po ashtu burim informacioni rreth menstruacioneve për shumicën e vajzave si para edhe pas menarkës ishte mamaja 46% dhe 45 %. Asnjë nga vajzat nuk kërkoi informacion para dhe pas menarkës tek mesuesja, mjeku, apo psikologu i shkollës.

Konkluzion: Bazuar në gjetjet e këtij studimi vajzat kanë përjetuar emocione positive dhe negative me ardhjen e menarkës. Mamaja ishte personi që vajzat ju referuan për marrjen e informacionit para dhe pas menseve. Për një përgatitje më të mirë psikologjike dhe mjekësore një seancë edukimi rreth menstruacioneve hartuar nga mjeku, apo psikologu i shkollës do të ishte e vlefshme, me qëllim që ardhja e menarkës të përjetohet me sa më shumë pozitivitet nga vajzat.

Fjalë kyç: menarka; adoleshnte; emocione

HERPES ZOSTER VIRUS NË PACIENTËT HEMATOLOGJIK

Ana Plaku, Adela Perolla, Elsuarta Calliku, Alma Cili, Tatjana Caja, Polikron Pulluqi, Arben Ivanaj
Shërbimi i Hematologjisë, Qëndra Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë.

Abstrakt

Hyrje: Infeksionet virale janë një ndër shkaqet kryesore të morbiditetit dhe mortalitetit në pacientët me sëmundje hematologjike. Pjesa më e madhe e komplikacioneve nga infeksionet virale në këta pacientë vijnë si rezultat i reaktivizimit të viruseve, kryesisht Herpes Zoster. Herpes Zoster prezantohet me klinikën e dhimbjes dhe me vezikula duke ndjekur trajektoren e inervimit vetëm në një anë të trupit. Prekja e tre ose më shumë dermatomeve njihet si Zoster i diseminuar. Mund të ndodhi në cfarëdo lloj moshe me predispozitë moshat e mëdha. Faktorët kryesor të riskut në pacientët me malinjanca hematologjike përfshijnë neutropenitë, kohëzgjatja, kimioterapia, sëmundje shoqëruese. Studime të ndryshme sugjerojnë se fillimi i aciklovirit profilaktik do të jepte benefite në uljen e incidencës së Herpes Zoster në pacientët hematologjike nën kimioterapi.

Rasti klinik: Pacienti mashkull mosha 48vj i diagnostikuar me Mieloma Multiple në dhjetor 2021. Fillon trajtimin sipas protokollit me VED. Pas ciklit të parë të mjekimit në janar 2022 paraqitet në Shërbimin e Hematologjisë me ankesat djegie unilaterale në regionin lumbar me përhapje në fjankun e majtë dhe dhimbje. Në ekzaminim objektiv vërehet vezikula dhe krusta të formuara në po të njëjtin region. Lezionet ishin të dhimbshme dhe i shkaktonin kruarje. Fillohet mjekimi me aciklovir dhe ndërpritet trajtimi me VED deri në përmirsimin klinik të pacientit.

Diskutime: Herpes zoster shkaktohet nga reaktivizimi i virusit varicela zoster. Ky reaktivizim është i lidhur ngushtë me imunokompromentimin në pacientë me sëmundje hematologjike malinje (Leukemia akute, LLC, CML, Limfoma, Mieloma Multiple), Diabet Mellitus, sëmundje autoimmune, HIV, medikamente imunosupresive. Ky pacient u diagnostikua në bazë të paraqitjes klinike dhe u përgjigj mirë kundrejt mjekimit me aciklovir per os.

Konkluzione: Herpes Zoster i diseminuar është një infeksion serioz i paraqitur në pacientët e imunokompromentuar. Cdo paraqitje klinike me rash dhe vezikula në pacientët e imunokompromentuar duhet të vlerësohet si mundësi e infektimit nga herpes zoster. Diagnostikimi dhe mjekimi i hershëm me aciklovir con në ulje të morbiditetit dhe komplikacioneve severe.

Fjalë kyç: Infeksione virale, Aciklovir, Sëmundjet hematologjike, Herpes Zoster Virus, Kimioterapi.

EFEKTIVITETI I USHTRIMEVE TË BALANCËS NË RRITJEN E PERFORMANCËS SPORTIVE DHE AFTËSIVE MOTORIKE TE SPORTISTËT ME DËMTIME TË GJYMTYRËVE INFERIORE

Ana Sulaj

Abstrakt

Hyrje: Si rezultat i rritjes së dëmtimeve sportive dhe instabilitetit kronik të artikulacioneve të gjymtyrëve inferiore ekzistojnë disa polemika në lidhje me programin e tyre të rehabilitimit dhe efektivitetit të trajnimit të ekuilibrit dhe balancës për përmirësimin e performancës funksionale. Për këtë arsye menduam të rishikojmë ndikimin që kanë ushtrimet e balancës dhe sesa efektive janë ato.

Qëllimi: Evidentimi i rolit të ushtrimeve të balancës dhe ekuilibrit në përmirësimin e forcës dhe funksionalitetit për të rritur performancën fizike dhe aftësitë motorike të sportistëve me dëmtime të gjymtyrëve inferiore.

Metodat: Janë rishikuar artikuj shkencorë të cilët analizojnë dhe vlerësojnë efektivitetin e ushtrimeve të ndryshme të balancës si pjesë e një programi rehabilitimi të sportistëve me dëmtime të gjymtyrëve inferiore në rritjen e forcës muskulare dhe performancës funksionale të tyre.

Rezultatet: Janë vënë re rezultate sinjifikante të ushtrimeve të ndryshme të balancës dhe ekuilibrit nga rezultatet e marra nga artikujt më të fundit shkencorë. Gjithashtu janë vënë re rezultate pozitive gjatë rehabilitimit të sportistëve me anë të këtyre ushtrimeve.

Konkluzioni: Rezultatet tregojnë se ushtrimet e balancës dhe ekuilibrit janë efektive në rritjen e stabilitetit artikular, forcës muskulare dhe aftësive motorike. Të gjithë këto komponentë kanë arritur në përfundimin e rritjes së performancës sportive të sportistit.

Fjalë kyçe: ushtrime balance, trajnimi i ekuilibrit, performancë sportive, aftësi motorike

SITUATA E DISA ÇRREGULLIMEVE DIARREIKE DHE SËMUNDJEVE TË TJERA INFEKTIVE ME BAZË USHQIMORE, NË RRETHIN E TIRANËS 2015-2016

Dr. A. Xhixha[1], T. Xhixha[3], Dr. A. Xhixha[2]
[1] *Drejtoria e Shëndetit Publik, Tiranë*
[2]*Inspektoriati Shëndetësor Shtetëror, Tiranë*
[3] *Student, Fakulteti i Mjekësisë, Tiranë*

Abstrakt

Objektivat: Përcaktimi i ngarkesës mikrobiale në mostrat ushqimore, është një procedurë normale që ndiqet gjatë shpërthimeve të cregullimeve diarreke , apo intoxikacioneve alimentare që shfaqen papritmas, me një grup simtomash, në njerëz që kanë ngrënë, pirë të njëjtin ushqim, ne subjekte te perpunimit dhe konsumimit te ushqimit . Ne paraqesim dëshmi nga disa Hetime epidemiologjike ku rezulton si shkaktar Salmonela Enteritidis, në disa prej analizave të marra si dhe E.Coli apo STA me një ngarkesë më të lartë se normat e lejuara në produkte ushqimore të konsumuara, për të zbatuar shqyrtimin e detyrueshem analitik për të gjithë personelin (koprokulturën), dhe detyrimin ligjor të ruajtjes së kampioneve ushqimore, të gatuara.

Metodat: Përveç masave të kontrollit rutinë gjatë një shpërthimi, marrja e mostrave ushqimore si dhe depistime shkallë pastërtie në ambjentet dhe duar personeli, janë mbledhur dhe mostra fecesh për koprokulturë. Ne kemi bërë një studim, duke përdorur të dhëna nga Hetimi epidemiologjik për të parë dhe analizuar triadën Person-Kohë-Vend , për të gjetur shkaktarin e përbashkët të "rrezikut " për individët e sëmurë, dhe për t'u informuar mbi njohuritë e personelit në lidhje me shkaktarët, rregullat higjeno sanitare apo edhe rehidrimin dhe menaxhimin e duhur të një diarreje.

Rezultatet: Rezultatet laboratorike të koprokulturave të punonjësve, paraqiten në 2015, 17 raste me Salmonelë dhe 2 E.Coli patogjen. 10 raste me Salmonela enteritidis në vitin 2016, 1me E. coli patogjen; Në 2015 në 6 raste ITU, 38.3%(18; 47) e mostrave ushqimore të analizuara rezultuan me ngarkese mikrobike më të lartë se norma e lejuar për E.Coli, STA, apo Salmonela enteritidis. Në 2016 në 7 raste ITU, 37% (17 ;46) e mostrave ushqimore rezultuan me ngarkese mikrobike më të lartë se norma e lejuar për E.Coli, STA . 21.6% dhe 29.5% e ekaminimeve për shkallën e pastërtisë në duar personeli dhe ambjente apo mjete pune rezultuan të ndotura me Bacterium Coli në vitet përkatëse.

Diskutim / Konkluzioni: Ky hetim tregon se në mjediset e përpunimit të ushqimit kontrolli i higjenës dhe temperaturës së ruajtjes së këtyre produkteve nuk merret shumë në konsideratë. Marrja e njohurive të përgjithshme mbi sistemin e autokontrollit HACCP, i cili identifikon gjithë parimet e Higjenës së ushqimit që janë të zbatueshme mbi të gjithë zinxhirin e prodhimit (prodhimtarinë primare deri tek konsumatori përfundimtar), që të arrihet qëllimi.

Fjalë kyç: ngarkesë mikrobiale, mostra ushqimore, hetime epidemiologjike, depistim, konsumatori përfundimtar.

ASTAKSANTINA: NJË PËRBËRËS NATYROR ME VEPRIMTARI BIOLOGJIKE DHE PËRFITIME SHËNDETËSORE

Dorina Dervishi[1], Emi Panariti[2], Sara Zavalani[1], Xheni Nokaj[3]
[1]*Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti Europian i Tiranës, Shqipëri*
[2]*Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University, Shqipëri*
[3]*Farmaci Rrjeti*

Abstrakt

Hyrje: Astaksantina, (3,3′-dihidroksi-β, β′-karoten-4,4′-dion) është një karotenoid i cili mund të gjendet më së shumti në mikroalgën *Haematococcus pluvialis* dhe në majanë e kuqe *Phaffia rhodozyma*. Është një antioksidues i fuqishëm biologjik dhe ka veti të tjera të dobishme farmakologjike.

Metoda: Një shqyrtim i literaturës u krye nëpërmjet artikujve të ndryshëm shkencorë të gjetur në PubMed, Google Scholar, etj. Ata u vlerësuan në tema lidhur me astaxanthin, rreth burimeve të saj, veprimtarive biologjike, vetive terapeutike dhe aplikimeve komerciale.

Rezultatet: Studime të shumta kanë treguar se astaksantina ka veti antioksiduese dhe anti-inflamatore. Ajo ka efekte të mundshme të nxitjes së shëndetit në parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve të ndryshme të tilla si kanceri, hipertension, diabet, sëmundjet kardiovaskulare, sëmundje neurodegjenerative dhe sëmundje të lëkurës.

Përfundimet: Astaksantina, një ksantofil shumë i fuqishëm ka shumë veti farmakologjike dhe suplementet orale të këtij anti-oksidanti janë mbrojtëse kundër një game të gjerë sëmundjesh.

Fjalë kyç: Astaxanthin, karotenoide, antioksidues.

MENAXHIMI I ANOMALISË SË KLASËS II/1 ME KAFSHIM TË HAPUR

Dr. Ekrem Çitaku, Dr. Emire Çitaku, Dr. Burak Shabani, Dr. Minire Çitaku, Dr. Shkurte Çitaku.

Abstrakt

Qëllimi: Qëllimi i këtij prezantimi është të përshkruajmë menaxhimin e anomalisë së klasës II/1 me kafshim të hapur rakitik te pacientja e rritur, si pasojë e mungesës së vitaminës D gjatë fëmijërisë së saj.

Materialet dhe metodat: Pacientja e moshës 23 vjeç, gjinia femër, erdhi në klinikë me ankesën se dhëmbet e përparëm të sipërm i ka te shtyrë përpara.

Gjate ekzaminimit ekstra oral vërejtëm: profil konveks, fytyre simetrike, buza e sipërme e shkurtër, buzë inkompetente, frymëmarrje me goje.
Gjate ekzaminimit intraoral vërejtëm: denticion i përhershëm, kafshim i hapur, sëmundje kronike periodontale, zmalt hipoplastik, me ngjyrë të verdhë te të gjithë dhëmbët, anomali të klasës II/1, incizivët maksillare të protruduar, over jet 8 mm, hapësira interokluzale në regjionin frontal 3 mm.
Trajtimi: Te pacientja kemi bërë nxjerrje të dhëmbëve, pas kësaj kemi aplikuar aparat mobil aktiv dhe aparat fiks. Në fazën përfundimtare kemi aplikuar aparat për retencion.

Rezultatet: Pacientja është trajtuar në klinikë në mënyrë aktive përafërsisht 2 vite.

Duke i falënderuar trajtimit adekuat over jet nga 8 mm u reduktua ne 2 mm, dhe over bite 2 mm.
Te kjo paciente kemi arritur ta bëjmë korrigjimin e anomalisë së klasës II/1, profil të drejtë, okluzion optimal, buzë kompetente dhe frymëmarrje me goje.
Një vit pas trajtimit aktiv nuk kishte recidiv.

Konkluzionet: Anomalitë e klasës II/1 me kafshim të hapur janë një problem i shpeshtë ortodontik. Por me një diagnoze të kujdesshme dhe me një plan terapeutik adekuat, mund të arrihen rezultatet optimale, me efekte anësore minimale.

Fjalë kyç: kafshim i hapur, aparat mobil aktiv, aparat fiks**.**

TRAJTIMI I DIASTEMËS MEDIANE - QASJA MULTIDISIPLINARE

Dr. Ekrem Çitaku, Dr. Emire Çitaku, Dr. Burak Shabani, Dr. Minire Çitaku, Dr. Shkurte Çitaku.

Abstrakt

Qëllimi: Qëllimi i këtij prezantimi është të përshkruhet qasja multidisiplinare në trajtimin e diastemës mediane dhe mikrodoncisë te pacientja e moshës madhore.

Materialet dhe metodat: Pacientja e gjinisë femërore, 24 vjeçare, erdhi në klinikë duke kërkuar zgjidhje për hapësirat në mes të incizivëve të sipërm qëndrorë, që i shkaktonin asaj probleme estetike.

Ekzaminimi ekstra oral: fytyre asimetrike, profil normal, buzë kompetente.
Ekzaminimi intra oral: denticion i përhershëm, indet e buta orale të shëndosha, anomali e klasës I, diastemë mediane 5 mm, në mes të incizivëve qëndrorë të sipërm, incizivët laterale të sipërm të vegjël (mikrodontik).
Në konsultim me pacienten u pajtuam për një bashkëpunim multidisciplinar ortodontik-konservativ, natyrisht pas analizës së detajuar të gjendjes së saj orale.

Terapia: Terapia ortodontike – aplikimi i aparatit fiks.

Terapia konservative-vendosja e fasetave nga kompoziti *(Veneers)* në të dy incizivët lateralë të sipërm mikrodontik, me formë dhe madhësi që i përshtateshin dhëmbëve të tjerë të pacientes.

Rezultatet: Trajtimi multidisiplinar te kjo paciente zgjati përafërsisht 1 vjet.

Si rezultat i trajtimit të kombinuar ortodontik/konservativ u arritën rezultate të mira estetike dhe funksionale, pacientja ishte shumë e kënaqur nga pamja e saj e re.

Konkluzionet: Përmes këtij rasti mund të shohim se me bashkëpunim multidisciplinar, përmes trajtimit ortodontik dhe të restaurimit konservativ mund të arrihen rezultate optimale në trajtimin e mikrodocisë dhe diastemes mediane te të rriturit.

Fjalë kyç: diastemë, asimetri, faseta.

ARSYET SE PSE VJEN KARIESI I FËMIJËRISË SË HERSHME

Dr. Elona Zahaj
Klinika Stomatologjike Universitare

Abstrakt

Qëllimi: Kariesi i fëmijërisë së hershme është një problem tejet madhor tek fëmijët e moshës nga 0-6vjec. ECC fillon me një lezion të bardhë tek dhëmbët incizor lart. Nëqoftëse lihet pa u trajtuar ai vazhdon të shkatërrojë totalisht kurorën e dhëmbit. Kjo është një sëmundje mulltifaktoriale e cila me ndërveprimin e faktorëve të cilat përfshijnë mikroorganizmat kariogjenik, ekspozimin ndaj karbohidrateve të fermentueshme nëpërmjet mënyrës së gabuar të ushqimit, pa mundësite ekonomike, në komunitete të cilat nuk kanë njohuri të mjaftueshme, ushqyerja për një kohë të gjatë me biberon gjatë natës, higjenë e varfër e kavitetit oral.

Konkluzionet: Kariesi i fëmijërisë së hershme është një sëmundje infektive kronike e cila prek fëmijët. Kjo sëmundje precipiton me shpejtësi dhe ka një impakt të madh në denticion.

Fjalë kyç: karies, fëmijëri e hershme.

TRAJTIMI INTERDISIPLINAR I ANOMALISË SË KLASËS II/1 ME DIASTEMA

Dr. Emire Çitaku, Dr. Ekrem Çitaku, Dr. Burak Shabani, Dr. Minire Çitaku, Dr. Shkurte Çitaku

Abstrakt

Qëllimi: Qëllimi i këtij prezantimi është te përshkruhet trajtimi interdisciplinar i anomalisë së klasës II/1 me diastema.

Materialet dhe metodat: Pacienti: 14 vjeç, gjinia mashkullore, erdhi në klinikën tonë duke u ankuar për problemet estetike që ia shkaktonin atij hapësirat në mes të dhëmbëve dhe dhëmbët e sipërm të përparmë që ishin te shtyrë përpara.

Me ekzaminim ekstra oral vërejtëm fytyre asimetrike, profil konveks, buze inkompetente, frymëmarrje me goje.
Me ekzaminim intra oral vërejtëm: denticion te përhershëm, higjienë të mirë orale, indet e buta të shëndosha, dhembë me formë dhe madhësi normale, anomali të klasës II/1, incizivët maksillarë të protruduar, over jet 10 mm, diastema në të dy nofullat.

Terapia: Në fazën e parë kemi bërë ekstraksione të dhëmbëve

Në fazën e dytë kemi aplikuar aparate fikse

Në fazën finale kemi aplikuar aparate për retencion.

Rezultatet: Kohëzgjatja e trajtimit ishte 18 muaj

Rezultatet e arritura: over jet i reduktuar nga 10 mm në 2 mm, over bite 3 mm.
Pas korrigjimit të klasës II/1 buzët e pacientit janë kompetente dhe frymëmarrja është me hundë.

Konkluzionet: Korrigjimi dhe retencioni i anomalive të klasës II/1 është mjaft kompleks, por me diagnozë të saktë dhe me një plan adekuat terapeutik, mund të arrihen rezultate optimale funksionale dhe estetike.

Fjalë kyç: diastema, anomali, asimetri.

TRAJTIMI I DENDËSISË BIMAKSILLARE TE PACIENTI ADOLESHENT

Dr. Emire Çitaku, Dr. Ekrem Çitaku, Dr. Burak Shabani, Dr. Minire Çitaku, Dr. Shkurte Çitaku

Qëllimi: Qëllimi i këtij prezantimi është të përshkruajmë menaxhimin ortodontik të dendësisë bimaksillare me kaninë ektopikë te pacienti adoleshent.

Materialet dhe metodat: Pacienti 14 vjeç, gjinia mashkullore, erdhi në klinikë me ankesën se i ka dhëmbët shumë të dendur dhe kaninët shumë lart.

Ekzaminimi ekstraoral: profil i rrafshët fytyre asimetrike.
Ekzaminimi intraoral: denticion i përhershëm, higjiene e dobët orale, dhembë me formë dhe madhësi normale, anomali e klasës II/1, dendësi primare bimaksillare, kaninë ektopikë, kafshim i kryqëzuar në anën e djathtë, kafshim i bllokuar i incizivëve laterale te sipërm.

Trajtimi Faza e pare: kemi bërë ekstrakcionet e dhëmbëve

Faza e dyte: aplikimi i aparatit aktiv mobile
Faza e trete: aplikimi i aparatit fiks
Faza finale: aplikimi i aparateve për retension.

Rezultatet: Kohëzgjatja e trajtimit ortodontik ishte përafërsisht 18 muaj.

Rezultatet e arritura: over jet 2 mm, overbite 2 mm, korrigjimi i rotacionit dhe inklinimit të dhëmbëve, korrigjimi i kafshimit të kryqëzuar dhe i kafshimit të bllokuar. Dhembët u radhitën në hark në mënyrën e duhur, u arrit raport optimal ndërmjet dhëmbëve dhe nofullave dhe pacienti ishte i kënaqur me dukjen e tij.

Pacienti nuk kishte recidiv pas gjashte muajsh.

Konkluzionet: Dendësia e dhëmbëve është një nga problemet më të shpeshta ortodontike te fëmijët dhe te të rriturit. Diagnoza e kujdesshme dhe plani adekuat i trajtimit japin rezultate optimale estetike dhe funksionale.

Fjalë kyç: dendësime bimaksilare, pacient adoleshent.

ROLI I ANALIZËS KROMOZOMIKE KONVENCIONALE NË DIAGNOSTIKIMIN E ANEMISË FANKONI

[1]Flogerta Alia, [2]Dorina Roko, [2]Anila Babameto – Laku
[1] Shërbimi i Gjenetikës Mjekësore, QSU "Nënë Tereza"
[2] Shërbimi i Gjenetikës Mjekësore, QSU "Nënë Tereza", Fakulteti i Mjekësise, Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Anemia Fankoni (AF) është një sëmundje gjenetike recesive autozomike e rralle qe ben pjese ne në grupin e sindromeve të paqendrueshmerise kromozomike, te shoqeruara citogjenetikisht me thyerje kromozomike, konfigurime triradiale apo kuadriradiale. Megjithese shenja kryesore eshte pancytopenia, manifestimet klinike të Anemisë Fankoni përfshijnë: vonesën në rritje, keqformime të veshkave dhe skeletit si dhe disa manifestime kutane. Per vendosjen e diagnozes ekzaminimi molekular i ADN-se është i rëndesishëm, por në shumë raste ajo vendoset nëpërmjet kryerjes së analizës së kariotipit standart.

Metoda: Per identifikimin e thyerjeve kromozomike, triadave apo tetradave u krye ekzaminimi i citogjenetikes konvencionale (kariotipi standart) nga gjaku periferik në Shërbimin e Laboratorit të Gjenetikës, QSUNT. Kulturat qelizore u stimuluan me fitohemaglutine dhe u perdoren bandat G. Interpretimi i rezultateve eshte bere sipas sistemit "International System for Human Cytogenetic Nomenclature 2019" (ISCN 2019).

Rezultatet: Nga shenjat klinike dhe identifikimi i thyerjeve kromozomike, triadave e tetradave ne metafazat e studjuara u diagnostikuan 6 paciente me Anemi Fankoni. Asnjë nga pacientet nuk kishte histori familjare të mëparshme për nje patologji te tille.

Ne 4 raste pacientët me moshe 4-10 vjeç kishin pancitopeni, shtat të shkurtër, njolla kafe-qumësht në trup. Njeri nga pacientet paraqiste aplazi te gishtit të madh të dorës së djathtë dhe pranine e një falangu distal të dyfishuar (bifid) në gishtin e madh të dorës së majtë.

Pacientet e tjera ishin dy vajza binjake, në moshën 10 vjeçare. Njëra prej tyre paraqiste pancitopeni, strabizëm, njolla kafe-qumësht dhe polidaktili, ndërsa motra e saj vetëm pancitopeni dhe njolla kafe-qumësht.

Përfundimet: Ekzaminimi citogjenetik per venien dhe konfirmimin e diagnozes, këshillimi gjenetik dhe diagnoza e paralindjes rekomandohen ne familjet që kanë nje të sëmurë me Aneminë Fankoni. Vendosja e diagnozës se sakte e te hershme është e rëndësishme për menaxhimin e ketyre pacienteve si dhe monitorimin e tyre për shkak të rrezikut të lartë që kanë sindromet e paqëndrueshmërisë kromozomike për t'u bashkëshoqëruar me patologji malinje.

Fjalë kyç: Anemia Fankoni, citogjenetika konvencionale, pancitopenia, thyerje kromozomike

RITRAJTIMI I NJE DËSHTIMI ENDODONTIK (RAPORTIM RASTI)

Florjan Zoto[1], Odeta Zoto[2]
[1]*Fakulteti i Mjekësisë Dentare*
[2]*Klinikë dentare private*

Abstrakt

Gjatë trajtimit endodontik të sistemit të kanaleve të rrënjës, pengesat për të arritur suksesin afatshkurtër dhe afatgjatë të trajtimit janë të shumta. Disa prej tyre janë: variacionet e sistemit kanalar, preparimi mekaniko-kimik i papërshtatshëm, cilësia jo e mirë e mbushjes së kanalit, mikrorrjedhjet koronare, niveli i mbushjes së sistemit kanalar etj. Këto pengesa mund të çojnë në dështim të trajtimit endodontik. Pavarësisht suksesit të lartë që ka trajtimi endodontik, dështimi i tij ndodh në një numër të madh rastesh dhe përgjithësisht i atribuohet shkaqeve të mësipërme.

Ritrajtimi i dështimeve endodontike është i rëndësishem për të ruajtur dhëmbin në harkun dentar, dhe për parandalimin e ekstraksionit, çka do të çonte në pasoja funksionale dhe fiziologjike për pacientin.

Paraqitja e rastit: pacienti 41 vjeç, paraqitet me një rast të dështuar endodontik të 44 (diagnoza: periodontit kronik), si pasojë e: mos zbulimit dhe trajtimit të një kanali shtesë dhe një vide të vendosur jo korrekt në kanal.

Rasti u ritrajtua në mënyrë endodontike konservative dhe në përfundim u restaurua me dy vida qelqi për shkak të destruksionit koronar dhe koronë porcelani.

Për parandalimin e dështimeve endodontike ka rëndësi njohja e variacioneve të sistemit kanalar dhe hapja e mirë e dhomës pulpare për evidentimin e të gjithë kanaleve.

Ritrajtimi endodontik është një alternativë e suksesshme e rasteve të dështuara endodontike.

Fjalë kyç: dështim endodontik, kompleksitet i sistemit kanalar, ritrajtim endodontik.

STRATEGJIA KOMBËTARE NDAJ COVID-19 DHE ROLI I FONDIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Dr. Shk. Florjana Rustemi[1]
[1]*Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Tiranë*

Abstrakt

Prej Dhjetorit 2019, është raportuar një rritje e shpejtë e rasteve Covid-19 në të gjithë botën. Aftësia e Covid-19 për përhapje të shpejtë ka mbingarkuar edhe sistemet shëndetësore më të zhvilluara në botë. Në 28 Shkurt 2022, janë raportuar më shumë se 436,400,000 raste në të gjithë botën, dhe më shumë se 5,970,000 të vdekur. Objektivat kryesorë kombëtarë strategjikë për shëndetin publik, në përputhje me OBSH-në janë: Frenimi i transmetimit; Ulja e ekspozimit; Mbrojtja e grupeve vulnerabël; Ulja e vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë nga të gjitha shkaqet; Përshpejtimi i aksesit të barabartë në mjetet e reja ndaj Covid-19. Në kuadër të gatishmërisë, përgjigjes strategjike dhe planit të veprimit ndaj Covid-19, FSDKSH ka ndërmarrë veprime si pjesë e planit kombëtar, në përputhje me strategjinë e shërbimeve efektive dhe gjithëpërfshirëse të kujdesit shëndetësor. Që nga Marsi 2020, kur u shpall gjendja e jashtëzakonshme për shkak të infeksionit Covid-19, FSDKSH ndërmori veprime të rëndësishme për të përballuar vështirësitë në akses për shërbimet e kujdesit shëndetësor, në drejtim të hartimit, hyrjes në fuqi dhe ndjekjes së Udhëzimeve dhe Urdhrave për institucionet publike që ofrojnë kujdes shëndetësor në nivelin parësor dhe spitalor, për lehtësimin e proçedurave për pacientët kronikë të trajtuar me barna të rimbursuara, veçanërisht pacientët mbi 65 vjeç, pacientët e trajtuar me barna të rimbursuara nga farmacia e rimbursimit të QSUT dhe pacientët në dializë. Gjatë pandemisë, FSDKSH promovoi komunikimin online midis pacientëve dhe profesionistëve shëndetësorë, regjistrimin e vizitave elektronike në sistemin e-Vizita dhe përdorimin e aplikacioneve si: Whatsapp, Viber, Skype dhe telemjekësisë për të parandaluar përhapjen e Covid-19. FSDKSH ka financuar vaksinat Covid-19 në Shqipëri përmes "Gavi Alliance" dhe marrëveshjeve me prodhuesit dhe rimbursimin e barnave për trajtimin e pacientëve pozitivë me Sars-Cov-2. Gatishmëria, kërkimi shkencor dhe inovacioni do të vazhdojnë të jenë thelbësorë për përgjigjen ndaj pandemisë në vitin 2022.

Fjalët kyç: Covid-19, strategji kombëtare, plan përgjigje, FSDKSH, shërbimet e kujdesit shëndetësor, pacientët.

TURKISH TRIFOLIUM PRATENSE L. INDUCED APOPTOSIS AND AUTOPHAGY IN C6 GLIOBLASTOMA CELLS, BUT WAS NOT EFFECTIVE ON CANCER STEM CELLS

Gamze Tanrıverdi[1], Aynur Abdulova[1], Hatice Çölgeçen[2], Havva Atar[2], Belisa Kaleci[1], Tuğba Ekiz-Yılmaz[3]

[1]Istanbul University-Cerrahpasa, Cerrahpasa Faculty of Medicine, Department of Histology and Embryology, Istanbul, Turkey.

[2]Bulent Ecevit University, Faculty of Arts and Sciences, Department of Biology, Botany, Zonguldak, Turkey.

[3]Istanbul University, Istanbul Faculty of Medicine, Department of Histology and Embryology, Istanbul, Turkey.

Abstract

GBM occurs in adults with an incidence of 16% of all primary brain tumors and 54% of all gliomas. It is the most common type of primary brain tumor. The ability to reproduce rapidly and the surrounding brain characterized by a tendency to aggressively and strongly spread into the tissue. The standard treatment approach of GBM is surgical resection followed by simultaneous chemo and radiation therapy. Unfortunately, a significant number of GBM cases develop resistance to the used chemotherapeutic drugs. Therefore, there is an urgent

need for the development of new chemotherapeutic agents. Red clover, also known as *Trifolium Pratense L.* (TP) is an endemic plant containing various isoflavones such as biochanin A, genistein, daidzein, and formononetin in high concentrations. Also, it has been shown in different studies that these molecules can function as anticancer agents. TP is a naturally tetraploid plant grown in our country. In this study, using electron microscopy, we aimed to examine the effects of the TP on GBM cells.

C6 glioblastoma cells were cultured for 24 and 48 hours to increasing doses (0, 7, 12.5, 25, 50, and 100 µg/ml) of TP extract. This extract was prepared by dissolving 22.5 µg of TP in 100 µl of ethanol. The cell proliferation indexes of the experimental groups were calculated using the CCK-8 assay kit. It was determined that TP reached IC50 at 25nM dose and IC25 value at 12.5nM dose. After the determination of the effective dose, the cells were evaluated with CCK-8, Annexin V, cytochrom-c, CD117 and Beta-tubulin labeling respectively. And also, investigated effects of this Turkish tetraploid on GBM by TEM.

The IC50 values of the experiment were 12.5 µg and 25 µg doses and apoptotic markers caspase-3, Annexin V and cytochrom-c were determined at the highest levels in these groups. And also, it was determined that the control groups consisted of spindle-shaped elongated cells with mitochondria in normal morphology, well-developed Golgi, and a prominent GER and SER. In the 12.5nM and 25nM effective dose groups, the cells have lost their elongated form and show round or polygonal shapes. Mitochondria were damaged, and cristae structures were degenerate. The GER and SER cisternae were highly enlarged and with irregular shapes. The cells have abnormal morphology and cytoplasmic appearance, and the number of vesicular structures in their cytoplasm has increased markedly. In parallel with the increasing doses of TP, autophagic vacuoles increased in the cells. In addition, it was observed that there were many extra vesicles closely related to the cells. Microscopic evaluations revealed numerous cells with cytoplasmic membrane blebs and numerous apoptotic cell bodies. On the other hand, we eliminated a large number of cells using the plant extract, but the remaining cells were highly CD117 positive. The presence of these CD117 positive cells which act as cancer stem cells. These findings suggested that the efficacy of the extract was limited on these resistant cells. For that, the plant TP a natural tetraploid endemic in our country, has an apoptotic cell death-inducing effect on GBM cells and may be more effective when used together with tyrosine kinase inhibitors such as imatinib.

Keywords: Trifolium Pratense, Glioblastoma, cancer, cell culture.

TURK TRIFOLIUM PRATENSE L. INDUKTOI APOPTOZËN DHE AUTOFAGINË NË QELIZAT GLIOBLASTOMA C6, POR NUK ISHTE EFEKTIVE NË QELIZAT BURIMORE TË KANCERIT.

Gamze Tanrıverdi[1], Aynur Abdulova[1], Hatice Çölgeçen[2], Havva Atar[2], Belisa Kaleci[2], Tuğba Ekiz-Yılmaz[3]

[1]*Universiteti i Stambollit-Cerrahpasa, Fakulteti i Mjekësisë Cerrahpasa, Departamenti i Histologjisë dhe Embriologjisë, Stamboll, Turqi.*

[2]*Universiteti Bulent Ecevit, Fakulteti i Arteve dhe Shkencave, Departamenti i Biologjisë, Botanikë, Zonguldak, Turqi.*

[3]*Universiteti i Stambollit, Fakulteti i Mjekësisë i Stambollit, Departamenti i Histologjisë dhe Embriologjisë, Stamboll, Turqi.*

Abstrakt

GBM shfaqet tek të rriturit me një incidencë prej 16% të të gjithë tumoreve parësore të trurit dhe 54% të të gjitha gliomave. Është lloji më i zakonshëm i tumorit primar të trurit. Aftësia për të riprodhuar me shpejtësi dhe truri përreth karakterizohet nga një tendencë për t'u përhapur në mënyrë agresive dhe fort në inde. Qasja standarde e trajtimit të GBM është rezeksioni kirurgjik i ndjekur nga kimioterapia e njëkohshme dhe rrezatimi. Fatkeqësisht, një numër i konsiderueshëm i rasteve të GBM zhvillojnë rezistencë ndaj barnave kimioterapeutike të përdorura. Prandaj, ekziston një nevojë urgjente për zhvillimin e agjentëve të rinj kimioterapeutikë. Tërfili i kuq, i njohur edhe si Trifolium Pratense L. (TP) është një bimë endemike që përmban izoflavone të ndryshme si biochanin A, genistein, daidzein dhe formononetin në përqendrime të larta. Vlerat IC50 të eksperimentit ishin doza 12,5 µg dhe 25 µg dhe shënuesit apoptotikë kaspaz-3, aneksin V dhe citokrom-c u përcaktuan në nivelet më të larta në këto grupe. Gjithashtu, u përcaktua se grupet e kontrollit përbëheshin nga qeliza të zgjatura në formë boshti me mitokondri në morfologji normale, Golgi të zhvilluar mirë dhe një GER dhe SER të spikatur. Në grupet e dozave efektive 12.5nM dhe 25nM, qelizat kanë humbur formën e tyre të zgjatur dhe tregojnë forma të rrumbullakëta ose poligonale. Mitokondritë u dëmtuan dhe strukturat kristae ishin të degjeneruara. Cisternat GER dhe SER ishin shumë të zmadhuara dhe me forma të çrregullta. Qelizat kanë morfologji anormale dhe pamje citoplazmike, dhe numri i strukturave vezikulare në citoplazmën e tyre është rritur ndjeshëm. Këto gjetje sugjerojnë se efikasiteti i ekstraktit ishte i kufizuar në këto qeliza rezistente. Për këtë, bima TP një endemike natyrale tetraploid në vendin tonë, ka një efekt apoptotik që shkakton vdekjen e qelizave në qelizat GBM dhe mund të jetë më efektive kur përdoret së bashku me frenuesit e tirozinës kinazës si imatinib.

Fjalë kyç: Trifolium Pratense, Glioblastoma, kancer, kultura qelizore

DEPISTIMI I FIBROZËS KISTIKE.

Ilda Ndreko[1], Ariola Kosta Zeqirllari[2]
[1]*Qendra Shëndetësore Nr.1, Fier, Shqipëri.*
[2]*Qendra Shëndetësore Nr.8, Tiranë, Shqipëri.*

Abstrakt

Hyrje: Fibroza kistike (FK) është një çrregullim gjenetik që prek më shpesh mushkëritë, por gjithashtu pankreasin, mëlçinë, veshkat dhe zorrët e holla. Ajo është një sëmundje e trashëguar në mënyrë autozomale recesive. Shkaktohet nga prezenca e një mutacioni në dy kopjet e gjeneve për proteinën rregullatore transmembranoze të Fibrozës Kistike (CFTR). Ata individë me një kopje të gjenit janë bartës dhe në pjesën më të madhe normal. Mutacioni më i shpeshtë F508 është një delecion i tre nukleotideve që rezulton në humbjen e aminoacidit Fenilaninë në pozicionin e 508 të proteinës. Ky mutacion numërohet në 2/3 e rasteve, afërsisht në 65-70% të rasteve të fibrozës kistike në mbarë botën. Megjithatë, mbi 1500 mutacione të tjerë mund të shkaktojnë Fibrozën Kistike (FK). Gjeni CFTR është gjetur në kromozonin e 7. Mutacione të tjera gjenden në proteina, këto janë shumë të shkurtra sepse prodhimi i tyre ka mbaruar para kohe. Mutacione të tjera prodhojnë proteina që nuk e

përdorin energjinë normalisht, nuk lejojnë klorin dhe tiocianatet të kalojnë membranën dhe degradojnë më shpejt se normalisht. Mutacionet gjithashtu mund të cojnë në prodhimin e më pak kopjeve të proteinës CFTR. CFTR përfshihet në prodhimin e djersës, lëngjeve digjestive dhe mukusjt. Kur CFTR është jofunksionale, sekrecionet të cilat normalisht janë të holla do të trashen. Kjo gjendje diagnostikohet nga testi i djersës dhe nga teste gjenetike. Fibroza Kistike është më e shpeshtë në Europën Veriore dhe prek 1 në 3000 të porsalindur. 1 në 25 individë janë bartës. Problemet pulmonare janë përgjegjëse për vdekjet në 80% të personave të sëmurë. Nëse 2 bartës do të kenë një fëmijë: 25 % ose 1/4 kanë shans për një fëmijë të sëmurë me Fibrozë Kistike, 50% ose ½ të jenë bartës por jo të sëmurë me Fibrozë Kistike, 25 % ose 1/4 nuk janë bartës dhe nuk e kanë Fibrozën Kistike. Nuk ka kurë, por ushqyerja e mirë dhe ndërmarrja e hapave që hollojnë mukusin dhe lehtësojnë nxjerrjen e tij mund të ndihmojnë.

Rast Klinik: A.B, 27 vjece, pa histori familjare për Fibrozë Kistike. Fëmija i parë lind spontanisht me peshë 3500 gr (2012) pas 4 muajsh ekzitues, diagnostikohet me Fibrozë Kistike. Të dy prindërit diagnostikohen bartës të mutacionit në gjenin e CFTR. Ata kanë 2 mutacione të ndryshme DELF508 dhe 621+1G>T. Fëmija i dytë (2013) është bartës i mutacionit si prindërit e tij. Fëmija i tretë (2016) është diagnostikuar me Fibrozë Kistike me amniocentezë në javën e 16 të shtatëzanisë. Eshtë bërë abort terapeutik. Fëmija i katërt (2018) është bartës i mutacionit për Fibrozën Kistike.

Përfundimi: Është e rëndësishme të bëhen analiza gjenetike për Fibrozën Kistike për të vlerësuar bartësit e mutacionit, që të parandalohen lindja e fëmijëve të sëmurë me Fibrozë Kistike.

Fjalë kyç: Çrregullim gjenetik, depistimi, Fibroza Kistike, prodhim mukusi.

EKUILIBRI MIDIS VETËKUJDESIT DHE MËNYRËS SË JETESËS GJATË PERIUDHËS SË PANDEMISË

Msc. Jada Caja[1], Msc. Tedi Mana[1], Prof. Tatjana Caja[2]
[1]Specialist Sektori Psikosocial, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"
[1]Psikolog Klinik, Spitali Psikiatrik, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"
[2]Fakulteti i Mjekësisë/Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"

Abstrakt

Përgjatë periudhës së pandemisë punonjësit e kujdesit shëndetësorë kanë qenë dhe janë ende linja e parë e mbrojtjes për këtë sëmundje.

Materiali dhe metoda: U morën në intervistë 50 personel shëndetësor, kampionim rastësor, përgjatë periudhës Tetor – Nëntor 2021, 15 mjekë, 30 infermier, 5 fizioterapist, të cilët kanë punuar në klinika, poliklinika dhe shërbim në banesë. Pas intervistave individuale u plotësua testi "Inventari i ekuilibrit midis vetëkujdesit dhe mënyrës së jetesës gjatë periudhës së pandemisë" si një instrument vleresimi dhe jo një instrument klinik diagnostikues pra e përdorur vetem për qëllime edukative.

Rezultatet: Pas intervistave dhe aplikimt të testit rezultoi se: 19 personel shëndetësor morën 0 – 29 pikë pra aftësitë e tyre të vetëkujdesit dhe strategjitë e ekuilibrit të stilit të jetesës ishin

të dobëta dhe mund të përfitojnë nga plani për të ndryshuar stilin e jetës së tyre dhe për të përmirësuar vetëkujdesin. 12 personel shëndetësor morën 30 – 59 pikë ku rezultati i kësaj game pikësh sygjeron se aftësitë e tyre të vetëkujdesit dhe strategjitë e ekuilibrit të stilit të jetesës janë mesatare dhe sërisht dhe kjo kategori mund të përfitojë nga plani për të ndryshuar stilin e jetës së tyre dhe për të përmirësuar vetëkujdesin. 11 personel shëndetësor morën 60 – 84 pikë ku rezulton se kanë aftësi të mira të vetëkujdesit dhe ekuilibrit të stilit të jetës por mund të përfitojnë nga përgatitja për periudha me stres të lartë duke shtuar disa praktika shtesë. 8 personel shëndetësor u kategorizuan me aftësi të mira të vetëkujdesit dhe strategji të përshtatshme të ekuilibrit dhe qëndrueshmërisë të stilit të jetesës.

Konkluzione: Në përfundim të intervistave klinike si dhe testit të aplikuar iu ofrua të gjithë pjesëmarrësve në këtë studim një plan vetëkujdesi dhe përmirësimi i stilit të jetës. Sfidat e profesionistëve të shëndetësisë gjatë periudhës së COVID-19 kanë qenë të pamatshme duke përfshirë largimin nga familjet e tyre, sakrifica me orë të zgjatura në punë, vdekshmëria e lartë e pacientëve të hospitalizuar, mungesa e aktiviteteve etj. Çfarë ne kemi dashur të shprehim në këtë mini studim është se profesionistët e shëndetësisë kanë nevoja të mëdha për plane të detajuara për vetëkujdesin si dhe strategji për ruajtjen e ekuilibrave dhe të paturit një stil jete të qëndrueshëm.

Fjalë kyç: pandemi, personel shëndetësor.

PROCEDURAT E KONTROLLIT TË CILËSISË NË KAMERAT GAMA ME DY KOKA DHE NDËRTIMI I NJË FAQEJE INTERAKTIVE ANALITIKE NË INTERNET

Jurgen Shano

Abstrakt

Gama kamera është një paisje imazhuese në mjeksinë nukleare. Ajo është e ndërtuar nga një ose më shumë dedektorë planarë. Dedektorët planarë janë të ndërtuar nga tre komponetë kryesorë: kolimatorët, tubat fotoshumëzues dhe qarku amplifikues. Në mënyrë që gama kamera të funksionojë sipas standarteve të përcaktuara nga NEMA, ne duhet të kryejmë kontrolle periodike të cilësisë. Kontrolli i cilësise së gamma kamerës është një proçedurë që ndeshet shpesh në punën tonë të përditshme si Fizikantë Mjeksorë. Por pa njohuritë dhe eksperiencën e duhur ky proçes bëhet i vështirë dhe shpesh herë i pamundur për t'u realizuar. Për t'ju ardhur në ndihmë studentëve dhe fizikantëve mjeksorë të rinj, kemi krijuar një platformë online në të cilën mund të gjesh të gjithë informacionin e nevoshëm duke përfshirë edhe video demonstruese. Webpeage i krijuar do të jetë free dhe me akses të pa kufizuar.

INFEKSIONET E TRAKTIT URINAR NË MOSHAT ADULTE

Venemin Gega
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"

Abstrakt

Hyrje: Infeksionet e traktit urinar (ITU), u referohen pranisë së inflamacionit të traktit urinar të sipërm dhe të poshtëm, si përgjigje e pranisë së patogjenëve të ndryshëm. Ato kanë një përhapje të konsiderueshme në të gjitha moshat si dhe në të dyja gjinitë dhe janë një prej infeksioneve më të zakonshme tek adultët. Infeksionet e traktit urinar janë një problem i shpeshtë në mbarë botën të cilat shkaktohen nga pushtimi mikrobik në inde të ndryshme të traktit urinar.

Qëllimi: Qëllimi i ketij studimi është të vlerësojë parametrat urinar si dhe të përcaktojë shkaktarët kryesorë të infeksioneve të traktit urinar në moshat adulte. Të përshkruhen karakteristikat e grup popullatës së marrë në studim (femra/meshkuj, moshë, vendbanim).

Metodologjia: Studimi u realizua në një laborator jopublik në qytetin e Elbasanit gjatë periudhës Qershor - Shtator 2021. Këta individë janë paraqitur në laborator për një kontroll të përgjithshëm të urines. U bë pjesë e studimit çdo pacient i moshës mbi 18 vjeç që realizoi këto analiza: analiza klinike e urinës, urokultura. Analiza klinike e urinës përfshiu një kontroll fizik, kimik dhe mikroskopik të mostrave të urinës. U morën të dhëna demografike dhe klinike për çdo pacient.

Rezultatet: Prej 160 pacientëve që u përfshinë në studim 80 ishin meshkuj dhe 80 femra. Prevalenca e ITU rezultoi më e lartë tek femrat, krahasuar me meshkujt. Në urokulturë, bakteri më i shpeshtë shkaktar i ITU rezultoi Escherichia coli, për të dyja gjinitë.

Konkluzionet: Ekzaminimet laboratorike urinare së bashku me simptomat urinare duhet të vlerësohen me kujdes në përcaktimin e diagnozës së ITU. Ky studim vuri në dukje rëndësinë e ekzaminimit klinik të urinës dhe urokulturës në vendosjen e diagnozës së ITU.

Fjalë kyç: adultë, infeksion, trakti urinar, urokulturë.